KALOSH ÇELIKU
RRUFJANI

Biblioteka
**XHA DERALLA**

Redaktor letrar
**GANI XHAFOLLI**

Redaktore gjuhësore
**LAURA ÇUKA**

Ballina
**ADEM KASTRATI**

Karikaturat
**DHIMITËR LIGORI**
**ADEM KASTRATI (CUN GELI)**
**ZENI BALLAZHI**

Copyright by Asdreni

# Kalosh ÇeliKU

☼☼✞☞☺✌☠✋

***(Libër për Nesër)***

**Asdreni**

Shkup, 2013

*Tani ju urdhëroj të më humbisni mua e të gjeni vetveten: dhe vetëm, kur të gjithë të më keni mohuar atëherë do të kthehem tek ju...*

***Friedrich Nietzche***

**Në vend të parathënies**
**ÇELIKU ZË VEND TË VEÇANTË NË LETRAT SHQIPE**

Në kulturën dhe letërsinë shqiptare vepra e Kalosh Çelikut zë një vend të rëndësishëm si nga cilësia ashtu edhe nga sasia. Deri më tani për veprën e Kaloshin kanë shkruar shumë kritikë e miq të tij, por asnjëri nuk i ka prek disa veçori dhe aspekte të veprimtarisë së tij letrare. Askush nuk është marr me personalitetin e tij, si është ndërtuar, prej nga gjithë ai guxim intelektual dhe ajo çka është më e madhe më e rëndësishme dashuria e tij për bërjen e atdheut-mëmëdheut, por kjo e shprehur dhe e thënë krejt në një formë tjetër. Edhe lehtas me i ra veprës së tij zbulon të gjitha këto që u thanë më parë, por çështja është se duhet pranuar se ai në këto aspekte qëndron shumë lartë, është i panënshtruar, nuk shembet dot por i merr nëpërkëmbë të gjithë ata që mundohen me folklor të rrasin hundën atje ku nuk duhet dhe nuk e kanë vendin. E para nga të gjitha, personaliteti i tij është krijuar (ndërtuar) në dy periudha.

Për të qenë afërsisht të saktë duhet vepruar ashtu siç kanë vepruar edhe me krijuesit e tjerë, d.m.th. personaliteti i tij duhet të zbërthehet nëpërmjet veprimtarisë letrare. Njeriu është pasqyrë e veprës së vetë, dhe ajo mund të thuhet apo shprehet në njëmijë mënyra, por asaj të shkruarës nuk mund t'i ikësh dot dhe as ta nënçmosh.

Është me rëndësi të theksohet se pena e tij e mprehtë, përherë ka sjellë frymë të re, ka sjellë ka trajtuar në mënyrë të shumanshme fenomenet e shoqërisë, të elitave politike (nëse mund të thuhet kështu ngase elita politike është shumë vështirë të takosh tek shqiptarët), të elitave krijuese me një ndjenjë të hollë e me buzëqeshje ironike, me një stil satirik, me shumë shaka. Autori sikur ka vendosur që të luftojë hijet e zeza dhe fenomenet që stërkeqën dhe ngulfasin jetën kulturore, sociale, por më mirë thënë atë kombëtare, andaj në shënjestër të penës së tij kanë qenë, dhe vazhdojnë që të jenë krijuesit e oborreve, klanet që merren me fate njerëzish, thënë më saktë ata që ia kanë zënë frymën artit, kulturës, progresit, të ardhmes dhe zhvillimit e mirëqenies kombëtare. Është e natyrshme dhe historikisht e dëshmuar se fletët e veprave të krijuesve oborrtar kanë jetë të shkurtër dhe bien si gjethet e vjeshtës, apo më mirë thënë ikin bashkë me thinjat e tyre. Këto kinse vepra, ka raste që zverdhen më herët dhe atë me ndërrimin e klaneve politike, por pas lënë shëmti që duhet dikush ta shërojë, e autori ka vendosur që t'i luftojë për së gjalli.

Kaloshi për dallim nga brezi i ri i letrarëve, është krijues i dy periudhave. Të dy sistemeve u ka qëndruar stoik. Vertikal. Në kohë të pakohë, apo më mirë thënë në kohën kur nuk të qeshej e ti detyroheshe të qeshje me zë, apo kur nuk të qahej e ti nxjerrje lot krokodili (apo vajtoje përpara të tjerëve, kjo bëhej për dëshmi).

Që të mos bëje as njërën as tjetrën duhej të heshtje apo të fshihesh në dimi të grave, ndërsa të

mos e bëje as njërën as tjetrën dhe të mos fshiheshe në dimi të grave do duhej të ishe krijues si Kaloshi, të mos përfillje asgjë dhe me lapsin shaluar të ndaje shapin nga sheqeri, të ecje rrugës sate. Për të dëshmuar se kush është Kalosh Çeliku, që mbeti vertikal, dhe iu bëri ballë furtunave së pari duhet studiuar veprën, veprimtarinë dhe krijimtarinë e tij. Kur them veprën, veprimtarinë dhe krijimtarinë dua të sqarohem se të tre këto elemente tek Kaloshi shkojnë ndaras, nuk janë tërësi, prandaj ai ka ditë të ecë për tehut të thikës e të mos grithet, e çka është më e rëndësishme të mos lëndoj të tjerët, për t'iu shkaktuar dhimbje, e në të njëjtën kohë të jetë paralajmërues dhe hapur tua thotë se kush e fik dritën që dukej rrallë në horizont, apo kush i bënë hije rritës së kombit, kush ia zë frymën së ardhmes. Kaloshi në jetë është bohem, këtë e ka zgjedhë vetë, ndërsa me veprën unë kuptoj të gjitha publikimet e autorit. Veprimtaria e tij është pak më e gjerë se vepra, ajo përfshin edhe shkëmbimet e mendimeve, takimeve të ndryshme të paregjistruara si individuale, pjesëmarrjen në shumë manifestime kulturore e letrare si dhe organizimin e shumë evenimenteve poashtu letrare. Ndërsa krijimtaria e tij është vepra letrare, ajo që rrezaton dhe i bënë ballë çdo kohe, që e mbijeton atë. Veprimtaria e tij përfshin edhe personalitetin e tij, karakterin që ka ndërtuar dhe sa bënë dallim personaliteti dhe karakteri i tij kundrejt karakterit dhe motivit në veprën e tij letrare. Studimi i veprës së autorit, patjetër do duhet që të marr për bazë këto tre dimensione për të qenë me afër të saktës. Kaloshi në veprën e tij

letrare për motiv ka zbërthimin e skenarëve që përgatisin klanet e ndryshme, ai do të herr krijesat e kamufluara me karaktere të dobëta, shpirtzinjtë, plëngprishësit që për një asht dredhin bishtin në oborrin e dushmanit. Duhet thënë kështu se, vepra e autorit krijohet nga personazhet e tilla reale dhe jo të imagjinuara, ngase herë pas here ata vetë na dalin në sipërfaqe duke dëshmuar për punën e tyre në shërbim të detyrave ditore.

Kur personazhin e ke përpara dhe vetëm emrin ia ndërron është guximi i tij intelektual ndërsa në anën tjetër është origjinaliteti se personazhi është i gjallë vepron, me të gjitha të mirat dhe të këqijat, ndërtimit të figurës së tij si mungon asgjë. Ta prekësh këtë fenomen, ta luftosh këtë dukuri duhet të kesh dashuri të madhe për atdheun-mëmëdheun, (se personazhet e Kaloshit janë dëshmitar të mbrojtur nga çdo sistem, nga çdo klan politik) e këtë (guxim) e ka autori i shumë veprave. Lapsi i tij, ngjarjeve ditore nuk iu bëri asnjëherë shërbime, as në periudhën e parë të krijimtarisë së tij në kohën e komunizmit, por as në atë të dytën që thuhet periudha demokratike, ai nuk vrapoi si disa të tjerë që me kalbëzimin e sistemit të njëmendësisë zunë vendet “atdhetare”, sakrifikuan lot e fjalë  për të qenë në ballë, madje ata u uniformuan dhe në veprën e autorit fituan titujt e merituar, që vetëm ai di t’i pagëzoj për punën e bërë.

Vepra tregon vetë, andaj ai, me penën e tij i zhveshi nga veshja falso,  nga ideologjia e  tyre  e ndyrë, duke i marrë si personazhe, duke nxjerrë në shesh qelbësirën e veprave të tyre, dhe  mykun

e tyre të ngjitur për lëkurë të pushtetit. Ai i vendosi në sirtarët e krijesave të pashpirt, aktor të salloneve, duke lëpirë pjatat si zagarë e bushtra. Krijimtaria e tij letrare është shumë e hershme, shumëdimensionale, në aspektin e gjinive letrare ka shtrirje të gjerë, e demonstruar me shumë publikime dhe tituj të arrirë, me simbolik të zgjedhur nga letërsia popullore, nga kjo krijimtari e denjë e krijuar nga të parët tanë. Qëllimi im nuk është të analizoj të gjithë veprimtarinë, as të ndalem në ndonjë nga veprat e tij të shumta, qoftë ato poetike apo në prozë, por dua të them atë që përherë ma ka shtuar kureshtjen për njërën apo arsyen tjetër.E para; pena e tij hidhet lirshëm nëpër sallone, kuvende, kisha e xhamia, shkolla e biblioteka madje ajo ia tejkalon fuqisë së një pushke, shpesh bëhet top. Për të ecur dhe shënuar e shkruar në një mënyrë të tillë duhet mbi të gjitha guximi i lart intelektual, trimëri, dhe kur e ke këtë guxim bëhesh i veçantë. Shpesh herë në hapësirën tonë ndodhë që të thuhet se çka bëre për atdheun, dhe po të ndalesh në veprën e Kaloshit dhe ta analizosh në hollësi ai (Kaloshi) na del më atdhetar jo vetëm si personalitet, jo vetëm pse për armë pati lapsin, por me sakrificën që ka bërë në përzgjedhjen për të pastruar oborrin e çdo shtëpie, odën e çdo kuvendi nga fara e keqe (rezile), kolltukët e çdo institucioni, lavdëruesit e çdo manifestimi, duke paralajmëruar për hienat që ulen në ballë të çdo ndodhie, si ata që “kokën e kanë në xhami e bythën te partitë politike”, është sakrificë e tipit të veçantë, është guxim, është trimëri.

Kjo është një veprimtari e veçantë e autorit, por ai e ka shaluar lapsin që vepra, mundi dhe sakrifica e tij të mos zhduken, të jetojnë, të vlerësohen e çmohen nga pasardhësit dhe të mbeten në sirtarët e letrave shqipe madje atje në majë. Kaloshi edhe pse krijoi pa ndalë, pandërprerë, ai kurrë nuk ra preh e dogmave ditore, e kulteve të rreme, e madhështisë së kamufluar ideologjike, por çdo herë doli mbi të gjitha duke bërë luftën me laps e gotën plot. Gota plotë, mikja e lazdruar dhe jeta boheme ishin hajmalia e tij, për të ec lirshëm dhe për t'u kuptuar vonshëm. Kjo që them duket ironike për krijuesin oborrtar, për krijuesin partiak, për atë që e do atdheun që t'i flejë në krahë dhe ky në qetësinë dhe sigurinë absolute të jetojë me plotë lavde që ia thurin "trusakatët"... Kaloshi është mjeshtër i fjalës së shkruar, por është edhe nxitës për të zënë dritën. Ai përherë na e zbardhon se, të keqen e kemi në mesin tonë, në oborr, në kuvend, në tryezë, në dhomë! Vepra e tij po të lexohet me kujdes na e tregon rrugën, por jo me patetikën dhe këngën për vete që e duan "Rrospitë meshkuj". E keqja është se të tjerët duan lavde, dhe ai nuk këndon por ligjëron, dhe nuk më ka rënë rasti që me disa vargje të zbulojë mjerimin kolektiv të pasardhësve të ilirëve, ashtu siç e thotë Kaloshi në një poezi nga përmbledhja "Atdheu ky burrë pa Grua":

***DIKUSH NA KA BËRË MAGJI***

*Bashkë kur jemi. Ikim nga njëri - tjetri*
*E larg. I turremi marrëzisht me poezi.*

*O Imzot! Dikush na ka bërë magji,*
*Sukulla na ka futur nën jastëk. Hajmali.*
*Pare na ka varë në ballë për Shëngjergj*
*Nuk ka Babasheh që na i përze xhindet.*

*Dikush na ka bërë magji. Hajmali.*
*Xhindet të na flakin majë lisave...*

Këto vargje janë shumë domethënëse dhe kanë shtrirje aq sa është gjeografia e hartës shqiptare, që nuk na nderojnë por na udhëzojnë të gjejmë rrugën e përbashkët, na thonë ta duam njëri - tjetrin, të mos ikim nga njëri - tjetri, të mos shpifim... Këto vargje udhërrëfyese, atdhetare, edhe pse autori prek dhe përdor letërsinë popullore dhe bënë krahasime shumë të qëlluara me paren në lule të ballit.

Të rralla janë veprat që për motiv kanë artistiken dhe në të njëjtën kohë edhe atë atdhetare (kritike), kjo është arsyeja e dytë që më ka shtuar kureshtjen time për të thënë diç për veprën dhe autorin e lartpërmendur. Ajo që na sjell autori në veprat e tija të fundit është e përkryer në formë dhe shprehej, në art ai ka formuar ligjërim shumë të kapshëm me fjali të shkurtra e plotë kuptim, me harmoni dhe muzikalitet të lezetshëm, me shprehej autoktone, me një stil shumë të veçantë e origjinal, duke hedh në tregun e letrave shumë fjalë e togfjalësh të vjetra shqipe që i përgjigjen momentit e situatës, pastaj guximi intelektual atij, i jep të drejtën e lojës si tallës dhe hokatar të fenomeneve të shoqërisë, kjo mbase ia shtonë më së shumti vlerën veprës së tij, e bënë të afërt me lexuesin,

thjeshtë lexuesi bashkudhëton me personazhin, komunikon, është më shumë se reale, me personazhe të jetës së përditshme. Mënyra se si ai i palos për dheu kalorësit e rremë, heronjtë që shkrihen nën hijen e vetë, me formën e veprës artistike, e cila vepër në të njëjtën kohë bart me veti edhe shpatën kritike duke shpalos të bëmat e "atdhetarëve dhe krijuesve oborrtar, trimave të rremë, mashtruesve, parazitëve, madje duke hyrë edhe në kuvendet e rreme të trusakatëve", ai tani më del një udhërrëfyes i së ardhmes, ai është një njeri që ka parashikuar se si duket e ardhmja, ai është një përfytyrues se me personazhet e skenës nuk bëhet atdheu-mëmëdheu. Për ta thënë në një mënyrë si shpata me dy të prera, që lexuesi të komunikoj lirshëm duhet guxim shumë i madh, dhunti dhe mjeshtri e të shkruarit, veti këto që ai ka arritë t'i zotërojë. Autori hapur shprehet për çdo fenomen shoqëror. Guximi i tij intelektual shprehet përmes vargjeve:

*Unë nuk e dua këtë Shtet. Ferrparajsë*
*Që e duan trusakatët. Rrugaçët kuqezi.*
*Rrospitë Meshkuj. Dhe, Doktor Ziu.*
*Unë e dua Mëmëdheun! Dhe, Atdheun.*
*Unë nuk e dua këtë Shtet policor. Ferrparjsë*
*Ku ma dhunuan Mëmëdheun. Dhe, Atdheun.*

*E, shtiret se më do shumë Mua poetin rebel*
*Pusi më vë pas ferre. Rrugën mos ta vazhdoj*
*Për në Baba Tomor. Vendin e Perëndive*
*Vera ku pihet. Shkruhet poezi. E bëhet dashuri.*

***Unë e dua Mëmëdheun! Dhe, Atdheun...***

Këto vargje tregojnë për madhështinë e poetit dhe personalitetin e tij të ngritur, për diapazonin e tij. Ai nuk e do shtetin që për njërin është ferr e për tjetrin parajsë. Ai nuk e do shtetin që e udhëheqin trusakatët dhe rrugaçët, ashtu siç nuk duhet që ta duan as ata me pare ne ballë, dhe të cilëve u është dhunuar mëmëdheu. Kur thotë; "***Unë e dua Mëmëdheun! Dhe, Atdheun***" poeti tregohet shumë liberal, shumë demokrat. Vetëm shqiptarët kanë dy emra për "*Atdheun*", se siç thotë Lukiani "*nuk ka asgjë më të ëmbël se atdheu*", ndërsa Kaloshi në mënyrë ironike i porosit shqiptarët se nëse keni marr mëri nënën, duajeni të atin dhe të kundërtën, por na e bart porosinë e Lukianit se; "*çdo gjë që njerëzit e quajnë të shenjtë dhe të lartë, atyre ua ka mësuar atdheu, sepse ky i lindë, i rritë dhe edukon*", andaj ai i fton për të bërë atdheun, po të duan mundet edhe mëmëdheun, por jo shtet "*ferrparajsë*", që e duan "*trusakatët, rrugaçët kuqezi dhe Doktor Ziu*". Ai na fton për në Baba Tomor ku është kryegjyshata botërore, një vlerë që bashkon.

Ai thirr në dashuri si Petefi "*Për dashuri e jap jetën e për atdhe dhe dashurinë*". Kaloshi ka përgatitje të lartë, është mjeshtër i vargut dhe këtë e sjell në njëmijë mënyra tek lexuesi, andaj vepra e tij është largpamëse, udhërrëfyese dhe atdhetare.Pena e tij ka lëvruar gati në të gjitha gjinitë letrare duke filluar nga letërsia për fëmijë, poezia, poema, satira, novela, tregimi, drama, romani dhe tani në kohë të fundit ai e ka shaluar bukur fortë lapsin e tij si publicist. Periudha e parë e krijimtarisë së Kalosh Çelikut është ajo në regjimin komunist dhe më shumë i përket

letërsisë për fëmijë. Ai në këtë kohë krijoi veprat më të mira "*Zogu erdhi me një këngë*", "*Arusha pa bisht*" , "*Lepuri me pushkë*" etj. Periudha e dytë e veprimtarisë së tij letrare fillon menjëherë pas rënies së komunizmit si ideologji, por jo që ndryshoi diçka se, atë pushtetin e grabitën po të njëjtët, vetëm se të kamufluar në demokratë. Në këtë periudhë Kaloshi është shumë frytdhënës mbase i inspiruar nga morali i ultë i shoqërisë që shkojnë me personalitetin e tij dhe armët që ai ka përgatitur për t'iu kundërvënë.

Kjo është koha kur autori nis e krijon veprat më të mira për të rritur, me të cilat ai goditi tërë një sistem që mundohej në ngrihej në themele të vjetra, në ide gënjeshtare, më dogma mashtruese. Me satirën e tij të rreptë, me ironinë e pasur, me shakanë hokatare, ai shumë qartë paraqet rënien morale të shoqërisë dhe krijoi figurat e urryera të atdhetarëve të rrejshëm, të letrarëve të shitur, lajkatarëve të oborreve, të klerikëve sharlatan, të atdhetarëve mashtrues si dhe personaliteteve të ndryshme të degjeneruar. Të gjithë llumin e veseve e vë në lojë, por kjo është e mira se na nxjerrë në sipërfaqe fenomene të stërkequra shoqërore që jetojnë në kurriz të huaj.

Po të shihen me kujdes veprat e krijuara që nga viti 1995 nga publikimi i përmbledhjes me poezi "*Loja e syve*", "*Vjellja e zorrëve*" (!996) si dhe romani "*Varrimi i sorrave*" (1998), Kaloshi paralajmëron një stil të veçantë për të lënë gjurmë në letërsinë shqipe, dhe do na dalë si një krijues i pakënaqur duke sjellë në skenë çdo herë fenomene të shfrenuara, të një shoqërie të korruptuar, të babëzitur për pushtet. Është më se e

vërtetë se në këtë periudhë të krijimtarisë së tij klanet politike dhe ato të pseudokrijuesve janë në rritje, dhe kjo ka ndikuar që ai në veprën e tij përherë të marrë shtambat me verë dhe Miken që t'iu bëjë ballë mediokërve letrar, harbutëve politik, atdhetarëve të rrejshëm, por në të njëjtën kohë ata të gjithë së bashku me punën e tyre, Kaloshit në mënyrë të tërthortë i falin veprat më të mira. Duke përdorë në shumë raste edhe letërsinë popullore si një gurrë e pashtershme, ku motivohej për të parodizuar situata e raste, ai jo vetëm që luftoi, zhvilloi luftë të hapur, por padashtas bëri kapërcim triumfal dhe krijoi një stil të veçantë në letërsinë shqipe ku krijoi dhe letrarë të ri që e ndoqën pas. Vepra e autorit përveç fjalës artistike, ironisë dhe satirës, humorit autokton, përmban edhe një fije të hollë polemizuese që nga fillimi e deri në fund. Vepra e tij përherë shton polemikën në mes të grupeve, ndërsa polemika është vlera e një shoqërie për të ecur drejt progresit, këtë ai e bënë me mjeshtri. Personazhet e veprës paraqiten shumë natyrshme me të gjitha pasionet që i mundojnë, që nga pasionet erotike e gjer të lakmia e babëzitur për para, për pushtet a për lavdi të pamerituar. Satira e tij nuk kursen asgjë, ajo ecë, depërton në çdo derë që harrohet hapur, madje hynë edhe nëpër dritare, atje ku bënë sefa morali i shthurur shoqëror, atje ku shihen njollat e baltës së korrupsionit. Pena e tij e mprehtë ia nxjerrë bojën vesit, korrupsionit, madhështisë së rreme, duke luftuar pamëshirshëm moralin dhe veset e një shoqërie të shthurur. Autori personazhet i nxjerrë fare të vockël mizerabël, të rrëmbyer nga pasionet

me të ulëta, me aventura të kushtëzuara dashuriçkash, me intriga e prapaskena. Satira e tij të kafshon duke qeshur, duke bërë sefa në sallone e në tryeza. Thelbi i veprës së Kaloshit është përpjekja për të luftuar dhe demaskuar përpjekjet e mashtruesve, intrigave dhe skenarëve të rrejshëm ndërsa forma është ironia, satira dhe sarkazma që thuren aq bukur dhe me një stil të përkryer komunikues me lexuesin. Kaloshi letërsisë shqipe i ka falë shumë vepra artistike, ndërsa atdheut-mëmëdheut të tij i ka treguar se si duhet luftuar atdhetarët-mëmëdhetarët e rrejshëm, kulturës se si duhet të bëhet dhe me se bëhet, por edhe si pihet verë me dy shtamba dhe si bëhet dashuri. Vepra e tij thotë shumë, meriton shumë dhe është një nga veprat më të veçanta, se të veçantë janë krijuesit që për armë kanë elementin e ironisë dhe të satirës...

**SAFET HYSENI**

I PROFETI

**KRYEVEPRA**

Vërtet, ju shumë fshehtësi nuk i dini në këtë kryevepër artistike. E vrisni kokën, i shtrydhni trutë. E rrotulloni memorien. Po të kishit mundësi të më kishit më afër mbi kokë edhe do të më pyesnit, ja ta zëmë, për Torbën e Hoxhës. E di se çka ka pasur ajo brenda? Jo. E di vetëm Xhadia, e cila edhe është autorja e saj dhe shumë-shumë nja njëzet veta që kanë qenë në prova. Të tjerët ama nuk dinë asgjë për Torbën e Hoxhës se me çka ishte e mbushur atë natë. Ia hapnin grykën në mes të skenës, i nxirrnin një nga një kryengritësit.

E të nsërmen, kur salla u mbush plot me patriotë artdashës e zonja të rënda të salloneve, më kot e prisnin Torbën e Hoxhës në skenë. Megjithatë, përsëri u kënaqën zonjat së qeshuri duke prekur njëra-tjetrën me bërryla. Herë pas here edhe qeshnin me zë, u kënaqën me art e kulturë e lot. Vetëm se, gjatë gjithë premierës më dukej se u mungonte diçka, dihet Torba e Hoxhës. S'di pse ashtu kot mendoja se komedia vetëm aty e arrinte kulminacionin, do të tundej salla nga duartrokitjet. Ndodh, ndonjëra edhe të bënte vetëvrasje ose të ngjitej në skenë dhe t'ia rrëmbente torbën Xhadisë nga duart. Ç'ka s'mund të ndodhte gjatë asaj premiere.

Prandaj, edhe e pritja në çdo moment shthurjen e komedisë. E ajo erdhi si e porositur nga mesi i sallës.

- Nxirreni Torbën e Hoxhës! Torbën e Hoxhës e duam në skenë!...

Publiku për disa çaste heshti. Unë qesha me sa zë që kisha dhe u rash duarve shuplakë. E dini se qe akt i përkryer. Torba e Hoxhës ishte kulminacioni i komedisë patriotike. Zonjave putane dhe zotërinjve s'kam çka t'u them, vetëm ato e kuptojnë artin e lartë të salloneve…

Gjashtë muaj me radhë flitej tryezë më tryezë në Pazarin e Grave se Xhadia nga Majat e shqipeve këto ditë do të ekspononte një eksponat të veshjes kombëtare, "vëllazërim-bashkimit". Merreni me mend se, në ç'hall ka qenë Pazari i Grave, e të mos flasim për nuset me pashterka të kuqe e kalimtarët e rastit që kthenin për një palë çorapë ose shami. E kishin tjerrë e zgjatur këtë risi, saqë shumica mezi prisnin t'i shohin me sy gjithë ato breza e gajtana. E të mos e teprojmë më për këmishën kuqezi apo kësulën e bardhë. Vetë autorja e kësaj vepre kombëtare në disa biseda të rastit patë thënë: *se do të shihni se si endet arti plot dy sahat në sallë*. Megjithatë, e kam vështirë me ju, se nuk jeni mësuar me kryevepra botërore. Vetëm ç'faj kam unë që më keni rënë hise dhe duhet t'ua mësoj shkronjat e artit hyjnor, të "vëllazërim – bashkimit".

Tekefundit, tha: edhe ju zotërinj është koha që të ballafaqoheni me gjenitë femra. Burrneshat që

ia shkrepin artit, qoftë edhe dy sahat këtu në mes të Bit-Pazarit.Vërtet nuk e besoj të merreshin me diç tjetër banorët e Pazarit Grave më shumë se me kryeveprën që do ta linte në tryezë Xhadia. Ndonjëri edhe e tepronte, shkonte aq larg saqë thoshte se ju jeni të krisur, atë duhet mbajtur ja kështu, në duar. Apo t'i rrokni çiftelitë dhe t'i këndoni këngë patriotike. Kuptohet, nga një inspirim i këtillë, vërtet, unë i kushtova një elegji me çifteli. E tjetër është ajo se a mbeti e kënaqur apo kërkonte diç edhe më të madhe, ta zëmë ndonjë himn ose baladë. Ndoshta mu kjo edhe e zemroi, që atë ditë kur e nxori veprën e saj në tryezë karshi Diellit me rreze, mua me qëllim më la pa ftesë. Në këtë Pazar të Grave kishin eksponuar edhe autorë të tjerë, po unë vetëm kësaj radhe duhej të hyja pas shpine për t'u ndeshur me patriotiken, të bukurën në errësirë. Më kot e luta Shitësen e biletave. Ajo më tha se, kishte urdhër të mos jepte asnjë biletë jashtë klaneve "aristokrate" që e dinin se ç'është arti hyjnor i aristokratëve. Rendet e para ishin rezervuar për gratë dhe burrat e partive "demokratike" politike, patriotët e kulturofagët e dëgjuar anembanë Bit-Pazarit.

- Zotëri, - më thirri dikush pas shpine. E ktheva kokën. Ishte Vjollca Rrapi.

Aty për aty e ngadalësova hapin. Vendosa ta pres, të përshëndetem me atë zonjë. Edhe pse dikush mund të mendonte ku ta di unë çka, ndonjë rrotullim në kashtë. Punemadhe.

- Hë, edhe ti nuk ke biletë?

- Jo, - më buzëqeshi ajo si në kornizë.

- Eja pas meje!

Matanë sallës, nga një derë e fshehtë nëpër korridor u ngjita shkallëve dhe hyra në një derë tjetër të hapur krah më krah. Edhe ajo hyri pas meje. Më në fund pranë një reflektori ishte një karrige. E afrova dhe i thashë: Ulu, pushoi sytë!

- E këmbët? – u tall ajo.

- Këmbët dorëzoja errësirës!

- Kam frikë, - përsëri më ngacmoi ajo…

- Unë jam këtu… Shtrihu rehat, nuk të rrezikon Nëna Parti!...

Vetëm tashti, pasi kisha hyrë brenda, e pashë se gjëndesha në një verandë, në mesin e bërllokut. Nga i shikoja si në pasqyrë të gjithë ulur nëpër rende: Intelektuali i Rrejshëm, Zonja Kuqezi, Komunisti i Arratisur, Tellallja e Nënës Parti, Koordinatori Liberator, Yllkuqi i Shkupit, Shkrimtari i Madh, Gazetari i Oborrit e dhjetra të tjerë nga Klubi i Tullumbave. Në një rend e pashë edhe Gungaçin, Dr. Madhin, Ebu Xhehlin… Diku nga mesi sytë ma zunë edhe Rrospinë Mashkull. E përcillte me vëmendje ngjarjen, lëvizjet në skenë, burgun famëkeq, flamurin kombëtar që e kishin bërë edhe leckë edhe setre.

E pranoj se atë natë e ndjeva veten të lumtur, që nuk gjendesha në mesin e tyre, po mbi ta në një verandë. Ju do të thoni se kam qenë në errësirë. Po. Gjatë gjithë kohës kam qëndruar më këmbë, se jam mbështetur pas Zonjës së Sallonit

të librave. E dini çka? Nuk ma ndien. Ama hiç nuk e vras kokën. Mund t'ju them vetëm një gjë, atë natë ju kam parë pisa e lakuriq. Aq të mjerë, aq të varfër, ashtu kokë më kokë, saqë dy-tri herë kam vjellë. Përpak desh i nxora jashtë edhe zorrët. Vetëm se ju nuk më keni dëgjuar, keni qenë të zhytur në art, e keni përjetuar ngjarjen, ju ka dhimbur zemra… Vetëm unë nga lart ua kam parë lotët, ua kam dëgjuar duartrokitjet frenetike, prandaj edhe e them pa asnjëfarë rezervë se ju e kishit dashur dhe e doni popullin. Të tjerët na kishin mashtruar, na kishin treguar përralla për "vëllazërim-bashkimin".

Gjatë gjithë kohës, derisa nxënësit recitonin vjersha, mësuesi hante dajak e Xhuxhmaxhuxhi u binte trumbetave, unë isha në errësirë. U mundova ta shoh nëpër terr Vjollca Rrapin, së paku t'ia shoh lotët nga mundimet dhe vuajtjet e të burgosurve politik, por më kot. Natë. E zgjata dorën. Vetëm për çudi, atë e kishte zënë gjumi. S'di pse m'u dhimbs aq tepër pse nuk qe shtrirë në shtrat apo në ndonjë livadh me lule. Ja, edhe pse më erdhi keq ta zgjoj nga gjumi. E lashë të flinte, me siguri do të përfitonte më shumë sesa t'i zgurgullonte sytë në greminën artistike.

Duartrokitjet përsëri jehuan nëpër errësirë. E zgjata kokën, e pashë Xhadinë që e kishte veshur si ferexhe flamurin kombëtar dhe vraponte nëpër skenë duke fshirë me të pluhurin e dërrasave. Dritat filluan të shuhen-ndizen në skenë edhe më shpesh saqë desh m'i qorruan sytë. U ngrita.

- Zonjë, zgjohu! Përfundoi loja teatrore…
- A doli drita, ë?
- Po, - e rroka për dore dhe dolëm në korridor…

Turma zbriste shkallëve. Dikushi ulej nëpër tavolina. E dy-tre kamarierë vendosnin edhe të tjera tavolina e karrige për mysafirë. Me këtë mendonin t'ia lidhnin disi kryet artit. Vërtet kishin derdhur mund, djersë e lot të rrejshëm, tashti u mungonte vetëm muzika dhe vallja. Dorën në zemër, e kishin merituar si artistë në iterpretimin e roleve.

E unë gjatë gjithë kohës mendoja si të dal te dera me një paketë plot faculeta dhe t'ua shpërndaj nga një që t'i fshijnë lotët e derdhur për Atdheun. Pastaj, të ik sa më larg këtyre mureve, errësirës që më dukej se më turret përmbrapa. Xhadisë, që më ndiqte e ma bënte me dorë të ndalem mos ik, të ma lexojë një poezi erotike…

## FAQEZINJTË ERDHËN EDHE NË SHKUP

Faqezinjtë, pasi e bënë me fjalime Shqipëri Etnike në Prizren, pastaj në Itali, erdhën më në fund edhe në Shkup me një "nismë të re politike demokratike kuqezi". Merreni me mend, trima pas lufte. Tashti më në kohën, kur ne shqiptarët e kësaj ane vite me radhë e kemi një parti politike kuqezi (PDSH -në). Edhe, harrojnë "burrat" e vrapimeve maratonike pas partive politike për poste se, ky popull e mban mend shumë mirë të kaluarën në kokë, nuk i harron kurrë "kalorësit e arratisur", kohën e "artë" të tyre komuniste. Fatkeqësia më e madhe, që këta "kalorës të arratisur" nuk pushuan së lehuri e vepruari pas porte nëpër festa partiake e përvjetore edhe gjatë ndryshimeve demokratike. I shëtitën të gjitha partitë politike shqiptare anë e mbanë Atdheut: "akademiku" i tri akademive shqiptare (made in komunizëm), "politikani" numër dy i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe "miku besnik" i Ibrahim Rugovës, pas "ikjes" nga Kosova, përfundoi në kabinetin e Kiro Gligorovit. Këshilltarë, deputetë të popullit, ministra, drejtorë e zv/ drejtorë me gojën plotë patriotizëm vesh më vesh ende "luftojnë" për Shqipëri Etnike. E në realitet, edhe sot e kësaj dite kanë mbetur fundërrina shqiptare me të njëjtën parullë patetike neokomuniste: O bini burrat e mejdanit! Ende me rrotullimet e tyre akrobatike të shekullit, aftësitë e tyre teknefese politike duke na bërë përditë nga një Shqipëri Etnike.

Thonë: në të kaluarën gabuam, u besuam partive politike shqiptare, ama tashti do të na shihni ne si intelektualë të bashkuar kuqezi se si e bëjmë Shqipëri Etnike. Ndryshimi, tashti i shohim kokë më kokë nëpër debate politike: tym e flakë nxjerrin nga goja për bashkim kombëtar, Shqipëri Etnike. Përçudi, edhe sot si dje, të njëjtët individë "demokratë" të sotshëm, komunistë të djeshëm, vazhdojnë me të njëjtat metoda komuniste ta dalldisin ende këtë popull, ia ngatërrojnë rrugën lëmsh në oborr, lidhin me shami nyje te pragu i derës përpara Shtëpisë me parullën e njohur komuniste: "Vdekje, ose liri ". Vetëm e vetëm që ky popull heroik nëpër shekuj të futet në qorrsokak, të mos ngjitet një ditë në Baba Tomor.

Vallë, po deri kur do t'i lëmë këta argatë samari të na e fshijnë lëmën plot me grurë për çdo verë me sorrat mbi kokë???!!!... Shqiptarët e Maqedonisë, ashtu edhe ashtu janë të përçarë deri në palcë nga partitë politike. Edhe të Kosovës. E, për sa u përket partive politike të Nënës Shqipëri, dihet e shihet: një kryetar bashkie të Tiranës dyhet ta zgjedhin (i numrojnë votat) disa muaj me radhë, mos them një vit. Fatkeqsia më e madhe, Don Kishotët shqiptar me Sanço Panço pas tyre e kënaqën me politikë madhore Shqipërinë, tashti u ka mbetur ta përurojnë (fotografojnë) veten si "politikanë vizionarë" edhe në Kosovë e Maqedoni. Vështirë e kam ta përsëris edhe një herë, shkaku se nuk e dua atë thënjen italiane për popullin shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore: tuto albanezi, tuto komandanti.

Politikanët tanë ende mendojnë se ky popull është si gomari i Nstradin Hoxhës. I zbret Nastradini me pesëdhjetë kg. nga samari, i hip Nastradinica me njëqindepesëdhjetë kg. mbi shpinë. E, ai gjithë jetën mbeti me të katra këmbët i zhytur deri në fyt në batak. Askushi edhe i bie me thupër bythëve, e shalon me të katra gjoja për në Evropë. Vite me radhë në vend të taxhisë, barit i jep kashtë në grazhd.

Fantastike, ë?! Faqezinjtë kuqezi vijnë me "zgjidhjen e çështjes shqiptare", kur ky popull është ngi më deri në fyt me themelimin e partive politike. Premtimeve bajate komuniste. Politikave nëpër katunde: të njëjtit individë që deri dje përpiqeshin të blejnë nga një diplomë universitare duke shitur bozë, tullumba e speca në pazar, sot si profesorë universitar, shkrimtarë e gazetarë gjysmëanalfabetë shtyhen në ditën e "fitoreve" me bythë e bërryla për poste politike në Qeveri. O Imzot, cilët palaço do të na bëjnë Shqipëri Etnike! Vërtetë, fatkeqësi kombëtare, që një pjesë e këtij populli nuk i di neokomunistët kuqezi, ose ndodhë janë halldupë shqiptar që ende u duartrokisin debateve të tyre politike sakate. Realiteti, janë duke na marrë në qafë edhe në këtë botë, edhe në atë botë. Ehu, i zëntë nëma e popullit shqiptar: e hëngshin veten një ditë! Shkaku, se: Posa e marrim pak veten të ngrihemi më këmbë si popull, këta turr si në kohën komuniste me gjithë "arsenalin ushtarak partiak" edhe sot si dje me pankarta e flamuj kuqezi për Shqipëri Etnike.

Epo, mirë të themi, haj t'i pyesim këta "patriotë kuqezi" se: kur janë aq të ndezur,

"digjen" zjarr e flakë edhe në këtë shekull, pse deri më sot nuk e bënë një Shqipëri Etnike?! I rrudhin krahët neokomunistët: nuk na lë shkjau. O Imzot, a ka shkje më të mdhenj deri më sot se këta dumdumë "shqiptarë kuqezi"?!...

Shkjetë shqiptar, vërtetë mendojnë apo shtiren se i kemi harruar deklaratat e tyre të "vëllazërim-bashkimit" nëpër vite, intervistat e tyre ekskluzive në kohën komuniste si "intelektualë" serb ose maqedonas, apo ende mendojnë dhe e mashtrojnë veten se na mbajnë me sy të lidhur rrugës malore për në Vendin e perëndive, në Baba Tomor.

Dhe, vazhdojnë të fotografohen halldupët kuqezi, skeletët me  një këmbë në varr para kamerave televizive: "Nisma e "Aleancës Kuq e Zi" për mua është një alternativë që ngjallë shpresë, që ngjall shpresë se diçka duhet të lëvizë, duhet të ndodhë edhe tek ne. Aleanca shpresoj se mundë të jetë një faqe e re, mundë të jetë një rrugë e re, një alarm i ri që duhet ta dëgjojnë të gjithë, ta kenë parasysh në mos ta përkrahin haptazi të gjithë të tjerët në këtë hapësirë".

Deklaratë patetike e njohur komuniste, përshesh katundi. E kënaqi dumdumi kohën e "artë" komunsite si partizan besnik me poste në Qeveri, nëpër redaksi, kabinete e Akademi të shkencave në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. E përqau popullin shqiptar kudo që shkoi e arriti nëpër botë si "patriot kuqezi".

Kohë kjo, kur "vëllezërit" para syve të tij publikuan lloj-lloj librash me ofendime anti shqiptare, dezinformata, falsikime historike, tekste shkollore e Enciklopedi maqedonase.

Kulminacioni i patriotizmit: zërin nuk ua dëgjoi deri më sot njeri i gjallë. Ndoshta, i dëgjuan të vdekurit mes varreve, partizanët e tyre ideologjik, po sot është tjetër kohë lufte. Armë të tjera përdoren në fushën e betejës për Liri. Istikamet strategjike kanë ndryshuar në frontin e luftës. Edhe pusitë luftarake, nuk janë ato të dikurshmet me një pushkë të vjetër serbi në krah e bomba të kuqe italjani në breza pas një lisi, një guri ose ferre.

Edhe, në fund: çka mund të presin shqiptarët nga këta partizanë teknefesë në kohën e sotshme demokratike, kur "patriotët kuqezi" janë ushqyer e rritur në grazhdin e huaj, Njerkës me një torbë taxhi për qafe. Asgjë…



## ARRATISJA E PROFETIT NË BABA TOMOR

E vërtetë, arratisja e papritur e një miku të penës, është humbje e madhe për mua dhe Atdheun: familjare, miqësore, personale, shoqërore, po edhe mbarëkombëtare. E them këtë se, njerëzit e mëdhenj lindin çdo njëqind vjet. Teki Dervishi ishte i tillë si shkrimtar. E kam njohur herët këtë burrë të letrave shqipe me *Shtëpinë e sëmurë* dhe *Thashë*. E më vonë edhe personalisht në disa takime miqësore me romanin *Herezia e Dervish Mallutës* dhe *Bregu i pikëllimit* (drama).

Dramat e tia që janë vënë në skenë në Shkup i kam përcjell rregullisht dhe me vëmendje si zëra të ri proteste për një të nesërme. Temat aktuale problematike që na ngatërroheshin ne shqiptarëve vite me radhë nëpër këmbë, i trajtone me mjeshtri ky shkrimtar, dhe ishin guxim dhe fshikullim për kohën e sëmurë. Shkaku kryesor ky, që ra në sy qysh heret nga pushteti i atëhershëm komunist. Edhe gjatë "ndryshimeve demokratike", ky shkrimtar nuk shiheshte me sy të mirë si dëgjueshëm, por si i "rrerzikshëm" për shtetin dhe kulturofagët që i përkundte Nëna Parti në djep duke i shpërblyer me vende pune, poste dhe çmime letrare. Kurrë nuk merrte pjesë nëpër manifestime kulturore – letrare anë e mbanë Atdheut.

Vitet e '80 –ta unë u ktheva në Shkup e ai "iku" në Prishtinë. Edhe gjatë këtyre viteve shiheshim shpesh në Prishtinë.

Dorën në zemër, e lakmoja si shkrimtar dhe e kisha mësues të penës. Ishte njëri ndër shkrimtarët shqiptar që i njihte mirë vlerat e arrira të letërsisë botërore që në atë kohë. Burgu i Goli Otokut siç duket përveç dënimeve dhe vuajtjeve i solli edhe përfitime. Edhe, mbi të gjitha shkruante bukur dhe ishte mik besnik edhe i miqëve të mi të një gjenerate që la gjurmë të pashlyera në letërsinë shqipe: Beqir Musliu, Teki Dervishi dhe Musa Ramadani. Treshi i Madh i asaj kohe me zgjebe, që ne si studentë librat e tyre i gëlltinim me një frymë posa e shihnin dritën.

Vite më vonë, kur unë jetoja dhe punoja në Shkup, më dërgonte porosi pas miqëve që të kem kujdes nga disa individë, "intelektualë" të "vëllazërim-bashkimit" që në atë kohë si hije më ndiqnin hapa pas hapi si të dyshimtë.

E njihte mirë këtë rreth të rrezikshëm për krijuesit shqiptar, që me montime politike për një fjalë goje, një varg i rraste intelektualët në burg. Përndjekjen dhe montimet politike, gjithë kohën për sa kishte punuar si gazetar në gazetën *Flaka e vëllazërimit*, në Shkup i kishte pasur vetë mbi shpinë.

E unë edhe pse e njihja mirë këtë mes të ri, përsëri habitesha prej nga gjithë ajo energji e këtij njeriu që të kujdeset edhe për miqtë që të mos bien në kurthën e Policisë Letrare. Ndoshta, edhe është fajtori kryesor që unë si shkrimtar nuk rashë asnjë ditë në burg. Ndodhë, burgu famëkeq i Goli Otokut për të kishte qenë Universitet?! Nuk e di.

Javë për javë unë lexoja çdo gjë që më biente në dorë nga ky shkrimrar. Herë pas here, para Luftës së Drenicës (1998) dhe Kosovës (1999)

vinte edhe në Shkup. Një natë kemi ndejtur me miq në banesën e tij edhe deri në mëngjes. Pak para agimit u kthyem në shtëpi. Koha ishte e atillë: ne përveçse ishim njerëzit e ditës, ishim edhe të natës.Teki Dervishi ishte i palodhur si shkrimtar, punonte natë e ditë. Edhe botonte herë pas here ndonjë shkrim nëpër gazeta, revista letrare ose libër. Kurrë nuk e praktikonte të shkonte nëpër manifsetime kulturore duke vrapuar si të tjerët pas çmimeve letrare. E pëlqente vetminë si shkrimtar, nuk i pëlqente "rrëfimet patriotike" të tavernave. Vërtetë, ishte një Ujk plak në letërsi. Në prag të ndryshimeve "demokratike", në një bisedë informative në polici, që ma kishin kurdisur kulturofagët si të "rrezikshëm" për shoqërinë dhe shtetin, unë do ta mësoj të vërtetën për veten dhe Teki Dervishin. Kurrë nuk më kishte shkuar ndërmend se, unë ndiqesha në Shkup si gjoja i dërguar nga Kosova që të veproj në Maqedoni. Edhe atë: çështjen e shqiptarëve dashkam ta zgjidh me luftë…

Vërtetë, o burrë ishe dhe u arratise si profet i madh në Baba Tomor. Letërsia shqipe me ikjen tënde humbi një penë të rrallë rebele, po veprat tua: *Shtëpia e sëmurë, Thashë, Herezia e Dervish Mallutës, Bregu i pikëllimit*… rrinë kokë më kokë nëpër shtëpitë tona edhe sot e kësaj dite duke na bërë roje, në bibliotekë.

Ende vazhdon të marrësh frymë në mesin tonë si shkrimtar i pavdekshëm. Profet.

Përgëzime, o burrë edhe për amanetin: varrim vetëm nga familjarët e ngushtë, që u respektua. Nuk pati njoftime publike permes letrave

nekrologe në qytet për ditën dhe kohën e varrimit, derisa ajo ishte bërë e ditur në të përditshmen "*Bota sot*" ku Teki Dervishi ishte i lidhur nga themelimi e deri në ikjen e tij fizike! Pa akademi përkujtimore, pa fjalime mortore, pa nekrologji. I varrosur aty pranë Erenikut, rrëzë Çabratit dhe jo larg Majës së terrorizuar në luftën e fundit në Kosovë (1999). Luftë, në të cilën ti nu ike, nuk e lëshove Kosovën krah për krahu me Latif Berishën, Ymer Elshanin, Gani Xhafollin… Dy të parët ku edhe u masakruan në mënyrën më jonjerzore, ranë dëshmorë. Heroizëm të cilin ti pas lufte do të vësh në skenë në Shkup me dramën: *Eshtrat që vijnë vonë*.

Rrofsh e qofsh përgjithmonë pranë Zotit, në Baba Tomor! Që, nuk u dhae mundësi rrufjanëve si sorra e qyqe të të "qajnë" mbi varr…

Arratisja yte e papritur, është arratisje profeti pranë Zotit, në Baba Tomor. Vendin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri…

## SHTRIGANI I ALLAHUT

Turma e halldupëve që m'u ndërsye pas shpine dhe më shtynte para nga të gjitha anët drejtë Xhehenemit, s'di as vetë se si m'i ndali këmbët para disa shpalljeve pas dere, ku prisnin në rend sorrat e zeza. Halldupët me ferexhet hedhur krahëve, në vend të strukeve, tirqve me gajtana, xhamadanëve me sumbulla dhe kësulave të bardha. Haxhuxhet, me kësulëpartallat në kokë, shamitë e zeza që i kanë lidhur nyje për fyti, që mezi u dukeshin sytë e përgjakur në errësirë. Dhe, desha – s'desha isha i detyruar t'i dëgjoj ato krrokama sorrash që e kanë mbyllur veten në Kafaz. E di edhe këtë se, nga to nuk kam kurrnjëfarë dobie, po ma thotë mendja se, nuk do të kem edhe farë dëmi. Vërejtjen ma tërhoqi "xhihadi" i këshillit të halldupëve, i cili anëtarët e vet i bënte me dije se mu sot, në ora dymbëdhjetë, do të mbante një takim debativ "humanitar", ku në mes pikave të tjera aktuale, do të lexonte një punim të gjatë shkencor edhe Sorraku i kësaj organizate me tre fakultete të "kryer" brenda tre vjetëve (???!!!...) në botën e jashtme: Shtrigani i Allahut, i cili merrej edhe me risi të modës të falsifikimeve shkencore antishqiptare. Pak më lartë, një listë me emra halldupësh, sigurisht këtu bëhej fjalë për ndonjë kredi të "organizatave humanitare" ndërkombëtare. Në të djathtë arrita të lexoj se, Sorraku i Shtëpisë Publike në një ekspozitë ndërkombëtare për novatorizëm e kishte marrë shpërblimin e parë për "flijime shkencore" antishqiptare.

Diku nga fundi, nuk u shpëtoi syve as edhe "haxhillëku" që pritej të bënte kjo "organizatë humanitare" me karakter të propagandës ekonomike antishqiptare ndërkombëtare.

Imzot! Përderisa qëndroja gur më këmbë me sy nga muri, sa çel e mëshel sytë m'u parafytyrua koha e studimeve, në Prishtinë. Fakulteti Filologjik në të cilin studioja Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe. Profesori im i nderuar Anton Çetta, i cili në atë kohë na ligjëronte lëndën e Letërsisë së vjetër shqipe. Edhe, mes të tjerave me plot zell e dashuri na ligjëronte për Pjetër Bogdanin. Po, ajo tabelë e shpalljeve, orari i ligjëratave, lista e provimeve. E shkunda veten, e fërkova ballin të vij në vete, por çdo gjë ishte e kotë, mendimet më turreshin një korridori të gjatë plot me dritare për të fluturuar në qiell. Vetëm një gjë nuk më kujtohej mes këtyre shpalljeve: Halldupi. E kisha të largët, të huaj, që më largonte me vite. Kjo më kthente në realitet, kokës sa mundesha i bija me grushta. O njeri, ti je vetëm para tabelës së shpalljeve në Shtëpinë Publike. E gjithë kjo që ndodh me ty mund të jetë vetëm një ëndërr ose ty me siguri të kanë tradhtuar sytë, trutë. Ktheu në realitet, mos u merr shumë me halldupët mes këtij bërlloku, se kështu si ia ke nisur një ditë do ta shohësh me sy edhe fotografinë tënde të varur në tabelën e shpalljeve…

Rrëmujë më ishte para derës së Bankës Komerciale kur unë erdha në vete, i hapa sytë mes atyre "kursimtarëve" me librezat e kursimit në duar.

Njëherit i mblodha forcat të kthehem prapë, por kot, grupi i tyre më shtynte me dhunë drejt atyre dollapëve të xhamit. Herë-herë më shtrydhte, më shtrëngonte në grusht sikur Dexhalli. Më kot ndonjëherë i përpëlitja edhe këmbët në ajër, kërkoja ndihmë, të ik përtej këtyre mureve, çdo gjë më ishte e kotë se nuk më dëgjonte njeri. Halldupi m'i kishte vënë krahët pas shpine dhe më shtynte përpara me gjithë forcë. Më dhimbte kurrizi, më ndalej fryma dhe në çdo moment e pritja fundin, të më derdhen eshtrat si vjetërsira në tokë. Po, mu kur e prisja shkatërrimin tim, rrëmuja që tërhiqej si një zinxhir hekuri herë para, herë mbrapa, më hodhi nga rreshti buthekrye mu në mes të korridorit. Shkak ky, që më detyroi ta përqafoj fenë e Vaso Pashë Shkodranit: **SHQIPTARINË**.

- A u vrave? - Dikushi më rroku për krahësh duke më ngitur më këmbë.

- Jo. – mezi arrita t'i përgjigjem duke i mbajtur bythët me duar.

- Nuk më njeh, jam njëra nga ato Tri Zanat e tua që të prijnë para për në Baba Tomorr. E dy të tjerat të mbajnë për krahu. Mos të merren mendtë, do pak ujë?

- Jo, - arrita t'i përgjigjem edhe kësaj pyetje profetike, dhe vetëm tani arrita të shoh se ishte Vjollca Rrapi.

- Po, ç'deshe në atë rrëmujë të halldupëve, që i luten Zotit jo në xhami, po në mes të rrugës? Nuk e sheh se çdo gjë sillet lëmsh si në kontejnerët e bërllokut?

- Asgjë, Vjollcë. Turma e halldupëve më gjeti rrugës për në Baba Tomorr. Po, ti nga dole në Shtëpinë Publike?!...

- Erdha të deponoj nja shtatë mijë euro në bankë…

- Domethënë, edhe ti paske librezë kursimi me deviza?!

- Po, jam kursimtare e kësaj banke qe disa vite.

- E, a ke kursyer deri më tashti ndonjë euro?

- Ja, shihe librezën!

E mora librezën në dorë dhe nisa ta shfletoj që nga faqja e parë. O Imzot, ç'më panë sytë! Libreza e Vjollca Rrapit ishte me fotografi, rast i rrallë ky i kësaj banke komerciale në kursimin e devizave. E hapa edhe një faqe, shtatë mijë euro të deponuara. Edhe një faqe: tetë mijë… Edhe një faqe: nëntë mijë… Edhe një faqe: dhjetë mijë…

Vetëm tani e pata të qartë se ç'ishte ajo rrëmujë halldupësh që më shtynte me dhunë para, nuk mundesha ta ndal hapin, po më shtrydhte aq fort saqë më kërcisnin eshtrat. Përpak, kur e mora veten nga një pakuptimtësi e tillë, desh ia thashë këngës: *Çka po i thotë Dema Kadrisë/ a ia di, o rendin burrnisë...* U shkunda nga pluhuri, e drejtova veten në këmbë, ngrita kokën lartë dhe mora lirisht frymë. Dhe, s'do mend, për herë të parë e ndjeva veten të lumtur, dhe më erdhi mirë që nuk isha kursimtar i kësaj banke komerciale në Shtëpinë Publike…

Kur eca edhe disa hapa korridorit, i pata ikur më larg rrëmujës të halldupëve, hetova se hap pas hapi më ndiqte një hije.

Njëherit, desha ta vazhdoj rrugën, t'i ik nga sytë-këmbët pas shkallëve tutje kthinave të

Shtëpisë Publike, por kur e pashë se ajo hije halldupi më ndiqte mes rreshtave se ç'më pane sytë! Dhurata e Zotit: e kam vështirë t'i hedh aq besnikërisht në letër ato shigjeta, ato fluturime, atë bukuri. Aq më keq, më erdhi çudi, se kurrë deri më sot nuk e kisha hetuar aq thellë paaftësinë time si njeri i lapsit.

Unë kisha lënë gjurmë mbi letër, kisha lëruar thellë me pllug, po ç'e do kur nuk kisha ditur si ta hedh farën mes ugareve në arë, rrëzë Çukës. Kjo më frikësonte, m'i shtinte ethet në palcë, se mos mes këtyre fletëve të bardha nuk do të mbinte asgjë, qoftë edhe një ferrë murrizi. O Imzot, ç'do të thotë ta ndiesh veten të pafuqi para kësaj krijese të pafajshme, të mos jesh në gjendje ta hapësh gojën, t'i thuash sy më sy edhe një fjalë. Këto ishin ato momente që të shtynin t'i këpusish pullat e këmishës me oja, ta hapësh gjoksin të të qëllojnë shigjetat e halldupëve, të shtinë rrufetë…

Po, a mund të mposhtet dot një gjoks i këtillë leshatuk që kishte ecur përpara me vite e vite nëpër furtunë për në Baba Tomorr? Qoftë Dimër, qoftë Verë. Jo. E them këtë se, nuk dua ta turpëroj veten mes këtyre rreshtave, juve t'ju lidh me zinxhirë këmbeduar. Apo, ruana Zot, t'ua them emrin e mbiemrin, t'ju pështyj në fytyrë. Shtatë herë me radhë t'ju këndoj ninulla duke ju përkundur në djep te pragu i Shtëpisë, dhe shtatë herë me radhë me kamxhik t'ju zgjoj nga gjumi.

E, po nëse nuk jeni në gjendje edhe kësaj radhe të më dëgjoni, e paçit veten në qafë…

- Eja në vete i dashur, sa nuk të ka vrarë Bukuria! – Më shkundi me të dyja duart sa mundi Vjollca Rrapi.

- Zonjushë, kahdo që ik shoh mure… Mure… Sorra të zeza… Halldupë… Derë, s'di a pati për dalje kjo Shtëpi Publike?

- Edhe derë ka i dashur, edhe dritare… Vetëm nuk e di si do t'i gjejsh nëpër errësirë… Hoxha thërret në minare…

- E kam një fener. Por, bie shi, fryn era, shtinë rrufetë…

- Ti një ditë do t'i gjunjëzosh edhe rrufetë, por ec ta pimë nga një verë të kuqe!

- Më gjithë dëshirë, Zonjushë. E ndiej veten të lodhur… Kam nevojë edhe për pushim… Njerëz… Gjakun e azreti Isait, që fluturoi në qiell nga minarja e xhamisë…

Dhe, ashtu duke më mbajtur për krahësh, Vjollca Rrapi më shtiu në Kafe-Bar duke më ulur në karrige, pranë një tavoline, ndërsa vetë shkoi pas gotave të verës. Sa u ula e pashë se veten e lehtësova nga një barrë e rëndë mbi shpinë, që të thuash më kishte hyrë edhe nën lëkurë deri në palcë. Njëherit, edhe u tremba nga kërsitja e këtij thesi plot eshtra, mos derdhen si rraqe të vjetra nën tavolinë. Po, për fat të mirë nuk ndodhi kjo, se këto kishin përballuar ditë edhe më të vështira dhe ishin mësuar me barrën mbi shpinë.

- Mirëdita, Zoti Shkrimtar!

- Mirëdita! – Iu përgjigja zërit pa e ngritur kokën.

- Si duket, kohën e fundit keni filluar ta vizitoni edhe Kafe - Barin e Shtëpisë Publike në Qytetin e qyqeve?

- Ashtu duket. Dhe, tani kur e ngrita kokën, vërejta se ajo ishte Arta e Rrezikshme.

- A është e lirë? –Më pyeti për karrigen Arta e Rrezikshme me një buzëqeshje në fytyrë, që këtë e kishte në vend të grepit.

- Po, - iu përgjigja me gjysmë zëri, duke iu trembur shikimit të saj, që desh më përpiu të gjallë me gjithë tesha…

Mu kur e përfundova fjalën e fundit, Vjollca Rrapi erdhi me gotat e verës, ma vuri mua timen përpara, ndërsa me të veten u ul në karrige. E shikoi një herë Artën e Rrezikshme, pastaj mua… Edhe një herë Artën e Rrezikshme… Çdo gjë nuk donte analizë, e pata të qartë se pa fare mundi arrita t'ia lexoj në sy, në fytyrë. E kisha ndjekur një shkollë të rrugëve disa vite me radhë, për të cilën edhe mora diplomë nate. Mos të vijë kjo këtu si lëvdatë, në disa provime kisha marrë edhe dhjetëshe. Dhe, derisa unë pija verë dhe thellohesha në mendime, Vjollca Rrapi e piu të veten, kërkoi falje se duhet të blejë diçka në Çarshi dhe u ngrit nga tavolina. Edhe këtë hap e pata të qartë, deshi të më hakmerret duke më lënë në duart e Artës së Rrezikshme…

- A doni edhe një verë të kuqe? – E prishi qetësinë Arta e Rrezikshme.

- Po, iu përgjigja me zë të pakët, duke e ditur se Arta e Rrezikshme ia kishte qëlluar pikës sime të dobët si shkrimtar.

Arta e Rrezikshme u ngrit ngadal, duke më shikuar mua me bisht të syrit se, a jam i gatshëm t'ia shikoj vlerat e pasurisë së tundshme me të cilat ajo krenohej si e pakapërcyeshme në shtrat. Por, kur pa se unë nuk isha aty me sy e mëndje,

nuk nguli këmbë, iku duke u përdredhur, shkundur e tundur pas verës kuqe. Çdo gjë dija për Artën e Rrezikshme sesi sillet në shtrat, një herë në një bisedë tavoline unë e rrita aq shumë, sa thashë se ajo, kur bënë dashuri e dridh si tërmet edhe pallatin. E dija edhe atë se Arta e Rrezikshme ndizet zjarr, rebelohet dhe di të të kafshojë si pelë e egër. Atëherë e ke vështirë ta urtësosh, t'ia shuash zjarrin, ta sjellësh në vete edhe po ndejte me të në shtrat pa i zbritur plot një javë…

- Gëzuar! E cakrroi me mua ende pa u ulur gotën e verës Arta e Rrezikshme.

- Gëzuar! – E ngrita edhe unë me fund.

Arta e Rrezikshme menjëherë e mori shtambën me verë të kuqe dhe ma mbushi edhe një gotë me grykë. Dikur, u ngrit dhe pas pak kohe u kthye me një tepsi me mish të pjekur viçi. Edhe atë, e vendosi mbi tavolinë. Një gjë duhet pranuar, Arta e Rrezikshme ia dinte rendin burrënisë, verës së kuqe edhe shtratit. Me këtë donte të ta bëjë me dije se, ajo është e gjithanshme, di ta hedhë grepin edhe në ujë të pastër. Ajo kur donte, kot mundoheshe t'i ikësh ferrave, më mirë e kishe t'i dorëzohesh vetë pa luftë, se të zente edhe pa krimb.

- I sheh ata që janë ulur në atë tavolinë? – më pyeti Arta e Rrezikshme.

- Po.

- Ai është Shtrigani Allahut i Shtëpisë Publike. Tjetri pranë tij, Gungaçi, shitës i ferexheve të zeza. Ndërsa, ai në të djathtë me një torbë taxhi përqafe është Hoxha i Halldupit. Menjëherë, ai tjetri pranë tij është Shejtani i Allahut… Kurse,

ata tre të tjerët me mustaqe a pa to, janë praktikantë në Shtëpinë Publike…

E tha këtë Arta e Rrezikshme duke qeshur ëmbël dhe duke ma shti dorën për krahu. Unë vetëm e hëngra me sy këmbekokë, ngase e dija se*: betejat e përgjakshme kërkojnë heron*j *lufte*. Ajo dikur u ngrit nga tavolina duke më tërhequr për dore pas nga dera e korridorit. Ta them të vërtetën, nuk e kundërshtova, por ecja pas saj sikur më shpiente mes luleve, në Xhehnet. Ajo pas disa hapave e hapi një derë, duke më tërhequr pas vetes, vetëm tani edhe unë arrita të lexoj në ballë të saj se shkruante: WC. E mbylli derën dy herë me çelës, i lëshoi brekët në fund të këmbëve dhe e ngriti lartë ferexhenë. Unë vetëm tani arrita me të dy duart ta tërheq sa mundesha nga unë, vetja duke e pështetur fortë për muri. Ndërsa, Arta e Rrezikshme duke u rrokur me një dorë për litari të kazanit të WC –së, i ngiti hopa lartë të dyja këmbët duke m'i ngatërruar për mjedisi aq fortë, sa që përpak desh ma nxori shpirtin. Gjatë gjithë kohës sa zgjati kjo luftë, unë nuk kam dëgjuar gjë përveç zhurmës së ujit të WC –së që është lëshuar shtatë herë me radhë…

## EDHE FILIPI I MAQEDONISË VJEN NË SHKUP

Dorën në zemër, më në fund erdhi koha t'i duam edhe "vëllezërit"! I duam, s'i nuk i duam "vëllezërit": na i polli Njerka një natë të ftohtë acari pasmesnate. Dhe, duhet të pajtohemi me fatin historik, ne shqiptarët. Edhe, mbi të gjitha: janë të mirë këta "vëllezërit", që na i përkundi në djep Njerka në mes të Dimrit. Krah për krahu, bashkë me Ali Ahmetin na e sollën Skënderbeun në Shkup me gjithë kalë shale. Punemadhe, që heroi ynë kombëtar shpatën e ka futur në brez. Dashakqinjtë, do të thonë: i dorëzoi armët. Jo. Skënderbeu i sotshëm me kalë me shalë te sheshi "Skënderbeu", është i paqes dhe jo i luftës. Ne shqiptarët: jo, nuk e duam matanë Urës së Gurit, e duam në këtë anë në Çarshi, në mesin e parkingut të makinave, në bërllok!

Ali Ahmeti bashkë me "vëllezërit", u nervozua me shqiptarët. Për inatë të shqiptarëve tha: Skënderbeut, do t'ia bëjmë edhe sheshin më të madh e më të bukur që ka pasur ndonjëherë Shkupi. Ndryshe, ne punojmë dhe veprojmë për dallim nga "vëllezërit". Sheshin nuk e ngulfasim me përmendore dhe pallate betoni, e lëmë të marrë lirisht frymë, rrëzë Kalasë Dardane. Edhe livadh, po të jetë nevoja do t'i sjellim Skënderbeut në Shkup, që të ketë ku ta shalojë kalin heroi ynë legjendar. Halldupët, le të plasin nga inati. Problem i tyre është, që nuk duan t'ia përmendin as emrin, po takimet e biznesit i lënë: "te Kali".

Dhashtë Zoti, Skënderbeu një ditë e nxjerrë shpatën nga brezi, dhe me një të rame halldupëve ua flug kokat para këmbëve të kalit si kunguj stambolli.

"Vëllezërit", thanë: në rregull, pasi nuk na e jepni Skënderbeun matanë Urës Gurit, ne do t'i ndërtojmë shtëpi memoriale Nënë Terezës. Shqiptarët, përsëri: jo, matanë Vardarit edhe Nënë Tereza! Edhe Nënë Tereza eshtë e jona, den baba den shqiptare! "Vëllazërit", kësaj radhe u nervozuan keq, nuk i pyetën më shqiptarët. E dimë ne, pesëdhjetë vjet së bashku me ju hamë bukë e kripë në një grazhd: ju e doni shtatoren e Shokut Tito, të cilën para disa viteve kur ishte në pushtet LSDM –ja e propozoi me argatët e tyre shqiptarë në sheshin "Makedonija". Vetëmse, kurrën e kurrës nuk do ta shihni atë film pornografik: Shoku Tito mbi kalë të bardhë!...

Jerm, them unë folni edhe sot e kësaj dite. Populli thotë: dashuria juaj "besnike", hëngër fiq dhe vdiq. Për inatë të shqiptarëve, "vëllezërit" e ndërtuan shtëpinë memoriale: Nënë Tereza, jo ku e ka pasur shtëpinë e vjetër shenjtorja, po mu në zemër të Shkupit. Edhe Aleksandrin e Mdh me shpatën lartë në dorë, një ditë për inatë të shqiptarëve e sollën me kalin e tij Bukefal mu në mes të sheshit "Makedonija".

Ditët e ardhshme historike, "vëllezërit" e Njerkës pritet të ngrejnë një statujë 28 metra të lartë në bronz të Filipit të Maqaedonisë, mu në mesin e një kompleksi luksoz me katër shatërvanë. Edhe babain e Aleksandrit të Madh, Filipin kanë vendosur ta sjellin në Shkup.

Babë e bir krah për krahu me Skënderbeun, pas kryngritësve shqiptar që e çliruan dhe e lëshuan Shkupin, kësaj radhe kanë vendosur në këtë qytet shqiptar t'i ngrejnë çadrat. Kuajt e shalës me të katra t'i shalojnë bregut të Vardarit.

Edhe unë, pas gjithë këtyre "patriotizmave kuqezi" të shqiptarëve them: Amani, mos thuani se, edhe Filipi i Maqedonisë është i joni, vetëm i shqiptarëve. Shkaku se, do ta merrni në qafë edhe këtë mbret të Maqedonisë. Thuani, është edhe i juaji: i maqedonasve.

Përndryshe, po të presë sot në ne shqiptarët, kjo legjendë lufte do të flejë edhe një shekull në histori nëpër arkivat e muzeve botëror.

Përsëri, rebelohem në këtë shkrim: shyqyr Zotit që i kemi "vëllezërit" e Njerkës, na e zbardhën sadopak fytyrën para botës përparimtare në këtë shekull, kur na digjet zjarr mbi krye. I nderojnë edhe figurat tona historike kombëtare shqiptare.

Dhe, në fund them: na qoftë për hajër edhe Filipi i Maqedonisë!...

**RRUFJANI**

E kam thënë edhe më herët në një shkrim timin për veprimet e fshehta nga UDBA jugosllave në lidhje me aktivitetet "patriotike" të Rrufjanit. Vetëmse, në atë shkrim i kam rënë kalimthi si shkrimtar, nuk i kam kushtuar gjithaq rëndësi si problem shqiptar. Bile, e kam "tepruar" pak me ndonjërin që e kam futur edhe si personazh në libër. Faji nuk ka qenë i imi, po i atij partizani që nuk pushonte së vepruari edhe gjatë ndryshimeve demokratike, na mirrte më qafë në polici me shpifje gjoja antishtetërore. Shkurt, Rrufjani është i përgëdheluri i Shtetit policor. Dumdum i shëtitur nëpër parti politike e poste në Qeveri… Ministri… Institucione të shtetit... Redaksi... Intelektual me dy-tre vende pune. Anëtar i tre Akademive të Shkencave dhe Arteve. Veteran lufte me dy-tre pensione të shteteve ish Jugosllave. Dhe, honxhobonxho me honorare të majme si anëtar i komisoneve të ndryshme arsimore e kulturore në përpilimin e planprogrameve shkollore, Letërisë maqedonase, Enciklopedisë maqedonase, Antologjive të poezisë shqipe, Festivaleve të poezive, Ndarjes të çmimeve republikane...

Qëllimisht, kësaj radhe nuk do të merrem me persosanzhet e mi nëpër libra, po do të merrem me një fenomen interasant shqiptar, do të ndalem pak më gjatë në veprimet e tyre antishqiptare, që për fat të keq i vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Falë Zotit, erdhi koha që kësaj radhe të merrem pak më thellësisht me këto veprime të

shërbimeve sekrete antishqiptare, gjoja në shërbim të popullit dhe shtetit. Faktet t'i nxjerrim këmbëkryq për mejdani me argumente. Dihet, kam humbur shum kohë dhe pasuri të patundshme e të tundshme duke e vënë edhe jetën në rrezik për të ardhur deri te ky përfundim "policoro-shkencor". Nuk ka gjithaq rëndësi kjo dukuri negative në këtë shkrim. E rëndësishmja është, që unë mbeta gjallë dhe ia arrita qëllimit, hedhë gjithë marrëzitë e asaj kohe të errët në libra. E di edhe këtë pyetje, ju do të pyesni si lexuesë, si arrite deri te ky "zbulim sekret policor", kur gjithë jetën keni qenë jashtë sistemit?! E vërtetë, kam qenë jashtë sistemmit, por me orë të tëra këmbekrye brenda "sistemit" në bibliotekë, mes librave me kapakë të trashë nëpër rafte. Asgjë nuk ka ndryshuar nga ajo kohë policore e shërbimeve sekrete me sistemin e sotshëm "demokratik". Përmëtepër, kjo kohë është edhe më e rrezikshme, në emër të fjalës së lirë, mendimit ndryshe në "demokraci" me gjithë këto parti politike shqiptare. Shqiptari edhe në këtë kohë "demokratike" vazhdon të ndiqet, dënohet me burg dhe vritet si qeni në rrush.

Gjatë gjithë jetës time si shkrimtar i kam kaluar të gjitha provokimet policore: edhe spiunimin, edhe patriotizmin e rrejshëm, edhe bisedat informative në polici, edhe helmimet, edhe zjarret në banesë, edhe vdekjet klinike, edhe aksidentet e komunikacionit në rrugë… Uaaa, do të bërtisni ju nga gëzimi! Fitore e shekullit! Jo.

Zoti ashtu deshi, që unë të mbetem gjallë mes gjithë këtyre përndjekjeve e fatkeqësive të papara

deri më sot, të rrëfej për një histori të dhimbshme, që shqiptarëve u përsëritet brez pas brezi nëpër shekuj. Dorën në zemër, për raste të një historie të këtillë kanë shkruar edhe paraardhsit tanë rilindas, po jo si unë në këtë analizë publicistike që e kam përjetuar në shpirt dhe e kam pasur hap pas hapi gjithë jetën pas shpine si hije.

Interesant, shqiptarëve gjithmonë po u përsëritet historia. Edhe atë: jo vetëm historia, por edhe metodat e njëjta të përndjekjes policore. E kam thënë me qindra herë nëpër shkrime e libra: Sllavët e kanë studiuar shumë mirë nëpër institucionet e tyre akademike shtetërore mentalitetin shqiptar. Edhe, dinë më shumë për ne si popull, sesa vetë shqiptarët për historinë e tyre të bujshme luftarake.

Përçudi, them me vete, se si përsëritet historia: edhe koha e sotshme si e djeshmja. Përsëri, si në atë kohë, "spiunët" dhe "patritotët" edhe sot na i shpallë UDBA jugosllave. Dallimi, kësaj radhe na i shpallin me anë të Komisionit Lustror të miratuar nga Parlamenti me Ligjin për Lustrim. Shqiptarët, edhe në këtë kohë nuk mund të qahen se nuk kanë përfaqsuesë në këtë Komision për Lustrim me propozime të partive politike shqiptare. Tjetër punë është ajo se, kush janë ata emra të anëtarëve me "biografi të pastra politike": ku kanë punuar në kohën komuniste, e ku punojnë sot në këtë "demokratike". Punemadhe, edhe kjo nuk prish punë. Dëmi që u kanë bërë ato rrufjanë me denoncime e shpifje shumë individëve të pafajshëm, nuk shpaguhet sot me "zbulimin" e spiunëve.

Shqiptarët kanë pasur funksione të larta në ish shërbimet sekrete policore edhe të nivelit republikan jugosllav, po nuk u bë nami, nuk e zbuluan Amerikën. E as patën guximin si funksionarë shqiptar të shpallin: Shqipëri Etnike.

Fatkeqësisht, edhe ky Komision i Lustrimit nuk i ndryshoi metodat e punës policore, po mu si dikur UDBA jugosllave na i "shet" shumë lirë spiunët si zarzavate të kalbura në Bit-Pazar. Herë me anë të "pëllumbave postier", herë me anë të Komisionit të Lustrimit, e herë me anë të mjeteve të informacionit me tru neokomunist.

Vite më parë spiun e shpallën edhe Menduh Thaçin, kryetarin e Prtisë Demokratike Shqiptare. Kohën e fundit Ali Ahmetin, kryetarin e Bashkimit Demakoratik për Integrim. Musa Xhaferin. Dhe, Dajën. Spiun e shpallën edhe një ish gazetar, ambasador në Kroaci. Edhe, atë: Përçudi, kur njëri nga anëtarët e Komisionit Lustrues është shqiptar, bashkë me të kanë punuar vite me radhë si gazetarë e redaktorë në të njëjtën redaksi të një gazete të përditshme në gjuhën shqipe. Spiun e shpallën edhe një ish deputet dhe kryetar partie. Edhe ndonjë tjetër, që hë për hë nuk më kujtohet emri. Edhe vazhdon shpallja e spiunëve. Mirë, them unë mes këtyre rreshtave, po këta personalitete politike kanë qenë dhe janë në sistem, nëpër funksione të shtetit. Ndonjëri, edhe kryetar partie. Tjetri, ministër në Qeveri. Tjetri deputet i popullit me dy-tre mandate në Kuvend. Nuk e dinte shteti juridik se, këta kanë qenë ish bashkëpuntorë të shërbimeve sekrete, që pas njëzet vjetëve t'i shpallë spiunë?!

Qerrja moti na është thyer në rrugë. Tashti gjetëm rrugë, po nuk kemi qerre. Nejse. Sekret i vitit, Komisioni Lustrues për t'i shpallur spiunë, pritet nga opinioni edhe dy akademikë shqiptar. Po, ja që deri më sot, Komisioni Lustrues ende hamendet, nuk i shpalli "pehlivanët" e Shkupit.

Persëri, të mos përzihem shumë në punët e shtetit "demokratik", do të kthehem edhe pak te koha e "artë" komuniste. Sistemi i atëhershëm komunist jugosllav, vërtetë për shqiptarët nuk hapte shkolla shqipe dhe universitete, ama ndërtonte burgje. Shqiptarët dyert e burgjeve në atë kohë i kishin të hapura krah më krah. Mjaftonte ta dëgjosh Radio Tiranën, lexosh "Lahutën e Malcisë" të Fishtës, "Gjarpijt e gjakut" të Adem Demaçit, ndonjë libër këndimi që kishte mbetur ende i fshehur hatullave që nga koha e Ernest Koliqit si ministër i arsimit... Dhe, hop të shpallnin "armik të popullit dhe shtetit", të rrasnin më së paku pesë vjet në birucë.

Në burg të rrasnin edhe për romanin "Tradhtia" të Kapllan Resulit, që nga njëra anë ta jepte përmes "patriotëve" kuqezi vetë UDBA, e në anën tjetër papritmas të bastiste në shtëpi, të kapte me pelë për dore si libër i "ndaluar dhe i rrezikshëm" për shtetin. Punë tjetër ishte ajo e çuditshmja se, librat e Kpallan Resulit i kishe nëpër raftet e Bibliotekës Universitare "Shën Kirili e Metodi" në Shkup, dhe mund t'i lexoje në çdo kohë pa asnjëfarë problemi politik. Një grep i rrezikshëm ishte edhe ky, të shënonin si lexues të dyshimtë në listën e irredentistëve, po së paku ta jepnin vetë në bibliotekë, nuk kërkonin pëgjegjësi

dhe prova për të të rrasur me vite në burg. Mos flasim këtu edhe për raste edhe më të rënda irredentiste kundër shtetit komunist. Vaj halli për ty, nëse lëvdoje para "patriotëve" kuqezi Shqipërinë. Ose, thërrisje në rrugë: Kosova - republikë! Patjetër, duheshte t'i lash duart një herë e përgjithmonë nga liria.

Vonë, shumë vonë shqiptarët e kuptuan të vërtetën misterioze se, burgjet ishin vende përmisimi, nuk ishin universitete. Edhe, për atë kohë sipas sistemit të atëhershëm komunist, edhe më të nevojshëm se shkollat shqipe. Vite më vonë gjatë ndryshimeve demokratike, Partitë Politike Shqiptare burgën e morën si universitet shqiptar. Shumicën e të burgosurve i përqafuan si anëtarë në radhët e tyre politike. E harruan se, pak vetë nga ato burgje famëkeqe jugosllave dolën me mend në kokë. Shumica nga ta, kurrë nuk e panë lirinë, u kalbën ose vdiqën në qelitë e Goli Otokut dhe Idrizovës. Ndonjëri, në pleqëri mezi doli nga burgu i çmendur. Tjetri, peder. E shumica spiunë…

Mallkim kombëtar, përderisa "spiunët" dhe "patriotët" edhe sot na i shpallin të tjerët, si në kohën e komunizmit, kur të duan dhe sa herë të duan sipas rrethanave politike. Rasti ma kujtoi edhe një "spiun" të asaj kohe komuniste. E përhapën në gjithë katundin se spiun i UDBA ishte shoku Mito. I gjithë katundi iknim nga ai si prej dreqit. I ruheshim në biseda rasti, nuk flisnim para tij asgjë politike. Vetëm, na vinte çudi nga e dinte policia çdo gjë që ndodhte në katund?!

Flamurin kuqezi, kush e hipi në minare të xhamisë. Cili mbante armë pa leje në shtëpi.

Kush e këndoi këngën e Kalosh Zajazit në dasëm. E, kush e shkrepi revolen për dritare, kur zbriti nusja në lëmë… Edhe, në fund e dini kush kishte qenë spiuni i katundit?! Jo, nuk e dini: Hoxha dhe "patrioti" kuqezi.

Me siguri, ju doni të dini edhe për mua si shkrimtar, pse ende deri më sot nuk e bëra asnjë ditë burg?! E, në anën tjetër e lexoni emrin tim nëpër organizata të ndryshme nacionaliste e irredentiste. Nuk e di as vetë, se si kam hy dhe kush më ka shti nëpër ato lista antikomuniste, që sipas një bisede informative që pata në polici (1993), u binda edhe vetë se ato lista i posedonin edhe shërbimet sekrete të shtetit. Në atë bisedë informative kuptova edhe se, unë isha i dërguar nga Kosova që të veproj në Maqedoni. Qindra mijëra marka i kisha dërguar Partisë Socialiste në Shqiperi. Qesharake, ishte edhe ajo se kisha pasur disa takime të fshehta në Bullgari, kur unë në atë kohë nuk kisha as pasaportë udhëtimi. Vitin e kaluar (1992) kisha botuar edhe një libër me satira (*Trumbetat e Tellallit*). Librin e kemi të përkthyer fjalë për fjalë në gjuhën maqedonase, është thikë me dy teha, tha inspektori që më mori në pyetje.

Edhe, kulminacioni i bisedës informative se, unë isha ai kryesori që çështjen e shqiptarëve dua ta zgjidh me luftë. Qesha. Dhe, aty për aty iu përgjigja. Unë dua të jem ky që thoni ju, por fatkeqësisht nuk jam Ai kryesori. Fundi i fundit ju e dini se unë nuk kam edhe pasaportë udhëtimi.

Jo, ndërhyri inspektori, ne kemi informata të sakata nga bashkëpuntorët tanë të sigurimit. Akuzën e kanë nëshkruar njëzet veta, do t'i

shohësh nënshkrimet e denoncuesve? Jo, ia prita nuk ka nevojë. E mora me mend se kush ishin ata "patriotë" kuqezi me të cilët kisha pasur edhe disa polemika të ashpra rreth librit, *Trumbetat e Tellallit* (1992) në gazetën e tyre policore-shtetërore: gazetarë, shkrimtarë dhe redaktorë në redaksi. Fundi i një pjese të kësaj historie të hidhur që në atë kohë ma përgaditën rrufjanët. Zoti siç duket është i madh, rastësisht shpëtova nga burgu.

Vërtet, nuk bëra asnjë ditë burg, jo se i jam trembur burgut, po shkaku se më shumë u kam besuar "spiunëve", sesa "patriotëve" kuqezi. Ndoshta, edhe kam humbur diçka të vlefshme në jetën time si shkrimtar, ta zëmë bilbiotekën e pasur me libra në Idrizovë. Ose, ndonjë zanat tjetër me vlerë, që do ta mësoja në burg dhe nuk do të më lente sot pa punë. Nuk e di. Një gjë e di të sigurtë, bariu i katundit tim shkoi në burg analfabet, dhe nga andej u kthye piktor. Kushëriri im, poashtu gjysëm analfabet, u kthye nga burgu me gjuhë standarde letrare shqipe. Dhe, që në atë kohë komuniste, në dyqanet e maqedonasve pazarin e bënte në gjuhën shqipe. Skënderbeun pa frikë e vizatonte mureve shtëpi më shtëpi nëpër katund. Përçudi, nuk e merrnin më përsëri në burg. Përgjegjësit e burgut thonin: nuk e marrim se na bën probleme me të burgosurit, i meson ta vizatojnë Skënderbeun qeli më qeli.

Prandaj, më e arsyeshme është ta vizatoj Skënderbeun nëpër katund se sa bashkë me të burgosurit në qelitë e burgut. Ne ia sigurojmë fjetjen, bukën e ai na e përmbys kupën. Edhe në burg bën propagandë shqiptare. Nuk na duhet ky

hajlaz. Merreni dhe bëni çka të doni me të në katund! Rast interasant ky me kushëririn tim se si i shpëtoi edhe ai burgut komunist. Tashti më kushëriri im nuk e ka atë problem politik, Skënderbeun e ka në Bit-Pazar me gjithë kalë me shalë. Vetëmse, përçudi sot Skënderbeun e duan maqedonasit, po nuk e duan halldupët shqiptar. Vështirë e kanë t'ia përmendin edhe emrin, vazhdojnë t'i lënë takimet e punës dhe për çaj rusi te "Kali". Në këtë shkrim mos harroj t'jua përkujtoj edhe një thënie të gjermanëve në kohën e fashizmit, kur i pushtuan tokat shqiptare. Kohë kjo, e Marrëveshjes Historike Shqiptaro-Bullgare. Gojën plot, thanë për shqiptarët: Shumë para kemi harxhuar për spiunët nëpër botë. Përçudi, shqiptarët këtu qenkan spiunë pa para. Frikë kam edhe se, halldupëve shqiptar u pëlqen nofka: spiun…

Burra, ndaluni me shpifjet dhe denoncimet! Edhe spiunët, edhe patriotët do t'i shpallim vetë si shqiptarë. Mjaftë më na i shpallën para dyerve të oborrit rrufjanët e djeshëm komunistë dhe "vëllezërit" e Njerkës me anë të "pëllumbave postier"!

Dhe, në fund: shqiptarët duhet t'ua zgjasin dorën e pajtimit "spiunëve". Dhe, përzënë nga radhët e veta të partive politike shqiptare "patriotët" kuqezi…

## SHKUPI NJË DITË DO TA GËDHIJ MËNGJESIN SI KRYEQYTET I SHQIPËRISË ETNIKE

Shqiptarëve, s'kam çka ju shkruaj më diçka të re për Kalin e Trojës nëpër Bit – Pazar. E kanë mësuar këtë tradhti luftarake nga historia përmendësh si vjershë. Edhe në librat e këndimit në shkollë. Vite me radhë ju shkruaj në mjetet e informacionit për këtë Kalë Troje teknefes me zgjebe. Gjatë ndryshimeve demokratike, edhe një libër me qindra faqe të ilustruar me karikatura nga piktori ynë i madh Adem Kastrati (Cun Geli): *Kali i Trojës nëpër Bit – Pazar* (1994). E paralajmërova politikën shqiptare mes atyre faqeve: Kalin e Trojës, pasmesnate na e futi duke e tërhequr për freri në Çarshinë e Shkupit Doktor Ziu me shokë. Kohën e fundit, përpiqet me mish e shpirt të na e lidhë nën hije të Rrapit te shatërvani edhe Pelën e Trojës. Bishtin moti ia ka ngritur Pelës së Trojës, Sanço Pançoja shqiptar (Petrioti i vonuar melez). Ditë më parë, ju shkruajta edhe një shkrim rreziku: *Teutat e sotshme kuqezi – gra besnike në parti*. Tjetër, është ajo se kush i ka hipur kësaj pele me samarë në shpinë dhe kush e shalon me të katra nëpër Bit – Pazar. Nuk ka rëndësi kjo "shitje e lirë" në këtë shkrim parashikues për Nesër. Përsëri, halldupët burra e gra në mënyrë vullnetare duke u shty me bërryla e bythë, nguten të futen kësaj radhe kush i pari, jo në barkun e Kalit të Trojës, po në barkun e Pelës së Trojës me zgjebe.

Fatkeqësisht, edhe kësaj radhe e tërheq për freri Doktor Ziu me Sanço Pançon e tij shqiptar mbi gomar si hero lufte.

Interesant, të gjitha betajat e "përgjakshme" historike edhe sot si dje, bëhen për Dylqinenë e Tobozës. Përpak, para një viti për këtë Dylqine të Tobozës, Don Kishoti Shqiptar me Sanço Pançon trim mbi gomar, desh i futën shqiptarët me zor edhe në një luftë të re për të "drejta kombëtare", po të mos ishte Ali Ahmeti dhe Amerika.

Merreni me mend, ne shqiptarët që posa kishim dalë nga një luftë shkatërruese, edhe atë: pa brekë në bythë po të mos ishin amerikanët të na dalin krah dhe të na e mbronin shpinën. Qëllimi historik i "vëllazërim-bashkimit" nuk u mungonte kalorësve të arratisur shqiptar kuqezi: të gjitha "betejat e përgjakshme" i bënin për Dylqinenë e Tobozës shqiptare, që një Zot e di me cilin rrokulliseshte ditenatë në shtrat, bënte "dashuri" rrospie në Shtëpinë Publike.

E di, do të më pyesni në këtë shkrim: me vete duhet ta kishin edhe një hoxhë kuqezi me çallmë turku. Nuk duhet t'jua cungosh "patriotëve kuqezi" edhe këtë të drejtë qytetare, sipas konventave ndërkombëtare. Patjetër, mos mendoni se e kam harruar në xhepin e strukes, e kam lënë me qëllim për më vonë me nga një hajmali t'ju japë fuqi "kryengritësve" halldupë për luftë. "Patriotët" tanë kuqezi në barkun e Pelës së Trojës, si do të hynë në luftë për Shqipëri Etnike pa hajmali për qafe, pa një duva nga hoxha për rrugë të mbarë me bythën në Shkup e kokën në Turqi.

Përmëtepër, edhe të na prinë si komandantë pas lufte për në Liri. Teknefesët, që ende e kanë përqafe torbën me taxhi me kokat në grazhd të "vëllezërve" që nga koha e "artë" komuniste. Vërtetë, mendojnë apo shtihen se, ende ky popull ha bar dhe mund t'i hip në shpinë kujt t'i teket, bie me thupër shelgu bythëve nëpër qorrsokaqe. Apo, ende e mashtrojnë veten me taxhi, guxim donkishotian për t'i prirë në ballë këtij populli. Përsëri, nesër ta shesin shumë lirë: një post në Qeveri.

Jo! Jo, "patriotë kuqezi"! Populli shqiptar kësaj radhe ka vendosur vetë t'ia ngrej bishtin

Pelës së Trojës në Bit - Pazar. Nëse, është nevoja edhe bythët në hava, rrëzë Kalasë Dardane. Dhe, të gjithë "patriotët kuqezi" t'i rrasë me radhë njëri mbi tjetrin në bark të Pelës së Trojës. Ali Ahmeti, në mënyrë solemne beshkë me Gruevskin ta hapin Portën triumfale në Shkup, dhe e gjithë pjella e keqe komuniste të përfundojë bythekrye në Partinë e sotshme Neokomuniste.

Edhe: Shkupin përditë jemi duke e bërë metropolë botërore. Qytetin e rrethuar nga të gjitha anët me katunde shqiptarë. Skupin historik, që pas Tiranës është qyteti i dytë i banuar me shqiptarë. Vendbanimi i vetëm në botë, ku shqiptarët edhe sot e kësaj dite lindin, jetojnë, punojnë, vdesin dhe përsëri lindin pa nënshtetësi. E bëri së pari Natyra. Pastaj, ne "maqedonasit": bullgarët, shqiptarët, vllehët, serbët, turqit, romët… E sollëm me gjithë kalë në shkup Skënderbeun, Goce Dellçevin, Dame Gruevin, Karposhin, Shën Kirilin dhe Metodin, Shën

Klimentin dhe Naum Ohërin, Aleksnadrin e Madh… Rrugës është duke ardhë me kalë edhe babai i Alaksandrit të Madh, Filipi i Maqedonisë.

Dhe, çka mund të bëjmë ne shqiptarët më shumë se kaq për Shkupin?! Shekuj me radhë kemi derdh edhe gjak pët këtë qytet dardan nëpër histori. E çliruam nga të huajt, e "shkeli" për herë të parë edhe këmba e Isë Boletinit me kryengritësit shqiptar. Në mënyrë vullnetare, përsëri u tërhoqëm në male. E lamë me fajin tonë të marrë frymë në Robëri.

Shkupi është i Nënës Nayrë. Myslimanët dhe të krishterët do të thoshin: i Zotit.

Pajtohem, edhe unë them: Shkupi është i Nënës Natyrë dhe Zotit. I të gjithë qytetarëve të barabartë, pa dallim feje dhe kombi. Përditë, i japin frymë, jetë vetëm këta fëmijë, gra e burra… E bëjnë më madhështorë si qytet modern. Krenarë me Vardarin mes për mes qytetit. Urën e Gurit që i lidhë dy kultura të qytetërimeve: anën shqiptare dhe atë maqedonase. E ndërtojnë, zbukurojnë me blerim, ngrejnë përmendore.

Fatkeqësia: frikë kam, se: nesër nuk kemi kujt t'ia lëmë Shkupin! Ju. përsëri do të thoni: jo, kemi gjeneratën e ardhshme. E vërtetë, vetëmse nuk dimë kush do të jetë ajo gjeneratë e ardhshme pa ngarkesa pushtuese shoveniste dhe nacionaliste. Dhashtë Zoti, edhe i varrosim në histori misionarët e Beogradit në statuja më këmbë e kuaj shale. Vetëm, vështirë do ta kemi ta varrosim sipas ceromonive fetare e politike edhe Ditën e nesërme: Shkupi kur do të marrë lirisht frymë dhe do t'ju takoj me gjithë pallate e

përmendore, që gati prekin qiellin shqiptarëve autokton.

Dhe në fund, siç i kanë nisur punët historike, Natyra ose Zoti duke ua marrë mendtë politikanëve: Shkupi një ditë do ta gëdhij mëngjesin si kryeqytet i Shqipërisë Etnike…



## RRUGAÇJA

Vonë. Shumë vonë njeriu i sheh këmbët e padukshme që duan ta shkelin, shtypin në baltë si mizën. Njerëzit e sëmurë janë krijesa të cilëve etja për shkëlqim ua jep trajtat dhe format sipas dëshirës. I tjetërson. Dikend e bën të ecë këmbadoras, dikend të fluturojë në qiell, dikend ta tërheqë qerren… Njeriu mund të dalë nga çdo gëzhojë, por vështirë e ka të ikë nga grushtat e egër që e shtrëngojnë natë e ditë.

Veprën kur ta krijosh, t'i japësh shpirt, bukë, ujë, lumturi, liri… Jepi edhe atë më kryesorin, trurin. Ju do të thoni cilin tru? Atë trurin që e kanë vetëm njerëzit e urtë. Trurin e vërtetë. Trurin e dritës. Prapë ju do të thoni: - paska edhe tru fals?! Po, o lexues i nderuar. Mjerë ai që e ka atë tru. Njeriu si njeri nuk mundet ta qes dot në krye me tru të shëndoshë, e si do ta qes veten matanë lumit me tru të sëmurë. Unë sa për vete kur hidhërohem me njerëzit e sëmurë, them: njeriu më mirë të mos e kishte trurin fare në kokë. Nuk do të mendonte kurrë se këtë duhet bërë këtij, këtë atij… Më shkurt, nuk do të mendonte për të ardhmen e as për të kaluarën, në egërsi. Do të jetonte sipas dëshirës së vet, si kafshët nëpër livadh ose lidhur me litar për gardhi. Qesharake, ë? Kafshët me koka njerëzish në qafë! E njerëzit me koka kafshësh!... Pse, kafshët nuk janë të lumtura?...

Këtu e shoh se do të shahemi që në fillim të rrëfimit. Ju do të ma shani nënën, babën… Po, unë jam aq i vendosur në këta rreshta që i shkruaj

saqë ua kisha thënë në sy edhe atyre që nuk pajtohen me mua në këtë shkrim. Jam i lodhur më me marrëzirat e disa njerëzve të sëmurë, sa turp më vjen të rri edhe në dhomën time me libra. Dua të iki nga fytyrat e tyre të shëmtuara edhe përtej këtyre mureve. Po, muret dita-ditës ngushtohen, më shtrydhin… Marrëzirat e tyre më shtrëngojnë, më mundojnë, më trembin…

Shkrimtari ecën rrugës së Qytetit me duar në xhepa, që para tij e kanë shkelur njerëz të mençur e budallenj. Koka e tij bluan diç nëpër tru që nuk ia thotë kujt. Edhe sikur ta tredhin me litar si mëzat, këtë nuk do t'ia thonte, se s'ka besim. Ndoshta ai është ndonjëfarë budallai i llojit të vet, ku ta di, se për i mençur jo se jo deri në këtë ditë. E di ai këtë punë mirë, sepse ka folur njëherë moti dhe natën e ka rrahur me dru Lugati i Koçajve. Dy ditë e tri net ka ndejtur në shtrat i mbështjellë me kripë e qepë. Dhe, që atëherë nuk guxon më të flasë, se ka frikë mos e rrahin prapë si lopë. Ai, ç'është e vërteta, i ka dalur borxh vetes në mesin e librave. I ka thënë: ti je budallai më i madh që ka ekzistuar e nuk do të ekzistojë më në këtë lëmsh rrugësh. Ti kokën tënde vetë do ta shtish në xhep dhe do të ecësh perit të jetës hiç pa kokë. Ndodhë ndonjëri të ta pres perin ose të ta qesë këmbën e të rrëzohesh në greminë si lis i premë, pa frymë. Këmbët e budallenjve ose të të mençurve do të të shkelin si krimbin. E se do të çohesh më vonë apo jo, këtë nuk e di, të ta them në këtë shkrim.

Duart ende s'i ka nxjerrë nga xhepat e gunës së zezë.

Me njërën dorë luan me një para të metaltë si jeta me të rrugëve të gjata kah lumturia. Ndërsa, dorën tjetër e ka bosh, fyell. E sjell lart e poshtë nëpër xhepin e errët, për të gjetur së paku ndonjë copë letre apo diç tjetër ta gëzojë edhe atë, por kot. Edhe njerëzit, dikur thotë, janë si duart e mia në xhepa. Dikush ka e dikush s'ka. Ai, sa ka parë e sheh, ka ardhur në përfundim, se budallenjt kanë më shumë se të mençurit. Ja, në Qytetin e tij ka disa njerëz të pasur, por edhe budallenj. E të tjerët, mësuesë, profesorë, doktorë shkence, gazetarë, poetë, shkrimtarë… Vdesin një ditë edhe pa bukën e gojës. Mu për këtë disa herë nuk e konsideron veten për budalla, deri në atë masë. Natyra asnjëherë nuk t'i jepë dhuratë dy të këqija ose të mira bashkë. Nëse të jepë budallakinë, të jepë edhe pasurinë. E nëse të jepë mençurinë të jepë edhe varfërinë. Dhe, a s'është kështu?...

Në qoshkun e sheshit të Qytetit e bleu gazetën e ditës dhe pasi e shtiu në çantën e zezë eci nga kafeneja "Tre luanët". Hyri Brenda dhe u ulë në një tavolinë pranë dritares. Kamarieri, pasi e shikoi njëherë me bisht të syrit iu afrua tavolinës.

- Urdhëroni, zotëri!

- Një kafe të ëmbël!

- Menjëherë, iu përgjigj kamarieri dhe iku përmes tavolinave.

Shkrimtari e nxori përpara gazetën dhe nisi ta shfletojë faqe më faqe. U thellua në ngjarjet e ditës.

IN MEMORIAN
VDIQ PROF. DR. SHPIRT LIGU

Më 18 qershor të vitit 201… vdiq papritmas profesori i Universitetit dhe punëtori shkencor shumëvjeçarë, Shpirt Ligu.

Shpirt Ligu lindi më 193… në fshatin Dardhishtë.

O Zot! Falja mëkatet profesorit! Ki mëshirë! Gazetat e huaja çuan shumë pluhur për t'i ndritur emrin, derisa një gazetë e përditshme nuk ia botoi mëkatet e bëra në faqen e parë me shkronja të zeza. Profesori kohën e fundit ra në tybeistifa. U kthye nga Tyrbja. Mëshirë, o Zot! Profesori hyn në varr pa iman… Laj-laj ilallah. Muhamede stefkërlla…

Kamarieri dikur ia solli kafenë ia vuri përpara dhe iku pa zë përtej karrigeve. Shkrimtari e shfletoi edhe një faqe dhe doli në faqen e tregimit.

Din ÇUKA

RRUGAÇJA QË U DASHURUA NË EMRIN E SHKRIMTARIT

(*Fragment romani*)

Hajde Din Çuka! Hajde Din Çuka! Na u bëre edhe ti shkrimtar. Nuk e paskan pasur gabim shokët e klasës  që nuk të thirrnin me emër, por poet. Ore, a të kujtohet njëherë kur do të përjashtoheshe nga shkolla normale po të mos ishte profesori i gjuhës shqipe. Ti e shkruajte atë artikullin në gazetë: "*Flejnë profesorët, flejnë nxënësit, flejnë aktivitetet e lira*". Pastaj një vjershë satirike me titull "*Pedagogu*" të cilën ia përkushtove një profesori të shkollës. A të kujtohet? Vërtet pas këtij artikulli në shkollë nisi

punën grupi letrar, i muzikës, i piktorëve… Por, ty vëllaçko, disa profesorë nuk të shikonin me sy të mirë. Si borxh që ta kisha njëqind herë të thash: Din, shumë herët ia ke nisur me ato shkarravinat tua të ashpra t'i marrësh të tjerët nëpër gojë. Kjo është një që nuk të bën ty dhe në të ardhmen do të heqësh shumë rrugëve të jetës. E dyta, ti vrapon shumë pas femrave. E di si është, të gjithë njerëzit nuk janë të njëjtë në këtë vrapim maratonik. Ti argëtohesh me vajzën e tij e kapërdis, flen… Një ditë ti e lë atë, nis me një tjetër dhe e bënë buthë e krye, edhe atë në livadh. I biri i botës del dhe ta zë udhën. Pastaj, mua më duket se ti shumë e ke tepruar me atë zeshkanen, Rrugaçen. Mos e zgjatë më bre vëlla, se unë të njoh ty mirë këmbë e krye. Nuk je mësuar ti të jetosh natë e ditë vetëm me një grua…

Din Çuka filloi të qeshë në mes të rreshtave. Iu përgjigj mu në atë fragment romani.

- Hajt, o burrë, ti mos u mërzit, se femrat janë për aso punësh e nuk janë vetëm për t'u përdridhur rrugëve…

- Din, frenoje veten merre fjalën prapë!...

- Gjuha nuk është asht, por eshtra thyen…

- Po, ç'tëbëjmë hallit, pyeti Shkrimtari?

- Fjalën së apri duhet ta bluaj truri e pastaj gjuha…

- Din nuk jam i sigurt aq shumë me gojën sa në këtë shkrim…

- Me këtë shkrim je nisur të ngjitesh në Baba Tomor.

- Kam frikë mos bie shi… Breshër… Të shti rrufeja…

- Zoti Shkrimtar, nuk bëhet luftë pa armë.

- Din, rrezik është të ngjitesh në Baba Tmor!
- Rrezik është, por edhe fitore…

Shkrimtari e mbylli gazetën. Nuk i erdhi mirë me atë që lexoi nëpër ata rreshta. Dini, i tha vetes, po mplaket me një palë mend në kokë. Çudi! Paratë e kafesë i la mbi tavolinë dhe doli jashtë, në rrugë. Kësulën e rrasi në kokë deri në veshë. Duart përsëri i shtiu në xhepat e gunës së zezë. Kokëulur ecte rrugës kryesore nga Sheshi i Fitores. Disa kalimtarë rasti e përshëndetën, tungjatjeta! Shkrimtari ua kthente vetëm atyre që ia zenin udhën dhe gati-gati i ngatërroheshin nëpër këmbë. Dikur trupoi rrugën për të kaluar në anën tjetër të trotuarit. Një automobil që ulurinte sa mundej si egërsirë, përpak desh e shkeli si bretkosën në mes të udhës.

Shoferi mustaqepërdredhur, për moskujdesin e tij, nxori kokën në dritare dhe i lëshoi një të sharë në ajër. Shkrimtari me duart në xhapa, i thelluar në mendime, vazhdoi udhën.

Matanë rrugës, pas një koshi me hedhurina i kishte vënë pusi Rrugaçja…

## DARKËN E SHITA PËR NJË BIRRË

Vite më parë gjatë Manifestimit kulturor tradicional me karakter ndërkombtar Mbrëmjet e Poezisë Strugane, në një intervistë dhënë një gazetareje të huaj në mes të tjerave thashë: Mbrëmjet e Poezisë Strugane janë të politizuara deri në palcë, më shumë ka politikanë dhe spiunë se sa poetë. Vërtetë edhe ashtu ishte në atë kohë, në Mbrëmjet e Poezisë Strugane merrrnin pjesë poetë nga të gjitha vendet e botës, po aq më shumë edhe spiunë të të gjitha shërbimeve sekrete botërore. Nuk do të thotë kjo se sot nuk marrin pjesë, edhe sot marrin po jo aq shumë si dikur në "kohën e artë" komuniste. Edhe shpenzoheshin shuma të mëdha parash për këtë manifestim kulturor ndërkombëtar. Dorën në zemër, Maqedoninë në botë e njihnin në bazë të këtij manifestimi, me poezi se sa me politikë. Edhe ashtu duhet të ishte për një vend "demokratik" të vogël me një moshë pesëdhjetë vjeçare si vepër e Jugosllavisë titiste dhe njëzet vjeçare si shtet i pavarur që ecte drejtë zgjidhjes së çështjes së emrit si shtet i ri pa përvojë politike.

Manifestimi si vepër dhe ide e qëlluar komuniste vazhdonte të marrë frymë nga viti në vit. Dihet, edhe me plot vështirësi e probleme. Herë pas here në breg të Drinit Zi në Strugë griseshte flamuri shqiptar. Poetët shqiptar, edhe pse ishin themelues të këtij manifestimi kulturor, anashkaloheshin si pjesmarrës bashkë me gjuhën shqipe. Nuk ftoheshin në manifestim, ose i ftonin

sa për sy e faqe. E për shpërbilme as që duheshte të shihnin ndonjë ëndërr me përjashtim të Adem Gajtanit që mezi e mori një çmim letrar "Vëllezërit Milladinovci" (1983), edhe atë pas vdekjes. Dyzetetetë (48) vjet më vonë me plot intervenime politike edhe Fatos Arapi "Kurorën e artë" (2008). Mehmedali Hoxha (njëri nga themeluesit e këtij manifestimi), Murat Isaku dhe Abdylazis Islami hynë në varr pa këto çmime letrare, edhe pse kolegët e tyre maqedonas këto çmime letrare i rrëmbyen për herë të dytë e tretë gjatë këtyre viteve të "vëllazërim-bashkimit". Poetët tjerë servil shqiptar dhe "kritiku i tabanit kombëtar" gjatë gjithë kohës bënin jetën e argatit në dëm të letërsisë shqipe. Ashtu e donte politika dhe koha, thonë sot rrufjanët. Shqiptarët duhet të ishin si numra zbukurimi të Mbrëmjeve të Poezisë Strugane. "Vëllezërit" i kishin poetët shqiptar kukulla, që kur të donin dhe si të donin ua tërhiqnin penjtë: ua ngrenin duart, këmbët, bythët... I caktonin nëpër komisione, në juri të shpërblimeve sa për sy e faqe. Mashat shqiptare, para kamerave televizive vetëm hidheshin dhe përdridheshin me vallet dhe këngët folklorike sllave.

Dhe, në fund e merrnin shpërblimin: i torturonin nofullat me mish derri. Ndonjëherë i jepnin kosës edhe më shumë se sa kanë fuqi gjoja si patriotë shqiptar, dilnin edhe në Kosovë dhe Shqipëri. I ftonin miqtë e tyre poetë, po rrallëherë rastësisht ftonin ndojë Mbret të poezisë shqipe. "Vëllezërit" si gjithmonë u bienin duarve, ua rrahnin krahët. Vërtetë poezi të "arrira artistike". Ju jeni mbretërit e poezisë shqiptare. Ndonjëri

nga këta kalorës të arratisur edhe bënte pazar në emër të poezisë shqipe: shiste dhe blente çmime letrare nëpër manifestime kulturore. Shembull më i freskët është Fatos Arapi. Jo, se Arapi nuk e meriton "kurorën e artë", po jo para Frederik Rreshpjes, Dritëro Agollit, Teki Dervishit, Xhevahir Spahiut, Musa Ramadanit, Hida Halimit dhe Azem Shkrelit.

Përçudi, këta kalorës të arratisur të letërsisë shqipe, përveç ndarjeve të çmimeve letrare edhe ta caktonin vendin si shkrimtar në letërsi me "Antologjitë" e tyre të famshme. Kur të donin të shtinin dhe hiqnin nga planprogramet shkollore, lektyrat shkollore, librat e këndimit… Komisionet e tyre teknefese dhe "juritë profesionale", përditë e më shumë i ngushtonin radhët e tyre neokomuniste.

E emronin njëri - tjetrin nëpër komisione letrare të manifestimeve kulturore, Enciklopedisë maqedonase, botimeve luksoze të "Makedonska knizhevnost" (letërsisë maqedonase). Edhe i botonin "kryeveprat" e Klanit sakat të tyre me paratë e shqiptarëve në emër  të "Shtetit të përbashkët" si vepra të rralla artistike.

Vetë i vlerësonin, vetë i nderonin me çmime letrare si "vepra" të arrira artistike.

Të nesërmen, pasi i rrëmbenin honoraret e tyre marramendse për "flijimet e tyre artistike-patriotike", sharra kur u haste në gozhdë dilnin para popullit shqiptar me reagime në mjetet e informacionit: nuk na kanë pyetur "vëllezërit", dhe ne si "intelektualë shqiptar" do të japim dorëheqje. Një ditë më vonë, harronin horrat komunist se ç'kanë thënë, përsëri emroheshin në

komisione të tjera kulturore. Fatkeqsisht, vazhdonin t'i ndanin plaçkat e "luftës kulturore" në emër të popullit shqiptar dhe letërsisë shqipe. Përpilonin lloj-lloj listash nëpër manifestime kulturore. Punemadhe, që "poetët" e tyre nuk i njihte jo vetëm katundi, po as nëna e vet, e ku më populli shqiptar, dhe dumdumëve vite me radhë në vend të krundeve "vëllezërit" u jepnin të hanë kashtë në grazhd.

Kulminacioni i "artit të tyre gjenial" e arriti famën botërore vitet e fundit, kur filloi edhe t'ju tërhiqet freri. Goja t'u mbushet me shkumë dhe gjak. E në anëtë tjetër, "vëllezërit" edhe ua ndalën taxhinë. Përditë e më shumë u bienin me thupër bythëve si pela shqiptare. I shalonin me të katra livadheve të kositura me kosë.

Tashti, e shoh gabimin. Me rrallimin e mosardhjes të politikanëve dhe spiunëve në këto manifestime kulturore, u rrallua edhe shtrurja e sofrave të begatshme poetike. Në manifestimin e fundit (pesëdhjetë vjetorin e Mbrëmjeve të Poezisë Strugane), poetëve u shtroheshte përpara nga një bokall me ujë.

Fantastike: uji shkon me poezinë. Në sofër mungonte për çdo poet përkrahu ta shtronin vetëm edhe nga një xhadi. Edhe, sikur na thonin: lexoni poezi sa të doni, gjithë ditën deri në agim. Veprimi i këtillë ma kujtoi Niko Nikollën një satirist shqiptar nga Tirana, që gjatë një Akademie përkujtimore për Mehmedali Hoxhën para disa viteve në Strugë pasi na e shtruan sofrën me pije joalkoolike tha: poetët nëse do t'i bësh terbie përpara mbi tavolinë nxirru "fanta", "coca cola" dhe "gazoza"… Edhe do të shohësh se si ju

bien kokat mbi tavolinë. Niko Nikolla në atë Akademi përkujtimore në një nga restorantet e Strugës ku edhe na helmuan e tha edhe një realitet: nuk ka popull shqiptar, po ka popull shkrimtar.

Organizatorët e manifestimit poetët i kishin shpërndarë nëpër të gjitha hotelet e Strugës dhe të katundeve si Kashta e Kumbarës. Autorin e këtij shkrimi e kishin hudhur në një hotel privat në periferi të qytetit si Robinson Kruso. Që, të jetë sa më larg ecurisë dhe rrjedhave të manifestimit. Shkaku, se: ai është i pamëshirshëm në shkrime. Falë gjeturisë së tij prej shkrimtari kaloi edhe më mirë se Robinson Kruso, në mesin e miqëve poetë të paktë në numër në atë hotel. U muar vesh me pronarin e hotelit t'ia shesë darkën për një birrë. Bombat, dy "kashikara" me raki rrushi i kishte marrë me veti në çantë, ishte armatosur me kohë që nga shtëpia. Herë pas here dilte edhe në plazh, hynte para diellit në Liqe dhe dilte pas tij në breg. Poetët e tjerë nuk e kishin këtë fat, ndonjëri u kthye i dëshpruar pa lexuar edhe një poezi.

Punemadhe, që i kishin ftuar dhe ardhë me aeroplan nga larg me qindra kilometra vetëm për këtë punë, të lexojnë poezi. Ndonjëri i nervozuar nga sjellja e organizatorëve iku edhe para kohe, nuk e priti fundin e manifastimit, ndarjen e çmimeve letrare mbi Urën e Drinit Zi.

Përmëkeq, vitet e fundit nuk paguhen honoraret e poetëve pjesmarrës, nuk paguhet rruga. Edhe pse, këtë vit manifestimi mbaheshte nën patronatin e UNESCO. U shpërndanë edhe shumë libra të autorëve botëror e sllav, e asnjë të shkrimtarëve shqiptar. Në mungesë të

përkthyesve, organizatorët aty-këtu të shumtën e herave nuk i përkthenin poezitë e disa autorëve me "arsyetim" se, donin ta dëgjonin se si tingëllon poezia edhe gjuhen e tyre në këtë manifestim kulturor?! E sidomos, nuk u përkthyen poezitë e poetëve shqiptar. Shkaku, se: "vëllezërit" vërtetë nuk e dinin se si tingëllon gjuha shqipe nëpër këto manifestime kulturore letrare në "shtetin e përbashkët".

Poetët këta mbretër të pozisë, dita-ditës po shndërrohen në palaço të partive politike. I argëtojnë nëpër oborret e tyre politikanët teknefes me poezi patriotike – patetike. Megjithatë, manifestimi kulturor këtë vit pati edhe anën pozitive: Ramiz Merko, kryetari i komunës së Strugës për herë të parë poetët dhe të pranishmimit i përshëndeti vetëm në gjuhën shqipe. Edhe pse, para këmbëve të urës mbi Drinin e Zi, u brohoritë dhe fishkëllua nga "vëllezërit".

Nuk e dëgjova sekretarin e Ministrisë së Kulturës, z. Muzafer Bislimi gjatë koktelit në Kalishtë se në cilën gjuhë e hapi orën letrare, shkaku mungesës të zërimit (mikrofonave) në verandë të hotelit "Biser" para syve të Liqenit.

E di, ju do të ma përmendni edhe atë thënjen e urtë popullore, te ne në Katund i thonë: ta han bukën dhe ta përmbysë kupën. Jo. Tradita e shqiptarit është: mysafirin kur ta thirrësh në dasëm, prite siç duhet me të gjitha nderimet, ose mos e thirrë fare. Bukë dhe shtrat ka në shtëpi, nuk ka nevojë të udhëtojë me qindra kilometra të lexojë poezi për një bokall me ujë dhe gjumë në

periferi të qytetit mes gërmadhave të ndërtimeve të egra.

Urime! Edhe unë në Mbrëmjet e Poezisë Strugane e fitova një çmim: Darkën e shita për një birrë. Vërtet, edhe sot në "demokraci" sa bukur jua tërheqin penjtë!...



II RRUGA QORRE

**MËZI IM I BUKUR**
**ENDE I PALËPI**

Lexuesi i nderuar, e di se: lopa ndonjëherë pjellë viç të palëpi. Edhe pela me siguri pjellë mëz të palëpi. E ju, do të thoni: pse i pjellë në mes të Dimrit dhe nuk i lëpi?! Ja, arsyeja: nuk i do si ardhacak të rinj në familje.

Fatkeqësia është se, këto pjella të kafshëve të buta rriten arave e grazhdeve të huaja me një torbë taxhi për qafe dhe një krah kashtë. Në këtë rast i solli në jetë, Mushka. Melezja është ajo që i merr në mbrojtje këto kafshë të buta gjatë gjithë jetës. Edhe përkujdeset për to si kafshë të buta shtëpiake, i përgaditë për samarë. E di, ju do të thoni pse nuk i përgaditë për shalë? Nuk i përgaditë për shalë se, ju ka hije samari, mirë u rri në shpinë këtyre kafsheve të buta shtëpiake.

Rasti ma përkujtoi edhe një poezi timen që e kam shkruar para disa viteve dhe e kam botuar te libri im me poezi “ ***E përcolla Natën***” (1988):

## Kafshë e zbutur

*Dum Dumi është një kafshë e zbutur*
*që kullot në livadhet e Nënës Parti*
*e pi ujë në Hurdhë*
*e tërheq qerren rrugës*
*e lidhin në grazhd*
*me një krah bar*
*ose një kovë taxhi.*

*Dum Dumi është një kafshë e zbutur*
*mëzat i tredhur*
*që nuk i kërcen Lopës*
*dhe kurrë nuk e thyen zgjedhën...*

Dhe, merreni me mend, Mëzi im i bukur i palëpi edhe sot e kësaj dite nuk u rritë në kalë për samar, po mbeti gjithë jetën mëz i palëpi pas dyerve të hallkut duke pritur t'ia hudhin pas dere një torbë taxhi, ose një krah kashtë. Më kot e priste pronari të rritet në kalë dhe t'i vë samar për të bartur dru nga mali.

Mëzi i palëpi vazhdon të rritet edhe sot dyerve të huaja në mëshirën e hallkut, që një ditë t'i vënë samar, ngarkojnë me dru për në dimër.

Shkaku se, soji i tij ka lind për samar, e jo për shalë. Hije i ka në shpinë samari këtij mëzi të palëpi, që na e polli Pela pas dere dhe e rritë Mushka me një krah kashtë për samar.

Mirë, përsëri do të thoni ju: po ne kur do t'i vëmë samar këtij mëzi të palëpi? Kurrën e kurrës. Shkaku, se: e ka pjellë Pela dhe nuk e ka lëpi pas dere. Mushka e rritë me një krah kashtë për samar si gomarin e Nstradin Hoxhës.

Plaku i urtë i ka hipur përsëprapthi mëzit të palëpi në shpinë për në Pazar. E tërheq për kërpeshi Nstradinica. Gjatë rrugës me gropa pritet t'i hipë në shpinë edhe Nstradinica.

Edhe unë këtij mëzi të bukur të palëpi i kam dhënë një torbë taxhi duke u përpjekur që të rritet në kalë së paku për samar, të na sjellë në Shtëpi dru për zjarrin e ndezur në oxhak, në Dimër. Fatkeqësisht, ky mëz i palëpi është pjellë e keqe

mushke. Dhe, nuk sjellë në Katund as dru, as ujë mbi samar. Përmëtepër, e dini pse gomarin e kanë thirrë në dasëm?! Me siguri, po. E kanë thirrur, jo pse është i bukur ose i meçur, po nuk ka pasur kush t'ju bartë ujë për dasmorët.

Mëzi ynë i bukur i palëpi është soj gomari. Nënës së tij i ka kërcyer në shpinë gomari. Soji i këtillë nuk është për shalë, por ka lindur për samar.

Në fund: nuk e di mëzi im i bukur me copa pasqyre të arnuara në ballë se, unë gjithë jetën bëj luftë me këlyshë e qenë me zgjebe?! Malli më ka marrë për ujqër...

## GJAKU DHE FISI FLASIN SHUMË PËR PASARDHËSIT E FAMILJES

*(Letërpërgjigje, "Visar Xhambazit")*

Letërsia shqiptare:

**Student**

***Visar*** *09-09-2011, 06:17pm*

zoti Celiku, une vij nga nje familje e vjeter nga prishtina, dhe stergjyshi im ka pas emrin Emin Xhambazi,, ai ka qen pjestar i forcave otomane, me von u kthye kunder tyre, ti thua se Emin Xhambazi(Celiku) ka qen stergjyshi jyt, mundesh te japesh argumente per kete te lutem, pa ofendime vetem dua te sqaroj kete

ME RESPEKT Visar Xhambazi

"Visar" i dashur, nuk e them këtë unë, e ka vërtetuar edhe shkenca: Gjaku dhe fisi që trashëgohet brez pas brezi, flasin shumë për një familje. Nëse në atë familje ka pasur trima (kaçakë), në çdo njëqind vjet nga ajo rrënjë mund të shpërthejë një filizë, lindë një trim - kaçak. Nëse ka pasur hajdutë, përsëri do të lindë një hajdut. Nëse ka pasur spiunë, përsëri do të lindë spiun. Nëse tregtarë (xhambazë), përsëri do të lindë tregtar. Nëse, në atë familje ka pasur shurdhmemecë, përsëri pas disa viteve do të lindë një shurdhmemec. Ose, edhe pjestarë të asaj familje me të meta mendore - fizike.

Gjaku është ai kryesori që qarkullon në atë familje me vite e vite nëpër damarë. Shkenca thotë: gjeni.

Populli ynë shqiptar që moti i ka ditur këto ligje të Natyrës. Prandaj, edhe gjatë martesave të djemve e cucave të tyre, nënat shqiptare për nuset kanë pyetur deri në shtatë breza për fisin. Nuk kanë dashur ta përziejnë gjakun në familje.

Ja, argumenti më i fortë që stërgjyshi yt ka shum pak gjasa të ketë qenë kaçak, si stërgjyshi im Emin Çeliku (Xhambazi). Mbiemra Xhambazi ka me qindra anë e mbanë Atdheut. Stërgjyshi im nuk e ka pasur mbiemrin Xhambazi, pas këtij mbiemri ai vetëm është fshehur si kaçak nga përndjekja këmba – këmbës e pushtuesve osman. Shkaku se, gjithë jetën për së gjalli ia ka kthyer tytat e armëve turkut. Stërgjyshi im është fis Bajraktarësh bekteshian, dhe të parët e tij të shpërngulur me dhunë nga një fshat malor i Shqipërisë kanë ikur nga përndjekja osmane në një fshat tjetër të Shqipërisë, Cërvicë afër Kërçovës për t'ia humbur gjurmët turkut. Fshat, në të cilin jeton edhe sot fisi Çeliku (Bajraktari). Tre vëllezër kanë ikur nga përndjekja e pushtetit osman në atë kohë: njëri është ndalur në fshatin Cërvicë të Kërçovës, i dyti në Prilep (afër Manastirit, ku pasardhësit e tij jetojnë edhe sot) ende me mbiemrin Bajraktari dhe i treti në Turqi.

Përndjekja osmane ka qenë ajo, që fisin Bajraktari brez pas brezi nuk e ka lënë rehat në trojet e veta stërgjyshore, të ngulë rrënjë vetëm në një vend, por ka ikur, bredhur, fshehur maleve e luftuar me armë në dorë anembanë trojeve etnike të Shqipërisë.

Stërgjyshi yt Emin Xhambazi, që edhe ti e pranon se "ka qenë pjestar i forcave otomane", nuk ka dalë në mal vite me radhë të bëjë jetë kaçaku. Emin Çeliku (Xhambazi) kurrë nuk ka qenë pjestar i forcave osmane, por e ka luftuar turkun deri në vdekje: "… Dihet se në shtabin kryesor kryengritës ka qenë edhe Emin Xhambazi, por për të nuk ekzistojnë të dhëna më të hollësishme… Tani për tani dihet me siguri vetëm se në shtabin kryesor kryengritës kanë qenë Dervish Cara, Emin Xhambazi dhe Sylejman Toli, i cili në raportet konsullare angleze është shkruar gabimisht Soliman… Nga e gjithë kjo që u parashtrua shihet se ka pasur shtab kryesor kryengritës, por nuk e dimë numrin e saktë dhe listën emrave të anëtarëve të shtabit. Dihet vetëm se, më 18 maj 1844, në betejën e Katllanovës (afër Shkupit, sh. K.Ç.) u zu peng krejt shtabi kryesor kryengritës, me përjashtim të Emin Xhambazit që u vra në betejë". (*f. 109 – 110, Kryengritja e Dervish Carës – Dr. Aleksndar Matkovski, Shkup 1985*).

Argument tjetër, stërgjyshi yt nuk e ka ndërruar mbiemrin Xhambazi, që t'ia humbë gjurmët pushtetit osman. Arsye e fortë kjo e stërgjyshit tim, që turqit të mos i hakmerren familjes Çeliku. Dhe, stërgjyshi yt nuk e besoj të ketë luftuar krah për krahu me Drvish Carën maleve të Zajazit (Kërçovës), Dibrës, Gostivarit, Tetovës e Shkupit, në Kryengritjen e Drvish Carës (1843-1844).

Emrin e stërgjyshit e ka trashëguar im Atë: Emin Çeliku, i cili edhe ma ka rrëfyer gjithë këtë histori, shkakun e daljes të stërgjyshit në mal si

kaçak, i cili ka pasur edhe çetën e vetë të kaçakëve. Vite me radhë ka bërë jetë kaçaku duke mos iu bindur pushtuesve osman, u ka vënë pusi mes maleve me armë në dorë. I ka plaçkitur në çdo hap zaptiet turke duke ua shprëndarë plaçakat e luftës katundarëve të varfër. Më vonë gjatë përgaditjes së Kryengritjes shqiptare lidhet dhe bashkëpunon me Dervish Carën, dhe jo rastësisht është në shtabin kryesor të kryengritësve. Ende më rrinë para syve armët e Babait si trashëgim nga gjyshi i tij që i mbante në brez, krahut e hatullave në shtëpi. Emrin e një kaçaku të kësaj ane Kalosh Zajazi e trashëgoj edhe unë për shkak të admirimit të madh që kishte im Atë për kaçakët e maleve. Tjetër punë është ajo se, unë në vend të pushkës rroka penën. E përsëris edhe një herë: trimi lind trima, hajduti – hajdut, krimineli – kriminel, spiuni – spiun, servili – servil, tregtari (xhambazi) – tregtar, frikacaku frikacak, trusakati – trusakat…

Nga ana ime si shkrimtar, vetëm kaq kësaj radhe. Përmëtepër argumente mund t'ju japë historiani i kësaj ane (Kërçovë) prof. Dr. Ilmi Veliu. Familje Xhambazi ka edhe në fshatin tim të lindjes Cërvicë, por kurrë edhe sot e kësaj dite askushi nuk e trashëgon këtë emër kaçaku në atë familje. Dhe, argumenti i fundit: po të ishte stërgjyshi yt kaçak mali, deri më sot me siguri do ta kishin zbuluar gjithë ata historianë me Ali Hadrin në krye që i ka pasur dhe i ka Kosova.

Nuk do të kishin pritur kaq shumë gjatë kohë me këto "zbulime historike" të merret një student. Sëmundje e rrezikshme shqiptare kjo, që gati të gjithë "veteranët e luftërave çlirimtare" me çdo

kusht familajrët e tyre të gjallë e të vdekur duan t'i shpallin dëshmorë, heronjë lufte për Shqipëri Etnike…

P. S.

Mirë është t'i shfletosh këto libra: *Krynegritja e Dervish Carës* nga Dr. Aleksandar Matkovski (Shkup, 1985), *Poezia popullore e kaçakëve* nga Dr. Fazli Syla (Prishtinë, 1982), dhe *Zajazi nëpër shekuj*… - Dr. Ilmi Veliu (Kërçovë, 2011). Ku ta dish, ndodhë stërgjyshin tënd e gjen si emër e mbiemër mes atyre faqeve të këtyre librave. Mund të ndodhë edhe kjo: stërgjyshi yt si burrë i një familjeje të vjetër qytetare ka ardhë nga Prishtina dhe ka "dalë kaçak" maleve të Zajazit (Kërçovës), çerdhe historike e kaçakëve të kësaj ane, që brez pas brezi nuk e kanë duruar pushtetin osman. Ku ta dish?! Mundet, ndoshta edhe stërgjyshi yt ka "dalë kaçak" në mal ta luftojë me armë në dorë turkun duke ia kthyer tytën e pushkës si "pjestar i forcave otomane"...

## NATA E MADHE DHE DITA E NESËRME NËN RRAP NË SHKUP

Rrapi me dt. 23, 24 dhe 25 shtator për të 14 herë me radhë i tuboi zogjtë e tij shtegtarë. Edhe erdhën nga të katër anët: nga malet, fusha e qielli. Erdhi dallëndyshja e parë, bilbili këngëtar dhe lejleku mbi çati. Edhe si gjithmonë për çdo vjet ia thanë këngës. I kënduan verës me vapë që iku dhe vjeshtës me gjethe të verdha në Shkup. Degë më degë ndërtuan edhe çerdhe. E kaluan Natën e Madhe nën Rrap me poezi dhe këngë deri në agim. E përcollën Verën dhe e pritën Vjeshtën. Mëngjesin e gëdhirë degë më degë.

Natën strehoheshin nën Rrap e ditën fluturonin maleve. Edhe mbi Liqe fluturuan krah për krahu me gjithë këngë. Shkupin, edhe kësaj radhe e pushtuan në gjumë. Dritaret ende pa zbritur Dielli maleve ia hapën krah më krah. Edhe derën e madhe rrëzë Kalasë Dardane. Hënën e ulën në sofër këmbëkryq. Edhe i kënduan: "*Ulu mal të dalë Hëna*"!

Pano Taçi erdhi nga Tirana me poezi të egra. Gani Xhafolli nga Prishtina me 33 dashnore. Dhe, me një libër të ri me poezi: *Dashuria sillet rreth Lotit*. Dhimitër Pojanaku nga Poradeci me "*Plakat*". Vetëmse, jo me ato Plakat që i ngriu Marsi me gjithë dhenë. "Plakat" e Marsit, që i kërkoi Prillit "tri ditë hua, t'i shuaj Plakat me gjithë çka ka". Po, "*Plakat*" që Natën e Madhe e shndërruan në Nuse.

Krushqit e sollën e Doruntinën nga pas shtatë maleve larg dhe e zbritën nga koçia me këngë e

valle në mes të Lëmës. Ia hoqën duvakun, e ulën nën Rrap.

Erdhën, po kush nuk erdhi Natën e Madhe nën Rrap, qoftë Verë, qoftë Dimër. Erdhi Hëna. Erdhi Dielli me rreze. Erdhën: Bardhyl Maliqi nga Saranda. Dashnor Selimi me Spiro Xhavarën e Arqile Gjatën nga Athina. Na munguan gjatë këtyre Dy Netëve e Tri Ditëve poetike miqtë Iliaz Bobaj e Kosta Valetas nga Lesbosi. Nuk i ndali në rrugë kufiri politik as Marjana Shkurtin me Tomorrin nga Poradaci. Ilir Shyta erdhi me Poetin e Liqenit: "*Lasgush Poradeci biografi e arsyetuar*". Miku dhe Mikja e Rrapit i armatosi deri në dhëmbë me poezi. Armët i varën nëpër degë dhe lexuan poezi deri në agim.

Kujtime Kica erdhi me një kujtim dhe mallë nën sjetull. Burhanedin Xhemaili me Nazmi Beqirin nga "Jehona e Karadakut" me "*Doruntinën*. Delvina Kërluku përmes Grykës së Radikës me "*Altarin*". Radije Hoxha – Dija me "*Gjeniun*…" nga Prishtina. Elena Prenxhova me Sllagjana Atanasovën nga Shkupi. Remzi Salihu me Rami Kamberin nga Sharri Plak. Seida Beganoviq me "*Shtëpinë e kaltërt*", Fadil Curri me "*Adem Kastratin*". Rexhep Bajrami nga Haraqina me librin me poezi: "*Thashë: është Hënë*". Rrahim Ganiu me "*Homerin*". Bujar Plloshtani me Hënën e tij: Jetmire Velii…

Edhe kantautori Ferid Abdiu erdhi nga Kërçova. Bilbili, që këndon verë e dimër për çdo vjet degë më degë e lis më lis. E përcollën me poezi e këngë Verën dhe e pritën Vjeshtën. Dhe, i dalin me poezi e këngë para Dimrit.

Natën e Madhe u bë edhe Portreti letrar i Gani Xhafollit – Miku i Rrapit. Mbretit të Poezisë me 33 princesha, që nuk do të bëhet president shteti. Fjalë miradije për këtë poet rrebel folën miqtë e tij poetë: Kujtime Kica, Pandeli Koçi, Dashnor Selimi, Fadil Curri, Mustafa Spahiu, Rrahim Ganiu… Edhe, papritmas dolën te lirika e dashurisë, Sofra e Rrapit: *Lirika erotike që e mbajti gjallë një popull*… Hodhën hapat poetik mbi Urën e Gurit për të kaluar Vardarin. Liqeni i Ohërit, matanë maleve të Kërçovës i priste në breg: Sazan Golikun, Bardhyl Maliqin, Kujtime Kicën, Fadil Currin, Rrahim Ganiun… Pano Taçi me "*Dimrin* …" e tij mbi shpinë kishte hipur në varkën e Noes.

Notonte përmes dallgëve  për në Çukë, t'i shpëtoj poetët nga Përmbytja e madhe, ku edhe u bë përurimi i revistë letrare "*STILI 97*". Libri "*ALTAR*" i Delvina Kërlukut me poezi. Dhe, libri me reçensione i Ramzi Salihut: *Largimi nga izolimi*.

Pasmesnate, u ndanë edhe çmimet letrare. Juria profesionale: Kujtime Kica, Rami Kamberi dhe Kalosh Çeliku i ndanë edhe këto çmime letrare: për poezi më të bukur lexuar gjatë këtij Takimi nën Rrap - Dhimitër Pijanakut, për vepër erotike botuar gjatë dy takimeve - Gani Xhafollit dhe për vepër jetësore Pano Taçit. Dhe, dy çmimeve të tjera speciale me pretendim që në të ardhmen të bëhen tradiconale: Mikja e Rrapit, Mariana Shkurtit dhe Miku i Rrapit Pandeli Koçit.

Në fund, u shtruan edhe shtambat me verë nga organizatori (LSHSHM -së) për shpirtin poetik të

Mikes së Rrapit - Shane Muda, që para pak kohe papritmas fluturoi në qiell nga mesi ynë Takime nën Rrap. Poeten e Burgut politik, që gjatë Luftës së 2001-shit të UÇK-së në IRJ të Maqedonisë erdhi në Shkup me autobusin me targë TR plot me poetë, bashkë me Xhevahir Spahiun, Zyhdi Moravën, Iliriana Sulkuqin, Pano Taçin, Natasha Lako, Skënder Rusi, Mirela Sula, Sadik Bejko, Faruk Myrtaj, Milianov Kallupi, Entela Safeti, Qazim Shemaj, Jorgo Papingji e Visar Zhitin dhe lexuam poezi e kënduam këngë gjithë natën para tytave të tankeve…

## REGJISTRIM I POPULLATËS SA PËR SY E FAQE

Regjistrimi i realtë i një popullate që është prezent në shtet, kërkon edhe kushte politike e ekonomike. Patjetër, shteti demokratik popullatës së tij duhet t'i krijojë kushte për regjistrim. Nuk e kam të qartë se si një shtet do të bëjë regjistrimin e banorëve, kur ai shtet nuk i ka kryer obligimet e tia themelore ndaj atyre banorëve: t'ju jap nënshtetësi, posedimin e dokumenteve valide të identifikimit.

Në IRJ të Maqedonisë, edhe sot e kësaj dite askush nuk e di se sa banorë ka ky shtet i ri "demokratik". Regjistrimi i kësaj popullate në këtë shtet ende vazhdon të bëhet përkarshi botës demokratike sa për sy e faqe. Banorët e këtij shteti ende brez pas brezi vazhdojnë të lindin në këtë shtet, shkollohen, jetojnë, punojnë dhe vdesin pa nënshtetësi, asnjë dokument identifikimi. Lagje të tëra të Shkupit, katunde të tërë të rrethinës së Shkupit që deri në vitin 1981 deklaroheshin si turq e nuk dinin asnjë fjalë turke, edhe sot vazhdojnë të jenë lojal ndaj këtij shteti pa nënshtetësi e dokumnte identifikimi. Dhe, jo rastësisht ky regjistrim bëhet edhe me kaq probleme të trashëguara nga e kaluara dhe dorëheqje të komisionit shteteror dhe emërim të të njëjtit brenda një dite në prag të regjistrimit duke paralajmëruar falsifikim të regjistrimit të popullatës.

Faji?! Faji edhe sot është jetim.

Partitë politike shqiptare e kanë politizuar regjistrimin për marketing politik, merren me mërgimtarët, që nuk është problemi kryesor i popullatës shqiptare gjatë këtij regjistrimi. Shkaku se, ata mërgimtarë në këtë shtet kanë në emër të tyre pasuri, shtëpi dhe familje. Problemi kryesor me të cilin duhet të merren partitë politike shqiptare, është diskriminimi i banorëve që jetojnë në këtë shtet mbi pesëdhjetë vjet pa nënshtetësi. Edhe, ky është kushti i parë që partitë politke shqiptare duhet t'i vënë këtij shteti "demokratik" për të marrë pjesë në regjistrim. E, a e kanë bërë këta burra të pushtetit këtë kërkesë me gjithë këta parti politike shqiptare e dy universitete, intelektualë e akademikë?! Deri më sot, them: jo.

Atëherë, si do të kemi regjistrim të realtë në këtë shtet të përbashkët, si do të kemi bashkëjetesë, "vëllazërim-bashkim", ku një numër i madh i një popullate shqiptare ende është pa nënshtetësi. Ky është kushti i parë që partitë politike shqiptare është dashur t'i vënë palës maqedonase për pjesmarrje në regjistrim. Nuk mund të bëhet regjistrim real në një shtet ku një shumicë e popullatës shqiptare janë pa nënshtetësi. Tjetër është ajo se, këtë të "mirë" e kemi nga politika e gabuar sllave, që këtë popull me dhunë ka dashur ta përzë në Turqi (1945 - 1968) dhe në Shqipëri (1989 - 2001), që sot i kthehet si bumerang në politikën e laboratorisë famëkeqe qubrolloviqe sllave.

Fatkeqësisht, për atë politikë të gabuar serbe, ky popull ende jeton, shkollohet, punon dhe vdes

në këtë shtet edhe sot e kësaj dite pa nënshtetësi. Prandaj, siç thotë populli: macja më nuk mund të fshihet në thes. Realitet i hidhur ky, për një shtet të ri me pretendime për të shkuar në Evropë, që një Zot e di si do të shkojë me gjithë këto probleme politike e ekonomike. Fatkeqësisht, që edhe sot në këtë shekull të mos "di" numrin e saktë të banorëve, kjo nuk është arsye për një shtet demokratik. Vallë, thua i trembet numrit të shqiptarëve si popull shumicë në këtë shtet e pa pushtet?! Nuk e di. Koha është të gjejmë rrugë të reja në këtë shtet të përbashkët si të barabartë, e jo edhe sot të punojmë e verpojmë me njerëz të sotshëm e tru të moçëm. Ligje të natyrës janë këto: nëse do - të duan, nëse urren – të urrejnë, nëse vret – të vrasin.. E si do të kemi ne bashkëjetesë me "vëllezërit" nëse nuk ecim me lumin...

Megjithatë, edhe gjatë këtij regjistrimi shqiptarët duhet t'i përgadisin dokumnetet valide që i posedojnë se jetojnë denbabaden në këtë shtet të përbashkët. Edhe kësaj radhe, atyre që u është dhënë mundësia, të dëshmojnë me dokumente valide se janë banorë të këtij shteti. Patjetër, duhet t'i përgjigjen thirrjes së këtij shteti për regjistrim.

E nesërmja, të shohim! Ditë të reja vijnë për shqiptarët. Dhe, nuk është çudi që një ditë ky popull heroik, politikës së gabuar sllave t'i ngritet nga varri lugat…

## HONXHOBONXHO

Migjeni, poeti i mjerimit po të ishte gjallë çfarë poezie do të shkruante për Ditën e sotshme?! Me siguri një poezi të arrirë artistike edhe atë, më të fuqishme se në atë kohë. Grushti i tij kryengritës: "*mu në mes do t'i bientе malit që nuk bëzan. E ai të kënaqeshte duke qeshur si vigan i vram*ë".

E, Migjeni ynë i sotshëm?! Shqiptarët, a e kanë një Migjen në ditën e sotshme?! Po, e kanë edhe sot në "demokraci". Vetëmse, Migjenin e sotshëm e përkund në djep Nëna Parti me një ninullë: *flej biro se të banë mirë gjumi/ do të baj nana plak katundi*! E them këtë se, shqiptarëve edhe në ditën e sotshme u duhet Migjeni. E jo mjeranët, që pesëdhjetë vjet me radhë i janë ngatërruar arsimit dhe kulturës shqiptare nëpër këmbë. E kanë sakatuar pamëshirë nëpër institucionet e shtetit deri në vdekje.

Fatkeqësia: Mjeranët sot përpiqen me këmbëngulje të mbesin gjallë në mjetet e informacionit dhe janë si gomari teknefes, të rrezikshëm para cofjes në mes të udhës. Shkaku se, para se të japin shpirt, mund të qesin shqelma vdekjeprues.

Faji: Faji duhet kërkuar te partitë politike shqiptare. I kanë mbushur mjetet e informacionit shtetëror e privat me partizanë partiak gjysmanalfabetë. Rast specifik ky, për t'ua hapur derën rrufjanëve. Pjellave mushka të shokut Tito. Aftësitë e tyre të dikurshme t'i vënë në disponim edhe në ditën e sotshme "demokratike".

Turren të parët bythekrye në gjirin e partive politike. Shfrytëzojnë mosnjohurinë e Shqipërisë si shtet për këto "personalitete të tabanit kombëtar". Shkaku se, në Maqedoni dhe Kosovë njihen si Delja e zezë me zgjebe me këmbonë përqafe. Derën qysh moti në Kosovë ua kanë mbyllur rrufjanëve me vulë në ballë. Dumdumëve që në kohën komuniste shkruan poezi për "vëllazërim-bashkimin" dhe shokun Tito. E sot në "demokraci" dalin nëpër dritare dhe pëllasin në mjetet e informacionit për Sali Berishën, Hashim Thaçin e Ali Ahmetin.

Vite më parë lindi edhe kjo poezi:

**HONXHOBONXHO MBANË ZI**

*Honxhobonxho lëshoi mjekër*
*Për një mik të vjetër*
*Puthador qe pesëdhjetë vjet*
*Kuisling vjet, kuisling sivjet*
*Herë me popull, herë me pushtet.*
*Në Vetëshërbim po na shet:*
*Për një banesë, për një vend pune*
*Maskat i ndërroi pas çdo fortune.*

*Honxhobonxho seç mban zi*
*Për një ish mik në redaksi.*
*Kalemxhi me qindra profesione*
*I stërvitur nëpër sallone*
*I kripur shpesh me tagji*
*Që e vranë me tri elegji:*
*"Mafiozët" në Bit-Pazar*
*e i thanë - tradhëtar…*

Përçudi, pas kësaj elegjie më kujtohet edhe mendimi i një poeti shqiptar për fëmijë: Odhise Grillo, që sot nuk është në mesin e të gjallëve, kur e pyeta çka mendon për Honxhobonxhon si poet? Qeshi. Edhe m'u përgjigjë: është i shkathët në arnime letrare. E kthen gëzofin nga fryn era. Përndryshe, s'ka lidhje me poezinë e arrirë artistike. Populli thotë: Macet kur mungojnë në shtëpi, minjt hedhin valle.

Edhe, Honxhobonxho thotë në një intervistë: "Unë nuk jam përtac dhe dembel. Unë jam dembel në punët e rënda, por jo edhe në punën e lehtë me penë". Merreni me mend, Honxhobonxho trumbeton: "puna e lehtë është me penë". Jo, i përgjigjem unë në këtë shkrim! Puna më e vështirë është me penë, o Honxhobonxho! Edhe atë, më e vështirë se puna fizike me lopatë nëpër kanalet e hallkut.

Edhe Honxhobonxho turret me të katra ta bëj me dije Katundin se ka bërë një ve, e tjetër hiç. Gazetarët e rinj që dje Partia komunsite e sot Neokomunsite pa kritere shkencore i mori nga rruga në redaksi, turr se e kanë zbuluar "gjeniun" e letrave shqipe. Edhe harrojnë t'i përcjellin ngjarjet kulturore, daljen e një libri, reviste letrare në dritë. Kakarisin tra më tra me direktiva partiake si trusakatë me vargjet: "*Mixha Dulak i bie ziles / na jep bukë edhe dajak*..." Vërtetë, ai mixhë paska qenë i mençur, që Honxhobonxhos i ka dhënë dajak, t'ia mbyllë gojën që të mos flasë budallaki e kësi rrenash neokomunsite: "Libri im i parë u cenzurua se kishte një pikturë". Rrenë demagogjike, shtoj unë autori i këtij shkrimi.

Libri i Honxhobonxhos doli me titull bombastik fundekrye me vjersha patetike përkushtuar shokut Tito.

E rrufjanë të këtij soji, sot shqiptarët kanë me qerre. Edhe në Shqipëri. Edhe në Kosovë. Edhe në Maqedoni. Edhe nëpër botë. Turren me të katra si qentë pas çmimeve letrare. Punemadhe, që nuk kanë vlera të arrira artistike, me rëndësi është që të rrëmbejnë ndonjë çmim letrar, që të nesërmen të fryhen si bibani para kamerave televizive në mjetet e informacionit si "poetë kombëtar". Edhe shpallen qytetar nderi të ndonjë qyteti në Shqipëri, rrëmbjenë çmime letrare atje ku ende nuk i njohin mirë këto alamet "personalitete të tabanit kombëtar", trusakatë të kulturës e letërsisë shqiptare. Nuk ka rëndësi kush ua jep këto çmime letrare: eprori ushtarak, punëtori i krahut, spiuni, rrugaçi apo bariu i staneve… E rëndësishmja është, që këto "personalite" duhet t'i rrëmbjenë me "plot merita" ato çmime letrare. Shkurt, soji i tyre janë bërë si Pula e vjershës së Rexhep Hoxhës te libri i këndimit: kakarisin tra më tra nëpër kasolla, e ngrejnë më këmbë gjithë Katundin për një ve e tjetër hiç. E thirrin Dajrexhiun për të dhënë "vlerësime kritike-shkencore". Edhe ndonjë gazetare të re, që e ka humbur rrugën koridoreve të redaksisë radiotelevizive.

Bariu i staneve gjatë kohës komuniste Honxhobonxhos i vari përqafe edhe këmbonë me qëllim që t'i pri kopesë se deleve në kullosa maleve. Fatkeqësisht, Honxhobonxho në vend që t'ju pri në lëndina pranë Lumit, i printe kopesë së

deleve drejt pusisë së Ujkziut. Një ditë Bariu i staneve edhe u zemrua, ia hoqi këmbonën Honxhobonxhos. Vetëmse kot, Honxhobonxho nuk mund ta harrojë hujin e vjetër, deleve edhe pa këmbonë t'ju pri shkurreve tek Ujkziu mes maleve.

Dhe, them: edhe nuk ka faj Honxhobonxho. Ujkuziu edhe sot në "demokraci" do mjegull. Gjatë regjistrimit të fundit të popullatës në IRJ të Maqedonisë e fitoi me Bandën e tij neokomuniste një "çmim mbarëkombëtar": regjistruesi më i mirë me "bagazh patriotik" në këtë regjistrimin e fundit të populates në Demir Hisar. Edhe pse, këto deledhelpra nuk janë ujqër malesh, po dhelpra dinake që përpiqen edhe në kohën e sotshme demokratike me bisht t'i fshinë gjurmët…

## RRUGA QORRE

Im Atë i donte shumë kuajt me shalë. Në shtëpi kurrë nuk kemi mbajtur gomarë me samarë në shpinë. E mbaj mend qysh si fëmijë se, komshinjtë dhe gati i gjithë Katundi mbanin gomarë, vetëm shtëpia jonë nuk e kishte këtë kafshë shtëpiake. Nuk e di pse?! Edhe kurrë nuk më ka shkuar ndër mend ta pyes për së gjallit t'im Atë, pse familja jonë nuk e kishim këtë kafshë në shtëpi. Tashti, kur Halldupi përsëri na troket te porta, dhe na e rrëfen nëpër dritare këmbën e lyer me miell do ta pyesja, po ai më nuk është në mesin tonë, moti ka ikur mes varreve rrëzë Çukës. Një pyetje të këtillë do t'ia bëja edhe Nënës, po as ajo më nuk është në mesin e të gjallëve. Askush nuk më ka faj mua, që kaq vonë m'u kujtua ta pyes t'im Atë, pse kurrë në shtëpinë tonë nuk e mbajtëm gomarin me samarë, po kalin me shalë.

Edhe, një ditë prej ditësh në atë kohë im Atë bleu një maz në Pazarin e kafshëve. Dorën në zemër, si sot më kujtohet kur e solli në shtëpi. E futi në lëmë, e pak më vonë pasi ia prekëm ballin ne fëmijët, e lëshoi në livadh. Mazi me të katra me bishtin mbi shpinë vrapoi deri në fund të shelgjeve. Ne fëmijët pas tij hipur mbi "kuaj" - shkopinj shelgu me librat e këndimit në gji të xha Naimit me shokë. Vërtet, atë ditë u gëzuam të gjithë, na u hijeshua shtëpia, mori frymë livadhi.

Mazi një ditë u rritë dhe im Atë e pagëzoi me emrin Gjoku. Kali përditë rriteshte dhe lëshonte shtat si kalë me shalë në Katund.

Rrugës nga vraponte ai pluhuri pas tij çohej mjegull. E shalonte Gjokun pullali im Atë ditëve të pazarit rrugës përmes fushës, rrëzë Çukës për në Kërçovë.

Në atë kohë te ne në Katund, po edhe në fshatrat e tjerë të Kërçovës bëheshin shumë dasma. Përmëtepër, në ato dasma kishte edhe gara vrapimi me kuaj: me pehlivanë, me vrapime tradicionale, që moti fshatarët i kishin pagëzuar: "e torrmja".

Im Atë një ditë vendosi me Gjokun të dali edhe në gara të vrapimeve me kuaj. Gjatë gjithë vitit nuk ia ndali taxhinë, elbin që e mbillte vetëm për të te ara rrëzë Çukës. Shkaku se, sipas t'im Ati: elbi nuk i rriste bark Gjokut.

E bënte azgan, e hazdiste sa që kur e shalonte rrugës, thuaj gati se fluturonte në qiell si Gjoku i Gjergj Elez Alisë mbi mjegulla. Kalorësin e gjeti nga familja, ia besoi një kushëririt tonë, Nelit. Në këto gara merrte pjesë qysh heret edhe Kali i një kushëririt tonë, Xha Dullës. Nuk do mend, ky kalë edhe i kishte fituar disa gara vrapimi nëpër dasmat e Kërçovës. Im Atë, këta dy vëllezër kushërinj i kishte rritur, shkaku se herët si të vegjël kishin mbetur jetima. Edhe pse, këta dy kushërinjë herë pas here e spiunonin te paria për armëmbajtje pa leje. Dhe, jo vetëm këta dy vëllezër, po edhe dy vajzat e hallës i rriti im Atë, që i kishte nga e motra si jetime. Vajzat e hallës, pasi u rritën një ditë edhe u gjeti burra, i martoi me dasëm. Interesant, për to u kujdes edhe pse kishin burra deri në vdekje.

Nuk ka rëndësi e gjithë kjo në këtë shkrim. Rreziku nga "miqtë historik" na troket te porta.

Edhe pse nëpërmes të fesë islame pesqind vjet me radhë na kanë pushtuar, asimiluar dhe përzënë me dhunë në bashkëpunim me Serbinë në Turqi. Përsëri edhe në ditën e sotshme na sulen me të njëjtat metoda primitive historike: si çlirimtarë dhe "miq historik" të shqiptarëve. Fare pa pikë turpi kërkojnë ta ndryshojmë edhe historinë si popull: t'i shpallim si çlirimtarë e jo si pushtuesë shekullor brez pas brezi. Në asnjë vend të botës përparimtare nuk ndodhë kjo, populli pushtues edhe pas pavarësisë t'ia shkruaj historinë një populli tjetër për nga gjaku të nështruar në të kalurën shekuj me radhë nën këmbë.

E harron Halldupi, se Shqipëria falë këtij pushtuesi shekullor edhe sot e kësaj dite është e coptuar copë - copë nëpër botë. Fatkeqësia: shqiptarët i kanë dhënë Turqisë mjaftë personalitete historike qoftë në fushën e luftës, qoftë në atë të kulturës: Ataturku i bëri shtet, Sami Frashëri gjuhë letrare... Shqiptarët, fatkeqësisht ende punojnë dhe vazhdojnë t'i japin Turqisë personalite politike e kulturore, po Turqia kurrë nuk u ka dhënë asgjë shqiptarëve veç prangave dhe robërisë shekullore, dhe as që e ka ndërmend t'ju japë edhe në këtë shekull pëveçse asimilim kombëtar dhe robëri.

Qëllimi im është, dua të dalë te besa shqiptare. Trimëria dhe morali me të cilin krenohen dhe thirren edhe sot shqiptarët. Ne shqiptarët dimë të thirremi në besë, trimëri e moral… E në realitet kam frikë se shumica, falë Halldupit nuk kemi as besë, as trimëri e as moral. Shkaku, se: nëpër damarë ende na qarkullon gjak Halldupi. Moti këto vyrtyte i kemi zhveshur nga vetvetja, nuk i

kemi në ditën e sotshme. Koha vetë e dëshmon më së miri sot me këtë thirrje të shqiptarëve për ndihmë. Im Atë e provoi për së gjalli Baba Dovletin. Vite me radhë deshën ta përzënë si "turk alhamdulillah" me gjithë familje në Turqi. Stërgjyshi Emin Xhambazi (Çeliku) shkaku turkut doli kaçak meleve, iu bashkangjitë Çetës së Dervish Carës në kryengritje kundër turqve për liri.

Im Atë Gjokun në gara, siç thashë më lartë ia besoi kushëririt tonë, Nelit. E realiteti: Neli gjatë atyre vrapimeve Gjokut tonë pullali që vinte i pari për në Katund, ia ndërroi rrugën te udhëkryqi mu te varret pranë Tyrbes së Babashehut, e drejtoi rrugës që ndaheshte nga fshati Kolibare. Vetëm e vetëm, që Gjoku të mos dalë i pari në këto gara.

Tashti në fund të këtij shkrimi, merreni me mend sa besë, trimëri dhe moral kemi sot ne shqiptarët. Gjithë kohën thirremi në besë, trimëri e moral. E në realitet, nuk kemi as besë, as trimëri e as moral. Bythën në Shqipëri e kokën në Turqi.

Edhe sot, sa gjasojnë politikanët shqiptarë me garat e kuajve: Sali Berisha me Hashim Thaçin krah për krahu i shalojnë kuajt e tyre nëpër dasma shqiptare gjoja alla evropiane me shami në kokë e ferexhenë krahëve. Ali Ahmeti i ka hipur një gjoku të tij në shpinë me pasqyrë në ballë. Edhe Menduh Thaçi e shalon dorinë me mbrojtëse lëkure anash syve, të shoh vetëm përpara këmbëve me rruza të kuqe përqafe.

E rëndësishmja është, se: cilës rruge i kalërojnë kuajt e shalës këta politikanë shqiptarë… E dyta: kuajt e tyre të hazdisur me kalorësit në shpinë ende nuk kanë arritur në cak,

në Katund ta fitojnë "nishanin" e Dasmës Madhe. E treta: Dhashtë Zoti, këta kalorës të arratisur shqiptar me shpatën e Skënderbeut në dorë e me flamujt e gjelbërt me gjysmëhënë nëpër minare të xhamive aspak shqiptare nuk i drejtojnë kuajt e tyre me të katra rrugës qorre, edhe në ditën e sotshme të na përcjellin me dhunë e muzika përmes Çarshisë bythekrye në Turqi…

## BËRLLfOKU KUR I SULMON INSTITUCIONET SHQIPTARE

Mjerimi nuk ka kufi. Nuk e kam thënë unë, e ka thënë Migjeni. Vërtetë, "*kafshatë që nuk kapërdihet. Kafshatë që të mbetet në fyt, dhe të zë trishtimi*". Bërlloku shqiptar, që për arsimin dhe kulturën shqiptare nu e ka dhënë as edhe një kafe, sot sulmon institucionet shqiptare, që populli shqiptar i ka themeluar me djersë, pasuri e gjak. Edhe kush, Askushi që gjithë jetën është marrë me kriminalitet të organizuar: drogë, prostitucion dhe spiunim. Argat i shërbimeve sekrete të huaja antishqiptare brez pas brezi. Merreni me mend, edhe i bënë këto veprime përpërpara sigurimit shtetëror maqedonas, Partive politike shqiptare që gjoja përpiqen të vënë rend dhe ligj në këtë shtet "demokratik". Shkaku se, shqiptarët ende në ditën e sotshme nuk e kanë një Avni Rrustem, tradhtinë ta rrëzojë në tokë.

Institucionet e vetme që populli shqiptar me vite i ngriti me djersë, mjete të veta finiancare, ky bërllok shqiptar para syve të popullit shqiptar do t'i rrënojë brenda një nate. E vrasin në vendin e punës Drejtorin e Arsimit të komunës së Prishtinës, nxënësin e pafajshëm përpara Pallatit të Kulturës në mes të Tetovës, sulmojnë fizikisht përballë Universitetit Dekanin e Fakultetit Filologjik të USHT-së. Edhe atë kush, bërlloku shqiptar që deri dje ishte kundër Universitetit Shtetëror të Tetovës, sot do të blej me dhunë diploma universitare, vende pune e tituj shkencor.

I kërcnon profesorët me shprënguleje, shuarje të familjes dhe sulme fizike në rrugë. Vetëm e vetëm, që të kenë diploma të falura universitare, vende pune për gratë e fëmijët e tyre  në Universitet, tituj shkencor. Punemadhe, që janë gjysëmanalfabetë. Dumdumë, që gjithë kohën duan të bëjnë jetën e argatit parazit në kurriz të arsimit shqiptar.

Nuk e di në cilin vend të botës ekziston ky ligj, në cilin shtet demokratik nuk merret në mbrojtje kuadri universitar, po vjen në shprehje bërlloku dhe krimi përpara profesorve, sulmohet truri i një populli. Nuk e di në cilin shtet mbyllen sytë përpara bërllokut që lulzon me të madhe nëpër universitet tona shtetërore. Nuk e di, cili shtet nuk u del në mbrojtje profesorëve universitar, po i lë në mëshirën e rrugaçëve me dosje kriminele në liri që pretendojnë të bëhen edhe profesorë universitar, kur shtëpia e tyre e merituar është burgu i Idrizovës. Përmëkeq, kur përpiqemi të shkojmë në Evropë. E, si do të shkojmë në Evropë me gjithë këtë hale përpara Shtëpisë, kur themelet e një shoqërie, shteti janë: arsimi e kultura?! Kush është ky bërllok shqiptar, që sot shti haptas në arsimin shqiptar?! Ku ishte dje ky bërllok shqiptar, kur shtiheshin themelet e këtij Universiteti? Në cilën kafene shiste drogë dhe bënte prostitucion? Në cilin vetëshrëbim i spiunonte veteranët e arsimit? Kush e ndërsen edhe sot te Universiteti Shtetëror i Tetovës?! Dorë e zgjatur e kujt është ky mut shqiptar?!

Dihet, ata që e kanë ndërsyer dje, e ndërsejnë edhe sot dhe do ta ndrësejnë edhe nesër.

Ata që e ushqejnë ende në grazhd me dosje kriminele, e marrin në mbrojtje dhe sa herë që të ketë nevojë do ta ndrësejnë me gisht pas porte kundër arsimit, kulturës shqiptare.

Edhe sot, bërlloku shqiptar pa derdhur asnjë pikë djerse, e të mos themi gjaku, haptas para syve të botës e sulmon istutucionin e vetëm shqiptar që mezi e krijuam edhe para tytave të armëve. Tradita e vjetër shqiptare këtë bërllok, jo që nuk e ka mbajtur më në katund, po me gjithë familje e ka përzënë nga Atdheu. Vallë, si ta kthejmë edhe një herë traditën e vjetër shqiptare, bërllokun jo ta përzëmë nga katundi, po edhe nga koshat e plehrave në theqafje. Ligje të natyrës janë këto: nëse do, të duan, nëse urren - të urrejnë, nëse vret – të vrasin. Njëqind herë e kam thënë këtë nëpër shkrimet e mia publicistike: me kriminelin nuk mundesh të jesh i kulturuar. Hajdutit, t'ia hapësh derën. Spiunin - ta bësh besnik. Me vrasësin, të rrish duarkryq.

Dhe. kështu siç e ka nisur me kërcnime ky bërllok shqiptar, dhunë fizike e vrasje të trurit shqiptar për blerjen e diplomave universitare, vendeve të punës dhe titujve shkencor, si mendon Maqedonia të shkoj në Evropë?!

Shqiptarët, më nuk i pengon askushi për realizimin e qëllimeve të veta shekullore, përveç bërllokut të vet që me vite e ka para dere. Edhe, pa e hequr këtë bërllok shqiptar, kurrë nuk do të mund të ngrejë krye si popull, pastrojë edhe oborrin e kojshive.E di se, heqja e këtij bërlloku sot është e vështirë nga Partitë politike shqiptare dhe do punë dhe guxim.

Popullit shqiptar, kurrë nuk i ka munguar guximi e as puna. Dhe, nëse Shteti ligjor, Partitë politike shqiptare nuk janë në gjendje ta heqin këtë bërllok qafe, që vite me radhe u ngatërrohet nëpër këmbë shqiptarëve, përsëri vetë populli shqiptar do t'i përvesh duart, do të jetë i detyraur këtë bëllok që i ka mbi në lëmë vetë ta heq nga oborri i Shtëpisë. Përndryshe, nuk ka perspektivë si popull autokton në këtë shtet. Patjetër, duhet të gjej rrugë! Bërllokun shqiptar që e ujisin armiqtë e arsimit dhe kulturës shqiptare ta hedhë njëherë e përgjithmonë në koshin e plehrave. Nëse është nevoja, edhe me forcë ta ngarkojë me këmbët në hava në qerre drejtë varreve.

Popullit shqiptar më i ka ardhur në fyt, te hunda me këto plehëra të kafshëve shtëpiake. Nëse shteti ligjor, Partitë politike shqiptare nuk marrin masa parandaluese ndaj kërcnimeve dhe dhunës nëpër shkollat dhe universitet shqiptare, nesër me siguri do të jetë vonë për një shtet demokratik. Përsëri, do ta detyroni këtë popull heroik fatin e vet që ia nëpërkëmbëni me shekuj, vetë ta marrë në dorë.

Në fund: Dhe, kështu si ia keni nisur me kërcnime, dhunë dhe vrasje të trurit shqiptar, ajo ditë nuk është larg. Veten e paçit më qafë!...

## III KOHA ËSHTË SOT SHQIPËRIA TA HUDHË GUNËN KRAHËVE

### LËNGU I TURSHISË

Vërtet, sa të pasur dikur kemi qenë ne fëmijët e Katundit, në krahasim me fëmijët e sotshëm të Qytetit. Fëmia i sotshëm e ka shkollën para dere, televizorin, kompjuterin… Po, nuk e ka qengjin me një zile në qafë varë… Dashin me brirë rrotulluar dy-tri herë rreth veshëve, "*dap e dap që do mua të më qes në trap. Po, nuk më qet se më ka shok, prandaj lozim të dy tok*…" Delen, kaun, lopën, viçin, pulën, gjelin, kalin… Gomarin…

Edhe, shpesh e kam thënë nëpër shkrimet e mia publicistike: pse qengji nuk shkon pas dashit?!... Viçi pas kaut… Zogu pas gjelit?!... Ë?! Shkaku se, janë vepra të përkryera të Natyrës. Atëherë, ç'ndodhë me ne njerëzit?! Asgjë e jashtëzakonshme. I duartrokisim Kakamikut, që vite me radhë na shet shumë lirë te "vëllezërit". Përpiqemi t'i bëjmë konkurencë Natyrës. E di, edhe nuk e kemi aq lehtë t'i bëjmë konkurencë Natyrës, qoftë si njerëz të artit, qoftë si politikanë. Tashti për tashti, vetëm Natyra është e përkryer. Natyra dhe njeriu janë në gara maratonike në krijimin e veprave të arrira artistike.

Dorën në zemër, ne nuk kishim libra si këta fëmijët e sotshëm, por e kishim një fletore me disa fletë dhe laps në torbën e kanapit që na qepte nëna nga thesi i grisur për qafe. Edhe Abetaren e Shqipërisë me tridhjetegjashtë shkronja, kur Ministër i Arsimit ishte Ernest Koliqi.

Ministri i vetëm shqiptar, që në atë kohë Kosovën dhe Maqedoninë e mbushi me mësuesë vullnatarë shqiptar. Pemë këto të mbjellura me shumë vështirësi, mund e djersë që vite më vonë dhanë fruta. Librin e këndimit plot me vjersha e tregime të rilindasëve tanë kokë më kokë. Dita-ditës ecnim bashkë me lumin, natyrën. Me këtë nuk dua të them se, fëmijët e sotshëm nuk ecin me lumin, natyrën… Ecin, si nuk ecin edhe atë: krah për krahu. Vetëmse, fëmijët e sotshëm pijnë Coca Cola, nuk kanë pi si ne me ibrik lëng turshie. Eh, ta dini ju, sa i shijshëm ka qenë në atë kohë lëngu i turshisë! Autori i këtij shkrimi edhe sot e kësaj dite vazhdon plot me mall ta pi atë "lëngë turshie" për ilaç. Kurrë nuk shkon te mjeku. Librezën e shëndetësisë moti e ka hudhur pas librave, e ka fshehur pas tyre nëpër rafte.

Qëllimi i këtij shkrimi të vonuar me vite është në tjetër vend, të dalim te tema kryesore e këtij shkrimi. Ashtu si për çdo ditë edhe kësaj radhe ktheva t'i marrë "ilaçet" e mia të përditshme te "Miracoli". Kamarieri ma di hujin, posa e sheh se jam ulur në tavolinë, vjen i buzëqeshur me "ilaçin" në dorë dhe një mirëdita. Unë si çdo herë i thelluar në mendime me kokën mes duarve sikur më janë përmbytur të gjitha anijet në det, e lëshoj grepin të zë ndonjë shkrim intersant për ditën e sotshme, të mos shkoj në shtëpi duarthatë me duar në xhepa.

Dhe, ja vjen "peshku i artë", Kakamiku vetë i dyti drejtë e në grep. Padashtas, ulen në një tavolinë tjetër përballë meje në verandë.

Xhela i shkathët, që edhe ai rri gati më këmbë, fluturimthi vjen me tepsi në dorë para mysafirëve.

- Urdhëroni, zotëri?

- Një Coca Cola! E porositë pijen, sipas meje viktima e asaj dite.

- Ti, i drejtohet Xhela Kakamikut, që sipas veshjes dukej se ishte funksionar i Nënës Parti me post të lartë në ndonjë kabinet të Qeverisë. Edhe, kisha dëgjuar plot thashetheme rreth rrobave të këtyre aktivistëve partiak. Thonin, se: të gjithëve që nga kryetari e deri te shoferi ua qepte rrobat një rrobaqepës nga i njëjti stof dhe ngjyrë.

- Për mua, një "lëng turshie"! Iu përgjigjë Kakamiku.

Xhela iku pas pijeve përmes tavolinave. Unë e rrotullova rradaken e shkrimtarit rreth "lëngut të turshisë". Edhe, buzëqesha në vete matanë tavolinës.

Nuk vonoi shumë kohë, dhe Xhela erdhi me pijet e porositura në tepsi duke ua vënë mbi tavolinë. Ende pa ikur kamarieri, nevojtari i tha bashkëbiseduesit:

-Ty si duket të ka sjellë raki?! Nuk është ky lëng turshie. Kakamiku i zënë ngushtë si "mysliman", reagoi: - jo, nuk është lëng turshie.

Xhela i nervozuar, nuk mundi ta përmbajë dot më veten, ia priti plumb: - po, zotëri sipas fjalorit të juaj të "myslimanëve", ky është "lëng turshie". Unë jam kamerier me përvojë disavjeçare, edhe e di se kujt i thoni ju besimtarët e Allahut "lëng turshie".

Kakamiku i Nënës Parti i zënë ngushtë para përgjigjes të kamarierit, e uli kokën.

Dhe, vazhdoi me bisedën "zyrtare". Unë matanë tavolinës i buzëqesha tinës Xhelës. Xhela iu afrua tavolinës sime: - Dumdumët, mendojnë

se unë nuk e di gjuhën e tyre figurative plot "simbole" si kamarier. Gjithë natën rrinë nëpër kafene me bullgarka duke pi "lëng turshie" dhe bëjnë "politikë", e gjithë ditën bëjnë be në Kur'an, hiqen si myslimanë duke i falur të pesë vaktet para këmbëve të hoxhës në xhami.

Dhe, në fund shtoj unë autori i këtij shkrimi: Vërtetë, Nëna Parti bëri shumë punë patriotike për çështjen shqiptare. Shtatoren e Skënderbeut me gjithë kalë me shalë e solli në Shkup. Ama, patriotizmin më të madh e bëri, kur kakamikëve ua përzuri bullgarkat në Bullgari dhe nëpër Evropë. Edhe partizanëve të Nënës Parti, papritmas ua mbylli me dry shtëpitë publike në Veleshtë, që lakmi si katund ia kishte edhe Struga.

Një veprim të këtillë "patriotik" e bënë vite më parë, gjatë viteve '80-ta edhe serbët në Kosovë. Shqiptarëve ua ndalën çajin e rusit. Padashtas, i nxorrën të madh e të vogël në rrugë, në demonstrata. E rrotulluan bythekrye gjithë Prishtinën.

Vallë, a nuk janë këto vepra patriotike?! Tashti, edhe e shoh se: pse kakamikët dhe partizanët e sotshëm nuk e duan Nënën Parti. Edhe këta, priti nesër të dalin në rrugë në demonstrata me Kakamikun në krye, ta rrëzojnë nga pushteti Nënën Parti.

Nëna Parti pa vetëdije bëri "gabim" të madh politik.

Nuk duheshte t'i përzë bullgarkat nga Tetova. Përmëtepër, t'i mbyllë me dry shtëpitë publike në Veleshtë…

## SHEIKUT NË SHKUP I PËLQYEN QOFTET E "DESTANIT"

Pasanikun më të madh emirin e Katarit, Sheikun Hamad bin Kalifa Al Tani e priti "Destani" me qofte. Edhe merreni me mend, të gjitha mjetet e informacionit e ndiqnin me kamera televizive Sheikun se si hante "qofte" në Bit-Pazar. E ruante edhe policia si asnjë politikan tjetër deri më tani që ka ardhur në Shkup.

Populli edhe ai, i madh e i vogël kishte dalë në Bit-Pazar. Kurreshtja për ta parë Sheikun për nga së afërmi e kishte bërë të veten: kush është ky Sheik që do t'i provojë qoftet e "Destanit"?! Edhe atë: Sheiku, që në shtëpi nuk i mungonte asgjë dhe i ka provuar të gjitha kuzhinat e vendit dhe botërore. Po, ja që nuk i ka provuar qoftet e "Destanit". Specialitetin e "Destanit" me të cilët krenohet ky shtet i ri, që për nga popullariteti i kanë kaluar edhe kufinjt e IRJ të Maqedonisë. Më kot Qeveria e Gruevskit dhe Ali Ahmetit u përpoqën ta gjallërojnë Bit-Pazarin me "Tingujt e Çarshisë". Sheiku e gjallëroi gjatë një vizite, brenda një dite me qoftet e tymosur të "Destanit". Ustai, që fatkeqësisht nuk i ka më ato qoftet e dikurshëm të shijshëm me famë, por ja sot me erë tymi e provokoi edhe Sheikun e Katarit.

Dorën në zemër, partitë politike në Qeveri çka nuk bënë për ta provokuar Sheikun: edhe me arsim, edhe me kulturë, edhe me politikë. E sollën përreth përmendoreve të luanëve. E futën edhe në Muzeun e komitave.

Kapak i vunë në xhaminë e Mustafa Pashës. Fatkeqësisht, Sheikut nuk i intersuan misionarët e Beogradit shën Klimenti dhe Naum Ohëri, as Aleksandri i Madh me Goce Dellçevin e Nikolla Karevin me kuaj shale. E të mos flasim për Karposhin, që e shalonte kalin pa shalë nën Urën e Gurit. Skënderbeun nuk e pa fare mbi kalë me shpatën në brez. Shkaku se, shqiptarët e kishin fshehur pas "qebaptores të Destanit", mes makinave në parking.

Tashti e shoh, pse Sheiku gjatë natës që e kaloi me mobiljet e veta në "Aleksandër Pallas", e porositi darkën pa alkool. Qeveritarët tanë e patën më vështirë, për herë të parë hanin mish viçi e qëngji pa verën e Tikveshit. Edhe, i dënoi Zoti: shpërtheu zjarri në çati të hotelit. Vërtetë, e porositën darkën pa alkool, po në këtë hotel alkooli konsumohet me të madhe. Harami me vite e vite ecën tavolinë më tavolinë. Edhe nëpër dhoma. Vërejten ia tërhoqi Allahu Sheikut me zjarr në çati. Prandaj, ndoshta edhe më në fund Sheiku vendosi t'i provojë qoftet e "Destanit". Qebaptoren, ku nuk konsumohet alkooli, ende nuk ka hyrë harami, po vetëm birrat e Shkupit.

Përderisa, Sheiku hante qofte dhe e ruante policia, autori i këtij shkrimi i dëgjonte ankesat e qytetarëve, që nuk mund të largoheshin me makinat e tyre para se të ikë Sheiku. Burri i botës arabe, hante qofte te "Destani", në mbikqyrje të rreptë të policisë maqedonase dhe sigurimit mbretëror, para syve të popullit që rrinte duarkryq mbi tavolinat e zbrazura të lokaleve. Durimi u kishte ardhur në fyt, mezi e prisnin largimin e tij

nga Bit-Pazari. Turrevrap t'i rrëmbenin makinat e tyre nga parkingu dhe të iknin në shtëpi. E si për inatë, herë pas here mbi kokë u fluturonin helikopterët.

Edhe: vizita e Sheikut në IRJ të Maqedonisë ma kujtoi kohën komuniste. Veprimet e Partisë Komuniste se, arsimin e shqiptarëve e kishte sipas standardeve botërore. Përherë, kur arrinin delegacione nga bota e jashtme, ajo i dërgonte në shkollën fillore "Liria" në Shkup. Me këtë donte t'i thotë botës: e shihni se në ç'nivel e kanë shqiptarët arsimin. E në realitet, shkollat e tjera shqipe ishin nën nivelin e kohës të pas Luftës së Dytë botërore.

Arsye e fortë kjo, që Sheikun kësaj radhe e dërguan te "Destani". Lokal me tavolina e karrige në rrugë, ku Sheiku i provoi qoftet e "Destanit", pa asnjë shenjë gjelbërimi ose rrjedhë uji në shatërvan. Thuaj, pa asgjë natyrore. Vetëm e vetëm, që Sheikut t'i vij keq për këtë Shtet kaq të varfër, shti dorën në xhep, japë ndonjë dollarë për lëmoshë.

Dhe, në fund them: Sheiku, IRJ të Maqedonisë nuk e pëlqeu për nga arsimi, kultura, përmendoret grandioze në të dy anët e Vardarit… E, as për nga politika madhore…

Sheiku, IRJ të Maqedonisë ia pëlqeu: Qoftet e "Destanit"…

## MËZATI I TREDHUR KUQEZI

Moti kam dashur të shkruaj një shkrim për Mëzatin (Demin) e tredhur kuqezi me titull shkencor të Nënës Parti. Ose, siç e kam pagëzuar unë në një shkrim më të hershëm: Kakamikun. Hë sot, hë nesër e asesi të ulem në tavolinën e punës. Koha dinamike e "frymëzimeve artistike" siç duket e kishte fajin. Dorë më dorë më hidhte provokimeve "artistike" të partivpolitike. Kurrë nuk më kishte shkuar mendja se Mëzati (Demi) i tredhur kuqezi ishte mësuar gjithë jetën t'i qesin kashtë në grazhd. Nuk e donte barin e njomë të livadheve. Shkaku se, sipas tij ishin me "mesazhe të kamofluara": ishin të kripura me luledele. Zot, mos më keq, ia ngatërronin trutë dhe zorrët në bark.

Mëzati (Demi) i tredhur kuqezi, vërtetë kishte mësuar pak shkrim lexim në Lëmën e partive politike, po nuk e lexonte dot mes luledeleve barin.

I dukeshte i "kamofluar në mesazhe" plot simbole letrare: metafora, ironi, alegori, sarkazëm… Fatkeqësisht, vështirë i kuptonte mezazhet e shkrimeve të autorit. Gojën plot, thoshte: "Këtë e deklaron autori që në fillim, na e thotë të gjithëve se në Maqedoni çështjen kombëtare e ka zënë PDSH-ja, ajo do na e bëj Shqipërinë etnike në Maqedoni, prandaj ju të tjerët gjeni vënd tjetër ku ta bëni. Sipas këtij varianti do na dalin një garumbull me Shqypni Etnike, nga një për çdo katund – ky është varianti i rekomanduar nga autori. Po ta shohish hollë

hollë punën, në fakt mesazhi është diku tjetër, lihet me e kuptu në nëntekst. Ideja është se nuk na duhet fare ajo Shqipëria Etnike në Maqedoni, e di vetë PDSH-ja si do i gadisi punët atje. Ky me sa duket mesazhi i padukshëm, ose i kamufluar. Ndoshta, bën vaki e kam se kuptuar drejt, apo jo".

Përshesh mendimesh, fjalësh me një "gjuhë letrare standarde" gjysmagjeli të katundit, as gegërishte, as toskërishte. Gjysmanalfabet me titull shkencor. Kakamiku, që nuk e di ku e ka kokën e ku bythën. Shkurt, i pëlqen kashta në grazhd. Edhe gjithë jetën e fërkon barkun me dorë. Ushqim i mirë, thotë për kafshët e buta shtëpiake. Përmëtepër, nuk don ta lodhë trurin, as bythën të dalë pak edhe livadheve. Pse jo, edhe kullosave mes maleve para syve të Ujkziut te Lumi. Ballë për ballë ta kullosë tërfojën me luledele. Thotë, vetmevete: për mua është e mirë kashta. Edhe atë, kur ma hudh me kosh Zotëriu i Nënës Parti në grazhd.

Fajin e ka ai, që më dërgoi në Universitet privat ose në ndonjë seminar jashtë kufijve të Atdheut. Stolisi me titull shkencor. Dalldisi si ka zgjedhe vetëm për qerre. Përmëtepër, harroi se: shqiptarëtë sot doktora shkence kanë me qerre, po nuk kanë barinj të deleve. Edhe atë: të nivelit shkencor të Farizit, çobanit të staneve të Sharrit. Bariut me gunën e ogiçit krahëve, që vetë i kap delet për këmbe me kërrabë, vetë i mjel dhe vetë i nëqeth nën hije të dardhave gorrice.

Kakamiku, thotë: Nuk e dua barin e njomë, "rrezikun" plot me luledele në Livadh. Truri dhe barku im është mësuar gjithë jetën të hajë kashtë në grazhd. E si të dalë unë tashti livadheve kështu

i tredhur me herdhet nëpër këmbë, i përgaditur me vite për zgjedhë. Përkundër, lexuesit tim besnik, që nuk ka universitet e as titull shkencor për "flijime patriotike". I cili padashtas, më thotë: më pëlqeu shkrimi yt "Faqezinjtë erdhën edhe në Shkup". Urime!

Përçudi, Mëzati (Demi) i tredhur kuqezi me titullin shkencor në ballë që ia dhuroi Nëna Parti për "flijime artistike", nuk i kupton shkrimet e mia me "mesazhe të kamofluara". O, Imzot! Cilit t'i besoj: lexuesit tim besnik pa diplomë universitare partiake, apo Mëzatit (Demit) të tredhur kuqezi me titull shkencor partiak të blerë në ndonjë universitet privat?! Dihet, patjetër lexuesit tim besnik, që nuk ha kashtë në grazhd.

E përsëris edhe një herë: më tepër i besoj Farizit, bariut të staneve të Sharrit, që është mbi nivelin e juaj "shkencor", sojit të viçave të palëpi, të cilët na i polli Nëna Parti dhe na i flugu pasmesnate si kopila pas dere.

Edhe, Mëzatit (Demit) të tredhur kuqezi me titull shkencor, pasi publiksht më kërkoi t'i jap kashtë, edhe unë si autor i këtij shkrimi, do t'i jap një krah kashtë në grazhd. Nuk do ta lodh më veten t'ia heq kërpeshin e lidhur nyje, hap derën e burgut krah më krah të dalë të kullosë livadheve. Vështirë e kam ta dërgoj te Kasapi. Përmëkeq, tashti kur i kërcen në shpinë lopa në livadh…

Ë?!... Përsëri Mëzati (Demi) i tredhur nuk do të më kuptojë çka shkruaj unë mes këtyre rreshtave, me siguri edhe kësaj radhe do të thotë: ia pëziej trutë, zorrët në bark. Nuk i kam faj. Fajin e ka vet si kafshë e butë shtëpiake me gjithë atë alamet titull shkencor në ballë me të cilin e

shpërbleu Nëna Parti, kur nuk di të më lexojë mua mes rreshtave, edhe kur i jap të hajë kashtë.

Edhe, për fund: besoj se, këtij Mëzati (Demi) të tredhur kuqezi i dola borxhit: kashtë më kërkoi, kashtë i dhash të hajë në grazhd…

## DASHURI ME TULLUMBAT

Ministri Nuses me pashterkë të kuqe, personazhi kryesor i këtij shkrimi është me prejardhje nga vendi i Tullumbave. Vendlindja heroike, që dikur në kohën e "artë" komunsite e pushtoi me tullumba gjithë Jugosllavinë e shokut Tito. E sot, gjatë ndryshimeve demokratike me "politikë madhore" e pushtoi IRJ të Maqedonisë. Politikani, që guximshëm iu përgigjë edhe kryeatarit më azgan të Partisë Neokomuniste që e emëroi ministër në Qeveri. Lajmin e parë atë ditë ia përcolli nëna: Biro, ec se te kërkon me telefon Kryetari i partisë, të kanë bërë minstër! Nënë, i thuaj kryetarit le të pres pak se më ka ikur lopa nëpër livadhe!

Herë pas here, kur fotografoheshte para kamerave televizive ky bukurosh pushteti i telefonte gruas në shtëpi: Nuse, hape sonte televizorin, ta shohësh çfarë p… s'ame djalë ka bërë nëna shqiptare! Edhe nënën mos e harro, ngutu ma thirrë ta shoh emisionin televiziv! O njeri, a je në mend çka folë, nëna e falë namazin, i përgjigjet gruaja. Nënën e dua në telefon oj shashkëne*, ma jep nënën vrik ta shoh se çfarë djali azgan ka lind burrnesha në mes të dimrit me borë.

Kryevepër politike, ë? Patjetër. Ehu, sot sa kisha dashur këta burra pushteti, prapë ta pushtojnë me tullumba paqësore, jo vetëm IRJ të Maqedonisë, po edhe botën përparimtare të politikës e teknikës moderne. Pse jo, edhe Republikën e Serbisë si dikur pëllëmbë për

pëllëmbë, nga Trigllavi në Gjevgjeli. Dihet, me tullumba e jo me "politikë madhore" nëpër kabinete qeveritare. Vetëmse, ende nuk ndodhë një mrekulli e tillë e shekullit. Burrat e këtij soji, sot u janë sulur me dorë e këmbë universiteteve shtetëror e privat për diploma, tituj shkencor e vende pune.

Fatkeqësisht, asgjë nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë, edhe sot shqiptarët me "specialitetin e tullumbave" duan ta pushtojnë politikën botërore. Dita – ditës me "politikë madhore" nëpër çajtore e rrezikojnë edhe Amerikën me gjithë Rusi. Jo, u them unë mes këtyre rreshtave: nuk pushtohet aq lehtë me politikë bota, po me arsim dhe kulturë. Talenti për politikë, është dhunti e Natyrës. Përpara talentit gjenial, përkulet edhe vetë Zoti. Përsëri nuk pajtohen burrat e grave, kur ju them se: denbabaden i ka lindur nëna për mjeshtër të bozës dhe tullumbave me diplomë jugosllave?!

Jo, më përgjigjen aty – këtu me ndonjë shkrim teknefes si burra mejdani me diploma universitare të Beogradit. Thonë: Ne, kohën e fundit kemi vendosur të merremi edhe me "politikë madhore" të Shtetit maqedonas. Krah më krah do t'ia hapim derën për në Evropë. Edhe problemin e emrit do t'ia zgjidhim që e ka me Greqinë. Nëse është nevoja, edhe punën e identitetit. I kemi dhënë mjaftë personalitete këtij shteti nga të katër anët e kufijve politik më këmbë e me kuaj shale. Po, të jetë nevoja do t'i japim ende heronj lufte, kur nuk i jep historia. Popull me histori jemi ne shqiptarët.

Botës i kemi dhënë personalitete, e nuk do t'ju japim " vëllezërve " me të cilët ndërtojmë një Atdhe të përbashkët, kohën e fundit me rrënjë

antike. Pasaniku është ai që të jep, lëmën ta mbush plot me gra, burra e fëmijë të shëndoshë trima. Fukarai mund të të japë vetëm leckat e trupit, lind fëmijë trusakatë e frikacakë. Tullumbave në kohën e sotshme thonë, u ka dalë më boja, nuk janë në modë. Nuk mund të bëjmë biznes në botë me tullumba. Koha është të bëjmë biznes me politikë.

Mirë, u them unë: po ma rrëfeni atë rrugën e biznesit pas Çuke të "politikës madhore"! Edhe pse, gati thuaj këtë "politikë madhore" e dinë të gjithë shqiptarët se: Burrat e mejdanit e kanë zgjedhur rrugën e arsimit dhe kulturës shqiptare. Merreni me mend, burrat e botës pa turp fare bëjnë biznes me arsimin dhe kulturën shqiptare nëpër kabinete. Përditë, me shumicë e pakicë shesin e blejnë diploma e tituj shkencor.

"Vëllezërit", si gjithmonë që nga koha e "artë" komunsite janë të përgaditur në këto punë shkencore. Shkaku, se: e kanë studiuar mirë mentalitetin shqiptar nëpër akademitë e njohura sllave, pasi ua dorëzojnë postin e ministrit argatëve politik, dhuratë u japin edhe nga një sekretareshë. E dinë se, shqiptarët ku e kanë dobsinë më të madhe, gratë. Partia në pushtet bashkë me postin ua jep shpërblim edhe një grua, dhe gjithë jetën politike i ka në dorë këta "burra trima" të nënave shqiptare. Një veprim të këtillë, vite më parë e bënte edhe Partia Komuniste, kur ta jepte postin, bashkë me postin ta jepte dhuratë edhe një grua. Nuk kishte rëndësi, që ti e kishe një grua me fëmijë në shtëpi të cilën ta kishte zgjedhur nëna nëpër dasmat shqiptare, këtë grua ta jepte shpërblim Partia Komunsite.

Koha e sotshme "demokratike" me shpërblime politike, nuk është larg kohës së djeshme komuniste. Edhe minsitrit tonë unikat me lopë për dore, "vëllezërit" i dhanë një grua partiake. Ose, siç i thonë me gjuhën e politikës: sekretareshë. Fatkeqësia, minisitri edhe u dashurua këmbekrye në skretareshën e bukur. Gjithmonë, kur e shihte përballë matanë tavolinës punës, i dukej si tullumbë. Gjithë orarin e punës e hante me sy atë tullumbë politike me mini fustan që i rrinte para syve këmbën përmbi këmbë.

Përmëkeq, ajo tullumbë azgane e ndiqte si hije gjithkund: në punë, rrugë e shtëpi. Kurrsesi, nuk mund ta hiqte nga koka. Natë për natë e shihte edhe ëndërr. Merreni me mend, ajo tullumbë i dilte para syve edhe në sheshin e qytetit, para këmbëve të kalit të Aleksandrit të Madh se si lahej lakuriq nën ujvaret e shatërvanit. Shpeshëherë ia bënte edhe me sy. I buzëqeshte tinëz me këmbën përmbi këmbë nën tavolinë. Shkak ky, që ministrin më të shumtën e kohës e shihje në ëmbëltore se sa në ministri. Përditë e nxirrte me pirun në dorë gjithë inatin e mbëledhur lëmsh mbi tullumba. Frikë të shtinte edhe se, kështu siç e kishte nisur ky burrë pushteti "katërliqesh", nuk do të lente një ditë tullumbë të gjallë më këmbë në Qendrën tregtare.

Edhe, një të nesërme e shoh ministrin para derës së ëmbëltores në Qendrën tregtare me barkun e fryer si tinar lakërash turshi me këmbët përpjetë në hava.

Dhimbshëm u ndala para kësaj tragjedie, mes këtij shkrimi dhe them: dashuria me tullumbat politike, vërtetë qenka e rrezikshme. Ndodhë, një

ditë ta hanë edhe kokën. Edhe mua si fëmijë më kujtohet si sot: kur babai më merrte me vete te mulliri elektrik i qytetit ta bluajmë grurin e fshirë gjatë një vere. Herët në mëngjes, para hoxhës që e thirrte sabahun nga minarja e xhamisë, zgjoheshim që ta kapnim të parët radhën e pritjes me fshatarët. E gjithë kjo rrugë përfundonte me dy-tri tullumba te xha Murati, në Kërçovë.

Përçudi, edhe sot sa të freskët e kam ende memorien: e kisha shitur veten në atë kohë për dy - tri tullumba si politikanët e sotshëm në Qeveri. Edhe, i them vetes: çfarë shkolle politike paskan qenë ato tullumba artistike?! Shkollë jete, që unë edhe sot e kësaj dite nuk pata fatin ta ndjek krah për krahu me shokë në asnjë universitet të botës. Shkak kryesor ky, që unë sot nuk i dua tullumbat politike…

1) *Grua me teke e xhinde*.

## KOHA ËSHTË SOT SHQIPËRIA TA HUDHË GUNËN KRAHËVE

Fisi ynë i kaçakëve brez pas brezi ka qenë në luftë me pushtuesit dhe bërllokun shqiptar ("salep-intelektualët"): Edhe në kohën e Turqisë, edhe në kohën e Serbisë, edhe në kohën e Gjermanisë, edhe në kohën e Jugosllavisë komuniste. Edhe, në kohën e sotshme "demokratike" duke pritur trenin e fundit në stacion për në Evropë.

Fis kaçakësh ky, me vendlindje rrëzë Baba Tomorit, po pa Shtëpi të përhershme në Atdhe, i ndjekur nga pushtuesit barbar me prita, dëbime, helmime, spiunime, zjarre, vdekje klinike, aksidente komunikacioni e plot provokime politike që e ndjekin edhe sot e kësaj dite nëpër botë. Shkaku, se: ende nuk e ka shitur Atdheun. Fis kaçakësh, që ka qenë i detyruar të vrasë ose të ikë për ta shpëtuar veten në atë "bashibuzuk", të mbesi gjallë në rrugën e shenjtë për në Baba Tomor. Ligje të Natyrës janë këto edhe sot: nëse do, të duan. Nëse urren, të urrejnë. Nëse vret, të vrasin si qen në rrugë.

Bërlloku politik shqiptar, që moti e ka shitur Atdheun dhe në emër të popullit shqiptar, krijon pasuri dhe karrierë politike, sot ia ka futur gjumë nën hije të dardhave turke, për inatë të shqiptarëve në bashkëpunim me "salep-intelektualët" e Tun Batunit, që më sulmojnë si shkrimtar me shkrime teknefese dhe libra sakatë.

Thonë: Kopertinat e librave të mi me mike lakuriqe, Manifestime nën Rrap, ku shtrohen

gotat e rakisë së rrushit dhe shtambat me verë, e nuk shtrohet salepi, boza e limunada e Beogradit ua prishin moralin "patriotik" të Tun Batunit. "Salep-intelektualë", që flasin shkruajnë, qajnë dhe vajtojnë për vlera të arrira letrare e në realitet vetë i krijojnë dhe sakatojnë pamëshirë me në krye Doktorziun. Përmëkeq, duke i dhënë njëri-tjetrit çmime letrare e tituj shkencor te Pazari i grave. Që, e them edhe njëherë publikisht: gjithë titujt e tyre shkencor që ua shiti Doktorziu me shokë në universitetet shtetëror dhe privat i meriton Farizi, Bariu i staneve. Shkaku se, është mbi nivelin e tyre shkencor si kuadër arsimor universiteti. "Salep-intelektualët" e Tun Batunit, që turren pas diplomave universitare, titujve shkencor dhe vendeve të punës sikur të ishin tullumba. E, në realitet këto nuk janë tullumba politike Beogradi, po pite me hithra shqiptare.

Vërtet, i dua marrëzisht, sa të lezetshëm janë "salep-inteletualët" e Tun Batunit, ma kënaqën penën! Herë pas here shkruajnë edhe ndonjë libër kuqezi. Përditë, i këndojnë këngë me çifteli Lirësë. E Liria si kurvë azgëne e shtëpive publike, një Zot e di me cilin çon dashuri nëpër hotelet luksoze të botës.

Fatkeqësi kombëtare, edhe sot si dje. Shqiptarët më shumë kanë problem me vteveten, se sa me armikun shekullor. Përçudi, presin durkryq nëpër çajtore t'i çlirojnë nga halldupët armiqtë e dikurshëm shekullor.

Nuk do t'i përmend me emër e mbiemër këta armiq të përbetuar të popullit shqiptar. I di vetë populli. Shkaku se, gjithë jetën i ka pasur dhe i ka mbi shpinë dumdumët. Mallkim i tij është, që

edhe sot e kësaj dite ende nuk e ka hedhur nga shpina samarin. E hodhi sharrën e Beogradit me të cilën hyri në poezinë e Esad Mekulit: "O, vëlla, me sharrë në krah", po jo edhe samarin. Zgjedhën, që nëpër vite qafën ia ka bërë varrë, plot me plagë.

E dini pse?! Jo, edhe këtë nuk e dini si lexuesë. Prandaj, edhe vazhdoni ta mbani mbi shpinë samarin me gjithë barrë. Ditën kur do ta dini, pse e mbani këtë samar mbi shpinë, ç'atë ditë do ta hudhni barrën në mes të rrugës. Dhe, do t'i pranoni në gjirin tuaj vëllezërit maqedonas, fisin ilir antik të asimiluar nëpër shekuj. Nuk do të hidhëroheni kur të tjerët do t'ua sjellin më këmbë e kuaj shale në Shkup (Atdhe): Aleksandrin e Madh, Filipin e Maqedonisë, Josif Bagerin, Pjetër Bogdaninin, Pitu Gulin… Jo. Por, do t'u dilni para te Ura e Gurit t'i prisni me lule dhe duartrokitje frenetike.

Populli shqiptar nëpër shekuj sa ka pasur probleme me armiqtë shekullor, aq më shumë ka pasur problem edhe me vetveten si popull. Historikisht, më shumë ka punuar për të huajt, i ka bërë shtete, por shumë pak për Atdheun. I hidhni një sy historisë: kush e mbajti pesqind vjet gjallë Turqinë në Ballkan?! Shqiptarët. Serbinë si shtet?! Shqiptarët. Gjermaninë në këto troje si "çlirues" kombëtar?! Shqiptarët.

Jugosllavinë e shokut Tito, edhe këta të fundit si "vëllezër çlirimtar" me të cilët luftuan krah për krahu pët të na shti nën zgjedhë?! Shqiptarët. E ata, "vëllezërit" të Njerkës për çlirimin e vendit nga fashizmi, nuk e shkrepën asnjë pushkë. Shqiptarët qenë ata që u trokisinin te porta, të

dalin partizanë maleve për liri. Dhe, në fund e dini çka?! Shqiptarët qenë ata që pas lufte mbetën me gishta në gojë. Krerët e luftës: Mahmut Dumanin, Nexhat Agollin, Imer Lumën, Rexhë Ryshit Zajazin… i vranë pas lufte nëpër prita, ua rrëmbyen pushtetin. Gjallë mezi mbeti vetëm Rexhep Zajazi, edhe atë pasi e korrën në një pusi në Sateskë të Kërçovës, ia zbrazën në trup gjithë plumbat e automatikut.

Shqiptarët nëpër vite shumë popujve u dhanë edhe personalitete historike. Ataturku Turqinë e bëri shtet demokratik. Sami Frashëri turqve u krijoi gjuhë letrare. Arnautët Sirisë, i ngritën universitet. Egjiptit, poashtu i dhanë me dhjetra personalitete historike. E ata popuj çka u dhanë shqiptarëv`e?! Edhe ata u dhanë, si nuk u dhanë shqiptarëve: Robërinë. Asimilimin. Dhunën duke e përzënë në Turqi. Samarin në shpinë. Sharrën në krah si argatë derë më derë rrugëve të Beogradit.

Vallë, ende shqiptarët do të mbajnë gjallë shtete të huaja dhe krijojnë shtete të reja në Ballkan, në dëm të shtetit të vet shqiptar: Shqipërisë Etnike?! Edhe sot si dje, do të ushqejnë "vëllazërim–bashkimin".

Bashkëjetesën në trojet e tyre etnike në rolin e argatit. Ende do të vazhdojnë me "vëllezërit" t'i ndajnë lugët dhe enët?! Shtëpinë dhe arat duke ua lënë "vëllezërve" si banorë lojal të këtij shteti të shokut Tito. Arsye kjo, se kështu na do Evropa Plakë. Konferenca e Londrës (1913) në rolin e Kasapit, që dikur në tavolinë na i futi gërshërët, na qepi struke pa mëngë.

Jo! E them këtë me plot bindje për një të nesërme. Shqiptarët, mjaftë më kanë punuar për të tjerët si argatë fushe në Qeveri. Nuk e them këtë unë si shqiptar. E kanë thënë edhe më herët rilindasit, po ne si pasardhës nuk ua kemi vënë veshin porosive të atyre profetëve. Gjithë jetën mbetëm me atë gjysëm shtet shqiptar që na e lanë të parët trashëgim ta hedhim krahëve si struke pa mëngë. Gjatë gjithë këtyre viteve nuk ia qepëm as edhe një mëngë. Prandaj, jemi edhe sot në këtë gjendje politike copë-copë në gojë të Ujkut nëpër katër shtete. Përmëkeq, edhe të shpërndarë si Kashta e Kumbarës nëpër botë. Atdheun, edhe sot ia kemi lënë ta bëj bërlloku shqiptar, "salep-intelektualët" me ndihmën e "miqëve" historik. Realitet ky, që nuk gjason me të Djeshmen. Shqipërinë, nuk e bëri bërlloku shqiptar i halldupëve, po burrat e penës dhe pushkës.

Koha është sot, që në këtë njëqindvjetor të pavarsisë, Shqipëria ta hudhë gunën krahëve. Botës përparimtare, ka të drejtë dhe duhet t'ia kërkojë borxhet historike, trojet e veta etnike që ia coptoi krahët Konferenca e Londrës (1913) me gërshërë në tavolinë, e la pa mëngë mes ujqërve të Ballkanit njëqind vjet si struke…

## PAZARI I LIBRIT

Edhe: Shkrimtari që e ka shkrep lapsin me dy tyta anë e mbanë Atdheut, nuk ka mundësi dhe kohë këtë vit të shkojë në Panairin e librit: në Prishtinë, në Tiranë… Vendet e shenjta të librit, ku organizatorët të veshur me ngjyra partiake të përçarë nëpër shoqata botuese tregtare, organizojnë brenda një viti edhe nga dy-tre panaire të librit. I ftojnë me ftesa speciale miqtë e tyre, shkrimtarët dumdumë. Edhe, atë: në emër të popullit dhe kulturës shqiptare. Reklamojnë me të madhe titujt e librave teknefes të politikanëve. Ndajnë çmime letrare të panairit: familjarëve, miqve dhe klaneve të tyre letrare-politike. Mirë, do të thuash ti si lexues: Shyqyr Zotit, që më në fund edhe ne shqiptarët arritëm të organizojmë panaire të librit. Mjaftë më, gjithë jetën bëmë luftë për bashkim kombëtar e Shqipëri Etnike! Copë-copë i bëmë lapsat dhe çiftelitë me poezi e këngë patriotike për Liri. Koha është t'i kthehemi pak si e gjithë bota, edhe librit, armës paqësore. Pajtohem, vetëm nuk e shihni se këta dumdumë shqiptar nuk janë në gjendje ashtu siç duhet e u ka hije të organizojnë një panair libri, pse e rreni veten se do të organizojnë dy-tre panaire brenda një viti në të njëtin qytet kulturor të Atdheut?! Heshtje.

Përmes mjeteve të informacionit lexon lloj-lloj budallakish e mençurish të shekullit: Kolec Traboini shkruan: "**Qofte Beogradi dhe gjeniu pa brekë (***Në Panairin e 13-të të librit në Tiranë ).*

Pyes veten, anipse e di se kurrkush nuk më përgjigjet. E megjithatë në Panairin e Librit Tiranë tek Pallati i Kongreseve, vazhdon të qëndrojë një shënim me gërma të mëdha "Beograd", me gërma sllave sigurisht se serbët e kanë alergji latinishten e gërmave që përdor mbarë Europa, gjithë kjo sepse ata që kanë në dorë çelsat e Tiranës ua kishin lëshuar lejen serbëve me shitë qofte e birrë shqiptarëve... Kuku moj nanë.....A jam në Beograd apo në Tiranë.

Këtu nuk është problemi tek qoftet, tymi e kënga, por tek mentaliteti prej skllavi që kanë politikanët shqiptarë... që zgërlaqen tek shohin fjalën Beograd në ballë të Panairit të librit Shqiptar që në të vërtetë nuk është aspak shqiptar, sepse vetëm tre librave me lëng supe të Elena Kadaresë, Blendi Fevziut dhe Ben Blushit. Foto-busti i Blendi Fevziut shfaqet dukshëm në konkurencë me fotobustet e Enver Hoxhës në kohë të diktaturës. Nuk ka asnjë shkrimtar që në të gjallë t`i jetë bërë foto-busti kaq i madh sa i Blendi Fevziut, këtë megallomani ia ka ushqyer një universitet me emër të madh, por me reputacion të vogël, Universiteti Europian i Tiranës. Dhe natyrisht libri i fundit voluminoz i politikanit Ben Blushi, ku fiksioni përzihet me politikën krejt ngjashëm me lesh e linë që bën sot politika klanore shqiptare. Në tre këta soj libra gjysmetrosh, nxirren Kadareja, Shqipëria dhe Enver Hoxha pa brekë, tjetër gjë shqiptare nuk shihet kurrkund në këtë Panair. Duhet te shtohet dhe "Kurbani" i Edi Ramës që panairi të shfaq një kuadraturë solide të shkrimtarisë pa shkrimtarë."

"SHSHA: **Kush i lejoi serbët pranë Panairit të Librit dhe pse heshti Ali Aliu.**

Shoqata Shqiptaro-Amerikane në Çikago është e indinjuar me rastin e poshtërimit që i bënë serbët Panairit të Librit në Tiranë.

SHSHA-ja shtron pyetjen imediate se "kush po sjellë në Tiranë serbët dhe "Made in Beograd" në manifestimin kulturor të botës së librit shqip. Kjo na kujton kohën kur në Shqipëri vinin komisarët e PKJ-së (Milladin Popoviqi, S. Tempo, D. Mugosha) që ndër vite të "nacional-çlirimtarës" dhe të fatit të Kosovës, po ky regjim serb i Beogradit u bë vrastar dhe varrmihës për popullin shqiptar!"

Sipas SHSHA-së, e keqja e shëmtoj këtë festë të librit shqip në Tiranë, pasi dikush i solli serbët e Beogradit në qendër të Tiranës për të bërë biznes me shijen e qebapave…

Edhe më skandaloze ishte emisioni "Debat" në Vizion Plus që i kushtohej manifestimit të librit. Në studio ishin edhe përfaqësues nga Kosova Nazmi Rrahmani dhe nga Maqedonia, akademik Ali Aliu. Për rastin poshtërues serb nga Beogradi Rrahmani ngriti zërin kundër skenarëve serb para Pallatit të Kongreseve me tërë atë bagazh propagande që e prishi hijeshinë e botës së librit shqip. Ndërsa, Ali Aliu për çudi sikur u tremb me këtë rast dhe pa një pa dy e tha shtruar: Kjo gjë nuk më intereson! Mos të harron Akademik A. Aliu se tërë një jetë e ka kaluar në Kosovë bashkë me krijuesit dhe botën e librit që e kishim prezentë përkrah elitës intelktuale shqiptare dhe Universitet.

Kur kolegu i tij Blazho Mitevski (AMSHA) në Shkup përmes fjalorit 'shkencor' (sic!) alla Enciklopedija Maqedonase fyen dhe i shpall luftë popullit shqiptar në Ballkan, profesori ynë që ka bërë rrugëtimin e gjatë në të gjitha fushat dhe manifestimet shqiptare në atdhe, nuk mori guximin që të thotë fjalën e vetë me kompetencë shkencore prej akademiku. Kush po na mban leksion se si duhet të sillemi me (heshtje) para aktit dhe skenarëve poshtërues ndaj vlerave tona kombëtare para atdheut", thuhet në fund të këtij reagimi që e ka nënshkruar prof. Skënder Karaçica, drejtor ekzekutiv i SHSHA-së në Çikago. “

Shkrimtari, megjithatë mezi ka mundësi dhe gjen kohë të shkojë në Panairin e librit, në Tetovën e dy Universiteteve. Kryeqendrën politike e kulturore të shqiptarëve. Panairin e librit që e organizon Shoqata e Botuesve Shqiptar në Maqedoni, që përplaset për interesa personale, materiale e ideologjike fetare, herë me njërën parti politike shqiptare e herë me tjetrën në pushtet, shkon si kurva burrë më burrë. Këmbekrye, ditenatë në grazhd të Qeverisë. Mosaftsinë e vet organizative për çdo vit ua hudh doganierëve, gjoja se e ndalin librin shqip në kufi. “Fajtori” kryesor ky, që panairet e librit i përfundojnë si pazare të librit, ku plotësisht ka të drejtë një komentues kur thotë në mjetet e informacionit: mirë do të ishte që Panairin e librit ta shpërngulni në Xhepçishtë.

Edhe shkrimtari shkon si vizitues, dashamir i librit.

Asgjë interesante festive, i duket si Pazari i zarzavateve në Bit-Pazar: më shumë tregtarë të librit se sa shtëpi botuese. Nga të gjitha anët i rrethuar nga shtëpitë botuese fetare. Mirë do të thuash ti si lexues, ne jemi shqiptarë me shumicë myslimane. Pastaj, edhe kryetarin e Shoqatës të botuesve shqiptar me partizanët e tij përreth të ndihmuar edhe nga politikanë trusakatë, kryesisht i kemi me shumicë e pakicë hoxhallarë.

Ndalesh, në mes të Panairit të librit, Tetova 2011, e pyet veten ku ndodhesh: në Panairin e librit të Kryeqendrës politike e kulturore shqiptare me dy universitete e pesë parti politike shqiptare, apo në ndonjë qytet të shteteve arabe?! Nuk do t'i besosh realitetit që e sheh me sy hapur në mes të ditës, ulesh të pushosh pak eshtrat, në Kryeqendrën politike e kulturore të shqiptarëve. Ndalesh, dhe i bie kokës me të dyja duart me grushta: I kujton panairet e librit në Frankfurt dhe Lajpcing, ku dyndet një javë rresht i madh e i vogël e gjithë Gjermania. Sallat e atyre panaireve pa fund plot me libra, që për t'i vizituar të gjitha stendat të duhen muaj, të mos e teproj vite. Ngjarje e vërtetë kulturore festive, ku gjatë atyre ditëve e gjithë rinia gjermane për hatër të librit flente edhe në rrugë. Megjithatë, Frankfurti është Frankfurt. Lajpcingu – Lajpcing. Nuk është as Tiranë, as Prishtinë e as Tetovë e dy Universiteteve.

Përpiqet të gjejë ndonjë libër të tij nëpër këto stenda të panairit. Më kot endet si pa krye, nuk gjen as për farë, së paku një titull për fëmijë.

Organizatori me spiunët e tij fetar i ka hapur sytë nga dy, i ka bërë katër, mos u përvidhet

ndonjë libër i  këtij autori që e ka "mik" Shejtanin. Përjashtim, këtu bën libri me drama: Lamtumirë bërllok, i përvjedhur në stendën e një librarie të qytetit si pjesmarrëse në panair të librit.

Vazhdon rrugën për te Shtëpia botuese "ASDRENI", që e udhëheq vetë si shkrimtar: për habi as këtu nuk gjen libër të tij si shkrimtar. Mos flasim për librin e tij më të ri publicistik të "rrezikshëm": Xhadia. Gjithë librat e tij edhe sot shiten fshehurazi nën tavolinë si dikur në kohën komuniste. Momente këto, që për disa çaste ia përkujtojnë kohën e cenzurës komuniste të librit shqip. Mirë, atëherë na cenzuronte shkau, po tashti kush na cenzuron: "shqiptari mysliman me Din e Iman", Hoxha?!

Dëshprohet. Edhe në Panirin e librit në Tetovë, politikanët dhe hoxhallarët ia kanë zënë vendin e shkrimtarit. Stenda të stolisura me ballinat e librave të politikanëve e hoxhallarëve në ballë të mureve.  Zagushi edhe në Panairin e librit në Tetovë.

Shkrimtari më në fund bindet se, në këtë shoqëri "demokratike" nuk e ka vendin, ku politikanët dhe hoxhallarët janë edhe shkrimtarë. E kanë zaptuar shoqërinë me "politikë madhore" e libra teknefesë fetar. Përurime propaganduese para kamerave televizive.

Përfundimi: I ka mbetur vetëm edhe një vend i lirë për arratisje: FERRI…

## DELEZEZAT E NËNKRYEME KAKADEMIKE

*(Shkas: Dita e Alfabetit Shqip, në Manastir).*

Rroftë Kongresi i Manstirit, që falë 103 vjetorit na i nxorri në sipërfaqe Delezezat e nënkryeme kakademike! Jo, se këto Delezeza të nënkryeme kakademike nuk i kemi ditur, por jo si sot kaq të pispilosura si nuse me duvak në një Ditë festive kombëtare. Turr Delezezat e nënkryeme kakademike me të katra te kryetari i Shtetit. Burri i Shtetit multietnik, që e harroi shënimin e Kongresit të Manastirit, Alfabetin e shqiptarëve. Patriotët tjerë të vonuar nga Shqipëria e Kosova, edhe ata turren te Instituti i Trashigimisë Kulturore të Shqiptarëve në Shkup duke u fotografuar para kamerave televizive dhe bërë vetëm zhurmë propagandistike informative. Pavetëdije, e ngatërrojnë Manastirin me Shkupin. Vendi i manifestimit, kur dihet se është Manastiri. Punë tjetër është ajo se si ndodhi një gjë e tillë festive, kur ndërtojmë një shtet të përbashkët multietnik dhe duam të shkojmë në Evropë. Faji, përsëri u mbetet partive politike shqiptare në Qeveri. Kakademikëve dhe "patriotëve" të tyre kuqezi që i kanë dalldisur në grazhd me taxhi si këshilltarë e aktivistë politik.

Megjithatë, kakademikët janë kakademikë: kokën e kanë në parti, ndërsa bythën në Qeveri. Ditën, vërtetë me një sy hapur flejnë si lepuri, po natën nuk i merr gjumi. Përpiqen në Ditën e sotshme të lajnë mut bme shurrë.

Kakademikët e Letërsisë maqedonase, Enciklopedisë maqedonase, plan-programeve shkollore…

Dumdumët, që ende e hudhin gurin e përpiqen ta fshehin dorën. Që, më lehtë e kanë të arrinë te kryetari i Shtetit se sa te Qyteti i Alfabetit Shqip, në Manastir. Ose, te partitë politike shqiptare, ku e kanë futur kokën si krajtat në grazhd. Edhe një herë pyes botërisht, ku jetojnë këta kakademikë: në Maqedoni, apo në hënë?! Sotpërsot, edhe pyes ku e kanë bythën e ku kokën?! Mjeranët, që ende mendojnë se populli shqiptar ha kashtë. E ata do të trashin bythët me djersën e popullit shqiptar që ende kullon gjak. Fotografohen para kamerave televizive me deklarata teknefese në emër të tij si "patriotë" shqiptar kuqezi.

Prandaj, jo rastësisht ky popull heroik i ka pagëzuar si Delezeza të nënkryeme kakademike. Edhe një herë e pyes veten, edhe juve si shqiptarë: çka na duhen në Ditën e sotshme festive këto Delezeza të nënkryeme kakademike?! Popullit shqiptar jo se jo, po u duhen "vëllezërve" të Njerkës. Nëna ime, ndjesë pastë: Delezezat e nënkryeme i shiste në pazar për pak pare, ose i therte për mish t'ua hudhë qenëve në rrugë.

Dhe, në fund: i pyes këta kakademikë shqiptar, në emër të cilit popull, partive politike shqiptare kanë pasur takim te kryetari i Shtetit?! Vendin, kur dihet se e kanë pasur te Shtëpia e Alfabetit Shqip, në Manastir. Në emrin tim jo se jo! O, Imzot! Mos më shtini të bëj vtëvrasje për këta "patriotë" kuqezi në këtë moshë, në pleqëri!

Publikisht e them: nuk i dua këta kakademikë! Populli shqiptar, nëse i do, ja ku i ka pa pare. I qofshin falë! Edhe, jua paftë hajrin!...

## IV ASKUSHËT SI ARGATË BESNIK TË PARTIVE POLITKE

### DATJA* HYRI NË KONAK PA KOBURE

Festat e Nëntorit, edhe kësaj radhe ikën në histori me gunën krahëve dhe kësulën e bardhë në kokë. Politikanët e ngritën flamurin emblemë në jakën e setreve duke u fotografuar krah për krahu para kamerave televizive. Nxënësit, i lëshuan orët e mësimit dhe e hodhën krahëve flamurin kuqezi si struke. Ndonjëri e ngjeshi për brezi. Studentët e Shoqatës të posaformuar "Dardania" në prag të festës, pas Akademive festive për Ditën e flamurit edhe ata dolën në rrugë, por kësaj radhe jo në demonstrata për dije e të drejta universitare, po në ditë feste  për flamur kombëtar. Dikushi edhe e valonte në dorë rrugëve flamurin kuqezi. Aktivistët partiak e ngritën lartë nëpër dritaret e makinave. Motorxhinjt në grupe me flamuj në motorët e tyre bytrynin si mëzetër të hazdisur rrugëve të Shkupit. Shqiptarët anën e mbanë Atdheut e skuqën me flamuj kuqezi. Secili e festoi si mundi e diti në Pashallëkun e tij politik. Tetova heroike, kryeqendra kulturore dhe universitare e shqiptarisë, kësaj radhe nuk e ngriti asnjë flamur kuqezi. Përmëtepër, katër aktivistë të Lëvizjes "Illyricum Libertas", për shkak se kishin

1. *Lokalizëm, titull shqiptar siç e kanë anglezët lord, françezët De. Turqit: pasha, bej, aga… Dhe, sllavët vojvodë.*

vizatuar grafite dhe hartën e Shqipërisë Etnike në hyrje të Tetovës, i mori policia e Tetovës në "bisedë informative". Vetëm, shqiptarët jetima të Preshevës dhe Bujanovcit e festuan Ditën e flamurit me protesta për liri dhe të drejta kombëtare.

Hashim Thaçi u tha shqiptarëve: as mos tentojnë ta keqpërdorin flamurin kombëtar, simbolin shtetëror të Shqipërisë për marketing politik. "Vetëvendosja" dhe "Aleanca kuq e Zi" as e dëgjoi porosinë e kryeministrit të Kosovës: "Vetëvendosja" e shpalosi në dimensione të mëdha përballë Kuvendit të Kosovës, ndërsa "Aleanca Kuq e Zi" erdhi nga Tirana dhe e skuqi me flamuj kombëtarë edhe Prishtinën, e mbuloi me flamurin kuqezi simbolin e pavarsisë. Politika diplomatike do të thoshte: përzierje në punët e brendshme të një shteti. Faji, nuk qëndron te ata të "Alenacës Kuq e Zi", po te Sala që nuk u la as një pëllambë vend në Sheshin e Tiranës edha ata si patriotë ta valojnë flamurin kombëtar kuqezi në këtë përvjetor, Ditë feste.

Shkupi, kryeqyteti i shqiptarisë e gëdhiu mëngjesin me flamuj kombëtar kuqezi, u "bë" një ditë Shqipëri Etnike deri te Ura e Gurit, ku i kishin vënë pritat misionarët fetar të Beogradit dhe përmendoret e komitave me kuaj shale. Aleksandri i Madh e kishte kaluar Vardarin matanë dhe moti e kishte pushtuar sheshin e Shkupit. Bit – Pazari, vërtet dukej si një "Shqipërizë maqedonase", siç thoshte shpesh nëpër kollumnat e tia në mjetet e informacionit Patrioti i vonuar melez.

E mbushën Çarshinë me manifestime euforike kulturore dhe flamuj kuqezi. Dorën në zemër, kurrë Shkupi deri më sot nuk ka qenë kaq i veshur këmbekrye me veshje kombëtare shqiptare.

Rasti i kësaj feste madhështore m'i kujtoi vitet e '67 - 68, si nxënës i shkollës së mesme "Zef Lush Marku" në Shkup, që në atë kohë ishte univesitet i shqiptarëve. Kohë kjo, kur Skënderbeu as që guxohej të përmendet si emër, e ku më ta hipnim mbi kalë në Kala ose në mes të Shkupit. Ne, nxënësit e asaj kohe e mbanim tinëz në zemër, e rrallë nën jakën e setres si emblemë lirie.

Vërtetë, ato vite ishin të hidhura dhe të rrezikshme për popullin shqiptar. Vite, kur ndaloheshte rreptësisht çdo gjë patriotike shqiptare. Edhe, të rrasnin në bug për asgjë: një fjalë goje, një libër, për emblemën e Skënderbeut ose flamurit kuqezi në setre. Vit ky, që ma kujtoi edhe Lijen. Vajzën e kojshiut të banesës në Shkup, që në atë kohë ma qëndisi në një këmishë të kuqe me penj të zinj Skënderbeun me dy brinja. Edhe unë si i ri nëpër disa disko klube nate të Shkupit me atë këmishë kuqezi e pritsha agimin.

Edhe sot e kësaj dite them me vete: Dikushi më ka ruajtur, marrë në mbrojtje të mos them Zoti në atë kohë të rrezikshme për shqiptarët. Ndoshta, dora e asaj vajze që ma qëndisi Skënderbeun në këmishë. Hajmalinë time të vetme, që edhe sot e kësaj dite e mbaj përqafe. Ku ta di. Ndodhë.

Përmëkeq, në atë kohë flitej se ajo vajzë gjoja vinte nga një familje me prejardhje turke. Që, nuk

e besoj edhe sot e kësaj dite. Shkupi ka qenë dhe është i banuar denbabaden me shqiptarë të asimiluar në "turq" me dhunë politike. Edhe, ajo vajzë nuk ka mundur të jetë tjetër, përveçse shqiptare. Shkaku se, që në atë kohë ajo vajzë "turke" e donte Skënderbeun, në krahasim me "turqit" e sotshëm në Shkup, që nuk duan t'ia përmendin as emrin, po takimet e biznesit i lënë te "Kali"…

Lija, nuk e di a është ende gjallë, dhe a ka krijuar familje në ndonjë qytet shqiptar. E rëndësishmja është, që ajo ka qenë shqiptare. Faji im është, që unë edhe sot e kësaj dite nuk di asgjë për atë Marigonë të asaj kohe, vajzë shqiptare. Dhashtë Zoti, nuk ia kanë mbushur mendjen edhe asaj si "turke" të ikë në Turqi. Zëri i saj kudoqoftë, sot më thotë: unë të vendos të shkoj në Sheshin Skënderbeu, këtë Ditë madhështore ta festoj bashkë me popullin, e jo nëpër sallone me darka e pije me politikanët. I marr "ilaçet" e mia të rregullta te "Miracoli". Një grup të rinjsh rrinë matanë, në një tavolinë tjetër kokë më kokë, si për ditë feste. Anësh kalojnë të rinj të veshur kuqezi me flamuj kombëtar në dorë, lidhur për brezi e hedhur mbi shpinë. Pas pak kohe, vjen një tjetër djalë i ri dhe i përshëndet të pranishmit: gëzuar Festën e flamurit! Ata i përgjigjen: për hajër Bajramin! Edhe atë, merreni me mend: Ditën e Flamurit. Halldupët, që tashti nuk e duan edhe flamurin kombëtar kuqezi, po gjysmëhënën që nateditë e valojnë në minare të xhamive.

E ne, në atë kohë të rrezikshme e hipnim edhe në minare.

Rebelohem dhe e ngrej zërin në Ditën e sotshme festive të flamurit: Djema, ne që Skënderbeun dhe flamurin e fshihnim nën jakën e setres, ju arritët ta demonstroni me të madhe plot eufori rrugëve të Shkupit. Urime! Vetëm, më vjen inati kur partitë politike në pushtet u dalldisin ta përdhosni në rrugë, nëpër tubime me ngjyra partiake. Koncerte festive, që brenda një nate gëlltisin shuma marramendëse të parave. Edhe atë, në këtë kohë qorre kur nuk kemi tekste shkollore, lektyra shkollore… Banga shkollore e karrige për nxënësit. E, në anët tjetër, derdhim para me thasë në mes të dimrit për zhveshjen e këngëtareve lakuriq në skenë para këmbëve të Skënderbeut. Shkrepjen e fishekzjarreve në qiell, me djersën e popullit, paratë e të cilave do të organizonim dhjetëra manifestime kulturore letrare, do të botonim qindra libra për shkollarë. Dhe, dhashtë Zoti edhe unë në manifestimin e ardhshëm të flamurit kuqezi t'i ngjitem grupit tuaj demonstrativ me motorin tim të hazdisur, Gjokun e Gjergj Elez Alisë.

Datja në një emision popullor, në prag feste edhe u ulë këmbëkryq, gju më gju me popullin "Rreth oxhakut". Shfletoi shumë faqe historike gjatë atij emisioni. Shairët e zhveshën lakuriq Daten nga politika. Edhe atë cilin, Daten e veshur me tirqi e xhamadan me dymbëdhjetë gajtana. Daten me kësulë të bardhë kosovare në kokë. Datja është i sinqertë në politikë. Fatkeqësia, që: sinqeritet nuk ka në politikë.

Datja duhet ta di, edhe besoj se e di, politika është: të rrena, më rrene. Edhe, nuk ka gjithaq rëndësi kjo, ai është një emision kulturor.

Provokimet e atij emisoni, pas të cilit nuk qëndronte vetëm shairi i emisionit, ranë në ujë bythekrye në hurdhë. Datja doli mbi nivelin e provokatorëve: gju më gju me popullin. E këndoi edhe një këngë për Ditën e flamurit: Isa Boletinin se si hyri në Londër me dy kobure.

Datja vërtetë e këndoi këtë këngë përkushtuar këtij heroi kombëtar që hyri në Londër me dy kobure, ama kryesorja: ai hyri në këtë emision kulturor të një televizioni privat të "vëllazërim-bashkimit" pa kobure. Megjithatë, falë Zotit Madh i shkrepi dy koburet e Isë Boletinit. Edhe atë: në mes të Shkupit para këmbëve të Skënderbeut me kalë, në Bit-Pazar…

## ARUSHA ME DAJRE
## HEQ VALLE

Kohën e fundit, anë e mbanë Atdheut shqiptarët i kanë edhe manifestimet kulturore, dasmat e tyre poetike shqiptare. Vërtet, komunizmi në atë kohë i kishte "ngulfatur" dasmat e këtij lloji shqiptare, po ja erdhi koha që "demokracia" këtyre dasmave ua hoqi frerin nga goja. Kuajt e hazdisur me taxhi komuniste me një torbë përqafe, turren me të katra livadheve. Herë-herë pas hingëllimave të tyre poetike, qesin edhe shqelma vdekjeprurës me të dy këmbët e mbrapme mes livadheve. Edhe, i ke këngët e tyre antologjike patriotike me melos turko-arab me çifteli. Poezi patriotike me thasë. Shkau i pabesë "vritet" me tre plumba në ballë në mes të pazarit për Shqipëri Etnike.

Përçudi, "vritet" në kohën kur kemi këngatëarë dhe poetë me qerre. Shpallet me këngë e valle, kur dumdumi lodraxhiut rom ia stolis ballin me para. Kryeplaku i dasmës i dehur nga poezitë "artistike" dhe këngët patriotike, rri përkrahu në ballë të oxhakut me një Hanëm bullgare dhe i përcjellë me duartrokitje gratë dhe burrat e kombit se, si me këngë epike i dalin zot Atdheut. Punën e ecurisë së dasmës ua ka lënë kojshive. Dorën në zemër, sipas tarditës shqiptare dasmat te ne në katund i kanë bërë të afërmit tanë, familjes ose kojshitë. Edhe të mirën, edhe të keqen e kemi ndarë me ata gra e burra konaku.

Tjetër punë është ajo se, sa të aftë i kemi pasur ne kojshitë që të na i bëjnë dasmat shqiptare sipas traditave e zakoneve në katund.

Poetë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia gjatë Orës së madhe letrare e harrojnë poezinë, Mbretëreshën e salloneve aristokroate. Populli thotë: në dasëm kanë ardhë i hurit dhe i litarit, sipas ftesave të "agait" të dasmës. Dalldisen e çirren pas hapave të natës: i sqarojnë përpara të pranishmëve në sallë "poezitë" e tyre të shekullit. E, në anën tjetër harrojnë se në ato poezi patetike nuk kanë vargje të arrirë artistik. Komunistët, muajin nëntor e pagëzuan Nëntori i kuq. Dorën në zemër, Nëntori për shqiptarët duhet edhe të jetë i kuq. Gjithë fitoret dhe festat kombëtare, shqiptarët i kanë në Nëntor. Edhe Alfabetin… Edhe pavarësinë e Shtetit shqiptar… Edhe Ditën e flamurit… edhe Ditën e republikës… Shqiptarët gjatë këtij muaji të gjithë janë të veshur kuqezi. Edhe Shqipëria… Edhe Kosova… Edhe Maqedonia… Aleanca kuq e Zi, veç e ka shpallë më Shqipërinë Etnike në foltore me fjalime. E para, pasi e bëri Shqipëri Etnike në të gjitha tokat e coptuara shqiptare para Shtetit Shqiptar, pas Prizrenit e skuqi edhe Vlorën krah për krahu me Prishtinën. Tetova heroike, siç duket i mbeti jashta Shqipërisë Etnike.

Ditën e pavarësisë në të katër anët u zbuluan përmendore, shtihen gurthemele të sheshve të "pehlivanëve" e "Skënderbeut" nëpër sokaqet e ngushta arën përmbi arën. Organizohen "Tinguj të çarshisë", gala koncerte e përurime të librave për politikanë-shkrimtarë të dështuar e aktivistë të

partive politike. Shqiptarëve tjerë, kush u ka faj që nuk janë aktivistë të partisë në pushtet, po të partive tjera politike "demokratike". Ose, ndonjërit që nuk është në asnjë parti politike. Festat kombëtare i takojnë vetëm një partie, mu si në kohën e komunizmit. Popullit i takon euforia dhe këngët me çifteli. Manifestime kulturore e poetike, mu si në kohën komuniste të xhaxhit Enver e shokut Tito. Vërtetë, jemi popull euforik. E merreni me mend, gjithë këtë eufori patriotike dhe veprime me fjalë, shqiptarët t'i shndërronin në vepra kombëtare. Besnikë edhe sot e kësaj dite i kanë qëndruar parullës komuniste të shokut Tito: "Nga fjalët në vepra". E unë sot e them të kundërtën për shqiptarët: nga veprat në fjalë…

Lodraxhiu, mbi nivelin e tyre artistik e arrin kulminacionin e manifestimit kulturor. I rrëmben të gjitha çmimet letrare. Përsëri me anë të lodrës në mes të sallës shkrep shtatë plumba allti. Poetja luan çoçek shqiptar me këngën e Hajredin Pashës. Nusja dhe dhëndrri rrokullisen në dysheme, nuk dalin ende nga vallja. Poetët e tjerë krah për krahu duke përdrdhur bythët, rrëzohen në dysheme zvarrë sipas stilit rep, e heqin vallen popullore: Shota. Patriotja, në vend të poezisë ia thotë këngës: "Thërret Prizreni ori Shkodër". Edhe, i radhitë njëri pas tjetrit në këngë qytetet e Atdheut. E bën me këngë brenda një nate Shqipëri Etnike. Pasmesnate, lodraxhinjë e poetë bashkë ia marrin edhe një herë këngës patriotike: "Hajredin pasha po na vjen Radikës". Poeti i "vëllazërim-bashkimit" e luan edhe rolin e arushës me dajre.

Romi është lodraxhiu më trim në sallë. Guximtarët, herë pas here e rrëmbjenë edhe mikrofinin: fjalë të kota pa lidhje, që nuk kanë presje nuk kanë pikë gjatë kësaj nate. Secili përpiqet të shes mend më shumë se shoqi. Gjithë atë arritje të vlerave letrare, që nuk e kanë arritur me librat e tyre artistik gjatë gjithë jetës, përpiqen ta arrijnë brenda një nate si argatë besnik të Nënës Parti. E marrin si të paarrirë artistikisht nëpër gojë Naimin, Faik Konicën e Nolin.

Mirë do të thoni ju: po, shyqyr Zotit që edhe ne shqiptarët më në fund e gëzuam këtë ditë madhështore në demokraci me këngë, valle e poezi deri në agim! Edhe ne, kemi nevojë për një natë çmendurie pa brenga, t'i nxjerrim jashtë nga zemra e plasur të gjitha të mirat dhe të këqiat, po qe nevoja edhe jatagnët nga brezi. Gjithë jetën e lume rrimë në shtëpi nën zgjedhën e grave besnike dhe Qeverisë të "vëllazërim-bashkimit".

E vërtetë. Pajtohem, dashta nuk dashkam si autor i këtij shkrimi. Vetëm se, i keni përzi lëmsh profesionet, i keni bërë lesh e li në ditën e sotshme. Politikanët merren me letërsi artistike, e shkrimtarët me politikë. Lodraxhintjt rom para syve jua rrëmbejnë të gjitha çmimet letrare të manifestimit kulturor. Shkak kryesor ky, që në këtë kohë nuk kemi as politikanë e as poetë.

Vallë, a kemi nevojë ne shqiptarët që manifestimet kulturore dhe takimet poetike t'i shndërrojmë në dasma shqiptare të rangut të sotshëm kaq në nivel të ulët katundi?! Përurojmë në ditën e sotshme eksponentët e "vëllazërim-bashkimit"?! Edhe atë, kur e dimë se poezia lirike

kërkon atmosferë, intimitet, ngrohtësi, nivel artistik të pjesmarrsëve. Jo. Dasmat tona, përherë e kanë pasur nivelin e tyre tradicional popullor. Tjetër punë është sot se, ne edhe dasmave tona shqiptare jua kemi dhënë një tjetër karakter festiv. Berllokun ende e kemi në mesin tonë me qerre para dere. Bërllokun shqiptar.

Edhe, përderisa ky bërllok shqiptar merr frymë lirisht në mesin tonë shqiptar, ne nuk do të kemi dasma shqiptare e as takime poetike të një niveli të arrirë artistik botëror. Ftakeqësi kombëtare, më vjen keq për poetin e oborrit të "vëllazërim-bashkimit" me disa çmime republikane që ia dha DoktorZiu, që e zhveshën lakuriq brenda një nate në këtë takim poetik. Ia zbrazën xhepat lodraxhintj romë gjatë një takimi poetik. Djersa e popullit shqiptar shkoi për rrush e kumbulla. Nuk i kam unë faj, as në këtë jetë e as në atë jetë. Fajin e ka vetë, shkaku se ai as që ka qenë ndonjëherë poeti i kombit, siç i pëlqen ta heq e thirr veten nëpër këto takime letrare. Ose, Poet i liqenit.

Përfundimi: unë për së gjalli deri më sot, nuk di, e as kam dëgjuar poet tjetër të liqenit dhe kombit, përveç Lasgush Poradecit…

## ASKUSHËT SI ARGATË BESNIK TË PARTIVE POLITIKE

*(Shkas: Kurvat politike, qe ende deri më sot nuk e gjetën një burrë me brekët mbi pantallona).*

Shqiptarët historikisht kanë dhënë burra të pushkës dhe penës. Përçudi, kohën e fundit japin me shumicë e pakicë edhe kurva politike të shtëpive publike. Akullin e thyejnë partizanët neokomunist të partive politike duke i nxjerrë "armët" e tundshme nga brezi me vlera të arrira sakate publicistike. Hë për hë, në shenjë është Shqipëria demokratike. Nënëmadhja, që e rroku mashën e nxehtë demokratike që në kohën e Fan Nolit, kur dumdumët bënin gjumin e arushës nëpër parti politike antishqiptare.



Dorën në zemër, edhe Nënëmdhja ka gabime. Ose, siç do të thoshte Filip Shiroka: nuk e di Eva, me cilët i bëri këta kopila. Mirë, do të thoni ju: po, i përkryer nuk është as Shekspiri.

Pajtohem. E përkryer është vetëm Natyra. Populli thotë: Trimi i mirë me shumë shokë.

Edhe t'i vëmë gishtin kokës: Nënëmadhja, a ka gra e djemë burra?! Po. Edhe atë, me shumicë e pakicë. Trima pas lufte: për ministra në Qeveri, zv/ministra, ambasdorë, drejtorë, vende pune… Askushët, që në kopshtin e tyre nuk kanë ngulur as edhe një hu gardhi, e ku më t'i dalin zot katundit ose çështjes shqiptare. E në anën tjetër bëjnë luftë, fushatë parazgjedhore me njëri – tjetrin duke ia nxjerrë edhe sytë në mbrojtje të partive të tyre politike. Edhe atë, pasi kanë rrëshqitur në "akullin" e të gjitha partive politike dhe e kanë thyer kokën. Thonë: jo politika nuk është rrenë. "Politika është art i së mundshmes". Unë them: edhe kurvë. Kurva e do kurvën, po jo edhe burrin besnik. Gjysëmanalfabetët, që as për bari të kopesë me dele nuk i ka marrë Agai i Çelike në Çelëvjollcë. E këndej, duan të dalin në ballë me të gjitha rruzat e kuqe përqafe, t'i prinë popullit shqiptar.

Askushët me këmbëngulje duan ta përbaltin Nënëmadhen, përpiqen të shesin mend për "politikën madhore" para kamerave televizive. Përgjumshëm flasin jerm në përurimin e librave të politikanëve. E harrojnë "kritikët e tabanit kombëtar" se, nuk janë në gjendje t'i përdorin as mjetet e bujkut me të cilat ai e punon arën, e ku më lapsin për të vënë në lëvizje trurin e tyre të sëmurë nga kanceri. Edhe, çka do t'i tregosh DoktorZiut, që nuk sheh më larg se kabineti i Babait, nëpër dritare në lëmë?! Asgjë, përveç Lakuriqit që turret nëpër errësirë duke u përplasur

mureve të avllive e pemëve në kopësht. E, unë shoh më larg në errësirë, matanë gardhit: pas Çuke me lisa, Përtejzalli.

Vërtetë, ma kënaqën lapsin këta trusakatë! Ditenatë, më shani sa të doni, unë megjithatë ju dua marrëzisht si personazhe të librave të mi kokë më kokë në bibliotekë! Dorën në zemër, jeni edhe të lezetshëm, të veçantë në politikë, të pazëvendësueshëm si personazhe në libra. DoktorZiu ju pri në ballë hipur mbi Doriun me samarë. "Salep-intelektualët" i keni pas vetes mbi gomarë. Universitetet shqiptar mullinj ere. Njerkën, e keni Dylqinenë e Tobozës. Kalorës të arratisur, që pa marrë parasysh, a më doni ju, apo jo, unë ju dua të ju kem si personazhe kalorësiake nëpër libra edhe përtej varrit!

Shqiptarët nuk duhet të brengosen shumë për të Nesërmen, veprimet politike të kundërshtarit partiak, që e mbushi sheshin "Makedonija" plot me përmendore antike. Në mes të Shkupit ballë për ballë me Skënderbeun mbi kalë e solli edhe Aleksandrin e Madh. Fatkeqësisht, nuk i la vend DoktorZiut ta hipin "salep-intelektualët" edhe atë si hero lufte në gomar. Duartrokitje frenetike! Askushi nuk ka bërë më shumë për të Nesërmen e shqiptarëve, se sa ky premier maqedonas. Ndonjëherë, më shkon mendja për së prapthi, mos është me prejardhje shqiptare edhe ky premier?! Jo, nuk ma merr mendja se, shqiptarët nuk do ta sillnin Aleksandrin e Madh me gjithë kalë në Shkup. Edhe një herë binu duarve shuplakë! Rroftë kryeministri shqiptar!

Zemërohem. Nuk më pëlqen politika e Lakuriqit të natës që turret si pa kokë nëpër

errësirë. Shkaku, se: politika nuk ka turp, është kurvë. E pak veta arrinë ta rrëzojnë në kokërr të shpinës mes grunajave, ngrejnë këmbët përpjetë në hava. Askushët duan të maten me Kryeminstrin shqiptar. Momentalisht, që nuk dinë ku e kanë kokën e ku bythën. Edhe, ma përkujtojnë gëzimin tim më të madh si fëmijë te pragu i derës në Katund: kur e nxirrsha Kryngritësin për mejdani, edhe e flugësha sa më larg përpjetë shurrën në lëmë. Përsëri, do të më shkruani ndonjë koment se i vardisem Kryeministrit shqiptar për ndonjë vend pune. Jo. Vend pune kam, edhe atë: 24.00 orë pa pagesë, asnjë para. Vendi i punës të duhet ty, "o partizan i vogël me pushkën në krah", të marrësh rrogë mujore gjatë gjithë vitit pa punë fare dhe të rrish në shtëpi. E ka thënë këtë pas Luftës Dytë Botërore Mahmut Dumani, një veprimtar i njohur shqiptar, kur ka punuar e vepruar në këto anë shqiptare se, herët a vonë me këtë popull do të kemi probleme.

Ende nuk e shihni se në ç'nivel politik dhe kulturor është ky bërllok shqiptar?! Unë në shkrimet e mia i kam fshikulluar anët negative të shoqërisë shqiptare, jam marrë me fenomene e jo me individë, e ata ende më turren si mëzetër të tredhur me dy brinja. "Veprimet patriotike" të këtyre kalorësve të arratisur, qe njëzet vjet i janë ngatërruar nëpër këmbë popullit shqiptar krah për krahu me politikën sllave.

Përjashtimi se, falë Zotit edhe sllavët gjithëkund janë të përçarë, njëri – tjetrin përpiqen ta hanë me dhëmbë, por kur janë në pyetje shqiptarët, ata bëhen bashkë si një trup e një

shpirt nëpër parti në politikë. Sllavët, vërtetë në politikë hyjnë të përçarë, por kur e do nevoja nga ajo dalin të bashkuar krah për krahu si miq, vëllezër të një nëne. Ndërsa, shqiptarët hyjnë të përçarë dhe dalin edhe më të përçarë se dje si armiq, kopila të Njerkës.

Imzot, çka po ndodhë me politikanët shqiptarë?! "Salep – intelektualët" e Doktor Ziut, fundrrinat komuniste që shndërrohen brenda nate në gjiriz neokomunist. Njëzet vjet, gjatë ndryshimeve demokratike të njëjtit individë teknefes, shkojnë parti më parti si kurva burrë më burrë, themelojnë parti të reja politike, janë bërë rrospitë politike më të kërkuara në këtë Shtëpi publike. Edhe, këta rrospi politike bëhen bashkë, vetëm se kur?! Atëherë, kur u rrezikohet taxhia neokomuniste në grazhd. Ashti i hedhur nga DoktorZiu (lëpirja e një titulli shkencor), gjithë jetën i shitur nëpër parti komuniste dhe neokomuniste me torbën arnë përmbi arnë me taxhi përqafe. Edhe, ndërsehen këlyshët me zgjebe për të rrëzuar nga pushteti një Parti Politike Demokratike Shqiptare.Pajtohem. Edhe unë jam për ndryshime, po jo me këta trusakatë neokomunistë. Eksponentë të përjetshëm besnik të "vëllazërim-bashkimit". Vallë, shqiptarët nuk kanë personalitete të tjerë, figura të reja politike që duhet të dalin në fushën e majdanit me mëngët e përveshura gjer në bërryla, masin forcat politike me këta fundrrina neokomuniste?! E them me plot gojën se kanë shqiptarët, edhe më të aftë, edhe më të pakurruptuar, edhe më trima në politikë për një të Nesërme shqiptare.

Atëherë, çka ndodhë me shqiptarët?! Njëzet vjet me radhë ecin në vend, në rreth me këta trusakatë, e kurrsesi të ngriten më këmbë, ngjiten dhiareve për në Baba Tomorr. Vendin e shenjtë të Perëndive. Tyrben ku pihet vera. Lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri.

Shqiptarët, edhe gjatë kohë do ta kenë vështirë me këta politikanë teknefes të harxhuar dhe "salep-intelektualë" – prodhim serik të DoktorZiut të shpërndarë si farë hithërash nëpër parti politike, Qeveri e Universitete shqiptare.

Koha është: shqiptarët me këto rrospi politike të mos bashkohen në një parti politike, po t'i përzënë kurvat e sokakut me shqelma nga jeta politike shqiptare deri në theqafje. Partive të tyre neokomuniste t'u zhduket edhe furriku i fundit!

Koha është: në skenën politike shqiptare të vijnë djema të ditur trima me lapsa në brez. Edhe gunën e ogiçit krahëve. Dhe, ta shpëtojnë këtë popull të përvuajtur nga fosilet komuniste me një këmbë në varr, që vite me radhë e kanë rrëzuar në baltë për vdekje. Edhe, janë duke ardhë, prandaj edhe neokomunistët kohën e fundit janë kaq të tërbuar, enden qytet më qytet me torbat me libra-krunde në krah për ndihmë. Vetëmse, askush tjetër, përveç vetë populli shqiptar këtyre fundrrinave neokomuniste duhet t'ju fus shqelmin bythëve, përzë një herë e përgjithmonë nga skena politike shqiptare…

## DALLDIA POLITIKE E BUTAKËVE PARA MOTIT MADH

Turma e butakëve politik që më shtynte përpara nga të gjitha anët s'di as vetë se si m'i ndali këmbët para disa shpalljeve të shitblerjeve të mallrave me afate përdorimi të skaduara. Kështu desha – s'desha, qesh i detyruar t'i lexoj ato "çmime" historike që i kishin mbyllur hermetikisht në mes të xhamave. E dija edhe këtë, se nga to nuk kam kurrnjëfarë dobie ekonomike e as politike, po ma thoshte mendja se nuk do të kisha edhe farë dëmi në fushën e letërsisë. Vërejtjen ma tërhoqi lajmërimi i këshillit të punëtorëve "artistik", i cili anëtarët e vet i bënte me dije se mu sot, në ora dymbëdhjetë, do të mbante një tryezë "shkencore" pune, ku në mes pikave të tjera, do të lexonte një punim "shkencor" të gjatë edhe punëtori i kësaj organizate Dr. Arnim Dërrasa, i cili merrej edhe me risi të modës pornografike. Pak më lart një listë me emra e mbiemra, sigurisht këtu bëhej fjalë për ndonjë kredi universitare për specializimin e arnimeve të "gjenive" nëpër parti politike. Në të djathtë arrita të lexoj se, Dr. Shul Butaku i Shtëpisë së mallrave në një ekspozitë ndërkombëtare për novatorizëm e kishte marrë shpërblimin e parë. Diku nga fundi nuk u shpëtoi syve as edhe ekskursioni turistik që pritej të bënte kjo organizatë punuese "shkencore" me karakter të propagandës kulturore-ekonomike në Evropën e Bashkuar e pa kufinj politik.

Imzot! Përderisa qëndroja gur më këmbë me sy nga muri, sa çel e mëshel sytë m'u parafytyrua koha e studimeve. Fakulteti Filosofik në Prishtinë, në të cilin atë kohë studioja gjuhën dhe letërsinë shqipe. Po, ajo tabelë e shpalljeve, orari i ligjëratave, lista e provimeve. Përballë meje, edhe fotografia e shokut Tito. E shkunda veten, e fërkova ballin të vij në vete, por çdo gjë ishte e kotë, mendimet më turreshin një korridori të gjatë plot me dritare. Vetëm një gjë nuk më kujtohej mes këtyre shpalljeve programore, e kisha të largët, të huaj, që më largonte me vite. Kjo më kthente në realitet, kokës sa mundesha i bija me grushta. O njeri, ti je vetëm para tabelës së shpalljeve në Shtëpinë e mallrave. E gjithë kjo që ndodh me ty, mund të jetë vetëm ëndërr lirie ose ty me siguri të kanë tradhtuar sytë, trutë në kokë. Ktheu në realitet, mos u merr shumë me vetveten, se kështu si ia ke nisur një ditë do ta shohësh me sy edhe fotografinë tënde me gjithë mjekër të varur në tabelën e shpalljeve…

Rrëmujë më ishte para derës së Bankës Komerciale kur unë erdha në vete, i hapa sytë mes atyre kursimtarëve me librezat e kursimit në duar. Njëherit i mblodha forcat të kthehem prapë, por kot, grupi i tyre më shtynte me dhunë drejt atyre dollapëve të xhamit. Herë-herë më shtrydhte, më shtrëngonte në grusht sikur katallani. Më kot ndonjëherë i përpëlitja edhe këmbët në ajër, kërkoja ndihmë, të ik përtej këtyre mureve, çdo gjë më ishte e kotë se nuk më dëgjonte njeri. Dikushi m'i kishte vënë krahët pas shpine dhe më shtynte përpara me gjithë forcë.

Më dhimbte kurrizi, më ndalej fryma dhe në çdo moment e pritja fundin, të më derdhen eshtrat si vjetërsira në tokë. Po, mu kur e prisja shkatërrimin tim, rrëmuja e butakëve para Motit Madh që tërhiqej si një zinxhir hekuri herë para, herë prapa, më hodhi nga rreshti bythekrye mu në mes të korridorit.

- A u vrave? – Dikushi më rroku për krahësh duke më ngritur më këmbë.

- Jo. – Mezi arrita t'i përgjigjem. Duke i mbajtur bythët me duar.

- Mos të merren mendtë, do pak ujë?

- Jo, - arrita t'i përgjigjem edhe kësaj pyetje dhe vetëm tani arrita të shoh se ishte Tata e Madhe me një shkop në dorë.

- Po, ç'deshe në atë rrëmujë? Nuk e sheh se çdo gjë sillet lëmsh?

- Asgjë, Tata e Madhe. Vala e saj më gjeti në rrugë. Nuk dinë shkrim-lexim mes rreshtave. Nga të katër anët më sulmojnë me lehje: shpifje dhe etiketime politike. "Vëllazërim-bashkim" në emër të popullit shqiptar dhe Shqipërisë Etnike. Luftë bëjnë për pasuri të tundshme e të patundshme, tituj shkencor e vende pune në Universitetet shqiptare. Po, ti nga dole në Shtëpinë e mallrave?

- Erdha të deponoj nja shtatë mijë euro në bankë…

- Domethënë edhe ti paske librezë kursimi me deviza?!

- Po, jam kursimtare e kësaj banke komerciale qe disa vite.

- E, a ke kursyer deri më tashti ndonjë euro?

- Ja, shihe librezën e kursimit!

E mora librezën në dorë dhe nisa ta shfletoj që nga faqja e parë. O Imzot, ç'më panë sytë! Libreza e Tatës Madhe ishte me fotografi, rast i rrallë ky i kësaj banke në kursimin e devizave. E hapa edhe një faqe, shtatë mijë euro të deponuara. Edhe një faqe: tetë mijë… edhe një faqe: nëntë mijë… Edhe një faqe: dhjetë mijë…

Vetëm tani e pata të qartë se ç'ishte ajo rrëmujë butakësh, që nuk mundesha ta ndal hapin, po të shtrydhte aq fort saqë të kërcisnin eshtrat. Përpak, kur e mora veten nga një pakuptimtësi e tillë, desh ia thashë këngës. U shkunda nga pluhuri, e drejtova veten, ngrita kokën lart dhe mora lirisht frymë. Dhe, s'do mend, për herë të parë e ndjeva veten të lumtur dhe më erdhi mirë që nuk isha kursimtar i kësaj banke në Shtëpinë e mallrave…

Kur eca edhe disa hapa korridorit, i pata ikur më larg rrëmujës të butakëve, hetova se hap pas hapi më ndiqte një hije. Vetmevete thashë: Rrufjani. Njëherit, desha ta vazhdoj rrugën, t'i ik nga sytë pas shkallëve tutje kthinave të Shtëpisë së mallrave, por kur e pashë se ajo hije më ndiqte me këmbëngulje, e ktheva pas kokën. Vetëm tani e kam vështirë t'ju them këtu mes këtyre rreshtave se ç'më pane sytë. Shkaku: e kam vështirë t'i hedh aq besnikërisht në letër ato shigjeta, ato fluturime, atë bukuri natyrore.

Aq më keq, më erdhi çudi se, kurrë deri më sot nuk e kisha hetuar aq thellë paaftësinë time si njeri i lapsit e Librit. Unë kisha lënë gjurmë mbi letër, kisha lëruar thellë me plug, po ç'e do kur nuk kisha ditur si ta hedh farën me hebet në krah

ugareve. Kjo më frikësonte, m'i shtinte ethet në palcë, se mos këtyre fletëve të bardha nuk do të mbinte gjë në Pranverë, qoftë edhe një ferrë murrizi. O Imzot, ç'do të thotë ta ndiesh veten të dobët para kësaj krijese të pafajshme, të mos jesh në gjendje ta hapësh gojën, të thuash edhe një fjalë. Këto ishin momentet që të shtynin t'i këpusish pullat e këmishës, ta hapësh gjoksin të të qëllojnë shigjetat, të shtinë rrufetë si në lisa…

Po, a mund të mposhtet dot një gjoks i këtillë leshatuk me nuskë përqafe që kishte ecur përpara me vite e vite nëpër fortunë Verë e Dimër? Jo. E them këtë se, nuk dua ta turpëroj veten, juve si lexuesë besnik t'ju lidh me zinxhirë në këtë shkrim. Apo, ruana Zot, t'ua them emrin e mbiemrin, t'ju pështyj në fytyrë. Shtatë herë me radhë t'ju këndoj ninulla zgjimi dhe shtatë herë me radhë me kamxhik t'ju zgjoj nga gjumi i arushës. E, po nëse nuk jeni në gjendje edhe kësaj radhe të më dëgjoni, e paçit veten në qafë…

- Eja në vete, i dashur, sa nuk të ka vrarë Bukuria! – Më shkundi me të dyja duart sa mundi Tata e Madhe.

- Zonjë, kahdo që ik shoh mure… Mure… Derë s'di a pati kjo Kështjellë?

- Edhe derë ka, i dashur edhe dritare me hekura… Vetëm nuk e di, si do t'i gjejsh nëpër errësirë, fluturosh në qiell si profet…

- E kam një fener. Por, bie shi, fryn era, shtinë pandërprerë rrufetë…

- Ti një ditë do t'i gjunjëzosh edhe rrufetë, por ec ta pimë nga një verë të kuqe!

- Më gjithë dëshirë, Zonjë. E ndiej veten të lodhur… Kam nevojë edhe për pushim mes luleve… Njerëz…

Dhe, ashtu duke më mbajtur për krahësh, Tata e Madhe më shtiu në Kafe-Bar duke më ulur në karrige, pranë një tavoline, ndërsa vetë shkoi pas shtambave të verës. Sa u ula e pashë se veten e lehtësova nga një barrë e rëndë, që të thuash më kishte hyrë edhe nën lëkurë. Njëherit, edhe u tremba nga kërsitja e këtij thesi plot eshtra, mos derdhen si rraqe të vjetra nën tavolinë. Po për fat të mirë nuk ndodhi kjo, se këto kishin përballuar ditë edhe më të vështira dhe ishin mësuar me barrën në shpinë.

- Mirëdita, Zoti Shkrimtar!

- Mirëdita! – Iu përgjigja zërit pa e ngritur kokën.

- Si duket kohën e fundit keni filluar si shpesh ta vizitoni edhe Kafe-Barin e Shtëpisë së mallrave në periferi të Kryeqendrës kulturore shqiptare?

- Ashtu duket. Dhe, tani kur e ngrita kokën, vërejta se ajo ishte Xhadia.

- A është e lirë? –Më pyeti për karrigen Xhadia me një buzëqeshje magjepse, që këtë e kishte në vend të grepit.

- Po, - iu përgjigja me gjysmë zëri, duke iu trembur shikimit të saj, që desh më përpiu aty për aty me gjithë tesha…

Mu kur e përfundova fjalën e fundit, Tata e Madhe erdhi me shtambat e verës, ma vuri mua timen përpara, ndërsa me të veten u ulë në karrige. E shikoi një herë Xhadinë, pastaj mua… Edhe një herë Xhadinë…

Çdo gjë nuk donte analizë, e pata të qartë se pa fare mundi arrita t'ia lexoj dëshirat artistike në sy, në fytyrë. E kisha ndjekur një shkollë të rrugëve disa vite me radhë të podrumeve, për të cilën edhe mora diplomë universitare. Mos të vijë kjo këtu si lëvdatë, në disa provime kisha marrë edhe dhjetëshe. Dhe, derisa unë pija verë dhe thellohesha në mendime profetike, Tata e Madhe e piu të veten, kërkoi falje se duhet të blejë diçka dhe u ngrit nga tavolina. Edhe këtë hap e pata të qartë, deshi të më hakmerret duke më lënë në duart e Xhadisë…

- A doni edhe një verë të kuqe? – E prishi qetësinë Xhadia.

- Po, iu përgjigja me zë të pakët, duke e ditur se Xhadia ia kishte qëlluar pikës sime më të dobët të luftëtarit me penë.

Xhadia u ngrit ngadal, duke më shikuar mua me bisht të syrit, se a jam i gatshëm t'ia shikoj vlerat artistike me të cilat ajo krenohej si e pakapërcyeshme në shtrat. Por, kur pa se unë nuk isha aty me mendime, nuk nguli këmbë, iku pas verës. Çdo gjë dija për Xhadinë sesi sillet në shtrat, një herë në një bisedë rasti unë e rrita aq shumë sa thashë: se ajo, kur bënë dashuri, e dridh si tërmet edhe pallatin. E dija edhe atë se Xhadia ndizet zjarr, rebelohet dhe di të të kafshojë si pelë e egër. Atëherë e ke vështirë ta urtësosh, ta sjellësh në vete edhe po ndejte me të pa i zbritur plot një javë…

- Gëzuar! E cakrroi me mua ende pa u ulur shtabën e verës Xhadia.

- Gëzuar! – E ngrita edhe unë me fund.

Xhadia menjëherë e mori shtambën tjetër dhe ma mbushi edhe një me grykë. Dikur u ngrit te vitrina dhe pas pak kohe u kthye me një tepsi me mish të pjekur viçi. Edhe atë e vendosi përpara meje mbi tavolinë. Një gjë duhet pranuar, Xhadia ia dinte rendin edhe verës së kuqe. Me këtë donte të ta bëjë me dije se ajo është e gjithanshme, di ta hedhë grepin edhe në ujë të pastër. Ajo kur donte dhe vendoste, kot mundoheshe t'i ikësh, më mirë e kishe t'i dorëzohesh vetë pa luftë, se të zente edhe pa krimb.

- I sheh ata që janë ulur përkarshi në atë tavolinë? – më pyeti Xhadia.

- Po.

- Ai njëri është Dr. Shul Butaku i Shtëpisë së mallrave. Tjetri pranë tij, Gungaçi, shitës i fustanave të grave. Ndërsa, ai në të djathtë me një torbë përqafe është Shitësi i lodrave kineze për burra.

Menjëherë, ai tjetri pranë tij është DoktorZiu, kontrollues i çmimeve republikane… Kurse ata tre të tjerët me mustaqe a pa to, janë praktikantë të arnimeve shkencore me pretendime karrieriste për t'u punësuar në Universitet…

E tha këtë Xhadia duke qeshur ëmbël dhe duke ma shtrirë dorën në mes të këmbëve. Unë ia tërhoqa, ngase e dija se*: betejat e përgjakshme kërkojnë heronj lufte e jo arnime letrare e shkencore*.

Ajo dikur u ngrit nga tavolina duke më tërhequr pas nga dera në korridor. Ta them të vërtetën, kësaj radhe nuk e kundërshtova, por acja pas saj sikur më shpiente mes luleve.

Ajo e hapi një derë, duke më tërhequr pas vetes, vetëm tani edhe unë arrita të lexoj në ballë të saj se shkruante WC. E mbylli derën, i lëshoi brekët në fund të këmbëve dhe e ngriti lartë fustanin. Unë vetëm tani arrita me të dy duart ta tërheq sa mundesha nga unë duke e pështetur me të gjitha forcat për muri. Ndërsa Xhadia, duke u rrokur me një dorë për litari të kazanit të WC –së, i ngriti hopa lartë këmbët duke m'i ngatërruar për mjedisi aq fortë, sa që përpak desh ma nxori shpirtin. Gjatë gjithë kohës sa zgjati kjo dhembje, unë nuk kam dëgjuar gjë përveç piskamës të pakontrolluar dhe zhurmës së ujit të kazanit të WC -së që është lëshuar shtatë herë me radhë…

## RRUMADUCI

> *"...KULTUROFAGËT, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten në plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t'i copëtosh, po jo t'i çqitësh nga trupi që kafshojnë e thëthijnë... që t'i çqitësh këta nga kolltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën po edhe këmbët e trupin..."*
>
> **Fan NOLI**

Ecën. Ecën Rrumaduci i skuqur si spec arapi me pleqërinë në shpinë dhe brekët nëpër këmbë rrugë e pa rrugë. Skeletin e tij të gjallë - lugat, dikush kur e takon hëpërhë në rrugë, e ka frikë. Ikin burrat e mençur. Ikin gratë azgane nga sytë - këmbët. Asgjë më Rrumaducit s'i ka mbetur në trup, qoftë edhe një arnë "vëllazërim-bashkimi". Asgjë. Asht e lëkurë. Dikush thotë se, Rrumaduci është libër i mbyllur në të cilin fshihet vdekja. Jo rastësisht, e ka mik shtëpie Doktorziun, shefin e Policisë letrare. Askush deri më sot nuk e hapi atë libër të shohë çka shkruan mes atyre faqeve, apo ta vrasë veten me ndonjë rresht të atij libri në mes të Bit-Pazarit. Shumica e kanë bërë edhe legjendë. Thonë se, në atë libër ka varre. Secili varr në rrasat e gurit ka emër dhe mbiemër. Ecën Rrumaduci, ecën ky libër i mbyllur dorë më dorë i ndërsyer pas porte me urdhër të Doktorziut dhe "vëllezërve" të Njerkës. E kanë frikë këtë libër të gjallët, e kanë frikë të vdekurit. Vetëm Profeti, qe

disa vjet këtë libër e ka në dorë dhe e bart me vete në çantën e zezë përqafe. E ka lexuar deri në faqen një qind e njëzet e pesë. Dihet, e pati vështirë për ta hapur atë libër, mes atyre faqeve të gërmoj me shat rrëzë Çukës. Edhe, më vështirë e ka për ta lexuar deri në fund. Frikë ka se, në ndonjë rresht të atij libri do ta vras veten. Dhe, do të vdes para Rrumaducit mes bërllokut pa e shkrepur edhe një plumb. Një ditë ju do të shkoni dhe mbi varr do të derdhni lot, mbani fjalime patetike, ngreni përmendore si dëshmor lufte.

Kush i ka faj atij që gjithmonë është marrë me marrëzira?! E ka zhveshur lakuriq Rrumaducin me shokë para syve të lexuesit nëpër libra. Kush do të derdhë lotë për të, kur ai është i keq, aq i keq, sa që me lotët e sojit të Rrumaducit do të lajë bythën. Cili do ta gjuaj xhenazen e tij prapa maleve, do t'ia japë vizën për në Xhenet. Profeti i ka çelësat e Xhenetit. E dini? Jo, nuk e dini. Vetë nuk do të hyjë se ka bërë mëkate. Cilin do ai e dërgon në Xhenet. Ai nuk është hoxhë as prift.

Vetë e do Xhenemin, këtë e ka merituar si udhëtar i rreziqeve mes librave në bibliotekë. Përçudi, i pëlqen Xhenemi, se ai e do zjarrin… Flakën… E do dimrin, shtrëngatën, shiun, breshërin, akullin… Marrëzisht e do shëmtinë, varfërinë, Atdheun dhe Lirinë!… Nuk e do bukurinë, madhështinë… Jo, do ta hanë egërsirat! Kuptoni! Egërsirat! Po. Nëse, nuk e hanë Bolla me flokë kulaq mes fushës pjellore që rrezitet në Diell. Sepse, ai vetë, në një faqe të atij libri të rrezikshëm, e kërkon nateditë me pishë e qiri varrin e tij me libra…

Edhe, kush na shet sot moral, patriotizëm të rrejshëm?! Askushi. Rrumaduci, njëri nga anëtarët më besnik të Policisë Letrare me kokën në grazhd deri në vdekje. E shiti veten një asht, dje te Partia Komuniste, e shet sot te Partia Neokomuniste. Rrospia Mashkull me kokën te Partitë Politike Shqiptare e bythën te "vëllezërit" e Njerkës. Rrumaduci, që përderisa Profeti ndiqeshte fshatrave të malësisë së Shkupit, gjoja si i dërguar nga Kosova për të vepruar në Shkup dhe çështjen e shqiptarëve planifikonte ta zgjidhë me luftë, Rrumaduci shëtiste nëpër poste në redaksi duke i spiunuar kolegët e punës në polici e bërë cenzurë librave të shkrimtarëve shqiptar. Redaktor dhe zëvendësredaktor pa asnjëfarë bagazhi letrar, qoftë edhe një libër sa për farë duke i ndërruar vendet e punës sipas nevojës. Rrumaducin dhe sojin e tij unikat "krijues" që turren me të katra pas posteve politike në redaksi, publikisht e pyes: Pse Profeti me dëshirë dhe propozim të Xhaxhit Flokbardhë në atë kohë, nuk arriti të udhëheq revistën për fëmijë?! Përkundër dëshirës madhe të Xhaxhit Flokbardhë, kurrë nuk u realizua përpjekja e atij burri të penës e vizionari të madh të çështjes shqiptare.

E dini, pse?! Shkaku se, Rrumaduci me shokë edhe revistat për fëmijë i mbanin nën kontrollë dhe cenzurë policore. I hurit e i litarit mund t'i udhëhiqte ato revista shkollore, po jo edhe krijuesit e dëshmuar për fëmijë me një bagazh të madh letrar të përndjekur si të dyshimtë nëpër shkollat fillore anembanë Atdheut. Mësuesit e atëhershëm shkrimtar, kur niseshin në rrugë nëpër manifestime kulturore dilnin nga

shtëpia si autorë me dy sandëk në duar me libra, e jo si soji i Rrumaducit me duar në xhepa, që tashti para vdekjes u është tekur të bëhen edhe "shkrimtarë". Rrumaduci do të jetë ai, që për redaktor të revistës për fëmijë në mbledhje të redaksisë do të propozojë djalin e "Babait", mikun e tij dudum që e mbante për krahu në karrierën e tij letrare. Burri i botës, që gjatë ndryshimeve demokratike bashkë me "Babain" edhe pa lejen e Nënës Parti do të shkojë në Amerikë për pavarsinë e Maqedonisë pa vënë asnjë kusht për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Kryeredaktori i asaj gazete të "vëllazërim-bashkimit", që në atë kohë edhe me dy gishtat e Rrumaducit e shiti një kat të redaksisë për të mbetur edhe nje mandat ku edhe do të thotë: Unë jam kundër Profetit të vij në redaksi, por ju nëse u ka marrë malli mund t'ua sjellim fotografinë e tij ta varni nëpër zyra.

Realitet ky, që Profeti kur të dojë ka pasur mundësi të hyjë në atë redaksi si spiun, po e ka ditur se atje çdo i treti ka qenë spiunë. Arsye, që edhe i ka thënë Inspektorit të atëhershëm të sigurimit: Çdo të tretin atje e keni spiun. Çka ju duhet edhe një spiun tjetër në atë mes, nëse pajtoheni në atë Çerdhe të spiunëve mund të hyjë vetëm si shkrimtar. Patrioti i vonuar, edhe pse nuk e dinte gjuhën shqipe dhe jepte intervista si shkrimtar maqedonas, ishte më "i mençur" në ushtrimet akrobatike politike të asaj kohe, erdhi pa asnjë libër në xhep edhe përkundër këmbënguljes "patriotike" të Kryeredaktorit, iu hapën dyert krah më krah me dy-tre vende pune në radaksi. Kohë ajo qorre, kur krijuesit e

talentuar shqiptar bredhnin rrugëve si të papunë, ose ndiqeshin këmba-këmbës fshatrave të malësisë Shkupit si "nacionalistë dhe irredentistë". "Armiq të rrezikshëm për shtetin". Tashti, e shoh edhe pse qenkeni trembur nga krijuesit e "dyshimtë e të rrezikshëm" aq shumë në atë kohë (trembeni edhe sot, po u rrëshqitën këmbët – thyet kokën). Shkaku se, po të ishin atëherë krijuesit e vërtetë në atë redaksi edhe sot e kësaj dite do të ishte gjallë në mesin e shqiptarve e vetmja gazetë tradicionale në gjuhën shqipe me të gjitha revistat letrare për fëmijë e shkencore. Maqedonasit i ruajtën me xhelozi, i kanë edhe sot e kësaj dite të gjitha në numër, nuk u mungon as edhe një faqe. Pse soji juaj trusakatë nuk ruajti asgjë si trashëgim i shqiptarve nga ajo kohë për Ditën e sotshme?!

Policia Letrare dudumët i bëri edhe "shkrimtarë", që në Ditën e sotshme pa fije turpi të na shesin "mend, moral dhe patriotizëm".

Arsyetimi, është urdhëri nga lartë, i Bashkësisë Republikane të Kulturës në RS të Maqedonisë, që t'i dalin zot vendit të punës qoftë edhe me një paçavure. Falë Zotit, ishin gjysmanalfabetë: Patrioti i vonuar gjuhën shqipe e mësoi në redaksi me ndihmën e Rrumaducit, nuk merrnin vesh nga letësia, nxënësit e tyre nuk e mësonin në atë kohë alfabetin e gjuhës shqipe, nuk dinin shkrim-lexim. Përndryshe, do të na merrnin më qafë. Edhe pse, përditë nënshkruanin akuza denoncimi me shokë për kolegët e tyre si "armiq të shtetit" komunist, dhe pasi i botonin në gazetën e atëhershme të "vëllazërim-bashkinmit" si publikime serike "ekskluzive", i dërgonin edhe në

polici. Emrat e këtyre "patriotëve" shqiptar me nga dy kubure pa fishekë në brez ende "flejnë" nëpër arhivat e policisë jugosllave. Rrumaduci me shokë, që sot i shet popullit shqiptar "moral" dhe "patriotizëm", dy gurë e dru edhe sot si në atë kohë nuk i lë bashkë për ta futur kokën e bythën me të gjitha metodat policore përsëri si dje në ndonjë parti politike. Rrumaduci. që në mungesë të talentit dhe fakteve merret sot me gratë e hallkut, fëmijët e tyre dhe Muzat poetike të poetëve shqiptar.

Rrumaduci sot para vdekjes është nisur të bisedojë me varret. Rrugës në një kishë i rrëfehet si një Sanço Pançio shqiptar për "trimëri", shpërblimet e premtuara Doktorziut pas Altarit. E kërkon haptas për "flijime atistike" edhe një çmim shtetëror për merita "patriotike".

Përpiqet ta heq samarin e mëkateve që e ngarkoi vetë në shpinë gjatë kohës të shitjes lirë në Bit - Pazar: një torbë taxhi, ose një ashtë shpërblim. I mori më qafë në atë kohë të rrezikshme shumë kolegë të punës në redaksinë komuniste për një post zëvendësredaktori, redaktori përgjegjës në "gazetën e mjerimit". Mikun e Profetit dhe kolegun e tij të punës, pasi e përzunë nga puna e detyruan të bëjë vetëvrasje. Edhe vetëvrasjen e Profetit, moti e kanë paraparë dhe e trumbetojnë me të madhe në popull, e presin ditenatë si fitore në prehër të Njerkës. Karrierë "artistike-kulturore" bëjnë në emër të këtyre viktimave të pafajshme letrare: Kryeredaktorë, zëvendëskryeredaktorë e redaktorë përgjegjës, redaktorë të revisteëave për fëmijë, radaktorë të kulturës e edicionit të

botimeve. “Flijime artistike” ideologjike ushtronin në atë kohë si kalemxhi të Vetëshërbimit, që e mbanin me shokë nën kontrollë nateditë letërsinë shqipe. Përmëtepër, bënin edhe politikë “madhore” kadrovike letrare-artistike. “Vëllzërit” në besim ua kishin dhënë edhe sitën, edhe kallmin e gatimit në sofër. Saçin e çerepin ua jepte Nëna Parti Komuniste. Krijuesit e talentuar “nacionalistë dhe irredentistë” nuk kishin vend në këtë redaksi kokë e këmbë me frymë policore të “vëllaazërim-bashkimit”.

Vepër “artistike” kjo e duartrokitur nga vëllezërit e Njerkës dhe e arrirë “patriotike”, që më vonë do t’ia shohim sherrin ne si shqiptar, që falë këtyre “patriotëve” shqiptar nuk do t’i mbetet as nam e as nishan gjatë ndryshimeve demokratike.

Krah për krahu në sheshin “Makedonija” e hiqnin vallen e “vëllazërim bashkimit” me shami të kuqe përpara popullit shqiptar. Xhaxhi Flokbardhë, poet i posakthyer në atë kohë nga burgu shkaku denoncimeve politike në redaksi i pagëzonte me lloj-lloj nofkash artistike. Kurrë, nuk i thirrte në emër haramët e “vëllazërim-bashkimit”. Rrumaducin, e thirrte si “Sharpllaninac”. Tjetrin palaço me “Honxhobonxho”. Servilin, me “Nanaçi”. Xhaxhi flokbardhë nuk është më gjallë në mesin tonë, po “Sharpllaninci” si këlysh besnik i lindur me zgjebe i Doktorziut ende vazhdon të na ngatërrohet nëpër këmbë, jetojë e bëjë kërdi me shokët partizanë në emër të popullit shqiptar mbi kulturën shqiptare si anëtarë komisioni: i

planprogrameve shkollore, teksteve shkollore, lektyrave shkollore, “Makedonska knizhevnost” (Letërsi maqedonase), Enciklopedia maqedonase duke sakatuar deri në palcë pa mëshirë Letërsinë Shqiptare.

Rrumaduci nateditë, përpiqet t’i bëjë me arnime edhe sot dy fjali sakate bashkë t’i hedh në letër, po nuk i pjellë truri as edhe një bajgë. E ka mushkë katundi. Përpiqet të imitoj në shkrime Profetin, vjedhë pasukses stilin e shkrimit, figurat artistike-stilistike. Mendime e fjalë origjinale, herr si në kopësht të babait nga librat e Profetit kokë më kokë në bibliotekë. Duart i mbush plot me figura artistike, shprehje të vjedhura letrare pa asnjë pikë të derdhur djerse. Trusakati me shokë mendon se, kështu krijohet letërsia duke i arnuar shkrimet e tija teknefese me nga njëqind euro në Shqipëri e Kosovë që në fund i dalin pa mangë, as edhe për një struke. Asgjë nuk ka të veten origjinale ky kalemxhi Oborri i shitur me pak pare te vëllezërit” e Njerkës. Fundekrye vjedhje e hapur letrare në mes të ditës duke e mashtruar veten dhe lexuesin si autor i përjetshëm teknefes e plagjiator: Made in Policia letrare. Punë shkencore i nxjerrë Doktorziut në vlerësimet policore- letrare si kritik i vetëshpallur i “tabanit kombëtar”, të nesërmen t’i bie krahëve: Të lumtë, kështu krijohen vlerat e arrira artisike të shekullit. E meriton çmimin shtetëror “Nënë Tereza” për “humanizëm dhe aktivitet shoqëror”. Edhe pse, ti më tepër hiqesh si shkrimtar “ballistë”, nuk ka lidhje: Hije të ka kësaj radhe ky çmim humanitar shtetëror. Punemadhe, që ti deri më sot nuk ke bërë asgjë humanitare për shoqërinë. Rroftë miku

i Kabinetit të "Babait" që e ke anëtar komisioni dje dhe sot për çdo vjet jubilar në ndarjen e çmimeve kulturore të nivelit republikan.

Vitet ikin njëri pas tjetrit plot pordhë e piskamë. Zhurmë patriotike e kulturore. Rrugës nga kemi ecur të gjithë kemi lënë gjurmë të thella gati deri në brez, që nuk i fshin dot asnjë furtunë, asnjë Dimër. Erdhi koha të shkoj me Rrumaducin edhe në mesin e të vdekurve. Natën do të flej mbi varre. Ditën, dua të ha bukë me ta në një sofër! Në Qytetin e tyre veten e ndjej më të sigurt. Sa herë që të më teket mund të dal rrugëve, t'i bërtas hënës, ta shaj terrin, Rrumaducin me shokë… Ju do të thoni, nuk ke asgjë. Jo, kam me qerre sa të hanë edhe qentë. Kam pasuri, bukë, ujë… Nuk i dua këto! Nuk të bëjnë vetëm këto të lumtur!

E shoh Rrumaducin këmbadoras të lodhur se si hip kodrës te Guri Zi. Ehu, or Rrumaduc! Larg është Baba Tomori. Larg. Po edhe kaq vite të duhen të ngjitesh në majën e shenjtë, Malin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezi. Dhe, bëhet dashuri… Kthehu prapë, në bërllokun e Bit-Pazarit të marrësh edhe pak frymë para vdekjes! Atij mund t'i bëjnë vizitë vetëm haxhilerët. Ti nuk je haxhi, nuk i di rregullat dhe ligjet e Luftës me penë. Doktorziu me vite të tërheq zvarrë pas me zingjirë si këlysh me zgjebe. Kurrë, nuk u rrite në qen Sharri. Bagëtisë t'i dalësh zot me Bariun hedhur gunën krahëve mes maleve. Nën dardhat gorrice t' i mjelësh dhentë me kusi. Fatkeqësisht, ti e mjel Dashin me brirë rreth veshëve. Ujkun pasmesnate na e shti në vathë edhe këtë Mot të Madh (2012). Mund të të dënojë Zoti, të të vrasë me breshër, shi, rrufe…

Ndodhë, të shtjerë pamëshirë qielli në ty si Rrumaduc me zgjebe. Është rrezik të ngjitesh me gjithë këta qyrra lëvarë rreth gojës e mjekrës në Baba Tomor. Rrezik. Kësulën e zezë - leckë, rrase në kokë se fryen era e Bukoçit në Lëmë, thoshte dikur Nëna ime plakë me kaci në dorë përpara Shtëpisë!...

Papritmas, një degë qarri ia mori kësulën e zezë - leckë dhe ia fërfëlloi në ajër, teposhtë në përrua. Këmbët filluan t'i rrëshqasin kodrës, por ai i rraste thonjtë gjithnjë thellë e më thellë në batak. Ishte lagur e bërë qull, sikur ta kishte harruar dikush si leckë në shi me javë e muaj. Eci me mundime edhe tri metra zvarrë përmes baltës.

Mezi merrte frymë, po edhe duart e as këmbët më nuk e mbanin për fije bari si bërllok shqiptar. U rrokullis teposhtë kodrës bythekrye si një Rrumaduc mes lisave.

Ditën e nesërme, kur erdhi në vete Rrumaduci, pa se ishte shtrirë në gropën e një varri të vjetër. Vallë, mos paskam vdekur?! Për t'u vërtetuar, njëherë e luajti gishtin e madh të dorës. Pastaj, njërën dorë. Jo, qenkam ende gjallë. Dikur tjetrën, këmbët… Jo, jo, nuk paskam vdekur ende, o shokë partizanë me pushkën në krah! Ngadalë ngriti kokën, veten e pa si qyqe midis varreve. Këmbadoras u ngrit dhe e shikoi atë varr gjatë, gjatë…

- Më fal, o burrë! Përderisa qëndroja mbi ty kaq gjatë me siguri të ka rënduar trupi im kufomë e gjallë?

- Një ditë qentë do ta përmjerin xhenazen tënde, iu përgjigj varri.

- Po të ishe gjallë, me siguri do të ishe bërë si unë kalemxhi?… Doktor shkence… Politikan… Deputet i popullit… Ministër…

- Ti je i sëmurë! Unë jam me profesion kaçak i maleve. Edhe pas qindra vitesh, unë do të dëshiroja të bëhem prapë kaçak i maleve!...

- Qënke kokëfortë, rri në gropën tënde!

- Është më e sigurtë se biruca jote, në Bit-Pazar… Shpërblimi i "vëllezërve"…

- Ika, nuk mundem të merrem vesh me të vdekurit si ti në këtë kohë qorre.

- Hupu, se t'u ngrita me shpulla! Theje, qafën!

***Iku***. Iku Rrumaduci i zemruar me të sharat e varrit.

Nga frika iu ngatërruan këmbët dhe u përplas për një gur varri. Nëpër dhëmbë tha: - Ky me siguri nuk është si i pari. Është më i vogël. Ndoshta është ndonjë djalosh. E ka zemrën e butë…

- Ti po të ishe gjallë me siguri do të bëheshe gazetar?... Redaktor përgjegjës si unë në redaksi… Kritik letrar… Akademik…

- Mbylle gojën, këlysh me zgjebe! Shuaj! Unë jam hero. Ti je qen me zgjebe me bishtin nën këmbë nëpër Bit-Pazar…

- Më fal!

- Ti do hu shpinës! E di se, familja është e shenjtë?! Vetëm, spiuni prek në familje… Burri trim ka respekt për familjen…

- Edhe ti qenke si gjitoni yt, në rrugën tjetër, - i tha Rrumaduci.

- Nuk e ke mjaftë më taxhinë në grazhd gjatë gjithë këtyre viteve, i bërtiti varri. Ashtin e

Doktorziut?!... Shporrmu sysh! Shporrmu, se t'u ngrita me shpulla!

- Iku. Iku prapë Rrumaduci me brekët nëpër këmbë. E, ku të ikë më Rrumaduci me shokët partizanë më larg se nga varret, përveçse në hale?! E shajnë të gjallët, e shajnë të vdekurit. Në cilën gropë do të kapërdiset Rrumaduci me gjithë këto mëkate mbi shpinë? Jo. Rrumaduci s'ka ku të ikë më larg se, në hale. Ai bisedoi edhe me një varr.

Çka i tha ai?!... E dini? Jo, nuk e dini. Ishte im Atë… Nesër, do t'ia dëgjoni krismën te libri im më i ri me publicistikë letrare që pritet këto ditë të dalë në dritë: RRUFJANI…

**DEMI**

Vite më parë gjatë studimeve në Prishtinë, në një konkurs letrar të shpallur nga gazeta e përditshme "Rilindja" kam kunkuruar edhe me një tregim për fëmijë: *Sagjini*. Përçudi, tregimi në atë kohë bashkë me dy të tjerë u ble për botim. Edhe, u botua në "*Rilindja për fëmijë*" (1976). Ishin ato hapat e parë të mi në letërsi drejtë afirmimit si shkrimtar. Ose, ndryshe: vija si emër i ri premtues në letërsi përmes konkurseve letrare të asaj kohe. Arsyeja ishte se, shumica e redaktorëve në redaksi mendonin se isha pseudonim letrar. Interasant, për atë kohë, më lehtë e kisha t'i botoja krijimet e mia letrare me pseudonime, se sa me emrin dhe mbiemrin tim: Kalosh Çeliku. Nuk ishin shumë pseudonime: Kaemçe Çuka, Ilir Emini, Asdren Deralla, Xha Deralla, Ramë Çeliku e ndonjë tjetër, që nuk më kujtohet tashti pas kaq viteve.

Vite më vonë, atë punim letrar e botova edhe në librin me tregime për fëmijë: *Lepuri me pushkë* (Shkup, 1983). Kritika letrare e priti mirë si libër me tregime në atë kohë. Edhe lexuesit e vegjël e gëlltitën me një frymë. Ndonjëri nga ato tregime përfundoi edhe në librat e këndimit kokë më kokë me shumë shokë nëpër shkolla shqipe.

Gjysmë shekulli më vonë e sjell si ribotim në këtë shkrim një fragment të atij tregimi interesant për fëmijë që edhe sot rrëfen histori:

*… Dy ditë para Plaku i fshatit doli te kodra dhe thirri që atë ditë të gjithë fshatarët, burra e gra, të mblidhen te xhamia. Ditën e caktuar në fshat u*

*dukën njerëz të armatosur gjer  në dhëmbë. Flisnin një gjuhë që s'ua merrte vesh as dreqi. Këta duhet të ishin pushtuesit. Fshatarët qysh herët i kishin lëshuar shtëpitë dhe kishin dalë te xhamia. Vetëm Rama i vogël kishte mbetur duke ruajtur kafshët në livadhin e madh, përpara shtëpisë. Ushtarët hynin e dilnin nëpër shtëpia, thyenin arka dhe pastaj mbasi merrnin me veti çka ju pëlqente atyre, disa shtëpive ua vinin zjarrin. I tërë fshati vlonte nga pushtuesit. Sëfundi disa hynë edhe në shtëpinë e Ramës. Rama i shikonte me urrejtje nga Lisi midis livadhit duke ruajtur kafshët, i pafuqi t'i ndalë pushtuesit të mos e plaçkisnin shtëpinë e tij rrëzë Çukës.*

*Pas dy orësh kontrollimi pushtuesit dolën nga shtëpia me disa plaçka në duar. E kishin gjetur edhe mauzerrin e babait që e kishte fshehur në hatulla. Një ushtar mbante në duar disa tesha dhe florinjët e nënës sime. Disa të tjerë muarën nga kasolla pesë-gjashtë kosha me kashtë dhe i derdhën para pragut të derës së shtëpisë. Donin t'ia venin zjarrin. Në oborr hyri një epror ushtarak i stolisur me dekorata lufte. Me siguri ai do të ishte udhëheqsi i tyre. Mbasi i mblodhi ushtarët dhe biseduan diç, për Ramën e vogël të pakuptuar, i mlodhën plaçkat dhe u nisën nga lëma. Shtëpinë e lanë, nuk e kallën. Kur ranë nëpër livadh, përpara shtëpisë ku kullosnin kafshët, kah ata u turr Sagjini – kau që Rama i vogël e donte më së shumti. Ushtarët duke mos qenë të përgaditur nga kjo e papritur, ua dhanë këmbëve.*

*Por Sagjini me brirët e tij e rrëzoi për tokë një ushtar të armikut dhe e la pa frymë. Një ushtar tjetër shprazi automatikun në kaun e fuqishëm e guximtar. Sagjini lëshoi një zë të tmerrshëm dhe pas disa hapash u rrëzua për dhe. Pushtuesit e muarën ushtarin, i cili nuk jepte shenja jete, me zorrët jashtë dhe u nisën teposhtë livadhit. Rama i vogël vrapoi dhe u sul mbi kaun, duke derdhur lotët rrëke. Ia vuri veshin në krahëror. Ai nuk merrte frymë. Zemra e Sagjinit kishte pushuar.*

*Në mbrëmje kur u kthye babai i Ramës nga malet në shtëpi, ai ia tregoi ngjarjen dhe e luti babain që t'ia bëjnë një gropë dhe ta shtinë Sagjinin në dhe. Babai e kuptoi voglushin – ia plotësoi dëshirën. Baba e bir, me lot në sy, Sagjinin e shtinë në dhe, nën hijen e lisit midis livadhit përpara shtëpisë. Edhe sot dihet vendi, nuk është rrafshuar me tokë. E, Rama sa herë që kalon nëpër livadh nuk e lë pa kthyer kokën kah ish shoku i tij nën hije të Lisit midis livadhit.*

*-Të tilla ishin ato ditë të tmerrshme... - më tha xha Rama - kështu ishte atëherë kur u dilnim përballë hordhive pushtuese…*

*Prishtinë, Rilindja 1976*

Edhe, e dini ku e pata qëllimin në këtë shkrim?! Jo, nuk e dini si lexues. Patjetër, duhet t'ju hap rrugë mes këtyre rreshtave, hyni krah për krahu në këtë portë historike. Sagjini, si e patë edhe më lartë në tregim, ishte emri i kaut të zgjedhës, që gjatë okupatorit pushtues me brirë i rrëzoi në mes të livadhit disa ushtarë të armikut.

Vërtet e humbi jetën, po nuk mundi ta duroj dot këmbën e huaj pushtuese. Robërinë.

E ky Demi ynë i sotshëm melez i rritur dyerve të hallkut nëpër botë, nuk është në gjendje sot të rrëzoj në mes të livadhit as edhe një lopë. Qafën vetë e futë në zgjedhë. Vetëm e vetëm për një krah kashtë në grazhd. Ose, një torbë taxhi, pasi ia heqin zgjedhën nga qafa në lëmë. Dhe, e lidhin me kërpesh për brirësh në Livadh.

Padashtas, mes këtyre rreshtave më kujtohet Mirko Gashi, një poet i madh bohem shqiptar, kur gjatë një ore letrare lexonim poezi në një xhami të Kosovës. E gjithë kjo ndodhte shkaku Serbisë shoveniste, që pas demonstratave të ’81 -shit na i mori të gjitha të drejtat kombëtare dhe institucionet arsimore e kulturore. Dhe, ku të lexonim poezi në tjetër vend më të sigurtë, përveçse në xhami. Mirko Gashi i armatosur atë ditë me dy “kashikara” me raki rrushi në xhepat e gunës, lexoi plot emocione një poezi për Lumin.

Në bisedë e sipër, pas Orës së madhe letrare Gani Xhafolli i tha Mirko Gashit: Edhe Kaloshi është poet bohem si ti në poezi e jetë. Po, iu përgjigjë aty për aty Mirko Gashi. Vetëmse, Kalosh Çeliku është bohem i stilit të vet origjinal. Nuk gjason aspak me mua, as në poezi e as në jetë. Dikur, doli para të pranishmëve dhe e lexoi një poezi për Lumin e vogël, “*që ende nuk i ka mbushë dy vjet, e nuk do të lidhet në djep*”.

Dhe, u kthye në mesin tonë duke i kënduar ato dy vargjet e këngës popullore, që kurrë për së gjalli nuk i hoqi nga goja: “***Para se shpirti i ka dalë, i ka folë dy-tri fjalë***”…

## "VËLLAZËRIM - BASHKIMI" I NEOKOMUNISTËVE

Vite me borë. Dimri kur na e përplaste derën e Shtëpisë edhe ditën, edhe natën. Çatitë nga barra e rëndë, qanin gjithë natën, gati të na rrëzohehin mbi kokë. Muret, kur kishin veshë e nata sy, siç thotë populli. Ujku na uluronte në lëmë. Oxhaku mezi nxirrte tym mbi çati në qiell. Kohë, kur derën e kishim hapur për mikun, edhe armikun. Tjetër punë është ajo se, ne përveç mikut në atë kohë na trokiste në derë edhe armiku me diktafon në xhep. Sofrën e kishim të shtruar edhe për mikun, edhe për armikun. E prisnim sipas zakonit, traditës shqiptare. Padashtas, më kujtohet Nëna ime plakë, që nuk e shtronte vorbën me groshë në sofër deri në orët e vona, mos na trokisë në derë ndonjë udhëtar të cilin e ka zënë nata në rrugë. Gjumi, ne fëmijve të prapë na merrte shpeshëherë edhe pa darkë, kur gjithë natën e gjatë na këndonin zorrët në bark, përderisa xhindet na hidhnin dorë më dorë majë lisave.

Kohë ajo, kur një natë na trokiti edhe një "mik" i papritur me diktafon në xhep, të cilin e kishte "zënë" nata në rrugë. Dihet, tradita shqiptare, dera eshtë e hapur edhe për mikun, edhe për armikun. Derën ia hapëm "mikut" krah më krah. I shtruam sipas traditës edhe "bukë e kripë". Zemrën e mikriptësit ia hapëm për diktafonin e tij "kulturor" të fshehur në xhepin e setres.

Provokimet e herë pas hershme të misionarit policor "kodër pas bregu" për të na e plotësuar dosjen policore si familje. Dikur, pas mesnate edhe i shtruam qilimat me këmbë arushe në odën e miqve për gjumë ta kalojë natën.

Ditën e nesërme, kur dolëm në lëmë ta përcjellim "mikun", im Atë e shfrytzoi mosprezencën e tij disa metra larg duke lidhur këpucët te pragu i derës dhe më tha me zë të ulët te Lisi midis livadhit: kujdes ki nga ky "mik" i paftuar se, është spiun i rrezikshëm me tapi të UDB -ës jugosllave. E di, iu përgjigja t'im Ati. Vite me radhë ia kam mbushur barkun edhe kokën me alkool në "Menada". Në kulminacion të pijes, vetë e ka pranuar se është i paguar mirë si spiun të më përcjelli këmba-këmbës si "armik i shtetit".

Porosi të këtilla kur u ktheva në Shkup më vinin edhe nga Kosova. Teki Dervishi një shkrimtar i madh dhe i përndjekur me vite si i burgosur politik i Goli Otokut, "patriotin" e kishte nxjerrë nga dollapi i zyrës tij me shqelma në oborr. Punemadhe, që Rrumaduci ia kishte botuar një libër me vjersha "patriotike". Gjatë ndryshimeve demokratike edhe një tjetër mik ma tërhiqte vërejtjen për kalemxhiun besnik të Policisë letrare. Përditë më dërgonte pas miqve të penës porosi nga Prishtina të kem kujdes dhe t'i ruhem këtij soji të "patriotit" me bateria që në atë kohë e shtëtisnin "vëllezërit" redaksi më redaksi me shkollë fillore sipas nevojave të Policisë letrare. Një ditë, për "flijime artistike" e "armatosën" edhe me diplomë fakulteti.

Banesë e privilegje të tjera që i jep vetëm Policia letrare për "suksese" në fushëbetejën antishqiptare. Policia letrare, përveç diplomave universitare jep edhe tituj shkencor e vende pune në Universitet për partizanët e Shtëpisë Publike. Përçudi, ky soj "patrioti" nuk kënaqeshte vetëm me përndjekjen time nëpër fshatrat e Malësisë së Shkupit, po e ndiqte edhe rrethin tim latrar anemabanë Atdheut. Paditur unë, në emër timin shkonte dhe takoheshte me miqt e mi duke u prezentuar edhe si mik shtëpie. E shfrytzonte rastin në emër tim të botojë edhe ndonjë vjershë "patriotike" provokative për shokun Tito në gazetë. Një Zot e di me çka i provokonte në atë kohë miqtë e mi të penës në mes të ditës para syve të Policisë letrare. Ndonjëri, po të ishte gjallë, ndoshta edhe do të thoshte ndonjë fjalë sot, kur "vërshima" demokratike i nxori mbi sipërfaqe të ujit si kunguj stambolli. Fatkeqsisht, ata që sot do ta ndjenin veten më të lumtur kur do t'i shihnin emrat e këtyre "patriotëve" në listën e spiunëve, nuk janë më në mesin tonë krijues. Megjithatë, duhet të jenë të lumtur edhe atje mes varreve.

Shqiptarët njëherë e pëgjihmonë shpëtuan nga soji i këtyre "patriotëve" me dosje policore.

Vite më vonë, vetë do të flas koha me gojë. Libri i tij fundekrye përkushtime për shokun Tito do të botohet para librit tim me poezi për fëmijë: *Zogu erdhi me një këngë* (1982). Edhe atë, e pa dritën falë dy patriotëve të mëdhenj shqiptar dhe burrave të penës: Mehmeadli Hoxha dhe Abdylazis Islami.

Edhe pse, unë vija nga një shkollë e njohur letrare e Kosovës: Esad Mekuli, Vehbi Kikaj, Ymer Shkreli dhe Musa Ramadani. Vështirë në atë kohë mund të dilje me libër, kur përveç talentit kërkohej edhe ana tjetër e krijuesit bashkëpunor me librezë partiake, bagazh "talenti policor". Përmëtepër, o Imzot mos pyet po të ishe me prejardhje balliste. Shpërblimi, me "shqelma" partiak të hidhnin nga përpilimi i antologjive poetike të asaj kohe. E pësoje jo vetëm ti si poet, po edhe propozuesit e tu në atë antologji politike me masa standarde partiake, ose përzënje nga puna në rrugë në mes të Dimrit. Dëshmitarët, ende janë gjallë dhe rrëfejnë "mrekullira" në përpilimin e atyre antologjive poetike. I lumtur duhej të ishe që nuk përfundoje në burg. Aftësi e madhe duhej për t'u përvjedhur syve, veshëve dhe bërrylave të tyre partiak me thikat në brez, që përgjonin edhe matanë mureve. Unë pata fat në jetë, e thashë edhe më lartë: Derën e krijimtarisë letrare në Shkup ma hapen krah më krah Mehmdali Hoxha dhe Abdylazis Islami. E di se, po të mos ishin këta dy krijuesë shqiptar, moti do të kisha përfunduar në katund si bari i deleve, në burg ose si i çmendur rrugëve të qytetit me gunën e zezë deri në fund të këmbëve. Meritat krijuese për të dalur unë në sipërfaqe si krijues u takojnë atyre burrave të penës, ndërsa mua talenti, puna dhe përndjekja e pamëshirshme deri në vdekje.

Edhe sot, "miqtë" tanë që i kemi ushqyer me bukë, i shohim në sipërfaqe mes bërllokut aq pisa, aq të mjerë po si në atë kohë të rrezikshme komuniste.

Populli shqiptar i nami: i vraftë buka e Zotit! Edhe, e shihni se i vrau buka mu në këtë Mot të Madh (2012). E dini për cilën kohë e kam fjalën?! Kohën e rrezikshme të Doktoziut me shokë. Vite ato, kur krijuesë me "gabime politike" ishin të detyruar në emër të tyre të shkruanin libra dhe tema doktorature për avansimin e tyre edhe në jetën universitare. Kohë, kur në Kuvendin e Shoqatës të Shkrimtarve Shqiptar (1998), në shkollën fillore "Liria" përpiqeshin të më shkarkojnë me të gjitha metodat komunsite nga posti i kryetarit. Rrumaduci me urdhër të Doktorziut në gazetën e "vëllazërim-bashkimit" do të m'i ndërsej këlyshët me zgjebe. Vallë, nuk u kujtohet ajo kohë, kur ministri i informatvae nxirrte shkumë nga goja?! Këlyshi i Sharrit me shokë… Tata e Madhe?!... Këlyshi i Llagut…

Këlyshi me zgjebe i Bit-Pazarit që doli nga kontejnerët e Vetëshërbimit me një asht në gojë në dyluftim… Rrumaduci, gjoja për ta ndarë mejdanin?!... Nuk ju kujtohen, hiç fare ajo ditë historike?! Shkolla policore e Beogradit kur i nxori "haramët" nga brezi në mes të Shkupit. Përderisa, njëri nga ata nuk u ngritë dhe tha: Nëse vazhdoni kështu me etiketime, shpifje e sulme policore, do t'i hapim letrat. Argatët e Policisë letrare e shikuan njëri – tjetrin, i shtinë "armët" në brez dhe e mbyllën gojën. Cilat "letra" i hapnin këta "intelektualë" shqiptarë?!

Përfundimi: Kjo është një arsye e fortë, pse njëzetë vjet me radhë nuk mund të dalim nga ky qorrsokak politik mes Motit Madh (2012). Them qorrsokak politik: Shkaku se, vetëm hidhnu një sy

veprimeve të tyre politike! Përderisa, këta kalorës të arratisur na prijnë në ballë, ngatërrohen nëpër këmbë edhe sot me të njëtat metoda policore "shpëtimtare". Kualicione për të ardhur në pushtet bëjnë edhe me Partinë Neokomunsite. Rrufjanët e popullit shqiptar, ulen në sofër me antishqiptarët e përbetuar komunnist, "armiqt" e tyre gjoja të djeshëm politik, vetëm e vetëm që të vijnë në pushtet. E shitën me votën tonë demokratike dje toptan popullin shqiptar, e shesin sot dhe do ta shesin edhe nesër, po nuk i hudhëm kësaj radhe me duart tona në koshat e plehërave historik. I ndërrojnë partitë politike natededitë si kurva - burrat: vendet e punës dhe postet politike, po jo edhe hujin e vjetër policor që e kanë në gjak e shpirt brez pas brezi.

Koha është, në këtë Mot të Madh (2012), shqiptarët këto rriqra politike nga herdhet dhe nënsjetullat e partive politike shqiptare t'i përzënë po qe nevoja edhe me shqelma në rrugë mes bërllokut. STOP, Dexhallit me vulë në ballë, që i bie përmes Çarshisë me muzika. Përndryshe, edhe gjatë kohë kjo farë e keqe hithre do të na mbi në oborr, ngatërrohet nëpër këmbë si ndonjë lënjë e kalbur kungull stambolli.

Hi-hii-hiii… Vërtet, shumë shpejt i paskeni harruar ato "ofanziva të përgjakshme partizane", po nuk i harroj unë autori i këtij shkrimi. Edhe, shumëçka di për kalorësit e arratisur sa janë patriotë e trima, po nuk ua them të gjitha në Motin e Madh (2012), i ruaj me fakte për Ditën e gjykimit që nuk është larg, vjen më këmbë.

Sojit juaj, sot vetëm duart u kanë mbetur mbi sipërfaqe të uji në hurdhë duke pritur ndihmën e

"vëllezërve" (Partisë Neokomunsite) në breg. Përmëtepër, nuk i dini edhe ligjet e Natyrës për të mbyturin: Vetëm tri herë me radhë i mbyturi del në sipërfaqe të ujit. Rrezik është t'ia shtrish dorën se, i mbyturi të tërheq me vete në fund të hurdhës. Rrumaduci më kot turret me të katra nëpër dimitë e partive politike, as ato nuk mund t'i dalin sot në ndihmë dudumit "shqiptar". Gjurmët e tyre të thella nga kanë ecur si zvarranikë, nuk i fshin dot asnjë borë e madhe, asnjë fortunë Bukoçi.

Zoti, tashti më i ka marrë në dorë rrufjanët. Nesër, do t'i lexoni në faqen e internetit nga Komisioni Lustrues të shpallur si "dëshmorë lufte për liri". Punemadhe, është vonë dhe nuk meritojnë hakmarrje. Rrufjanët na kanë shkatërruar si personalite shqiptare. Hundët i kanë futur edhe në familje. Këmbën në fyt ia kanë vënë shoqërisë shqiptare. E di Zoti si duhet vepruar me spiunët e këtij soji, që edhe në Ditën e sotshme, në Njëqindvjetorin e Pvarësisë të Shqipërisë përpiqen të na ngatërrohen me të njëjtat metoda policore komunsite si dje nëpër këmbë.

O Imzot, mos m'i nxirrni para syve palaçot se, do t'i vjell edhe zorrët!...

V LUFTA PËR PUSHTET E VESHUR KUQEZI

## KËLYSHËT ME ZGJEBE NDJEKIN AUTORIN

Të gjithë jemi të sëmurë!
Të sëmurë jemi!
Të sëmurë!...

Ç'dreqin ke që çirresh në këtë kohë qorre, iu kërcnua Nata. Vërtetë, do t'i bindësh edhe banorët e mi të urtë se ti je i çmendur. Unë e di se, të paktë janë ata njerëz që flasin mirë për ty rrugëve. Thonë se, je i çmendur. Natën vonë ke derdhur ujë në sofër të xhindeve. Nusja e tyre me pashterkë të kuqe të ka në dorë. Përmëtepër, sipas Këlyshëve me zgjebe ti nuk duhet të vishesh me të zeza, po me të bardha. Përndryshe, do të të shpallin prift ose hoxhë. Halldupët, kërcnohen edhe se kanë "dëshmi nga institucione valide gjuhësore".

Përgjigjesh: Punemadhe, armët e zjarrit i kanë pa fishekë. Ose, me plumba qorra. Hi-hii-hiii… Kungujt e Stambollit, me cilat "dëshmi": të Policisë letrare?!...

Edhe ata pak miq që i pate, kur të shohin në rrugë ikin si të marrë. Vetëm Laura ecën gjurmëve të tua dhe e zë gjumi me emrin tënd në gojë. Ajo thotë: - unë kam besim në të edhe pse Rrufjani trumbeton se ai është i çmendur. Autori flijon veten për ju, o të poshtër! E ju një ditë do ta gozhdoni si Krishtin. Kryq. Shpëtoje, o Zot Profetin tim!...

Laura është e vetmja krijesë që e ka pas vetes nëpër Dimër. Të gjithë i kanë ikur edhe pse shumicën i ka pasur në dorë… Në kokë… Në zemër… Ndonjërin e ka futur edhe në xhepin e gunës së zezë… Çantë… E di, keni ikur që sot të ta shpallni të marrë, dhe Askushi t'ia bëjë edhe gropën. Natën ta mbulojë me kashtë ose gjethe. Kurthën, si te ajo anekdota popullore, që të rrëzohet vetë brenda bythekrye. Ose, pse ta fshehi këtu, t'ia lidhni litarin në qafë. Armiq! Edhe Laurën keni dashur ta bëni për vete duke përlyer fytyrën e tij me marrëzira… Mëkate… E di Autori, e keni dashur ju Laurën. Edhe sot e doni, gjithë ditën… Gjithë natën…

Një, dy… Treqind hapa… Katërqind… Katërqind hapa i ka kjo birucë me tri dritare deri te Lisi me degë të thata. Atë Lis pamëshirë e kanë rrahur stuhitë… Shiu…Breshëri… Rrufeja… Disa herë me radhë i ka rënë zjarri. Ja, shikoni ato degë të thata, ju flasin vetë me gojë. Pyetni! Në atë lis disa vite me radhë kanë bërë çerdhe lejlekët. Por, kurrë nuk janë plakur. I ka hëngër Nata. Autori vetë i ka parë nga biruca e tij, nëpër dritare, se si janë përleshur me terrin. Pasmesnate ua ka dëgjuar ofkëllimat nëpër errësirë… Përplasjet e fletëve… Piskamën e frikshme me ata veshë. Të nesërmen, ua ka parë vetëm puplat nëpër lëmë, majëlisi asnjë lejlek. Pas disa vitesh nuk ndërtoi më çerdhe aty asnjë zog shtegtar. Ikën edhe lejlekët. Mbeti vetëm Autori. Më kot i kërkonte me sy në lisa e qiell miqtë e vjetër. Edhe këngët e tyre kaherë kishin ikur larg, larg…

TERR. Terr është në Lëmë. Këtë natë shkruan poezi. Mos u hidhëro Laurë, pse këtë natë nuk ka

shkruar për Ty asnjë fjalë, asnjë varg! Sonte është i çmendur. E, Ai kur është i çmendur nuk do të shkruaj për Ty. Çka shkruan Autori? Poezi. Po, për cilët shkruan? Nuk përgjigjet… Autori është i çmendur. Ai nuk është urë. Nuk lakohet si thupër shelgu. Dikushi do që Autori të shkruaj bythprapë natën. Kurrë! Ai e ka kokën e tij në qafë… I mjafton ajo kokë sa të mos e harrojë Shtëpinë dhe të ecë rrugës me kokë të huaj në qafë. Këlyshët me zgjebe nuk i kanë kokat në qafë, po nën sjetulla ose te bytha. Ditënatë, lehin me të madhe pas Autorit. Përjagen, herë pas here nga frika edhe u shpëton në brekë. Struken pas porte me bishtin ndër këmbë. Autori, kur e kthen prapa kokën, i sheh aq të mjerë si buba me gjuhën e nxjerrur jashtë dypëllëmbë nga vapa. Mirë, u thotë: e di se lihni dhe plasët që t'ju shtrojë në sofër për darkë. Edhe jeni të lumtur të përfundoni në sofrën e tij si "viktima patriotike". Megjithatë, Autori kësaj radhe do t'ua falë jetën. Vëretet, e han qengjin… Delen Rudë… Mëshqerrën… Po, nuk i ha coftinat me zgjebe të sojit juaj unikat, t'i mbeteni nëpër dhëmbë. I dhimbseni ju vullnetarët e kësaj natyre "patriotike", nuk ua flugë puplat në mes të rrugës si lecka komuniste.

Vërtetë, ajo rradake pak është e rrokatur nga librat, por Autori e do atë kokë. Librat ia freskojnë, ushqejnë trutë. Ia japin shkopin me kërrabë të eci më sigurt me tri këmbë kah jeta pash më pash t'i bie Parajsës ose Ferrit. Troç, Autori do të jetë i çmendur! E kur do Ai vetë, pse ju bëni ish, kur s'u ka hyrë pula në arë? Sa mirë është të shkruash poezi, kur je i çmendur!

Sonte flet e shkruan marrëzira. Nëpër këtë shkrim ecë symbyllazi. Nuk i sheh pikat… Pikëçuditëset… Dy pikat… Tri pikat… Thonjëzat… Vizat… Kllapat… Të gjithë ju besoni. Vetëm Laura nuk beson në këtë natë.

- Laurë, sonte jam i çmendur, më beso! - Kurrë! – Unë me poezi do ta var veten në tra! – Ti je Profet! – Laurë, përditë Këlyshët me zgjebe më ndërsehen pas shpine… - Një ditë edhe do të të hedhin lule mbi varr rrëzë Çukës, fjalime patetike mbi kokë… Lotët e rrejshëm do t'ju shkojnë rrëke

O Imzot! Mëkate… Mjerim… Varfëri… Bërllok… Halldupë… Kunguj Stambolli me rrëfanga që i kanë mbetur në fyt Lopës… Këlyshë me zgjebe, që ende lehin në shkrimet e Autorit pas porte… Nateditë turren me të katra pas kryetarëve të partive politike si dhelpra pas herdheve të dashit, mos i bien udhës. E kanë shitur veten për një asht (titull shkencor), një torbë taxhi. I sheh në përurimet e librave "artistik" krah për krahu me partizanët e partive politike pa fije turpi, pikë gjaku në fytyrë. Jerm flasin para gazetarëve për librat e palexuar të politikanëve. I ngatërrojnë gjinitë letrare: nuk dinë çka është romani, publicistika politike. Duartrokisin dhe fotografohen para kamerave televizive si viça të palëpi të koperativave bujqësore në katund. Mezi i mban zorrët në bark nëpër këto tubime nga kundërmimi i erës keqe, i villet nga fundrrinat neokomuniste.

Përurimet e librave të tyre politik edhe nëpër katunde. Teatrin e fëmijve. Universitet. Si të ikë nga kjo birucë? Të gjithë shtiheni engjuj. Engjuj

nuk jeni të gjithë, o njerëz! Heu! Si ua prutë shpirtin në fyt edhe këtyre rreshtave. Autori dhe Laura të çmendur në Qytetin e qyqeve?!...

-Laurë, ec të ikim nga kjo birucë e fëlliqur neokomuniste!

E merr për dore dhe i ngjitet Lisit me degë të thata, matanë Përronit të Thanës. Një… Dy… Treqind hapa… Katërqind hapa… Shtriu dorën. I iku Dielli.

-Laurë, më iku Dielli! Jam i etshëm! Gji dua të pi nga ato Tri Zana të maleve! Gji dua të pi me dy shtamba! Fuqi për luftë me penë!...

## PARTIZANI I VOGËL ZBULOI SHOKËT

Pakgjë ka ndryshuar sot nga koha e "artë" komuniste. Partizanët me pushkën krahut edhe sot si dje dalin maleve e fushave për liri. Edhe, i rrokin në dorë armët për fitore. Fytas rroken me armikun shekullor, luftojnë lis pas lisi.

Vite me radhë kisha dëgjuar e lexuar në librat e këndimit plot rrëfime heroike partizane. Armiqtë se si, i mundonin robërit e luftës për zbulimin e shokëve. Metodat barbare jonjerëzore që përdornin për futjen e shokëve në lëkurë dashi. Shumica e atyre partizanëve edhe u vdisnin në duar okupatorëve pa i zbuluar shokët e idealit, luftës heroike për liri. "Vëllazërim – bashkim". "Atdhe të përbashkët".

Koha erdhi, edhe kësaj radhe pas lufte (2001) të kthehen në shtëpi burrat e pushkës. Ftakeqësisht, shqiptarëve u përsëritet historia. E fituan luftën. Lirinë. Paqen. Radhën e ka lufta me politikë dhe penë. Tashti, edhe dalin trimat pas lufte me armët në brez për mejdani. Cili ka luftuar më shumë se shoku për liri kombëtare. Cili ka qenë komandant e cili ushtar. Realiteti: të gjithë komandantë e vetëm një ushtar. Edhe ai, komandant "Askeri". Cila familje ka dhënë më shumë dëshmorë. Cili këngëtar do të këndojë më shumë këngë patriotike nëpër dasma. Cili poet më shumë të vdekur e të gjallë do t'i fus në libra. Interesant, e gjithë kjo ndodh në kohën e sotshme "demokratike" para syve të Komisionit të Lustrimit.

Patjetër, duhet të dihen spiunët dhe të përndjekurit politik. Ata të përvuajturit: "patriotët", që kanë luftuar me armë në dorë nëpër parti politike, Qeveri, kabinete, redakasi komuniste, ministri, e institucione të shtetit "demokratik".

Gabimi, trimat pas lufte edhe u rreken studimeve pasuniversitare, turren pas titujve shkencor. Gati të gjithë politikanët e djeshëm, sot janë profesorë universitar. Analistë politik. Nguten të shkruajnë kollumna si të përndjekur e të përvuajtur në sistemin e atëhershëm monist të shokut Tito. Partia komunsite këmba-këmbës i ka përndjekur me poste në redaksi, ministri e institucione të shtetit socialist. Përmëtepër, edhe i ka dënuar me burg partiak: u ka dhënë banesa komforne, honorare marramendëse, bursa për studime nëpër botë, tituj shkencor e vende pune nëpër Universitete.

E shi sot, në "demokraci të përndjekurit dhe armiqtë e shtetit", pa vetëdije probleme i nxjerrin edhe Komisionit për Lustrim: shkruajnë kollumna biografike si të përndjekur politik. Fatkeqësisht, siç duket këtë partizan të vogël armiku e ka zënë në gjumë rob lufte. Edhe, Partizani i vogël me pushkën në krah, këndon para popullit me çifteli këngë patriotike. I nxjerrë njëri pas tjetrit të gjithë shokët e "përndjekur" të luftës "ilegale" shqiptare me emra e mbiemra në mjetet e informacionit: gazetarë, shkrimtarë, akademikë, ministra, ambasadorë, deputetë, politikanë…

Fantastike, ë?! Pavetëdije Komisionit Lustrues ia ka lehtësuar punën në zbulimin e kodoshëve.

Përçudi, edhe sot si për inat nuk ka ndryshuar asgjë nga ajo kohë e "artë" komuniste. Partizani i vogël me pushkën në krah i zënë rob "demokracie", pa asnjëfarë ushtrimi të dhunës i zbuloi shokët e idealit, luftës guerile.

Ndalem mes rreshtave të këtij shkrimi artistik. Vërtetë, këta burra mejdani paskan qenë të përndjekur e të dënuar me burg institucional të kabineteve, punësimeve nëpër Sekretariate të Qeverisë, redaksive e minsitrive, që nga koha komuniste e deri te e sotshmja "demokratike". Individët e njëjtë, dje komunistë të shëtitur nëpër poste e kabinete, sot "demokratë" e patriotë të vonuar nëpër parti politike. Dorën në zemër, brutalisht i keni përndjekur dje me poste, vende pune, tituj shkencor e banesa shoqërore. I ndiqni edhe sot po me të njëtat metoda policore: dy-tri vende pune e honorare marramendëse nëpër komisione shtetërore. Dhe, falë miqve të tyre mezi i shpëtuan asaj torture të egër komuniste. Shyqyr Zotit, them me vete që nuk kam "miq", po kam "armiq". Ndoshta, këta të fundit edhe më mbajnë gjallë në jetë. Shkaku se, po të ishte puna e "miqëve", moti do të kisha përfunduar në burg ose varr. E them plot gojën: janë trima pas lufte. E meritojnë larinë, pas gjithë kësaj lufte të përgjakshme nëpër institucionet e Shtetit. "Flijimet e tyre artistike" na e sollën lirinë.

Shtetin e përbashkët multietnik. Arsye e fortë kjo, që Partizani vogël me pushkën në krah i zënë rob lufte për këtë arritje strategjike patriotike përgëzon merita institucionale: ua prezentoi Komisionit Lustrues edhe listën e " dëshmorëve "

të kombit. Kokë më kokë edhe sot si dje nëpër "manifestime kulturore", përurimin e librave "besceler" në Teatrin e fëmijve dhe Universitetin e Tetovës.

O Imzot, nuk i shihni edhe sot sa vuajnë e ndiqen për Atdheun me poste e çmime rebublikane nëpër institucionet e Shtetit të pëbashkët "demokratik"?! Unë i shoh, me rëndësi është t'i shihni edhe ju se si dënohen e vazhdojnë të burgosen me "dënime të rënda" në Shtëpinë publike. E them këtë, shkaku se: nuk dua të shkoni si cjapi te kasapi.

Ballukja e Ballit, pasi e kishte lexuar tekstin e analistit të "përndjekur", i pikëlluar ia kishte mbyllë telefonin. "I përndjekuri" nuk priton t'ju rrëfejë në "analizën informative" edhe se ka qenë në "ballë të oxhakut" të një partie politike. E në një "takim të paharrueshëm poetik" të kryeqendrës kulturore, ku vjershat e mrekullueshme" i kanë lexuar edhe dy "poete të rralla".

Vërtetë, paska qenë i "përndjekur hap pas hapi". Fajet e shëtitjeve nëpër institucione të Shtetit i ka Ballukja e Ballit, ish kryetar i një partie politike "demokratike", miku i të "përndjekurit" i "mbërthyer në kryq".

Vazhdon lista e miqve edhe me mikun e madh, që "i ka dhënë mundësi të krijojë institucione". Edhe me "shkrimtarin e veçantë dhe zërin e së vërtetës që ndodh këtu". Edhe me akademikun, profesorin universitar, ministrin, deputetin, me aktorë e piktorë. Fatkeqësisht, edhe me shumë miq të "shkëlqyeshëm, që nuk jetojnë më".

I "përndjekuri" më në fund ka edhe "miq maqedonas"… Edhe bullgarë... Edhe turq… Edhe miq të rinj, që ua adhuron talentin e "flijimeve artistike" në jetën kulturore e politike. Miq ka edhe në të gjitha partitë politike shqiptare: BDI, PDSH, në partinë e Rufi Osmanit. Edhe me themeluesit e PPD-së ka miqësi. Edhe… Edhe… Edhe plot "vajtime" të tjera e lotë si i "përndjekur politik" i shekullit.

Edhe, të "përndjekurit e sotshëm politik", pasi u kanë rrëshqitur këmbët në fushën politike, tashti merren me shkrimin e librave, "vizioneve politike kombëtare". Përfundimisht, pas gjithë dështimeve politike "t'i kthehen profesionit primar – shkrimit". Kulminacioni: paralejmërojnë se "vitin tjetër, do të sjellin një tjetër rrëfim.

Dhashtë Zoti, shqiptarët më në fund shpëtuan nga "politika e tyre madhore"! Politikanët e tyre besnik tashti e tutje më nuk do të merren me "politikë kombëtare", po me shkrimin e memuareve, librave "besceler"… Ashtu qoftë!...

## BABADIMRI "PUSHTOI" KUMANOVËN PARA VITIT RI 2012

Babadimri me thesin plot "dhurata" në shpinë e "pushtoi" Kumanovën para Vitit Ri 2012. Nuk kishte hipur në sajë si zakonisht duke e tërhequr drerët, po kësaj radhe i kishte hipur në shpinë Rosinantit të Don Kishotit. Përjashtim kishte bërë, nuk e kishte marrë me vete vetëm Sanço Pançon, po edhe Dylqinenë e Tobozës që e kishte fituar me luftë gjatë një dyluftimi të përgjakshëm me luanët antik, në Bit - Pazar.

Rrugën e "pushtimit" moti ia kishte hapur Edi Rama me librin e tij "*Kurban*". Erdhi nga Tirana në Prishtinë. Portat e Muzeut Kosovës, Teatrit të fëmijëve dhe Universitetit të Tetovës ia hapën krah më krah Kalorësit e arratisur neokomunistë. E "pushtoi" pa luftë pas Prishtinës edhe Shkupin e Tetovën. Don Kishotët dhe Sançot tanë, të frymzuar me dyluftimet e këtij Kalorësi të arratisur, pse edhe këta me thesin me libra në shpinë para Vitit Ri të mos i sulen Kumanovës heroike. Vatrës së krizës të luftës popullore të 2001 –shit. U hipën në shpinë Rosinatëve dhe gomarëve me samarë, i thirrën shokët e luftës: sonte do t'i biem Kumanovës. Qytetit tonë heroik, që shkau ende e mbanë nën këmbë.

I nxorrën armët e luftës mbi tavolinë, e ngritën zërin e kushtrimit: ne gjallë e Kumanova heroike nën këmbën e shkaut, kurrë! Thanë e çka nuk thanë atë natë. E lëvduan njëri - tjetrin si trima lufte, që nga koha famoze komuniste e dri më sot në këtë "demokratike".

I shanë partitë politike shqiptare, institucionet shqiptare që asgjë nuk kanë bërë për Kumanovën, në krahasim me këta kalorës të arratisur që e kishin vënë veten në "rrezik" brez pas brezi për zgjidhjen e çështjen shqiptare… Prandaj, kishin qenë të detyruar natën duke u maskuar si Babadimra në një rastorant t'i bien Kumanovës heroike me armë në dorë.

Gjithë natën hëngrën e pinë si "çlirimtarë e fitimtarë" lufte. Në fund, pasi e bënë me lëvdata e fjalë Shqipëri Etnike edhe u fotografuan krah për krahu para kamerave televizive si "komandantë" lufte. Gjysëm të dehur qafë për qafe me lotë ndër sy e puthën edhe flamurin kuqezi.

Edhe them vetmevete: patriotët e vonuar kuqezi nuk e dinë kur është mjaftë me këto "flijime artistike". Dhe, fund i dyluftimeve të zjarrta nëpër restorante fytas me shkaun. Përmëtepër, disa herë i them vetes se është humbje kohe, nuk do të merrem më me këta kalorës të arratisur. E sidomos pas frymëzimeve të dy librave të mi me publicistikë letrare: *Xhadia* (2011) dhe *Rrufjani* (2012).

Dhe, mu kur e marr vendimin, kalorësit e arratisur përsëri me dyluftimet e tyre për liri ma provokojnë pas gardhit dhe kënaqin lapsin. Edhe atë, plasa së qeshuri nga kurrizi me heroizmat e tyre para kamerave televizive për Shqipëri Etnike. Përditë e shoh se, është dalldisje kohe të merresh me këta kalorës të arratisur.

Shkaku se, i bëra të pavdekshëm si personazhe nëpër libra. E ata, kurrsesi të pushojnë së vepruari një ditë medyluftimet e tyre heroike për

Dylqinenë e Tobozës.Fatkeqësisht, nga beteja në betejë për fitore u pri Don Kishoti Shqiptar. Sanço Pançon edhe atë e ka pas me vete mbi gomar në çdo betejë në rolin e Babadimrit. Kësaj radhe, siç thashë më lartë vendosin t'i bien Kumanovës. Fytas të rroken me Bajlozin e Zi, që ka dalë nga deti dhe e kërkon për nuse Dylqinenë e Tobozës. Gjatë një nate i nxjerrin nga brezi të gjitha armët e ftohta e të "zjarrta" artilerike. Sulm nga toka e qielli. Gjakun për liri e derdhin përrua deri në gju, sa përpak në atë betejë të përgjakshme desh u mbyt edhe Rosinanti. Dunkishoti Shqiptar, nuk pati rrezik notoi matanë Vardarit deri te kabineti i "Babait". Babadimri me thesin e "dhuratave" në shpinë, kujtoi kohën e "artë" komuniste kur i madh e i vogël e prisnin te sheshi "Makedonija" të zbresë nga qielli me helikopter. Shpërblimet që ia jepte ai sistem me dy-tre vende pune në redaksi: gazetar me profesion të lirë, redaktor i revistave letrare, përgjegjës i edicionit të botimeve… Edhe gjatë ndryshimeve demokratike si "mik besnik i Abazit" me poste politike: drejtor i fondacioneve "humanitare", zv.drejtor i RTVM -së, zëdhënës besnik i Qeverisë neokomuniste nën hije në qiellin e hapur…

Sanço Panço "shqiptar" edhe sot si dje e ndjek nëpër beteja Don Kishotin Shqiptar. Herë pas here gjatë rrugës pas çdo beteje edhe e pyet "komandantin", se: kur do t'ia japë shpërblimin e premtuar si krah lufte. Don Kishoti Shqiptar pa i zbritur Rosinantit i përgjigjet: pasi Dylqinenë e Tobozës ta sjellim me koçi nuse në shtëpi.

Tashti, Sanço Panço i kënaqur me përgjigjen, i lumtur i kërcen gomarit në shpinë.

Beteja e përgjakshme për liri tashti zhvillohet jo në Tanushë, po në Kumanovë mes livadheve të Likovës. Don Kishoti Shqiptar, kur e sheh ushtrinë e armikut këmbëkryq nën çadrat ushtarake gjatë pushimit duke i pastruar armët e lufës, turrevrap me Rosinantin e ngre shpatën famëmadhe në dorë për luftë:

- Sanço, vrik thirri shokët neokomunistë! Sulm mbi armikun e pabesë, që përgaditet pas shpine t'i bie Kumanovës!

- O imzot Don Kishot Shqiptar, mos u ngutë t'i nxjerrësh armët nga brezi! Nuk është ushtria e armikut, po Bariu i staneve me tufën e deleve.

Don Kishoti shqiptar nuk e dëgjon bashkëluftarin, po i sulet kopesë së deleve me shpatë në dorë. Kërdi bën mbi ushtrinë e armikut. Përderisa, Bariu i staneve nuk e zdep çotek me kërrabë. Mezi e shpëtoi Sanço Panço, përsëri e hipi mbi kalë plot plagë. Rrugës mes maleve Don Kishoti Shqiptar në një lëndinë i sheh se si i kanë ngritur çadrat edhe Ushtrtia e Bajlozit Zi. Pa një pa dy i bërtet Sanço Panços me shokë:

- Sulm mbi ushtrinë barbare!

- Imzot, nuk është Ushtria e Bajlozit Zi, po Enciklopedia maqedonase!

Don Kishoti Shqiptar nuk e dëgjoi përsëri Sanço Pançon, po me të gjitha forcat i sulet Ushtrisë barbare të Bajlozit Zi. Sanço Panço, kësaj radhe me duar vetëm i mbylli sytë. Dikur, kur i hapi e pa komandantin e tij bythekrye në mes të lëndinës.

E kishin zdepur çotek kakademikët e shkieve. Përsëri turret dhe i ndihmon me plot plagë në trup t'i hipë Rosinantit në shpinë për luftë.

Kohë lufte heroike ishin ato, kur Sanço Panço me armë në brez ecte mbi gomar pas Zotëriut nga beteja në betejë për fitore. Herë pas here Don Kishoti Shqiptar edhe pse Sanço Panço nuk e dinte gjuhën shqipe e shpërblente me ndonjë plaçkë lufte: shkrimtar shqiptar në Letërsinë maqedonase, anëtar komisoni, çmim letrar…

Skandali i shekullit: Don Kishoti Shqiptar me Sanço Panço e shokë, janë të vonuar si patriotë shqiptar. Kumanovën para tyre e ka pushtuar poeti rebel Fadil Bekteshi. Përballë, këtyre kalorësve të arratisur që për arsimin dhe kulturën shqiptare deri më sot nuk e kanë dhënë nga xhepi i tyre as edhe një kafe. Edhe atë, as në kohën kur që të dy punonin në një redaksi komuniste. Dallimi, përderisa ky Sanço Panço shpërbleheshte me poste dhe dhurata, Fadil Bekteshi dënoheshte me përzënje nga puna. Rroga të sakatuara për çdo muaj dhe dy qese bombona t'ua dërgojë fëmijëve për Vitin e Ri, në Katund. Megjithatë, Fadil Bekteshi ka bërë më shumë se ky patriot i vonuar për Kumanovën. Fadil Bekteshi ka lënë gjurmë të thella në kulturën shqiptare, që nuk i fshin dot asnjë shtrëngatë, asnjë dëborë.

E udhëhoqi me sukses vite me radhë Klubin e Shkrimtarëve Shqiptar të Kumanovës, e themeloi Manifestimin Kulturor " Jehona e Karadakut ", nxorri në dritë revistën e parë letrare të pavarur shqiptare "Doruntina", botimin e librave…

E shi sot, Kumanova ia kthen borxhin me përurimin e kalorësve të arratisur, në rolin e

Babadimrave. Në prag të Motit Madh, nuk organizoi një orë letrare përkujtimore, një çmim letrar në emër të potit rebel. Përmëtepër, Klubin e Shkrimtarëve Shqiptar të Kumanovës ta pagëzonin së paku me emrin e tij si poet i kësaj ane. Vërtetë, Klubit të Shkrimtarëve do t'i kishte hije emri i tij, ndërsa kumanovarët nuk do të humbnin kohë me përurimin e kalorësve të arratisur, po do ta lanin borxhin që kanë ndaj këtij poeti shqiptar.

Turpi, në stilin e Migjenit nuk ka kufi: "*kafshatë që s'kapërdihet, o vëlla është mjerimi"/ kafshatë që të mbetet në fyt dhe të zë trishtimi*"... Qeshë Poeti i gjallë në varr me "flijimet artistike" të këtyre patriotëve të vonuar kuqezi. Edhe krenohet me grushtin e Migjenit, që "*mu në zemër i ka ra malit që nuk bëzan*". E ai kënaqet duke qeshur si vigan legjendar në varr.

Dhe, dikur nga zemra e plasur thotë: sa i lumtur jam mes varreve, nuk i shoh dhe dëgjoj marrëzirat e këtyre kalorësve të arratisur kuqezi, që i kanë hipur për së prapthi Rosinantit dhe gomarit për liri, Shqipëri Etnike!…

## LUFTA PËR PUSHTET E VESHUR "KUQEZI"

Përçudi, shqiptarët edhe sot e kësaj dite "i ndjek prapa historia". Luftë kanë bërë nëpër shekuj për pushtet. Edhe në kohën e Turqisë, edhe në kohën e Serbisë, edhe në kohën e Gjermanisë, edhe në kohën e Jugosllavisë, edhe në kohën e "demokracisë". Ose, siç kanë thënë Rilindasit tanë: "gjithë jetën punuan për të tjerë" e shumë pak për vete, i bënë shtete pushtuesit në dëm të Shqipërisë. Përmëtepër, kohë kjo kur ende nuk e kanë pasur dhe e kanë siç duhet një shtet natyral demokratik shqiptar.

Kurrsesi edhe në ditën e sotshme t'i bien kokës jo me gisht, po me grushta. Ndaluni, o burra shqiptar! Dorë mos vëni në rrëzimin e instituconeve shqiptare! Shtetin, himnin dhe flamurin shqiptar e kemi të përbashkët. Nuk i kemi dy-tri Shqipëri, po një Shqipëri. Faqezinjtë, që flamurin tonë kombëtar e kanë bërë flamur të partive politike, mund të mendojnë se sa parti politike kanë shqiptarët, po aq kanë edhe Shqipëri, Realiteti shqiptar e thotë të kundërtën, se ne kemi vetëm një Shqipëri. E kemi një popull. E kemi një flamur. E kemi një himn kombëtar. E kemi një Shqipëri.

Vërtetë të tjerët bëjnë luftë për pushtet, por ata me kohë i kanë realizuar shtetet e tyre demokratike. E shqiptarët edhe sot e kësaj dite ende nuk e kanë shtetin e tyre etnik shqiptar. Ju, do të thoni e kanë Shqipërinë. Po. Vetëm se, ky është një gjysëm shteti.

Shumica e trojeve etnike shqiptare, fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite kanë mbetur jashtë kufijve politik të Shtetit shqiptar.

Fatkeqësisht, edhe sot të gjitha organizimet festive kombëtare ende janë me ngjyra partiake. Populli shqiptar nuk është njëpartiak. Moti ajo ideologji komuniste ka përfunduar: Hëngër fiq dhe vdiq. Publikisht e ngrej zërin: së paku na leni të marrim lirisht frymë! Datat historike shqiptare mos i politizoni deri në palcë! Shkaku se, nuk janë data historike vetëm të një partie politike, pot të mbarë popullit shqiptar. Edhe Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar në Shkup do ta shënojë Njëqindvjetorin e pavarsisë të Shtetit shqiptar, po jo me ngjyra të veshura partiake. Takimet nën Rrap dhe revista letrare Stili 97, kryesisht do t'i përkushtohen këtij Njëqindvjetori të pavrsisë së Shqipërisë me ngjyra poetike. Manifestim Ndërkombëtar Kulturor ky në Shkup, që këtë Njëqindvjetor do të jenë Takime nën Rrap shqiptare, po jo njëpartiake të veshura "kuqezi".

Shqiptarët e sotshëm, njëherë e përgjithmonë duhet të pastrojnë me vetveten kryeneçe, të arriturat e Rilindasëve tanë nuk duhet t'i shndërrojnë në të arritura partiake. Populli shqiptar është Një. Nuk është dy, tri, katër e pesë parti politike. Festat kombëtare, secila parti kur është në pushtet do t'i përvetsojë si merita politike që vete. Fotografohen para kamerave televizive vetëm fytyrat e një partie politike, në vend që të festojnë së bashku krah për krahu e qafë për qafe të gjithë politikanët shqiptar.

Vaso Pashë Shkodrani e ka thënë: "Feja e shqiptarit, është shqiptaria. Unë them: Partia e

shqiptarit, është shqiptaria. Edhe një herë e them publikisht: kujt i duhen këto shënime përçarëse të datave historike njëpartiake?! Popullit shqiptar jo se jo! Atëherë, ju duhen partive politike për pushtet. Fatkeqsisht, e përsëris: populli shqiptar nuk është një parti politike.

Edhe, shqiptarët e sotshëm shkaku partive politike i "përzinë kësulat". Turren me të katra me dhunë të bëjnë "ndryshime" politike. E, harrojnë se këto ndryshime, luftë për pushtet bëhet vetëm atëherë kur të kesh shtet demokratik. Dorën në zemër, Shqipëria është shtet. Edhe Kosova. Edhe, e kuptoj luftën e tyre politike me mjete paqësore për pushtet. Po, nuk mund ta kuptoj luftën e tyre për pushtet në këtë Njëqindvjetor të pavarsisë së Shqipërisë. Kohë kjo, kur Shqipëria dhe Kosova së bashku me të gjitha trojet etnike shqiptare duhet të festojnë në këtë përvjetor madhështor. Ditenatë të punojnë për një të nesërme shqiptare. Shkaku se, Kosova është në formim e sipër të shtetit demokratik. Nuk duhet të humbin kohë duke u marrë me vteveten, luftën e klasave (partive politike) për pushtet. Merreni me mend, ende Kosova pa u formuar si shtet me të gjitha "nishanet", shqiptarët turr të bëjnë luftë për pushet. Pushtetin, që kryngritësit ua rrëmbyen me luftë armiqve historik. E shi sot, kalorësit e arratisur të veshur "kuqezi" duan të vijnë në pushtet me protesta "paqësore". Pavetëdije, harrojnë se pushteti fitohet me luftë, gjak. Poashtu rrëmbehet edhe me luftë, gjak.

Në kohën e sotshme me votën e lirë të popullit. Dhe, rrëzohet me votën e lirë të popullit.

Kalorësit e arratisur nëpër Parti politike, Lëvizje qytetare e Shoqata joqeveritare dhe "humanitare", në vend që të jenë një opozitë e fuqishme e partive politike shqiptare në pushtet, ato brenda një nate shndërrohen në parti politike me aspirata të sëmura për rrëmbimin e pushtetit me dhunë. Tymeflakë nxjerrin nga goja për bashkim kombëtar, Shqipëri Etnike. I skuqin sallat sportive e sheshet e qyteteve me flamuj kuqezi. E harrojnë se ai flamur e Shtet shqiptar ka ardhur përmes rrugës malore me anë të armëve. Nëpër dimër e verë. Shi, breshër e dëborë. Nëpër pusi e beteja të përgjakshme. Përmes rrebeshit të plumbave e predhave të armikut mbi kokë. Flamuri shqiptar nuk është pronë private, ose leckë me arna kujt t'i teket ta përdhosë e përbaltë, por simbol shtetëror.

Gjak është derdhur për këtë flamur kuqezi e Shtet shqipar. Gjak. Burrat e pushkës dhe penës që e zbritën fushave nuk kanë qenë të strukur në bereqetin e qeverive politike e kabinetet e presidentëve të shteteve. Grykës të pakënaqur, që në emër të popullit shqiptar duan të rrasin si thesin më shumë barkun se sa kokën.Koha është, shqiptarët kudoqofshin nëpër botë të mos bëjnë më luftë për pushtet, po luftë demokratike për Shtet etnik shqiptar. Ende nuk është koha që këta kalorës të arratisur nëpër Parti politike, Lëvizje e Shoqata joqeveritare dhe "humanitare" të bëjnë luftë për pushtet.

Tinëzisht të shfrytzojnë pakënaqsinë dhe varfërinë e popullit shqiptar për ta nxjerrë në protesta politike në rrugë. Mirë, thoni ju edhe ne si e gjithë bota përparimtare do të protestojmë në

rrugë. Demokracia i ka edhe këto veprime paqësore politike qytetare. Po, pajtohem. Vetëm, populli shqiptar gjithë jetën është me protesta politike në rrugë. Problem i madh është këtë popull si ta fusim në punë, nëpër institucione. E, jo ta nxjerrim në rrugë. Popull, që lehtë e nxjerrë në rrugë, po shumë vështirë e kthen në institucionet e shtetit.Tekefundit, shqiptarët janë në luftë paqësore, në mes të rrugës për shtet etnik shqiptar. Ditën që do të hipin në Baba Tomor, atëherë edhe do t'ju ketë hije të bëjnë luftë politike për pushtet.

Kundërshtarët politik, përveç armëve politike e ushtarake, kohën e fundit i kanë vënë në përdorim edhe librat publicistik. Fatkeqsisht, janë duke ua "marrë" bukën edhe shkrimtarëve. Turren me të katra anë e mbanë Atdheut duke i përuruar dhe shitur librat e tyre "kuqezi" të kripur me politikë përçarëse antishqiptare.

Lufta për pushtet sot nuk i ka hije as edhe Shqipërisë, që atë gjysëm shteti shqiptarëve ua la trashëgim Ismail Qemali me shokë. Shkaku, se: shqiptarët atij Shteti historik gjatë këtij shekulli nuk i kanë shtuar nga trojet e humbura as edhe një gur në kala.

Shqiptarët në jetën e tyre politike, është koha ta duan vetveten: Shtetin e tyre shqiptar. Pse jo, edhe Kosovën heroike derisa një ditë të arrihet bashkimi kombëtar.

Pastaj, të tjerët, "vëllezërit" e Njerkës. Edhe, jo rastëshisht, ne edhe në këtë Njëqindvjetor të Pavaresisë së Shqipërisë, merremi me vteveten: protesta politike në rrugë, luftë për pushtet. Armiqtë tanë shekullor siç duket i kanë shti thellë

rrënjët te populli shqiptar. Fatkeqsisht, ne me këta "vëllezër" e kemi përzi edhe gjakun. Kopilat që na i kanë lënë me shekuj nëpër këmbë, sot ngrejnë krye të veshur "kuqezi". E rrokin për fyti hapin tonë historik për Shqipëri Etnike. Edhe atë, kur?!... Tashti, kur Shqipëria në këtë Njëqindvjetor të pavarsisë ka të drejtë t'i kërkojë trojet e grabitura etnike shqiptare.

Politikanët shqiptar, patjetër duhet të ulen këmbëkryq në Odën e burrave dhe t'i bien kokës me grushta. Përkohësisht t'i lënë anash dyluftimet e tyre "kuqezi" për pushtet. Për ç'arsye deri më sot, gjatë këtyre njëqind vjetëve të Shtetit shqiptar, nuk e kanë bërë asnjë hap historik përpara, nuk e kanë lëvizur asnjë gur në Kalanë e Krujës të kryeheroit legjendar Skënderbeu?! Shtetin shqiptar, që e Shpalli me shokë Ismail Qemali në Vlorë. Mjerisht, edhe ky Njëqindvjetor i pavarsisë së Shqipërisë vazhdon të festohet me petkun e partive politike. Realitet i hidhur ky për një popull edhe këtë Njëqindvjetor, kur shqiptarët ende nuk janë të bashkuar në një shtet etnik. Edhe më vjen inati, edhe pas njëqind vjetëve, pse jemi nën nivelin patriotik të Rilindasëve shqiptar?!
Popull, të cilin e "ndjek prapa historia"…

## NAMQORRI NUK E SHEH RRUGËN E MESDITËS MADHE

Ditën, po shpeshëherë edhe natën, Shkrimtari e shihte Plakun me abetare me gunën e zezë krahëve se si hynte në Tyrbe. Disa herë, nga mendimet që i silleshin nëpër tru, ndalej në mes të rrugës dhe tinëz vidhte me sy burrin e botës, se si hynte me struken krahëve përmes varreve.

Ia merrte lakmi këtij plaku me mjekër, që hynte me aq guxim midis varreve dhe i shërbente madhërisë së Baba Shehut. Zemëroheshte, shpesh edhe e shante veten, pse ne të tjerët nuk e kishim një trimëri të tillë si Plaku me abetare. Pse ne nuk flenim si ai në rrugë… Tyrbe… Varre?...

Atje, o vëlla i dashur, e nisi rrëfimin Plaku me abetare, ka çka të të dojë zemra.

Vijnë pleq, plaka, fëmijë, cuca, nuse të reja… Sillen tri herë me radhë rreth varrit të Baba Shehut: te koka, te këmbët… Te koka, i lënë dy shtamba me verë të kuqe… Te këmbët: rroba… Para… Përçudi, një natë pa hënë e kam parë të

lutet mbi varrin e Baba Shehut edhe Namçorrin për Shqipëri Etnike. Uleshte e ngriheshte mbi varr si lugat. I pëshpëriste diç në vesh Baba Shehut. Dikur, e puthi varrin dhe iku me shpresë se Baba Shehu e ka shëruar nga magjitë, xhindet…

Punën tash e mora në dorë unë, plaku. Parat i futa në xhep. Rrobat njëra pas tjetrës në një thes të grisur me arna. Shtambave me verë të kuqe ua ngrita bythët në hava:

- Gët-gët, gët-gët, gëët-gëëët…

- Hu-hu… Hu-hu… Huu-huuu…

Në Fund u rash duarve si pehlivani i Shkupit rreth nuses që nuk iku me të tjerat në shtëpi, po me këmbëngulje priste ta shëroj Baba Shehu. E vesha dollamën e gjelbër. Shtëllungën e bardhë të leshit e vara për qafe dhe iu afrova nuses.

Hë e hëë e hëëë… Përsipër… Përfund… Përmbrapa… Bythekrye bashkë… Dikur, nusja u bë qull nga djersët. Atëherë unë biro, edhe njëherë ia përzura të gjitha xhindet dhe e përgëzova, i rash me shpullë bythëve: - me shëndet!...

Plaku me abetare kur ia tregoi Shkrimtarit të gjitha këto mrekullira, nusen me të cilën lënuri lesh arapi në dhomën e Baba Shehut, ai e harroi frikën. Shprehu dëshirë të shkojë edhe ai në Tyrbe, t'i presin së bashku krah për krahu të sëmurët, që vijnë t'i shërojë Baba Shehu.

Plaku me abetare nuk i kundërshtoi, por me një kusht që ai për të gjitha ato që do të bënin e shihnin me sy mos t'i shkruante nëpër gazeta, libra.

***Rafti me libra***. Plaku me abetare dhe Shkrimtari një mesdite vere, tinëz argatëve që punonin në fushë, hynë në Tyrbe. Dhoma e rregulluar aq me shije, thuaj se këtu jetonte me të vërtetë njeri e jo xhenaze, ia përziu trutë.

Filluan t'i merren këmbët… Mendtë… O Zot! Më mirë jetoka i vdekuri, se i gjalli! Tyrbja për të ishte një zbulim i ri në jetë. Shtrati i rregulluar me çarshafë të bardhë… Jastëkë për nën krye... Tavolinat… Luganiku… Magja… Karriget… Enët… Lëkurat e ogiçëve… Rafti me libra… Shkurt, s'ia kishte marrë mendja Shkrimtarit se Baba Shehu kishte qenë edhe adhurues i madh i librave. Vetë ai sa qe gjallë, ndërtoi Tyrben… Varrin… Solli çdo gjë që i nevoitej një njeriu në jetë pas vdekjes.

- Mirë, po kush e mbanë kaq në rregull këtë Tyrbe?

- Nuset e reja…

- Dhe unë, pse ia bëj gjithë këtë shërbim Baba Shehut, ditën, natën? Ose, pse ua përzë nuseve të reja, xhindet?

Edhe këso pyetjesh do të më bëni, e di… Ashtu e kërkon puna, he burrë! Ne të gjallët duhet t'i bëjmë të gjitha këto mrekullira, se të vdekurve u kanë mbetur vetëm eshtrat. E sa di unë, eshtrave nuk u duhet ushqim… Verë… Para… Nuse…

Më duhen mua, o burrë! Patjetër, mua, plakut. Ose, ndonjë tjetri kështu si unë, që nuk e ka kaq mirë në shtëpi. Zoti me të madhin e vet ka menduar edhe për ne të varfërit… Ose, siç thoni ju të mençurit për ne, "të krisurit". Shkrimtari u ngrit nga shtrati.

Ngadalë e ndezi fenerin mbi oxhak. Nëpër dritën e zbehtë mezi e dalloi në një qosh Plakun me abetare se si ia përzente xhindet një nuseje me pashterkë të kuqe. Edhe ky më nuk priti të mbarojë ceremonia, por vrik e vrik i shpërtheu pantallonat dhe iu afrua nuses që i rrinte te koka Baba Shehut. Këmishën e gjatë ia përvjeli duke ia hudhur mbi kokë dhe filloi t'ia përzejë xhindet.

Dikur, i larë në djersë, u nis kah rafti me libra dhe nisi t'i shfletojë disa tituj të dorëshkrimeve: *Pazari i grave, Shtrigani i Allahut, Rrufjani, Mëzati i tredhur kuqezi, Rrugaçja, Dalldia politike e butakëve, Delezet e nënkryeme kakademike, Lufta për pushtet e veshur "kuqezi"*

Në dorëshkrimin e fundit: ***Lufta për pushtet e veshur "kuqezi"***, padashtas te ***Ina*** lexoi mes atyre faqeve një koment të Namçorrit i fshehur pas pseudonimit "*Sharri*": *Na tregove se edhe Lidhja e shkrimtarëve do të festoj te rrapi. Ku ka Lidhje të shkrimtarëve në maqedoni? Mos mendon për atë që e ke uzurpuar ti para 20 vjetësh.*

Dhe, një tjetri te ***Zemra shqiptare***:

*Ah ç'na ka gjetur me ju sllavo shqiptarët*

*Zarel Golemi*

*Or ti zotni Kalosh!*

*Sëpari të sugjeroj që të mësosh mirë gjuhën shqipe(duke jetuar në troje të pushtuara nga sllavët s'ke faj) mbasi nuk di ku duhet vendosur "Q" dhe ku "Ç". p.sh. në shqip nuk shkruhet*

*"kryeneqe" siç e shruani ju por "KRYENEÇE". Megjithatë po i referohemi shkrimit tuaj dhe cilësimit që i bëni ju KUQEZINJVE të cilët me nder Sali Berisha i quajti faqezinj, dhe që ju e quani çështjen e tyre luftë për pushtet.*
*A mund të më thoni ju zotëri se ku është e keqja të kërkosh të marrësh pushtetin?Deri më sot si këtu dhe në mbarë botën, a nuk përpiqen miliona forca politike për të marrë pushtetin respektivisht në vëndet e tyre?Pse ju i përjashtoni kuqezinjtë nga gara për pushtet?*
*Mos ju ka ngelur sahati tek koha e pushtetit njëpartiak të terroristëve të kuq si në Shqipëri ashtu edhe në tojet shqiptare të pushtuara nga sllavët?*
*Mendoj se duhet të reflektosh dhe të mos e quash luftë për pushtet por garë për pushtet dhe e dyta askush që i thotë vetes shqiptar nuk ka të drejtë të përjashtojë kërkesën e bashkimit të kombit, ndryshe ËSHTË TRADHËTAR. Natyrisht që kjo do kohë POR DO BËHET SE S'BËN. Të përshëndes vëllai im shqiptar.*

E detyron autorin e këtij dorshkrimi t'i përgjgjijet: Humbje kohe është ta bindësh Namqorrin që nuk e sheh rrugën e Mesditës Madhe, e ku më dhiaret e Natës pa hënë. Përmëtepër, t'i thuash se nuk di të lexoj në gjuhën shqipe. Shkaku, se: ai e "njeh" më mirë se ti gjuhën shqipe.

Edhe atë, është "patriot më i madh se ti kuqezi". Përpiqet syrin e tjetrit ta "mjekoj", nxjerr ashkëlën e nuk ka aftësi shkencore nga syri i tij ta heqë trungun.

Namqorri "kuqezi" nateditë trumbeton bashkim kombëtar, e nuk e di se s'ka sy e as tru për t'u ngjitur dhiareve në Baba Tomor. Vendin e Perëndive. Tyrben ku pihet vera. Lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri me Hënën. Kokëshkreti, të gjithë ata që nuk i shkojnë prapa në këtë "betejë patriotike kuqezi", i shpallë tradhtarë.

Tjetër, nuk e ka të qartë Namqorri "kuqezi" se, me cilët shqiptarë do ta bëj "bashkimin e tij kombëtar", kur një pjesë të shqiptarëve jashtë kufijve politik ende i quan dhe ankohet: "*Ah. ç'na ka gjetur me ju sllavo shqiptarët*"???!!!... Përvetson pa pikë djerse mendimin tim që unë (K. Ç.) i pari e kam publikuar këtë pagëzim për "sllavo shqiptarët" e shitur dy-tri veta nëpër shkrimet e mia në mjetet e informacioinit. Edhe, atë: gjatë kohë jam marrë me ketë fenomen të çuditshëm historik shqiptar. Vetëm për dallim, ky "patriot kuqezi" të gjithë shqiptarët e këtyre trojeve etnike shqiptare jashta kufijve poilitik të Shtetit shqiptar i shti në një thes me arna për t'ia lidhur grykën nesër me një kordhë kanapi.

Pavetëdije, i harron ngjarjet historike shqiptare: se, po të mos ishte Isë Boletini me kosovarët trima, Ismail Qemali për Zotin vështirë do ta shpallte Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë…

**REBELJA**
*(Kush e lidh sonte të shtatën plagë. Thashë).*
**Hida Halimi**

Arratisja e papritur e një poeteje rebele nga mesi ynë letrar, është një humbje e madhe për Letërsinë shqipe. E sidomos për familjen, miqtë, manifestimet poetike, Kosovën dhe Shqipërinë.

Hida Halimi herët ka qenë krahu ynë i djathtë i Luftës me penë në Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar "Ditët e Naimit", në Tetovë. Kohë e vështirë ajo, kur vargu shqip ndiqej dhe dënohej hap pas hapi. Poetët merreshin në "biseda informative" në polici. Librat e tyre përfundonin si shtrigat në turrën e ndezur të druve. Vite, kur partitë tona politike shqiptare hoqën dorë nga Shkupi, "bënin politikë madhore" dhe strukeshin nëpër katundet e Tetovës, ne e futëm të parët vargun shqip në Bit-Pazar që jehonte nën Rrap deri në orët e mëngjesit duke pritur agimin.Vite më vonë, kur vargu shqip më kishte hyrë në Shkup, Hida Halimi do të shndërrohet Zanë e maleve në Manifestimin Kulturor Ndërkombëtar: "Takime nën Rrap", në Shkup.

Vit për vit do ta ngrej zërin për liri. Rrugë do t'i hapë Skënderbeut në Qafë Thanë ta shalojë kalin edhe në Bit – Pazar. Poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare do t'i dalin para heroit legjendar me vargje ta presin edhe në Shkup. Poezitë e saj rebele, moti e pushtuan Shkupin dhe lëshuan thellë rrënjë nën Rrap, qysh në kohën më të vështirë për shqiptarët: Luftën e Kosovës 1998

dhe 2001 -shit në IRJ të Maqedonisë. Atëherë, kur me vargje gjatë Orës madhe latrare i ulëm edhe tytat e tanksave në Saraj të Shkupit rrethuar si poetë nga të katër anët. Kohë e egër lufte ajo, kur vargu i Asdrenit ngriti krye: **Nuk duam gjë tjetër, nukë / vetëm ca armë dhe ca bukë.**

Dhe, tashti në këtë ditë zie, ato armë të fuqishme paqësore kanë çelur në lulezjarre krah për krahu me Diellin. Përsëri si dikur nën Rrap e ngritën zërin: *"Ia puthë këmbët, duart/ Dhe shenjën e hjekës humane./ Atë kryq druri/ Se shpëtimtari mungon*".

Poetja shtatë male larg e flug vargun: *"Për ullishtet e tim eti tha/ U flijova perëndive/ Lojën me trimat e fshatit mbi fiqtë e pikur/ Në rërën e nxehtë/ ninullat e ëmbla mbi djep/ Paqen e pleqërisë së kotur mbi furkën me lesh/ Epitafin ku udhëtarët e lodhur nga jeta/ Do t'i kërkonin prehje trupit tim të derdhur".*

Dhimbjen e shprishjes së Atdheut, përkundër një pjese të madhe të poezive atdhetare plot zhurmë, patetikë e trimëri të shpifur, që kemi pasur rast t'i lexojmë sidomos në vitet e fundit, Hida Halimi përkundrazi, e këndon me një qetësi të hidhur*: "Ia kënduan psalmet për bukurinë e gijotinës/ E ngushëlluan me dashurinë e mëshirës/ M'i thanë Ifigjeni, Rozafë.../ Një pëllëmbë shkrum ra mbi grafikën e Virgjëreshës Mëri.../ Kush e lidh sonte të shtatën plagë/ Thashë".*

Zëri kryengritës është ky, i poetes ebele që shpalon guximin e shpirtit të saj plot dashuri e etje për jetë dhe me sfidimin të pamëshirshëm

ndaj botës së mbytur deri në fyt në batakun e konvencës e të hipokrizisë. Atdheu kur është në rrezik.

Zjarr e flakë nxjerr me vargjet: *"Në ankthet e mëngjesit/ mos u fal për mua/ Nuk jam virgjëreshë e shenjtë / E virgjër është vetëm dashuria..."* Hida Halimi, me zërin e çiltër të artistes, e rrëzon fare lehtë piramidën e moralit të rremë, ngaqë ligjet e egër vetë jeta i zbaton pikërisht tek gruaja, duke ia besuar dashurinë dhe pavdekësinë. E gjithë kjo më së miri artikulohet tek vjersha *Etje dhe mall* e ciklit: "*Vendëlindjen e zgjedh unë*": "*Që kur e ngujova time bijë në mitër/ e di se s'jamë shterpë/ Më therin ijet/ E pres./ Në këtë natë të shastisur/ Desha ta shoh/ Ta prek/ Ta mbaj në gji/ Desha t'i them/ Arbëri si Beatriçeja*".

Vërtetë, papritmas e humbëm fizikisht një poete rebele të pazëvendsueshme të Rrapit, po ajo ende vazhdon të marrë frymë mes vargjeve, jetojë në mesin tonë të botës peotike. Ende i kemi gjallë nën Rrap Lulezjarret e saj, që do të shpërthejnë në të ardhmen edhe më me zjarr për çdo Pranverë…

**RRENA**

Vëllezër, pasi vetë unë plaku i kam sytë e zgjidhur, do t'ju lexoj një fragment nga Abetarja. Shkaku se, ndonjëri ose ndonjëra nga ju nuk di të lexojë mes rreshtave dhe nuk e kupton Shkrimtarin. Vërtet ka kryer ndonjë shkollë fillore, medrese në gjuhën e halldupit ose fakultet, po nuk di shkrim – lexim. Një Zot e di si e ka kryer atë shkollim. Natë e ditë duke u marrë me thashetheme nëpër çajtore, ose duke i falur të pesë vaktet dhe lutur Zotit para këmbëve të hoxhës në xhami. Kurrë në jetën e tij (saj), së paku nuk e ka lexuar as edhe një libër në gjuhën shqipe. Është koha të shohim ç'fshihet apo ç'na mësojnë gjithë ata rreshta në mes atyre dy kapakëve të Abetares.

***Rr*** *e madhe e shtypit*
***rr*** *e vogël e shtypit.*

## RRENA

Ujqërit janë banorët më të vjetër të Pyllit. Fisi i tyre është fis i ditur dhe trim. Bashkë jetojnë, bashkë gjuajnë dhe kurrë nuk e hanë djersën e argatëve. Banorëve tjerë të Pyllit u ndajnë drejtësi dhe më të shumtën e herave i gjykojnë natën. Heroizëm të pashoq kanë treguar në shumë beteja të përgjakshme për mbrojtjen e Pyllit. Nuk e shtypin asnjë fis të Pyllit. Banorët tjerë në vendin e tyre të lirë i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë.

Nuk e duan mishin e qëngjave se i kanë vëllezër…

Ky është ai fragmenti i Abetares për të cilin u thash në fillim se do t'ua lexoj fjalë për fjalë. Pikë për pikë. Në Abetare shkruan edhe për dhelprën, skifterin, korbin, zogun e keq… Hutin me veshë… Por, ju mjafton të dini vetëm fragmentin RRENA nga Abetarja. Mendoj kështu, se mua asnjë shkronjë tjetër nuk më ka marrë më shumë kohë. Derisa e kam mësuar këtë shkronjë dhe fragment, djersët më kanë shkuar çurg ballit. Në mesin e ditës kam parë ëndërra të frikshme. Kuçedrën me njëzet krerë… Dhëmbët e ujkut… Bishtin e dhelprës... Qikllopin me një sy… Shtrigën… Shejtanin… Lugatin… Tollosunin… Njëherit them, se po të isha nxënës i ndonjë mësuesi të vjetër, derisa ta mësoja këtë shkronjë, duart ku ta dijsh sa herë do t'i futja nga zori në mes të këmbëve. Patjetër, edhe do t'i fërkoja njërën me tjetrën… Hukatja… Pështyja…

Nën sjetulla… Nëpër xhepa… Sidoqoftë, unë këtë shkronjë e mësova në moshën shtatëdhjetëvjeçare. Plak me mjekër. I thinjur. Me shkop me kërrabë. I përkulur. Ju do të thoni vonë. Jo. Asnjëherë nuk është vonë të mësosh diçka, fundi i fundit qoftë vetëm edhe një rresht. Vonë është të mos e mësosh fare. Merreni me mend sa i varfër do të isha pa këtë shkronjë, pa këtë fragment të Abetares. Tenxhere…Në fund, lirisht mund të shtojmë edhe ndonjë rresht. Shkronjën **Rr** të madhe dhe **rr** të vogël të shtypit e kanë përdorë: Rrufjani, Hoxhë Efendiu, Lugati i Koçajve dhe ndonjë tjetër "patriot".

Aspak nuk është e sigurt që atyre të mos u jetë i njohur edhe fragmenti i Abetares, **RRENA**. Në doni të dini pak më mirë, ata edhe janë shërbyer me këtë fragment të Abetares. E kanë mësuar përmendësh, si Kur'an. Npër ata pak rreshta e kanë gjetur fjalën e kërkuar me të cilën i kanë shërbyer njerëzimit. E kanë gërryer dhenë para këmbëve të tyre aq tepër sa që janë në rrezik t'u shembet edhe ajo nën këmbë. Mundohen me thonj ta kthejnë atë dhe prapë, por nuk i lënë rehat sorrat. Ditë për ditë ua këndojnë këngën e tyre të njohur, vetëm me dy nota.

- Krrak… Krraak… Krraaak…

- Krrak… Krraak… Kraaak…

S'ka njeri që nuk e di këtë këngë. Është këngë që të nxjerrë sytë… Këngë vdekje… Varrim sorrash…

Është kohë mjegullash… Bie shi… Breshër… Shti rrufeja… Egërsohet lumi… dridhen këmbët e urave… Përmbyten shtëpitë… Varret… Ecin gjarpërinjtë nëpër ujë… Shpërthen zjarri… Flaka me gjuhë e lëpin qiellin… Digjen pyjet… Arat… Livadhet…

- Udhembarë, o plak! Ku je nisur kaq herët ende pa lindur dielli?

- Te karriga e Sheshit të Fitores, zoti Shkrimtar.

- Po, ç'ishin ato fjalë që i thoje rrugës?

- Marrëzira.

- Plak, për marrëzira ta vënë saçin e skuqur në kokë.

- Zoti Shkrimtar, një saç të tillë kërkoj, se duan të më dalin trutë.

- Plak, mos të ka rënë tokmaku në kokë?

- Jo. Më është varë për qafe një zile.

- Mos të marrin për dhi, qengj? Ruaju thikës së kasapit!

- Jo, zoti Shkrimtar. Jam mëzat. Dash me brirë.

- Plak, ta lagim fytin me nga një gotë me verë?

- Zoti Shkrimtar, po të duash e shterim edhe tinarin.

- Jo, plak. Tinarin do ta shterim tjetër ditë.

- Nuk më pritet, zoti Shkrimtar. Kam frikë mos vdes natën. Tinarin dua ta shoh të shprazur për së gjalli, ditën. Me këmbët e mia du të hyj vetë në Shtëpi. Xhenazja nuk hyn në shtëpi, por në varr…

- Plak, mos u ngut, ti ke Shtëpi!

- Kam, por nuk dua të hyj pasi të vdes, zoti Shkrimtar.

- Jo, plak. Ti në Shtëpi do të hyjsh më këmbë… Me këngë… Tupana…

- Zoti Shkrimtar, unë dua ta kem me vete edhe shkopin në dorë!

- Edhe shkopin, plak.

- Po, shaminë e kuqe?

- Atë do ta varësh në majë të shkopit.

- Zoti shkrimtar, më hidhet të qaj…

- Jo, plak. Do t'ia marrësh këngës. Sot kemi gëzim. Fitore.

- Çfarë gëzimi, zoti Shkrimtar?

- Të tregoj më vonë. Tani çoje gotën! Gëzuar!

(*Dy veta ballë për ballë zbraznin njëra pas tjetrës gotat me verë të kuqe mbi tavolinë. Fytyrat i kishin të skuqura flakë… Zjarr… E përqafonin njëri-tjetrin si fëmijë të përmalluar me vite e vite. Herë pas here bisedonin kokë më kokë.*)

- Zoti Shkrimtar, e di kush i mbytë fëmijët?

- Hesht, plak! Prit të vij dita!

- Po, ditë është.

- Ditë është, por pas ditës vjen nata… Terri… Rrugëve del Lugati i Koçajve… Dreqi… Bolla me flokë… Tollosuni…

- E di edhe kush hapën natën varre…

- Pssst! Mbylle gojën! Është herët, plak. Na tradhtojnë karriget… Tavolinat… Gotat… Dritaret… Muret kanë veshë… E, nata sy… Na i lidhin këmbët… Duart…

- Zoti Shkrimtar, nuk mundem më të hesht, do t'i them të gjitha një ditë. Numri i të pafajshëmve, viktimave shtohet dita-ditës.

- Plak, duhet të presim ditën! Nuk mundemi t'i bëjmë ballë tokmakut. Nuk jemi rritur me mish viçi, por me bukë misri…

- Zoti Shkrimtar, tokmakut, po qe nevoja do t'i përballojmë edhe me eshtra.

- Plak, o të gjallë, o të vdekur! Gëzuar!...

- Gëzuar, zoti Shkrimtar!

Akrepat e orës i shkilnin ngadalë numrat romake në mur. Dera mërzitej pse e prekte çdo dorë. Karriget qanin nën heshtje nën bythët e mëdha. Tavolinave u dridheshin këmbët pse mbanin gota në duar aqë të ndyra. Dyshemeja rënkonte pse e shkilnin këmbë bishash. Pasqyrat e varura në mur, fshihnin fytyrat me duar para kokave garroçe. Sytë të dhembnin kur i shikoje ato fytyra të shëmtuara të shitura, besëpërlyera…

- Plak, të ikim nga këtu se u qelbet fryma!

- Ikim, zoti Shkrimtar! Mbylle mirë derën, mos delë një erë e tillë në rrugë!

- Mirë thua, plak. Ajo erë coftinash nuk duhet të dalë nëpër Qytet. Është rrezik t'i krimbin edhe rrugët.

- Zoti Shkrimtar, nuk mundem më t'i shoh krimbat. Ecin nëpër mish… Kokë… Ujë… Bukë…

- Plak, ne hamë bukë me krimba…

- Hamë bukë me krimba zoti Shkrimtar, por nuk krimbemi.

- Është rrezik plak, krimbat të të ecin nëpër trup!...

- Zoti Shkrimtar, krimbat e prishin edhe gjakun.

- Plak, gjakun edhe zemrën… Po, shikoi njëherë ata dy njerëz! Sjelljet e tyre në rrugë, a nuk të shtyjnë të mendosh se disa njerëz u ngjajnë krimbave? Të erren sytë të thuash me plot gojën se njerëzit e kanë preardhjen nga krimbat. Të bënë ta hudhësh poshtë teorinë e Darvinit.

- Zoti Shkrimtar, asnjë mendimtar nuk mundet të më bindë, se të gjithë njerëzit preardhjen e kanë nga majmuni.

- Mua plak, ma merr mendja se me preardhjen e njerëzve duhet të merren edhe në të ardhmen mendimtarët. Ndodh që preardhjen mos ta kemi të gjithë nga majmuni! Mundet ndonjëri nga ne ta ketë preardhjen nga krimbi… Gjarpri… Qeni… Ujku… Dhelpra… Huti me veshë… Qyqja… Derri…

- S'di zoti Shkrimtar. Sjelljet e tyre në rrugë… Ecjet… Lehjet… Ndjekjet… Mashtrimet… Shpifjet… Shkeljet… Gëlltitjet…

Hë për hë, të shtyjnë të besosh edhe në të tjera teori shkencore…

- Plak, frikohem se njerëzit nuk e kanë preardhjen nga e njëjta shtazë. Disa herë ma thotë mendja se, Dravini e bëri me qëllim kur tha: njerëzit e kanë preardhjen nga majmuni. E tha këtë, se nuk deshi të ngjallë te njerëzit frikë… Armiqësi… Urrejtje… Tmerr… Luftë…

Frikohem mos njerëzit janë pjellë e luftës! Këta kopila që aq tepër e mërzisin njëri-tjetrin, mos kanë lindur tinëz në ndonjë kasollë me kashtë. Ose, kanë lindur me ndonjë njeri të planetit tjetër, në mes të grunajave. Plakat që u kanë dërguar bukë argatëve e kanë dëgjuar vajin e kopilit. E kanë mbështjellë në pashterkë dhe e kanë dërguar në shtëpi. E kanë ushqyer e rritur me shpresë se rrisin ndonjë fryt të dy të rinjve beqarë. Por, ai fëmijë që në djep ka filluar të bëjë me dorë e gojë:

-Bam!... Baam!... Baaam!... Ta-taa-taaa…

Plaka është trembur me këtë gjest  të fëmijës. I ka rënë krahërorit me grushta.

- Qyqja! Qyqja! Qyqja, unë! Ky fëmijë paralajmëron vdekjen. Është pjellë dreqi. Shiko si i rrotullon sytë nëpër dhomë! Me këmbëngulje kërkon të zgjidhet nga djepi. Dorën e luhat në ajër sikur pret koka njerëzish.

- Bam!... Baam!... Baaam!... Ta-taa-taaa!...

Më duket se turret nëpër dhomë me gjithë djep në kurriz. Më detyron ta lëshoj Shtëpinë. Bënë gjeste me dorë. E ngre njërën dorë lart, shtrëngon gishtat dhe me tjetrën korr. Oh, ç’gjë e tmerrshme! Kopili më bëhet zot në Shtëpi.

Më erren sytë ta kap për fyti dhe t’ia fus gishtat thellë në mish. Ta rrisësh kopilin në Shtëpi është aventurë e rrezikshme. E them këtë

se vjen dita kur ai kopil ta kërkon kokën. Ti do s'do, do ta kapësh kokën tënde për flokësh dhe do t'ia fusësh në gojë. Ai të nesërmen do të kërkojë kokën e fëmijëve. Edhe ata do të jenë të detyruar t'ia japin kokën, derisa ndonjëri nga ata nuk do t'ia nxjerrë shpirtin me gurë…

VI TRËNDAFILJA DHE FACEBOOK

## "ÇERTIFIKATA E SHKRIMTARIT" MERRET NË SHKODËR

Shqiptarët, vërtet nuk kanë ende Shqipëri Etnike, ama si e gjithë bota përparimtare i kanë edhe Don Kishotët e tyre dhe Sanço Pançot shqiptar. Historikisht, kanë pasur dhe kanë kuaj Troje, edhe gomarë me samarë. Patjetër, nga një Don Kishot dhe Sanço Panço duhet të ketë Tirana, Prishtina dhe Shkupi. Burrat e botës, pasi lanë name në politikë anë e mbanë Atdheut në rrëshqitje akrobatike në akull duke e thyer kokën, kohën e fundit e provojnë veten edhe në letërsi, përurimin e librave të tyre teknefesë Rrugës Kombit që ua ndërtoi Sali Berisha nëpër "Shqipëri Etnike". Thesin me libra në shpinë dhe turr me të katra në Prishtinë, Shkup, Tetovë, Kumanovë, Preshevë e Shkodër. I harruan vendet e punës, postet politike me të cilat për "flijime artistike" i shpërbleu Partia. Kopeisht, kush më i pari i sulmojnë universitetet shqiptare në plaçkitjen e studentëve si kusarët mes detit të hapur turren pas thesarit. Universiteti i Tiranës dhe i Prishtinës moti ua ka mbyllur dyert. Lëmë për të fshirë egjrën e tyre kanë gjetur në Universitetin e Tetovës.

Guximshëm me ndihmën e "salep-intelektualëve" i nxjerrin librat e tyre teknefesë mbi tavolinë duke i shtitur si dushk për gogla.

Në çdo përurim të radhës tymeflakë nxjerrin nga goja, aty për aty e bëjnë me fjalë bombastike

Shqipëri Etnike. Mes librave e ngrejnë edhe flamurin kombëtar kuqezi, si dikur Ismail Qemali në Vlorë. Tjetër punë është ajo se, flamurin e tyre këta "dëshmorë të demokracisë" në këtë njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë e heqin nga krahët si struke, ndërsa harrojnë se atë të Ismail Qemalit plot mundime e qëndisi brenda një nate Marigona. Falë Zotit, që nuk e heqin nga qafa e tyre shallin turko-arab dhe të na e ngrejnë në mes të sallës si flamur bardhezi shqiptar. Mund të ndodh edhe kjo një ditë, "Shqipërinë e tyre Etnike" aq të përfolur në mjetet e informacionit, nëpër debate e tubime festive të na e shpallin edhe me këtë flamur të ri që e bartin kudo përqafe nëpër fushëbeteja luftarake për liri.

E harrojnë kalorësit e arratisur, se kanë ardhur në përurimin e librave e jo të bërit "politikë madhore". Pavetëdije, i ngatërrojnë profesionet: shkrimtarin me politikanin. Ose, anasjelltas në mes të ditës kur dalin në binë, në ballë të popullit: I shajnë të gjallë e të vdekur, që deri më sot nuk kanë bërë asgjë për bashkimin e tokave shqiptare. Fytas rroken edhe me Skënderbeun… Ismail Qemalin... Isë Boletinin... Azem e Shotë Galicën... Bajram Currin e Kalosh Zajazin…

Armët i nxjerrin nga brezi për luftë heroike, liri ose vdekje: "misionin për përhapjen e të vërtetës historike për shqiptarinë e Shkupit." Shkaku se, shqiptarët deri më sot po të mos dilnin në skenën politike këta "burra mejdani", nuk do të dinin asgjë për të "vërtetën historike për shqiptarinë e Shkupit".

Paralajmërojnë: UÇK -ja pasi zbriti nga malet dhe i "dorëzoi armët", nesër ne "komandantët

trima” të vonuar do t’u ngjitemi maleve me pushkën krahut?! Ku ta dish, them unë: ndoshta edhe mund t’i ngjiten malit me “armët” e tyre në krah, po dihet vetëm si turistë. Edhe atë: vetëm në verë, se në dimër nuk ua mban bytha. E sidomos në ditën e sotshme kur secili shqiptar është më patriot se shoku. Trim mbi trima. Ose, siç thotë populli: Trimat, gjithmonë dalin pas lufte. Atëherë, kur ndahen postet në Qeveri. Plaçkat e luftës. “Stacion i radhës ishte Shkodra, një ndër qytetet më të njohura shqiptare për nga begatia historike dhe kulturore.

Në një natë të ftohtë dimri përplot me borë, biblioteka “Marin Barleti” në Shkodër  për dy orë rresht u shndërrua në një vatër të ngrohtë të dashamirëve të librit dhe historisë. Moti i ftohtë nuk pengoi shumë intelektualë të njohur shkodranë të marrin pjesë në promovimin e librave, për të dëgjuar të vërtetën historike të Shkupit të shkruar në një stil të përkryer eseistik nga ana e autorit” (?!...), që sot për sot ia “rrezikon” çmimin Nobel edhe të madhit Ismail Kadare. Edhe atë, merreni me mend: në kohën e sotshme kur nuk është i përkryer as edhe Shekspiri. Përmëtepër, në këtë fatkeqësi natyrore që nga të katër anët bora e ka rrethuar Atdheun. Shqiptarët, kur bëjnë luftë me vdekjen që u është ulur këmbëkryq te pragu i derës, përpara shtëpisë. Pyes unë, autori i këtij shkrimi: pse jo edhe në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, tre kryeqendrat shqiptare?!...

Vallë, mos është ky edhe një përurim i radhës provokues i kalorësve të arratisur?!... Përgjigjen le ta japë vetë lexuesi i nderuar mes rreshtave, që

i përcjellë me vite hap pas hapi "aktivitetet e tyre kulturore" të kalorësve të arratisur me "pushkën" krahut për Shqipëri Etnike.

Edhe, Sanço Panço ynë shqiptar me shallin turko-arab lidhur për qafe duke u përpjekur mos mbetet larg zotëriut të tij Don Kishotit të Tiranës me plot gojën thotë para të pranishmëve: "Jam i nderuar që gjendem sot në qytetin e Gjergj Fishtës, Marin Barletit dhe Shtjefën Gjeçovit. Unë jam i vetëdijshëm për shijen e përsosur të shkodranëve për kulturën dhe letërsisë. Prandaj sot nuk kam ardhur të lavdërohem para jush me veprat e mia, por kam ardhur para jush të marr certifikatën e shkrimtarit". Duartrokitje. Dhe, shtoj unë autori i këtij shkrimi: pse jo ta marrësh edhe çertifikatën e politikanit teknefes "kuqezi"?! Nesër, përsëri në emër të librit shqip me të katra t'u turresh posteve politike.

Vite më parë, vërtet kisha dëgjuar për shitjen e diplomave universitare dhe titujve shkencor në Qafë Thanë, po nuk kisha dëgjuar publikisht se, matanë kufirit shqiptar jepen edhe "çertifikata për shkrimtarë". Arritje historike kjo në këtë kohë moderne të shkencës dhe teknikës, kur shqiptari i sotshëm shumë lehtë bëhet jo vetëm politikan, po edhe shkrimtar i madh mbarëkombëtar. E boton "kryeveprën" e tij sakate në shtypshkronjë dhe me thesin e librave në shpinë, turret qytet më qytet të Shqipërisë Etnike të marr "çertifikatën e shkrimtarit".

Zbulim i ri i shekullit ky, ose mashtrim historik i të gjitha kohërave: shqiptarët më, tashti e tutje nuk do të kenë nevojë të turren pas diplomave universitare e titujve shkencor, po pas

"çertifikatave të shkrimtarit" me firma të institucionit të ri krijues në Shkodër. Kalorësit e arratisur, pas shumë përpjekjeve siç duket më në fund zbuluan një "shkollë letrare" për dhënjen e "çertifikatave të shkrimtarit". Hë për hë, ma kujtuan satiristin e mirënjohur Niko Nikollën, ku vite më parë në një manifestim kulturor për poetin Mehmedali Hoxha (1997), në Strugë tha: "Nuk ka popull shqiptar, po ka popull shkrimtar". O Imzot, na shpëto nga soji i këtillë me shumicë e pakicë i politikanëve dhe shkrimtarëve! Natë e ditë po të jetë nevoja do të të lutem edhe në emër të Krishtit e Muhamedit a. s., qoftë në kishë ose xhami.

-Hi-hii-hiii… Sanço Panço ynë modern hipur mbi gomar në mes të dimrit duke çarë borën e madhe në Qafë Thanë ka shkuar deri në Shkodër për të marr "çertifikatën e shkrimtarit", kur këtë punë ka mundur ta bëj fare lehtë edhe në Bit-Pazar mes Shkupit në ndonjë çajtore, te Pazari i Grave. Ose, çertifikatën e politikanit ka mundur ta marr te Klubi i tollumbave me firmë e vulë të Tatës Madhe. Hije vërtetë do t'i kishte ta merrte së pari nëpër këto "institucione" kulturore e politike të "vëllazërim-bashkimit".

E, pastaj ta shalojë gomarin e tij asht e lëkurë në këtë dimër e borë të madhe deri në Shkodër. Edhe atë, ende pa e marr në Shkup " çertifikatën e shkrimtarit ", i lufton me shitjen e librave në Shkodër "padrejtësitë që po ju bëhen shqiparëve të këtushëm... duke rikujtuar edhe njëherë se fajin kryesor për këto padrejtësi nuk qëndrojnë te maqedonasit por te vetë politikanët shqiptarë". Fytas krah për krahu me "vëllezërit" neokomunist

përpara Qeverisë rroket me "Enciklopedinë maqedonase", "Letërsinë maqedonase", që nga gomari i duken si ushtri armike e në dyluftimet luftarake i dalin mullinj ere në shkretëtirë. Përçudi, e lufton "Letërsinë maqedonase", në të cilën vite me radhë punoi zotëriu i tij si kalorës i arratisur i dëgjuar në këto anë, Doktor Ziu me shokë. Mezi e futi pas shumë përpjekjeve në këtë Brigadë luftarake të "vëllazërim-bashkimit" edhe Sanço Pançon tonë si ushtar.

Sanço Panço ynë modern gjatë atij përurimi si shkrimtar "nuk përjashtoi nga kritikat e tij as politikanët në Shqipëri dhe Kosovë, duke e përmendur bashkimin e trojeve shqiptare si një proces i cili do të shpëtojë shqiptarët, me thënien e njohur: "Shqiptarët po si bashkuan kokat, nuk munden t'i bashkojnë as tokat". E, harron ta pyes veten në ditën e sotshme, gjatë këtyre viteve të ndryshimeve demokratike, çka ka bërë ai në bashkimin e kokave dhe tokave shqiptare?! Asgjë, përveçse vrapimit pas shoqatave "humanitare", posteve politike dhe parave.

Kulminacion "idealist" kuqezi, i këtyre kalorësve të arratisur me thesin e librave në shpinë (njëri në Tiranë, tjetri në Prishtinë e i treti në Shkup), që më në fund me "luftë paqësore", shitjen e librave të tyre nëpër qytetet e "pushtuar" Arbërore kanë vendosur për inat të amerikanëve dhe gjermanëve ta "bëjnë" para kohe Shqipërinë Etnike. Pse jo, edhe ta shpallin në këtë njëqindvjetor të Pavarsisë së Shqipërisë?! Vetëm se, e kanë hallin te "bashkimi i kokave", prandaj edhe ende "nuk munden t'i bashkojnë tokat". Që,

ndryshe sipas tyre (kokave teknefese) do të thotë: të ecim pas gomarit.

Pavetëdije, harrojnë se poeti ynë për fëmijë Fejzi Bojku në Shkup, moti e ka arrirë këtë bashkim patetik kombëtar të kokave e tokave, qysh në kohën e "artë" komuniste me vjershën e tij të njohur në Librat e këndimit: " *Një tokë - një kokë*".

Fitore historike, ë?! Luftë heroike gjoks më gjoks me armikun e pabesë shekullor e këtyre dy-tre kalorësve të arratisur nëpër beteja të përgjakshme për bashkim kombëtar?! Dorën në zemër, edhe unë jam për ndryshime politike. Bashkim kombëtar. Shqipëri Etnike siç dëshiron i gjithë populli shqiptar. Po, jo me këta kalorës të arratisur, që njëzet vjet me radh i janë ngatërruar popullit shqiptar nëpër këmbë me poste partiake duke i ndërruar brenda një nate partitë politike si kurva - burrat. Edhe pse, kurvës i ka hije rrospillëku. E këtyre hadumëve nuk u ka hije as shalli turko-arab bardhezi. Tjerë burra do të jenë ata që do të bëjnë ndryshime në politikën shqiptare. Shqipëri Etnike.

Dhe, në fund më thoni: Cili shqiptar trim besa-besë me armët e luftës në brez do ta merrte guximin ta fus kokën e tij në një thes me këta "patriotë çlirimtar kuqezi" (që deri dje nuk e dinin as edhe se a janë shqiptarë), e sot dalldisen me shalla turko-arab për qafe e ferexhenë krahëve gjoja për Shqipëri Etnike???!!!…

## DUDUMËT NËN SJETULLAT E PARTIVE POLITIKE

Dorën në zemër, falemnderit Zotit që edhe ne shqiptarët një ditë arritëm të festojmë Njëqindvjetorin e Pavarësisë të Shtetit Shqiptar. Merita historike, dihet kanë Rilindasit tanë të penës e pushkës. Vetëm, pas kësaj vepre madhështore na lanë pas vetes edhe shumë probleme të pazgjidhura. Dihet, jo edhe me fajin e tyre se, superfuqitë na i futën mbi tavolinë gërshërët në Londër. E para: nuk e bënë shtet ashtu siç duhet me të gjitha "nishanet", po na lanë struke pa mëngë. E dyta: na lanë në gjysëm të rrugës. Dhe, e treta: nuk e ndanë egjërin nga gruri. Përmëtepër, me gjithë byk na futën në hambar. Shkak ky, që edhe sot e kësaj dite kemi probleme. Lëmsh i kemi bërë profesionet. Politkani merret me arsim e kulturë e mësuesi dhe artisti me politikë.

Ilustrimi më i mirë është Dita e sotshme e Njëqindvjetorit të Pavarësisë të Shqipërisë. Ditë, kur shqiptarët kurrë nuk kanë qenë më të përçarë se sa sot në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë të shtetit shqiptar. Turren me të katra duke u shtyrë me bërryla pas posteve politike. Themelimin e partive të reja politike për ta përçarë edhe më tepër këtë popull. Ende pa i vënë çatinë Shtëpisë, luftojnë për ndarjen e lugëve dhe enëve. Arat (trojet), dihet ua kanë lënë armiqëve shekullor. Ditë kjo, kur të gjithë shqiptarët nguten të shpallin e dekorojnë sa më shumë heronj dhe dëshmorë familjar, miqësor e klanor  të Atdheut.

E në anën tjetër, i harrojnë emrat e personaliteteve historik, që vërtet i kanë dhënë shumë arsimit dhe kulturës shqiptare. Fatkeqësi kombëtare, për këtë popull liridashës që Ferexhezeza e ndjek si hije me vite e vite.

Dudumët dhe gjysmanalfabetët edhe sot vendosin për fatin e shqiptarëve. Nuk bëhet fjalë këtu për bukën e gojës, vendeve të punës dhe posteve partiake, por për çështjen shqiptare ende te pazgjidhur edhe sot e kësaj dite. Bukë dhe ujë shqiptari ka pasur gjithmonë nëpër shekuj, po i ka mungurar liria. Shteti etnik shqiptar. Pavetëdije, që përsëri e ka lënë në duart e dudumëve dhe gjysmanalfabetëve nën sjetulla të partive politike.

Përditë i sheh para kamerave televizive pa fije turpi se si fotografohen plot zhurmë e piskamë edhe këtë Njëqidvjetor historik. Vetëm se, të shkretët kanë bërë pak punë për t'u krekosur si gjelat mbi gardh, thirrin agimin. Anembanë Atdheut festojnë të përçarë sipas bindjeve dhe tekave të partive politike. Secili më patriot dhe trim se shoku. Merreni me mend në këtë Ditë festive të Motit Madh, ata merren me njëri-tjetrin "zbulimin" e dosjeve komuniste. Luftë bëjnë për pushtet. I vizitojnë të vdekurit, u vënë kurora lulesh mbi kokë sipas arshinit dhe bindjeve të partive politike. Ndonjëri, më guximtari u thotë diçka, ndonjë fjalë sakate edhe mbi kokë. Përçdudi, them me vete: si nuk zgjohen ata të vdekur nga varri dhe t'i përzënë me shqelma halldupët.

Njëqind vjet është dashur të presim ne shqiptarët që publikisht pa frikë të vishemi kuqezi, përbaltim flamurin kombëtar edhe mbi

varre. Shkollat dhe rrugët t'i emërojmë me emra të personaliteteve shqiptare. Edhe pse, këtë punë shumë më parë, më në nivel dhe me tru e ka bërë Ernest Koliqi, si ministër shqiptar i arsimit.

Kohë ajo, kur i mbuloi me mësuesë vullnetar nga Shqipëria të gjitha trojet etnike shqiptare. Shkollat shqipe i pagëzoi me emra të personaliteteve shqiptar. Vetë, për bela arrita pak ditë të jem dëshmitar i gjallë i asaj kohe para perëndimit të "Shqipërisë Madhe", mësuesit kur vinin në shkollë me kësula të bardha. E hapnin orën e mësimit me himnin kombëtar dhe vjershat e Rilindasëve nëpër librat e këndimit: Naimit, Fishtës, Pashko Vasa, Asdrenit, Çajupit e Ndre Mjedjes me shokë. Në fotografi, në fund të vitit shkollor kur e gjithë klasa dilnim me kësula të bardha.

Vite më vonë (1979/80), kur do të kthehem nga Kosova si mësues nëpër fshatrat e malësisë së Shkupit, do t'i gjej gjurmët e tyre  të thella ende të pashlyera mes këtyre maleve. Përinat, edhe pse këto shkolla periferike ishin nën gunën e shkollave qëndrore maqedonase, ende i ruanin me xhelozi emrat me të cilët i kishin pagëzuar pishtarët e parë të arsimit: "Skënderbeu", "Ismail Qemali", "Fan Noli", "Naim Frashëri", "Pashko Vasa", "Asdreni", "Liria", Faik Konica… Posta dhe revistat shkollore: "Fatosi", "Gëzimi" dhe "Pionieri" nga Kosova edhe në atë kohë  të errët komuniste, na vinin me adresë në emër të këtyre personaliteteve shqiptar. E di, ju do të thoni: kush ua ka vënë veshin juve atje mes atyre maleve. Pushteti i atëhershëm komunist, ndoshta edhe as që e ka ditur se ju  frymoni, ende jeni gjallë në

mesin e egërsirave. E vërtetë, në këto male siç duket nuk ishte ngjitur dot as turku. E dini pse, jo nuk e dini.

Edhe unë u habita me traditën dhe mikpritjen e këtyre malësorëve. Shtëpitë pa gardhe e mure. Nuk kishin as xhami të fshatit, po kishin shkollë në gjuhën shqipe. Gratë e pambuluara të përshëndetnin kur të takonin në rrugë. Traditë kjo, që nuk ndodhte në Shkup. Edhe pse, Shkupin e dija si qytetin më fanatik në botë, për shkak se këtu e kisha kryer shkollën e mesme normale. E dija e dhe si merr frymë. Vetëm, në atë kohë i dija dy-tre fshatra shqiptar, edhe atë falë shokëve që i kisha në klasë. Nuk e dija se këtyre maleve nuk ishte ngjitur dot as këmba e turkut për ta përhapur fenë islame me fanatizëm. Vonë, shumë vonë (1980), unë me ardhjen time si mësues nëpër këto fshatra të malësisë së Shkupit, do të mësoj se: Shkupi nga të katër anët ishte i rrethuar me fshatra shqiptar. Padashtas, në atë kohë mësova se këta banorë ishin të regjistruar si turq, edhe pse nuk e dinin asnjë fjalë në gjuhën turke. Fshati Tisovicë, ku punoja unë në fillim si mësues, i gjithë fshati me dhunë ishte shpërngulur në Turqi dhe pas një muaji pasi atje nuk u kishte pëlqyer jetesa, përsëri i gjithë fshati ishte kthyer në vendlindje.

Regjistrimi i vitit 1981, do ta ndryshojë shumë situatën e këtyre anëve. “Turqit”, kësaj radhe do të regjistrohen si shqiptarë. Numri i nxënësve në shkollën e vetme fillore në gjuhën turke “Tefejuz” me mësuesë shqiptar, do të bie dukshëm nga viti në vit.

Ndonjëri aty-këtu ende vazhdon të regjistrohet si "turk", pa e ditur edhe një fjalë të vetme në gjuhën turqishte, po kjo është tjetër punë, histori më vete e kësaj ane den baba den shqiptare me të cilën duhet në të ardhmen të merren historianët.

Në këtë shkrim, nuk e pata këtu qëllimin, Shkupin e banuar me shqiptarë. Fjalën e kam në tjetër vend, "kodër pas bregu". Emërimin e sotshëm të shkollave shqipe, rrugëve dhe institucioneve shqiptare. Aspak, nuk jam i kënaqur me propozimlistat e dudumëve dhe gjysmanalfabetëve shqiptar nën sjetullat e partive politike. E kanë bërë lesh e li politikën, arsimin dhe kulturën shqiptare. Haj ta zëmë në atë kohë u kishin faj "vëllezërit", po sot në ditën e sotshme kush e ka fajin?! Edhe atë: në këtë kohë kur kemi me dhjetra parti politike shqiptare, nga dy-tre Lidhje e shoqata të arsimatarëve, Unione të intelektualëve, institucione kultorore.

Ende nuk dinë cilët emra mund t'i bartin shkollat shqipe, e cilët rrugët, institucionet kulturore shqiptare. Përgjumshëm, propozojnë emra aty ku nuk e kanë vendin si personalitete. Me siguri ata emra i kanë dëgjuar në xhami, nëpër çajtore ose gjatë fushatave zgjedhore të partive politike. Asgjë nuk dinë më shumë për këto personalitete. Shembull skandal: Emri i artistit. Punëtor arsimi gjithë jetën, emri i të cilit i jepet një rruge. Në vend që t'i jepet një shkolle, institucioni kulturor. E të mos flasim për emrat tjerë të bejlerëve e pashallarëve (prodhime me afate të skaduara turku), që pakgjë kanë bërë për arsimin dhe kulturën shqiptare, që u jepen sot

shkollave shqipe. Dudumët me veprimet e tyre "patriotike" përdhosin personalitetet shqiptare.

Ose, nga nënsjetullat e partive politike trumbetojnë se: Shqipëria dhe Kosova kanë mbetur në mëshirën "patriotike" të dudumëve kuqezi. Njëkohësisht, harrojnë se festat kombëtare nuk janë manifestime që i takojnë vetëm një partie politike, po festa kombëtare që i takojnë mbarë popullit shqiptar. Përmëtepër, në këtë kohë kur para dhe pas Luftës së Dytë Botërore edhe ky popull i kësaj ane ka dhënë me bollëk personalitete historike të luftës, arsimit dhe kulturës shqiptare: Sulltanë Qafa, Kalosh Zajazi, Xhemë Gostivari, Mahmut Dumani, Azem Morana, Sadudin Gjura, Sali Lisi, Nexhat Pustina, Mehmedali Hoxha, Mehmet Gega… Personalite këto, që në atë kohë pushtuese i rrokën armët për liri e dije, hapën shkollat e para shqipe në këto anë.

Faji, nuk është gjithaq vetëm i partive politike shqiptare, po edhe i individëve të papërgjegjshëm të arsimit dhe kulturës shqiptare. Partizanët partiak, edhe unë pajtohem me atë thënjen humoristike: "ku di gjë mësuesja", siç thotë shpesh Sala. Edhe pse një pjesë të fajit e kanë edhe ata si faktorë kryesor politik të shoqërisë, sistemit të shtetit demokratik. Vetëm, habitem me veprimet dhe trurin e dudumëve arsimor e kulturor nën sjetullat e partive politike, vërtetë nuk dijnë apo janë të paguar të përhapin sa më shumë huti e padituri në Rilindjen e sotshme shqiptare…

## DIAGNOZA TEKNEFESE E POLICISË LETRARE

E gjithë kjo histori dyluftimi ndodhi vite më parë pas Luftës së fundit (2001), gjatë një Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: Takime nën Rrap, në Shkup. Poetët nga të katër anët e Atdheut veç më kishin ardhë nën Rrap, dhe pasi ishin vendosur në hotel prisnin fillimin e programit kulturor. Ndonjëri, e përfitonte rastin edhe shkëmbente libra me mikun. Ia zgjatnin dorën, njiheshin si personalitete të letrave. Realiteti, edhe këtë qëllim e mision kulturor kishin këto takime letrare, të njihemi mes veti si poetë shqiptar, e jo vetëm t'i lexojmë njëri - tjetrit poezi. Librat e vëllezërve matanë kufirit i kishim pasur nëpër duar qysh në kohën e komunizmit. Vërtetë, ishim të ndarë me kufinj politik, po librat ilegalisht e kalonin kufirin maleve dhe lexoheshin dorë më dorë, herët njiheshim si emra të letërsisë shqipe. Dihet, ndonjëri që ziheshte me kërpesh për dore edhe e paguante shtrenjtë "armën e rrezikshme" që e mbante në shtëpi, më së paku me dhjetë vjet burg në birucë. Tjetër punë ishte ajo e "debatikëve", kur "librat e rrezikshëm për shtetin" i shpërndante në mënyrë "ilegale" edhe vetë policia. Nga njëra anë ta jepte librin e ndaluar përmes "patriotit" të tyre, e në anën tjetër herët të nesërmen të bastiste, ta gjente "armën" pa leje në shtëpi. Dënimi dihej që në fillim të "propagandës armiqsore", më së paku pesë ose dhjetë vjet burg, heqje lirie.

Kohët e sotshme, tashti janë pak më ndryshe për nga fjala e lirë, vërtetë kemi kufinj politik, po nuk kemi kufinj kulturor. Librat dhe poetët e kalojnë kufirin lirshëm pa pengesa matanë e këndej gardhit. Nuk do të thotë kjo se, tani nuk ndiqemi si "armiq të shtetit të përbashkët" e të partive politike. Jo, përgjohemi për fjalën e lirë publike edhe më zi se dje, po tashti dënohemi me metoda të tjera "pak më demokratike" të partive politike në pushtet: vende pune, poste në Qeveri, një torbë taxhi për qafe, izolim publik, burg shtëpiak… Dënime më të lehta politike këto sot, në krahasim me ato të djeshmet policore. Kryesorja, megjithatë nuk është mirë vetëm të qahemi e vajtojmë Lirinë, vërtet marrim pak më lirshëm frymë se sa në kohën e "artë" komuniste. Sistemin e atëhershëm të egër policor, kur për një varg të dykuptimtë revolucionar publikuar në gazetë ose libër, të shkonte koka si "qenit në rrush". Eshtrat "pa nam e nishan" t'i varrosnin gardianët nëpër qelitë burgjeve famëkeqe të Idrizovës ose Goli Otokut.

Përderisa, merresha me përgaditjen e ecurisë së manifestimit kulturor, në tavolinë u ulë Rrufjani. Pas pak kohe, erdhi edhe Honxhobonxho. Që të dy gjatë gjithë jetës, pasi u vendosa me vendbanim në Shkup nuk m'u shqepën nga shpina si rriqrat kur u sulen deleve edhe në mes të Dimrit. Shkaku se, vija nga Prishtina, Universiteti i Kosovës. E, të gjithë ne që studionim ose punonim atë kohë në Kosovë, një ditë kur ktheheshim në vendlindje ishim të "rrezikshëm" për shtetin.

Edhe s'do mend, më ndiqnin si hije këmba - këmbës, bënin gara cili më shumë se shoku do të përcjellë informata i shitur vetëm për një asht te Vetëshërbimi, në Bit-Pazar. Ditënatë i kisha pas shpine si hije në çdo hap: kafene, punë, shtëpi, libra. Njëri më i "përndjekuri" me poste policore dhe një torbë taxhi për qafe, mori rrugë të gjatë edhe deri në vendlindje, Katund. Siç duket, çdo gjë donin të dinin për mua si "irredentist", si familje kaçakësh e ballistësh. Babain dhe Nënën ende atëherë i kisha gjallë, në Katund. Edhe Vëllain, që ndiqte mësimet në Shkollën e mesme bujqësore të Manastirit e spiunoi shoku më i ngushtë "besnik" dibran (E. M.). Shok i shkollës dhe banesës me akuzën se, "ëndrron Shqipëri Etnike". I cili, për t'i shpëtuar dënimit, papritmas një natë iku nga sytë - këmbët, në Paris. Përditë Vëllait nga atje i vinin në Policinë e Kërçovës "letra dashurie": fotografi e inçizime filmike për pjesmarrje në organizimin e demonstratave shqiptare antijugosllave dhe takimet e shpeshta që i kishte me Abaz Ermenin, në Paris. Vetëmse, tashti për dallim nga ajo kohë "vëllazërore - miqësore" e shkollimit mesëm në Manstir, të gjitha ato informacione "armiqsore antijugosllave" kundër shtetit, i merrte në dorë shoku i tij më i ngushtë i dikurshëm dibran, i avancuar për shërbime të fshehta informative si agjent i policisë në Kërçovë.

Dënimi dihej në atë kohë, vërtetë e kishin vështirë ta rrasin në burg për shkak të mosprezencës në vendin e ngjarjes të "krimit", po nuk guxonte të vij në shtëpi me vite se ia merrnin

pasaportën, e humbiste vendin e punës ose e rrasnin pa gjykim në burg për "veprimtari armiqsore" kundër shtetit. Përvoja e hidhur e përndjekjes komuniste na kishte bërë që të ruhemi si prej gjarprit. Sytë nga dy t'i bënim katër. Ose, siç thotë shpesh populli: muret kanë veshë, e nata sy… Shkaku se, përsëri siç thotë populli: na kishte djegur tambëli, tashti i frynim edhe kosit. Arsye, që mysafirin e paftuar me diktafon në xhep e detyrë policore që na trokiti te porta, pasi e pritëm sipas traditës shqiptare me bukë, kripë e konak, të nesërmen e përcollëm plot "informata armiqsore" për në Shkup. Babai në mes të lëmës më hoqi anash dhe më tha: kujdes, ruaju prej këtij "mikut" se, është spiun i shitur një trobë taxhi. I kishte thënë në atë kohë edhe Vëllait për "mikun" dibran, por ai nuk ia kishte vënë shum veshin paralajmërimit. Prandaj, përpak desh e pësoi në birucë, po të mos kishte ikur me kohë në Paris. Buzëqesha. E di, i thashë. Herë pas here në "Menada" i kam dhënë edhe të pi alkool me kusi, ia kam shtruar me mish mullar edhe sofrën. I dehur tapë, më ka thënë edhe vetë se është spiun dhe e ka për detyrë që të më ndjek mua hap pas hapi si hije. Edhe miqtë poetë nga Kosova, përditë më dërgojnë porosi, që të kem kujdes, t'i ruhem këtij "miku" të rrejshëm të penës që më përcillte pas shpine këmba-këmbës edhe në hale. Vetëm, më erdhi çudi, nga e diktoi babai ose e nuhati brenda një nate "mikun" e paftuar me detyrë policore.

Një ditë "miku" i pandashëm me diktafon në xhep, që herë pas here kur t'i tekej i paftuar vinte

edhe në shtëpi, gjoja pas ndonjë libri shqip në bibliotekë, më mori në telefon: Edhe unë kam marrë një ftesë për Mbrëmjet e poezisë, në Strugë. Mirë është që të shkojmë së bashku në ato takime poetike. Nuk ka problem, iu përgjigja. Vetëm se, ndodh unë do të shkoj një ditë përpara. Ndoshta, një natë edhe do të flej në Katund. Nuk e përmbajti dot veten nga inati që ia hodha: Vetëm, mos harro se unë jam në rrugën e shokut Tito. Provokimi i radhës. Asgjë, nuk duheshte më tepër në atë kohë policore, vetëm që unë përmes telefonit ta shaj shokun Tito. Dhe, hop të nesërmen në bazë të dëshmive të inçizuara në diktafon të më rrasnin më së paku pesë vjet burg në birucë. Nuk m'u durua, iu përgjigja aty për aty përmes telefonit plot zemërim: mirë bre nënën e nënës, po unë në cilën rrugë jam?! Dhe, ia mbylla gojën Honxhobonxhos duke e përplasur kufjen e telefonit me forcë te qoshku i gazetave.

Vite më vonë (1992) gjatë një "bisede informative" në polici do t'i kuptoj deklaratat denoncuese të këtyre "miqëve patriotë" kuqezi. Përmëtepër, edhe kolegë të punës e penës. Poetë, redaktorë e gazetarë të punësuar në gazetën e "*Vëllazërim - bashkimit*". Çerdhe e spiunëve, kur në atë kohë, në prag të ndryshimeve demokratike, pas botimit të librit tim me satira: "*Trumbetat e Tellallit*" (1992), vetëm për një torbë taxhi do të më ndërsehen me të katra pas shpine si qentë e tërbuar në gazetën e tyre neokomuniste me shkrime policore plot etiketime e shpifje. Sulme frontale të njëpasnjëshme me gracka policore mes dy zjarreve, njëkohësisht duke m'i lëshuar pas

shpine policinë sekrete shtetërore dhe Bashkësinë e Fesë Islame, gjoja se unë paskam thënë në librat e mi: "Kur'ani është burim i gënjeshtrave". Shpifjen e fundit, ma vërtetoi një profesor teolog i Medreses "Isa Beu", në Shkup gjatë një takimi të rastit: o burrë, jemi mbytur duke i lexuar të gjitha librat e tu me urdhër të kryetarit, që ta gjejmë shkrimin në të cilin ke thënë se: "Kur'ani është burim i gënjeshtrave". Buzëqesha, duke e pyetur me ironi: e, a e gjetët në ndonjë faqe? Jo, m'u përgjigjë po me të njëjtën buzëqeshje.

Natedité më kishin spiunuar e shpifur, sa që vështirë e kisha t'i besoj edhe vetevetes, realitetit se kush isha unë si krijues letrar: armik apo mik i këtij shteti. Inati më vinte të pëlcas, ata kishin ditur për mua më shumë se unë si "armik i shtetit". Një gjë e dija me siguri: unë nuk isha kundër shtetit, po shteti ishte kundër meje si shkrimtar. Hap pas hapi i kishin përcilljellur dhe përkthyer shkrimet dhe librat e mi në polici. I dinin të gjitha presjet dhe pikat. Edhe fotografitë e cilëve patriotë shqiptar i mbaja në dhomën e punës. Librat e "rrezikshëm" të shkrimtarëve të ndaluar kokë më kokë në bibliotekë. Unë kisha qenë sipas tyre i dërguar nga Kosova që të veproj në këto anë të malësisë së Shkupit. Herë pas here kisha pasur edhe takime të fshehta në Bullgari.

Me mijëra marka i kisha dërguar Partisë Socialiste në Shqipëri. E mbi të gjitha unë isha ai kryesori: çështjen e shqiptarëve doja ta zgjidhë me luftë. Inspektori vazhdoi ende të lexojë e radhisë shpifje e thashetheme të denoncuesve nga disa fletë të shtypura me makinë shkrimi që i

kishte përpara mbi tavolinë: në "Menada" kisha ndejtur në një tavolinë edhe me një person shumë të rrezikshëm, i cili u kishte ikur me këmbë të thyer nga burgu. Në themelimin e Bashkësisë Kulturore të Intelektualëve në të cilën merrnin pjesë edhe të burgosur politik, në Tetovë e kisha dhënë nënshkrimin në një listë të cilën e posedonte si dëshmi policia. Takimi organizativ kulturor m'u kujtua si sot para syve, vërtet e kisha nënshkruar në mënyrë vullnetare pa asnjë dyshim. Edhe miku im i penës mu kujtua, që erdhi e më mori të shkojmë në atë takim "kulturor". E gjithë kjo "mrekulli" për mua nuk ishte ku ta di unë se çfarë zbulimi policor, i dija të gjitha: edhe provokimet, edhe përndjekjet… Edhe se, në çdo parti politike, shoqata kulturore e "humanitare", policia i kishte filtruar edhe spiunët e vet si "patriotë" kuqezi. Thikën e tyre pas shpine, thellë deri në asht do ta hetoj me ardhjen time si kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar. Gurë e dru do të rrokullisin kundër meje përderisa nuk ia arritën qëllimit, përçarjes të shkrimtarëve shqiptar. Edhe e dini kush, ata që sot janë më të zëshmit plot zhurmë për Shqipëri Etnike. "Patriotët" kuqezi, që nuk lanë parti politike pa e futur kokën me gjithë bythë.

Posteve politike dhe taxhisë edhe sot si dje u turren me të katra. Tashti, mu kujtuan edhe zbulimet e organizatorëve të demonstratave në Tetovë e Prishtinë (1968, 1981). Regjistrat e shpeshtë gjatë Luftës së fundit të shqiptarëve (1999, 2001), që i kurdiste dhe i regjistronte vetë policia përmes njerëzve të tyre besnikë gjoja për

"ndihma humanitare" në Kosovë, shpërndarjen e armëve për kryengritje. Përçudi, të gjitha këto lista me emra e mbiemra posa përfundonte mbledhja ose aksioni, që atë ditë përmes njerëzve të tyre pjesëmarrës nëpër këto tubime përcilleshin pikë për pikë, pa i shtuar asnjë presje në polici.

Njëzetë nënshkrime pasojnë në këtë denoncim politik si "armik i shtetit", më tha bashkëbiseduesi i Sigurimit policor. A, do t'i shohësh me sy, që të bindesh edhe vetë si "armik i shtetit", më pyeti Inspekori. Jo, i marr me mend se kush janë palaçot. -iu përgjigja. Fytyrat e tyre më dolën para sysh si në film.

Qesha. Pse qesh, më pyeti përsëri Inspektori. Qesh se, sipas jush unë qenkam ai "kryesori". Tekefundit, edhe unë dua të jetë ashtu siç thoni ju të gdhihem aq trim, shkaku se më vjen përshtati ky etiketim si nacionalist shqiptar, po nuk është ashtu, he burrë. Përfundimisht, mos më thirrni më për kësi budallakish të "patriotëve" kuqezi në "biseda informative"! Mos më merrni më qafë, të mos di as vetë se kush jam si njeri i penës.

Dhe, të kthehemi te fillimi i rrëfimit historik: vizitat e papritura të "miqve" të paftuar atë natë festive në tavolinë rrëzë Kalasë të Shkupit. Papritmas, rrufjanët u zunë mes tyre me fjalë si gjelat mbi pleh. Ty po të përcjellë UÇK- ja. -i tha që ta trembë Honxhobonxho Rrufjanit. Unë i shikova që të dy në fytyrë, nga dolën sot kaq trima me armët në brez?! Vallë, mos janë edhe këta nga ata trimat pas lufte?! Rrufjani kuqezi u skuq si spec. Edhe, aty për aty u trembë. Unë arrita t'ua kuptoj hallin e "kacafytjes patriotike".

Qëllimin, që të dy papritmas u rrokën shkaku im, menduan se perëzihen në punët sekrete policore të njëri - tjetrit, ia rrezikonin shoku-shokut bukën e gojës. Padashtas, nisa t'i marr me të mirat dhe qetësoj me fjalë, pajtoj si kolegë të penës e "patriotë" trima kuqezi.

Edhe, përçudi ia arrita disi qëllimit, mezi e shuajta zjarrin e ndezur me flakë në oxhak. I qetsova me fjalë gjatë asaj ore poetike burrat e botës, që përpak desh u rrahën për mua si dy rrufjanë kuqezi. E hapëm Orën e madhe letrare pas Luftës së fundit (2001). Poetët lexuan poezi patriotike e erotike. Xhaxhi Kuqezi atë natë duke bërtitur në kupë të qiellit lexoi një poezi përkushtuar komandantit të UÇK -së, Ali Ahmeti. Një poet tjetër reagoi rreth çmimeve letrare, pse një çmim letrar nuk iu nda edhe atij si "poet i madh", por pas vdekjes i jepet mikut tim të ndjerë, poetit Fadil Bekteshi. E kalova edhe këtë provokim të rastit me heshtje gjatë asaj nate poetike.

Një ditë të nesërme në opinion dolën listat e spiunëve. Përçudi, mes atyre emrave lakoheshin nëpër rasat e gjuhës shqipe edhe disa "miq" të mi të penës. Inati më vinte të pëlcas nga kurrizi, si kisha mundur të merrem me letërsi mes kaq shumë spiunëve dhe të mbetem ende gjallë në jetë. Mikun tim të penës, poetin Fadil Bekteshi nga një përndjekje e paparë deri më sot, e detyruan të bëjë vetëvrasje. Radhën, thonin "miqtë" e mi pas shpine, tashti e ka ky një ditë. Nuk do t'i shkojë gjatë kungulli mbi ujë, pritnje një natë, kur edhe ky pas tij do të bëjë vetëvrasje.

I provuan të gjitha metodat policore: përgjimet, shpifjet, etiketimet, helmimet, zjarret në banesë, vdekjen klinike, aksidentin e komunikacionit… Diagnoza më e re e Policisë letrare, sipas tyre që e përhapën në të katër anët në popull trumbetonte, "i ka mbetur në dorë edhe letra e fundit: vetëvrasja". Njëherit, edhe hë për hë në atë kohë qorre më shtinë frikë, ndoshta edhe mund të më ndodhte ky fund parashikues i tyre tragjik. Nuk do të kishte gjithaq rëndësi si ndodhi fatkeqësia, i doli vetë para kamionit, trenit, apo e hudhën xhindet nga kati shtatë i pallatit. E rëndësishmja ishte, shpallja zyrtare: "armiku i shtetit" më në fund bëri vetëvrasje. Vetë e flugu veten jo siç kishim lexuar nëpër librat e tij majë lisave, po nga kati shtatë i pallatit si kukëll leckash në asfalt. Zoti ia faltë mëkatet! I qoftë falë Parajsa! Vetëm se, për inat të tyre: jo, nuk më deshi Zonja Vdekje. Zoti nuk ua plotësoi dëshirën "miqëve" të mi hadumë. Lufta ende vazhdon me penë.

"Miqtë" e mi të penës sot nuk më ndjekin më si dikur hap pas hapi, nuk më denoncojnë me etiketime e shpifje në polici. Thonë: hiquni tij, është "i çmendur". Diagnozë teknefese është kjo, më e mira deri më sot nga ana e tyre si "miq" dhe siç duket e fundit. Dorën në zemër, edhe mua më pëlqen kjo diagnozë "shkencore - policore", është më e bukur se vetëvrasja, Zonja Vdekje. Ndoshta, ku ta di edhe më ka hije si shkrimtar. Shkaku se, sipas meje: çmenduria është kulminacioni i mençurisë.

Tekefundit, më mirë të jetoj "i çmendur" mes rrufjanëve, sesa i vdekur mes varreve rrëzë

Çukës. Dita-ditës vazhdoj të zgjohem me Gruan më të bukur në botë - poezinë, që nuk ikë të më lë në vetmi, është besnike. Qesh dhe kënaqem me "zbulimet" e tyre fantastike policore nëpër takime poetike. Përçudi, kohën e fundit u kënaqa së qeshuri edhe me anëtarin e Komisionit të Lustrimit. Vërtet, jam i lumtur heeeu, përtej çdo kufiri. E sidomos, me atë pyetjen "stilistike" të shekullit, kur e ka pyetur Rrufjanin: Cili e ka spiunuar më shumë njëri-tjetrin si krijuesë letrar, ai ty si "patriot" kuqezi apo ti atë si "të çmendur" e "armik i rrezikshëm" për shtetin?! Ndërsa, Honxhobonxho korri fitore historike. Arriti kulminacionin e "flijimit artistik", e fitoi shpërblimin e merituar për vepër jetësore. Komisioni i Lustrimit sipas dëshmive policore e shpalli në mjetet e informacionit këmbekokë "hero lufte" të UDBA -së famëkeqe jugosllave…

## O BURRË KOT I BIE SAMARIT NUK I TEKET GOMARIT

Edhe në kohën e Turqisë, edhe në kohën e Serbisë, edhe në kohën e Gjermanisë (Shqipërisë Madhe), edhe në kohën e Jogosllavisë të shokut Tito, shqiptarët kanë bërë luftë për shtet etnik shqiptar. Tjetër punë është ajo se, ky popull liridashës gjatë gjithë sundimit të pushtuesve ka pasur dhe ka ende tradhtarë, që e kanë shitur veten një torbë taxhi: sejmenë, agallarë, bejlerë, pashallarë, xhandarë serbie, vojvodë katundi, shokë partizanë (drugari), rrufjanë, ministra qeverie…

Shqiptarëve shekuj me radhë nëpër këmbë u ngatrrohet vetvetja si problem historik. E kanë vështirë pa e pastruar oborrin e Shtëpisë së vet, ta pastrojnë lëmën e kojshisë. Tjetër punë është ajo, se ky popull më tepër merret me të tjerët se sa me vetëveten: i ka bërë shtete demokratike, u ka hapur universitete, u ka dhënë personalitete historike. Kohën e fundit edhe "vëllezërit" e Njerkës do t'i bëj shtet. Nuk e ka lehtë ky popull, që ka jetuar me shekuj nën pushtuesin Osman e sllav, sot të ngritet më këmbë për liri kombëtare. Sytë t'i fshijë me të dyja duart nga sklepat, laj fytyrën. Kokës t'i bie me grushta. Shkaku se, me këta pushtuesë shekullor, përveç pazareve politike personale, ka përzi edhe gjak. Shembull, që nuk e luan nga vëndi as topi i qershisë, është mospajtimet e kokave shqiptare, përplasja e shqiptarëve në Qeveri.

Lufta e tyre për pushtet e jo për shtet shqiptar. Pavetëdije çojnë ujë me gomarët e tyre në mulli të armikut shekullor.

Përçudi, në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, ky gjak i huaj tërbohet si qeni me zgjebe pas porte, në rrugë. Gjuhën jashtë dypëllëmbë nga vapa leh dhe ndërsehet pas çdo kalimtari shqiptar liridashës me gunën krahëve. Fatkeqësi kombëtare, i ndërsehet edhe të Zotit dhe përpiqet ta shqyej me dhëmbë. Merreni me mend, Zotëriut që e mori nga rruga në Shtëpi, i dha bukë ujë dhe konak.

Tërbimi është sëmudje e rrezikshme për njerëzimin e këtij shekulli, që e pranon edhe shkenca botërore. E sidomos, kur tërbohet Gomari me samar dhe pëllet në rrugë. Bishtin mbi shpinë e hedhë si ferexhenë krahëve, që i duket rrugës si sexhade. Edhe pasqyrë i vënë në ballë gomarit. Rruza kuqezi për qafe. Megjithatë, gomari është gomar, nuk është kalë me shalë. Gjok të cilin e shalojnë vetëm kreshnikët e maleve për liri.

Edhe, tërbimi kuqezi sot në këtë Njëqindvjetor të Pavarsisë së Shqipërisë ka dalë në rrugë me nuska për qafe. Është njësoj si përmbytja e madhe. Ose, siç thotë Kur'ani, erdhi Kiameti. Lumi, pas shiut dhe breshërit turbullohet dhe delë i egërsuar nga shtrati. E kur delë ai nga shtrati arave dhe livadheve, përmbytet Natyra dhe merr me vete çdo gjë që i delë përpara në rrugë. Edhe bërllokun, edhe bajgat, edhe plehun, edhe koritat e fëmijëve, edhe lulet… Vetëm, lenat nuk mund t'i marrë me vete majë lisave.

Fatmirësisht, që nuk na bie zjarri. Shkaku, se: zjarri nuk ka mëshirë. Flaka e tij përla çdo gjë që i delë përpara në rrugë. Ose, siç thotë populli: përkrah drurit thatë, digjet edhe i buti.

Realitetin, përsëri duhet kërkuar te gjaku. Niçja thotë për gjakun: *Nga të gjitha ato që janë shkruar i dua vetëm ato që dikushi i ka shkruar me gjakun e vet. Shkruaj me gjak: edhe ti do të kuptosh se gjaku është shpirti. Nuk është lehtë ta kuptosh gjakun e huaj: unë i urrej të papunët që lexojnë…*

Gomari e di, do samarin. Edhe Zotëriun me kamxhik mbi shpinë. Thasët me drith mbi samar për në mulli. Barrën e druve për Dimër. Shkopin e thanës bythëve. Përmëtepër, e ka dhunti dhe shpërblim nga i Zoti të ngulitet me të katra këmbët në baltak. Edhe kërkon me të gjitha metodat demokratike politike me lutje para këmbëve të hoxhës t'i zbresë Zotëriu nga shpina.

Zotëriu këtij gomari i jep bukë, ujë, shtëpi përmisimi në Idrizovë. Edhe shkop të mirë thane bythëve. Shkaku se: nga gomari nuk kërkon tru, po samar…

Dhe, në fund o burrë, kot i bie samarit, kur nuk i teket gomarit…

## KRYENGRITËSI

Vështirë e ke në ditën e sotshme ta mbajsh gjallë dhe të ri Kryngritësin e maleve për luftë (Liri), kur je i rrethuar nga hadumët e xhadive kuqezi që të sulmojnë nga të katër anët me "armët më moderne": Kurvat politike. Përjashtim nuk bëjnë në këtë rrethim, as dumdumët e partive politike, që na kënaqën me "politikë madhore", dhe shi tashti kohën e fundit kanë vendosur ta provojnë veten edhe në fushën e letërsisë. E pushtojnë Panairin e librit (2011) në Tiranë me librat e tyre "politiko-sakatik" krah për krahu me qoftet e Beogradit, "kashikarat" me raki të kumbullave dhe turbo-shundin folklorik me këngë serbe. Përmëkeq, shqiptarët pas këtyre specialiteteve serbe të përziera me libra "besteler" të shkruar nga politikanë – "shkrimtarë" të dështuar në frymën neokomuniste, turren si dhentë pas kripës te Përrroni i Xhetit: në Tiranë, Prishtinë e Shkup. Sojit të këtillë të "shkrimtarëve", rreptësisht u ndalohet ta përdorin armën e fundit paqësore: Kryengritësin. Edhe kritikëve të "tabanit kombëtar" bashkë me "salep-intelektualët", që merren me përurimin dhe vlerësimin e këtyre librave teknefes nëpër muze historik e teatro të fëmijëve në Bit-Pazar të Shkupit. Shkaku se: janë hadumë. Arsye, nuk dinë t'ia tërheqin këmbëzën "nagantit", dhe nuk kanë kryer ndonjë shkollë të njohur malore me famë politike mbarëkombëtare në Baba Tomor. Shkollën e dëgjuar luftarake-artistike të salloneve aristokrate të Çajupit, nuk e kan studjuar siç duhet

në thellësi poezinë antologjike: Kanari. Edhe pse, dorë më dorë qarkullojnë edhe sot e kësaj dite fotografitë e tyre lakuriqe anë e mbanë Atdheut.

Zonja "Gadafja" në këto dyluftime të përgjakshme me parullën komuniste: "Vdekje ose liri", e merr guximin ta porosisë një partizan hadum të të pyes publikisht: Kur do të dali Kaçaku i malit në dyluftim nën Rrap të rroket fytas me dy shtambat me verë?! Babashehu, një tjetër komentues po në atë faqe interneti i përgjigjet: E pyeta Kaçakun e livadheve. E di, si m'u përgjigjë ai burrë i grave?! Ditën, kur Kryengritësit do t'i dalë gjumi, atëherë ende pa dalë drita do t'ju bie Sarajeve të Pashait.

"Nagantin" e nxjerr vrik nga brezi, nuk dorëzohesh në këtë rrethim mu si te ajo kënga e njohur popullore shqiptare: përpara mejdanin se sa armët. I nxjerr koburet e Isë Boletinit nga brezi, mauzerrin e Azem Galicës me të cilën i doli zot Mëmëdheut krah për krahu me Shotë Galicën. Kaçakçe, nxjerr nga hatullat armën supermoderne që nuk e ka përdorur për çlirimin e trojeve etnike deri më sot shqiptaria: Kryengritësin e fushave dhe maleve. Kushtrimin jep majë një kepi për Liri me jatagan në dorë: O, bini burra armikut, bini! Kurrë, në dorë të shkaut për së gjalli kjo pasuri e tundshme me fusha, male, lëndina, lugje ujore e tërfojë nën hije të dardhave dundushore.

Përditë, çdo mëngjes Kryengritësin si spartakun e kam larë me ujë të ftohtë akull. Herë pas here e kam shti grykave me shkurre të bëjë gjimnastikën e mëngjesit. Një, dy, tre, katër…

Para, anësh, mbrapa… Bythekrye… Edhe një herë nga e para e përsërisnim ushtrimin e mëngjesit! E kam mbajtur gjallë për luftë. Ia kam dhënë të gjitha përgaditjet natyrore ushtarake sipas mundësive dhe aftësive të Komandantit. E kam nxjerrë edhe nëpër livadhe mes shelgjeve te Mulliri i Arapit. E kam ngjitur edhe maleve, në Drenovë. Dhiareve për të hipur në Baba Tomorr. Malin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri.

Nën hije të dardhave gorrice, gjatë rrugës e kam strehuar si kaçak mali rrëzë Çukës me lisa kokë më kokë me drenushat. E kam përshkuar edhe te Dy lisat te Guri i Zi, mos e zënë magjitë e plakave dhe hajmalitë e hoxhallarëve. Pse, të mos i fus pranë Burimit të Përronit të Thanës, Kryengtitësi nën hijen e dardhës gorrice edhe një sy gjumë kreshniku?! E dikur, pasi t'i dalë gjumi t'i futet si qengj me një zile  në qafë  varë Deles Rudë për gji, të pi tambël Zane, japë fuqi për luftë.

Ditën e nesërme, i nervozuar kam thënë plot inatë: edhe ti je si shqiptarët e mi "patriotë dhe trima" kuqezi të fushave me tërfojë, sa më shumë të të lëmojnë, shpërblejnë me dhurata, ti hazdisesh livadheve, çohesh më këmbë për luftë heroike. Prandaj, duhet ndërruar taktikën e strategjisë me ty si shok lufte. Nuk duhet të të lëmoj me dorë, por duhet të të bie me grusht në kokë, mu si Migjeni "malit që nuk bëzan. E ai të kënaqet duke qeshur si vigan i vramë". Ose, si Pano Taçi në një poezi të egër: Krapin na i skuqin të tjerat/ kur gratë me hi kanë furrat/ Ndaj turremi

të zëmë mëshqerrat/ me kërrabën dell që mbajnë burrat./ Për shtrat na bëhen bumbusherat;/ rrofshin kurvat! Dhe, e vazhdon luftën heroike-artistike me një poezi tjetër erotike: "Thonë se plagën që bën gopi/ s'ta bën pushka, s'ta bën topi". Shkaku se, o Kryengritës: edhe ti je si shqiptarët e mi "patriotë dhe trima" kuqezi me armë në dorë e lotë në sy për Shqipëri Etnike, që edhe sot e kësaj dite i turren përmbrapa Lirisë ta rrëzojnë pas ndonjë lisi në kokërr të shpinës.

Kryngritësin e kam nxjerrë shpeshëherë të rroket fytas edhe me rrunzat më të egëra të Kopesë me zgjebe që e ndjekin Autorin. Fytas u rrok edhe me "Salep-intelektualët" e Tun Batunit: "Poeti", "Cërvicaliu", "Esat", "AK", "Afrim", "Lina", Admiri", "Albini", "Shkupjani II", "Rihan", "arta", "bedri", "tetovari", "mamuti", "Drejtpeshim"… Tym për tymi si te ajo kënga e njohur popullore kërçovare: "Sula i vogël / Sulë jetimi / me Kaloshin tym për tymi. Tym për tymi / në atë përru/ a more vesh moj e zeza gru/ me Kaloshin jam fjalu". Vërtetë, jam bindur se këta dudumë shqiptar nuk dinë t'i lexojnë shkrimet e mia mes rreshtave, kuptojnë figurat artistike-letrare me përjashtim të: "Observer", "Ariuan", "Selman Dervishi-Mani, USA", Xha Derralla", "Izeti", "marinc", "jamini", "Kongresi i Bashkimit", "driton", "Taxheri", "xiki", "Dardan Hasani", Bi-Bi", "Babashehu", "shkupjani", "Edon Shkupi", "Genti Aliu", "iliri", "Bum Dajaku", "Engjëlli K", "kled lushnja", "Trimi", "reali" "Lulzim Hoxha", "Vlora", "Bardhyl Maliqi", "Luli", "Dibrani", "Bleta", "plisi", "iliaz

Kadriu", "brukxeli", "shpati@shkup", "Timo Merkuri", "kulumana", "Lume", "brari", "Ilirida", "Mburoja"...

Edhe, e kam ditur moti se, ky Kryengritës trim nuk më lë në baltë. Edhe ashtu po ndodhë: Kryengtitësi im nuk mplaket, nuk dorëzohet, nuk di për moshë pleqërie, u doli hadumëve për mejdani. Botërisht e them: është mbi nivelin shkencor të "salep-intelektualëve" me tre – katër profesione: politikanit, profesorit, shkrimtarit, analistit politik… Dhe, rrufjanit. Kryengritësi im është trim mbi trima, që i del zot Vatanit. Përmëtepër, siç duket edhe do të vdes i ri në shtrat fyt për fyti me armikun e pabesë. Shkaku, se: nuk më dëgjon, nuk pranon këshilla. Ditënatë rroket fytas me rrunzat e hazdisura të Bariut të maleve në Çelvjollcë. Herë pas here, ua ngre këmbët përpjetë në hava para syve të Diellit mes lëndinave nën hije të dardhave gorrice.

Edhe për fund: Kryengtitësi është arma e vetme që e posedojnë sotpërsot shqiptarët e vërtetë trima për luftë. E di, ju do të pyesni: Pse, ka edhe shqiptarë frikacakë?! Po. Edhe atë, shqiptarë që u flen lepuri në bark. Përmëtepër, Kryengritësi mbi të gjitha është armë paqeje e jo terroriste. Dorën në zemër, shqiptarët nuk e kanë përdorë deri më sot gjithë arsenalin ushtarak nga toka e qielli nëpër beteja të përgjakshme për Liri. E kam thënë edhe nëpër shkrimet e mëhershme të mia të publikuara në mjetet e informacionit dhe libra. Shqiparët i kanë përdorur gati të gjitha armët luftarake për bashkimin e trojeve etnike shqiptare: Shpatën e Skënderbeut, topin e Mic

Sokolit, mauzerrin e Shotë Galicës, koburet e Isë Boletinit, martinën e Kalosh Zajazit, gërshërët e dhenve të Sulltanë Qafës…

Fatkeqësisht, në Ditën e sotshme shqiptarëve e papërdorur u ka mbetur në dorë edhe arma e fundit paqësore me dy tyta: Kryengritësi. Koburja e vetme historike e të parëve me të cilën një ditë me luftë paqësore do t'ia kthejnë Shqipërisë trojet e grabitura etnike.

Tekefundit, shqiptarët në Ditën e sotshme kur i kanë përdorur të gjitha armët artilerike luftarake, pse të mos e përdorin edhe këtë armë paqësore për realizimin e qëllimeve të veta shekullore???!!!...

Edhe, siç duket, shqiptarët qëllimin e tyre historik brez pas brezi, bashkimin e trojeve etnike shqiptare do ta arrinë me armën e tyre paqësore të fundit, ende të papërdorur me gjithë arsenalin fuqiplotë ushtarak nga toka e qielli: KRYENGRITËSIN…

## TRËNDAFILJA DHE FACEBOOK

Gati e gjithë bota kishin Facebook. Vetëm Trëndafilja nuk kishte, e kalonte kohën me punët e shtëpisë dhe herë pas here shkruante poezi. Përditë i vinin ftesa përmes internetit ta bëjnë si shoqe. Jo, u përgjigjej Trëndafilja. Felemndrit, nuk kam kohë, merrem me poezi dhe "politikë madhore". Kohën e fundit jam duke shkruar një roman për Luftën e Kosovës (1989). Edhe, i shëtiti gati të gjitha Partitë politike Shqiptare Demokratike, po askund nuk zuri vend. Fati njëjtë e përcillte edhe me burrat. Shkak ky, që nuk la burrë pa sharë, marrë nëpër gojë. Faj kishin të gjithë burrat, që nuk u jepnin të drejta të barabarta grave të tyre mbyllur brenda katër mureve. Falë Zotit që nuk kishin guxim, se po të mundeshin këta "burreca" do t'u vishnin edhe ferexhe. Zërin kudo e ngrente për të drejtat dhe liritë e grave. Raste kishte, kur zemëroheshte edhe i thirrte gratë besnike të dalin në protesta e demonstrata kundër burrave. Patjetër, duhet ndryshuar vjersha e Çajupit: *Burrat nën hije/ lozën kuvendojnë/ pika që s'u bie/ se nga gratë rrojnë*. Vargjet, që poshtërojnë gruan duhet gëdhendur ja, kështu me sopatën e madhe: *Gratë nën hije/ lozën kuvendojnë/ pika që s'u bie se nga burrat rrojnë*. Duartrokitje për vjershën antologjike "*Kanari",* ama për vargjet e mësipër duhet pështyrë në fytyrë "maskarai". Herë pas here me parulla të këtilla teknefese dilte edhe në dritaren e MTV -së duke e bërë lëmsh gjuhën dhe poezinë shqipe.

Mendime të cunguara, vargje të sakatuara: pa duar, këmbë, veshë, sy e tru i pillte hiç fare pa shterëzime nga goja rreth mullarit. Një ditë e theu mendjen, po e gjithë bota ka Facebook. Edhe gratë e kombit kuqezi. Edhe burrat e kombit. Dhe, vendosi ta hapë Facebook -un.

Ditët e para Trëndfilja fluturonte nga gëzimi. Nga të katër anët e botës iu paraqitën të njohur e të panjohur që ta bëjnë shoqe. Vetëm për një kohë të shkurtër i bëri me qindra shoqe e shokë. E bëri shok edhe një patriot kuqezi (ish kryetar partie të Degës), që përmes postës elektronike, hakerët ia kishin dërguar një mëshqerrë të hazdisur lakuriqe. Edhe një kritik letrar tullac që ia "krihte" poezinë "patriotike". Familjes kudo i dërgonte përshëndetje nëpër botë. Fotografitë me thasë fluturonin nëpër qiell edhe më shpejtë se aeroplani përmes postës elektronike nëpër të katër anët e globit. Edhe poezi "patriotike" që posa kishin dalë nga furra artistike dërgonin partizanët. Lule. Trëndafila. Shqiponja të zeza dykrenare. E gjithë faqja e inetretit brenda një ditënate u veshë kuqezi. Plot flamuj kombëtar, shqiponja dykrenare, Ismail Qemala, Bajram Curra, Shotë Galica, Isë Boletina, Teuta kuqezi e Mic Sokola që e rrokin topin për fyti.

Nateditë Trëndafilja rrinte në kompjuter me orë të tëra e vetmuar si qyqe. Ndonjëherë, zgjohej edhe pas mesnate, para hoxhës dhe dërgonte përshëndetje, poezi, fotografi "artistike". Herë pas here në mesin e tyre paraqitej edhe një Dilinxhi si shok me macjen në prehër. Dilinxhiu siç duket u kishte rënë në fije Grave të kombit.

Macjen e kishte hedhur mes luleve, shqiponjave dhe poezive si grepin gjuetari në lumë. Herë pas here me macjen në prehër ua dërgonte edhe nga një poezi "patriotike".

Poetja e kombit kuqezi, faqen e Facebookut e mbushi plot poezi: Atdhe, flamur kombëtar, shqiponja e personalitete historike. Natën vonë pasmesnate, dilte në verandë si "ujkeshë", uluronte dhe pinte kafe me Saffon, Ana Ahmatovën e Marina Cvetajevën. Merreni me mend, edhe Hëna kur dilte mbi Çelëvjollcë me vargjet e poetit popullor: *Ulu mal të dalë Hëna*, trembeshte nga poezia dhe bukuria e "profetes" shqiptare, fshiheshte pas malit.

Vetëm yjet e nxirrnin pak tinëz syrin pas një reje ta shohin vargun e saj 'rebelues" se si kërcente çati më çati e lis më lis për liri. Huti me veshë, posa e pa Trëndafilen e hudhi këngën nga dega, rroku çiftelinë me dy tela ta bëjë copë-copë për Liri. Natës Madhe i dha zjarr. Agimi ende pa lind Dielli, Tërndafilen e gjeti në mesin e poezive. Shtambave me verë. Zogjtë këngatarë, posa i panë shehirët në këtë derexhe, e lanë këngën atë ditë. Hë për hë mbetën pa gojë, varg në sqep. Burri më kot gjithë natën e kishte pritur Trëndafilen në shtrat. Fëmijët në mëngjes për një copë buke me reçel të shkojnë në shkollë.

Trëndafilen e kishte marrë një gjumë i thellë në verandë me laptop mbi kokë. Gërhiste, dhe nuk la shelg pa sharruar më këmbë atë natë në livadh. Pasmesdite, kur u zgjua Trendafilja dhe e hapi laptopin, gati mbeti pa mend. Hakerët, me siguri Dilinxhiu me macje në prehër ua kishte

shperndarë një film “dokumentar” porno me një zezak dhe pesë gra azgane bythekrye në shtrat. Mëzati i hazdisur bytrynte nëpër dhomë, ndërsa grave histerike u shkonte zëri për qielli. U përpoq ta fshinte “kryeveprën botërore”, po nuk fshihej dot nga faqja e dheut. Ndihmë kërkoi në të katër anët, po edhe ato nuk dinin si ta hiqnin këtë damkë të zezë nga mesi i luleve.

Dhe, përfundimi: Trendafilja e mbylli Facebookun. Përsëri, filloi të bie herët në shtrat me burrin. Pasmesnate, kur i kujtohej filmi dokumetar porno edhe tërbohej në shtrat si shterre mes livadheve. Tërmeti e dridhte dhomën. Shtëpinë. Herët në mëngjes, tashti fëmijët e kishin edhe nga disa copa buke me reçel.

Vetëm, unë si shkrimtar përsëri nuk jam rehat. Frikë kam, Trëndafilja mos e hapë prapë Facebookun. Telefonin me orë të tëra duke u marrë me thashetheme. Shkaku, se: kush do t’i durojë përsëri gjithë ato “poezi patriotike”, lule, shqiponja kuqezi në flamur, personalitete historike. Shtrat të zbrazët deri në mëngjes. Fëmijë të pikëlluar në rrugë me lot ndër sy edhe pa një copë buke me reçel, që i pret në shkollë vjersha e xha Naimit…

## PUNËMADHJA

Interesant, ë?! Punëmadhja, gjithë jetën me flamurin kuqezi krahëve mbeti duke festuar "fitore" me çifteli dhe duke këndur këngë e zbuluar përmendore nëpër varre. Në Facebook duke shkruar "pizi" patetike të ilustruara me trëndafila plot patriotizëm e thashememe. Burrë, as grua nuk la pa e marrë nëpër gojë. Nuk la familjar e farefis pa e shpallur dëshmor lufte. E në realitet, ende gërhet në gjumë për liri.

Punëmadhja, lirinë pret t'ia sjellin "vëllezërit" mbi kalë me shalë. Edhe, atë: Rrugës para koçisë t'i pri vetë me flamurin kuqezi hedhur krahëve si ferexhe, edhe sot si dje t'i këndojë këngë patetike me dajre.

Herë pas here krushqit partiak mes maleve të shkrepin edhe pushkë. E, Punëmadhja, nën hije të blirit t'ia thotë këngës: Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola???!!!... Vit për vit derdhë gjakun deri në gju, sa mbytet edhe kali si te ajo kënga e njohur popullore. Shkaun ta vrasë me çifteli e dajre.

Përçudi, Punëmadhja në ditën e sotshme e shtrembëron përmbi vetull edhe shaminë e zezë. Ferexhenë e hudhë krahëve për liri. Shkaku, se: "pizitë" e saja patriotike i ka vlerësuar një "kritik" i madh i Fcebookut. Doktor Madhi i "tabanit kombëtar", që në faqen e vet i ka futur në një thes të gjitha personalitet letrare shqiptar ballistë e komunistë, dhe shkruan recensione pa asnjëfarë kriteri letrar: kunguj Stambolli, speca të kuq, banane, kastraveca, patate, domate, dardha gorrice, mollë të egra, kumbulla të zeza me

krimba… I futë në thesin me arna dhe ua lidhë grykën nye t'i shesë në Bit-Pazar. E mashtron veten, po edhe çiftin e Punëmadhes se "pizitë" e tyre janë të përosusura "antologjike". Merreni me mend, në këtë kohë, kur edhe Shekspiri nuk është i përsosur. Askushi i bëhet mëzat (Muzë) Punëmadhes natë e ditë nëpër tubime partiake të kërkojë të drejta të barabarta kombëtare të grave. E presë në dritare ose shtrat me trëndafila të kuq në dorë Dum Dumin me gunën hedhur krahëve t'i kthehet nga lufta e "përgjakshme" për liri. Tjetër punë është ajo se, Punëmadhja gjithë natën rri qafë për qafe me "vëllezërit" e ditën me "patriotët" kuqezi heq valle me shami për Shqipëri Etnike. Përditë na e ulë çmimin, na shet lirë, të mos them pa pare në Bit-Pazar.

Punëmadhja, përveçse merret me politikë madhore, herë pas here bënë edhe kulturë shqiptare të "vëllazërim-bashkimit". Papritmas, e zemëruar përtej kufirit, përshkak se, rastësisht e paska gjetur veten në ndonjë shkrim timin profetik, përmes SMS ma dërgon një "pizi" të saj më të re "antologjike" që posa ka dalë nga furra e saj me kashtë.

Falemnderit, Punëmadhe për "pizinë antologjike". Unë ta zgjata dorën në kohët më të vështira, të ngrita nga bërlloku më këmbë. Vite me radhë të kam shëtitur me xhip së bashku me Tri Muzat e mia poetike edhe nëpër manifestime kulturore. Redaktimin e fletoreve të tua me vjersha e tregime që ta shohin dritën. Pavetëdije se, e kisha pasur për krahu spiunen e gruas sime besnike. Shpeshëherë për ty si grua e pakrah kam hyrë edhe në luftë, kur t'u sulën ujqërit në

gazetën e "vëllazërim-bashkimit". Nuk e di për cilën grua apo Mike e ke fjalën të cilën e pagëzon "hale". I kam shumë gra e Mike, me qerre. Mjerisht për ty si xhadi, për nga dhuntitë  që ua ka dhënë Natyra dhe Zoti, janë mbi nivelin tënd artistik: Edhe për nga morali, edhe për nga vlerat e arrira artistike. Megjithatë, unë nuk kam fuqi dhe nuk mundem të të bëj poete, nëse nuk ke lindur, nuk e ke dhunti nga Zoti! "Pizinë" tënde e publikova shkaku se, përpiqem të ta heq disi atë bindje, urrejtje fanatike që ke për burrat. Ose, siç ke thënë edhe vetë në disa biseda rasti: "unë i ha burrat". Realiteti flet ndryshe: Ty nuk të "hanë" burrat, po as edhe qentë me zgjebe. Fundi i fundit, mos i humbësh shpresat, ose bindu  më  në fund në këtë shkrim miqësor se edhe ti po të duash me pak përpjekje dhe punë shtëpiake në Kopësht, mund t'i bëhesh Muzë ndonjë hadumi teknefes të Nënës Parti me herdhet nëpër këmbë.

Tjetër punë është ajo se, Punëmadhja më kishte spionuar edhe te Eshkundura. Gjatë një takim rasti ia kishte përplasur në fytyrë: Miku yt ka qenë dashnori im me të cilin e kam kaluar natën në një hotel të Qytetit. Pastaj, ai ka qenë "viktimë"  e disa grave azgane që i përmend nëpër libra. Vetë këtë denoncim "policor" të Punëmadhes ma përcolli Eshkundura. Edhe më mori në pyetje, "bisedë informative" një natë të ftohtë dimri. Edhe merreni me mend, kur Eshkundura të merr në "bisedë informarive", më mirë të të marrë UDBA Jugosllave, CIA ose KGBA -ja. Djersët më shkonin çurg ballit deri në fund të këmbëve. Ndoshta, thashë: pasi e pranon ajo, po unë me këmbëngulje e hedh poshtë

shpifjen tendecioze të asaj xhadie. Mezi shpëtova atë natë, i thashë: ku ta di unë, nuk më kujtohet "krimi", ndoshta kam qenë i dehur me raki rrushi atë natë pa Hënë. Po, me Zonjën Di?! Edhe, për këtë do të më thuash se ke qenë i dehur-tapë. Jo, nuk do të të them për këtë Engjull grua. Zonja Di vetëm më shoqëron nën Rrap kur pimë së bashku verë nën hije. Gji më jep me dy shtamba për poezi, fuqi për luftë. Budallai, më tha

Eshkundura, vazhdo ta mashtrosh veten se unë nuk di gjë, vetëm po të zura me pelë për dore të gjitha do të m'i paguash në shtrat. Dhe, iku e zmeruar nëpër natë. Kohën e fundit, siç ka paraljmëruar Punëmadhja shkruan edhe një libër me "pizi" patriotike për Mëzatin e tredhur si "dëshmor" lufte. Thesin në shpinë do të turret me të katra ta përurojë nëpër IRJ të Maqedonisë, Kosovë e Shqipëri. Përgjumshëm merret me reklamimin e "pizive" të veta patetike, skuqur me gjak, "flamuj tregtar" të Ernest Koliqit e varre nëpër Çarshi të Shkupit. Edhe atë: plot pordhë e piskamë në Shtëpinë Publike. Dy sahat nëpër Çarshi, para këmbëve të kalit të Skënderbeut e bën Shqipëri Etnike. Kaq, për sot në këtë ditë feste. Pastaj, tërhiqet nëpër çajtore mes faqes së Facebook -ut si "fitimtare" dhe gjithë ditën duke pi çaj rusi bënë politikë madhore shqiptare.

Veprime patriotike këto pa krye të Punëmadhes, që ma kujtojnë edhe një histori të hidhur të vendasit tim gazetar (H. H.), ish i burgosur politik në Burrel në kohën e Enver Hoxhës. Përmes tij mësova shumë rrëfime për funksionimin e spiunimit në sistemin komunist në Jugosllavi e Shqipëri. Që, në atë kohë, emisionin

informativ për shqiptarët jashtë atdheut tinëz e dëgjoja përmes valëve të Radio Tiranës. Në bisedë e sipër, herë pas here i dëshpruar edhe për këtë sistem komunist kur u kthye  në vendlindje, që e gjeti në Jugosllavi më thoshte: ti je vetë dreqi në tepsi. Vështirë e kanë të të mashtrojnë "vëllezërit" me ndonjë pusi pas porte, zënë në grep si rob lufte. E dija se ku e ka fjalën, prandaj nuk e lodhja për sqarime. Tjetër punë, "frymëzimi" më intersonte mua si shkrimtar. Në çdo hap pas shpine kisha plotë spiunë që më ndiqnin këmba- këmbës pas shpine. Plotë provokime patriotike. Edhe sot, kam me qerre.

Shumë më shumë, në atë kohë më befasonin veprimet dhe metodat e spiunimit të këtyre dy shteteve komuniste, sesa vetëvetja kush më ndjek pas shpine si qeni me zgjebe matanë porte i shitur për një asht.

Djalë i ri, ky vendasi im ishte kur e hodhën matanë kufirit nga Mali Zi me dy-tre shokë për gjah "të freskët" shqiptar. Ne punonim, më thotë ai: me arsyetim dhe keqardhje në Serbi si punëtorë krahu ose shkolloheshim në atë shtet komunist për "vëllazërim - bashkim". Vite me radhë gjatë shkollimit edhe na përgadisnin, për spiunim që një ditë të na hedhin si krah pune spiunazhi në Shqipëri. Dhe, një ditë me emra e mbiemra të tjerë, vendlindje të rrejshme nga Serbia, Kosova e Maqedonia natën na nxorën matanë kufirit. Porosi kishim, që dhjetë vjet të mos merremi me aktivitete spiunimi, mos bimë në sy si të dyshimtë të na zënë me pelë për dore. E pas dhjetë vjetëve, pasi ta marrim veten të merremi me detyrën "fisnike patriotike

atdhetare”. Vërtet, në atë kohë si emigrantë që kishim “ikur” nga Jugosllavia dhe nuk e “donim” sistemin komunist jugosllav, kishim mjaft privilegje shtetërore: poste në Qeveri, vende pune, pagesa shtesë dhe jetë normale si qytetarë lojal të këtij shteti “demokratik” komunsit. Shumica gjatë këtyre vjetëve “lirie” edhe martoheshim, krijonim familje.

Përçudi, nuk shkonte as një vjet-dy dhe na thirrnin në hetime. Habi e madhe, çdo gjë dinin për ne me emër e mbiemër se nga cili vend vinim për spiunazhë.

Inspektorët e sigurimit na pështynin në fytyrë si spiunë titist dha na rrasnin me vite në burgun e famshëm, Burrel. Shkaku ynë, për shkak të provave, ndonjëherë e rrasnin në burg edhe ndonjë të pafajshëm, që vërtet kishte ikur nga zori për veprime patriotike t’i shpëtojë rrezikut. Ose, siç thotë populli: përkrah drurit të thatë, digjeshte edhe i buti.

Vite më vonë në burg, më thotë vendasi do të mësoj edhe historinë e gjithë këtij zbulimi sekret të kurdisur policor. Njësoj si shteti Jugosllav që përnatë hidhte spiunë në Shqipëri, poashtu edhe shteti Shqiptar hidhte spiunë në Jugosllavi. I pashoq në atë kohë ishte në zbulimin e këtyre rasteve të rrezikshme një epror ushtarak shqiptar me prejardhje nga Kosova në grumbullimin e informatave politike dhe të nesërmen na i thoshte në sy të gjitha të palarat, se: ishim spiunë. Dhe, kishim dalë në këtë anë me emra të rrejshëm për t’ia humbur gjurmët sigurimit shqiptar, dhe vinim nga një vendlindje poashtu e rrejshme për spiunim të hedhur nga Jugosllavia.

"Vëllezërit" edhe sot nuk i kanë ndryshuar veprimet dhe metodat e spiunimit komunist, i dinë këto "gra e burra të kombit" kuqezi brez pas brezi sa peshojnë në kandar, prandaj edhe nuk humbin shumë kohë në veprime për t'i hedhur në mesin tonë si "patriotë" kuqezi për zbulime "antishtetërore irredentiste". Shumicën edhe i kanë marrë në gji, rritur që nga koha komuniste duke i stolisur me tituj shkencor, emërime ambasadorësh nëpër botë, profesorë universitar, vende pune në redaksi e anëtarë të akademive shkencore. E ndërtojnë Shkupin e "përbashkët" modern me përmendore grandioze, institucione kombëtare e kulturë antike. Personalitete të huazuar nga fqinjtë me kuaj me shalë e më këmbë në sheshin e Kryeqytetit. Luanë në të dy anët e urës. Gra gjysëmlakuriqe duke kërcyer bythekrye nga Ura e Gurit në Vardar me bythët mbi ujë. Filipin e Maqedonisë mbi kalë me kokën mbi ndërtesa disaktëshe rrëzë Kalasë.

Punëmadhes, përsëri nuk i pjellë truri. Mendja ma thotë, e ka mushkë. Përditë e shoh se si fotografohet e krekoset para kamerave televizive me "motrat e vëllezërit" në përurimin e kulturës njëpartiake të zarzavateve, ndërsehet pas shpine. Herë pas here jep intervista "ekskluzive". Edhe, krenohet që është pjesmarrëse në "lulëzimin" e kësaj kulture teknefese të "vëllazërim-bashkimit".

Punëmadhja, që deri më sot: përveç thashethemeve dhe lehjeve pas shpine, as edhe një kafe nuk e ka dhënë për kulturën shqiptare…

## QOFTËLARGU

E kthej prapa trurin si në film para tridhjetë vjetëve, në prag të demonstratave shqiptare në Prishtinë. Ose, Pranverën e hershme shqiptare (11 mars 1981). Kohë kjo, kur përpiqeshim të ngrihemi edhe një herë më këmbë si popull shqiptar. Shekuj me radhë i kishim pasur mbi shpinë Perandorinë Osmane, sllavët dhe neofashizmin komunist. Vite robërie kur na bienin bythëve me thupër nëpër histori e mua më kishin hedhur maleve si mësues, përderisa kolegët e mi krijuesë bënin qejfe në kokërr të shpinës nëpër redaksitë komuniste. Aparati burokratik komunist, kur kërkonte në mesin tonë bashkëpunëtorë të devotshëm, "trima" që dilnin në dyluftime me shkrime t'ju kundërvihen në atë kohë intelektualëve më të zëshëm "nacionalistë" shqiptar: Ismail Kadare dhe Rexhep Qose. Ndonjërin, e kërcnonin edhe me vende të punës.

Intelektualët e Kosovës në këtë fushatë antishqiptare kanë qenë më të kujdesshëm e të vendosur si vizionarë. Propagandës sllave i vinte të plasë nga inati, pse në mesin e gjithë këtyre intelektualëve që i kishte Kosova, nuk gjenin as edhe një për farë t'i kundërvihet Ismail Kaderes, që në atë kohë mori guximin t'i dalë zot Kosovës. Mezi e gjetën më në fund një "krijues" anonim që punonte si gazetar në Radio Prishtina të dalë me një shkrim sakat kundër Ismail Kadares. Heqin qafe kërkesën politike të Partisë Komuniste. Në Shkup ndodhi katastrofa diferencuese: Teki Dervishi që nuk pranoi të dalë me shkrime kundër

Ismail Kadaresë u përzu nga puna, ndërsa dy kolegët e tij shkrimtarë që punonin në të njëjtën redaksi të "Flakës së vëllazërimit", i rrejti mendja se mund të maten me gjeniun e letrave shqipe, dolën me shkrime teknefese në vezhdime kundër shkrimtarit "nacionalist" me famë botërore. Vetë në atë kohë kam qenë dëshmitar i këtyre fushatave të papara diferencuese kundër intelektualëve shqiptar. Edhe mua, permes mashave shqiptare  në mënyrë indirekte mu vardisën në Shkup: pse nuk del me një shkrim kundër Rexhep Qoses, ti je më i madh se ai si shkrimtar, edhe më guximtar në shkrime letrare. Vetëm dil thuaja të vërtetën e "vëllazërim-bashkimit" në sy, punën tjetër të karrierës artistike na e beso ne të Lidhjes socialiste. Ditën, vetëm zgjidhe ku don ta gdhish, në cilën redaksi në gjuhën shqipe si redaktor.

E vështirë ishte edhe përgjigja intelektuale në atë kohë qorre, të shkonte koka si qenit në rrush. Patjetër, duhej gjetur rrugë. Edhe, e gjeta: Rexhep Qosja është intelektual i madh shqiptar, habitem se si pajtoheni ju që t'i kundërvihem unë si shkrimtar. Mirë do të ishte të gjeni ndonjërin të rangut tij intelektual, ose së paku afër tij me vlera të arrira intelektuale. Realiteti, e kam pasur edhe profesor të studimeve në Prishtinë. Pak vetë do t'ju besojnë këtu në Shkup, që unë t'i kundërvihem profesorit tim të nderuar Rexhep Qoses me thashetheme. Fat i imi në atë kohë, edhe nuk kisha të humb ndonjë post që ma kishte dhuruar për merita të pakapërcyeshme Partia Komuniste, përveçse atë: të mësuesit të maleve.

Edhe, e dini çka: falë Zotit shpëtova nga një grep i rrezikshëm politik komunist i asaj kohe që edhe sot e kësaj dite do ta kisha si barrë në shpinë. Ndonjëri nga kolegët e mi e hëngër grepin komunist, fitoi poste e vende pune, çmime letrare, avansime në karrierën e tij letrare. Vepër kjo "patriotike", të cilën e vazhduan edhe gjatë ndryshimeve demokratike. Qoftëlargu do të merret edhe me projekte "madhore" letrare, përkthimin e veprave të shkrimtarëve më eminent të Shqipërisë, ne mesin e tyre edhe të Ismail Kadare. Vetëm se, kurrë nuk do të arrij gjatë përurimit të atyre librave ta mashtrojë me një "darkë të fshehtë", sjellë Ismail Kadaren në Shkup. Rolin e argatit besnik do ta bëjë edhe në hartimin e Enciklopedisë maqedonase, Letërsisë maqedonase, ndarjen e çmimeve letrare e republikane. Dorën në zemër, aspak sot nuk ua kam lakmi, mjafton dhe gëzohem që mbeta gjallë, nxora në dritë edhe ndonjë libër. Rrugës, vërtetë morëm shumë plagë, po megjithatë e vazhduam luftën me penë për në Liri.

Maleve ramë dhe u ngritëm përsëri për Liri. Armiq shekullor i patëm pushtuesit dhe gjakprishurit si pjellë meleze të popullit heroik shqiptar. Krah për krahu, gjatë periudhës komuniste na luftuan dudumët në anën tjetër kundërshtare me shokët. Megjithatë, luftën edhe sot e kësaj dite nuk e ndalëm për Liri.

Shkaku: E dini edhe pse ne nesër do ta fitojmë Luftën?! Lirinë. Shqipërinë Etnike. Jo, nuk e dini o burra! Ne bëjmë luftë nëpër shekuj për Shtet etnik shqiptar.

Vite ma radhë vdesim maleve, armët ende i kemi në dorë. E di, ju do të thoni: I dorëzuat pas Luftës së fundit (2001) në IRJ të Maqedonisë. Jo, të gjithë shqiptarët. Përmëtepër, ne tashti kemi rrok në dorë armë edhe më të fuqishme se bomba atomike: librin dhe penën.

Edhe kësaj radhe Qoftëlargut me shokë nuk do t'ia përmend emrin, as nofkën me të cilën e kam emëruar nëpër libra. Shkaku se: "miqtë" e mi të penës m'u ankuan, më thanë mjaftë më me atë Qoftëlargun! Pse, nuk e len t'i mbyllë ditët e fundit në rehati dhe paqe. Pajtohem me ju, u thashë: po, sikur ky Qoftëlargu me shokë të pushonte së vepruari, mos t'i ngatërrohet ende popullit shqiptar nëpër këmbë.

Vetëmse, Qoftëlargu nuk heshtë, posa ne e marrim veten si shqiptarë, ngrihemi më këmbë, ky rrufjan me shokë na hyn nga dera e madhe në Shtëpi si "patriot" kuqezi. Ende vazhdon me "flijime artistike" shumë vetë t'i marrë në qafë. Vite me radhë, që nga koha e komunizmit e luan rolin e "shpëtimtarit" Noes, e në realitet është këmbë e kokë rrufjan. "Patriot" kuqezi në barkun e Kalit të Trojës nëpër Bit-Pazar, që edhe gjatë kohë do të kemi probleme me vetveten si shqiptar, përderisa këtë soj "patrioti" kuqezi nuk e përcjellim me lule dhe flamurin kuqezi mbi arkivol në varr.

Ditën e nesërme besoj se, pa këtë soj melezi me shokë, gjak të fëlliqur, do të marrim lirisht frymë për në ardhmëri. Baba Tomor. E dini pse?! Jo, edhe këtë nuk e dini si shqiptarë. Problemi kryesor, jo i yni po i "vëllezërve": nuk do të kenë

kakademikë shqiptar, kryetarë partie, ambasadorë, ministra, deputetë të popullit.

Zërin vazhdoj ta ngrej mes këtyre rreshtave: a ka forca populli shqiptar t'i hedhë nga samari në kokërr të shpinës këta dudumë me zgjebe? Vite me radhë na ngatërrohen nëpër këmbë, na shesin lirë te "vëllezërit", e deri më tani i kanë shëtirur të gjitha partitë politike shqiptare. Dihet, me poste dhe një torbë taxhi për qafe në Qeveri. Prandaj, edhe një herë ju them: hidhni nga qafa këta dudumë shqiptar! Gomarët me të cilët unë nuk do të shkoja as për dru në mal e ku më në politikën shqiptare.

E ju, nëse mendoni me këta gomarë të bëni politikë madhore, Shqipëri Etnike, Bashkim Evropian, ja ku i keni me të gjitha postet politike. U qofshin falë! Vetëm, patjetër e kam borxh t'ua them edhe një fjalë: nësër mos u ankoni se ju dolën tradhtarë.

Edhe, publikisht e pyes veten në ditën e sotshme: a kemi ne shqiptarët mjete të informacionit që kësaj pjelle neokomuniste ti dalë ballë për ballë?! Jo, nuk kemi, përgjigjem vetë unë autori i këtij shkrimi. Vallë, kush e ka fajin?! Përsëri, nuk e dini?!

Hi-hii-hiii… Qoftëlargu me shokë si këshilltar besnik i Partive politike…

## PËRPAK DESH I PËRZIMË KËSULAT

Dje, e humba të drejtën e anëtarësimit në ndonjë parti politike shqiptare. Sot, faljen e pesë vakteve në xhami. Shkaku, se: Përderisa unë vendosja t'ju trokas te dera si mik, kalorësit e arratisur veç më ishin ulur në rendet e para me këmbën përmbi këmbë. Përditë i ndërronin partitë politike si kurva burrat. Moti e kam thënë: Kurvë nuk është gruaja që shkon burrë më burrë, po politikani që shkon parti më parti. Edhe, u pajtova me fatin: falë u qofshin në këtë jetë e në atë jetë të gjitha postet e shpërblimet partiake! Nuk ua kam aspak lakmi. Rroftë për mua poezia, vera dhe gratë! Gjithë jetën po të duan le të bëjnë politikë madhore: le të bëhen shkrimtarë besnik të partive politike, ministra, ambasadorë, deputetë të popullit, drejtorë e zv/drejtorë, besimtarë të Allahut…

Mirë e kam edhe kështu unë kaçaku i fushës, për inat të tyre do të merrem me kulturë dhe shkrimin e ndonjë libri. Ditët në fillim kalonin mirë, ata merresheshin me politikë madhore e unë me kulturë. E dinim kufirin e Çifligut të xha Derellës te Përroni i Thanës. Asnjëri nuk përziheshte në arën e tjetrit për ta prekur kufirin, të mbjellë misër për sorrat. Dardhën gorricë me vite e kishim të përbashkët për hije gjatë verës.

Përçudi, kjo "marrveshje patriotike" nuk zgjati shumë, njësoj si ajo marrëveshja e dikurshme historike "shqiptare-jugosllave". Burrat e kombit nuk e mbajtën fjalën, papritmas filluan të merren edhe me arsim e kulturë.

I përvetsuan gati të gjitha manifestimet kulturore dhe i politizuan deri në palcë. Ose, themeluan institucione kulturore partiake, siç thonë "vëllezërit" paralele. Vërtetë, ne i themeluam në kohë të vështira, kur "vëllai" na rrinte me sopatë mbi kokë, po tani manifestimeve kulutore u delë zot Partia. Edhe, i organizon për çdo vjet, dihet më në "nivel" si politikën shqiptare. Populli thotë: sa për sy e faqe, plot zhurmë e piskamë në mes të Dimrit. Edhe atë, duke i veshur vetëm me një ngjyrë partiake, kur dihet se kultura nuk i takon vetëm një partie politike, po mbarë popullit shqiptar. I hurit e i litarit, siç thotë populli merr pjesë nëpër këto manifestimre kulturore: kalorësit e arratisur, pashterkëkuqet, patriotët e vonuar, rrufjanët, Trëndafilet shamizeza e partizanët e sotshëm si shkrimtarë partiak. Vetëm, mall e ke të shohësh ndonjë artist babaxhan mes këtyre patriotëve të vonuar. Dumdumët hipin në foltore dhe për dy sahat e bëjnë Shqipëri Etnike. Gati të gjithë duan të duken, marrin fjalën për diskutime të zjarrta, edhe harrohen nëpër betejat e përgjakshme neokomuniste. Orë të tëra i maltertojnë në foltore me "heroizmat" e tyre të dikurshme patriotike të pranishmit në sallë. Shpeshëherë, ndodh ta humbin rrugën edhe partizanët partiak të punësuar si argatë nëpër instuticionet shtetërore, që rregullisht më shumë marrin pjesë nëpër këto takime kulturore që t'i shoh Baba Parti, sesa për hatër të librit.

E di, ju do të thoni: edhe ju poetët rebelë më nuk duroheni me vargje profetike, poezinë e keni

zjarr. Dorën në zemër, e kemi edhe flakë, por kur i shohim këta kalorës të arratisur krah për krahu në mes të sallës si e kanë rrokur librin shqip për fyti, nuk na shkrep-ndizet as poezia. Plas ti po deshe gjithë ditën duke i fry zjarrit, xixë nuk del mbi çati në atë sallë të ftohtë polare. Rrugën e hapi Edi Rama me librin "Kurban". Lëmë, siç duket që e shtruan partitë politike për të fshirë kulturën shqiptare e gjetën Shkupin. Turr nga të katër anët e Atdheut me thesin plot arna me libra në shpinë. I nxjerrin librat "besceler" mbi tavolinë si kungujt e Stambollit. Tjerrin mendime "filosofike", flasin jerm për lënjët e tyre që nuk i hanë as lopët e Koperativës. Kotnasikoti i duartrokisin të pranishmit, t'i përfundojnë lëvdatat e gjata patriotike për njrë-tjetrin se, po derdhet grosha.

Dhe, ma kujtojnë thënjen e satiristit Niko Nikolla në një Akademi përkujtomore për Mehmedali Hoxhën (1997), në Strugë: Nuk ka popull shqiptar, po popull shkrimtar. Vetmevete them: Shkupi siç duket në këtë Njëqindvjetor të pavarësisë së Shqipërisë nuk paska punë tjetër më të mençur, përveçse përurimit të librave të kalorësve të arratisur. Plot gojën them: Lum ky popull me gjithë këta "patriotë e shkrimtarë". Lakmi është për t'ia marrë edhe bota. Dhe, habitem si është e mundur me gjithë këta trima lufte që e rrokin topin për fyti, ende ky popull ta gëdhijë mëngjesin në robëri.

Përmëtepër, na e gërditën politikën, tashti janë duke na e gërditur edhe librin me poza patriotike. Punemadhe, që fëmijët tanë ende nuk kanë tekste

shkollore, lektyra shkollore, revista për fëmijë… Pajtohem me trumbetimin e partizanëve të arsimit: e ardhmja u takon fëmijëve, e kalorësve të arratisur e sotshmja, që nguten për së gjalli duke u shtyrë me bërryla ta fusin veten me zor si "çlirimtarë" në histori. Tekefundit, ne nuk u prëzihemi në bërjen e politikës madhore në Qeveri, në Kuvend, ministri. Përse, atëherë së paku nuk e lënë rehat të marrë frymë në ditën e sotshme arsimi dhe kultura shqiptare?!

Realiteti, unë nuk shkoj edhe aq shpesh nëpër këto "manifestime kulturore" të partive politike. Herë më bëjnë ndonjë ftesë, herë nuk më bëjnë nëpër dasmat e tyre partiake. Ndonjëra, ndodh edhe e humb rrugën nëpër Bit-Pazar. Ose, ma ka harruar Shtëpinë, tavanin me dërrasa si te ajo kënga popullore e Rexhep Zajazit: "Çitmi çikë santiret se plasa".

Ku ta di unë autori i këtij shkrimi, ndoshta edhe tremben mos shkruaj për "flijimet e tyre artistike", ndonjë elegji me çifteli gjatë dyluftimeve të tyre për pushtet pa pushtet. I dorëzuan armët, tashti rrokën në dorë librin për luftë. Përmëkeq, ndonjëri ose ndonjëra nga "burrat dhe gratë e kombit", kur e gjen veten pa ferexhe në shkrime, zemrohet duke sharë shkrimin dhe hedhë gurë e dru mbi autorin. Ndodhë. Megjithatë, unë kam tjetër bindje krijuese se, nuk ia vlen të merret pjesë nëpër këto karnavale partiake me maska, ku partitë politike merren me arsim e kulturë e trusakatët-intelektualë me politikë. Vërtetë nuk dinë të bëjnë politikë madhore këta ekzemplarë të rrallë të

"vëllazërim-bashkimit", ama kulturën siç duket e "hanë", përtypin me dhëmbë.

Përinat të gojëkëqinjve edhe disi pajtohem me fatin e krijuesit. Thashë: Tashti e tutje do t'i ndërrojmë profesionet, politikanët do të merren me kulturë e ne intelektualët me politikë. Suksese të pakaprëcyera treguan në arsim, ndoshta u ecën qerrja e thyer mes maleve edhe në kulturë. Që sot, tashti filloi fushata parazgjedhore: partitë politike do të merren me arsim e kulturë e ne njerëzit e artit me politikë. Moti kisha dëgjuar nga im Vëlla, që kishte hëngër bukë në një sofër me Abaz Ermejnin në Paris, se: shqiptarët janë të prirur të gjithë të merren me politikë. Edhe maxhatorja, edhe bujku, edhe bariu, edhe berberi, edhe këpuctari, edhe tullumbaxhiu, edhe hoxha, edhe lypsi, edhe rrugaçi… Popull i çuditshëm jemi ne shqiptarët, që  në  të  ardhmen patjetër me ne duhet të merret për studime nëpër laboratore shkenca. Askund në botën përparimtare nuk ndodhë ky lulëzim marrëzie siç ndodh te ne shqiptarët. Po e pyete dikend në Vashington se, kush është president i Amerikës, do t'i rrudhi krahët. Përgjigjet, nuk e di. E te ne shqiptarët, edhe fëmijët e djepit po i pyete kush janë kryetarët e partive politike më të mëdha shqiptare, do të të përgjigjen njëzëri: Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi.

Botën ta lëmë pak rehat me problemet e veta politike, të kthehemi te ne shqiptarët. Burrat e mejdanit, që gjithmonë i ke në rendet e para, qofshin politike, fetare apo kulturore. Arsimin dhe kulturën i kanë si poligon ku i reklamojnë para kamerave televizive "fitoret" e tyre politike.

Ndodh, ndonjëri edhe të shtyhet me bërryla para gazetarëve. Në xhami kur e do nevoja, i vënë në përdorim edhe grushtat. Muaj më parë e nxorrën me grushta nga xhamia edhe besimtarin e Allahut, Haxhi Deputetin.

Përpak, një skandal i tillë të më ndodhë edhe mua në një përurim të librit. Padashtas, shkaku vendeve të lira, u ula në rendet e para duke menduar se nëpër këto aktivitete kultuore kur na digjet zjarr mbi krye, nuk vinë politikanët. Thashë: haj t'i shoh burrat e mejdanit edhe si bëjnë kulturë shqiptare në "liri". Mjaftë më i përcolla vetën nëpër ekranet televizive. Për bela, mu atë natë erdhën gati të gjithë krah për krahu: ministra, ambasadorë, drejtorë, funksionarë politik, rrufjanë, hoxhallarë… Përçudi, mungonte vetëm Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi.

"Vëllai" kujdestar i Shtetit të përbashkët, që përkujdeseshte për mbarëvajtjen e përurimit të librit pas pak kohe më tha: duhet të ngritesh nga ky vend për dy - tre rende më mbrapa se na erdhën papritur kalorësit e arratisur: ministrat, ambasadorët dhe funksionarët e Babës Parti.

Mirë, ore burrë i them: po, unë jam ulur në rendin e katërt, nuk jam në rendin e parë, vend i rezervuar gjithmonë për politikanët. Tekefundit, unë kurrë nuk u kam shkuar në Qeveri, Kuvend, as në ministri t'ua zë vëndet, e as në selitë partiake t'u lutem për poste e emërime të ambasadorëve. Unë gjithë jetën ulem mbrapa me popullin, në karriget e fundit, sot për herë të parë u ula pak më para dhe u bë nami. Punemadhe, i thashë partizanit të Babës Parti: nuk çohem nga karriga. Pse të mos ulen mbrapa një herë në jetën

e tyre edhe këta burra mejdani?! Përndryshe, si do të jemi të barabartë me "vëllazërim-bashkim" në shtetin e përbashkët "demokratik"?! Falë Zotit Madh: ministrat, ambasadorët dhe funksionarët politik më në fund u pajtuan që unë të rri në vendin tim, karrige pa poste. E ata, diku në fund të sallës si dashamirë të "flaktë" të librit duke gërhatur në gjumë e sharruar shelgje në livadh për liri.

Dhe, përpak desh i përzimë kësulat…



VII RRUGA E MISTIKËVE PËR NË
BABA TOMOR

## LIQENI KY BURRË - MUZË I POETES REBELE

Flora Sela - Kastrati në librin më të ri me poezi: ***Burrë e kam Liqenin*** me mjeshtri u ka ikur vargjeve të thatë pa gjak e shpirt. Patetikës patriotike duke sjellur risi në poezinë erotike shqipe për Liqenin, sikur është ruajtja dhe ndikimi i poezisë së dashurisë popullore, që në kohën e Lasgush Poradecit. Poezia e saj mes këtyre dy kapakëve ka edhe filozofinë jetësore plot simbole e figura poetike.

***Pano Taçi në mesin e miqve në MKTN: TAKIME NËN RRAP, në Shkup (2011).***

Libri në gjirin e vet e ka edhe tipin e poezisë filosofike - profetike. Zakonisht, këtë lloj të poezisë e kanë shkruar poetë - profetë, që letërsia shqipe i ka pasur edhe para kohës së Romantizmit shqiptar. Stili i përsosur i autores, ku poetja nuk ka shkruar shumë për të Kaluarën, po për Ditën e Sotshme dhe të Nesërme. Vargu kryengritës i poetes e lufton tradhtinë, hipokrizinë, koprracinë dhe grykësinë në mesin tonë latrar me maska. Një spektër më i gjerë objektesh paraqitet në poezinë e saj erotike, e cila dallohet fare lehtë nga poezia patetike - patriotike...

Rruga ujore pëmes Liqenit për të hipur në Shën Num ka qenë e vështirë plotë pengesa e pusi pas ferre, lisi ose guri për poeten rebele. Fatkeqësisht, krah për krahu me rrospi meshkuj e rrufjanë nëpër prita t'i shkrepin armët pas shpine. Në çdo hap papritur i ka dalë para Ujku me këmbën me miell. Dhelpëra duke i fshi rrugës gjurmët me bisht. Gjarpëri kulaç në Diell. Bolla me flokë te Liqeni. Shtrigani i Allahut. Askushi i Nënës Parti, që e ka përcjellë me çifteli në luftë për "liri", e vetë me gjithë familje me të katra ka ikur në bregdet për pushime nëpër botë. Kulminacioni i patriotizmit shqiptar: Ditën e nesërme, pas lufte kur delë në zgjedhje si deputet i popullit, ministër në Qeveri, ambasador në Bullgari. Hero i gjallë lufte. Topin e Mic Sokolit e rrok për fyti. Edhe, gjatë fushatës zgjedhore e shpallë Shqipëri Etnike edhe deri në Azi. Dorën në zemër, edhe pse edhe atje kemi hise, të parët tanë trima kanë mbjellë farë kudo nëpër botë.

Verë e Dimër pandërprerë këtyre anëve kanë fryer stuhitë, ka rënë shi, breshër, dëborë e

madhe. I ka mbuluar dhiaret. Shtegun për dalje në rrugë. Zëra ka dëgjuar pas shpine: ulërimën e Ujkut, vajtimin e Qyqes, këngën e Hutit me veshë mbi çati në breg të Liqenit. Megjithatë, poetja nuk e ka kthyer prapa kokën të shoh kush i vjen pas shpine si hije. Nata e ka zënë, papritmas në breg të Liqenit. Matanë lumit, e ka ditur se përveç gojëligave i kanë vënë pusi edhe dumdumët Nënës parti. Edhe pse, gjatë gjithë rrugës i ka pri Liqni, ky burrë - Muzë. I ka pri para, ndërsa Drini i Zi e ka mbajtur për krahu. Herë pas here i kanë dhënë edhe verë me shtamba. Fuqi për poezi.

Tashti i kujtohet Shën Naumi. Gjoku i lidhur nën hije te Kisha. Vargu i varur në degë. Liqeni, ky burrë - Muzë me dy shtamba me verë në breg te plepat. Muza me të cilin i shkrujati librat me poezi: ***Heu po më çmend ky infuzion*** *(2007)*. Ringjallja në Shën Num te Kisha. Liqeni ky burrë - Muzë duke e vajtuar mbi kokë, që me lotërrushisn e Shën Mërisë Virgjër e ngriti nga varri. Libri me poezi: ***Vazhdoj ta kërkoj të Nesrëmen*** (2009). Edhe, Ëngjëlli burrë që e mori në mbrojtje mes dallgëve të tërbuara, e vodhi nga Zonja Vdekje. Fuqi i dha me dy shtamba me verë, gjak të Krishtit për librin me poezi: ***Burrë e kam Liqenin*** (2012). Djemnusha, Doruntina e ditëve tona shqiptare, Liria që gjatë Luftës së Fundit (2001) na e ndërruan komitat me një tjetër Nuse. Shkaku se, rrotat e koçisë na u thyen mes maleve. Hë për hë iu kthye fuqia si kreshnikëve të Jutbinës, kur e grabitën Tanushën e Krajlit.

Gjoksin e hapi në këtë libër të shtinë rrufetë. Përsëri me nëntë plagë u ngritë nga varri me libra për ta vazhduar rrugën ujore për në Shën Naum.

Vendin e shenjt të Muzave, ku pihet vera, shkruhet poezia dhe bëhet dashuri. Nuses me koçi i doli para me vargun krahut. Flamurin kombëtar me një mollë të kuqe në majë të shkopit lartë në dorë para koçisë. Krushqëve të Lirisë u bashkohet me këngën: ***Hajdeni bini djemtë e Shalës/ përmes sarajeve të Pashës***! Në Shën Naum e shkrep vargun, e bën me dije Liqenin se vjen Nusja me koçi mbuluar me qilima e këmbë arushe. Krushkat për krahu e zbritën me këngë në Lëmë. Cucat shqiptare cope - copë në valle i bënë dajret. Babai e nxorri mauzerrin nga hatullat.

Përçudi, këtë burrë Muzë - Liqenin e murosi gjatë rrugës nën Urë mbi Drinin e Zi me dy shtamba me verë jashtë mureve për poetët që nuk ikin nga Atdheu.

Shkak ky, që përsëri i dha fuqi, u ngritë më këmbë nga varri, në mes të Natës i bërtiti qiellit: verë dua të pi me dy shtamba! Verë. Fuqi për poezi! Përmes dallgëve të tërbuara përsëri të më prinë si dje Liqeni, ky burrë - Muzë. Drini i Zi të më mbajë si Nuse me kurorë për krahu...

Herët në mëngjes, kur i doli gjumi, i hapi sytë: përpak desh e lanë mendtë kur e pa veten e shtrirë sa gjerë - gjatë mbi varrin e Babashehut, në Tyrbe. Liqeni, ky burrë - Muzë i rrinte mbi kokë me poezi, i jepte verë me dy shtamba të zgjohet nga varri me libra. Fuqi të Tri Zanave mes maleve për poezi… Liri…

## RRUGA E MISTIKËVE PËR NË BABA TOMOR

Poezia është shprehje e artizmit poetik, lojë fjalësh, burimisht që kanë qëllim magjik, është thirrje hyjnore, arrin në qiell dhe hedh fuqinë e vet dhe bëhet e fuqishme duke pasur edhe shpirtin e tyre, Hyut. Nuk është ajo e përshkrimeve, përkushtimeve prijësve të partisë, parullave të thata patetike. Rreth nesh çdo gjë është poezi: toka, qielli, dita, nata, ëndrra, era, shiu, bora, zogjtë, lumi, lindja, vdekja, ringjallja… Vetëm, duhet një sy i mprehtë për t'i hedhur në letër emocionet, idetë dhe imagjinata duhet shkrirë në indin poetik me mjeshtri të jashtëzakonshme qiellore.

Dhe, risinë që sjellë poezia e dashurisë në letersinë shqipe i ka rrënjët te lirika popullore, që e ka tejkaluar moti pjesa më e fuqishme e poezisë shqipe, lirika e dashurisë. Dhe, jo rastësisht Lasgushi është poet i madh. De Rada, Serembe, Frederik Rreshpja, Dritëro Agolli, Hida Halimi, Xhevahir Spahiu, Azem Shkreli, Visar Zhiti, Mimoza Ahmeti, Mirko Gashi, Pano Taçi, Gani Xhafolli, Zyhdi Morava etj.

Poezia shqipe është lëruar dhe zhvilluar brenda kufijve politik: Shqipëri, Kosovë, IRJ e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Diasporë. Dhe, përçudi, përderisa në Shqipëri ajo është lëruar përkrah poezisë patriotike edhe poezia e dashurisë, në Kosovë, Mal të Zi dhe IRJ e Maqedonisë është lëruar poezia patriotike. Realitet, që do të thotë se, një popull e manifeston

atë që nuk e ka, i mungon me vite, liria. Risi në poezinë shqipe, sot është kombinimi i dashurisë me patriotizmin. Poetët që e lërojnë këtë lloj poezie numërohen në gishta. Megjithatë, kjo është poezia e ironisë, sarkazmës dhe protestës artistike.

Motivet e poezisë erotike në letërsinë shqipe janë të njohura: besnikëria, tradhtia, ndarjet, xhelozia, malli, sëmundja nga dashuria, mirëpo edhe ëmbëlsia nga dashuria dhe bukuria e trupit të zhveshur. Është interesante se në rolin e subjektit lirik paraqitet në këto poezi, njësoj shpeshherë gruaja sikur edhe mashkulli. Përmëtepër, te disa autorë është e përbashkët tema: jeta pas vdekjes. Ringjallja. Dhe, raporti midis jetës dhe vdekjes. Edhe pse, në kohën e sotshme ende vazhdon të shkruhet me të madhe poezia patriotike, ku gjakohet pas lirisë dhe luftohet robëria shekullore.

Poezia erotike në gjirin e vet e ka edhe tipin e poezisë profetike. Zakonisht, këtë lloj të poezisë e kanë shkruar poetë-profetë, që letërsia shqipe i ka pasur edhe para kohës së Romantizmit: Frakulla, Çami, Zuko Kamberi etj. Stili i poetëve-profetë është i përsosur, nuk vajtojnë për të kaluarën, po për të sotmen dhe të nesërmen. Vargu i kësaj poezie e lufton hipokrizinë, koprracinë dhe grykësinë. Një spektër më i gjerë objektesh paraqitet në poezinë erotike, e cila dallohet fare lehtë nga poezia patriotike. Kështu që mjeshtëria e poetit shprehet me kërkimin e forcave të reja, përsosjen e figurave ekzistuese dhe të proçeseve stilistike duke lejuar shtimin dhe zhvillimin e temave të paprekshme.

Poezia erotike e  ka gjakun dhe shpirtin, që i ecin nëpër damarë. Një përzierje të së resë: dashurisë me patriotizmin. Gjuha e thjeshtë dhe me stilin e qartë, po të thellë është përsosur me imagjinatën e pasur dhe gjuhën e stolisur. Këndimi i poezisë te "*Borë në mars*": *Pas borës së acart – Ti vjen si pranverë/ E nesërmja do të vij/ me Ty*!/ dhe asaj erotike: *Shijen e buzëve Tua/ do ta marr me vete*. *– Po, kam frikë se ma zbulojnë -/ Në kufi*...!/  Vdekjes dhe Lindjes. Ringjalljes…

Dhe, për mua si poet, poezi e fuqishme është ajo që qarkullon nëpër damarë gjak dhe shpirt, i ka thellë rrënjët në poezinë popullore.

Dhe, i japin gji Tri Zana të maleve. Fuqi për luftë si Mujit dhe Halilit… Ikja nga parullat e thata, patetika patriotike është risi e plotë në poezinë erotike, sikur është ruajtja dhe ndikimi i poezisë popullore. Poezia e mirë artistike duhet të ketë edhe filozofinë jetësore plot figura poetike. Poeti hedhë farën në tokë pjellore, ashtu si bujku me hebet në krah drithin në ara, kështu që frutat e pjekur në pranverë, poezitë i lulëzojnë në libër, bregliqen…

Armë e fuqishme është edhe lirika satirike, ku poeti përqesh momente njerëzore, politikën me prijësit e tyre, madje edhe vetë fatin e popullit shqiptar. Origjinaliteti i poetit, fatkeqësisht ende është në kundërshtim me dukuritë imorale dhe idetë e kohës, në të cilën jeton brenda kufijve politikë.

Poezia erotike shqipe sa vjen e më shumë demokratizohet dhe misticizmi depërton thellë e më thellë në art.  Dashurinë ndaj lirisë e paraqet

me shprehje plot figura dhe me gjuhën erotike të lirikës së dashurisë. E zhvesh nga trupi ferexhenë patetike dhe parullat e thata dhe i vesh rrobat e nusërisë. Në poezinë erotike shqipe, nganjëherë është shumë vështirë të dallohet deri ku shkon alegoria e ku fillon shfaqja realiste. Vetë gjuha shqipe, gjuhë e poezisë ka disa veçori të saj poetike, e përshtatshme në paraqitjen e dy-tre dykuptimësive të vargut. Megjithatë, në këtë poezi ekziston edhe një rrezik stereotipash, sepse ajo bazohet në disa tema të përsëritura: dashuria, vera, bukuria.

Që, poeti shqiptar sot më e ka tejkaluar me sukses dhe pasuruar me Baba Tomorin si vend i perëndive: Rrapin, Miken, vetminë, Lotët e Shën Mërisë, Gjakun e Krishtit, Burrin, Engjëllin mbrojtës grua, Nimfën. Qiririn, Natën e Madhe etj.

Inspirimi i poetit është i sinqertë dhe i thellë duke u shërbyer me shprehje të larta poetike. Formën e një vargu mes legjendave, porosish dhe alegorish. Tendencë kjo, për të krijuar një rrymë të re letrare me shumë vazhdues dhe përkrahës për një të nesërme. Poeti rebel është i gatshëm të rroket fytas edhe me Zonjën Vdekje. Ringjalljen. Lindjen. Robërinë. Lirinë. Shkurt, ballafaqohet me misteriozen: dashurinë qiellore dhe tokësore.

E di se, rrezik për poetët e talentuar me dhunti nga Zoti, janë poetët e rrejshëm të oborreve të partive politike. Poetë pa talent, po të shkathët t'u vihen pas partive politike në pushtet, si dhelpra pas dashit, me shpresë se mos i bien udhës. Poetë të këtillë vetëm për një përdorim, letërsia shqipe

ka me bollëk, sa kanë të hanë edhe qentë e rrugëve…

Herët a vonë, këta poetë do të dështojnë në poezi. Rrugën do t'ia lëshojnë poetit-profet, lirikut me mendime të thella dhe me talent të madh vrojtues, kur është fjala për situatat e përgjithshme njerëzore, i cili ka qëndruar, në të vërtetë, mjaft indiferent kur është fjala për ngjarjet politike të kohës së tij pseudopatriotike.

Vargu i luftarak, përjeton një lulëzim të ri të lirikës shqipe. I lëshon paragjykimet, maxhen, burgun shtëpiak… Ferexhenë e hudh në përrua…

Robërinë... Shkolla letrare është shtegu i tij drejtë Lirisë… Universiteti… Biblioteka… E nxjerrë vargun nga brezi. Poeti është me shpirt krenarë dhe i vetëdijshëm në paraqitjen e realitetit shoqëror, kështu që për këtë poet rebel jeta e varur nga partitë politike është e huaj. Tentim ky, i komunizmit që tërë jetën e shoqërisë ta ketë nën kontroll. Hap i gabuar ideologjik me të cilin dështoi në parashikime. Tashti e kanë radhën partitë politike "demokratike", shkaku se poetët bëhen edhe më të fuqishëm. Stili i tyre është sakrificë, ndjeshmëri e poetit dhe sinqeriteti. Përsëri do të vdesë dhe ringjallet mes poezive, por kurrë nuk do t'u bie duarve dhe këndojë arritjeve të tyre demagogjike.

Shkëputja e poetit nga format klasike poetike nuk qe proces i lehtë, me vete mori edhe viktima artistike. Nuk është punë e lehtë t'u ikësh ndikimeve nga letërsia ruse (Shqipëri) dhe jugosllave (Kosovë. Mal i Zi e IRJ e Maqedonisë).

Poezia shqipe moderne sot ka një rrezik nga poetët e oborrit të partive politike "demokratike". Fatkeqësisht, falë Zotit, në përgjithësi janë poetë të dobët dhe pa talent. Megjithatë, poezia e ardhmërisë do të jetë poezia e verës dhe e dashurisë, që alegorikisht të paraqesë dashurinë hyjnore dhe dehjen e mistikëve në Baba Tomor...

Ardhmëria e poezisë shqipe qëndron në traditën e poezisë popullore, Rilindjes shqiptare, duke u pasuruar me rrugë të reja, për të hipur në Baba Tomor. Atdheun e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri…

***Hida Halimi pas pranimit të çmimit letrar: "RRAPI", për vepër jetësore nga Gani Xhafolli.***

## SANÇO PANÇOT HIPUR MBI GOMARË

Më ecet ende këtyre rrugëve të gjata, por pleqëria më troket në derë. Çudi! Nuk mundem të ndahem aq lehtë nga bërlloku… Konservat… Ndjekjet… Rënjet… Ngritjet… Pasuria… Varfëria… Bukuria… E shëmtuara… Qenkan do punë të fshehta, që paskan në vete magnet. O bir, o bir! Sa do të gëzohesha sikur magneti i tyre të mos tërhiqte, po të shtynte, të shtynte në theqafje. Do t'ua ktheja shpinën njëherë e përgjithmonë, pa asnjëfarë mëshire gjithë këtyre bajgave politike. S'do e mundoja veten të eci me sy të mbyllur shtigjeve… Dhiareve… As t'u ngjitem këtyre shkallëve përpjetë, që të zbresin kaq poshtë, përdhe. Nuk do të lejoja të ec pas Hijes që më ka lidhur për brirësh për në varr. S'e kisha marrë kaq lehtë këtë vrapim maratonik për në zero. Po, do t'ju bija mbeturinave neokomuniste me këmbë. Natën do të ecja symëshelë në dritën e Hënës. Ditën do ta merrja shkopin në dorë…

- Zoti Shkrimtar, këmbët po më ecin vetë për në xhami.

- Plak, mos hip në qerre!

- Jo, zoti Shkrimtar. I kam këmbët.

- Plak, ki kujdes mos e gabosh udhën!

- Zoti Shkrimtar, e di unë udhën edhe natën për në Shtëpi…

Dhe, ju mund të më shani natë e ditë. Nuk do të m'i kuptoni marrëzirat. Do t'i kuptoni më vonë. Ose, kurrë. Por, mua s'më bëhet vonë.

Nuk jap pesë para. Unë gjithmonë kam qenë i detyruar ta ngris zërin kundër duarve të përlyera

me gjak… Koshave të bërllokut… Fytyrave të shëmtuara me kokën te partitë politike shqiptare e bythën te "vëllezërit"… Sanço Pançove të Ali Ahmetit që propagandojnë "kulturë dhe biznes" shqiptar. Kakademikun (Sanço Panço shqiptar), që në hapjet solemne të "faltoreve" shenjta të librit flet përgjumshëm para të pranishmëve, i kthehet mikrofonit dy edhe tre-katër herë me arsye se paska harruar në këtë "ngjarje të madhe kulturore" në Bit-Pazar t'i përcjell "përshëndetjet e një miku të librit". Ne të pranishmit, gojëhapur pa frymë mezi prisnim Kakademikun të na i përcjellë përshëndetjet e Ali Ahmetit për librin, kur hop papritmas Kakademiku shkrep në mes të Bit-Pazarit "allti": "përshëndetjet" e një deputeti të Partisë Socialiste nga Shqipëria. Edhe atë: tri ditë para Ditës Botërore të Librit. Tekefundit, së paku "dashamirët" e librit ta prisnin këtë datë historike që e kemi në prag, shënonin siç do t'u kishte hije shqiptarëve, në Çarshi të Shkupit.

Zakonisht i madh e i vogël krah për krahu mbi kuaj me shalë e gomarë. I kanë harruar datat historike, i kanë ngatërruar përvjetoret, manifestimet kulturore. I kanë bërë lesh e li kripur me "politikë madhore". Dorën në zemër, megjithatë duhet përgëzuar "dashamirët" e librit shqip: falë biznesit familjar-partiak nuk e kanë lënë në mëshirën e Shoqatave të Botuesve Shqiptar se, do t'i mbushnin raftet deri në tavan me libra fetar e çaj rusi. Vend të lirë nuk do të na linin si shqiptarë mes librave të ngrejmë me miq edhe ndonjë gotë raki rrushi ose verë të kuqe.

Dhashtë Zoti, Kakademiku kësaj radhe e ka këmbën e mbarë, që fare pak besoj në hapin e tij

në arsim, kulturë dhe politikë shqiptare. Shkaku se, siç thotë populli: ku ka shkelur këmba e tij me vite nuk ka mbi bar as lule në livadh.

E bëj këtë hap artistik, akuzë parashikuese se, nuk kam frikë. Tokën e kanë munduar dhe e mundojnë dy lloj njerëzish. Njerëz të leckosur, që punojnë natën, ditën dhe e dënojnë veten, shpirtin me varfëri dhe njerëz parazitë që nuk punojnë fare, por jetojnë në shpinën e të parëve me emër e mbiemër - "salep-intelektualë": kakademikë, profesorë universitar, autorë tekstesh të dramave të arnuara teknefese nga rruga, regjisorë, aktorë, gazetarë… Sanço Panço shqiptar: dje, të Menduh Thaçit, sot të Ali Ahmetit, që nuk u pjellë truri edhe sot e kësaj dite, e kanë mushkë. Betejat e përgjakshme për liri me mullinjt e erës i bëjnë për Dylqinenë e Tobozës. Qengjat e pjekur në hell, dhuratat e majme i kërkojnë pa asnjë grimë turpi për "kryerjen" e ndonjë pune "patriotike kuqezi". Mos them: shiten edhe për një çorbë, pa pare. Në fund, e gjithë ajo punë del rrenë. Fragment Abetareje. Sanço Panço me diploma të blera universitare e tituj shkencor të "vëllezërve", e përsëris thënien: dje, të Menduh Thaçit, sot të Ali Ahmetit. Edhe të parët, edhe të fundit janë të rrezikshëm për shoqërinë. Shtetin Shqiptar edhe në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë.

E unë i kam dashur më shumë njerëzit. Të gjithë ato që i kam parë me sy dhe i kam dëgjuar me veshë, m'i kanë hëngër mushkëritë, zemrën, zorrët… Mu për këtë më është dukur e udhës t'ua heq maskat, se e kam dashur më shumë veten, juve si shqiptarë… S'më ka shkuar kurrë ndërmend se mund të ma këpusin mishin me

danë. Mund të më fusin në kusi me ujë shkul. Mund të ma zhveshin me dorë lëkurën nga trupi. Mund të më varin në trekëmbësh si "armik i popullit dhe shtetit të përbashkët". Ose: si burrë tradhtar i Dylqines së Tobozës. Mu pse nuk më ka shkuar kurrë mendja për këso dënimesh, unë do t'ia arrij qëllimit dhe ju një ditë për mua do t'i rrahni duart shuplakë. Ti nuk je i marrë. Ti je vëllai i njeriut. Ti ke ecur vetëm ditën. Ti nuk i ke përlyer duart me gjak. Ti na i ke zgjidhur sytë të mos shkojmë vetë te Kasapi. Ti e do Abetaren… Diellin… Hënën… Yjet… Lulet… Fluturat… Pranverën… Ne të duam ty, o plak me mjekër të bardhë! Ne vijmë pas teje edhe në varr… Prijna drejtë rrugës së drejtë, vërtetë përmes luleve! Ne u besojmë marrëzirave që i shkruan nëpër libra…

- O i marrë, a t'u kujtua më në fund edhe ty të vijsh në xhami? - i bërtiti Hoxhë Efendiu me Kur'an në dorë.

- Po, o hoxhë. Erdha ta fal teravinë.

- Vonë është, o plak! Është vonë, o i marrë! Nuk është për ty xhamia me flamuj gjysëmhëne nëpër dy e katër minare. E di, moti e propagandon nëpër Bit-Pazar, se: edhe unë do të vij në xhami t'i lutem Zotit, vetëm atëherë kur nëpër minaret tona do të valojë flamuri kombëtar shqiptar. Hi-hii-hiii… Plak, për ty është, Xhehnemi.

- Jo, o hoxhë! Nuk është vonë. Erdha më në fund t'i rrëfehem Allahut.

- Ha-haa-haaa… Tybeistifka, ti do t'i rrëfehesh Allahut?! Po, ç'do t'i tregosh o i marrë? Marrëzira të xha Derallës duke shartuar dardha gorrice te "Jasakët e Tikeve"?

- Po, o hoxhë, marrëzira… Edhe atë: Natën e Madhe…

- Heu, o i marrë! Allahu sheh dhe dëgjon gjithë çka ndodh në tokë.

- Jo, o Hoxhë Efendi! Allahu nuk i sheh gjithë këto marrëzira, le të flas plaku në xhami. - Ndërhynë disa burra me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë.

- Burra, unë do t'i bëj vetëm disa pyetje hoxhës?

- Fol, plak! Fol, jemi në "demokraci"! U dëgjuan zëra të tjerë në xhami.

- O hoxhë, unë dua ta dijë kush i mbyt fëmijët në djep? Dhe, pse asaj dore të ndytë më shumë ia ka ënda fëmijët shqiptar?

- Ku ta dij unë, o i marrë! Nuk përzihem në punët e Allahut!... Tybeistikfa!...

- E di ti, o hoxhë! E di. Se, ti u ke bërë hajmali. U ke dhënë barna… Injeksione… Kush ia la xha Seferit gjilpërën e këputur në dhëmbë?

- Xhemat. Ky plak është i marrë. Përzieni nga xhamia!

- Jo, o hoxhë! Ky plak është i mençur. Vazhdo, plak! Vazhdo! - ndërhyri një i ri.

- Kush i shëron gratë që i kanë burrat në kurbet?

- Xhemat, ky plak fol me xhindet!

- Jo, me ty o hoxhë efendi! Tjetër punë është ajo nëse, ti e merr veten për xhinde.

Pasi nuk rrëfehesh vetë si besimtar besnik, po të rrëfej unë para Allahut… Xhematit…

- Plak, ti qenke i meçur! I mençur! U dëgjuan zëra të tjerë në xhami.

- Burra, fëmijët i mbyt Hoxhë Efendiu. Ky bënë injeksione ku i dhemb pacientit. Nëse i dhemb koka, në kokë… Nëse dhëmbi, në dhëmb… Nëse këmba, në këmbë… Nëse syri, në sy… Thotë, se përnjëherë i bënë tri punë. Një: bën hajmali. Dy: jep barëra. Dhe, tre: injeksione. E kanë paguar disa "shkencëtarë të njohur vëllezër" të mos shtohet fara e shqiptarëve. Këta, viteve të fundit e kanë zbuluar shtimin e shpejtë të numrit të lyrekëve. Sipas mendimit të tyre duhet të pengohet lindja e tepërt e fëmijëve, se botës i kërcënohet varfëria dhe rreziku nga shqiptarët???!!!... Hoxhë Efendiu përveç parave të "shkencëtarëve të njohur vëllezër" merr para me të dyja duart edhe nga populli. Ai i shëron gratë, vajzat, nuset e reja… Hoxhë Efendiu është edhe Lugati i Koçajve.

- Hoxhë Efendiu, qenka Lugati i Koçajve?! U habitën burrat dhe filluan një nga një ta lëshojnë xhaminë.

- Çka pritni ju të rendit të parë që nuk dilni në oborr?

- Ne i besojmë Allahut! I lutemi, o plak!

- Edhe juve ju di se çfarë besimtarësh besnik jeni në xhami. Gjithë natën e gjatë vidhni nëpër Qytet. Natë për natë përpiqeni t'i vrisni intelektualët si qenin në rrush. I bëni nëntëqindenëntëdhjetenëntë të këqija.

Dhe, kur vjen koha e të falmes të gjithë vini në xhami, uleni në rendin e parë, para këmbëve të hoxhës. Të gjith ju të rendit të parë i keni duart e përlyera me gjak deri në bërryl…

Kur i thash të gjitha dhe s'më mbeti më asnjë fjalë në gojë, dola jashtë duke mbyllur pas vetes

derën e xhamisë. Rrugës vetja mu duk e lehtë, gjeth. E hetova se isha shkarkuar nga një barrë e rëndë mbi shpinë. Disa herë më erdhi fuqia t'u bërtas varreve, por e përmbajta veten rrëzë Çukës. Unë e kisha pasur në shpinë një samar. Të gjithë ata që kishin bërë mëkate më kishin hipur në shpinë. Ma kishin vënë frerin dhe më kishin detyruar të ec nëpër pyllin shkëmbor. Unë me këmbë të përgjakura kisha ecur natën, ditën. Më ishin marrë mendtë udhës. E kisha parë Hënën me barrë. Natën më kishin urdhëruar të flej në livadh. Më kishin detyruar të hesht dhe mos e ngrej gishtin. Më vonë e kuptova se këtë e kishin bërë, jo pse më kishin dashur shumë, por pse më kishin pasur frikë. Ishin trembur mos ua zbuloj veprat e shëmtuara me shkop. Ose, të lëshoj në llogari të tyre ndonjë marrëzi nëpër Qytet. Të ec pas këmbëve që të çojnë në mjerim… Dyshim… Pikëpyetje… Bërllok… T'ua shoh sytë e skuqur! Më dridhen këmbët. S'kam fuqi të ik përpara këtyre përbindshave… Qikllopëve me një sy… Grykësve… Zemra më kërcen si top llastiku në krahëror, në mes eshtrave… Lëkurës…

Këta qenë e buça me zgjebe ma rrënqethin trupin. Këmbët m'i bëjnë të më bredhin valle në tokë pa lodra e cingana. Përmëtepër, edhe pa dajren e Nuses me pashterkë të kuqe.

Duart të më dridhen në xhepa. Flokët m'i çojnë përpjet - iriq. Ma shtinë frikën. M'i errin sytë. Natë për natë shoh ëndërr gjarpërinj… Bolla me flokë… Dhelpra… Ujqër… Derra…

Por, para gjithë këtyre bajgave politike shoh shkëlqimin tim në qiell. Ngrihem përmbi re si zog shqiponje. Fluturoj… Fluturoj… Fluturoj…

Rrugës e shoh qiellin e kaltërt… Pa mjegulla… Shi… Breshër… Rrufe… Të gjithë këta armiq që e sulmojnë tokën, njerëzit, kafshët, bimët… Qenkan në qiell! Gjithë të këqijat e të mirat bëheshkan në mes qiellit e tokës. S'di ç'dorë përzihet në mes të kësaj hapsire. Nga na çojnë këto këmbë që nuk na dëgjojnë, o burra? Më hidhet vetë ta marrë litarin dhe t'i lidhë këmbët e mia nye deri në asht. Gojën me shami. Mos bëni më asnjë hap! Mos e folë asnjë fjalë! Një hap më tej, një fjalë më shumë është rrezik! Rrezik! Ju nuk dini ku ma çoni kokën. Vrapimi i juaj është vrapim pulamëshehtas në Kasollën e vjetër me kashtë. Kur dua t'i lidh këmbët, gojën, dikush  më tërheq për gjuhe. Më shan… Më rreh… Ec përpara, o plak! Përpara! Në këmbë! Këmbadoras! Jo, nuk dua. Dua të ec përmbrapa! Ec përpara, kur të them, o plak i marrë! Urdhëri duhet të kryhet i gjallë ose i vdekur.

S'keni forcë ju të vraponi përmbrapa. Zbrit në tokë! Jo, jo! Kam frikë. Në tokë ma hedhin litarin në qafë. Më shtinë bajga në xhepa. Më bien me tokmak në kokë. Me zor ma varin për qafe në xhami hajmalinë e Hoxhë Efendiut. Urdhëri është të zbresësh në tokë. Në tokë, o plak! Poshtë! Përdhe! Zvarrë!…

Më detyruan ta tërheq qerren me katër rrota. E detyrimi është më i fortë se ky shkop. Ja, nuk bëj inat. E dua veten më shumë se juve, o Sanço Panço të Ali Ahmetit! Edhe: Faji nuk është i Ali Ahmetit, po i Sanço Pançove shqiptar, që i shkojnë përmbrapa për ndonjë shpërblim pas lufte si dhelpra - dashit mos i bien udhës. Ose, siç thotë Sala: ku di gjë mësuesja sa liqene i ka Shqipëria.

Unë them: ku di gjë Ali Ahmeti, çka bëjnë në "fushën e betejës" duke u turrur pas posteve partiake rrugës për në Liri Sanço Pançot e tij hipur mbi gomarë. Prandaj, do të zbres në tokë. Këmbadoras ta tërheq qerren… Oh, ç'shoh o Zot!... Natën me ferexhenë hedhur krahëve… E kam frikë Tollosunin… Xhindet… Lugatin e Koçajve… Sanço Pançot e Ali Ahmetit mbi gomarë…

Ne qenkeshim të këqinj. Aq të këqinj. Aq të këqinj… Na shpëto, o Zot!...

## PJESHKA E KATUNDIT

Pjeshka e Katundit është Libër i hapur më vete nëpër shekuj me qindra faqe. Verë e Dimër i ka bërë ballë stuhisë, e rrahur pa mëshirë në shi e dëborë. Fortuna, vit për vit degët ia përplaste në të katër anët e botës. Katundarët shpeshëherë e pagëzonin edhe si Pjeshka e Sulojcës. Shkaku se, Pjeshka e Sulojcës, ishte edhe Pjeshka e Katundit. Shkurt: Pjeshka e të gjithëve - "vëllazërim-bashkimit", pa dallim feje e kombësie siç thoshin dje komunistët, e thonë sot neokomunistët. Ose, ndryshe me gjuhën e politikanëve: Pjeshka e përbashkët. Megjithatë, ajo ishte dhe mbeti vërtet Pjeshka e Katundit. E them këtë se, verës pa frikë i kacavireshin nëpër degë fëmijët për lulet e hershme. E thenin, e sakatonin për vrapimet dhe lojërat e tyre livadheve, rrëzë Çukës. Të nesërmen, i kacavireshin si hajdutë pas frutave, t'i mbushin plot gjinjt dhe xhapat. E, askujt nuk i kujtohej t'i hedhë te rrënjët për çdo mëngjes ende pa lind Dielli një kofë me ujë në Pranverë.

Edhe, në Pranverë Pjeshka e Katundit posa shpërthente lule, turr fëmijët hutaç t'i hipin në majë. Degët plot me lule në dorë, dilnin te porta e Xha Mazllëmit. "Ureja", siç e kishin pagëzuar katundarët, rreziteshin në diell me barkun dhe herdhet përjashta gjithë ditën e lume. Kohë kjo, kur Pjeshka e Katundit posa i lidhte frutat e para ende të jeshilta, gumzhonte nga fëmijët si një zgjua bletësh në Kopësht. I hipnin grupe-grupe plot pordhë e piskamë nëpër degë deri në majë.

Përmëkeq, përveçse i mbushnin gjinjtë dhe xhepat me fruta, ia thenin pamëshirë edhe degët.

Vjeshtës, përsëri i suleshin nga të katër anët me çetat e tyre të kaçakëve, i mbushnin çantat për t'i dalë në pritë vjershës së xha Naimit në shkollë. Eh, kjo ishte e dhimbshme për Pjeshkën e Katundit. Nuk hidhërohej Pjeshka e Katundit pse i kacavireshin fëmijët, po pse edhe të rriturit i suleshin si hajnat. Kush mbërrinte i pari i kacavireshin në majë, mbushnin gjinjt dhe xhepat, nuk hidhërohej: ani thonte në vete, po i dhimbte pse ia thenin degët. E sakatonin për vdekje, që mezi e merrte veten vitin tjetër, në Pranverë.

Pjeshkës së Katundit, vërtet ditën i kacavireshin fëmijët edhe e sakatonin pa vetëdije, e zvarrisnin edhe nëpër livadhe deri te Lugu i Ymerit. Degët e së cilës, shpeshherë i ndiznin edhe për Një Maj si zjarre të festës të punëtorëve te Kodra e Xhambazëve. Megjithatë, ky nuk ishte problemi kryesor i "vëllazërim-bashkimit". Pjeshka e Katundit vuante kur i kacavireshin të rriturit, politikanët teknefesë: kryetarët e partive politike, deputetët e popullit, ambasadorët, ministrat në Qeveri... E dhimbshme, thonte ajo është kjo: kur të kacaviren natën me parulla neokomuniste bythëgrisurit në emër të popullit me thasët në shpinë. Edhe merreni me mend, pëderisa fëmijët më kacaviren ditën, këta "burra të kombit" më kacaviren natën. Dorën në zemër, fëmijët i mbushin gjinjt dhe xhepat, e "burrat e kombit" thasët me arna i ngarkojnë në qerre t'i shpiejnë në shtëpi.

Përditë e shoh Pjeshkën e Katundit se si vuan për të drejta kombëtare e drejtësi në stinën e Vjeshtës. Dimrit e kërrusur me borën mbi kokë, mezi e pret Pranverën, të shperthej me lule. Fruta, lëshojë degët përtokë që t'i kacaviren fëmijët dhe "burrat e kombit me gratë e tyre besnike" kuqezi në majë. Pamëshirë, në emër të popullit t'ia thejnë degët, sakatojnë për vdekje mos dalë edhe njëherë me gjithë lule në Pranverë. E, kujton me mall plakun e urtë Xha Derallën me sharrë në krah te Jasakët e Tikeve duke i shartuar dardhat gorrice. Mrize të deleve duke ringjallur gjatë stinës së verës me vapë. Bariut, kur i mbusheshte plot me tambël kusia. E ai mbi Gurin e Isenit i jepte fyellit zjarr për kaçakët e asaj ane. Luftën e tyre me shokë, herë me Kral e herë me Mbret. Atdheut, i dilnin zot me armë në dorë dhe dhe për çdo vjet e nisnin nga një luftë. Gjakun e derdhnin deri në gju sa që sipas këngës popullore mbytej edhe kali. Murgoja me veshët përpjetë kur bënte roje te Përroni i Thanës. Ujku, kur e kishte mall të na bie tinëz në stane.

Kohë ajo, kur ne me shkopinj thane e libra në duar atyre kodrave i recitonim me zë vjershat e xha Naimit me shokë. Abetaren e mbanim në gji verë e dimër. Nuk guxonte të na e rrëmbejë nga dora as shiu e as era. Krah për krahu i dilnim stuhisë para me libra në gji e lapsa në dorë. Ditë për ditë hapnim shtigje të reja drejtë maleve.

Ditës Madhe i dilnim para me këngë e valle. E prisnim te Çuka me vjersha. Guri i Zi, për ne hutaçët në atë kohë ishte shkollë shqipe. Edhe Dy lisat me shtat të përbashkët të stolisur me lloj- lloj

penjësh e lecaksh, ku nuset e reja për shëndet i përshkonin fëmijët. Eh, ta dini ju lexuesë sa herë ne hutaçët jemi përshkuar te ata dy lisa. Njëri pas tjetrit hynim e dilnim me lecka e penj lloj-lloj ngjyre përqafe. Ndoshta, ky edhe ka qenë shkaku për t'u shpëtuar xhindeve, që gjithë natën e gjatë na hidhnin dorë më dorë mbi çatia e majë lisave. Kisha e vjetër shqiptare në majë pa këmbonë, ku i kishte futur thellë themelet dhe nuk e fshinte dot ende asnjë stuhi, asnjë dëborë. Vërtet, ta dini ju sa vjersha të rilindasve tanë janë recitur mbi ato themele antike. Edhe sa libra të këndimit nga Shqipëria i kemi fshehur në atë kohë nën ata gurë mbuluar me bar e gjethe. Edhe sot e kësaj dite rrinë strukur kokë më kokë dhe cicërrojnë si zogj, na presin ne hutaçëve t'i marrim përsëri në dorë. Dimrave t'u dalim para me libra e lapsa në brez.

Megjithatë, Pjeshka e Katundit nëpër vite ka përballuar shum dimra me dëborë si Nuse malesh me kurorë. Këmishën e bardhë me oja deri në fund të këmbëve. Pashterkën e kuqe nëpër dasmat shqiptare. Dajren në dorë kur ka zbritur nga koçia në lëmë me pushkë. Vallen e ka hequr me shami. Edhe ka pritur nëpër vite shumë Pranvera. Çifte të rinjsh qafë për qafe nën hije. Edhe, hajdutë me çizme në majë. Megjithatë dihet, edhe sot si dje, dorën pa frikë ia ka shtri Diellit me rreze që zbret maleve nga Çelëvjollca. U gëzohet fëmijëve kur i kacaviren nëpër degë, po jo edhe hajdutëve të sotshëm me çizme. Trusaktëve, që sot në emër të popullit na kanë shaluar me të katra për në Liri…

**KAKADEMIKU**

*(Kritiku është ai që zgjedh rolin e spiunit në kohë lufte, ngaqë s'ka guxim të luftojë…)*

## Flober

Herë ec me njërën, herë me tjetrën këmbë. Në një dorë mbaj brekët, me tjetrën shkopin. Njëri sy më shikon para këmbëve, tjetri në qiell. Veshi i djathtë dëgjon Lumin, i majti Rrufenë. Kokën ma mban qafa, qafën e mbaj unë. Mua më mban toka.

Kush e mban Diellin?

Ja, këtij duhet t'i gjejmë një qafë të fortë, o njerëz! Ç'është e drjeta ai e ka qafën. Po, ne nuk dijmë kush e mban Diellin? Si çdo kokë që e ka qafën e vet, ashtu duhet ta ketë edhe Dielli. Dielli duhet të ketë edhe këmbë… Duar… Veshë… Sy… Gojë… Në doni të dini më shumë, Dielli duhet të ketë edhe zemër. Ç'mendoni ju po të mos kishte Dielli zemër? A do të derdhte rreze mbi tokë? Jo. Atëherë, në çfarë mjerimi do të mbytej bota? Mos pyet. Këtë e them sepse s'kam guxim të të përgjigjem me ndonjë përrallë. Rrenë. E kam mbi kokë një tokmak. Sa herë që flas mendime të rrezikshme më dhemb kryet. Zemra më dobësohet, më dobësohet aq tepër sa mezi e vë në lëvizje gjakun. Trutë më ngushtohen, më dridhen në kokë si në konservë. E ndjej veten të harruar si një lundër në det, mes stuhish e dallgësh.

Mundohem not të afrohem, të dal në breg, po era më shtyn sa më thellë midis valëve. Është një luftë për jetë a vdekje.

- Plak-o, të kam gjetur një nuse! E zgjoi nga këto mendime Kakademiku.

- Mbaje për vete, o burrë! Ia pafsh hajrin! Unë kam nuse.

- Vërtetë ke, por nuk është si kjo që ta kam gjetur unë pas shtatë malesh. Plak, është me faqe të kuqe. Flokët i ka pas shpine deri në fund të këmbëve. Bereqetin në lëmë nuk mund ta fusin në hambar as shtatë burra. Po të duash ta paguaj edhe biletën të shkosh në atë Qytet të Anadollit…

- Jo. Falemnderit. Nuk ka nevojë. Le t'i ketë të kuqe jo vetëm faqet, por edhe bereqetin me gjithë rraqe…

- E merrja me mend unë këtë punë. Ti je mësuar të jetosh këtu në varfëri. Ta mbajsh barkun me dorë për bukë nëpër ditë. Plak, ky është vend fukara. Vend i nemur nga Baba Dovleti. Dëgjomë mua, ec hipi trenit shko te nusja në Turqi!

- Për ty është i varfër, por mua nuk më lënë të ik varret…

- Ha-haa-haaa!... Plak, të kam ditur të mençur. Ti flet marrëzira.

- Nuk dua të më dish të mençur, unë e di ku ma ke bërë gropën.

- Ndal, plak! Ngutesh. Mos fol ashtu, he burrë! Unë gropën?

- Po. Po, ti. E ke mbuluar edhe me kashtë. Vetëm mos harro, populli thotë: Ai që ia bënë gropën tjetrit, bie vetë në gropë.

- Plak, unë e pata për të mirën tënde, desha të të dërgoj në një vend me lule.

- Ti më premton lule, por unë i dua ferrat!...

- Plak, thyeje këmbën e shejtanit!

- Jo. Më tepër e dua këtë vend! Atdheun. Të parët e mi… Nënën… Babain me dhjetë plagë… Kurrë nuk do t'ia arrish qëllimit të më përzësh nga kjo baltë. Edhe, e di pse?! Askund nuk zure vend si kurva burrë më burrë, ti shkon parti më parti politike. Kurvës, tekefundit i ka hije. Mos them, ma përkujton edhe stafetën e shokut Tito dorë më dorë, kur ia dorëzonin pionierët me nga një shami të kuqe përqafe për ditëlindje. Vetëm se, ti nuk ke kujt t'ia dorëzosh "stafetën", Babai yt hëngër fiq dhe vdiq, mbete qyqe mes sorrave. Përçudi, kur u doli gjumi gati të gjithë të përzunë me një shqelm bythëve: Ibrahim Rugova nga Prishtina, Sali Berisha nga Tirana. Rehabilitim, kërkove në Shkup te njerëzit e penës, Pashallëku i Babait. Shkaku, se: këta mund t'i manipulosh më së lehti si Kakademik.

Vrik ike pasi i përçave edhe këta artistë dhe, bythekrye drejtë te Kabineti i Babait. Vite më vonë, pas lufte (2001) nga ku si " i përndjekur politik" do t'i sulesh për emërime nëpër komisione të ndryshme edhe Ali Ahmetit, o Sanço Panço shqiptar. Universitetit të Tetovës. Edhe këtu nuk të zuri bytha vend duke u marrë me "veprime madhore patriotike", dhe një ditë të përzunë si qen me zgjebe. Kohën e fundit, në kuadër të Njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, përsëri manipulon me njerëzit e painformuar të penës, përuron "kulturë madhore

shqiptare” nëpër birucat e errëta njëpartiake nëpër Bit-Pazar.

Hap debate kulturore sakatuese me vetevten pa asnjë zë të ftuar që mendon ndryshe nga Klani juaj “sllavo-shqiptar”: rreth Encikopedisë maqedonase, Letërsisë maqedonase, plan-programeve shkollore, teksteve shkollore, lektyrave shkollore. Gurë e dru hedh para të pranishmëve mbi “vëllezërit” si fajtorë. E harron se ti je fajtori kryesor, pyka e tyre teknefese: përpilues i teksteve shkollore, anëtar i komisonit për ndarjen e çmimeve në nivel republikan, manifestime kulturore.

Fotografohesh para kamerave telelvizive pa fije turpi me dy-tre kalorës të arratisur e ndonjë Sanço Panço në emër të popullit shqiptar për Dylqinenë e Tobozës. E, harron se arsimi dhe kultura nuk i takojnë vetëm një partie politike, po mbarë popullit shqiptar. Edhe sot e kësaj dite vazhdon të na përçash si shqiptarë, shesësh lirë te “vëllezërit”. Nesër, ku do të përfundosh me gjithë këtë “bagazh patriotik” mbi shpinë gjoja për “vëllazërim-bashkim në shtetin e përbashkët”?! E di, vështirë e ke të më përgjigjesh. Ja, po ta them unë si Profet shqiptar: Askund më larg se në ndonjë varr-hale. Përditë e më thellë fundosesh në hurdhë. Dora e valëvitur vetëm të ka mbetur jashtë mbi ujë për ndihmë. Përpiqesh ta mbash gjallë shpirtin, shpëtosh veten duke i fundosur edhe shpëtimtarët e pafajshëm në fund të hurdhës. Megjithatë, e kam për detyrë të ta përkujtoj: I mbyturi vetëm tre herë delë mbi ujë. Populli thotë: rrezik është të mbyturit t’ia shtrish dorën

se, të tërheq me vete në rrymën e ujit. Ferra do të të çelin mbi varr në vend të luleve. Ferra, gomari me qerre.

Fatkeqësia shqiptare: Përçudi, ende vazhdon t'i shesësh personalitet shqiptare për një drekë ose darkë edhe në kohën e sotshme demokratike. Edhe, merreni me mend: në Njëqindvjetorin e Pavarësisë të Shqipërisë duke prezentuar kulturën dhe letërsinë shqipe të coptuar nëpër kufinj politik. E di, ku: në fund të sallës të Panairit të librit Shkupi 2012 me kokën në brekë. Vend, në të cilin është dashur ta prezentoni siç i ka hije Shtetin Shqiptar në Njëqindvjetorin e Pavarsisë. Qoshk, në të cilin me Kakademikun në krye nuk patët guxim të mbani në atë mes kulturor as një përurim të librit, orë letrare.

Përmëkeq, ju nuk i njihni as instuticionet shqiptare që me mund, djersë e gjak i kemi themeluar dhe mbajtur gjallë edhe para tytave të armëve: Fakultetin Pedagogjik, Katederën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Dy Unversitet e Tetovës, Dy Unione të Intelegjencisë të Shqiptarëve, Lidhjen e Shkrimatarve Shqiptar, Dy Lidhje të Arsimatarëve Shqiptar e disa Klube të Shoqatës së Shkrimtarve Shqiptar nëpër disa qytete. Dorën në zemër, ne i kemi themeluar si Një, po ti me shokët partizanë na i ke coptuar në dy-tri katër institucione shqiptare. Përçani penat më të njohura letrare të kësaj ane nëpër parti politike. Rrugës ua hudhni nga një asht shpërblim, një torbë taxhi. E fshihni fytyrën e shëmtuar me shami të zezë. Mjerim shqiptar.

- Plak, tani, më në fund u binda se me të vërtetë qenke i marrë. Ika.

- Hupu! Theje qafën! Për këtë vend, për këto varre jam i marrë. Jetoj i marrë… Ec i marrë… Kundërshtoj i marrë… Dënohem si i marrë… Vdes i marrë…

Njerëzit që mendojnë për të mirën tënde i ke në çdo rrugë… Fshat… Qytet… Shtihen: njëri me lëkurë të lepurit. Tjetri me lëkurë të qengjit. Por, dikur, kur i hap sytë t'i shohësh më mirë, i sheh me lëkurë të gjarpërit… Dhelprës… Ujkut… Derrit… Habitesh. Fillon kokës t'i biesh me grushta. Don të zgjohesh nga gjumi. Po, e gjithë kjo është e vërtetë, o plak! Ti nuk flen. Nuk sheh ëndrra. E ke trupin e pastër, të kthjellët. Vetëm sytë të erren. Në mesin e ditës të delë Nata me ferexhenë krahëve. Me një shami të zezë përdhunshëm t'i lidhë sytë. Gojën ta mbyllë me njërën dorë dhe të detyron ta lakosh rrugën. Që, t'u bindesh urdhërave të saja, herë pas here të mëshon shpinës me thupër. Bythët nga zori i mban me duar. Të kërcënohet. Ec përpara, plak i marrë! Ti gjithmonë duhet t'i kesh sytë të lidhur, me shami. Kështu me sy të lidhur nuk do të shohësh gjë, nuk di kend ke takuar rrugës. Zëri i kujt të ka thirrur pas shpine. Xhenazen e kujt e ke shkelur me këmbë. Do të ecësh me sy të lidhur si duan të tjerët, plak. Dhe, nuk do të guxosh të flasësh marrëzira. He, çfarë fjalësh të mençura do të nxjerrë ajo gojë… Mjaltë. Edhe ti pak shpinën do ta zbusësh, se e ke të egër.

Dikur, ajo vetë do të mësohet t'i hipë dikush dhe ti do të ulesh ngadalë në gjunj, në tokë.

Më vonë me kalorësin në shpinë do të vraposh me të katra rrugës së gjatë gropa-gropa…

***Mundohem***. Përpiqem me duar, vetëm pak ta heqi nga sytë shaminë. Vetëm pak të shoh dritën… Vetëm pak të shoh ç'ndodhë rreth meje, midis këtyre njerëzve. Vetëm disa hapa të ec i marrë fushës… Maleve… Të shoh xhenazen e kujt shkeli udhës. Thuprën e kujt e kam pas bythëve. Cilin kalorës e kam në shpinë dhe kush më thirr rrugës së yjeve. Por, kot. Mu kur dua ta heq pak më poshtë shaminë, dy duar të fuqishme ma shtrëngojnë fortë dhe ma lidhin nyje. Paraftyroj lisat anë e mbanë udhës kokë më kokë. Zogun e mbyllur në kafaz. Shkrimtarin të çmendur mbi libër. Piktorin e varur në atelje. Diellin të pikëlluar mbi kokë. Tatën e Madhe me një gjysëm buke para këmbëve të Skënderbeut, në Bit-Pazar… Zemërohem. Ngrihem më këmbë… Bërtas… Dua të ec me dy këmbë! E dini ju kush ec me katër këmbë? Nuk dua më të më detyroni të ec si kafshë. M'i zgjidhni sytë!... Sytë… Dua vetë ta shoh botën kaq të bukur, kaq të mjerë! Kaq të pasur, kaq të varfër! Kaq të zbukuruar, kaq të shëmtuar!...

Dy duar të fuqishme m'i zgjidhën sytë. Por, kur pash se ato dy duar ishin duart e mia! Qava. E putha njërën, pastaj tjetrën dhe i ngrita lart nga qielli. Heu, qiell! Këto duar m'i zgjidhën sytë… Këto duar, kur duan, thyejnë edhe pranga. Vrapova i marrë rrugëve. Ngadalë… Shpejt… Më shpejt… Edhe më shpejt… Dikur u binda se të marrët qenkan njerëz të lumtur. Njerëz që nuk lejojnë t'ua lidhësh sytë.

Nuk u binden urdhërave të asnjë kalorësi. Nuk mundesh t'i blejsh me para. Natën s'e veshin ferexhenë e zezë. Ditën e bartin në duar. Natës ia

zbulojnë me shkop marrëzirat e Kakademikut të lëshuara rrugëve. I nxjerrin punë Hoxhë Efendiut që të nesërmen në xhami, mëkatet e natës së kaluar t'ia mveshë Lugatit të Koçajve. Grave dorëlira u shkruajnë letra dashurie të nënshkruara me emrin e Lugatit të Koçajve dhe u caktojnë takim te Mulliri i Arapit, rrëzë Çukës. Natën e caktuar të veshur me këmisha të bardha deri në fund të këmbëve, u dalin në takim si Lugat i Koçajve që t'u shtohet bereqeti në Lëmë…

Fundi. Ka ardhur fundi të flas marrëzira edhe në xhami. Nuk mund t'i duroj të gjitha rrenat e Hoxhë Efendiut. Kakademikut si rrufjan që nga koha e komunizmit. Fytyrat e tyre të shëmtuara mbjellin tmerr… Frikë… Vdekje… Në petkun e tij "patriotiko-fetar" fshihet Dreqi me brirë. Ai ditën ua këndon besimtarëve Kur'anin, ndërsa natën zgjohet lugat. Duart e tij që prekin Ku'ranin dinë të marrin edhe shpirtëra. Suksese të pakapërcyera ka arritur te fëmijët. Nuk ma merr mendja Hoxhë Efendiu të jetë kujtuar vetë për këtë mjeshtri. Është dikush tjetër që e ka ushtruar dhe mësuar në këtë zeje. Mua më vjen çudi, se si njerëzit kanë aq besim në ato duar të përlyera me gjak. Kërkojnë ndihmën e tij, u binden këshillave të tija edhe pse ato duar u sjellin vdekje. Këto dreqni të hoxhës më frikojnë edhe mua plakun. Them: mos ndonjë ditë do të shkoj edhe unë si qengji te kasapi, të kërkoj të më shërojë Hoxhë Efendiu. Ndodh, Hoxha të m'i marrë mendtë, si dhelpra kur ua merr pulave. E dini ç'thonë fshatarët për dhelprën dhe pulat? Ndoshta, e dini. Dhelpra i shikon pulat nga poshtë, nën pemë. E ato i bien pa mend një nga një para këmbëve.

Ndodh, Hoxhë Efendiu t'i ketë sytë e dhelprës… Dhëmbin e gjarpërit… Gojën e ujkut… Zemrën e derrit…

- Tungjatjeta, plak-o!

- Tungjatjeta, zoti Shkrimtar!

- Plak, nga të çojnë sot këmbët?

- Në xhami.

- Në xhami plak, është Hoxhë Efendiu me shokë. Kakademiku me "salep-intelektualët", që i falin mbi qilima të Persisë pesë vekte, i luten Zotit per mëkate. Ditën rrinë me "patriotët kuqezi" e natën kokë më kokë me "vëllezërit". Të japin injeksion në kokë. Ta varin hajmalinë për qafe si torbë me taxhi.

- Zoti Shkrimtar, nuk mundem më ta bind veten që të hesht para gjith këtyre marrëzirave. Një ditë do t'ia përplas në sy Hoxhë Efendiut, para xhematit, të gjitha të mirat e të këqijat.

- Plak, me këtë ecje do t'u ngjitesh maleve.

- Mjaft më ndejta fushave, zoti Shkrimtar. Dua të pij edhe ujë burimi!...

- Plak, edhe mua më duket se këtu shkrimet e mia nuk kanë zë, do të hip në majë të Çelëvjollcës që e prek me kokë qiellin…

- Zoti Shkrimtar, më kot dua t'i zgjoj me shkop të vdekurit nga varret. E kanë gjumin e rëndë me vite nën ata gurë…

- Hesht, plak! Mos shih ëndrra! Unë nuk mundem t'i zgjoj të gjallët nga gjumi, ti kërkon t'i zgjosh të vdekurit.

- Zoti Shkrimtar, nuk zgjohen të gjallët me rreshta e libra duke i rënë samarit, t'i teket gomarit, ashtu siç nuk zgjohen të vdekurit me shkop duke u rënë gurëve të varreve.

- Po, ç'të bëjmë hallit, plak?

- Të ngrihemi vetë më këmbë… Ta shajmë Natën me ferexhe… T'i bërtasim Dimrit… Përzëmë nga mesi ynë Hoxhën me shokë. Kakademikun me "salep-intelektualët" hipur mbi gomarë. Të lindë Dielli me rreze mbi male, në Çelëvjollcë… Ta thërrasim Pranverën, Shqipërinë Etnike në minaret e xhamive shqiptare…

## PROTESTA POLITIKE ME PETK FETAR

Vitet e fundit, IRJ të Maqedonisë e kanë rrokur për fyti festat shtetërore dhe protestat qytetare. Edhe, sipas Ministres së Punëve të Brendshme, znj. Gordana Jankulovska: Edhe, grupi „radikalë islamikë“. Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi moti paralajmëroi në mjetet e informacionit se ballafaqohet dhe ka probleme me një grup fundamentalist të islamit jotradicional, i cili ia ka rrëmbyer me dhunë edhe tri xhami, shtëpi të Zotit. Dëshmi bindëse ishte, sulmi me grushta i Haxhi Deputetit (E. A.) para kamerave televizive në xhaminë e Isa Beut, në Shkup. Tri ditë më parë edhe sulmi fizik ndaj autorit të këtij shkrimi se, gjoja me shkrime e paska ofenduar Muhamedin a. s. Askushi nuk i dëgjoi ankesat e Bashksësisë Fetare Islame dhe qytetarve që kërcnoheshin përditë dhe dilnin me frikë në rrugë nga „radikalë islamikë“, siç tha Zonja ministreshë në një shtet „demokratik“. Mos them edhe se, për këto pyka pas shpine që u rraseshin shqiptarëve, „vëllezërit“ nga gëzimi u bienin duarve shuplakë. I shpërblenin partizanët e tyre besnik me poste partiake në Qeveri, vende pune e anëtarë komisioni nëpër ministri për „vëllazërim-bashkim“ në emër të popullit shqiptar. Përderisa, këta „radikalë islamikë“ një ditë nuk iu sulën partive politike dhe Shtetit. E them këtë se, vetë jam dëshmitar i gjallë i këtyre veprimeve të ndërsyera antishqiptare.

Ose, siç thotë populli: E hudhin gurin dhe e fshehin dorën para syve të Policisë maqedonase. Rastin e sulmit fizik ndaj meje kur e paraqita në polici, inspektori mu kërcnua me padi penale se, unë i paskam provokuar „melaqet“ e Allahut.

Përçudi, në këtë shtet „demokratik“ që nateditë synon të shkojë në Evropë, vetëm festohet dhe dilet me pankarta në duar e me „Allahu Akbar“ në protesta qytetare. Maqedonasit i kanë festat e tyre shtetërore e fetare, shqiptarët të tyre kombëtare e fetare. Bullgarët edhe kombëtare edhe fetare. Vllehët, edhe ata të tyre nëpër institucionet e „shtetit të përbashkët“. Serbët të tyren me prapavijë politike. Vetëm turqit i ka kapur nostallgjia e Peradnorisë Osmane duke pi çaj rusi nëpër Bit-Pazar, e rrejnë veten se do të kthehen si pushtuesë përsëri në Ballkan. Romët, ecin nëpër qytet me Arushën për dore. Dajres i bien, e shtinë në valle. Pesë herë në ditë e thirrin nga minaret e xhamive Shejtanin për ndihmë t’i shpie në Xhehnet mes luleve. Merreni me mend, edhe atë: në shekullin e njëzetenjë. Kohë kjo, kur edhe vetë Qeveria turke e lufton fenë islame nga instuticionet e shtetit modern të Ataturkut, shqiptarët turren me të katra si miza në qumësht me „Allahu Akbar“ e flamuj të huaj arabo-turk të bëjnë Shqipëri Etnike. Ia panë hajrin siç duket turkut si pushtues pesqind vjet me radhë, nga e pranuan fenë islame që përpak gati na asimiloi të gjithëve si popull shqiptar dhe na përzuri në Turqi. Përmëkeq, edhe pas faljes së „xhumasë“ nga xhamia, shtëpia e Zotit (në vend të dalin nga

shkolla, Universiteti), dalin në protesta masovike të përjavshme në rrugë me flamuj arab, turq e lutje fetare.

Përditë, zgjohemi me festa shtetërore dhe protesta qytetare pakrye. Vetëm, pak punë e shumë demagogji fetare-politike. Popullit të këtij shteti siç duket Zoti ia ka nda festat dhe protestat qytetare. E jo punën. Kulminacioni, kohën e fundit pas këtyre festave edhe „nuk qëndron njeri“ si organizator. Besimtari i devotshëm i Zotit do të thoshte: I organizon Shejtani. Ditën e premte, pas faljes së namazit si delet e nënkryeme të zeza pa bari, krye më vete dalin nga xhamia (Shtëpia e Zotit) symëshelë në protesta me veshje e flamuj arab. Ditën e nesërme, dalin me antiprotestë „maqedonasit“ përpara Qeverisë. Dallimi, maqedonasit për inat të shqiptarve dalin në protesta me flamuj shtetëror (Diellin me rreze), pankarta shoveniste e parulla terroriste: Vdekje për shqiptarët, stop terrorizimit islamik, Qeveria shqiptare... Thirrje për luftë përmes internetit. Shkurt, dhuna thirr dhunë. Realiteti: Të rinjt maqedonas, kësaj radhe vështirë u manipuluan në përmasa të mëdha, të manifestojnë dhunë dhe sulme të tërbuara kundër selive të partive të tyre politike, komunave maqedonase, institucioneve të shtetit, „Qeverisë shqiptare“ t’ia thyejnë me gurë xhamat nga rruga.

Muhamedi a.s. po të ishte gjallë do të thoshte publikisht: Luftë politike bëjnë harëmët, kush për pushtet e kush për Baba Dovlet. E asnjëri për fe e Vatan. Gojën plot e ka thënë edhe porosinë antologjike: Pa Vatan nuk ka iman.

E di edhe këtë, ju mendjen e keni te pasuria dhe shtëpia. Jo. Muhamedi a.s. pasuri, shtëpi dhe gra ka pausur me qerre. Vatani i tij, për të cilin e ka pasur fjalën ka qenë Atdheu. Ehu, e shfrytzoj rastin të ju pyes në këtë shkrim publicistik: Cili është Atdheu i juaj brez pas brezi si „patriotë“ mysliman me „din e iman“ në Ditën e sotshme?! Frikë keni të më pëgjigjeni mes këtyre rreshtave. Dexhalli u rri me tokmak mbi kokë. Nuk ka problem. Vetë ju pyeta, vetë edhe do t'ju përgjigjem: E keni thënë moti në xhami, qysh në kohën e Turqisë. Edhe sot e demonstroni në këtë Njëqindvjetor të Pavarsisë së Shqipërisë, e manifestoni me të madhe krah për krahu me „vëllezërit“ edhe në rrugë. Kokën gjoja e keni në Shqipëri Etnike, e bythën te Shtetet Arabe, ose në Turqi. Gjysmëhënën e keni vulë në ballë. Përditë na e valoni rrugëve të trojeve shqiptare, e hipni edhe në minare. Dexhalli me shokë u pri në luftë.

Fatkeqësia: Edhe, siç duket jeni melezë që i doni marrëzisht festat shtetërore. Dhe, protestat qytetare për të „drejta të barabarta kombëtare“ me flamuj të huaj e lutje fetare në rrugë. Një Zot e di kush u polli pas porte në Ditën e sotshme të Njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Ndodhë, Dexhalli. Ose, Shejtani me shokë. Vetëm punën nuk ua ka anda dudumëve të nemur nga Baba Dovleti. Punën. Ironia: Shembull më të freskët e keni, „Pranverën arabe“. Dhunën dhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm për pushtet. Përditë i pengoni edhe ato pak veta që duan të shkojnë në punë. I bllokoni në rrugë me orë nëpër protesta.

I zvarrisni nëpër autobusë pas gjithë asaj pune të lodhshme që mezi e nxjerrin me vështirësi bukën e gojës për familjen, të kthehen në shtëpi. Edhe kush: rrugaçët e papunë që paguhen me para të përlyera për të propaganduar veshje dhe zakone arabe në dëm të shqiptarëve duke u përjagur gjithë natën me çaj rusi nëpër lokale nate e shtëpi publike si „besimtarë besnik“ të Allahut, që i falin pesë vakte në xhami, i luten Allahut për mëkate me tespi kuqezi para këmbëve të hoxhës.

Mirë, më në fund them unë, o „shqiptarë“ të Allahut: Pse, pakënaqsinë tuaj nuk e shprehni me punë?! Shkollë. Universitet. Vërtet, kësaj radhe e them publikisht: ju nuk keni faj. Fajin e ka shteti „demokratik i përbashkët“ dhe xhamitë tona me flamur të huaj në minare, që me gjithë këtë bërllok shqiptar shekullor do të shkojë Nuse pa koçi në Evropë... Rrezik ky, për këtë shtet të ri „demokratik“ që edhe në të ardhmen përpiqet ta mbaj veten gjallë mes Ballkanit me festa neokomunsite e protesta qytetare me simbole fetare. E gjithë puna e protestave qytetare: edhe myslimane-shqiptare, edhe maqedonase-shoveniste përpara Qeverisë, ma përkujton anakdotën e punës së jorganit të Nastradin Hoxhës, kur ia kanë vjedhur jorganin. Zhurmën e madhe politike për rrëmbimin e pushtetit me dhunë nga rruga, e jo me vota të lira demokratike nëpër institucione të shtetit. Pavetëdije, se kjo metodë primitive moti ka perënduar në shtetet demokratike. Momentalisht, e praktikojnë vetëm shtetet arabe, ku mungon dialogu demokratik dhe liria qytetare. Shtete, që i ka dënuar, nemur edhe vetë Zoti.

Dudumët me flamuj arab, turq, këmbëza-lecka e thirrje fetare „Allahu Akbar“, që deri dje (1981) deklaroheshin e regjistoheshin si turq „ehamdurila“, e sot si „shqiptar“ për Shqipëri Etnike, para syve të botës duan ta arabizojnë edhe shoqërinë shqiptare. Fatkeqësisht, në Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Haptas manipulojnë me të rinjt shqiptar, që vendin e kanë në shkollë, Universitet dhe punë, e jo në rrugë të ndërsyer nga armiqtë tanë shekullor ndaj institucioneve shqiptare. Gurët i rrëmbejnë si armë për hakmarrje politike në vend të votave demokratike gjatë zgjedhjeve të ardhshme lokale e parlamentare për ndryshime politike, duke thyer xhamat e Selisë së Partisë Politike Shqiptare (BDI), Komunës shqiptare të Çairit dhe goditur me gurë gazetarët dhe kamermanët e pafajshëm në punën e tyre të përditshme. Shkak ky, që përmes këtij shkrimi edhe shfrytzoj rastin t‘i thirr të rinjt shqiptar të mos bien në provokime të „bashibuzukëve“ të tërbuar e të shitur me para të ndyera të nëntokës kriminele dhe të bëhen pre e shërbimeve sekrete policore të armiqve tanë historik, individëve dhe grupeve të dyshimta me sulme pakrye ndaj institucioneve shqiptare, që i kemi fituar nëpër shekuj me djersë, gjak e luftë.

Edhe një herë e pyes veten dhe juve si dudumë shqiptar: Po, deri kur do të na prini me lutje fetare, flamuj arab e protesta gjoja qytetare në rrugë për Liri… Shqipëri Etnike?!...

## „PËRRALLA E PËRGJAKSHME“ MAQEDONASE

Vite më parë, në kohën e „artë“ komuniste në librat e këndimit sipas plan-programit shkollor e kishim edhe një poemë të Desanka Maksimoviqit: „Përralla e përgjakshme“. E mësonim përmendësh këtë vjershë patetike dhe e recitonim në klasë dhe shkollë gjatë festave e përvjetoreve të datave partizane. Dihet, merrnim edhe duartrokitje frenetike, përqafime e rrahje krahësh nga politikanët shqiptar të asaj kohe. Përkundër prindërve tanë, që për habi para nesh i shihnim me sy se, nuk i duartrokisnin kësaj poeme, nuk na i lëmonin flokët pas shfaqjes në sallën e zbukuruar me lule e flamuj të huaj republikan.

Poema, vërtetë ishte e gjatë dhe vështirë mësoheshte përmendësh si vjershë. E sidomos për mua që në atë kohë kisha shumë probleme me mësimin përmendësh të vjershave. Ku ta di unë, sipas shkencës isha tip logjik e jo akustik. Mezi i mësoja vjershat e Rilindasve tanë përmendësh, po jo edhe këtë poemë të gjatë me kilometra, siç e kishim pagëzuar ne shkollarët në atë kohë. E, si për inatë mësuesi mu këtë vjershë na e jepte ta mësojmë përmendësh për një javë. Dënimi dihej në atë kohë për këtë vjershë „patriotike-revolucionare“, thupra e thanës ose njëshi me karrike në ditar. E dinim edhe këtë se, mësuesi nuk kishte faj i shkreti. Fajin e kishte sistemi komunist. E them këtë se, mësuesi ynë këtë vjershë nuk e lexonte me gjithë zemër. E shihnim në syt e tij, veprimet në klasë.

Tjetër fytyrë, sy kishte kur i lexonte vjeshat e xha Naimit me shokë.

Edhe sot, pas faljes së ditës „xhuma“ të „Pranverës islame-shqiptare“ të shpallur nga bashibuzukët, vështirë e kam ta harroj titullin a asaj poeme të gjatë që ende vazhdon të më shfaqet në ëndërr si shtrigë. Po, kurrë nuk e besoja se ajo poemë, një ditë në kohën e sotshme „demokratike“ do të na ulet këmbëkryq edhe në sofër si shkollë partizane. Porosia „edukative-patriotike“ e asaj poeme dihej që në atë kohë. Gjermanët i kishin pushkatuar nxënësit bashkë me profesorët e tyre serb, në Kragujevc. Ishte kjo, historia e kurdisur mirë partizane. Dhe, porosia „edukative-patriotike“ e poetes serbe Desanka Maksimoviq me „kryeveprën“ e asaj kohe të „vëllazërim-bashkimit“.

Edhe versioni tjetër, që qarkullonte në popull dhe arriti deri te veshi ynë i shkollarëve: Partizanët serb ishin veshur me uniformë ushtarake gjermane dhe i kishin pushkatuar vetë nxënësit dhe profesorët serb në shkollë. Shkaku se, populli serb nuk kishte dashur të dalë në luftë kundër gjermanve. Qëllimi i këtij skenari serb u arritë: Që të nesërmen i gjithë populli serb pas këtij aksioni doli në luftë kundër okupatorit.

Përçudi, ajo „Përrrallë e përgjakshme“ serbe, gjysëm shekulli më vonë po na përsëritet edhe në IRJ të Maqedonisë. Pesë të rinj maqedonas vriten te liqeni artificial Smilkovc të Shkupit nga ekzekutues të panjohur. Skenar politik i njohur qysh më heret nga qarqet e errta serbe dhe i përsëritur nga autorë të paguar ose kriminelë të njohur në popull. Edhe atë, pas disa skenareve të

dështuara në skenën politike maqedonase: Emetimi i programit të A1 me muaj në rrugë para Qeverisë, ku fatkeqsisht para mikrofonit radhiteshin edhe argatë shqiptar të politikës në pushtet, gazetarisë dhe letrave shqipe, vrasja e dy shqiptarëve në Gostivar, vrasja e nxënësit shqiptar në shkollë, sulmi fizik i nxënësve shqiptar në autobus... „Përralla e përgjakshme“ serbe e Desanka Maksimoviqit u ringjallë edhe te ne, në Shkup. Autorët e kësaj përralle si zakonisht, ende nuk dihen për opinionin. Populli, pas Luftës së 2001 –shit, përsëri filloi të zgjohet me frikë. Rrufe përhapet edhe propaganda se, përsëri do të kemi luftë. Parti politike opozitare e shoqata joqeveritare paralajmërojnë protesta te reja në rrugë.

Përdallim nga „Pranvera islame-shqiptare“ në ikje, kësaj radhe „Vjeshtë të nxehtë“ politike. Mirë, them unë si autor i këtij shkrimi: Po, kur do të punojë ky popull, shkojë në shkollë Universitet ku e ka vendin?! Përgjigje marr përmes komenteve: ofendime dhe kërcnime fizike. Shpallin luftë në „Shtetin e përbashkët“, të cilën qarqe të errta antishqiptare me rrufjanë shqiptar, moti e thërrasin edhe me buri milloshevjane, terrorizojnë shoqërinë qytetare. Fatkeqësisht, në radhët e tyre ka edhe individë dhe grupe të pakënaqur shqiptar që si të paaftë i kanë hunbur postet e tyre politike: ministra, zv. minsitra, drejtorë, zv. drejtorë e ambasadorë nëpër botë. Shkurt, partitë politike, qofshin maqedonase, qofshin shqiptare pa vetëdije e presin degën e vet në të cilën kanë hipur në pemë me vite dhe hanë dardha të qullta gorrice duke harruar se ato do t’ju

mbeten në fyt një ditë, po jo në këtë „Pranverë islame-shqiptare“.

Pushtetin, përpiqen ta rrëmbejnë me të gjitha „armët politike“ legale e ilegale, me leje e pa leje të popullit, pa menduar fare se edhe vetë do të digjen në këtë zjarr të ndezur me flakë. Qorrsokak politik, ku duan ta fusin për interesa personale e grupore edhe popullin.

Kohë kjo, kur pushteti sot merret me „armë“ demokratike, votën e lirë të qytetarve në zgjedhje lokale e parlamentare. Grupe të pakënaqura të partive politike, individë të papërgjegjshëm e përgëdhelur gjithë jetën nga shteti dhe partitë politike për karrierë politike dhe pasuri në emër të popullit, u janë terruar syt dhe nuk zgjedhin armë për të ardhur deri te qëllimi (pushteti). I përdorin të gjitha armët jodemokratike për ta „fituar luftën“: Dhunë dhe frikë të përhapin në popull. Askushët, kujt t’i teket e nxjerrin këtë popull me protesta në rrugë për realizimin e qëllimeve të tyre të errëta për karrierë të sëmurë politike. Mos them se, secila parti politike i ka partizanët e tyre besnik për t’i vënë në lëvizje në çdo kohë këto protesta pa krye sipas nevojës antishqiptare. Mjeranët siç duket i tremb Skënderbeu në Shkup. Nënë Tereza. Njëqindvjetori i Pavarësisë së Shqipërisë. Kosova e pavarur. Abetarja e përbashkët shqiptare e përuruar në Prizren. Përditë, e presin kohën dhe momentin e përshtatshëm, vetëm Qoftëlargu ynë historik t’u japi shenjë dhe i madh e i vogël me pankarta në duar, flamuj të huaj e „Allahu Akber“ të dalin në rrugë. Përpiqen të imitojnë „Pranverën arabe“. Në mjetet e informacionit: Trusakatët shpallin edhe

„Pranverën islame-shqiptare“. E në realitet, haptas thërrasin „Pranverën serbe“...

Neteditë e vështirësojnë jetën e këtij populli të varfër heroik të coptuar copë-copë me plot probleme të grumbulluara shekuj me radhë mbi krye. E, këtij populli liridashës ende nuk i teket, kurrësesi ta hudhë samarin me gjithë barrën sllavo-fundamentaliste në përrua. Qoftëlargun si kalorës të arratisur shekullor bythekrye në mes të rrugës, që gjithë jetën i ka hipur në shpinë dhe e ka shaluar me të katra për në „Liri... Shqipëri Etnike“...

## HOXHA I ALLAHUT

Hoxhën arabo-shqiptar të Allahut me shokë, sipas sulmeve me shkrime teknefese plot të „vërteta me din e iman“, dilka se e paskam patur „mik“?!... Tmerr, i Zotit! Falë Zotit, që nuk i jam rrëfyer Halldupit të Allahut si besimtarët e krishterë besnik Priftit, se përndryshe një Zot e di ku do të përfundoja si shkrimtar shqiptar. Ama, ta them të vërtetën: Nuk ju dua juve me këmbët e trurin në legen. Plasni! E dua Hoxhën shqiptar me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë! Hiç fare nuk e dua hoxhën me çallmë turku, kësulë-leckë të zezë ose „shajkaçë“ në kokë, nateditë qafë për qafe me Dexhallin. Shkurt e shqip: Haptas e dua Xhaminë Shqiptare me flamurin kombëtar kuq e zi në minare! Shtëpinë e Zotit, ku besimtarët besnik i luten Zotit në gjuhën shqipe. Xhaminë që është në shërbim të kombit dhe Shtetit shqiptar.

Pleqtë tanë të mençur moti kanë thënë: Nuk bën shumë të rrish natën vonë se, pasmesnate dalin të shëtisin xhindet. Ndodhë të të zatekin në errësirë, përflakin me ndonjë shkujë dhe kurrë nuk çon krye në jetë. Rrugës të bëjnë të flasësh vetmevete marrëzira që nuk i mban dot as kandari i turkut, e jo më ai i Çajupit. Portave t’u biesh me shkop, thërrasish në mes të Shkupit me pankarta në duar, flamuj arab e „Allahu Akbar - Pranverën arabe-serbe“.

Halldupin e Allahut me shokë, siç duket pasmesnate në këtë shkrim xhindet nuk e kanë gjetur duke falur „sabahun“ në xhami, po duke

„pi çaj rusi“ bythekrye në Facebook. Edhe siç shihet, me siguri nuk i kanë futur dy-tri shpulla, po i ka rënë atë natë Dexhalli me tokmak mu në kokë.

Ditën e nesërme Halldupi i Allahut me shokë nuk flet rrugëve vetmevete marrëzira, po në Facebook. Jerm belbëzon me gojën dhe mësimet e çoroditura „profetike“ të Dexhallit. I ngatrron vitet, i ngatrron lëmsh faktet, i ngatrron mendimet. Nyje përpiqet t’i lidhë në hajmali t’ia shesë me dhunë lexuesit shqiptar. Një Zot e di çka shkruan nëpër ato hajmali. E ka larë e shpërlarë me „çaj rusi“ (shlihovicë serbe). Edhe, hiqet në Facebook si profet arabo-shqiptar. E citon Kur“anin, pavetëdije se Muhamedi a. s. sipas fesë islame është pejgamberi i fundit, nuk ka më pas tij tjetër pejgamber.

Tjetër punë është ajo se, te Feja e Vaso Pashë Shkodranit - **SHQIPTARIA**, ende nuk është mbyllë kapitulli i profetëve shqiptar. Përmëtepër, Halldupi i Allahut edhe rren mbarë-prapë para syve si „hoxhë besnik“ i Allahut. Macën e zezë, siç thotë populli do ta fsheh në thes. Shejtani them unë, nëse ka pasur edhe ndonjë vëlla, ai është hoxha. Jo rastësisht, populli shqiptar i ka edhe gjithë ato anekdota të krijuara nëpër shekuj në letërsinë popullore shqiptare për hoxhën. Historikisht, hoxha ka qenë njeriu më i pamoralshëm, mashtruesi dhe spiuni më i madh i popullit shqiptar. Hoxha ka qenë ai që e ka mashtruar denbabaden në trojet e veta këtë popull dhe bindur për t‘u shpërngulur me dhunë në Turqi. Hoxha, pas Luftës së Dytë Botërore ka nëshkruar në emër të popullit se, shqiptarët e

këtyre trevavae nuk duan të bashkohen me Shqipërinë, po duan të mbeten përjetë nën Jugosllavi. Filip Papajani, një shkrimtar Rilindas shqiptar ka thënë për hoxhën: Njeri i sotshëm me tru të moçëm.

Halldupi i Allahut me kërcnime publike, arnë përmbi arnë i qep hajmalitë dhe përpiqet me shpifje, etiketime e rrena t'ia varë publikisht përqafe kundërshtarit të shkrimeve: „raki smederevka, votkë ruse, Skopsko". Gur e dru hedh mbi ata që nuk pinë „çaj rusi" (shlihovicë serbe) dhe nuk i luten Allahut pesë herë në ditë në xhami. Etiketon plot gojën për racizëm. Ose, pse pinë shqiptarët lotët e Shën Mërisë Virgjër: raki rrushi të Kosovës e konjak „Skënderbeu". Gjakun e Isu Krishtit, verë të kuqe „Chardonnay" ose „Kashtjella" të Ilirisë. Vërtet, ma kënaqi lapsin ky Halldup i Allahut. Zëri kurrë deri më sot nuk i është dëgjuar shqip në minare, as gjatë Luftës së Kosovës (1988), as gjatë Luftës së fundit të 2001 –shit. Gjatë asaj kohe merreshte me hapjen solemne të xhamive dhe përhapjen e fesë islame si „misionar" fanatik i vonuar nëpër Shqipëri. Ditë-natë i mban këmbët në legen e kokën në laptop (sipas disa hoxhallarëve Shejtanit të Arapit) duke dërguar fotografi plot „xhinde nga mërgimi" me kësulë të zezë myslimane e herë me shajkaçë serbe në Facebook si „shpëtimtar" i vonuar me shekuj i fesë islame nëpër „pusitë sllave" në trojet e coptuara shqiptare.

Trutë përpiqet t'i shtrydhë në legen e mbaj gjallë me ilahi e thashetheme se më ka dhënë „inspirim me shkruar prozë dhe me qenë analitikë". Hi-hii-hiii. Harami i Zotit... I mjeri, që

ende mezi e flet dhe e shkruan gjuhën shqipe plot barbarizma sllave, turke e arabe. Larg romanit „*Varrimi i sorrave*“ (1988) është me qindra kilomatra. Majat e tij artistike për t'i prekur me dorë, sy e tru më së pari duhet të marrë „abdes“, nëse do të hipë në Baba Tomor me „gomarin fluturues“, që e përmend shpesh nëpër shkarravinat e tia „analitike“ teknefese. Ose, romanin tjetër: „*Qyteti i qyqeve*“ (1997), „Mekën“ e tij maqedonase, siç ka dëshirë ai ta pagëzoj në xhami duke thirrë nga minarja nateditë Pranverën e vonuar arabe-serbe. E di, ai e do shumë romanin „*Shtëpia publike*“ (2000), por jo kësaj radhe se për të si hoxhë është haram. Frikë kam se do të digjet në zjarr të Xhehnemit.

Realitet i hidhur ky, për ta parë veten shkaku se, unë kur dilja para lexuesit me romane, ai me shokët mysliman merrej me vjedhjen e pulave nëpër mëhallat e Çarshisë Shkupit duke kërcyer avli më avli si Shejtani i Allahut. Halldupi i Allahut me shokë më rrëfen mua për kulturë dhe letërsi shqiptare... Liri... Shqipëri Etnike... Fe islame... Parardhësit e tij nga fisi i Dhëndrrit, që gjatë ngritjes të shqiptarisë më këmbë, trumbetonte në mjetet e informacionit për Universitetin e Tetovës se ka lindur si „foshnje e vdekur“. Pastaj, krenohet me paraardhësit e tij se nuk e njohin pushtetin (???!!!...), nuk i kanë paguar tatime dhe kanë ikur në Shipkovicë për ta vazhduar ikjen me gjithë dele në Turqi. Dhe, kur është prishur marrëveshja Serbi - Turqi kanë mbetur në Shkup si „turq ehamdurila“. Halldupi me „din e iman“, që më lëvdohet mua se ka fjetur me Kleopatrën. I mjeri hoxhë, që nuk di edhe se,

kush ka qenë Kleopatra. Po, të kishte fjetur me Kleopatrën, ai sot nuk dë ishte gjallë më si hoxhë në Bit-Pazar. I faleminderohem Zotit, që nuk thotë se, ka fjetur edhe me Teutën ilire. Realitet ky, që Teuta ilire nuk ka fjetur me burra që pinë çaj rusi. Teuta ilire ka fjetur me burra me nga dy kobure në brez.

O Imzot, feja islame paska mbetur në mëshirën e horrave të Shkupit! Dudumët nuk e dinë se unë për sa i përket babait vij nga një familje bekteshiane. Stërgjyshi im, Emin Çeliku (Xhambazi) si kaçak mali ka marrë pjesë në Kryengritjen e Dervish Carës dhe ka rënë dëshmor ne betejën e Katllanovës, afër Shkupit.

E për nga dajt e nënës, doktorë të teologjisë që i kanë kryer studimet në Kairo. Gruan, poashtu e kam mbesë hoxhe i cili është miqsuar dhe ka ngrënë bukë me Asdrenin, në Bukuresht. Poet i himnit kombëtar, i cili në atë kohë ka qenë mik edhe në Kërçovë. Askushi, që në jetën e vet për kulturën shqiptare deri më sot nuk e ka dhënë as edhe një kafe, merr guximin të më mësojë mua me paçavure të arnaura për fe e Atdhe. Edhe atë del, kur dikushi për kulturën shqiptare e ka shitur gati gjithë pasurinë e trashëguar nga Babai. Dhe, sot për sot, i ka mbetur edhe një mal me lisa, që kur t'i teket e shet edhe atë të dalë kaçak me lapsin në dorë për Liri...

Alarm serioz ky për Halldupin e Allahut me kokën në xhami e bythën duke e shëtitur parti më parti politike si kurva e moralshme që hiqet virgjine burrë më burrë. Marrëzisht e lakmon Dashin me brirë rreth veshëve që i ka shkuar pas dhelprës mos i bien udhës. Copë-copë bëhet t'u

turret prapa partive politike për një asht të hedhur pas porte. Nateditë e vajton Kohën qorre, kur Halldupi i Allahut përderisa në Shkollën e mesme fetare në Prishtinë e mësonte fenë dhe ilahitë përmendësh duke bërë praktitkën gjatë muajit të Ramazanit, turreshte pas parave të „zeqatit“ nëpër Kosovë, unë përkrah studimeve përhapja arsim dhe dije në Drenicë.

Vite ato me borë, kur unë e botova pjesën teatrore „*Revolucioni i luleve*“ (1980), pas një konkursi letrar të shpallur në Prishtinë duke i paraparë demonstratat e ,81 – shit, Halldupi i Allahut me shokët mysliman rrezitëte herdhet në diell rënoreve të shteteve arabe. Unë përderisa përhapja arsim dhe dije nëpër fshatrat e malësisë së Shkupit, që falë „veprimtarisë patriotike“ të hoxhallarëve i gjeta të regjistruar si turq „ehamdurila“ pa ditur asnjë fjalë në gjuhën turke deri në regjistrimin e vitit 1981, Halldupi i Allahut vazhdonte t'i rrezisë herdhet dhe trutë nëpër shtetet arabe. Unë pas vdekjes klinike në Voskopojë dhe ringjalljes po atë ditë në Korçë (2000), një vit përpara e parashikova edhe Luftën e fundit të 2001 -shit. Zot i dola nën Rrap Shkupit me poezi e jo me ilahi e „ezan“ arab në minare duke u rrokur fytas me të „Dashurën“ e Omar Khajamit gjatë gjithë kohës sa zgjati lufta për Liri. Përderisa, Halldupi i Allahut si „misionar fetar“ i vonuar hapte xhami arabe dhe thirrte „ezan“ në minare, përhapte fenë islame si „misionar“ i vonuar nëpër Shqipëri i paguar nga Shejtani për propagandë fetare.

Rasti i Halldupit Allahut ma kujtoi edhe pishtarin e ringjalljes Islame në Shqipëri, Haxhi

Hafiz Sabri Koçi me dy shishe konjak „Skënderbeu“ në xhepa kur kishte hyrë në xhami. Xhemati e kishte pritur me brohoritje në oborr Hoxhën patriot shqiptar: Hoxha është i yni! Hoxha është i yni! Hoxha është i yni!

Haxhi Hafiz Sabri Koçi ishte ndalë te dera e xhamisë mu si Isë Boletini me dy kobure në brez kur hyri në Londër dhe u ishte përgjigjur si burrat: Na, bërryl! Hoxha është i Allahut...

Vite më vonë, „analisti politik“ e la hoxhallëkun, filloi të merret edhe me politikë madhore.

Rriqër u bë mes këmbëve t’ju ngjitet përmbrapa partive politike shqiptare. Fatkeqësisht, kryetari i Nëns Parti kuqezi, që në mes të Shkupit gjatë fushatës të zgjedhjeve të kaluara të parakohshme parlamentare në IRJ të Maqedonisë (2011), në mes të Bit-Pazarit bërtiti „Allahu Akber“, si „politikan vizionar“ nuk i fali Halldupit të Allahut asnjë post qeveritar. Përmëkeq, e humbi edhe xhaminë, shtëpinë e Zotit. Tashti, i mbëlodhi forcat, u përpoq së paku të bëhet kryetar i ndonjë partie minore duke dhënë shpirt para vdekjes. Edhe këtu, nuk i eci fati si në Shqipëri duke e thirr në vend të Zotit - Shejtanin në minare. Njëri pas tjetrit të gjithë liderët partiak pas një përdorimi ia „dogji“ Menduh Thaçi. „Analisti politik“ si „vizionar“ i së nesërmes islame, i mbëlodhi plaçkat, i hipi në shpinë „gomarit fluturues“ dhe u arratis në Londër.

„Mekën“ e tij të tretë, prej nga përpiqet me këmbët dhe trutë në legen, përsëri me „gomarin fluturues“ si kalorës i arratisur prapë të kthehet si

„çlirimtar“ i vonuar në Shkup. Në mes të ditës me diell, syhapur sheh ëndrra arabe, kësaj radhe të kthehet jo si hoxhë, po si kryetar partie politike.

„Çaj rusi“ vazhdon të pi me gjygym turku me këmbët e trutë në legen. Dhe, sheh ëndrra arabe në mes të Ditës Madhe. Motit Madh, 2012. Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Thërret „ezan“ me shokë, jo nga minarja e xhamisë, po nga facebook: „Pranverën islame-shqiptare“ duke e pasur mendjen te Pranvera e vonuar serbe...



## THIRRJA NË "DIN E IMAN" PËR HAKMARRJE

- O plak, pendohu për të gjitha ato që i fole pas "teravisë" në xhami!

- Kush je ti tani, që më urdhëron natën?! Përgjumshëm në vend të Allahut, e thirrë nateditë Shejtanin në minare. Edhe, atë: në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012) ma përmend autobusin, do të më përzësh me dhunë në Turqi?!

Në protesta qytetare del me "Allahu akbar" dhe flamur arab. Kësulë - leckë të zezë në kokë. Ose, "shajkaçë" serbe.

- Unë?

- Po, ti me ferexhenë krahëve.

- Unë jam Lugati i Koçajve. Ose, me "veprimet artistike-patriotike": Hoxha i Allahut. Bindu dhe lutu përpara këmishës së bardhë me oja e xixëlla deri në fund të këmbëve, kur dal natën!

- Jo, or Lugat i Koçajve! Jo. Frikë kam mos më rrahin me dru kur të dalë drita! Vulën e Dexhallit të ma vënë në ballë pas Përmbytjes Madhe (Kiametit). Shkaku se, ti në faqen tënde të Facebook –ut si "pejgamber i fundit" mysliman pas Muhamedit a. s. mu si dje ma ke paraparë edhe fundin tim, vdekjen solemne. Edhe atë, ma përmend pa fije turpi të ndjerin Ardian Klosi. I mjeri ti me këmbët dhe trutë në legen. Ende nuk e di gjakun tim që më ec nëpër damarë. Karakterin që më ndjek si hije brez pas brezi me shekuj. Kurrë, nuk mund ta vras veten si qen në mes të rrugës. E di, ju mund të më helmoni, vrisni kur të

doni në çdo hap. Vetëm e keni gabim si dje edhe sot se, unë vetë mund t'ia heq këmbëzën e revoles vetes në kokë?!... Veprimin e këtillë nuk e lejon as edhe Kur'ani në të cilin ju thirreni si myslimanë "ehamdurila". Haram sipas Kur'anit është ta vrasësh veten si qen.

Kush je ti o Hoxhë i Allahut, që thirresh në "din e iman" e këndej më rrëfen përkundër dëshirës Zotit rrugën e vetëvrasjes?! Përmëtepër, edhe thirr në ndihmë: "apelon te ndonjë shqiptar musliman në Shkup, në mungesë tonën atje, të padis Kaloshin për shpifje që ia bënë hoxhës… AlbaNur i merr mbi supe gjitha shpenzimet gjyqësore". Imzot, ky është kërcnim klasik?! E në anën tjetër trumbeton se, unë kurrë nuk kam pasur kërcnime e as sulme fizike. Edhe, ju u thoni këtyre dudumve myslimanë, që thirren nateditë në "din e iman"?! Përbaltin Fenë Islame tradicionale me thirrje terroriste për hakmarrje.

- Mos u tremb, o plak! Unë dal edhe ditën. Thuaj, atë ditë isha i marrë kur fola marrëzira në xhami! Lotët e Shën Mërisë Virgjër më mashtruan nën hije të Rrapit. Cuca Boheme me dy shtamba verë mes poezive.

- Ti thua që del edhe ditën, por ditën del pa këmishë. Lugatin ditën pa këmishë të bardhë deri në fund të këmbëve, nuk e kanë frikë njerëzit.

- O plak! Unë aq sa jam i rrezikshëm natën, jam edhe ditën.

- Të besoj, por kam frikë… Frikë… Ditën nuk ke këmishë të bardhë, por çallmë turku e Kur'an në vend të kësulës së bardhë të Bajram Currit.

- Plak, ti duhet të më kesh frikë mua, të kap për fyti, ta nxjerr shpirtin me thonj.

- Jo, or Lugat i Koçajve! Jo. Të marrët, asnjëherë nuk frikohen nga ata të rrezikshmit! E, as nga Bajlozi Zi që del nga deti, po nga të urtët…

- Plak, do të pendohesh një ditë. Mos u përzi në punë të kojshive!...

- Kurrë! Eci pas një ylli.

- Ai yll të çon në varr.

- Plak, hiq dorë nga zbulimi i mëkateve! Mendohu edhe një ditë! Nesër, do të vij të bisedoj prapë një natë. Edhe të tjerët janë njerëz.

- Mos eja kurrë! Të mëshoj me shkop aty ku lidhet Sagjini, në lule të ballit. Vështirë e ke të më hipësh mua në autobus për në Turqi. Ose, të më shtish me hajmali të bëj vetëvrasje. Edhe atë, kush më ndërsehet pas shpine: Buça e Katundit me Këlyshin me zgjebe. Bërlloku shqiptar, që e fsheh veten nën ferexhe dhe dimi të grave. Askush Askushi, që mezi e njeh nëna e vet, e ku më Katundi ose lexuesi shqiptar. Pavetëdije e zbuloni veten si autorë të komenteve ofenduese, kërcnuese dhe gjysëmanalfabete nën shkrimet e mia publicistike. Frikë keni të dilni me emër e mbiemër si burrat në fushën e mejdanit. Ferexhenë dhe shaminë e zezë nëpër shekuj me të cilën e fshihni fytyrën me gjithë sy ta hidhni në përrua. Flamurin kuqezi kombëtar në këtë Njëqindvjetor të pavarësisë të Shqipërisë ta nxirrni të valojë nëpër minare të xhamive. Publikisht, para botës këmbëkryq ta shpallni Xhaminë shqiptare.

Hoxha i Allahut, që harron se unë vij nga Katundi i xha Derallës. Burri i mençur, që gjithë

jetën është tallur me hoxhën, kur i është kërcnuar pse nuk shkon në xhami me zjarr të Xhehnemit.
E dini si i është përgjigjur plaku i mençur Hoxhës Allahut? Jo, nuk e dini. Hoxhë, harron ti se nëntë muaj janë dimër, e vetëm tre muaj verë. Acari madh kur do ta kaplojë Xhehnetin tënd me lule do të vish të më lutesh në Xhehnem për pak zjarr, por jo nuk do të të jap, do të të përgjigjem: rri mërdhiu në Xhehnet! Pastaj, përderisa unë të arrij në Xhehnem, ti më me gjithë ato mëkate në shpinë veç ke shkuar para meje me shokë. E ke shuar zjarrin e Xhehnemit.

Katundi im, vjet për vjet ka nxjerrë në mal nga një kaçak ta luftojë pushtuesin osman, u ka ra stacioneve të policisë serbe e fashsite me armë në dorë. Nuk do t'i përmendim kësaj radhe emrat e kaçakëve të maleve, ata i di e gjithë bota. Mjafton kësaj radhe të përmendim mësuesin patriot i ardhur nga Shqipëria Llaqi Prenqi, që me nxënësit e Katundit dhe flamurin kuqezi kombëtar në ballë e sulmoi stacionin e karabinierve në fshatin Premkë të Kërçovës (1944). Flamur, që edhe sot e kësaj dite ruhet me xhelozi si kujtim në një familje patriotike të fshatit Cërvicë. Përmëtepër, vij nga Katundi i xha Dulit i Riu, që në lokalet e xhamisë Katundit na furnizonte për "ilaç" me Lotët e Shën Mërisë Virgjër. Dhe, të nesërmen krah për krahu me shokë edhe në kohën e egër komuniste me lodra e muzika veshur me tirqi, xhamadan e kësula të bardha i binim me këngë e valle përmidisi Çarshisë Kërçovës. Edhe, gjatë ndryshimeve demokratike, kohë kur ti vite me radhë je deklaruar si sllav e je regjistruar turk

"ehamdurila", unë me poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare në kohë lufte (një autobus me targa TR.) përmidisi me poezi e këngë qytetare i kemi rënë Çarshisë Shkupit nën Rrap. Të gjithë nuk jemi njerëz!... Rrugës nga kemi ecur, kemi lënë gjurmë të thella që nuk i fshin dot asnjë stuhi. Shtrëngatë.

Vështirë është të të bindin se si duhet të ecësh, kur ti ecën me vite e vite. Lirinë e sheh edhe pas maleve. Askushi nuk e sheh në mes të Ditës Madhe, as edhe para syve. Rrugës ke thyer këmbë… Duar… Kurrizin… Qafën… Falë Zotit, nuk e ke thyer kokën… Ke ecur para… Përmbrapa… Lartë… Poshtë… Nëpër bar… Ferra… Apo, cilin ta duash… Ta urrejsh… Vrasësh… Të gjitha i ke mësuar një nga një. I ke futur në gji. U ke rënë me këmbë. Ose, cili është i mirë. Cili i keq. Të gjitha i di ti. Të gjitha. Mu për këtë nuk dua të të rri mbi kokë me këshilla. Se, ti di vetë ta ndajsh bykun nga gruri në mes të Lëmës. Ec rrugës! Ec! Vetëm kjo rrugë të shpjer në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Të gjithë nuk kemi merituar t'u marrim erë luleve. Dikush do të shtrihet në bajga… Kalbësira… Plehëra… S'i kemi hapur të gjithë sytë cilës rruge ecim nëpër errësirë. Na janë përzirë rrugët… Na janë lidhur nye… Na janë bërë lëmsh… Disa nga ne fare s'e kanë kërkuar rrugën. Kanë hyrë kanaleve. Këtë e kanë bërë pse s'kanë ditur apo me dëshirë, është krejtë njësoj. Vonë, shumë vonë kanë parë se një ecje e tillë symëshelë i ka qitur në gjiriz. I kanë rënë atij deti të zi me krimba kryemëshehtas, për t'u larë lakuriq. Por, në vend që të lahen, janë çuditur kur kanë parë se si fytyrës u kanë ecur

krimbat. Xhepat u janë mbushur me mut. Teshave teposhtë nga këmbët u ka rrjedhë ujë i zi…

- Tungjatjeta, plak-o! Tungjatjeta!

- O ti qenke, zoti Shkrimtar! Tungjatjeta!

- Plak, sot më duket, si herët ia ke nisur të flasësh rrugëve?

- Herët sot, zoti Shkrimtar, ka lindur Dielli…

- Po, ç'është plak, Ditë apo Natë?

- Ditë, zoti Shkrimtar… Ditë… Dritë…

- Plak, e ka marrë edhe gazeta!

- Zoti Shkrimtar, mos ka pjellë Bushtra këlyshë me zgjebe?!

- Po, plak! Përmëtepër, edhe qorra me katër sy pas porte…

- Zoti Shkrimtar, te ne populli thotë: Hu më hu, huni në bythë…

- Ore, lere gjithë e gjithë, po ai i paska pasur edhe thikat e operimit. Mirë që u zbulua me kohë, se do të na bënte të gjithëve një popull sallatë… Burra… Gra… Fëmijë…

- Budallai. Nuk i kanë mjaftuar hajmalitë, tabletat, injeksionet, por ka dashur t'i përdorë edhe thikat e Kasapit të Ballkanit.

- Plak, paskemi qenë ditëgjatë. Shpëtuam edhe kësaj radhe nga thikat e Kasapit.

- Zoti Shkrimtar, edhe nga thikat e Kasapit edhe nga hajmalitë…

Është kënaqësi e madhe të ecësh i lirë. T'i fusësh duart në xhepa dhe të dalësh si kaçak mali në rrugë. Por, jo të ecësh me frikë. Të shikosh kush të vjen prapa… Anësh… Para… Ose, t'i trembesh çdo porte… Ferre… Lisi… Guri… Se, të jetosh gjithë jetën me frikë, është njësoj sikur nuk jeton fare. Po, a mundemi të çlirohemi nga

frika? Jo. Nuk mundemi, se edhe frika është një lloj trimërie më vete që i ka hipur kalit me shalë…

Vrapoj rrugëve të gjata, herë me njërën këmbë, herë me të dyja këmbët.

U turrem rrezeve të diellit si xhenazja varrit. Shkopin e kam ngritur lart në dor. Ndaleni! Heu, ndaleni! Juve ju bërtas, më kuptoni?! Ndaleni! Dua të ju them dy fjalë në vesh! Afrohuni mos na dëgjojnë sorrat me ferxhetë krahëve! Ë, ju dridhen këmbët? Keni frikë! Mos e lëshoj si lopa bajgën në mes të Lëmës. Jo. Hiqni nga koka ato marrëzira! Unë u tregoj si ecet rrugëve. Nga sa shkallë t'i kapërceni përnjëherë. Në cilën torbë e keni çelësin e Derës Madhe të Shtëpisë… O Zot, si më plakët para kohe. Po, deri kur unë do të vrapoj para jush me kokën në torbë? Mos mendoni se nuk më duhet koka? Gabim. Dikushi kokën e ka si veksh. Po, ç'të duhet një kokë e tillë në qafë? Aq e trashë, aq e varfër. Aq e mjerë. Ikni! Ikni nga kokat e tilla, o njerëz! Mirrni nga sytë këmbët! Rrezik është të të turret një kokë e tillë rrugëve të Qytetit. Rrezik!... Po, ç'duhet bërë, e pyes veten në mes të këtyre rreshtave? Duhet të ecni rrugës me mend në kokë. T'i shihni gropat… Kodrat… Egërsirat… Mos e lakoni rrugën! Vazhdoni! Ecni! Vazhdimi është fitore. Në fund do të bindeni edhe vetë, se ditët e lumtura fitohen me luftë në fushën e mejdanit. Edhe Liria, që nuk e sheh Askush Askushi me brekët nëpër këmbë. Dhe, asgjë nuk ka bërë në jetën e vet për Lirinë, por edhe sot e kësaj dite e ka rrokur me të dyja duart për fyti. Mjerë ai që

është shtrirë të cofë në mes të udhës si qen me zgjebe…

- Plak, a të thash se Hoxhë Efendiu do ta gjejë nga Allahu?

- Po, zoti Shkrimtar. Vetëm se, edhe unë i ndihmova Allahut.

- Plak, mos m'i nxirr edhe këto pak mend që më kanë mbetur në kokë! E pabesueshme, si i ndihmove ti Allahut?!

- Zoti Shkrimtar, Hoxhë Efendiut ia ngrita këmbët nga minaraja e xhamisë…

- Mos u huto, plak!

- Vetëm i ndihmova Allahut, zoti Shkrimtar.

- Po, Rrufjani si dual në hekururdhë para trenit Shkup - Beograd?!

- Allahu, zoti Shkrimtar.

- Allahu, po kush i ndihmoi, plak?

- Ai e lidhi veten me litarë për qafe dhe e tërhoqi si qen në hekurudhë, para trenit…

Tani, më në fund mund të më bindni edhe mua plakun se jetoni mirë nëpër shtëpi… Ecni rrugës pa frikë… U këndoni ditëve të reja… E doni Lirinë… Keni bukë… Ujë… Por, kurrë nuk jeni aq të sigurt për vdekjen e Përbindshit… Kuçedrës me dy kokë… Qikllopit me një sy… Bajlozit Zi që herë pas here del nga deti… Shejtanit të Allahut me ferexhenë krahëve. Ata vërtet vdiqën ose cofën, thuaj si të të vij ty më së miri. Po, ku ta dijmë ne? Ndonjëri ndodh ka mbetur ende gjallë. Apo ngrihet lugat. Ose, lind. Më shkurt, nuk jemi gjithmonë të sigurt këtyre vrapimeve maratonike për në Baba Tomor. Me rëndësi është të ecet përpara. S'do të thotë gjë, nëse ndonjëherë biem poshtë, shtrihemi përdhe. Armët nuk duhet

lëshuar nga dora. Përsëri duhet të ngrihemi më këmbë. Të ecim përpara… Përpara… Përpara…

- Mirë thua, o plak! Përpara! Vetëm përpara! Po. ç'bën aty në përrua?

- I varros sorrat e zeza me ferexhetë krahëve:

**HOXHË EFENDIU - LUGATI I KOÇAJVE**

***Lindi në vitin kaq e kaq.***
***Njeri.***
***Vdiq në vitin kaq e kaq.***
***Lugat me ferexhenë krahëve.***

- Po, ky tjetri o plak?

- Edhe ai zoti Shkrimtar, ka emër dhe mbiemër mbi varr.

**RRUFJAN RRUFJANI**

***Lindi në vitin kaq e kaq.***
***Cofi në vitin kaq e kaq.***
***Qen me zgjebe…***

Lavdi "heronjve" të Xhadisë!... Amen…

Dhe ja, o Hoxhë i Allahut me ferexhenë krahëve në mes të Shkupit ta plotësova dëshirën: po qesh pas varrimit të sorrave me ëndrrën tënde arabe plot pordhë e piskamë: "Pranverën islame-shqiptare", në Shkup. Shkaku, se: E shoh Lirinë edhe prapa maleve… Krushqit e sjellin Nuse në koçi me këngën popullore: ***Hajdeni bini djemtë e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës!***…

VIII MOTI MADH

## UNAZA MAGJIKE

Aftësitë e paparishikuara të Nënës Parti i kemi ditur e njohur që nga koha e „artë“ komuniste. E rëndësishmja është, vetëm të dojë Nëna Parti dhe si me shkop magjik brenda një nate shndërrohesh në personalitet i rëndësishëm politik, kulturor e shoqëror. Moti e kam parë një film artistik, kur personazhi kryesor vetëm e rrotullonte unazën në gisht dhe brenda disa sekondave kë të donte e bënte bretkosë. Përsëri e rrotullonte unazën dhe nga bretkosa, kur të donte e bënte njeri. Mrekullia e Zotit. Edhe Nëna Parti më duket mua se, e ka atë unazë magjike: „Salep-intelektualin“ e bën profesor Universitar, bariun e bën mjek, tollumbaxhiun - shkrimtar, hoxhën - analist politik, mjekun - kritik letrar, hajdutin - politikan. Them, me vete: Po, të mos ishte Nëna Parti, çka do të bëheshin këta kalorës të arratisur?! Një Zot e di, asgjë them prapë vetmevete: përveçse argatë trusakatë.

Kohën e fundit, në Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë i madh e i vogël janë në gara politike e kulturore parazgjedhore se, kush është patriot më i madh se shoku. Nëna Parti në pushtet me të madhe më tepër bën zhurmë kulturore, sesa aktivitete të arrira artistike e letrare. Javë për javë i ke nga dy e tri aktivitete kulturore: përurim të librave, hapje të ekspozitave, koncerte gala e festivale të këngës zbavitëse e popullore.

Edhe shfaqjet teatrore me tekste të arnuara e vënje në skenë „shkelë e shko“, kemi gati për çdo javë. O Imzot, ku të gjej kohë t‘i përcjell gjithë këto „manifestime kulturore“ shqiptare?! Falë Zotit dhe partive politike, „shkel e shko“ në IRJ të Maqedonisë i kemi edhe tri teatro shqiptar që na i themeluan „veteranët e kulturës“ shqiptare: njërin Partia Komuniste e këta dy të fundit Nëna Parti. Tjetër punë është ajo se, atë që e themeloi Partia Komuniste në kohën e „vëllazërim-bashkimit“, tekefundit së paku e kanë trashëgim një gjysëm shtëpie të përbashkët me Teatrin turk. Teatrot e Nënës Parti edhe sot e kësaj dite janë qiraxhi si cergarët pa shtëpi. Publiku i tyre i zgjedhur dhe i rregullt dihet, janë politikanët. Gabimisht, ndonjëherë edhe mua më dërgojnë ndonjë ftesë. Mirë do të ishte të mos më dërgonin fare, shkaku se: kohën e fundit nuk ma kënaqin, po ma lodhin lapsin.

Ish ambasadori me profesion mjek, në ditën e sotshme merret edhe me kritikë letrare. I ka lënë „kërkimet shkencore“ për nesër, të mos them edhe profesionin humanitar të mjekut. Turret me të katra pas profesionit të politikanit. Përçudi, brenda një nate u bë „kritik letrar“. Alamet shkrimtarësh sjellë nga Mëmëdheu në IRJ të Maqedonisë. Mos them, gati të gjithë politikanë të arratisur që merren edhe me shkrime. Përmëtepër, ai edhe i hap këto përurime të librave me „kritikat“ e tij të përgjumura para kamerave televizive. Trurin „gjenial“ e vë në përdorim, folë jerm marrëzira në mes të Ditës Madhe.

I lumtur në këto momente do të ishte vetëm ai, që është shurdhmemec. Asgjë të mos shohi me

sy, asgjë të mos dëgjoj me veshë. Doktorziu si „kritik latrar i tabanit kombëtar“, është më i „lumturi“ nga të pranishmit në sallë. Mezi u duartrokitë reçensioneve të këtij „kritiku të madh letrar“ si mik i moçëm partiak, ish ministër i arsimit, ish ambasador i OKB -së në Gjenevë, që Nëna Parti kohën e fundit na e propagandon edhe si „kritik të madh letrar“ mbarëkombëtar. Dorën në zemër, letërsia botërore moti e ka pasur dhe e ka edhe mjekun shkrimtar, po jo sojin e këtij kalorësi të arratisur shqiptar. Publikisht e pyes këtë „kritik të madh letrar“, si do ta ndjente veten kur në sallën e operfimit në spital me thikat në duar mbi pacientin e sëmurë ta shihte një shkrimtar?!

Botuesi-autor edhe ai i shkreti përpiqet të thotë për librin e botuar si autor ndonjë fjalë të „madhe“. Përshëndetjet dhe urimet si zakonisht jehojnë në sallë: I përshëndes kryetarin e Nënës Parti, ministrat në Qeveri, kryetarin e komunës, ambasadorin e Shqipërisë dhe Kosovës, rektorin e Universitetit, akademikun e rregullt në sallë në këto „aktivitete kulturore“... E zgjasin diskutimin e tyre rreth librit - litarë. E tjerrin në Bit-Pazar si shtëllungë leshi. Përdredhin boshtin si ato plakat e Katundit në furkë ulur në shkam te pragu i derës. Dhe, frikë të kesh t’ua japësh në dorë mikrofonin. Edhe, nëse nuk ua jepë, vetë dalin dhe e rrëmbejnë si dhelpra pulën me kthetra majë peme e shtrijnë nën këmbë t’ia nxjerrin pupëlat. Burrat e botës nuk e dinë kur është mjaftë.

Gjithë kohën bluajnë bosh mes dy gurëve egjër për miell në mulli.

Doktorziu në rendin e parë si „kritik letrar i tabanit kombëtar“, do të plasë nga inati: bukën para syve po ia marrin mjekët, tollumbaxhinjt dhe hoxhallarët. Nëna Parti i ka bërë lëmsh profesionet. Burri i botës durimin nuk mund ta bëjë zap, reagon me zë ndaj botuesit-autor mik shtëpie, që mezi iu dha rasti nga partizanët e Nënës Parti edhe atij më në fund t’i jepet në dorë mikrofoni: „Mjaftë më se nuk do ta lexojë askush librin!“ Botuesi-autor, e lë leximin e parathënies, po nuk është i kënaqur me ndërhyrjen e mikut, tashti fillon me spjegimin e „kryeveprës botërore“ me fjalë. Doktorziu, „kritiku letrar i tabanit kombëtar“ do të plasë nga inati. Falë Zotit, botuesi-autor më në fund e shteri „fjalorin e tij artistik“. Heshti. Doktorziu bashkë me partizanët partiak plot gëzim u ranë durve shuplakë duke kërcyer nga karriget.

Tashti, filluan pyetjet e të pranishmëve. Gazetarët, dihet janë të parët, bëjnë pyetje të thata patetike pa lidhje kotnasikoti. Fatkeqësisht, edhe përgjigjet i kanë patetike, të gjata e monotone. Botuesi- autor e ka qëllimin në tjetër vend, shfrytëzojë rastin të shes ndonjë libër. Deshi - s’deshi pajtohet me fatin. Edhe këtu, si për inat nuk i eci pazari. Partizanët e Nënës Parti, vështirë e ke t’i mashtrosh në ditën e sotshme me „flijime artistike“, nuk blejnë e as lexojnë libra. Gjithë jetën janë mësuar t’u falen librat si zarzavatet e kalbura në Bit-Pazar, që të mos i lexojnë kurrë, ose t’i hudhin ende pa dalë te dera në kontenierët e bërllokut.

Shembull ende i freskët: Në Shkup erdhi Kryetari i Partisë Neokomuniste me librin e tij „bestseler“. Patrioti i Vonuar për inat me dy „kryeveprat“ e tij pas Kumanovës e Preshevës shkoi deri në Shkodër për të marrë „çertifikatën e shkrimtarit“.

Politikani i Arratisur, pas aktiviteteve dhe posteve politike të ambasadorit, më në fund mezi vendosi t’i kthehet letërsisë me tre libra erdhi në Shkup. Vetëm, përçudi sipas veprimeve

„artistike“ gati thuaj të gjithë e kishin të vetmin qëllim: shitjen e librave të tyre si kashtën në grazhd popullit shqiptar. Punemadhe, që burrat e botës kanë qenë dhe ende janë partizanë partiak: kush kryetar partie, kryetar bashkie i Tiranës, ish ambasador në Paris. I fundit i shëtitur nëpër poste që nga koha komuniste: redaktor me dy-tri vende pune në gazetën e „vëllazërim-bashkimit“, drejtor i shoqatave „humanitare“ e zëvendës drejtor i Nënës Parti në MTV. Edhe nuk kanë gjithaq nevojë për para si shkrimtarët tjerë të „papunë“, po ja i rrenë mendja se këtu është ai „livadhi i premtuar“ nga shokët komunistë, ku mund të kullosësh pa frikë bar - tërfojë dhe rrasësh me grykë barkun e madh si tinar. Asgjë nuk ishin ato poste partiake, nuk u dolën sipas premtimeve partiake as çorbë turku, i lanë të „urët“ burrat e mejdanit gjithë jetën, nuk ua rrasën barkun. Populli është ai që e ngi jo vetëm barkun, po edhe syrin e urët të sojit të këtyre politikanve teknefesë.

Fatkeqësia: Mysafirët gati të gjithë i kanë partizanë të Nënës Parti. Fare pak, aty-këtu ndonjë shkrimtar sa për farë dhe së paku për të pushuar sytë. Shkrimtarët e „papunë“ blejnë libra, po nuk kanë para as për bukë. E, partizanët e Nënës Parti të shëtitur nëpër poste politike, jo që nuk blejnë libra, po ata edhe nuk lexojnë pa para në këtë kohë qorre për kulturën shqiptare...

## FILIPI DYTË I MAQEDONISË SI XHAXHI ENVER

Shqiptarët nuk kanë arsye të ankohen se kryeqyteti i tyre historik Shkupi është i mbushur me misionarë fetar të Beogradit, heronj antik e bullgar, kryq të madh në malin „Vodno“. Punemadhe. Një ditë, ato statuja, pasuri e patundshme të gjitha do të jenë pronë e shqiptarve. Nëse, e përkujtojmë Nolin e Madh me vargjet:

*Jesu Krishti s' dëgjoj, dhe s'e mori vesh mikun.*
*Dhe me lot i penduar e hodhi kamçikun,*
*Dhe i tha: "S'e ka fajin kurrizi, po truri,*
*Se lirin' e sjell drita e mëndjes, jo druri."*

Vërtet, fajin në atë kohë qorre nuk e pati „kurrizi, po truri“. Patjetër, sipas Shën Pjetrit duheshte vënë në përdorim „druri“:

*“Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin.*
*Se shpirt-robi s'çlirohet askurrë pa drurin."*

Gabimi i tij politik, Nolit në atë kohë i kushtoi shumë shtrenjtë, e detyroi demokratin pas Qeverisë gjashtëmujore të themelimit të Shtetit të parë demokratik shqiptar në Ballkan (16 qershor – 24 dhjetor 1924), ta humbë pushtetin dhe të arratiset nëpër botë. Miqtë e tij të luftës: Luigj Gurakuqi dhe Bajram Curri nuk e lëshuan Atdheun, vazhduan luftën për liri, ku më në fund u vranë nga dora tradhtare shqiptare, njëri në Bari

të Italisë e tjetri te Shpellë e Dragobisë (Kosovë). Edhe sot, fajin nuk e ka „*kurrizi, po truri. Se, lirin e sjell drita e mendjes, jo druri*.“ Ose, nuk kemi arsye të frikohemi nga të vdekurit më këmbë e mbi kalë që na e „zbukurojnë“ Qytetin me petk antik. Rrezik duhet të kemi nga të gjallët, që gumzhijnë si bletët në koshere pas mjaltit e luleve! Edhe në Ditën e sotshme e thirrin nëpër minare Baba Dovletin! „Pranverën islame-shqiptare“. Qofshin ato spiunë sllavë ose shqiptarë të shitur një torbë taxhi.

Shembull ende i freskët historik për ta ilustruar këtë shkrim është Hitleri, i cili aq shumë e ka dashur dhe lexuar Niçen. Idetë e tija filosofike për pushtet i ka vënë në praktikë si diktator. Ndikime të dukshme nga Niçja ka pasur edhe njëri ndër shkrimtarët më të mëdhenj gjerman: Hermann Hesse. Në bazë të veprimeve politike në Shtetin Shqiptar komunist të Enver Hoxhës, hedh mendimin në „treg“ se, xhaxhi Enevr i vodhi në ide Rilindasit tanë patriotë: Vaso Pashë Shkodranin, se: „*Feja e shqiptarit është Shqiptaria*“. Dhe, Nolin e Madh që krijoi Shtetin e parë shqiptar demokratik në Ballkan: „*Se shpirt-robi s'çlirohet askurrë pa drurin”...* Inati më vjen, dhe dua të plasë sipas veprimeve politike nga politikanët e sotshëm shqiptar se, cilët ide ata „vjedhin“ sot për Shqipëri Etnike?! Edhe pse, trumbetojnë me të madhe gjatë fushatave parazgjedhore dhe në pushtet, rrugën e tyre të integrimit në Bashkimin Evropian.

Shqiptarët sot i kanë edhe xhamitë „e tyre“ në Bit-Pazar, kur t’u teket mund ta thirrin nga minaret në ndihmë Zotin. Fatkeqësia është, që në

„minaret e tyre“ edhe sot e kësaj dite ende nuk valon flamuri kombëtar shqiptar kuqezi. Sot për sot nuk thirret „ezani“ në gjuhën shqipe nga ajo Shtëpi e Zotit. Shkaku se, profiterë politik fetar „shqiptar“ që thirren në „Din e Iman“, pëllasin nateditë në mjetet e informacionit dhe Facebook marrëzira edhe në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, gjoja për Shqipëri Etnike. „Gomarin fluturues“ e kanë hipur në minare mu si shkrimtari shqiptar Nehas Sopaj para lufte Maçorrin e tij te romani për fëmijë „Fluturimi mbi Sllupçan“ (1997). Edhe, vërtet një ditë Maçorri i Nehas Sopajt gjatë Luftës së fundit të 2001 -shit, fluturoi mbi Sllupçan me helikopterë rus duke na hedhur nga qielli „dhurata humanitare si mik strategjik“ për „Bajram“ i shqiptarëve.

Nuk prish punë, edhe banorët e asaj ane ua kthyen „ndihmën humanitare“, i shpërblyen me „ëmbëlsira festive“ si për Ditë „Bajrami“ të traditës shqiptare. „Miqtë“ e paftuar ikën nga sytë – këmbët. Enesërmja, patjetër edhe këta haramë të Allahut, që na rrinë ende me „gomarë fluturues“ mbi kokë do t‘i gëdhijë shqiptarë nëpër xhamitë shqiptare me flamurin kuqezi në minare. Shkaku, se: Në hyrje të Çarshisë së Vjetër më në fund e morën porosinë: Sot e kanë edhe Filipin e Dytë të Maqedonisë duke i përshëndetur kalimtarët e rastit me grusht si xhaxhi Enver. Vërtet, pas ndryshimeve demokratike shqiptarët e rrëzuan në Tiranë, po „vëllezërit“ për inat përsëri na e ngritën në Shkup.

Edhe, misionarve fetar të Beogradit pas ringjalljes në të dy anët e Vardarit u thotë STOP:

Këtu është kufiri demokratik. Radhën e ka të na vijë si Nuse e vonuar me koçi Olimbia Shqiptare, rrëzë Kalasë Dardane. Krah për krahu me krushqit dasmorë dhe këngën e njohur popullore shqiptare: ***Hajdeni bini djemtë e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës***! Nga Porta e Madhe Triumfale e Gruevskit të na hyjë në lëmë me gjithë duvak e lule në dorë në këtë Dasëm shqiptare. Krushkat ta zbresin nga koçia për krahu në oborr, përpara Shtëpisë. Cucat me këngë e valle copë-copë t'i bëjnë dajret. Përndryshe, do të kemi probleme në të ardhmen me barazinë gjinore, Shoqatat joqeveritare të grave. Shkaku se, në të dy anët e Vardarit më këmbë e kuaj të gjitha përmendoret sot për sot i kemi burra, e asnjë grua. Edhe atë, kur dihet se ky vend ka dhënë me bollëk edhe gra heroina me tirqi e xhamadan me mauzerrin krahut. Pse jo, nesër në ndonjë shesh qyteti të mos e kemi me gjithë gërshërë të dhenëve edhe Sulltanë Qafën?!...

Shkupit historik moti, që nga koha e Perandorisë osmane e komunsite i janë rritur flokët dhe mjekra gati deri në brez. Vardari nëpër shekuj përpiqet t'ia lajë sytë dhe faqet nga gjirizi. Vite e vite përmes qytetit gurgullon nën Urën e Gurit. Cuca shqiptare pasi ende i ka gërshërët e dhenve në dorë, koha është t'i ulë në karrike këta burra pushteti pa mustaqe e me mjekra.

Mirë e mirë t'ua shkurtojë me gërshërë të dhenëve leshërat që ua kanë mbuluar sytë e fytyrën, përgadis për Dasmën e Madhe Shqiptare. Ditën e premte me disa grushta shpinës t'i fusë në odën e Martesës historike. Punën në dorë tashti ta marrë Dhëndrri kreshnik, që gji për luftë i kanë

dhënë Tri Zana të maleve. Duvakun ngadalë t'ia heq nga koka Nuses shqiptare. Dhashtë Zoti edhe kësaj radhe krushqëve nuk u është thyer koçia në rrugë mes maleve. Dhëndrrit si zakonisht mes maleve t'ia ndrrojnë Nusen, fusin në koçi tjetër nuse xhadi.

Dorën në zemër, në Shkup më këmbë e kuaj shale i ke të gjithë burrat e historisë shqiptare e bullgare: Edhe Aleksandrin e Madh, edhe Skënderbeun, edhe Goce Dellçevin, edhe Nikolla Karevin, edhe Karposhin, edhe Nënë Terezën me gjithë shtëpi... Naim Frashëri moti e ka thënë këtë profeci në një vjershë: „*Ç'hoqi Shqipërize e gjorë!/ Vashatë gjith' u përmblodhë,/ për të mos rënë në dorë.*"/ Kohën e fundit me emrat e tyre pagëzohen edhe rrugët e Komunës së Çairit. Duartrokitje. Ndashtë, ndonjëri nuk ka gjithaq merita para shokut, nuk e ka shkrep as edhe një pushkë për çështjen shqiptare, nuk ka dhënë për shqiptarët asnjë lek, e rëndësishmja është se familjarët i kanë ende në pushtet. Dhe, jo rastësisht pas lufte na dalin kaq shumë trima. Komandantë lufte. Hoxhallarë me „Din e Iman", që këtë popull e dalldisin ta fusin edhe në një luftë të re gjoja për „Shqipëri Etnike". Popull me traditë historike dhe kulturë jemi ne shqiptarët: „*Për çdo vjet e kami nisur nga një luftë. Herë me Krajl e herë me Mbret*." Tjetër punë është ajo se, edhe sot e kësaj dite ende nuk e kemi bërë Shqipërinë Etnike. Historikisht, gjithmonë kemi qenë të vonuar nëpër shekuj: Përderisa, Turqia e humbte luftën në Stamboll, ne në trojet tona etnike bënim luftë për ta mbajtur gjallë të Sëmurën e Ballkanit, e kërkonim në trojet tona

shqiptare Baba Dovletin. Fashizmi e humbte luftën në Berlin, ne ende bënim luftë me armë në dorë maleve të Zajazit për „Shqipëri të Madhe“. Komunizmit, i vinte fundi në Rusi, ne në demonstrat e studentëve në Prishtinë, dilnim në rrugë me fotografitë e shokut Tito në ballë.

Tashti së shpejti pritet t‘i kemi në mes të Shkupit edhe Pjetër Bogdanin, Josif Bagerin, Nexhat Agollin dhe Hasan Prishtinën para Gjygjit Themelor të Maqedonisë. Dhashtë Zoti, Mendjendrituri i Kosvës më në fund vëndos rregulla dhe ligj në këtë Shtet! Nesër, me siguri nëse vjen në pushtet edhe ndonjë parti tjetër politike e paralajmëruar me protesta në rrugë nga „Fronti i Bashkuar Kombëtar i Vëllezërve“, do t’i kemi nëpër rrugët e Shkupit: Edhe Kalosh Zajazin, Sulltanë Qafën, Mahmut Dumanin, Azem Moranën, Mehmedali Hoxhën, Sadudin Gjurën, Nexhat Pustinën, Nikolla Gruevskin, Ali Ahmetin, Arben Xhaferin e Menduh Thaçin...

Probleme historia e ardhshme do të ketë me Branko Cërvenkovskin dhe disa kalorës të arratisur shqiptar - Sanço Panço hipur në gomar duke luftuar për Dylqinenë e Tobozës. „Fakirët“ nuk e kanë problemin e popullit, po të vetvetes se si ta ngrisin nesër në përmendore.

Vend të lirë nuk u ka lënë Gruevski as për varre, që edhe ata t'i ngrisin shtatoret e tyre politike-historike, përveçse në rrjedhën e lirë plot dallgë të Varderit. Valët e tij, kur do të tërbohen Dimrit le t’i shpiejnë „heronjtë e shtetit demokratik maqedonas“ në Greqinë Antike. Nuk na duhet ky bërllok komunist. Vendin e kanë në muze. E, sa di unë Greqia është e njohur për

muzetë historik që nga koha e Teutës Ilire. Edhe, Sanço Pançot e Ali Ahmetit hipur mbi gomarë le të vazhdojnë t'i punësojnë nëpër institucione dashnoret e tyre besnike, fëmijët e tyre, farefisin e partizanët partiak. Përditë të propagandojnë me të madhe zhurmë kulturore nëpër Bit-Pazar. Përurimin e librave. Hapjen e eksopzitave figurative. Debate kulturore me vetveten në Institutin e Trashigimisë Kulturore e Qendrat infromative-kulturore-njëpartiake. Përpak, në këtë shkrim profetik ta harrojmë, edhe „pëllumbin postier", që dosjet e UDBA -s jugosllave, shqiptarëve ua lë natën pas dere. Kohën e fundit, pasi e „dogji" Menduh Thaçi si politkan me „perspektivë", merret edhe me „analiza politike" krah për krahu me Hoxhën e Allahut. Nateditë nëpër Bit- Pazar thërrasin „Allahu Akbar". „Pranverën islame-shqiptare". I rrenë mendja se, kjo është rruga e vetme për t'u ulur me shokë në karriken e Qeverisë maqedonase.

Mjeranët, që ende nuk e dinë se Ali Ahmeti vjen nga një familje hoxhallarësh me shumë autoritet dje dhe sot në Kërçovë. Askush nuk mund ta dojë më shumë se ai Zotin. Dajallarët e tij studimet e larta teologjike i kanë kryer në Kairo. Doktorë të teologjisë që punojnë edhe sot nëpër Universietet më të njohur të vendit dhe botës. Pavetëdije, dalldisen nga qarqe të errta antishqiptare tradicionale se do ta rrëmbjenë me dhunë pushtetin, po qe nevoja për karrike do të bëhen bashkë edhe me Shejtanin e Allahut. E, harrojnë në Ditën e sotshme se, pushteti merret edhe me votën e lirë të popullit. Dudumët qorra me sy në ballë, që e kanë fjalën e bukur shqipe

freski, të cilën e zëvendsojnë për rrëmbimin e pushtetit me fjalën e huaj: „refresh“. Enesërmja shqiptare bythekrye do t’i hedhë si plehëra historik në kontenierët e brëllokut në Bit-Pazar, Prishtinë ose në Tiranë. Qerre me katër rrota e dy palë qe nuk do të kemi t’i hudhim si bërllok shqiptar në Vardar për t’i shpjerë rrjedha e lumit në Greqi. Turqi.

Përinatë të dudumëve, Shkupi dita-ditës frymon shqip dhe po vishet me petk kombëtar shqiptar, tirqi e xhamadan. Këmulën e bardhë në kokë. Sahatin me qystek që në vitin 2001 e ka varë përqafe si këmbonë dashi me brirë. E hodhi nga shpina përgjithmonë uniformën e kuqe neokomuniste. Mashat shqiptare që i ngatërroheshin nëpër këmbë si popull liridashës. Përmendoren e shokut Tito hipur në kalë të bardhë, që sipas paralajmërimit në një fushatë parazgjedhore në Shkup, pritej në ngritet nga një parti politike neokomuniste në sheshin „Makedonija“. Natën papritur, për inat të tyre erdhi Aleksandri i Madh hipur në kalë me shpatën në dorë ballë për ballë në të dy anët e Vardarit me Skënderbeun dhe e pushtuan Shkupin pa luftë.

Momentalisht, i ndanë vetëm Vardari si kufi natyror e i bashkon Shkupi Dardan, një hap kali matanë Urës Gurit që me siguri nesër not do ta kalojnë lumin. Kryqzojnë shpatat si burrat për fitore në Bit-Pazar. Krah për krahu shalojnë kuajt në Kryeqytetin e Dardanisë Shqiptare. Shtet etnik demokratik shqiptar me gunën krahëve në mes të Ballkanit.

Dudumët më kot me vite i kanë vënë pusi pas ferre çështjes shqiptare te Ura e Gurit, kaçakët e

Zajazit moti e kanë pushtuar Shkupin. Skënderbeu me kalë me shalë posa e shkeli pragun e Shtëpisë, shpatën namëmadhe pas fitores historike e futi në brez. Armë të tjera lufte kërkohen në këtë kohë demokratike. Stërnipat e tij sot e vazhdojnë luftën me libra nën sjetulla, i kanë nxjerrë lapsat nga brezi rrugëve të Shkupit për Liri...

Zoti e bëftë për hajër këtë Njëqindvjetor të Pavarsësisë së Shqipërisë!... Enesërmja, për inatë të dudumëve do ta gëdhijë mëngjesin si Ditë e Madhe historike shqiptare...

**ASHIKU I RRAPIT**
**VDES I RI**

## Urrejtja në liri

*( Mikut tim, Pano Taçi )*

U njohëm rastësisht, në manifestim poetik
Ti i kishe shkarravitur muret e zandaneve.
E Unë, burgun shtëpiak në IRJ Maqedoni.

Vetëm, për çudi ta pata lakmi
Urrejtjen ti e kishe lënë në burg.
E Unë e kisha nxjerrë në liri...

*(Edhe Ajo nuk ishte xheloze, Shkup, 2004)*

E pritnim për çdo vjet plot mall si gjithmonë në Shkup edhe këtë fundverë me fillimin e Vjeshtës si Lejlekun e vonuar shtegtar në Takimet Poetike nën Rrap. Realiteti, ai edhe i mbante gjallë këto takime poetike. Ishte njëri ndër themeluesit e këtyre takimeve tradicionale të poezisë erotike. Nuk e ndalte Moti i keq: shiu, breshëri e as bora  për të marrë pjesë në këto takime tradicionale. Rrugën e merrte edhe këmbë si djalë i ri nëpër Qafë Thanë. Ndonjëherë na paraqiteshte me anë të telefonit se ka mbetur në Strugë. Nuk kishte asnjë lidhje komunikacioni për të arritur me kohë në Shkup. I merrja miqtë atje, në telefon dhe u thoja: Pano ka mbetur në Strugë, ku të doni ta gjeni nëpër qytet të ma sillni në Shkup! Edhe, pas dy orëve e sillnin Ashikun e Rrapit.

Raste kishte edhe kur përfundonte me gjithë miq në polici, në Kërçovë pse kishte lexuar poezi në Tetovë. Turr ne organizatorët pas politikanëve shqiptar në pushtet, kur dëgjonim se Pano Taçin përsëri e kanë rrasë në birucë. I madh e i vogël çoheshim më këmbë për ta përcjellur në Tiranë pa asnjë ferrë në këmbë. E donin të gjithë, po përçudi edhe ai i donte njerëzit. Punemadhe, që një soj i tyre e kishin rrasur edhe në burg. I tillë ishte Pano Taçi. Autori i vargjeve që kërkoi përsëri ta kthenin në burg se atje, „i kishte të gjitha“: bukë, shtëpi, lekë, gra... E, në liri nuk kishte asgjë, as edhe bukë për darkë. Vargjet, kohën e fundit më nuk e dëgjonin poetin, ngrenin krye:*„Do shkoj të shtrihem të bëj gjumë/ O soi im i morit, u lodha shumë,/ më shumë se ç'duhet./ Duke gicilisur tokën plakë:/ kam cimbisur helm e jo gjak“.*

Zemrën na e bënte mal, kur e shihnim në mesin tonë për çdo vjet me poezitë e „egra“. Kurrë, nuk na ka shkur mendja se këtë vit me gjithë ato vite plot vuajte mbi shpinë nuk do ta kemi në mesin tonë nën Rrap. Përkundër, problemeve që më rrinë natë e ditë mbi kokë, këtë vit mendoja të shkoj ta marr vet deri në Tiranë. Çfarë parandjenje dhe fati të tmerrshëm kemi ne poetët e nemur nga pushteti?! Lumë ne që u besojmë poezive e jo partive politike! Kryetarve teknefes të partive politike e Shtetit. Përpara duhet të vdesim si poetë, që të vijnë të na sjellin lule, qajnë mbi varr. Iku paprtimas, edhe atë në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, kur prisnim këtë vit ta përcjellim Natën me poezi

e këngë deri në agim me Ashikun e Rrapit. Fatkeqësisht, kësaj radhe nuk e deshi Zoti. Rrapi më kot do ta pres shtegtarin e plagosur t'i paraqitet nga rruga me telefon se ka mbetur në Strugë. Jo, ai kësaj radhe ka gjetur tjetër shtëpi, atje nuk ka telefon. Gjatë kohë Rrapi do të mbajë zi për poetin. Mikun që e deshi aq shumë dimër e verë. Shkaku se, Pano Taçi vetë kishte në shpirt „dimër jashta, dimër brenda".

E përcollëm dikur së bashku me poezi e këngë edhe Luftën e fundit (2001) nën Rrap. Krah për krahu me shokë lexuam poezi para tytave të tankeve. Frikës që na ndiqte pas si hije... Zonjën Vdekje, kur në çdo hap na vënte pusi pas ferre... Erdhi koha, më në fund t'i kthehemi jetës... Manifestimeve kulturore... Lirisht të marrim frymë përmes poezive anembanë Atdheut. Tekefundit, t'i heqim qafe kufijt politik. Armët e kishin bërë të veten me shekuj, mjaftë kishin folur nëpër vite. Tashti, duhet të heshtnin mbyllin gojën. Radhën e ka pena... ***Kur flet arma, heshtë pena... E kur flet pena, hesht arma...***

Manifestimi kulturor, Netët Poetike të verës: TAKIME NËN RRAP, atë vit kishte edhe karakter festiv, për herë të parë u mbajtë në Zonën e lirë... Edhe vitet tjerë e kishin bërë të veten nën Rrap me vargje e këngë deri në agim. Kurrë, Shkupit deri në atë ditë nuk i kishin ardhur aq shumë miq poetë, një autobus me targa TR nga të gjitha trojet etnike shqiptare. Artisti Xhevat Limani lexoi në mënyrë shekspiriane Asdrenin: „*Nuk' duamë gjë tjetër, nukë/ vetëm ca armë edhe ca bukë*!"

Vargu shqip atë natë nën Rrap krisi në mes të Shkupit. Poezitë e para për UÇK – në u lexuan deri në agim. E përcollëm Natën.

E shih kësaj radhe, në këtë Njëqindvjetor të Pavrsësisë së Shqipërisë për të pesëmbëdhjetën herë me radhë pritej përsëri të tuboheshim si zogjtë shtegtar nga të gjitha trojet etnike shqiptare. Patjetër, edhe do të tubohemi me gjithë poezi në Motin e Madh 2012. Një minutë heshtje do të mbajmë për ty, o Pani Plak si dëshmorë i poezisë... Edhe për Miken tjetër të Rrapit, Hida Halimin... Lavdi... Revista letrare STILI 97 këtë Njëqindvjetor do të mbaj me krenari në ballinë në dy numrat e këtij viti (2012) portretet e dy miqve të Rrapit.

Luftën dikur e përcollëm me poezi e këngë nën Rrap... Zonën e lirë... Sot si për çdo vjet Hida Halimi dhe ti o Pano Taçi, përsëri do të jeni në mesin tonë, që edhe këtë Manifestim Kulturor Tradicional Ndërkombëtar TAKIME NËN RRAP ta hapni me poezinë - himn:

**NA BASHKOI RRAPI**

.....

Ejani o dashamirë
Mblidhuni, t'ia bëjmë fora.
Ne siç jemi zemërdlirë
s'kanë se ç'na bëjnë ca morra.

Le të buçasë këngë e Rapit
më e bukur për çdo mot.
Cmirëziu me trutë e krapit
të na ndaj e ka më kot.

Shpirt i tij i zi me damga
e me zemrën përplot driza.
Rrjetën thur si marimanga
të na kapë me ç'na çmon miza.

Por ne insekte nuk jemi,
jemi zogj të Rrapit të lartë
blerimin nën buzë e kemi
siç kemi këngën të zjarrtë...
.....

Tri ditë e tri netë do të lexojmë poezi nën Rrap... Këngë... Valle deri në agim... Dolli do të ngrejmë në Zonën lirë për shpirtin tënd të shenjtë që fluturoi në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Tyrben ku pihet vera, shkruhet poezi... Dhe, bëhet dashuri...

Zonja Vdekje kësaj radhe nuk do të na vij e papritur në këtë manifestim kulturor nën Rrap. Edhe pse, edhe asaj moti i kemi dërguar një ftesë. E presim ta përshëndes Dasmën e Motit Madh 2012 me një poezi, ku ti o Pano Taçi kësaj radhe do ta fitosh titullin e përjetshëm: ASHIKU I RRAPIT... Çmim letrar që do të ndahet për çdo vjet nën Rrap...

## „XHAMI“ PA MINARE

Teatri Shqiptar në Shkup, moti e ka humbur misionin e tij të shenjtë si instuticion i kulturës shqiptare, që nga koha e „ndryshimeve demokratike“. Fushë e lirë kjo për trusakatët, kur Partitë politike shqiptare i zhvillonin fushatat parazgjedhore lokale e parlamentare dhe „betejat e tyre të përgjakshme“ me Shpatën e Skënderbeut për liri. Politikë „madhore“ bënin në sallë, brenda katër mureve „burrat e mejdanit“. E shpallnin Shqypni Etnike. E ngrenin flamurin kuqezi para syve të popullit dy sahat në teatër. I suleshin foltores duke u shtyrë me bërryla me fjalime të zjarrta patriotike, secili më patriot se shoku hipur mbi Kalin e bardhë me një këmbë të thyer gjatë fushatave parazgjedhore për pushtet. E zvarritnin krahëve si ferexhe flamurin shqiptar kombëtar nëpër sallë para publikut. Inati të vjen sot, që ky gjysmëteatër shqiptar më lirshëm ka marrë frymë në kohën e „artë“ komuniste, sesa në Ditën e sotshme „demokratike“ me dy universite shqiptare. Fabrika prodhimi të „salep-intelektualve“ me diploma universitare e tituj shkencor.

Përinat, veprimeve të tyre „strategjike“, në vend që të merret me kërkime arsimore-shkencore, që nga ky vit do t’u „konkurojë“ me prodhimin e rrumaducëve serik pasuniversitar edhe Instituti i Trashëgimisë Kulturore në Shkup (Mollë sherri e partive politike shqiptare). Hoqi dorë nga përurimi i librave dhe konferencat e përjavshme „shkencore“ duke u fotografuar krah

për krahu para kamerave televizive „çaj-ruso-shkenctarët“ e Bit-Pazarit. Nuk kishin levërdi materiale me zhurmën kulturore - shkencore „kalorësit e arratisur“ të partive politike t’i mbushin xhepat me djersën e popullit. Lakmi ua morën kolegëve të dy universiteteve shqiptare, Fakultetit Pedagogjik, Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Universiteteve privat që gjatë këtyre viteve mbinë si këpurdhat pas shiut. Njëzëri, vendosën të merren edhe këta „shkenctarë“ me prodhimin serik të diplomave dhe titujve univarsitar me „shumicë e pakicë“ duke i shitur si zarzavate bujqësore të kalbura në Bit-Pazar. Përçudi, synojnë t‘i mbushin thasët e grisur me paratë e studentëve të varfër duke i plaçkitur haptas para syve të popullit e sakatuar tashti edhe në tru me sëpatën „intelektuale“ pa asnjfarë bagazhi shkencor. Aspak, nuk janë larg veprimeve të atyre doktorësakatëve edhe „salep-intelektualve“ për nga „njohurit shkencore“ dhe titujve universitar të fituar me „gjoks“ e intervenime partiake prapa perdeve me ndihmën e „vëllezërve strategjik“ në këtë shtet të ri „demokratik“. Alamet profesorësh janë dudumët e Nënës parti, vërtetet nuk vijnë nga Universiteti i Sorbonës dhe Havardit, ama vijnë nga ai i Çajtoreve të Bit-Pazarit me „bursa studimore“ të Fondacioneve „humanitare“ për bashkëjetesë dhe „vëllazërim-bashkim“. Tashti, më në fund erdhi koha të shohim kulminacionin e „lulëzimit“ arsimor të shqiptarve. Gjithë jetën mbetën lypës te Ura e Gurit duke u ankuar me protesta demokratike në rrugë, se: nuk kanë shkolla në

gjuhën shqipe, universitete shtetëror e private. Rroftë Partia Neokomunsite që ua e hapi derën haramëve krah më krah duke i stolisur me poste partiake, jua dha „edhe arrën edhe çekiçin në dorë“. Dudumët do t'i dalin zot nesër Atdheut me „prodhime bujqësore“ me afate të skaduara për një përdorim në Koperativën e Livadheve. Edhe, do të shpallin qytetarë nderi në mëhallën e tyre brenda një muaji nobelistë e rektorë universitati. Përbaltin emrat e këtyre personaliteve të metropoleve botërore duke i shpallur qytetarë nderi të një mëhalle të Shkupit. Përgëzime, nëse këto personalitete shqiptare i shpallnin qytarë nderi të Shkupit. Partizançe përpiqen ta „shpëtojnë“ nga kanceri vdekjeprurës me rrënjë të lëshuara arsimin dhe instuticionet shqiptare, që sistemi komunist na i rrëzoi për „shërim“ në shtratin e vdekjes klinike  në „spital“, falë „aftësive“ të tyre arsimore e shkencore.

Dorën në zemër, „Drama Shqiptare“ në atë kohë edhe pse nën një çati të përbashkët me „Dramën Turke“ i pagëzuar si Teatër i Kombësive, vërtet ishte çerdhe kulturore e krijuesve shqiptar: Loni Papa me *Cucën e maleve*, Spiro Çomora me *Karnevalet e Korçës*, Teki Dervishi me *Zbutsin e njerëzve me sy prej zymrydi*, Anton Pashku me *Gof* -in, Ymer Shkreli me dramën *Zeka i Zi udhëton për në Babilon*, Beqir Musliu me *Shtriganin e Gjel Hanit*... Edhe atë, kohë kur nuk kishim mundësi të siguronim bileta, shkaku se ishin shitur brenda një dite. Falë Zotit, ishim të detyruar në mungesë të karrigeve nga  errësira, shfaqjet teatrore të asaj kohe t'i

përcjellim më këmbë. Vetëm, këtu duhet përmendur se, në atë kohë aktorët e punësuar në këtë gjysmëteatër nuk kishin pretendime që të bëhen shkrimtarë, regjosorë dhe politikanë. Jo vetëm kaq, „gjenitë“ me gunat krahëve në atë sistem komunist nuk dëshironin t‘i bënin shkrimtare edhe gratë e tyre duke arnuar përralla popullore për fëmijë, regjisorë e aktorë me zor fëmijët e tyre pa talent. Tekstet e vënë në skenë, në atë kohë i shkruanin shkrimtarë të dëshmuar shqiptar të letrave shqipe. Fatmirësisht, sot shfaqjet teatarore në kët institucion me gjysmë shpirti jepen gratis, po nuk u hy njeri i gjallë në sallë me përjashtim të ndonjë politikani të arratisur, që e ka humbur rrugën për në shtëpi ose e ka përzënë gruaja me shqelma në sokak. Në atë kohë, organizoheshin manifestime kulturore-artistike shqiptare edhe para syve e tytave të armëve policore. Shfaqje të shumta teatrore për fëmijë. Drama shqiptare ishte çerdhe kulturore „irredentiste“ ku takoheshin herë pas here krijuesit shqiptar të „rrezikshëm“ për shtetin neokomunist. Dhe, diskutonin me orë të tëra kokë më kokë për artin dhe letërsinë: Teki Dervishi, Adem Kastrati, Musa Ramadani, Radije Hoxha – Dija, Ymer Shkreli, Frederik Rreshpja, Pano Taçi, Gani Xhafolli, Fadil Curri, Fehmi Kurexha, Fadil Bekteshi, Muhamet Curri, autori i këtij shkrimi, Kalosh Çeliku...

Po, sot në Ditën e Motit Madh 2012, ç’punë kombëtare bën ky Teatër Shqiptar, përveç aktiviteteve propaganduese kulturore-politike?! Askush nuk e di, thonë që është strukur në mes të

bërllokut, në Bit-Pazar. Edhe, gërhet në gjumë, sharron jerm shelgje në livadh. Ëndrra sheh syhapur në mes të Dimrit. Ferexhenë e zezë e ka hudhur krahëve. Kokën e ka mbuluar me shami si një grua e vejë pa burrë. Herë pas here vë në skenë ndonjë dramë të arnuar arnë përmbi arnë nga shkrimtarët e vetëquajtur të Oborrit, shpallin fushtatat e tyre parazgjedhore partitë politike shqiptare, japin deklarata teknefese para kamerave televizive kalorës të arratisur. Ose, grupacione të xhindosura të Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni duke shpalosur idetë e tyre patriotike-fetare për një „Pranverë myslimane-shqiptare“ edhe në Shkup. Kohë qorre kjo, kur për arsimin dhe kulturën shqiptare përkujdesen dhe vendosin trusakatët: Tollumbaxhiu, hoxha, partizani partiak, që nuk di ku e ka kokën e ku bythën.

Anarkia fetare: katër fe të ndryshme që nuk kanë zënë rrënjë ende në zemrën e shqiptarit të vërtet duke fshehur identitetin, marrin guximin pa pasur në gjak e shpirt shqiptarinë, kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë t‘i udhëheqin punët e Shtetit shqiptar. Edhe, vajtojnë halldupët nateditë se kush na udhëheq në Shqipëri, Kosovë e IRJ të Maqedonisë duke e nxjerrë veten në siprëfaqe, se: Shqiptarët u dashka t’i udhëheqin „hoxhallarët“. Mashat shqiptare të shitura shumë lirë nëpër shekuj te armiqtë e Shtetit Shqiptar.

Edhe, lexoj në Facebook: „Islami, feja e vëretetë“. Nuk e di, pse ma kujtojnë thirrjen e shqiptarve gjatë ndryshimeve demokratike në IRJ të Maqedonisë: PPD -ja, Partia politike e vërtetë e

shqiptarëve. Xhadi, që gjatë këtyre viteve na i polli dhjetëra kopilesha shqiptare plot trusakatë me thasë. Edhe një kopile tjetër pritet të na pjellë në vjeshtë me petk fetar-politik e „Din e Iman“. Një Zot e di ku i kanë baballarët këto kopilesha që na i lënë natën pas dere „vëllezërit“.

Vallë, në Ditën e sotshme të Motit Madh 2012, a frymon ende shqip ky Teatër Shqiptar?! A merr frymë lirisht sikur dje fuqishëm me gjithë mushkëri?! Dhe, sa ka tru, hundë dhe zemër shqiptare sot ky Teatër?! Jo, nuk e di e them plot gojën. Në gjirin e tij sot sillet siç thotë populli shqiptar i hurit e litarit: më shumë politikanë, tregtarë e spiunë sesa artistë. Mezi vihet në skenë ndonjë tekst drame nga të punësuarit e tij dudumë, familjarët (gratë dhe fëmijët e tyre), ose miqtë e ngusht të klanit të tyre me zgjebe partiake me tekste të arnuara nga dramaturxhia e letërsisë botërore arnë përmbi arnë.

Aktorët e punësuar në këtë institucion kulturor janë të vetëshpallurit „gjeni“ të shekullit: edhe politikanë, edhe drejtorë, edhe shkrimtarë, edhe regjisorë... Vetëm, shum pak janë aktorë, zot t‘i dalin punës artistike për të cilën edhe marrin rroga mujore me vite nga populli shqiptar të cilin e kanë rrëzuar nën këmbë si ujqërit. Teatri Kombësive i dikurshëm në Shkup, sot është shndërruar në „xhami“ pa minare. Dërrasave të tij në skenë që dikur para syve të Policisë letrare shpërthenin vlerat e arrira artistike, tinëz me frikë valonte flamuri kombëtar kuqezi, sot në „demokraci“ në Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, përkrah tij zvarritet edhe flamuri i

huaj me gjysmëhënë e yll të kuq në ballë. Përmëkeq, manipulohen dhe politizohen fëmijët shqiptar nga partitë politike shqiptare dhe grupacione të pakokë të fesë islame gjoja me „kësula të bardha“ në kokë e flamuj partiak e me gjysmëhënë në duar si „revolucionar“, kur ata nuk kanë shkolla e as tekste shkollore. Uzurpojnë me „politikë madhore e fe Islame“ për thirrje „revolucionare“ institucionin e vetëm kulturor shqiptar në Shkup, të cilin mezi e shpëtuam dhe e trashëguam duke derdhur djersë e gjak nga Partia Komuniste. Fatkeqësisht, sot grupacione të fesë Islame me ndihmën e partive politike shqiptare, Teatrin Shqiptar po e shndërrojnë në „xhami“ turko-arabe.

I mungon vetëm minarja me simbolin e gjysmëhënës dhe yllit komunist në majë. Edhe atë, në këtë kohë „demokratike“, kur besimtarët myslimanë kanë hapsirë marramendëse nëpër qindra xhami ku mund t’i organizojnë nateditë manifestimet e tyre fetare-kulturore. Publikisht i pyes organizatorët e këtyre manifestimeve fetare - kulturore, si do ta ndjenin veten po të lexonim poezi ne poetët shqiptar nëpër xhamitë e tyre myslimane?! Edhe pse, para Luftës së Fundit të Kosovës (1998 - 1999), kur politika serbe na i mori të gjitha institucionet e arsimit e kulturës, për të qenë më të sigurtë nga përndjekja e policisë serbe që na ndiqte këmba-këmbës, në atë kohë me në krye poetin bohem Mirko Gashin i armatosur me „dy kashikara“ lot rrushi në xhepat e gunës zezë, ne organizonim orë letrare dhe lexonim poezi edhe në xhami.

Mirko Gashi nga „Hytbja“ lexonte poezi për Lumin: *Ende pa i mbushur dy vjet, nuk do të lidhet në djep*. Tashti, edhe pse Kosova e ka fituar pavarësinë dhe lirinë, dhe është shtuar dukshëm me të madhe pas lufte numri i xhamive, nuk e besoj se sot mund të gjenim vend strehimi mes „besimtarve besnik“ të Zotit të lexojmë poezi në ndonjë xhami dhe ulemi këmbëkryq në qilimat e persisë.

Pajtohem, këto grupacione të fesë Islame të mos kishin hapsirë, lokale ku t’i manifestonin „idetë e tyre fetare“, lutjet drejtuar Allahut t’i organizojnë edhe në Teatrin Shqiptar në mungesë të xhamive, po nuk e di një veprim të këtillë sa e lejon edhe Kur’ani, feja Islame kur i kemi me qindra xhami, shtëpi të Zotit. Nuk jam ndonjë njohës i madh i fesë Islame, po me siguri edhe vetë Zoti nuk do të pajtoheshte me veprimet pakrye të këtyre bandave myslimane që u pri në ballë Shejtani i Allahut. Realitet i hidhur ky, që sot flet ndryshe: shqiptarët kanë nevojë për instutucione kulturore dhe shkolla shqipe. Xhami përveç qyteteve kemi me katër minare edhe nëpër katunde. Përinatë të „kaurrit“, jo një xhami, po dy-tri edhe katër xhami i ka secili katund shqiptar me një shkollë të vetme si „dhuratë“ që nga sistemi komunist me çati gati të rrëzuar sot mbi kokë. Dudumët sot shkaun dhe „kaurrët shqiptar i luftojnë“ me xhami turko-arabe e jo me shkolla shqipe. Atëherë, ku qëndron problemi që na ngatërrohet me shekuj nëpër këmbë këta „njerëz të sotshëm me tru të moçëm“?!

Nuk e shihni, i kemi nateditë para syve dhe mbi kokë edhe në rrugë. Populli shqiptar brez pas

brezi në luftë për Shqipëri Etnike, është koha trutë të mos i mbajë më bashkë me këmbët në legen në Ditën e sotshme të Motit Madh.

Respekt për fenë Islame dhe besimtarët e vërtetë besnik të Zotit, po atje ku e kanë vendin në xhami! Përmëtepër, në Xhaminë Shqiptare. Shtëpinë e Zotit, që është në shërbim të popullit dhe Shtetit Shqiptar. Përndryshe, kështu siç e kanë nisur këta „hoxhallarë“ të Allahut, „njerëz të sotshëm me tru të moçëm“ siç ka thënë shkrimtari shqiptar Filip Papajani, që sot merren edhe me „politikë madhore“, një ditë edhe shkollat shqipe do të na i shpallin „xhami“ pa minare...

## QORRFISHEKË KËRÇOVE DHE GROSHË TETOVE

Fatkeqësisht, koha është sot shqiptarët t'i bien kokës jo me gisht, po me grushta. Përçarjen teknefese nëpër parti politike për interesa personale, familjare e grupore duhet përzënë nga mesi i tyre në theqafje. Edhe atë, në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë. Motit Madh 2012. Ditë, kur patjetër duhet ta ndajmë grurin nga byku. Trurin e intelektualëve shqiptar sipas aftësive ta vëmë në kandar. Dushkun, siç thotë populli edhe në të ardhmen të mos lejojmë individë dhe parti politike të na e shesin për gogëla. Vlerë të „arrirë" politike-kulturore e shkencore. Ballëlartë nëse duam të ecim me popujt e tjerë të civilizuar krah për krahu në histori. Tjetër punë është ajo se ne, në lëmë na ka mbuluar byku deri në fyt. Koka dhe duart na kanë mbetur jashtë për të dalë nga bataku shekullor, së paku ta shpëtojmë veten si popull. Vite me radhë ne kemi fshi me qe e kalë bereqetin në lëmë që nga koha e Baba Dovletit. Erë të fortë nuk kemi pasur për ta hedhur grurin në lëmë. Ose, siç thoshte shpesh Nëna ime plakë: nuk fryn Bukoçi. Byku që nuk e hanë as lopët me vite na ka mbetur bashkë me grurin mullarë-mullarë te pragu i derës madhe të Shtëpisë. Shkak ky, që gjatë këtyre viteve të ndryshimeve demokratike ne kemi hëngër bukë të përzier me byk. Groshë tetove me shkrumb e qorrfishekë kërçove. Jo rastësisht, gati të gjitha partitë politike më të mëdha shqiptare selitë i kanë themeluar dhe i kanë në Tetovë.

Qytetin historik e dy universiteteve. Një parti politike gjatë gjithë jetës Tetovën e proklamonte si kryeqendër politike e kulturore shqiptare. Politikisht hoqi dorë nga Shkupi, kryeqyteti i Dardanisë dhe ambasadave botërore, qyteti me më shumë shqiptar pas Tiranës. Pala tjetër „strategjike“ e koalicionit në Qeveri për „politikën e tyre madhore“ shqiptare u biente duarve shuplakë për fitore. Groshën e vënë të zihet në zjarr pa mish për darkë në Tetovë. Përmëkeq, gjatë këtyre viteve të ndryshimeve demokratike nuk i qitën ujë në vorbë. Gabim historik i shqiptarëve. Edhe pse, grosha e Tetovës për nga kualiteti dhe shija është e dëgjuar anë e mbanë Atdheut. Mos t'i përmendim këtu ëmbëltoret e tyre të dëgjuara nëpër botë. Larg specialitetit të tyre nuk janë edhe qorrfishekët e Kërçovës. Rasti ma kujtoi edhe t'im Atë kur shiste groshë në pazarin e Kërçovës. Pazarxhinjt, që donin të blenin groshë e pysenin: a, është e mirë grosha dhe t'ua thotë të vërtetën, a zihet shpejt me një ujë në zjarr? E dini si u përgjigjej im Atë? Jo, nuk e dini. Burra, unë e shes groshën dhe jo gruan time që t'ua përgadis juve në sofër për darkë. Interesant, ë?! Thënia e t'im Ati sa më përgjason sot me aftësitë e politikanëve shqiptar gjatë këtyre vrapimeve për pushtet me koka të huaja në qafë.

Ndryshimet demokratike ishin shansë e vetme që ne shqiptarët vetë me lopatë druri ta hedhim bereqetin në lëmë. Grurin ta ndajmë nga byku. Egjrën që tinëz përpiqet të na futet si bukë në magje. Arsye e fortë kjo, që thasët me drith duhet

situr mirë maxhatoret tona shqiptare t'i mbushin me grykë, lidhin mirë me kordhë kanapi dhe dërgojmë në mulli për miell. Groshën ta vëmë në sofër për darkë si ushqim special tradicional. Nëna ime edhe sot më kujtohet me lopatë druri gati në dorë, kur priste të fryjë Bukoçi. Bereqetin e verës ta pastrojë me këmbëngulje mes lëmës nga byku e egjra. Falë saj, ne hanim bukë pa egjër. Edhe groshë për darkë pa shkrumb, që piqej gjithë ditën e gjatë në zjarr pranë oxhakut, po e qëndisur përsipri me tëlyen bagëtie sipas dëshirës së Babait.

Përçudi, partitë politike shqiptare sot nuk e presin të fryjë Bukoçi. Bereqetin nuk e hedhin si dikur nënat tona me lopatë druri në lëmë. Fytas janë rrokur me njëra-tjetrën për pushtet. Armët i kanë nxjerrë nga brezi në emër të popullit. Edhe atë, pa fije turpi e thirrin popullin për ndryshime politike: na e jepni votën t'ju nxjerrim në dritë! Jetën gjatë qeverisjes sonë t'ua bëjmë parajsë me lule. Ne, do t'ju nxjerrim nga bataku në të cilin edhe u futëm përshkak gabimeve tona gjatë këtyre viteve sa qemë në pushtet. Merreni me mend, partitë politike që me votën e popullit e fituan pushtetin dy-tri e më tepër mandate. Mjaftë kohë gjatë këtyre viteve patën ta dëshmojnë veten, të mos bëjnë më gabime për ndryshime në jetën politike-kulturore të shqiptarve. Mjerisht, pakgjë bënë në ngritjen e këtij populli të përvuajtur nga armiqtë shekullor i rrethuar nga të katër anët me istikame.

Gjithmonë e ngritën zërin vetëm para zgjedhjeve lokale e parlamentare me premtime

demagogjike, kur u duheshte vota e popullit. Mjeranët, harronin se edhe politika ndrron si stinët e vjetit. Kurrë siç duket në jetën e tyre nuk e kishin lexuar poemën e Ndre Mjedjes: *Bilbili*. Vargjet e tij të famshëm:

*Bylbyl, ky shekull or e ças ndrrohet:*
*Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;*
*Edhe natyra po don m'u ndrrue:*
*Fillo me gëzue.*

Gjithmonë, nuk është vetëm verë, ose dimër. Vjeshta vjen me shi, breshër dhe rrufe. Dihet, gjithmonë shti në lisa e kurrë, në ferra. Shqiptarët kanë pak lisa e shumë ferra edhe në rrugë. Argatët „besnik" të dikurshëm të partive politike, shkaku humbjeve të posteve politike dhe interesave të tyre personale paralajmërojnë edhe themelimin e një partie të re me zgjebe politike shqiptare. Ose, koalicion me opozitën maqedonase neokomuniste për të dalur krah për krahu në zgjedhjet e ardhmshme parlamentare. Pavetëdije, ua zgjasin jetën partive politike shqiptare të pazoja gjatë këtyre viteve në pushtet. Publikisht e them: me një bërllok të tillë kontenieri të harxhuar vetëm për një përdorim, që vetë këto parti politike i kanë djegur me poste politike gjatë këtyre viteve në pushtet partizanët e tyre me pushkë shelgu në krah, nuk themeleohet parti e re politike shqiptare dhe nuk do të kemi ndryshime rrënjësore në politikën shqiptare.

Përderisa, këtë bërllok shqiptar që na ka mbi në oborr, vetë me duart tona nuk e shkulim nga

rrënja, themeli siç thotë Noli i Madh: „... *KULTUROFAGËT, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten në plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t'i coptosh, po jo t'i ç'qitësh nga trupi që kafshojnë e thithijnë... që t'i ç'qitësh këta nga kolltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën po edhe këmbët e trupin...*"

Shkaku kryesor ky, që partitë politike shqiptare pasi e merrnin pushtetin ia futnin gjumë në Qeveri e kabinete me kulturofagët qafë për qafe për shtatë palë qejfe. Edhe, vazhdojnë të na japin përditë të hamë bukë me egjër. Groshë tetove me shkrumb e qorrfishekë kërçove. Vetëm, hidhnu një sy kuadrove të tyre të „zgjedhura shkencore- politike" nëpër institucione të shtetit të „përbashkët", që na i servojnë si bukë të përditshme misëri të pjekur në çerep poreçe e përsipri saç me shpuzë të Destan Xhypit! Aspak nuk u vjen era bukë, po era egjër. Shkak ky, që ne si shqiptarë të nëpërkëmbur nuk na dhemb vetëm barku, po edhe koka. Koha është, shqiptarët njëherë e përgjithmonë ta ndajnë grurin nga byku. Mjaftë më, shkaku trusakatëve gjithë jetën hëngrëm bukë me egjër e qorrfishekë kërçove!

Vallë, nuk i shihni partizanët e tyre teknefesë sesi shtyhen me bërryla në emër të popullit për interesa personale materiale. Poste partiake duke u përpjekur të shtojnë pasurinë me djersën dhe gjakun e popullit shqiptar gjoja për shënimin e Njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, flamurit kuqezi shqiptar?!

Fajin duke ua hedhur të tjerëve pa arsye në mjetet e informacionit, që nuk derdhin mjete

materiale  për xhepat e tyre të grisur si thasë Baba Dovleti. Askushët e djeshëm, që si turq „ehamdurila“ ishin nisur të shpërngulen me gjithë familje në Turqi. Mirë do të ishte të ikte edhe ky bërllok shqiptar. Ndoshta, do të shpëtonim nga „patriotizmi“ i tyre halldup, nuk do t’i kishim këto probleme politike që i kemi sot në Shkup. Shkaku prishjes së marrëveshjes mes Serbisë dhe Turqisë për shpërnguljen e shqitarëve në Turqi, na mbetën ferrë e keqe nëpër këmbë edhe sot e kësaj dite me zemër turku e veshje të rrejshme gjoja shqiptare „kuqezi“. Partizanë „besnik“ të partive politike, që kokën e kanë në parti e bythën në Turqi. Zhurmë politike, arsim, kulturë e shkencë bëjnë vetëm për poste partiake e përfitime materiale.

Amani, malli më ka marrë për pak bujqësi dhe blegtori. Përshesh me kos në mëngjes te pragu i derës. Barkun e kam plot me arsim, kulturë dhe shkencë. Ushqim të shëndosh kërkoj për trurin! Lëmsh na i keni bërë profesionet: Shkencën e keni përzier me turizmin e një sezone verore. Bujqësinë me fenë Islame. Politikën me prostitucionin nëpër shtëpi publike. Asgjë nuk na ofroni pëveç zhurmës arsimore, kulturore e demagogjisë politike. Ditenatë na shtroni në sofër përurime të librave e „konferenca shkencore“. Organizmi i një shoqërie moderne mendoni se mund ta mbaj veten gjallë vetëm me këto ushqime, që na i servoni edhe pa kripë. Gabim e keni sot e gjithë ditën, truri juaj nuk pjellë, e keni mushkë.

Trusakatët na i keni vënë në ballë, që nuk janë në gjendje t’i ruajnë as buallicat e katundit, e ku

më dhentë e bariut me gunën krahëve maleve të Sharrit Plak. Fyellit t'i biejnë lëndinave te Sytë e Sharrit, që dhentë të kullosin rehat te Lugu i Ymerit. Qentë t'i ndejllin rreth bagëtisë. Ujku, kurrë të mos u bie paprtimas si dje ndër dele. Gojën ta mbyllin, që para syve tanë të mos trumbetojnë para kamerave televizive arsim, kulturë dhe „shkencë" shqiptare. Zhurmë e përditshme plot politikë deri në palcë që na i shurdhoi veshët. Edhe kush, pakurrizorët që partia pa kritere shkencore i mori nga rruga, u dha poste e tituj shkencor dhe i ngriti nga bërlloku i kontenierve në kuadro universitar.

Vorba mbi zjarr po vlon me gurgullimë, thotë populli. Kapaku i saj kërcen valle kaçake, derdhet grosha. Dramagjakut me kokë gjarpëri nga vapa i dridhen këmbët. Ndodhë, të dalë nga shpuza, ecë nëpër dhomë. Gojën ta hapë si kuçedër, vjellë zjarr. Motin e Madh do të na leni pa darkë në sofër. Ose, duhet qitur me kovë ujë të ftohtë groshës, ose duhet hequr vorbën nga flaka e zjarrit pranë oxhakut. Përndryshe, edhe gjatë kohë do të hamë bukë me egjër. Dhe, groshë tetove me shkrumb e qorrfishekë kërçove...

## ENESËRMJA VJEN NUSE ME KOÇI

Nuk e di as vetë sa gjatë kohë kisha qëndruar ashtu i shtrirë në WC me brekët nëpër këmbë, por kur i hapa sytë pashë se më kishte marrë gjumi. Më vinte të pëlcas nga inati, t'i mëshoj kokës me grushta, t'i bie për muri, ta bëj copë-copë… Pse, pasi më kishin përdorur më kishin hedhur si leckë të pavlerë në shportën e hedhurinave. U mudova me sy ta hetoj Xhadinë, mos ndoshta edhe atë në ndonjë qosh e kishte zënë gjumi, por kot! Në vend të saj arrita të lexoj në derë vetëm disa fjalë të ndyta dhe tri-katër vizatime pornografike.

Njëherit, thashë: mos Xhadia ka dalë në çarshi nëpër Bit-Pazar të më sjellë bukë, që ta vazhdojmë luftën… Por, pas disa minutash, pasi ajo nuk erdhi, e ndërrova mendjen, duhej të ik sa më parë larg këtyre mureve të Qytetit të qyeve. Vetëm përtej kësaj dere do ta ndieja veten të lirë, i nderuar mes njerëzve, i përtërirë në ajër të pastër. Këto qenë ato momente që më dhanë fuqi të ngrihem më këmbë dhe me njërën dorë ta hap derën. Po, mu kur e hapa derën dhe sa desha të ik si i marrë tutje korridorit tatëpjetë shkallëve për të dalë sa më parë në rrugë, dy duar të fuqishme më rrokën për krahësh.

- Ndal! Kush të turret pas që nuk je në gjendje të shohësh ku të çojnë këmbët?

- Askush! -Arrita t'i përgjigjem. Kur u ndala ta shoh mirë në fytyrë, e pashë se ishte Rrumaduci.

- Pasi nuk të turret askush, si deshe të dalësh nga Shtëpia e mallrave pa kthyer tek unë në

Kabinetin e “Babait”, së paku të pish një gotë verë.

- Jo, nuk desha të dal, por nuk di as vetë se ç’ndodhi me mua mes këtyre këndeve, shtyllave të betonit…

- Mos ndonjë shitëse e bukur t’i ka errur sytë dhe mendon se të vetmin shpëtim e ke përtej këtyre mureve, në rrugë?

- Jo. Jo, kurrë nuk i kam pasur më të kthjelluar trutë se këtë ditë.

- Atëherë, ec he burrë shkojmë tek unë e pimë nga një gotë verë!

- Shkojmë! – I thashë, duke e ditur më në fund se e kisha zor të shpëtoja nga këto mure të ftohta betoni… Qyteti i qyqeve…

U nisëm korridorit, po mua kjo fare nuk më gëzonte, aq më keq edhe më tepër më tmerronte, më shtinte frikë.

Unë pas gjithë asaj aventure në WC kisha nevojë të shtrihem në një livadh me lule, t’ia them një kënge. Sa e thashë fjalën e fundit, seç më shpëtoi një e qeshur nga thellësia e barkut. Po në këtë kohë të sëmurë me ethe, ku do të gjeje të të dëgjojë njeri?! Të gjithë do të vazhdonin rrugën, nuk do ta kthenin anësh as kokën, aq më keq ndonjëri ndodhte t’i mëshonte edhe ndonjë pordhë patriotike. E sheh tani se deri në ç’nivel shkencor kemi arritur, në ç’lulëzim kulturor, kush e çan kokën për këngë? Vjersha me simbole. Është kohë e luleve tani, pjeshkëve dhe vrapimeve maratonike. Në çdo moment mund të vrënjtet moti, të bie shi, të shkrep rrufeja…

- E sheh këtë kabinet? – Më zgjoi nga mendimet Rrumaduci.

- Po.

- Është Kabineti i “Babait”. Është një ndër kabinetet më të rregulluara në gjithë Shtëpinë e mallrave. E ka tavolinën, telefonin dhe raftet me revistat e modës më të njohura të vendit dhe të botës. Mbi kokë i qëndron edhe një akt femre, për të cilën disa kolegë thonë se “Babai” e mban për ta zhvilluar deri në kulminacion fantazinë.

- E, a është sot këtu “Babai”?

- Nuk ma merr mendja. Se, ai rrallë herë rri në kabinet. Gjithmonë është i angazhuar me punë jashtë Shtetit. E thirrin nëpër organizata të ndryshme të vendit dhe jashtë. “Babai” ynë merr pjesë edhe në të gjitha panairet e modës…

- Asgjë! Dëm i madh! Vetëm desha t’ia shoh kabinetin…

- E di, m’u kujtua, - tha Rrumaduci dhe e shtyri derën e cila nuk u hap, të më bindë se me të vërtetë nuk ishte aty “Babai”.

- Po, këto kabina të vogla antike që kanë mbirë si këpurdha pas shiut, për çka ju hyjnë në punë?

- Që të fshihemi nga blerësit… Qeshi Rrumaduci…

- Asgjë nuk kuptoj, - thashë, pa e ndalur hapin.

- E di se nuk kupton, shumë pyetje të mundojnë në kokë, por pasi të hyjsh brenda çdo gjë do ta kesh të qartë dhe e hapi një derë.

Vetëm kur dola jashtë dhe e ndjeva veten të lirë, nuk e di pse m’u lidh goja. Më shpëtuan lotët. Më ushtuan veshët. Nuk ua thashë në fytyrë se kush ishte i marrë, Pasardhësi i Zef Serembes apo ata të sëmurë. Me sëpatën e madhe, nuk ua shava nënën. E di se as kjo te ata nuk do të ndikonte, po kryesorja unë do ta lahtësoja

shpirtin. Pse? Se ata nuk kishin veshë, nuk kishin sy, nuk kishin fytyrë, nuk kishin zemër… Nuk kishin bythë… Nuk kishin herdhe…

- Mos u mundo të ikësh prej këtyre mureve të betonit pa hyrë edhe në Sallonin e mobilieve! – Më tërhoqi për krahësh Rrumaduci. E kemi sot një përurim libri të një kryetari të Partisë Politike Neokomunsite. Përveç meje në këtë përurim do të flasë për librin "besceler" edhe Dr. Arnim Dërrasa.

- Nuk ik, por më zihet fryma. Kam nevojë për ajër të pastër…

- Në Sallonin e mobilieve ke çdo gjë që ta do shpirti… Pastaj, më duket se sot është edhe hapja solemne e Festave të Vitit Ri…

- Mirë, pajtohem, vetëm me një kusht: të mos më detyrojnë të heq valle…

- Oh, jo. Jo, për këtë mos u bën merak. Vallen do ta heq Dr. Madhi… Ne vetëm po të duam mund t'u biem duarve.

- E lule? A mund t'i hudhim lule?

- Hi-hii-hiii… Qeshi Rrumaduci. – Mund t'i hudhim edhe herdhe dashi…

Këmbën sa e vura te pragu u hap dera dhe një dritë e fortë që u turr drejt meje nga brenda m'i verboi sytë. Nuk e di as vetë se kush kishte qenë më i shpejtë – ajo apo unë që i mbulova sytë me duar. Po, kur i hoqa ato, para meje qëndronte Xhadia krejt lakuriq si xhenaze, me një tepsi në dorë. Ajo ma afroi tepsinë dhe unë, duke i shikuar anash nga turpi, e mora pijen. Po kështu veproi edhe Rrumaduci. Vetëm se nuk munda ta marr dot veten nga kjo e papritur në gjysëmerrësirë. Nga çdo anë shuheshin dhe ndizeshin dritat me

lloj-lloj ngjyrash që të mbështillnin si lurek. E nga ajo thellësi e errët vinte një muzikë e fortë rokënroli që t'i shurdhonte veshët. U tremba. I futa gishtat në veshë, por kur pashë se edhe kjo ishte e kotë, vendosa të pajtohem me fatin. Po tani pas shpine dëgjova një frymëmarrje të thellë nëpër terr. E pas kësaj edhe një piskamë histerike. Tani më nuk m'u durua pa e kthyer kokën. O Imzot, ç'më panë sytë! Xhadinë e kishin shtrirë sa gjerë gjatë në një shtrat në mesin e dhuratave të Vitit Ri. Babadimri ia mbante kokën, e Xhuxhmaxhuxhi ngrihej e ulej mbi të, sikur lënurte lesh arapi. Dum Dumi e priste radhën, rrinte më këmbë. M'u terruan sytë.

Dritat u ndezën edhe një herë dhe unë tani shihja vetëm trupa të lakuriqsuar bark më bark… Këmbë të ngritura në hava… O Imzot, ç'ndodh me mua mes këtyre njerëzve?!... Unë paskam hyrë në mesin e të vdekurve apo të gjallëve!... Dritat u ndezën edhe një herë dhe unë tashti e pashë pranë meje Rrumaducin. E kishte hequr setren dhe i kishte përveshur mëngët. Sytë i ishin skuqur e terruar dhe s'dinte as vetë se ku do ta ndante mejdanin e dylyftimeve "patriotike"…

- A, e pe lojën e Xhadisë?

- Po. Mezi arrita t'i përgjigjem mes asaj muzike të fortë të Tina Tanerit.

- Te dera e solli Gungaçi, që t'u shërbejë mysafirëve me pije…

- E kush është ai barkmadhi me syza, që mezi e mbajnë këmbët?

- Ai është Drejtori i Shtëpisë së mallrave.

- Po, ajo shitësja e lakuriquar që i përdridhet rrotull si bollë shullani?

- Një praktikante e ardhshme që shkruan edhe vjersha me simbole…

- E ai tjetri me brekë  të gjata kërpi?

- Dr. Madhi.

- Po ç'bën ai ashtu gjysmë i dehur?

- Heq valle… U bie durve shuplakë… E pret Vitin e Ri…

O Imzot, si të dal në rrugë?! Pse më dënove t'i shoh edhe këto mëkate, kur e di fare mirë se unë nesër nuk do të blej asgjë nga kjo Shtëpi e mallrave? Ti e di se unë edhe ashtu s'kam pasur bindje të mirë për mallrat e tyre. Gjithmonë ma ka hëngër mendja se janë të cilësisë së dobët.

Pse atëherë më fute edhe në Sallonin e mobilieve ta pres Natën e Vitit Ri? Mos vallë me këtë deshe të më bindësh për shërbimin e mirë të Xhadisë?! Apo deshe sa më thellë edhe mua të më rrasësh në mëkate. Të m'i mbyllësh sytë. Të më dehish me verë të kuqe… Të m'i zgjidhësh brekët në këtë Shtëpi publike…

E thashë këtë dhe e shtrëngova edhe për një birë rripin. Nga frika që më sillej në rreth isha në gjendje  edhe ta këpus barkun. Por,  mjerisht nuk e di se si u këput rripi dhe më ranë pantollonat në fund të këmbëve. E mu në atë moment, për bela u ndezën dritat. Nuk e di ndonjëherë në jetë a e kam ndier veten më ngushtë se atë natë festive. Jo. E them këtë, se këto janë momente kur vështirë e ke të mbetesh edhe gjallë, të shtrihesh në shtrat. Nga të gjitha anët të përkëdhelin duar, duan të të bëjnë burrë. E ti në ato rrethana do të jesh grua. O Zot! Si do të bëhet para kohe Kiameti. Përmbytja e madhe. Po, këto janë ato shenjat e para që na i dërgojnë të vdekurit me anë të muzikës. E ne

s'kemi guxim t'i dëgjojmë, i mbyllim veshët. Ata edhe me anë të dritave na japin sinjale. E ne i mbyllim sytë. Na e ka ënda gjumin. Themi se nuk jemi të humbur, e dimë rrugën…

Po, mu kur dua të tregoj mes këtyre njerëzve se jam ende gjallë, duar të panumërta më zhveshin deri në lëkurë. Më kot mundohem t'u shpëtoj, të ik si i marrë mes Qytetit të qyqeve, kur ata më presin kudo në rrugë. E kanë ngritur dorën dhe më urdhërojnë të lahem në një fuçi me verë. Nuk ka shpëtim. E ngrej njërën këmbë, pastaj tjetrën dhe zhytem si peshk.

E fus brenda edhe kokën. E nxjerr. E mes këtyre rrotullimeve në verë, duar të panumërta ma fërkojnë shpinën… Gjoksin… Fundin e barkut… Po mu këto duar kur më nxjerrin në shtrat, pasi më kanë larë nga mëkatet, më lëpijnë si delja qengjin. Tek tani më mbushet mendja se linda dhe duhet të më vënë në gjumë. Të më lidhin në djep dhe të ma këndojnë një ninullë zgjimi…

Vetëm, kur u zgjova u habita kur pashë se pasi kishin luajtur me mua gjithë natën e gjatë më kishin hedhur pas dere. Unë kisha qenë vetëm një kukull e dëgjuar që nuk di të qeshë e qajë kur e vënë në gjumë. Ja, edhe pse përkohësisht i mbylla sytë. Po, kur i hapa përsëri, e pashë Pasardhësin e Zef Serembes me një libër me vjersha në dorë, që me vite të tëra endej poshtë e lart sokaqeve nëpër Qytetin e qyqeve. E kishte hapur në një faqe dhe bërtiste përpara kalimtarëve të rastit nën Rrap:

Enesërmja vjen Nuse me koçi…

**PYKË shelgu**

Jo, rastësisht e nisa këtë shkrim me vargjet e një poezie satirike të Spiro Çomorës. Autorit të komedisë „Karnevalet e Korçës“. Trungu i lisit, kur i thotë pykës: Inati nuk më vjen nga sëpata që është nga hekuri, po nga pyka që është pjesë e trungut tim nga druri.

Shqiptarët nëpër shekuj i kanë pasur pykat e tyre të një trungu nga gjaku, që armiqtë shekullor me qytë të sëpatës ia kanë rrasur sa më thellë në trup, i kanë çarë copë-copë mes tokës e qiellit. Populli thotë: „pyka nxjerrë pykën“. Fatkeqësisht, popullit shqiptar, pak veta përpiqen t‘ia nxjerrin pykën, po pyka i bën vend pykës tjetër për t’i hyrë sa më thellë në palcë. Edhe sot si dje, përçudi u lindi pas porte një Pykë shelgu. Vetëm se, kësaj radhe jo një pykë nga druri ose hekuri, po një Pykë shelgu në emër të „bashkimit“ të shoqatave joqeveritare nën një çati si „Lëvizje politike-patriotike“. Dorën në zemër, shoqëria shqiptare gjithmonë ka hapsirë për të gjitha veprimet për ndryshime politike. E sidomos në kohën e sotshme demokratike, kur secili ka të drejtë të thirret në shprehjen e lirisë të fjalës dhe mendimit politik ndryshe. Ama, jo qorrazi si miza në qumësht, ose të rreshtohen si delet e nënkryeme qafërjepura pas Dashit me një brirë të thyer t’u prijë lëndinave demokratike për në gojë të Ujkut.

Themeluesit e kësaj „Lëvizje“ (Pyka) dihen nga populli shqiptar me emër e mbiemër, kalorës të arratisur që deri më sot nuk zunë vend në asnjë

Parti Politike Shqiptare. Ose, siç thotë Fishta i Madh te „Gomari i Babatasit“:

*„Ani kush pra, me i pri kombit*
*Ju do pyka bijtë prej llomit*
*Që „Shqiptarë“ vedit thoni.*
*Jo pse ju Shqipninë doni.*
*Jo pse ju ndo‘ send kuptoni*
*Shka asht Atdheu e shka është Lirija.*
*Shka asht Vllaznija e Parasija*
*Përpraimi e Qytetnia.*
*Por, veç pse ende der më sot*
*Një tyran s’po e gjeni dot.*
*Nën këmbë t’cilit ju me u shtrue.*
*Se un ma tash jam regjë me jue.*
*E jau njof shpirtin der m’palc:*
*Pleh i ndytë, me u bartun m’shkale*
*E me u qitë jashta Shqipnije.*

Dudumët, që i shëtitën të gjitha Partitë Politike dhe fondacionet „humanitare“ duke rrëmbyer me të dyja duart mjete materiale e poste politike: Drejtorë, zv/drejtorë, kryetarë të shoqatave „joqeveritare“, anëtarë të komisioneve, këshilltarë e hoxhallarë të xhamive. Syrin, përsëri e kanë të urët, pak siç duket i kishin këto shpërblime për „flijime artistike“, burrat e botës, fesë dhe kombit meritojnë më tepër si „dëshmorë“ lufte. Hapi i tyre „shpëtimtar“ (njerëz të sotshëm me tru të moçëm), pse të mos themelojnë edhe një „Lëvizje qytetare myslimane-shqiptare“?! Nesër, sipas veprimit të disa shoqatave „joqeveritare“ ta shpallin veten edhe si Parti Politike Myslimane

në mes të Shqipërisë Etnike. Shkupin ta mbushin me flamuj partiak fetar turko-arab gjatë fushatës parazgjedhore për pushtet.

„... Formimi i lëvizjes për bashkimin e shoqatave dhe tradhtia e disa shoqatave brenda lëvizjes“ i ndiqte prapa si Ismail Qemalin historia?! Duartrokitje, „patriotë“ bythëgrisur të kombit: ide e vjetër myslimane-komuniste me veprim të sotshëm tekenefes neokomunist: „Një tokë, një kokë“. Vallë, po si do të kemi veprime e mendime për ndryshime politike me këta „patriotë“ të vonuar në prehërin e „vëllezërve“ të Njerkës?! E patëm dikur një Parti Komuniste, çka na duhet tashti një tjetër neokomuniste?! Edhe, shqiptarët ia „panë“ mjaftë hajrin asaj pjelle mushke si popull demokratik në Ballkan, që nga koha e Fan Nolit, malli i mori ta provojnë edhe këtë melezen neokominste. Turren me të katra, e fusin kokën në thesin me arna: Shoqata Islame e joqeveritare shqiptare. Kokë më kokë bashkë: speca, patate, domate, qepë e banane. Thirrje u bëjnë „çafirëve“ t‘u kërkojnë „hallallëk“ myslimanëve për „zullumin“. E ngrejnë zërin kundër „njerëzve negativ dhe të djegur te muslimanët, që i japin një notë negative lëvizjes“. Edhe, e vajtojnë „Lëvizjen“ (Pykën e shelgut), për „tradhtinë“, që ia bënë „çafirët“ pas shpine duke ua përmendur „Ditën e Gjykimit“...

Trurin e tyre të sëmurë me çallmë turku në kokë, nateditë nuk e merr gjumi me kokën në xhami e bythën te partitë politike. Tregtinë në emër të popullit shqiptar e kanë në shpirt e gjak.

Moti përpiqen të na e ulin çmimin e pazarit politik, shesin sa më lirë te „vëllazërit“ në Bit-

Pazar. Herë pas here i sheh nëpër organizime kulturore e sofra partiake si dele të nënkryeme. Krah për krahu në „protesta qytetare“ me fjalime demagogjike përpara Qeverisë për lirinë e shtypit. Debate televizive me veteveten para kamerave televizive. Organizatorë të fshehtë të protestave politike me petk fetar në Shkup. Përditë manipulojnë rininë dhe popullin shqiptar, që nesër ta shesin shumë lirë, mos them pa pare te Partia Neokomuniste për një karrige, për një post partiak në Qeveri, për një emërim imami në xhami.

Dudumët, që sot nuk i do edhe vetë Zoti. Trusakatë që nuk e dinë çka është pyka. Llojet e pykave: pykë druri dhe pykë hekuri. Kohën e fundit si „ideologë politik-fetar“ na e zbuluan edhe një lloj pyke: Pykë shelgu. Funksionin që lujnë ato në jetën e përditshme të malësorit. Në mes të ditës para syve të popullit shqiptar themelojnë „Lëvizje“ qytetare me pagëzim humuristiko-satirik „PYKA“. Haptas, vjedhin pa vend dhe arsye simbolin e një poezie satirike të Spiro Çomorës. Ose, titullin e një reviste humoristike-satirike „Pyka“ që dilte herë pas here në Strugë. Pavetëdije, dalin në sipërfaqe si pyka teknefese shelgu myslimane-shqiptare.

Nënçmojnë këtë popull duke menduar se ende hanë bar livadheve, mund ta kullosësh edhe në të ardhmen me thirrjen e „ezanit“ nga minaret e xhamive turko-arabe mes livadheve.

Trungut tij plak plot plagë, rrasësh me qytë të Sëpatës Neokomuniste të „vëllezërve“ edhe pykën e drurit të shelgut. Përçash pikë e pesë popullin shqiptar edhe në këtë Njëqindvjetor të

Pavarsisë së Shqipërisë. Edhe atë, me „Pykën“ e vet të një trungu, gjaku e me qytën e Sëpatës Neokomuniste, që na i polli Xhadia natën këta kopila e na i la ditën pas porte.

Falë Zotit, janë pyka shelgu. Nuk janë pyka hekuri. Përndryshe, do të na merrnin më qafë si popull demokratik shqiptar në mes të Ballkanit, jo sot po edhe nesër...



## RRUGA E VETME DERI TE LIRIA

Edhe, jo rastësisht sulmet më të ashpëra edhe sot e kësaj dite na vijnë nga Partia Politike Neokomuniste, që shqiptarëve ua ka pi dje, ua pinë sot, përpiqet t'ua pi edhe nesër gjakun. Fatkeqësia është, se disa shqiptarë melez ende u besojnë këtyre butakëve të kuq me yll në ball nëpër Bit-Pazar, nuk i hedhin nga samari. Shtyhen me bërryla në radhët partiake dhe tubimet e tyre antishqiptare duke na shitur shumë lirë, mos them pa pare te "vëllezërit". Edhe atë ku, te yllkuqët që gjithë jetën popullit shqiptar i janë ngatërruar nëpër këmbë, i kanë punuar pas shpine.

Turqinë, ne shqiptarët e përzumë nga Ballkani. Përderisa i jepnim agallarë, pashallarë, kryetarë shteti dhe ushtarë, ajo dalngadalë e pushtonte gjithë botën. Sami Frashëri u bëri gjuhë letrare. Ataturku i bëti shtet modern. Ali Pashë Tepelena i mësoi të bëjnë dashuri. Edhe Luftën e Dytë Botërore e nisëm dhe e bëmë ne shqiptarët. Im Atë, Emin Çeliku shpesh më thoshte: historikisht po na tradhtojnë "vëllezërit". Ne shkuam shtëpi më shtëpi t'i nxjerrim në luftë, shkaku se, nuk donin të luftonin kundër Baba Dovletit, e më vonë fashizmit, edhe atë: na u bashkuan nga fundi i luftës. "Vëllezërit" nuk kanë luftuar kurrë kundër armikut të përbashkët, as  në kohën e Turqisë e as në kohën e fashizmit, e fituan luftën dhe pushtetin me gjakun dhe në emër të shqiptarëve.

Përsëri, edhe në ditën e sotshme, ndodhë e njëjta histori: Përçudi, shqiptarët edhe sot përpiqen t'i bëjnë "vëllezërit" shtet në dëm të interesave të veta shekullore.

Marrëveshjen gjatë Luftës së Dytë Botërore në mes të ballistëve dhe partizanëve për herë të parë e kam dëgjuar nga im Atë, Emin Çeliku e më vonë nga dokumentet historike të asaj kohe me të cilat bëj krahasimin e Luftës strategjike shqiptare për Liri. Brigadat Shqiptare Partizane nga Shqipëria me flamurin kombëtar shqiptar në ballë e kanë çliruar Kërçovën, Gostivarin, Tetovën dhe Shkupin. Luftë e paparë vëllavrasëse është zhvilluar në Kërçovë mes partizanëve dhe ballistëve. Berlini kur e humbi luftën në mes të Gjermanisë, Zajazi ende bënte luftë maleve, nuk i dorëzonte armët. Im atë, Emnin Çeliku shpeshëherë ma rrëfente atë luftë të përgjakshme historike: ne përderisa bërtitnim "me dorë" në mbrojtjen e Kërçovës, ata nga ana kundërtshtare (partizanët shqiptar), të Brigadave partizane shqiptare na përgjigjeshin "me dorë e me këmbë". Ne, ballistëve nuk na vranë partizanët e kësaj ane, po partizanët e Birgadave shqiptare nga Shqipëria me ndihmën e "vëllezërëve". Historikisht, shqiptari e ka vra shqiptarin: Dora shqiptare e ka vra Kalosh Zajazin, Bajram Currin, Luigj Guarakuqin, Hasan Prishtinën, Mefail Zajazin, Xhemë Gostivarin, Nexhat Agollin, Xha Rexhën, Jusuf Gërvallën…

Im Atë, Emin Çeliku më rrëfente edhe një histori interesante për luftëtarët e Zajazit. Fshat kaçakësh ky, që gjatë Lufës së Dytë Botërore ka

pasur në gji edhe partizanë edhe ballistë. Kurrë, më thoshte im Atë ata trima me mustaqet vesh më vesh e pushkën krahut nuk kanë luftuar njëri kundër tjetrit në luftë frontale. Gjithë natën luanin së bashku "filxhana", partizanë e ballistë, i bënin planet e Luftës. Ditën e nesërme, i rrëbenin armët dhe dilnin në mal për liri. Komandantët e të dy anëve "kundërshtare luftarake", para se të dilnim në mal, vetë na porositnin ne luftëtarëve: nuk duhet të luftojmë vëllai me vëlla, se pas përfundimit të luftës do të kemi edhe shumë punë për çlirimin e Atdheut. Tjetër punë është ajo, histori më vete se ne na tradhtoi e shiti te "vëllezërit" pjella jonë shqiptare.

Edhe ashtu, një ditë doli parashikimi i atyre burrave të penës e pushkës. Partizanët jugosllav na tradhtuan: nuk e mbajtën fjalën e marrëveshjes "shqiptare-jugosllave" se, pas çlirimit nga fashizmi viset shqiptare të Maqedonisë, Kosovës me Preshevë, Bujanovc e Mal i Zi do t'i bashkohen Shqipërisë. Përmëtepër, ndodhi "Tradhtia e madhe", pas shpine nga pusia filloi vrasja e ballistëve dhe partizanëve shqiptar, emrat e të cilëve sipas meritave luftarake ndodheshin dhe priteshte të emërohen pas lufte si udhëheqës në ballë të institucioneve komuniste: Mefailëve të Zajazit, Xha Rexhës, Xhemë Gostivarit, Mahmut Dumanit, Nexhat Agollit, Sadudin Gjurës etj. Brigadat Shqiptare i dërguan në Frontin e Sremit, ku ndodhi masakra e Tivarit dhe nga ai front i përgjakshëm u tradhtuan dhe u kthyen pak veta në shtëpi si invalidë lufte.

Xha Rexhën, ballistët e kishin në katund, kur të donin mund ta vrisnin si partizan, po nuk e

vranë gjatë luftës, u vra në një pusi pas lufte përderisa kthehesh te nga një takim partiak nga Shkupi. Përveç partizanëve, askushi nuk e dinte se ku ndodhej dhe kur do të kthehej xha Rexha në Zajaz. E vranë, shkaku se: askushi nuk kishte më shumë merita pas lufte si partizan se xha Rexha të udhëheq me Kërçovën. Rexhep Zajazin (këngëtarin e Trio Zajazi), një trim tjetër partizan pas lufte e kositën me automatik në pusi te Ura e Sateskës. Mezi shpëtoi gjallë nga plagët e marra për vdekje, edhe atë falë Nënës time që e strehoi dhe e mjekoi plot shtatë javë në shtëpi. Një numër i vogël i ballistëve arritën të ikin në Greqi, në Evropë e Amerikë me shpresë të organizimit atje dhe një ditë të kthehen si çlirimtarë, rrëzojnë komunizmin në Shqipëri. Barrën kryesore e mori mbi shpinë Balli Kombëtar dhe Legaliteti.

Vite pas lufte ato në mërgim, kur në krye të Operacioneve Shqiptare për OPC, Frank Wisner emëroi një oficer të ri James Macarger, i cili kishte gati një vit që punonte për çështjen shqiptare në Departamentin e Shtetit dhe i njihte shumicën e liderëve të Mërgatës Shqiptare. James Macarger për t'i dhënë një mbështetje politike operacioneve të planifikuara, propozoi krijimin e një Qeverie Shqiptare në Mërgim, megjithëse përpjekjet për një bashkim të fraksioneve shqiptare ishte një ëndërr e vështirë.

Debate të shumta në gjirin e Mërgatës për lidershipin e kësaj organizate po krijonin vështirësi dhe pas presioneve të OPC, më në fund u vendos që kryesinë e kësaj Qeverie në Mërgim e njohur në atë kohë edhe si Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë ta merrte Mithat Frashëri. Mithat

Frashëri i thirrur nga Turqia ku kishte emigruar pas largimit nga Shqipëria, arriti në Romë ku u njoh me planin e përpunuar nga OPC dhe propozimin e tij për të udhëhequr Qeverinë Shqiptare të Emigracionit. Frashëri pas një sërë takimesh me zyrtarët e CIA -s në Itali dhe Francë, udhëtoi për në Amerikë, i shoqëruar nga Koloneli i Shërbimit Sekret Amerikan Loe. Pasi mbërriti në Vashington ku u prit nga nënsekretari i Shtetit dhe zyrtarë të tjerë të OPC, Frashëri udhëtoi për në New York ku do të vendoseshin Zyrat Qendrore të Komitetit Kombëtar Shqipëria e Lirë. I vendosur në Hotelin luksoz "Althorp", Frashëri filloi takimet me një sërë shqiptarësh emigrantë të arratisur pas lufte nga Shqipëria.

Optimist për një mundësi reale të kthimit në Shqipëri, Mithat Frashëri papritmas gjendet i vdekur në dhomën e tij. Vdekja e befasishme e Frashërit solli një përmbysje të shpejtë të situatës politike të ekuilibruar me aq vështirësi nga amerikanët. Gjithsesi Shërbimi Sekret Amerikan u mundua që vdekja e papritur e Frashërit të mbahej sa më larg syve kureshtarë të mediave duke mos krijuar publicitet të panevojshëm. Shkak ky, që asnjë hap nuk u ndërmor për të sqaruar vdekjen e papritur të Kryetarit të Qeverisë në Mergim. Thashetheme për vrasjen e Frashërit kanë qarkulluar në mesin e emigracionit shqiptar, megjithëse asnjëherë nuk pati një tentativë serioze për ta ndriçuar këtë vdekje të papritur, pikërisht në momentin kur përpjekjet politike për një Bashkim të Mërgatës Shqiptare ishin në kulmin e tyre. Vallë, mos agjentë të fshehtë sovjetikë në radhët e inteligjencës amerikane

kishin njoftuar për rrezikun potencial që mund të sillte Mithat Frashëri në Operacionet Klandestine që priteshin të fillonin dhe si rrjedhim Sigurimi shqiptar dhe njerëzit e tyre mund ta kenë eliminuar atë? Shërbimi i Fshehtë Shqiptar i cili u krijua sipas modelit sovjetik megjithëse pa eksperiencë të gjatë në këtë fushë drejtohej nga të rinj ambiciozë të cilët kishin vendosur kontakte me një sërë të arratisurish shqiptarë në Perendim. Mos vallë njëri prej tyre ka qenë personi përgjegjës për vrasjen e Frashërit?

Fatkeqësisht, amerikanët nuk kanë mbajtur në mbikqyrje shqiptarët me të cilët Frashëri kishte kaluar ditët e fundit të jetës së tij për të krijuar një ide mbi personat e mundshëm për një mision të tillë. Megjithatë, në dokumentin e vdekjes të Frashërit e gjendur në arkivin e CIA -s të deklasifikuar kohët e fundit ka një shënim mbi vdekjen e Frashërit, ku thuhet se ai ishte identifikuar nga mbesa e tij dhe i fejuari shqiptaro-amerikan Tom Stefani.

Dhëndrri, Tom Stefani, një ish-oficer i OSS, pararendëses së CIA -s, kishte shërbyer në Shqipëri gjatë luftës dhe kishte qenë shumë afër me punë pranë shtabit partizan të udhëhequr nga Hoxha. Bashkëpunimi i tij me Harry Fultz, shefi i Zyrës për Shqipërinë kishin qenë normale gjatë luftës, por diçka kishte ndryshuar pasi Stefani kishte marshuar si fitimtar së bashku me liderët kryesorë komunistë në çlirimin e Tiranës. Megjithatë, Stefani pasi ishte kthyer në Amerikë me të fejuarën e tij shqiptare, mbesën e Mithat Frashërit e kishin larguar nga Shërbimi i Fshehtë Amerikan. I mbetur pa punë dhe pa asnjë

perspektivë për karrierë, Tom Stefani kishte probleme të mëdha me pijet alkoolike. Arsyeja e vërtetë se përse Tom Stefani u largua nga ky shërbim ende nuk dihet, por kolegë të tij të OSS kanë dëshmuar se Stefani dyshohej për bashkëpunim të afërt me liderët komunistë shqiptar.

Abaz Ermenji për këtë ngjarje historike flet me ironi therëse: "Aleatët tanë donin të bënin eksperiment me Shqipërinë duke na trajnuar ne sikur të ishim minj laboratori, kavie, pa çarë kokën për humbjet njerëzore dhe në një sipërmarrje absurde që ishte e destinuar të dështonte. Ky dështim ishte pak a shumë i ngjashëm me atë që pësuan amerikanët me kubanët në mërgim në rastin e gjirit Pigs disa vjet më vonë".

Operacioni i kurdisur luftarak ishte i përbashkët anglo-amerikan. Atëherë ishte formuar komiteti Shqipëria e Lirë, kryesisht me njerëz të Abaz Kupit dhe Abaz Ermenjit. Nga mesi i tyre do të dërgoheshin njerëz që do të testonin mundësinë e minimit të regjimit komunist të Hoxhës. Vullnetarët kishin veshur uniforma britanike. Kur koha e përshtatshme erdhi, i hipën në një anije peshkimi dhe i depërtuan në mes të Adriatikut, dhe përmes detit fshehtas ata hynë në Shqipëri.

Ndërsa, amerikanët i hidhnin nga aeoroplani desantët në veri me parashuta. Fatkeqësisht, pjesa më e madhe e tyre u kapën posa dilnin ose binin në tokë. Përçudi, posa dilnin në breg, apo binin në tokë, përfundonin në pritë. I zenin të gjallë dhe pas “bisedave informative” i detyronin t’u

paraqiten eprorëve se kanë arritur shëndosh e mirë, mund të dërgojnë për përfocime edhe të tjerë desantë. Shumica prej tyre u kapën, ndërsa disa të tjerë duke u hedhur gabimisht nga ana e pilotëve në pyll, mezi shpëtuan pasi u strehuan për disa ditë në Kërçovë, e pastaj kaluan në Greqi. Operacioni luftarak qe tradhtuar nga Kim Filbi, i cili bashkëpunonte me rusët, që i treguan gjithçka Enver Hoxhës.

Momentin që Abaz Ermenji e kuptoi tradhtinë, që të gjithë po vriteshin kot si qeni në rrush, pa asnjë qëllim, bashkë me Abaz Kupin vendosën që t'i tërheqin grupet e forcave të tyre dhe morën vendim të mos dërgojnë fare më desantë në Shqipëri. Përkundër asaj, që amerikanët kishin interes që kjo gjë të vazhdonte edhe ndonjë ditë ose javë. Sipas një deklarate të Mbretit Zog, thuhet se 300 shqiptarë janë vrarë në këto operacione.

Dhe, rrëzimi i sistemit komunist nga Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë, nuk ndodhi kurrë. Përsëri u tradhtuan ose u zbuluan nga spiuni i atëhershëm Kim Filbi. Autori i librit Nikolas Bethel te "Tradhtia e Madhe" e përshkruan shumë bukur në detale këtë ngjarje historike e interesante të dhimbshme shqiptare. Fatkeqësia e sotshme: zjarrit antishqiptar krah për krahu me deputetët e Partisë Politike Neokomuniste edhe sot i fryejnë deputetë të pavetëdijshëm shqiptar me "sqarime" në foltore të Kuvendit, se: 28 Nëntori është Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, datë të cilën deputetët e partisë tjetër politike motër e "fshehin" me festën e Ditës së flamurit shqiptar. Historia po na përsëritet ne shqiptarëve.

Marrëveshjen e Ohërit, mezi e mbajmë gjallë me gjysëm shpirti qe njëzetë vjet me radhë nëpër institucionet e "përbashkëta demokratike".

Njëra Parti politike shqiptare e tërheq për koke e tjetra për këmbësh. "Vëllezërit" veç më e kanë shtruar mbi tavolinë për operacion, i rrinë gati me thikat mbi kokë. Edhe sot si dje, të përçarë nëpër parti politike. Përçudi, ende nuk mbushemi mend dhe mësojmë nga historia, po jemi nën nivelin e ideve dhe veprimeve të atyre burrave të penës dhe pushkës. Ende pa e fituar luftën përfundimtare çlirimtare, bëjmë luftë për pushtet kur nuk kemi pushtet e as shtet etnik shqiptar. Gjithë jetën u morëm me flamur kuqezi, gjuhë shqipe, shkolla shqipe dhe të drejta të barabarta kombëtare. Edhe atë, si: lypës te Ura e Gurit. E kurrë me rrëmbimin e pushtetit me penë e rrugë demokratike. Çelësit kryesor të Derës Madhe, që Brenda një dite i zgjidhë të gjitha problemet e grumbulluara shqiptare-sllave. Kërkesa minimale njerëzore që na ngatërrohen edhe sot nëpër këmbë që nga koha e Turqisë. Koha është, në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, shqiptarët kodoqofshin nëpër botë t'i bien mëndjes përmbrapa, rroken qafë për qafe me vëllain për Fitoren e Madhe të Shekullit.

Nevoja po të jetë, kokës t' bien edhe me grushta. Hudhin nga shpina samarin e gomarit me arna lëkure ogiçi. Oborrin e vet së pari ta pastrojnë nga bërlloku. E pastaj, të dalin edhe te pastrimi i lëmave të kojshive, "vëllezërve". Gjelat e partive politike shqiptare që krekosen mbi pleh gjoja se e thirrin mëngjesin dhe këndojnë si pula, para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare t'i

shpërblejë sipas meritave me vota demokratike. Nëna ime, ndjesë pastë, shpesh thoshte: gjelat kur këndojnë si pula, ndjellin kob! Biro, gjelave të tillë duhet prerë kokën mbi cung. Natën e Madhe t'i shtrojmë për darkë si meze me raki rrushi për burrat e Atdheut që zbresin nga malet.

Rrugë e vetme kjo, për të arritur një popull deri te Liria. Qëllimi historik: Bashkimi kombëtar. Fitorja e Madhe Shqiptare e pritur me shkuj, të bërit Shqipëri Etnike me të gjitha "nishanet" në jakën e gunës botërore…

## MOTI MADH

Njëqindvjetorin e Shtetit të Pavarur Shqiptar, anembanë Atdheut në këtë Ditë të Madhe e feston mbarë Shqiptaria. Edhe, e meriton dhe duhet ta festojë këtë Ditë historike të Motit Madh, secili ashtu siç mendon, mundet dhe di me të gjitha forcat e Trurit dhe zemrës. Farën e Shtetit Shqiptar e mbollën të parët tanë Rilindasit, ne sot pasardhësit e tyre duhet ta vadisim dhe ta korrim një ditë para Dimrit që rri gati me drapër në dorë. Thasët t'i mbushim me grykë me bereqet, ngarkojmë në qerre dhe rrasim hambarët për Dimër, të dalim në Pranverë. Edhe, ajo Ditë e Madhe nuk është larg, vjen me kalë me shalë në 28 Nëtorin e Madh 2012. Nusen e sjellin krushqit me koçi nga përtej shtatë maleve me këngën e njohur të dasmave të shpeshta shqiptare: ***Hajdeni bini djemtë e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës.***

Në hyrje të Katundit, krushqit edhe qesin pushkë. Lajmi përhapet në të katër anët e Shqiptarisë të Atdheut: Nusja e maleve vjen me koçi e mbuluar me qilima kuqezi të qëndisur me këmbë arushe. Krushkat copë-copë i bëjnë dajret me këngë e valle. Babai e nxjerrë mauzerrin nga hatullat dhe shkrep pushkë, e paralajmëron Katundin.

Dhëndri e shikon Nusen nga dritarja e Shtëpisë dhe fërkon duart. Gëzimin nuk mund ta përmbajë brenda si kaçak mali, pasardhës i atyre grave e burrave trima me pushkë e penë në luftë për liri e Shtet të Pavarur Shqiptar. Nagantin e nxjerrë nga brezi për dritare.

Tymeflakë si rrufe krisma e tij çanë qiellin. Nëntë plumba ia numron Natës në ballë. Erdhi Dita e gëzimit, edhe Shtëpia jonë të festojë me këngë e valle. Mjaftë më me vite e shekuj u përpoqëm nateditë nëpër pusi këtë Nuse ta zbresim nga malet. Ditënatë kaluam nëpër prita e zjarre të armëve. Qerrja na është thyer disa herë me radhë në rrugë, dhe na e kanë ndërruar Nusen me një tjetër Xhadi.

Dudumët, sot në Motin e Madh 2012 kot përpiqen të na ngatërrohen nëpër këmbë si ferra me shpifje e etiketime. Haramët që për arsimin dhe kulturën shqiptare nuk e kanë dhënë as edhe një kafe. Minimizojnë veprimet e Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar.

Hapat e saj, që i ka bërë nga themelimi i Universitetit të Tetovës. Nuk i shohin gjurmët e thella para syve, për ta si dudumë të rrasur në batak deri në fyt. Nënshkrimet e dhëna nëpër ato dokumente historike në atë kohë të vështirë, kur të shkonte edhe koka si qenit në rrush, siç thotë populli. Hë për hë, jashtë u ka mbetur vetëm koka. Bythën dhe barkun e madh si tinar të lakrave turshi, moti e kanë arratisur në hurdhë. Bataku historik, ku janë rrasur këmbekokë dhe një ditë do t'i gëlltisë të gjallë me duart lartë për ndihmë. Njeri nuk do të kenë pranë t'ua zgjasë as dorën e shpëtimit në mes të Lumit. Ne, nuk na mbrojnë theshethemet, shpifjet dhe etiketimet e tyre trusakate, po puna dhe gjurmët që i kemi lënë pas udhës për në Baba Tomor aq të thella, që nuk i fshin dot asnjë furtunë, asnjë borë e madhe, asnjë Dimër. Vargu shqip kur hyri i pari me shokë në Bit-Pazar të Shkupit, ata ende ishin në

gjumë dhe gërhisnin në prehër të Xhadisë mes ëndrrave të ditës duke sharruar shelgje në livadh. I përdridhnin bythët nëpër Bit-Pazar si rrospi katundi për një asht, një torbë taxhi.

Takimet nën Rrap sot fesotojnë pesëmbëdhjetë vjetorin e themelimit si manifestim kulturor i veçantë i poezisë erotike, në Shkup. Poashtu, edhe revista e pavarur letrare STILI 97 (56 numra), organ i Lidhjes të Shkrimtarve Shqiptar, që në këtë anë të Atdheut erdhi si një zë i ri kryengritës në letërsinë shqipe. Hapi dyert krah më krah edhe të krijuesve të rinj, sidomos të femrës krijuese rebele shqiptare.

Sot një numër i tyre që kanë kaluar nëpër gjirin dhe djepin e Lidhjes të Shkrimtarve Shqiptar në Shkup, janë emra të njohur në Letërsinë Shqiptare mbarëkombëtare, po edhe atë botërore. Njëqind vjet shtet shqiptar nuk janë pak në këtë Ditë të Madhe. Poashtu, nuk janë pak edhe njëzet vjet veprimi të Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup. Nën Rrap ka jehuar vargu i poetëve shqiptar më të njohur anembanë Atdheut dhe botëror edhe para tytave të tanksave. Nata e Madhe është përcjellur me poezi, këngë e valle deri në agim.

Nën Rrap, unë sonte i shoh poetët e gjallë edhe të vdekur fizikisht kokë më kokë, siç i shihni edhe ju brez për brezi në valle. Ngrejnë dolli për Ditën e Madhe. E shoh matanë tavolinave Fredrik Rreshpen, Pano Taçin. Zyhdi Moravën, Hida Halimin, Mehmadali Hoxhën, Sadudin Gjurën, Abdylazis Islamin, Murat Isakun, Ramadan Sinanin, Daut Gurrën, Fadil Bekteshin, Shaqir Sadikun dhe qindra poetë të tjerë të gjallë duke

filluar nga Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu me Visar Zhitin e përfunduar te Vahit Nasufi e Gani Xhafolli me shokë se si e heqin vallen e Lirisë nën Rrap. Vetëmse, nuk i shoh dudumët. Ngatërraçët e dështuar, që na janë ngatërruar rrugës nëpër këmbë dhe janë strukur sonte si sorra nga vargu kryengritës i fuqishëm shqiptar nëpër birucat e tyre të errta ta festojnë humbjen historike.

Përsëri u ngjitëm maleve. Patjetër, Nusen e vërtetë duhet ta sjellim në Katund.

Edhe, siç duket e sollëm kësaj radhe edhe në Shkup, në këtë Njëqindvjetor të Shtetit Shqiptar. E zbritëm në lëmë me këngë e valle. Cucat copë - copë i bënë dajret. Kënga dhe vallja nuk pushon deri në agim. Vargu shqip, ky nagantë i trashëguar i Rilindasve tanë edhe sot si dje e zgjon Shkupin nga gjumi shekullor rrëzë Kalasë Dardane.

Lidhja e Shkrimtarve Shqiptar këtë vit festiv të Njëqindvjetoit të Shtetit Shqiptar i organizon dy Manifestime kulturore tradiocinale ndërkombëtar bashkë, njëri pas tjetrit: ***Takime nën Rrap*** (29, 30 shtator dhe 1 tetor 2012), në Shkup dhe ***Ditët e Humorit dhe Satirës: Xha Deralla*** (01, 02 dhe 03 tetor 2012), në Kërçovë. Ditën festive  të 28 Nëntorit të Motit Madh 2012, nën Rrap do ta mbajë edhe Natën e Madhe Poetike me poezi, këngë e valle deri në agim.

Mirëse erdhe Nusja jonë hallëmadhe nga pas shtatë maleve larg. Derën e madhe të Shtëpisë moti ta kemi hapur krah më krah. Vallen e kaçakëve hiqe edhe sot si dikur përpara Shtëpisë me shami, që Nesër të na e mbushësh Lëmën plot

me fëmijë trima me lapsa në brez e libra në dorë, brez pas brezi t'i dalin zot Atdheut…

IX KOPILAT QË I POLLI XHADIA
DHE NA I LA PAS PORTE

## KALORËSIT E ARRATISUR ME NJË KËMBË NË VARR

Vërtet, një ditë do të vdes i lumtur. Edhe, e kam thënë disa herë nëpër shkrimet e mia, se: ma kënaqët Lapsin. Kalorësve të arratisur dalngadalë hipur në qerren me katër rrota po u vjen fundi. Nuk do të vijnë një ditë krah për krahu të më qajnë mbi varr. Kurora lulesh të më vënë mbi kokë.

Fjalime patetike të më vjellin para miqve poetë. Populli shqiptar gjatë këtyre viteve i ka lexuar faqe për faqe si Libër i mbyllur dhe i ka hedhur plehërat në kontenierët e bërllokut. Fitore kjo, në këtë Mot të Madh 2012, Njëqind Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë që duhet të na gëzojë të gjithëve si shqiptarë. Megjithatë, horrave vështirë u del shpirti edhe në këtë Ditë festive, kur shtihen se janë të cofur. Populli thotë: ruajuni nga shqelmat e fundit para cofjes të gomarit në Lëmë.

Vitet e fundit të pleqërisë përpiqen t'i qesin edhe shqelmat e fundit të coftinës komuniste. Nuk mund të pajtohen me realitetin e Motit Madh (2012) pa e futur veten në ndonjë qosh si "dëshmorë" lufte. Vështirë u delë shpirti. E kanë rrasur shtatë pashë thellë nëpër parti politike. I përdorin edhe të gjitha forcat e fundit. I manipulojnë edhe personalitetet publike për ta mbajtur veten gjallë qoftë edhe një ditë. Babai,

hëngër fiq dhe u vdiq. Partitë politike shqiptare me nga një shqelm bythëve si këshilltarë politik e aktivistë partiak, pasi i panë se çfarë malli janë i përzunë në rrugë si qenë me zgjebe pas porte. E gjithë bota shqiptare i pa se janë "rraqe" vetëm për një përdorim.

Huji i vjetër komunist, është huj si sëmundje kanceri. Kalorësit e arratisur gjithmonë janë mësuar të jenë të përgëdhelur në çdo pushtet duke shëtitur nëpër poste e karrige, komisione e vende pune nëpër kabinete. Pensione "veteranësh lufte" marrin nga tri-katër shtete. Anëtarë janë të tre akademive shkencore.

Burrat e botës që nga koha e komunizmit janë mësuar vetëm të marrin me duar e këmbë, e kurrë të mos japin as edhe një lek për kulturën shqiptare. Matrapazët kulturor i ke kudo: në qeveri, ministri, komunë e parti politike. I blejnë "partizanët" partiak për pak para që t'i shtojnë radhët e tyre të çetës partizane. Edhe i ulin kukullat në vendet e para për t'u duartrokitur, kur ata organizojnë "manifestime kulturore" të improvizuara, orë letrare përkujtimore duke na i përbaltur para syve personalitetet tona shqiptare pas ikjes të papritur nga mesi ynë kulturor. Moti u shkruan në ballë tradhëtia me shkronja shqipe: Interesi personal në dëm të çështjes të pazgjidhur shqiptare. Intersant, presin që dikushi tjetër të organizojë diçka kulturore, dhe këta me të katra për të ndërhyrë partizançe me "pushkët" krahut për ta "pasuruar" programin e organizatorëve. Arsyeja: të tjerët i paguajnë shpenzimet e udhëtimit, fjetjes dhe ushqimit, pse "burrat e mejdanit" të mos turren pas famës "patriotike" që

u rrëshqet nën këmbë, fotografohen para kamerave televizive.

Kurrë në jetën e tyre nuk kanë dhënë asnjë lek për arsimin dhe kulturën shqiptare. Fajin, nuk e kanë kalorësit e arratisur, po Shteti "demokratik" që gjithë jetën i mbanë nën sjetulla si dudumë shqiptar. Shembull: Panairi i librit në Shkup 2012, përderisa oragnizohej atje ku e ka vendin siç i ka hije një Paniri të librit ndërkombëtar, Kalorësi i arratisur me shokë duke i pritur personalitetet shqiptare nga Tirana në Qafë Thanë, i dërgon të mbajnë "aktivetete kulturore" për librin në në një komunë-lagje në periferi të Shkupit. E jo në lokalet e Panairit të librit, në Shkup. Ditët e fundit, përderisa mbahen Mbrëmjet e Pozisë Strugane në Strugë (2012), ku ai me shokë gjithë jetën është në atë Drejtori duke vazhduar ta përdhosë poezinë shqipe, gjuhën shqipe, grisi flamurin shqiptar, turr me të katra të organizojë orë përkujtimore për Ali Podrimjen në një kafe-çajtore të Strugës, në vend të lokaleve të Hotel "Drinit" para syve të Botës. I manipulon me vite njerëzit e sinqertë të kulturës shqiptare. Përmëtepër, edhe na "zbulon" personalitete me preardhje shqiptare që gjithë jetën i kanë kontribuar dhe i përkasin kulturës maqedonase.

Punemadhe. Populli shqiptar historikisht gjithmonë u ka dhënë personalitete popujve të tjerë nëpër botë, por shumë pak vetëvetes nëpër shekuj. Edhe, kthej sytë pas gjatë ndryshimeve demokratike, "veprimet patriotike" të Kalorësit të arratisur t'i shoh në sy: ecjet, dyluftimet për karrierë politike, "flijimet artistike" të tij si politikani numër dy i Ibrahim Rugovës, që

përfundon në kabinetin e Babait të Maqedonisë. Padashtas, m'i kujton edhe organizimet tona kulturore: "Ditët e Naimit" në Tetovë, Takime nën Rrap, në Shkup. Rehabilitimin e tij në IRJ të Maqedonisë. Përdeisa, ne i organizonim këto manifestime kulturore me shumë vështirësi, ai me shokët partizanë përpiqeshte t'i ngulfasë me të gjitha metodat policore në ministri dhe organizonte "aktivitete kulturore" paralele në të njëjtën kohë. I priste mysafirët tanë në Qafë Thanë, i ndalte në Strugë, ose i përcillte në polici.

Mirë them unë, kur është aq "aktivist kulturor" i madh shqiptar, pse nuk organizon një manifestim kulturor të vetin dhe të mos u ngatërrohet të tjerëve më nëpër këmbë. Pushtetin e ka në dorë. Ministritë, poashtu me "vëllezërit" qafë për qafe. Para merr nga të katër anët me thasë. Përsëri, e pyes veten: Çka i mungon sot këtij Kalorësi të arratisur?! Përgjigjem: vetëm qumështi i zogut. Atëherë, pse nuk i ngrys ditët e fundit të pleqërisë në shtëpi si "veteran lufte", po vazhdon edhe më me hov të merret me hujin e vjetër teknefes të rrufjanit komunist. Përçaj popullin shqiptar edhe sot si dje me të gjitha metodat "kulturore" policore.

Fatkeqësia, dihet: që të arsyetohen para popullit me vete i marrin edhe disa personalitete që deri dje deklaroheshin si maqedonas dhe i kanë kontribuar kulturës dhe letërsisë maqedonase, vetëm e vetëm të bëjnë "zhurmë kulturore" propaganduese dhe të fotografohen para kamerave televizive si kalorës të arratisur për të rënë përsëri në sy të partive politike shqiptare. Të mjerët, nuk e shohin veten se si

duken para kamerave televizive?! Gungaçë, që sot nuk u rri mbi shpinë mirë e ka hije as samari.

Sterjo Spasse, nuk ka qenë shqiptar, po është dhe mbetet shumë më patriot dhe shkrimtar se ky bërllok shqiptar që na ngatërrohet nëpër këmbë si popull me dhjetë plagë, që sot përpiqet të çohet nga shtrati më këmbë. Maqedonasit për së gjalli i përdorën të gjitha metodat, që Sterjo Spasse të deklarohet si shkrimtar maqedonas: I përkthyen disa libra, ndoshta i premtuan edhe shpërblime marramendëse. Jo, nuk pranoi, vdiq si burrë dhe shkrimtar shqiptar, ua tha në sy "dashamirëve" dhe argatëve shqiptar: unë vërtetë jam me preardhje bullgare ose maqedonase siç thoni ju, po unë jam shkrimtar shqiptar.

Përçudi, sot habitem me shqiptarët e mi që më së shumti merren me parsonalitet që i kanë dhënë botës, e shumë pak me personalitet që kanë punuar dhe punojnë për çështjen shqiptare. Dorën në zemër, shqiptarët sot për sot i kanë dy nobelistë. I treti është në rrugë: Ismail Kadare. Vetëm nuk duhet të kënaqemi me këtë arritje, duhet ta pyesim veten edhe çka bënë këta nobelistë për Shqipërinë: ndërtuan ndonjë shkollë shqipe, spital, rrugë të kombit, apo themeluan ndonjë fondacion në dobi të çështjes shqiptare. Populli thotë: mos ia shih gunën, po punën.

Fatkeqësisht, personaliteve shqiptare u ngjiten për herdhesh rriqërat politike që si të paaftë i kanë humbur postet partiake pët ta mbajtur veten gjallë edhe ndonjë ditë në jetën politike. Përndryshe, po të mos ishin këto personalitete shqiptare t'i mbajnë gjallë, moti do të kishin cofur si qenë me zgjebe në rrugë pas porte.

Edhe, patjetër do të cofin një ditë, por mbi varrin e tyre Nesër askushi nuk do të dëshirojë të vëndosë korora të luleve dhe bëjë karrierë politike…

## POETI REBEL I POEZIVE TË EGËRA

Risinë që sjellë sot poezia e dashurisë në letersinë shqipe i ka rrënjët te lirika popullore, që e ka tejkaluar moti pjesa më e fuqishme e poezisë shqipe, lirika e dashurisë. Dhe, jo rastësisht Lasgushi është poet i madh. Pano Taçi është vëllai i vogël i Lasgush Poradecit.

Poezia shqipe është lëruar dhe zhvilluar brenda kufijve politik: Shqipëri, Kosovë, IRJ e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Diasporë. Dhe, përçudi, përderisa në Shqipëri ajo është lëruar përkrah poezisë patriotike edhe poezia e dashurisë, në Kosovë, Mal të Zi dhe IRJ e Maqedonisë është lëruar vetëm poezia patriotike. Realitet ky, që do të thotë se, një popull e manifeston atë që nuk e ka, i mungon me vite, liria. Risi në poezinë shqipe, sot është edhe kombinimi i dashurisë me patriotizmin. Poetët që e lërojnë këtë lloj poezie të veçantë numërohen në gishta. Megjithatë, kjo është poezia profetike e ironisë, sarkazmës dhe protestës artistike.

Motivet e poezisë erotike në letërsinë shqipe janë të njohura: besnikëria, tradhtia, ndarjet, xhelozia, malli, sëmundja nga dashuria, mirëpo edhe ëmbëlsia nga dashuria dhe bukuria e trupit të zhveshur. Është interesante se në rolin e subjektit lirik paraqitet në këto poezi, njësoj shpeshherë gruaja sikur edhe mashkulli. Përmëtepër, te Pano Taçi është e përbashkët tema: jeta pas vdekjes. Ringjallja. Dhe, raporti midis jetës dhe vdekjes.

Edhe pse, në kohën e sotshme ende vazhdon të shkruhet me të madhe poezia patriotike, ku gjakohet pas lirisë dhe luftohet robëria shekullore.

Poezia erotike në gjirin e vet e ka edhe tipin e poezisë profetike. Zakonisht, këtë lloj të poezisë e kanë shkruar poetë-profetë, që letërsia shqipe i ka pasur edhe para kohës së Romantizmit: Frakulla, Çami, Zuko Kamberi etj. Stili i poetëve-profetë është i përsosur, nuk vajtojnë për të kaluarën, po për të sotmen dhe të nesërmen. Vargu i kësaj poezie e lufton hipokrizinë, koprracinë dhe grykësinë. Një spektër më i gjerë objektesh paraqitet në poezinë erotike, e cila dallohet fare lehtë nga poezia patriotike. Kështu që mjeshtëria e Pano Taçit shprehet me kërkimin e forcave të reja, përsosjen e figurave ekzistuese dhe të proçeseve stilistike duke lejuar shtimin dhe zhvillimin e temave të paprekshme.

Poezia erotike e Pano Taçit ka gjakun dhe shpirtin, që i ecin nëpër damarë. Një përzierje të së resë: dashurisë me patriotizmin. Gjuha e thjeshtë dhe me stilin e qartë, po të thellë është përsosur me imagjinatën e pasur dhe gjuhën e stolisur. Këndimi i poezisë te "*Eja Mike*": *Sa herë vjen çapkëni prill,/ çapkëne më bëhet shpresa,/ brezin nga mesi ia zgjidh malit,/ t'ia bëj rrëkeza./*

Dhe, për mua si poet, poezi e fuqishme është ajo që nëpër damarë i qarkullon gjak dhe shpirt, i ka thellë rrënjët në poezinë popullore. Dhe, i japin gji Tri Zana të maleve. Fuqi për luftë si Mujit dhe Halilit për ta sjellur Nuse në Katund Tanushën e Krajlit…

Ikja e Pano Taçit nga parullat e thata, patetika patriotike është risi e plotë në poezinë erotike shqipe, sikur është ruajtja dhe ndikimi i poezisë popullore. Poezia e mirë artistike duhet të ketë edhe filozofinë jetësore plot figura poetike. Pano Taçi hedhë farën në tokë pjellore, ashtu si bujku me hebet në krah drithin në ara, kështu që frutat e pjekur në vjeshtë, poezitë i lulëzojnë në Pranverë në libër…

Armë e fuqishme është edhe lirika satirike, ku Pano Taçi përqesh momente njerëzore, politikën me prijësit e tyre, madje edhe vetë fatin e popullit shqiptar. Qeverisë i shkruan letër te poezia "*Greva e urisë"*: *me spermë ia shkroi qeverisë/ të më rris dhe ca pensionin/ veç për p... e rrospisë./ Shtona, qeveri, racionin,/ Ndryshe k... teveqel/ Gjallë nga greva nuk më del.* Origjinaliteti i poetit, fatkeqësisht ende është në kundërshtim me dukuritë imorale dhe idetë e kohës, në të cilën jeton brenda kufijve politik.

Poezia erotike e Pano Taçit sa vjen e më shumë demokratizohet dhe misticizmi depërton thellë e më thellë në art. Dashurinë ndaj lirisë e paraqet me shprehje plot figura dhe me gjuhën erotike të lirikës së dashurisë. E zhvesh nga trupi ferexhenë patetike dhe parullat e thata dhe i vesh rrobat e nusërisë. Në poezinë erotike të poetit rebel, nganjëherë është shumë vështirë të dallohet deri ku shkon alegoria e ku fillon shfaqja realiste. Vetë gjuha shqipe, gjuhë e poezisë ka disa veçori të saj poetike, e përshtatshme në paraqitjen e dy-tre dykuptimësive të vargut. Megjithatë, në këtë poezi ekziston edhe një rrezik stereotipash, sepse

ajo bazohet në disa tema të përsëritura: dashuria, vera, bukuria. Që, Pano Taçi sot më e ka tejkaluar me sukses dhe pasuruar me Baba Tomorin si vend i perëndive: Rrapin, Miken, vetminë, Lotët e Shën Mërisë, Gjakun e Krishtit, Burrin, Engjëllin mbrojtës grua, Nimfën. Qiririn, Romen, Natën e Madhe etj.

Inspirimi i Pano Taçit është i sinqertë dhe i thellë duke u shërbyer me shprehje të larta poetike. Formën e një vargu mes legjendave, porosish dhe alegorish. Tendencë kjo, për të krijuar një rrymë të re letrare me shumë vazhdues dhe përkrahës për një të Nesërme. Poeti rebel Pano Taçi është i gatshëm të rroket fytas edhe me Zonjën Vdekje. Ringjalljen. Lindjen. Robërinë. Lirinë. Shkurt, ballafaqohet me misteriozen: dashurinë qiellore dhe tokësore.

Vargu luftarak i Pano Taçit, përjeton një lulëzim të ri në lirikën shqipe. I lëshon paragjykimet, frikën, burgun shtëpiak… Robërinë... Shkolla e re letrare është shtegu i tij drejtë Lirisë… Universiteti… Biblioteka… E nxjerrë vargun nga brezi. Poeti është me shpirt krenar dhe i vetëdijshëm në paraqitjen e realitetit shoqëror, kështu që për këtë poet rebel jeta e varur nga partitë politike është e huaj. Tentim ky, i komunizmit që tërë jetën e shoqërisë ta ketë nën kontroll. Hap i gabuar ideologjik me të cilin dështoi në parashikime. Tashti e kanë radhën partitë politike demokratike, shkaku se poeti ringjallet edhe më i fuqishëm. Stili i tij është sakrificë, ndjeshmëri e poetit dhe sinqeriteti.

Përsëri do të vdesë dhe ringjallet mes poezive, por kurrë nuk do t'u bie duarve dhe këndojë

arritjeve të tyre demagogjike krah për krahu me trusakatët para kamerave televizive.

Shkëputja e Pano Taçit nga format klasike poetike nuk qe proces i lehtë, që me vete e mori edhe si viktimë kryengritëse artistike. Nuk është punë e lehtë t'u ikësh ndikimeve nga letërsia ruse (Shqipëri) dhe jugosllave (Kosovë. Mal i Zi e IRJ e Maqedonisë).

Poezia shqipe moderne sot ka një rrezik nga poetët e oborrit në prehër të partive politike. Fatkeqësisht, falë Zotit, në përgjithësi janë poetë të dobët dhe pa talent. Megjithatë, poezia e ardhmërisë do të jetë poezia e verës dhe e dashurisë, që alegorikisht të paraqesë dashurinë hyjnore dhe dehjen e mistikëve në Baba Tomor...

Ardhmëria e poezisë shqipe qëndron në traditën e poezisë popullore, Rilindjes shqiptare, duke u pasuruar me rrugë të reja, për të hipur mes reve në Baba Tomor. Mal, ku Pano Taçi me shokë veç ka hipur më në majë. Atdheun e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri…

## SAHAT ME NJË AKREP

Im Atë, vërtet ishte burrë i mençur: I dinte spiunët. Titujt "partizanë" ua lexonte në sy e ballë. Edhe, kur kishte probleme me mua si shkrimtar u thoshte: Kaloshi është sahat me një akrep. Nuk dihet kur është dymbëdhjetë, e kur një. Dorën në zemër, në atë kohë edhe ia merrsha inatin. Edhe pse, ai e thoshte realitetin. E, në anën tjetër herë pas here ma tërhiqte vërejtjen, të kem kujdes nga "shokët dhe miqtë patriotë". E sidomos, me Hoxhën e Allahut. Një gazetar tjetër vendas, që në atë kohë nga Serbia si të ri e kishin hedhur matanë kufirit si spiun, kur u kthye pas vuajtjes të dënimit në Kërçovë për mua thoshte: Ty nuk mund të të mashtrojnë bashibuzukët aq lehtë, ti je dreqi në tepsi. Përpara meje e shante Shqipërinë si sistem komunist, e dikur në këto biseda të gjata harronte dhe e lëvdonte si shtet shqiptar. Rrëfente për veten dhe shokët që në atë kohë i kishin nxjerrë matanë kufirit si të "arratisur politik" me emra, mbiemra e vendbanime të rrejshëm. Dhjetë vjet e kishim për detyrë të mos merreshim me aktivitete spiunimi, pas dhjetë vjetëve të fillonim me punën "patriotike" në shërbim të UDBA jugosllave.

Përçudi, të nesërmen na zbulonin se jemi të dërguar si spiunë jugosllav. Agjentët e sigurimit shqiptar na e përplasnin në sy, se: nuk i kemi emrat dhe vendlindjet e vërteta me të cilët ishim prezentuar para organeve të sigurimit shqiptar si të "arratisur politik".

Përmëtepër, na i thonin para syve emrat dhe mbiemrat e vërtetë, dhe nga cili katund ose qytet vinim si këlyshë jogosllav për spunim në Shqipëri.

Vite më vonë, ne të "burgosurit politik" do ta mësonim të vërtetën e zbulimit historik. Ashtu siç hidhte matanë kufrit spiunë gjoja si të arratisur politik shteti jugosllav, hidhte edhe Shqipëria në Jugosllavi. Në këtë aktivitet të spiunazhit u dallua një epror ushtarak me prejardhje nga Mitrovica e Kosovës, i cili e kalonte kufirin shqiptaro – jugosllav si gardhin e kopshtit të babait. Gati thuaj të gjithë spiunët që u hodhën nga Jugosllavia në Shqipëri në atë kohë, na zbuloi ai agjent shqiptar duke na rrasur njërin pas tjetrit në burg si shqerrat bariu në vathë.

Vetë unë, Kalosh Çeliku isha ai që nuk i besoja edhe këmishës sime në trup. Ndoshta edhe kisha arsye. Ishte kohë qorre. Kohë, kur siç thotë populli: Nata kishte sy e muret veshë. Nuk duheshte shumë "patriotizëm" për të të rrasur në birucë: vetëm ta dëgjoje Radio Tiranën, lexosh ndonjë libër të "ndaluar", shajsh Shokun Tito. Ose, bërtasësh në rrugë: Kosova republikë. Miku im i ndjerë, Fadil Bekteshi si gazetar i TV Prishtina në atë kohë i hëngër disa vjet burg, pse në vend të "sheshirit" (cilindrit) në një shkrim e përdori fjalën "republikë". Veprim patriotik ky, që si "bagazh politik" në një gazetë të "vëllazërim-bashkimit" do ta paguaj me kokë. Ndërsa, spiunët kënaqeshin me thënjen e tim Ati.

Dhe, iknin plot gëzim të raportojnë te punëdhënësi se e kishin zbuluar enigmën e shekullit: Kalosh Çeliku është sahat me një akrep.

Edhe sot, për inat të dudumëve jam sahat me një akrep. Përmëtepër, kohën e fundit edhe më pëlqen ky pagëzim i tim Ati. Çudia e Zotit, si mbeta ende gjallë mes kaq shumë spiunëve me pakicë e shumicë pa e bërë asnjë ditë burg. Rasti, ma kujton edhe kthimin tim nga Kosova në Shkup. Rrufjanët, kur m'u sulën në këtë Qytet me shpifje e etiketime se gjoja jam i dërguar nga Kosova.

Përmëtepër, edhe se: Çështjen e shqiptarëve dua ta zgjidh me luftë. Honxhobonxho pasi pinte dhe bëheshte tapë në "Menada", vetë ma rrëfente këtë histori policore. Edhe se, është i ngarkuar me detyrë të më përcjellë hap pas hapi. Pasmesnate, ma thoshte e dhe këtë: Nuk jam vetëm unë, i ke edhe disa "miq" të tjerë që i ushqen me pije e bukë në sofër. Ditenatën rrinë me ty në tavolinë, të nesërmen të shesin për pak pare në polici. Mikun tim të penës Teki Dërvishi (Zoti e bekoftë), që tanimë e kishin përzënë nga gazeta e "vëllazërim-bashkimit", shkaku se nuk kishte dalë me shkrime kundër Ismail Kadare, herë pas here edhe më dërgonte porosi nga Prishtina: Të kem kujdes nga Honxhobonxho me shokë. Nuk duhet t'ju rrëfehem shumë në sofër, hap zemrën krah më krah rrumaducëve. Shkaku se, rrufjanët janë të rrezikshëm.

Edhe, ne shqiptarët jemi të çuditshëm, nuk dimë për së gjalli t'i vlerësojmë personalitetet, nuk e kemi "ditur" se përveç shkrimtarit shqiptar me famë botërore Ismail Kadare, ndoshta edhe ndonjë tjetri e kemi patur edhe një kandidat tjetër serioz për çmimin Nobël: Teki Dërvishi. Dukuri negative kjo e instuticioneve tona kulturore që me

vite jemi të mbyllura në guacën politike, klanore e familjare. Nuk dimë për së gjalli t'i vlerësojmë dhe çmojmë personalitetet shqiptar, trurin e Atdheut.

Kulltukofagët, që vijnë sot në pushtet me votat "demokratike" të popullit, i shajnë për së gjalli e pastaj i vajtojnë pas vdekjes. Edhe, më bëjnë zë miqtë e mi të marr pjesë në varrimin e kulltukofagëve. U përgjigjem: unë nuk marr pjesë nëpër varrime, unë marr pjesë vetëm nëpër ringjallje. Përderisa, këta kulltukofagë vdesin mes dhjamit, miqtë e mi poetë shkaku tyre vdesin edhe pa bukë, me bark të zbrazët dhe nuk ka kush t'i shti në varr. Rasti, përsëri ma rikujtoi shkrimtarin e madh Teki Dërvishi, që e la me amanet për së gjalli: varrim pa soleminitete, personalitete partiake mbi varrin tim që të bëjnë karrierë politike, vetëm në rrethin e ngusht familjar. Unë do t'i shtoja këtij "varrimi" madhështor të Poetit: edhe, pa ngushëllime në familje. Mërzisin familjen rrufjanët e paftyrë me pritje - përcjellje dhe deklarata patetike para kamerave televizive.Dhe, faleminderit Natyrës që e bën pastrimin e shoqërisë shqiptare. Përndryshe, do të na mbulonte bërlloku për së gjalli këmbekokë. Dhashtë Zoti, vijnë të rinjt me një tjetër tru e bagazh politik. Edhe pse, trusakatët nateditë e kërkojnë me këmbëngulje në mjetet e informacionit dhe presin të bëj vetëvrasje.

Shtriganët e Allahut, siç duket e kanë harruar edhe një thënje profetike të një Hoxhe me shumë autoritet në Kërçovë, kur pas disa hajmalive i tha t'im Ati: E ruaj edhe një hajmali të fundit për të, vetëmse duhet ta shoh se si duket në pamje. A

vjen ai ndonjëherë në Kërçovë? Po, për çdo të shtunë, ishte përgjigjur im Atë. Atëherë, është mirë ta shoh unë përpara se ta përdorë edhe hajmailinë e fundit. Dhe, një të shtune (ditë pazari) im Atë nga ëmbëltorja e xha Muratit i thotë Hoxhës: ja, ai është matanë trotuarit me gunën e zezë deri në fund të këmbëve, flokët e gjata pas shpine dhe mjekrën e zezë. E dini, si iu përgjigjë Hoxha më i madh i Kërçovës?! Jo, nuk e dini. Vëlla, mos eja më për Kaloshin, mos i harxho kot paratë që i fiton me djersë! Atë, nuk e zënë magjitë, as hajmalitë e hoxhallarëve.

Thashë: Kohën e fundit edhe më plëqen kjo prognozë e tim Ati, vazhdoj jetën mes librave si, sahat me një akrep. Pse duhet të di i hurit e litarit çka pështjellë Kalosh Çeliku në kokë?! Fatkeqësi, për Hoxhën e Allahut. Cilin e do e cilin e urren. Planet e tij si shkrimtar për Ditën e Nesërme të Motit Madh.

Përdallim nga koha e djeshme, sot nuk ik unë nga spiunët, po spiunët ikin me të katra nga Kalosh Çeliku. Përditë dalin emrat e tyre si spiunë në gazetë. Radhën e presin hoxhallarët e rrejshëm dhe kulturofagët. Edhe, shtyhen me bërryla, kush të dalë i pari. Qeshë sot vetmevete, kur më kujtohet Ministri i Informatave në Kuvendin e Shoqatës së Shkrimtarve Shqiptar duke nxjerrë shkumë nga goja.

Qenmelez Sharrin duke mbëledhur nënshkrime falsifikat të më shkarkojnë nga posti i kryetarit. Rrumaduci duke ia botuar ato lista sakate në gazetën e "vëllazërim-bashkimit" se, unë në vend të "Ditëve të Naimit" i organizoj "Ditët e ashures". Këlysh Llagun duke kërcyer mbi

tavolina si spec i kuq kopshti në gojë të Lopës. Kritik Poetucin tullac (Sanço Pançon shqiptar të Doktorziut), autor të atyre shkrimeve duke rrëfyer grushta si një kalorës i arratisur teknefes në Arenën e dyluftimit edhe në Shkollën fillore "Liria", në Shkup. Tatën e Madhe duke lëvizur bishtin para qenëve me zgjebe, me shpresë se ndonjë Këlyshmelez Sharri do t'i kërcejë në shpinë, Buçës "azgane" të Katundit.

Ndonjëri që sot, kur Komisioni Lustrues ia publikon emrin në mjetet e informacionit edhe zemrohet, nuk do ta pranojë realitetin si spiun. E në atë kohë krenoheshte me këtë gradë policore. Ngutet në mjetet e informacionit dhe në gjykatë të kërkoj drejtësi. Përpiqet ta shpëtoj veten si i "burgosur politik". Mirë, them unë: Pse Komisioni Lustrues nuk "gabon" t'i publikojë emrat e atdhetarëve të vërtetë, po emrat këtyre "shqiptarëve të ndershëm", që edhe sot e kësaj dite përpiqen të na ngatërrohen nëpër këmbë. Në anën tjetër harron se, pak vetë dolën nga burgu pa pasoja. Burgu është vend përmisimi, e nuk është universitet. Shumica vdiqën brenda katër mureve nga maltertimet fizike, ndonjëri vetë e përplasi kokën për muri, tjetri doli si homoseksual, disa pranuan bashkëpunim, dolën në liri si spiunë. Një pakicë, që nuk e shitën veten si të çmendur duke u endur rrugëve e folur vetmevete. Dhe, pak veta me mendtë në kokë. Dëmet e papara që ua sollën personaliteteve, familjeve dhe shoqërisë shqiptare këta individë trusakatë me kokën në xhami e bythën në polici, nuk i mbanë dot as kandari i Çajupit.

Vonë. Shumë vonë është, edhe nuk më hynë në punë mua e as shoqërisë shqiptare "zbulimi" i këtyre spiunëve. Publikimi i emrave dhe dosjeve të tyre në mjetet e informacionit. Shqiptarët, nuk duhet të tremben aq shumë nga spiunët e djeshëm, po nga spiunët e sotshëm që na ndjekin edhe më zi se dje po me të njëjtat metoda policore. Vërtet e ndërruan partinë politike, po jo hujin e kodoshit. E rëndësishmja, i kam ditur moti dhe i di këta këlyshë me zgjebe, që në atë kohë më ndiqnin këmba- këmbës edhe nëpër fshatrat e Malësisë të Shkupit. Edhe sot më ndjekin si këlyshë rruge, po kush nuk ua vë veshin. Turren të tërbuar si pa kokë rrugëve të Shkupit me një asht në gojë e një këmbë në varr. Rrallë ndonjëri nga "vëllazërit" komunist të arratisur për të ardhur në pushtet ua hudhë për mëshirë nga një asht si shpërblim. Edhe sot si dje, ndërsehen me të katra pas porte në mjetet e informacionit: Rrumaduci me një asht në gojë, Lamlami me një torbë taxhi për qafe si hajmali. Kritik Poetuci tullac nga një "Ent Punësimi" policor. E lëvizin bishtin ndër këmbë, që të duken si qenmelezë Sharri përpara pronarëve të Vetëshërbimit. Përditë, e shesin veten lirë në Bit – Pazar. Shpesh-herë edhe pa pare.

Vetëm e vetëm, që "vëllezërit" komunistë t'ua hudhin nga një asht në rrugë si lëmoshë ta mbajnë veten gjallë në kontenierët e bërllokut, në Shkup. Emrat të ju dalin në gazetë si "intelektualë", fotografohen para kamerave televizive si "patriotë" kuqezi.

Kalosh Çeliku moti i ka ditur dhe i di këta spiunë me vulë në ballë, falë veprimeve të tyre

"patriotike". Nuk është marrë me thashethemet e hallkut rrugëve nëpër Bit-Pazar, po me fenomene, veprimet e tyre në shoqëri, "Shtetin e përbashkët". Gjurmët, që i kanë lënë aq të thella këta "patriotë" me zgjebe në shoqërinë shqiptare, kurrë nuk do t'i fshijë dot asnjë furtunë, asnjë borë e madhe…

Vite më vonë, e shoh se im Atë kishte pasur të drejtë: më kishte shpëtuar në atë kohë nga spiunët, burgu politik. Për fat timin, edhe Honxhobonxho i kishte ndihmuar pak, kudo e trumbetonte në rrethin e tij policor thënien e tim Ati: Kalosh Çeliku është sahat me një akrep. Nuk dihet kur është dymbëdhjetë e kur një.

Megjithatë, sot ky sahat me një akrep e tregon kohën e saktë të Motit Madh 2012, kur duhet të na dalë gjumi, ngrihemi nga shtrati me dhjetë plagë në trup. Tjetër punë është ajo se, Hoxha i Allahut me shokë nuk di ta lexojë këtë sahat me një akrep…

**HOJDODOLJA***
*(Fenomen i çuditshëm shqiptar)*

Edhe, vazhdojnë të lehin nateditë: Lam Lami i tërbuar krah për krahu me Hojdodolen dhe Këlyshin me zgjebe të DoktorZiut përmbrapa për një asht shpërblim në kontenierët e bërllokut, në Bit-Pazar. Njëri në vijë, tjetra në lëndinë. Këlyshi me zgjebe me një asht në gojë dhe bishtin ndër këmbë edha ai pas porte në livadhe. Gjuhën nga vapa e kanë nxjerrë jashtë dy pëllëmbë. Përditë merren me shpifje e etiketime nëpër faqe të internetit dhe në Facebook me këmbët dhe trutë në legen. I mjeri Lam Lami dhe Hojdodolja - pulë që këndon si gjel. Këlysh me zgjebe me një asht në gojë - shpërblim. Asgjë nuk thonë të vërtetë, vjellin e shkruajnë jerm duke përhapur sa më shumë shpifje, rrena e huti në popull. Fenomen i çuditshëm shqiptar: Pula kur këndon si gjel. Nëna ime plakë thoshte: Bir, kënga e saj ndjell kob. Patjetër, duhet t'ia zhdukim furriqet. Në Shtëpinë tonë lajmëtar është gjeli, Mbreti i pulave. E paralajmëron agimin. Përçudi, sot Pula qafërjepur e "thirrë" agimin. Fatkeqësi kombëtare, që Nëna ime nuk është gjallë, thikën t'ia vë në qafë. Heshti qyqen.

Nateditë e tërheqin njëri-tjetrin për veshi e për këmbe. Bishti. Tinëz edhe i kërcejnë në shpinë pas gardhit ose mullarit me bar. Edhe atë, se cili do ta strukë veten i pari në Oborrin e Xhadisë me poshterkë të kuqe.

I ka ndërsyer si gjithmonë Qoftëlargu me argatë shqiptar, fis i tyre me prejardhje shqiptare

që për Universitetin e Tetovës tha, se: "është foshnje që ka lindur e vdekur". Realitet i hidhur ky për dudumët, "foshnja që lindi e vdekur", sot është rritur burrë me mustaqe vesh më vesh. I delë zot Shtëpisë. Budallain mos e pyet asgjë, ai tregon vetë për montimet politike të asaj kohe kundër intelektualëve shqiptar. I kemi ditur ato montime të sojit të këtij "azgani" partiak me kërcnime telefonike e presione policore: brenda një muaji ta lëshoj Shkupin. Po, ndodhi e kundërta, Shkupin e lëshoi ai me rrugaçët politik. Fal Zotit dhe Natyrës unë edhe sot e kësaj dite punoj dhe jetoj në Shkup. Metoda të vjetra policore janë ato që i përdorët në atë kohë kundër intelektualve shqiptar dhe doni t'i përsërisni edhe në Ditën e sotshme. Erëra të tjera fryjnë në këtë Mot të Madh (2012). Ditët i keni të numëruara, i keni futur në thesin me arna. Ja, çka i tërbon këta qenëmelezë me këlyshët e tyre me zgjebe në Çetën partizane me "pushkën" në dorë pa fishekë. Tremben se do t'u përsëritet Rënia e Rankoviqit të Ri edhe në Shkup (Qoftëlargut). Ikën, ose i përzunë nga Kosova kjo nuk ka gjithaq rëndësi në këtë shkrim, e rëndësishmja është: ku të ikin tashti më larg se në hale, përveçse asaj rrugës të premtuar "me lule xheneti" si turq "ehamdurila", në Turqi. E vetmja rrugë qorre që ju ka mbetur e lirë haramëve. Rrugët tjera malore i kanë të zëna pas lisave. Kaçakët shqiptar që zbritën nga mali u kanë vënë pusi. U thonë: bëni çka të doni në xhami me këmbët dhe trutë në legen. N'dashi ngreni bythët, n'dashi ngreni këmbët përpjetë në hava.

Vetëm, kurrë të mos ju shohim t'i luteni Zotit me "allahu akber" para këmbëve të Atdheut. Ikni thyeni qafën nga sytë këmbët nëpër botë. Shumë shpejt edhe flamurin arab me hënën drapër nga minaret e xhamive do t'ua hedhim në përrua dhe në vend të tij një ditë do të valojë krenar flamuri kombëtar kuqezi me shqiponjën dykrenare nëpër xhamitë shqiptare anembanë Shqipërisë.

Gjithë jetën mbetët duke lëpirë një asht që ua hedhin herë pas here "vëllezërit" neokomunistë, edhe vazhdoni ta lëpini duke lëkundur bishtin edhe sot e kësaj dite me shpresë se, Partia Neokomuniste do të ringjallet nga varri, përsëri të vijë në pushtet dhe do t'ua hedhë ashtin e premtuar për dritare, ose një torbë taxhi në kontenierët e bërllokut, përpara Qeverisë. Shkak kryesor ky, që Lam Lami, Hojdodolja dhe Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut lehin para Qeverisë maqedonase-shqiptare. E thirrin "Pranverën arabe" duke e pasur mendjen te "Pranvera serbe" në mes të Shkupit. Përçudi, askushi deri më sot nuk ua hedhë për dritare nga një ashtë në rrugë si shpërblim për lehje pas porte.

Përmëtepër, Lam Lamit, Hojdodoles dhe Këlyshit me zgjebe të DoktorZiut as edhe një bub rruge me bishtin nën këmbë më nuk u shkon përmbrapa si shok lufte. E kanë humbur besimin e Zotit dhe Qoftëlargut, nuk e ruajnë "Shtëpinë e sëmurë". Bukë hanë në tjetër oborr (Shtëpi), atje lehin gjoja pas Ujkut me bythën në Lëmë e mendjen e kanë te "vëllezërit" neokomunistë.

Përpiqen, ende ta mashtrojnë e manipulojnë këtë popull heroik me përjagëje e lehje në

Facebook. Njëri vetëm për një asht të hedhur pas porte duke lehur non-stop para kamerave televizive se, Ali Ahmetin e ka mik. Edhe, po t'i thotë Ali Ahmeti që të punojë si shërbetor, ai edhe do të punojë si shërbetor. Tjetri më "azgani" e ka "mik" Kalosh Çelikun. Hojdodolja në të katër anët trumbeton, lëvdohet para grave besnike se e ka "pasur edhe dashnor". Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut lëvdohet se i ka bërë roje policore në gazetën e "vëllazërim-bashkimit" duke shkruar reçensione pozitive për librat e tij të "rrezikshëm". I kanë dalur zot, kur Partia e tyre Neokomunsite ia ka ndërsyer këlyshët me zgjebe pas shpine. Zagarët e asaj Partie Politike Neokomuniste, sot janë shndërruar në "analistë politik", "shkrimtarë", "kritikë letrar" dhe "hoxhallarë" me këmbë e tru në legen. Përpiqen ende ta manipulojnë popullin shqiptar me përralla turko-arabe. Trusakatët, ende mendojnë se populli shqiptar hanë bar, i ka harruar porositë e Rilindasve shqiptar nëpër libra të arratisur nëpër botë për Shqipëri Etnike, ku i lanë edhe eshtrat. Udhërrëfyesit shekullor të këtij populli trim nëpër shekuj në luftë herë me Krajl e herë me Mbret.

Trusakatët, edhe sot si dje, i rrenë mendja se me ndihmën e hoxhallarëve të rrejshëm mund ta përzënë këtë popull në Turqi. Hëngër fiq dhe vdiq ajo kohë e "bashibuzukëve" misionar të Allahut. Shqiptarët, sot u prijnë punëve me laps e Libër nëpër institucione për Nesër. O Imzot, çfarë soji i keq është Lam Lami, Hojdodolja dhe Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut?! Përçudi, Hojdodolja me Këlyshin me zgjebe të DoktorZiut ende qënkan gjallë?! E unë mendoja se kanë cofur, që në vitin

1998 (Lufta e Kosovës), në shkollën fillore "LIRIA", në Shkup. Fatkeqësi kombëtare, si i ka harruar gjatë kësaj kohe Doktorziu t'u organizojë ndonjë Akademi përkujtimore. Në emër të të vdekurve ta mbajë veten ende gjallë edhe ndonjë ditë në jetën "politike-kulturore" të shqiptarisë. Shpalli para të pranishmëve si "patriotë" shqiptarë, që me "armë" në dorë kanë luftuar maleve të Sharrit. Gjithë jetën i janë turr pas Xhadisë me pashterkë të kuqe dhe janë shitur te "vëllezërit" neokomunistë shumë lirë në Bit-Pazar: një asht, ose një torbë taxhi. Përpiqen edhe sot si dje krah për krahu me bishtin ndër këmbë të lehin lam-lam pas porte, po askush nuk ua hap derën t'i fusi coftinat komuniste në Lëmë.

Në kulminacion të tërbimit më shkruajnë mesazhe e komente anonime, pavetëdije se përditë e zbulojnë mjerimin e tyre, veten para meje dhe lexuesit me emër e mbiemër si rrufjanë shqiptar. Përpiqen të më rrëfejnë përralla arabe në mes të Shkupit (Shqipërisë). Anekdota popullore të Nastradin Hoxhës. E nuk i njohin, e as i kanë dëgjuar dhe dinë anekdotat e Xha Derallës. I "marrin" kompetencat e institucioneve shtetërore informative sekrete: në Tiranë, Beograd dhe Shkup duke shpallur spiunë dhe patriotë sipas arshinit të tyre "patriotik". Komisonit Lustrues nuk i mbeti më punë për zbulimin e kodoshëve.

Gjithë "spiunët dhe patritotët shqiptar" i zbuluan Lam Lami, Hojdodolja dhe Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut me përjashtim të vetvetes si "patriotë kuqezi" me traditë shekullore brez pas brezi komunistë. Exhindosura nuk di ta dallojë qilimin nga flamuri. Shqiponjën dykrenare nga

këmbët e arushës. Vërtetë, janë të lezetshëm, ma kënaqën Lapsin. Ndonjëherë, nuk e di edhe pse më dhimbsen mjeranët, filloj t'i dua si kalorës të arratisur të "Kalemit". Përpiqem t'i shpëtoj me mish e shpirt personazhet e librave të mi nga vetëvrasja publike në Facebook e gazeta të "pavarura". Vetë shkruajnë shkrime sakate pa tru, vetë u përgjigjen komenteve të lexuesve duke e fshehur veten nën ferexhe ose dimi të grave. Përsëri, pa vetëdije e zbulojnë dhe zhveshin veten lakuriq si struci me kokën në zall e bythët në hava, se janë rritur e ushqyer me ilahi arabe.

Po i njëjti autor me këmbët e trutë në legen (pasi nuk u bë hoxhë e as politikan-profet i "Pranverës arabe" në Shkup duke e pasur mendjen te Pranvera serbe, ndoshta i ecë fati të bëhet shkrimtar) duke u pëpjekur ta fshehi veten nën ferexhenë e zezë nën shkrimin tim shkruan koment plot marrëzira.

Hojdodolja, të nesërmen brenda një dite turret t'i dalë në ndihmë Hoxhës të Allahut në telefonin tim celular më shkruan mbi dhjetë pizi-mesazhe. Edhe, dikur kur nuk i përgjigjem më merr në orët e mëngjesit tri-katër herë në telefon. E mjera, si t'ia hap telefonin në këtë "kohë dashurie të kolerës". Zemërohet. Tym e flakë nxjerrë nga "goja" (Edhe, ...).

E thirr në ndihmë Rrumaducin dhe Rrospinë Mashkull me zgjebe. Këlyshin e DoktorZiut. Ndoshta, edhe ndonjë tjetër partizan me yll të kuq në ballë e Kur'an nën sjetull. Kokë më kokë me arnë përmbi arnë të më shkruajnë "letra dashurie". Vazhdon me shpifjet dhe sharjet

teknefese përmes pizi-mesazheve në Facebook dhe internet.

Pizi - mesazhet nuk kanë "vlera artistike" dhe nuk janë të rëndësishëm për lexuesit në këtë shkrim profetik për Ditën e Nesërme. Hi-hii-hiii (e qeshura ime ironike e përditshme për gjysmanalfabetët). Vërtet, jeni duke ma kënaqur Lapsin…

Dudumët, me pseudonime halldupi, që përpqien të fshihet nën dimi të grave ose nën ferexhexhenë e zezë, shkaku se me siguri asgjë nuk kanë bërë në jetën e tyre "patriotike" për Nesër, përveçse kanë qenë gjithë jetën argatë të shitur herë me pare e herë pa pare te armiqtë tanë historik, të cilët i kanë përzënë nga të gjitha institucionet shtetërore ku janë përpjekur t'i strehojnë "vëllazërit", së fundi i përzunë edhe nga "*Ditën e Naimit*", duke u zvarritur të bëhen poetë, kritikë letrar dhe hoxhallarë të rrejshëm më paraqiten mua me komente teknefese nën shkrimet e mia publicistike.

Përgjigje të cilën më jua ka dhënë vetë Hojdodolja (mikja e tyre) nën një shkrim tjetër timin publicistik: Hoxha i Allahut.

Me qëllim nuk dua t'ia përmend emrin Xhindihalles se, kam frikë do të më zë goja qelb, edhe pse e ka nënshkruar me emër e mbiemër.

Egjetura, siç i themi ne në Katund, kur Tollosuni u bie me tokamk në kokë disa njerëzve kur flasin rrugës përçartë vetëmevete hipur mbi gomarin e Nastradinit si Nastradinica e stolisur me lule-lale. Pavetëdije se, mund ta cofi rrugës gomarin e shkretë në krahasim me Nastradin Hoxhën që i ka peshë me gjithë tesha e këpucë,

pesëdhjetë kilogram e Nastradinica 120 kg. Shkaku se, më dhimbset e shkreta duke vajtuar si qyqe lis më lis e çati më çati për një burrë me tirqi e xhamadan me sumbulla.

Ditën tjetër të radhës, symëshelë turr me të katra tërbohet me bishtin ndër këmbë e ashtin në gojë edhe Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut.

Mjerim historik i Këlyshit me zgjebe të DoktorZiut. Hojdodolja merr guximin t'i rri përkrah si azgane e "Kalemit", i mëson udhëheqësit dhe redaktorët, emra të mirënjohur anembanë Atdheut për kritere të vlerave artistike.

Trusakatët, kërkojnë që unë të humb kohë, merrem në Ditën e sotshme të Motit Madh 2012 me ta si palaço rruge të përgëdhelur si "letrarë" e përgaditur nëpër podrume antishqiptare, t'ua mësoj shkrim - leximin. Teorinë e letërisisë shqipe të Gani Lubotenit si gjela e pula qafërjepura, pjella komuniste në "gazetën e mjerimit" dhe rritur në Shtëpinë Publike të "vëllezërve" me drapër e çekiç në dorë.

Shkrim të cilin as që e kam parë e lexuar të "autores" në fjalë, por Hojdodolen mos e pyet se tregon vetë nivelin e saj të "lartë artistik" e kulturor. Vjellë sikur ta ketë zënë fundi i barkut për vdekje dhe e lëshon pas ferre.

Fatkeqësia, nuk vjellë art, po patetikë të pakontrolluar plot sharje e urrejte. Mjerimi i saj i shekullit, lëvdohet se, "do të më vras me poezi". Dhashtë, Zoti! "Plumbave" të vetëm që nuk u jam trembur dhe trembem në jetë edhe sot e kësaj dite. Vetëmse, kam frikë edhe ato rraqe mos i dalin pizi. Megjithatë, përsëri një "punë

patriotike” që duhet duartrokitur: nuk do të më vrasë me plumba. Edhe, kërcnohen trusakatët.

Njëzëri paralajmërojnë vazhdime të letrave të “dashurisë”. Pizi - mesazhe.

E harruan “Pranverën arabe”, në Shkup. Siç duket e kanë harruar edhe “Vjeshtën arabe” pa na trokotitur te porta duke e pasur mendjen nateditë te Pranvera serbe. “Dimri arab” i gjeti si kërcunj shelgu të kalbur në mes të Lëmës, të papërdorshëm për ndezjen e zjarrit në oxhak.

Trutë i shtrydhin në legen të më rrëfejnë mua përralla të Njëmienjënetëve arabe për Shkupin se, nuk e ditkam unë këtë Qytet si merr frymë dhe zgjohet nga gjumi. Rininë e bujshme shkollore që e kam kaluar me serenata korçare e shansone françeze qafë për qafe me cuca azgane deri në agim nëpër klubet e natës në këtë Qyetet, i zgjuar me legjandat e pavdekshme shqiptare e botërore. Edhe, pas studimeve në Prishtinë, para viteve ’80 -ta i jam kthyer përgjithmnonë deri në vdekje. Gati gjithë jetën time e kam kaluar dhe e kaloj në këtë Kryeqytet shqiptar. Punën time si mësues në Drenicë dhe Malësinë e Shkupit. Veprimtarinë e bujshme letrare. Thonë, se: ne nuk jemi rrumaducë, po jemi shumë të moralshëm me fe e besë.

Mirë, them unë: atëherë, pse piskatni e vajtoni si qyqe shelg më shelg, u shkon zëri për qielli?! Nëse nuk jeni rrumaducë, me siguri jeni dudumë. Përsëri, nuk jeni të lumtur, ë? Vërtet, më vjen keq për ju si “dëshmorë” të vonuar lufte me “Kalem” në dorë për liri. Përshesh me kos, si vetë autorët e komenteve teknefes pa gjak e shpirt shqiptar. Përgjumshëm thirrni “ezan” në Facebook duke e

kujtuar veten se ende jeni në minare me shpifje e etiketime se, unë me raki në dorë qënkam kundër minareve të xhamive. E dalldisni Hojdodolen ta lëvizë bishtin, mos ndoshta në këtë "krizë dashurie" pleqërie, i vardiset Rrumaduci i tërbuar me zgjebe i delë në fushën e mejadnit jo nga deti, po podrumi me "shpatë" në dorë.

Jo! Jo, o trusakatë me këmbët e trutë në legen: unë nuk jam kundër xhamive shqiptare me flamurin kuqezi në minare. E as kundër kishave shqiptare. Hardhuca nuk leh si qen, po leh ti o dudum krah për krahu me Hojdodolen dhe Këlyshin me zgjebe të DoktorZiut. I mjeri Hoxhë i Allahut, që në trup e shpirt nuk ke të veshur asgjë shqiptare. Tollosuni, siç duket me tokmak vathe u ka rënë në kokë. Lëmsh i bëni fjalitë, mendimet, shenjat e pikësimit. Nuk e dini gjuhën shqipe. Përmëkeq, në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012), në shekullin XXI, përpiqeni të na shisni dushkë për gogëla. Krekoseni si gjela e pula qafërjepura mbi pleh se, nuk keni kryer shkolla të "shkive". I mjeri hoxhë, a shkolla të "shkieve" të duket ty Shkolla Normale në Shkup, Universiteti i Prishtinës. Hajt, m'i numroni një herë ju shkollat e juaja të kryera, që nuk janë të "shkieve" e janë me "din e iman"! Diplomat e juaja që i keni varë në mur për stoli si "syrret" bostani dhe i keni blerë me para turku, arabi ose sllavi dhe i keni marrë me "gjoks" brenda një nate…

Serbia gjithmonë i ka dashur dhe i do hoxhallarët e sojit tënd dhe xhamitë turko-arabe. Serbia nuk e do xhaminë shqiptare dhe hoxhallarët shqiptar me kësulën e bardhë të

Bajram Currit në kokë dhe Abetare në gji të Kostandin Kritoforidhit.

Populli thotë: Qeni i keq (unë them, Lam Lami, Hojdodolja teknefese dhe Këlyshi me zgjebe i DoktorZiut ta sjellin Ujkun në Shtëpi. Mjaftë më na i hëngrët tinës qengjat me një zile në qafë varë në mes të ditës te bregu i Lumit. Koha është sot, këtë soj qenëmelezësh me zgjebe krah për krahu me buça katundi t'i lëmë përgjithmonë të përjagen e cofin pas porte me një ashtë në gojë.

Përndryshe, kurrë nuk do të ngritemi më këmbë si popull historik shqiptar. Rrugën ta vazhdojmë me shokë për në Baba Tomor. Malin e Perëndive, ku pihet vera. Tyrben ku bëhet dashuri me Hënën… Dhe, shkruhet poezi për Ditën e Nesërme Shqiptare…

1) *Grua me të meta psikike*.

## MIQTË E RRAPIT ME POEZI ERDHËN NË SHKUP

Takimet poetike nën Rrap sot fesotojnë pesëmbëdhjetë vjetorin e themelimit si manifestim kulturor i veçantë i poezisë erotike, në Shkup. Poashtu, edhe revista e pavarur letrare STILI 97 (56 numra), organ i Lidhjes të Shkrimtarve Shqiptar, që në këtë anë të Atdheut erdhi si një zë i ri kryengritës në letërsinë shqipe. Hapi dyert krah më krah edhe për krijuesit e rinj, sidomos të femrës krijuese rebele shqiptare. Sot një numër i tyre që kanë kaluar nëpër gjirin dhe djepin e Lidhjes të Shkrimtarve Shqiptar në Shkup, janë emra të njohur në Letërsinë Shqiptare mbarëkombëtare, po edhe atë botërore. Njëqind vjet shtet shqiptar nuk janë pak në këtë Ditë të Madhe. Poashtu, nuk janë pak edhe njëzet vjet veprimi të Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup. Nën Rrap ka jehuar vargu i poetëve shqiptar më të njohur anembanë Atdheut dhe botëror edhe para tytave të tanksave (2001). Nata e Madhe është përcjellur me poezi, këngë e valle deri në agim.

Nën Rrap, sonte me ne festojnë poetët e gjallë e të vdekur fizikisht kokë më kokë, siç i shihni edhe ju brez për brezi në valle me poezi. Ngrejnë dolli për Ditën e Madhe. E shoh matanë tavolinave Fredrik Rreshpen, Pano Taçin. Zyhdi Moravën, Hida Halimin, Mehmedali Hoxhën, Sadudin Gjurën, Abdylazis Islamin, Murat Isakun, Ramadan Sinanin, Daut Gurrën, Fadil Bekteshin, Shaqir Sadikun dhe qindra poetë të

tjerë të gjallë duke u nisur nga Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu me Visar Zhitin e përfunduar te Vahit Nasufi e Gani Xhafolli me shokë se si e heqin vallen e Lirisë nën Rrap. Vetëmse, nuk i shoh dudumët. Ngatërraçët e tredhur, që na janë ngatërruar rrugës nëpër këmbë dhe janë strukur sonte si lakuriqë nate e sorra të zeza nga vargu kryengritës i fuqishëm shqiptar nëpër zgavrat e Rrapit ta festojnë dështimin e tyre historik.

Lidhja e Shkrimtarve Shqiptar këtë vit festiv në Njëqindvjetorin e Shtetit të pavarur Shqiptar i organizoi dy Manifestime kulturore tradiocinale ndërkombëtar bashkë, njëri pas tjetrit: ***Takime nën Rrap*** (29, 30 shtator dhe 1 tetor 2012), në Shkup dhe ***Ditët e Humorit dhe Satirës: Xha Deralla*** (01, 02 dhe 03 tetor 2012), në Kërçovë.

Nata e parë, Ora simbolike letrare: Na bashkoi Rrapi u hap me një minutë heshtje për poetët që ikën papritmas nga mesi ynë letrar: Hida Halimi, Pano Taçi dhe Ali Podrimja. Poezia tradicionale e

Pano Tatiçit: ***Na bashkoi Rrapi*** të cilën e recitoi artisti Ali Qerimi i ngriti të pranishmit më këmbë. Kryetari i Lidhjes të Shkimtarve Shqiptar, Kalosh Çeliku i përshëndeti të pranishmit me një shkrim profetik duke u dëshiruar mirëseardhje nën Rrap. Ora letrare simbolike filloi me poezinë e dashurisë të Gani Xhafollit. Papritmas, në skenë del shkrimtari nga Prishtina Reshat Sahitaj me një poezi të poetit Agim Vinca, përkushtuar Ali Podrimjes. Prend Buzhala e shalon vargun matanë Vardarit. Fitore Gashi me dy shtamba verë del para poetëve me një poezi të "egër".

Gjon Gjergjaj me një poezi azgane i ngjitet Kalasë Dardane, në Bit-Pazar. Mëhill Vellaj ka ardhur nën Rrap nga Amerika. Pandeli Koçi pa mikun e Rrapit Pano Taçin nga Tirana, kësaj radhe me satiristin e mirënjohur shkodran Nikolla Spathari. Dashmir Malo nga Saranda me poetin rebel Xhelal Toskun. Dima Çomova me një çantë plot me punime artistike-figurative nga Bullgaria. Kosta Valetas, Iliaz Bobaj dhe Dashnor Selimi nga Greqia. Valles tyre poetike i ngjitet edhe shkrimtari maqedonas Paskal Gilevski. Skender Rusi vetë i dyti me Artur Ballin me poezinë: ***Korça ka lindur nga puthje***t. Bujar Plloshtani me një poezi filosofike nga Tetova. Seida Beganoviq me biçikletën simbolike në poezi bregut Vardarit. Beatriçe Balliçi nga Elbasani i bukur i këngës popullore. Fatmir Musai po nga i njëjti qytet i Konstandin Kristoforidhit. Remzi Salihu me një shkrim burgu për Pano Taçin. Fadil Curri nga qyteti i nemur prej turqve te kënga popullore: ***Kaçanikut i raftë pika, nantë sahat asht therë me thika***. Rexhep Bajrami nga Haraçina heroike.

Edurd Sulollari, Istref Haxhillari e Bujar Balliu krah për krahu nga Lini i Shqipërisë. Mariana Shkurti me Festim Tomorin nga Poradaci. Dhe, poetë të tjerë nga Shkupi e Kumanova si për çdo verë u strehuan si zogjë shtegëtar nën Rrap.

Vargun dikur pasmesnate e lidhin nën Rrap. Shtambat me verë i rrokullisin para syve të Hënës mbi mal. Poeti popullor kur i lutet Karadakut: ***Ulu mal, të dalë Hana***. Tri Zana nën Rrap u japin gji me shtamba. Fuqi për poezi. Shtatë sahat larg ta flugin vargun.

Ditën e nesërme, poetët ulen këmbëkryq rreth sofrës poetike. Sipas programit të paraparë nga organizatori, përgaditen t'i përkujtojnë me portrete letrare, miqtë e Rrapit: Hida Halimi dhe Pano Taçi. Reshat Sahitaj për disa çaste në mesin tonë me një poezi e ringjallë Hida Halimin***: Dhe nisem***, e hap krah më krah portën letrare. Rreth veprimtarisë letrare të Hida Halimit flasin miqtë e saj të penës: Gani Xhafolli, Reshat Sahitaj, Beatriçe Balliçi e Kalosh Çeliku. Mikun tjetër të Rrapit, pano Taçi e përkujton Pandeli Koçi. Remzi Salihu me një shkrim artistik: ***Dy net burg me Pano Taçin***. Përjashtim radhe, bëjnë miqtë tanë nga Greqia: Kostas Valetas dhe Iliaz Bobaj. Natën e Madhe ata nuk do ta presin me ne nën Rrap. Shkaku se, duhet të udhëtojnë për në Greqi. Nesër janë në punë. Librat e tyre më rrinë kokë më kokë mbi tavolinë. Përurimin e tyre do ta hap poeti Iliaz Bobaj me librin e Kosta Valetas: ***Drita e Lesbos***.

Paskal Gilevski edhe ai ka përgaditur një diskutim për librin me tregime të mikut vëlla grek. Tashti, sipas zakonit fjala i jepet edhe Kosta

Valetas. Reshat Sahitaj i përkthen fjalët e tia nga gjuha frënge. Shkrimtari i madh grek gjatë diskutimit i lëvdon shqiptarët duke thënë se janë vëllezër me grekët. Thotë: Unë i dua patriotët dhe nacionalistët, po jo edhe shovenistët e pushtuesit. Radha i mbetet poetit Iliaz Bobaj me librin e tij satirik: ***Kali i pushtetit***, që posa ka dalë në dritë nga Shtëpia Gazetare Botuese "ASDRENI", në Shkup.

Rreth librit flasin Pandeli Koçi dhe Prend Buzhala. Në fund e merr fjalën edhe vetë autori. Përgëzime. Urime.

Gjatë kësaj nate bëhet edhe përurimi i dy numrave më të ri të revistës letrare: ***STILI 97***, përkushtuar njëri Mikes të Rrapit, Hida Halimi dhe tjetri Mikut të Rrapit Pano Taçi. Fjalë miradie flet kryeredaktori i revistës, Kalosh Çeliku.

Pasmesnate, juria profesionale e përbërë nga Reshat Sahitaj (kryetar), Remzi Salihu (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndanë edhe çmimet letrare: Për vepër jetësore e rrëmben shkrimtari Kosta Valetas. Tjetrin, për vepër erotike e fiton poetja nga Elbasani Beatriçe Balliçi. Një çmim Mikja e Rrapit i ndahet edhe poetes bullgare Dima Çomova. Çmimi i poezisë erotike kësaj radhe i jepet poetit Fatmir Musai.

Agimi më ka zbritur me të dy këmbët në Shkup. Poetët i pret rrugë e gjatë për në vendlindje. Satiristët i shalojnë kuajt e shalës për në Kërçovë, në Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA. Plaku mjekërbardhë si dikur me shkopin me kërrabë përpara këmbëve u kadalë para te porta me anekdota...

## XHA DERALLA NA E HODHI EDHE KËSAJ RADHE

Nga Shkupi pas Takimeve poetike nën Rrap, erdhëm në Kërçovë. Dhe, e pyetëm një plak para porte në fshatin Cërvicë: O plak, ku është "Çifliku i Xha Derallës"?

Plaku u ngritë më këmbë me gjithë mjekrën e bardhë dhe shkopin me kërrabë. Mirëse erdhët, gra e burra! "Çifliku i Xha Derallës" është në Kërçovë, tek ajo Çuka pas malit, drejtoi plaku në vend të gishtit tregues shkopin. E shihni atë Çukë në mes të Qytetit? Atje, është "Çifliku i Xha Derallës".

Po, i thamë ne gati njëzëri. Faleminderit, plak. Dhe, morëm rrugën krah për krahu për te "Çifliku i Xha Derallës".

Rrugës e takuam drejtorin e Muzeut të qytetit, Ilmi Veliu. I thamë, jemi nisur për te "Çifliku i Xha Derallës". Qeshi. "Çifliku i Xha Derallës" është afër Përronit të Thanës, në fshatin Cërvicë. E, kush ju dërgoi në këtë anë të Kalasë Kërçovës?!

Një plak me mjekër e kësulë të bardhë në kokë.

Përsëri qeshi, drejtori. Ai ka qenë Xha Deralla. Përmëtepër, ju paska mashtruar, ka bërë pak shaka edhe kësaj radhe me poetët.

Nuk prish punë, i thamë ne si burrat. I kuptojmë dhe i duam mashtrimet dhe shakatë e Xha Derallës. Po, vështirë e kemi t'i duam dhe kuptojmë "anekdotat" e politikanve.

Ilmi Veliu, drejtori i Muzeut të qytetit aty për aty doli me një propozim: Meqenëse e keni bërë gjithë këtë rrugë, mos të ju shkojë mundi kot, pasi ta vizitojmë Muzeun e Luftës, do të ngjitemi edhe deri te Kalaja e Kërçovës.

Moti, qysh në fëmijëri kisha dëgjuar se kalaja e dytë më e bukur në Ish Jugosllavi. Vite me radhë edhe isha ngjitur dhiareve, qoftë pas ndonjë rrunze azgane, qoftë pas organizimeve të shpeshta muzikore të asaj kohe duke e përcjellur natën me rokenrol nëpër disko-klube.

Përçudi, si kishte ndodhur që kaq gjatë kohë të mos e kisha vizituar Kalanë e Kërçovës. Fajin me siguri e kishte koha e studimeve në Prishtinë. E më vonë, edhe arratisja ime si mësues në Drenicë e Malësinë e Shkupit.

Krah për krahu si poetë iu ngjitëm Kalasë Kërçovës. Rrugës herë pas here Ilmi Veliu na rrëfente gjurmë të gurëve ilir që ende nuk i kishte hëngër dhëmbi i kohës. Aty-këtu edhe ndonjë birë shuli në mur me të cilin ilirët e kishin mbyllur derën. Kalanë e Kërçovës e kishte shkelur edhe këmba e serbit, edhe e romakut, edhe e turkut, edhe ajo e partizanëve. Secili në këtë kala i kishte lënë të thella gjurmët deri në ditën e sotshme si pushtues. Vetëm, unë e mbaja në mend fare mirë Kalanë e pas Luftës së Dytë Botërore, kohën e "artë" komuniste, kur ajo kala - parajsë ishte e rregulluar bukur dhe mbuluar me lloj-lloj lule. Fontana e karrike druri në çdo pesëdhjetë metra.

Ecëm edhe pak në heshtje rrugës. Unë mendova me vete, me siguri do t'i shohim matanë pishave sheshet me lule.

Edhe pak, arritëm te përmendoret e dëshmorëve partizanë. Habia e radhës: Ndonjëri pa kokë. Tjetri pa këmbë. Ibe Palikuqi kishte "ikur" me gjithë trup e kokë. Aty për aty mu kujtua edhe përmendorja e Skënderbeut që pas lufte trimat kërçovar e kishin hipur në kala. E më vonë, pas prishjes së miqësisë shqiptaro-jugosllave, e kishin tërhequr pushtetarët për shkaqe politike. E kishin futur në një kasollë të fshehtë brenda kalasë. Që, unë gjatë shkollës së mesme sa herë që ngjitesha me shokë në kala, e vizitoja tinës dhe e shihja se si "bënë" gjumë shekullor heroi ynë legjendar Skënderbe i strukur në Kala.

Vite më vonë, më kotë shkoja me shokë te kasolla e Kalasë, Skënderbeu nuk ishte më në atë vend, nuk kishte as nam as nishan siç thotë populli. Natën ia kishin ndërruar shtëpinë. Edhe, pyeta për fatin e tij, nuk e dimë mu përgjigjën rojet e Kalasë. Një përgjigje të tillë merrja edhe nga miqtë e penës. Njëri ma bëri me dije se, pas ndryshimeve demokratike politike e kishin bërë edhe një kërkesë deri te partitë politike shqiptare që ta kthejnë përsëri përmendoren e Skënderbeut në kala. Por, ata u ishin përgjigjur: Përmendoren e Skënderbeut do ta lëmë për më vonë, kur t'i vijë dita.

Tashti, edhe e shoh realitetin me sy, pse Xha Deralla na paska dërguar në Kala të Kërçovës. "Çifliku i Xha Derallës", kur ne e vizitonim si fëmijë me dhenë, ishte plot ferra. Vështirë nga aty nxirrnim ndonjë shkop thëne. Ose fyell shtogu.

Banorë të atij çifliku me nam ishin: zogjtë, laraskat, sorrat, korbat, breshkat, zhapinjt,

gjarpërinjt dhe boat e rrezikshme. Edhe Kalanë e Kërçovës, ne poetët për dallim nga dita e djeshme komuniste, sot e gjetëm plot bërllok dhe ferra. Asnjë lule, asnjë fontanë, asnjë karrike. Llambat elektrike të rrëzuara në tokë. Terri i kishte rënë mbi kokë. Fatmirësisht, e kishin nxjerrë një zorrë gome ku rridhte uji i ftohtë për kalimtarët e rastit. E dikur, këtë kala e vizitonin grupe turistësh nga e gjitha bota. Kokëulur u kthyem të dëshpruar në hotel. Pas dreke, dhe pushimit të mesditës, e pamë se kush kishte qenë Xha Deralla. Humoristi dhe satiristi madh, që edhe malin me dardha gorrice e kishte shartuar me dardha verore.

Pasdarke, nga malli për humanistin ne e shaluam fantazinë. Për disa çaste e sollëm Xha Derallën në mesin tonë me humor dhe satirë. Orën simbolike satirike e hapi Ibrahim Koça me poezinë e Ali Asllanit: *Hani, pini dhe rrëmbeni*. Vëllezërit Dervishi i përshëndetën të pranishmit me këngën kërçovare: *Në bahçe na ka ra bryma*. Lumturi Axhami i dha zjarr e flakë me një këngë dasme. Poetët, pas saj e morën Natën e Madhe në dorë me humor dhe poezi satirike. Njëri pas tjetrit lexuan poezi, rrëfyen barcoleta, edhe anekdota. Dikur, çetës së tyre i erdhi në ndihmë edhe Xha Deralla me anekdotat e tij të egra: *Hoxha i katundit*, *Pajtimi me Kolibaret* dhe *Xhandarët e serbit*.Ditën e nesërme, u bë edhe përurimi i dy librave të satiristit kërçovar Begzat Rrahmani: *Gjarpërinjtë e fushës sterile* dhe *Eunukët e Haremit*.

Rreth krijimtarisë letrare të autorit dhe librave diskutoi Bekim Adili. Poashtu, u bë edhe përurimi i numrit më të ri të revistës për humor

dhe satirë, që del kur t'i teket ZEKTHI. Tryeza satirike kërçovare u shtrua në mesin e poetëve: ***Humori dhe satira brez pas brezi e mbajtën gjallë popullin heroik shqiptar në mes të Ballkanit.*** Atmosferën e ngrohtë satirike e ndezën me diskutimet e tyre rreth humorit dhe satirës nëpër shekuj. Në fund, Tryezën satirike e përmbylli artisti i madh strugan Pajazit Murtishi, që kishte ardhë nga Amerika me një fragment të poemës Naim Frashërit *Bagëti e Bujqësi*.

Nata e Madhe kërçovare i hapi dyert krah më krah me humor, satirë dhe këngë deri në agim. Poezitë e tyre i lexuan poetët: Gani Xhafolli, Pandeli Koçi, Nikolla Spathari, Begzat Rrahmani, Xhevdet Ukalli, Bujar Plloshtani, Fatmir Musai, Remzi Salihu, Xhelal Ademi, Ilmi Veliu, Ibrahim Koça dhe Kalosh Çeliku.

Pasmesnate, juria profesionale e përbërë nga Reshat Sahitaj (kryetar), Remzi Salihu (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndau edhe çmimet letrare: për vepër jetësore satirike Nikolla Spatharit, për vepër satirike Iliaz Bobaj dhe për poezi të egër satirike gazetarit dhe humoristit Ibrahim Koça (Date Koçi).

Dita tjetër e nesërme, poetët i përcolli disa në Qafë Thanë, disa në Tetovë e Shkup. Gani Xhafollin në Prishtinë tek 33 dashnoret, që dikur ia rrëmbeu UÇK –ja e pas lufte ia ktheu që të gjitha në numër, në Prishtinë. Vetëm satiristët kërçovar mbetën në Kërçovë me Xha Derallën.

Që, vitin e ardhshëm, përsëri të na e shtrojnë sofrën e miqësisë te "Çifliku i Xha Derallës" pranë Përronit Thanës, në fshatin Cërvicë…

## RRAPI MË NDJEK SI HIJE ANEMBANË ATDHEUT

Vite pas lufte, kur linda në Katund (1951), Babai e nxori mauzerin nga hatullat dhe shkrepi pushkë. E paralejmëroi Katundin për ardhjen time në jetë. Ende vendit i vinte era barot. Frikë e varfëri, që mezi e përballonim me punë rrëzë Çukës. Arat duke i mbjellur me drithëra e kullotur bagëtinë te Përroni i Thanës. Nën dardhat gorricë te Çifliku i xha Derallës i bienim fyellit me shokë. Qeni Murgo i çonte veshët përpjetë, herë para e mbrapa duke hedhur sytë matanë dëllinjave. Ujku na ndiqte ferrë pas ferre edhe ditën, edhe natën si „mik“ shtëpie.

Kohë e keqe ajo, kur zvarritesha pas bishtit të Sagjinit. Kaut Zi që gjatë pushtimit fashist, nën hijen e Lisit midis livdhit i rrëzoi në tokë me brirë tre ushtarë pushtues gjerman. Vërtet, ushtarët tjerë të trembur e kositën me automatik, po ai ra dëshmor nën hijen e Lisit, i doli zot livadhit rrëzë Çukës. Hije e cila do të më strehojë gjatë gjithë fëmijërisë në Katund. Nën atë Lis për herë të parë u takova edhe me Rilindësit tanë: Naimin, Fishtën, Asdrenin, Çajupin, Luigj Gurakuqin, Ndre Mjedjen, Filip Shirokën, Ali Asllanin, Nolin e Madh... Vjershat e tyre më mbanin për dore, rritën me rrezet e Diellit që zbriste nga Çelëvjollca. Në një Libër të këndimit me të cilin kishte mësuar Vëllai në shkollë, gjatë kohës kur ministër i arsimit ishte Ernest Koliqi për herë të parë e pash në fotografi Korçën. Qytet i madh mu duk në atë kohë me shtëpitë çati më çati.

Nuk e di pse?! Ndoshta, pse unë përveç katundit tim dhe Kërçovës, nuk kisha parë qytet tjetër, apo?! Vetëm, një gje e dija dhe e kisha të qartë: Korçën, shkaku kufijve politik dhe kulturor mund ta shihja vetëm në fotografi, ose ëndërr. Ajo kohë ishte e atillë, na i kishte lidhur sytë e këmbët, shtupuar veshët me pambuk në Atdhe. Tinëz e dëgjonim Radio Tiranën dhe Radio Kuksin. Librat e këndimit bashkë me armët e trashëguara brez pas brezi i fshihnim hatullave. Herë pas here mbi bombat e italjanit që padashtas rrokulliseshin në kashtë, kërcenim mbi to sikur të ishin topa llastiku. Ne u rritëm me „lodra“ të rrezikshme nëpër duar. Zoti na ruante nga rreziku, por kishte raste kur ne duke luajtur me ato „lodra“ të rrezikshme nga pakujdesia të fluturonim si zogj të plagosur në hava. Fatkeqësi të tillë kobëzezë patën dy shoqet e klasës, të cilat duke luajtur me ato „lodra“, një ditë fluturuan në qiell. Njëra vdiq, ndërsa tjetra u plak pa një sy dhe pa një dorë si invalide. Gjatë kohë vendi i tyre mbeti i zbrazët në klasë. Më kot me sy i pritëm te dera, të hynin në klasë. Ajo ditë nuk erdhi kurrë. Edhe sot e kësaj dite, ajo fatkeqësi nuk më hiqet nga sytë dhe mendja.

Tjetër stuhi frynte në atë kohë, e tjetër erë fryn sot në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012). Fati mes rreziqesh më ndoqi këmba-këmbës në jetë . Gjiri i Nënës më dha fuqi për luftë me penë. Gjatë kohë e kam pirë tambëlin e Nënës. Krahas librave të këndimit në shkollë, nën hijen e Lisit midis livadhit më priste edhe tambëli i Nënës. Ende më kujtohet rasti, kur një ditë Nëna u përpoq të më

ndajë nga gjiri. Erdha me lopët nga kullosa e Livadhit të „Pukoshtës“ pas porte dhe si zakonisht bërtita ende pa hyrë në lëmë: Nënë, dua tambël! Përçudi, kësaj radhe Nëna më priti në mes të lëmës me një përgjigje hutaçe: Sisën, sot e ka marrë Buba. E hapi jakën e këmishës duke ma treguar një leckë të zezë çerepi. Aty për aty iu përgjigja: Unë Bubën do ta vras me shkop! E nxora leckën e zezë me shkopin që e kisha në dorë duke e hedhur matanë gardhit. Dhe, në mes të lëmës iu sula gjirit të Nënës si qengj. Javë të tëra do të vazhdoj të pi tambël Nëne, përderisa një ditë nuk do ta braktis vetë atë fuqi Zane. Përkundër asaj, që ndonjëherë si bari i deleve te mrizi i dardhës gorricë i futesha si qengj edhe Deles Rudë. E, më vonë kur u rrita pak, edhe cucave azgane. Shprehi të cilën nuk mund ta heq qafe edhe sot e kësaj dite.

Ditët, javët dhe vitet iknin shpjetë, e unë rritesha nën hijen e Lisit midis livadhit me vjershat e xha Naimit me shokë. Shkaktarë, që më nxitën t'i hedh në letër edhe vargjet e parë për dallëndyshen dhe lejlekun në çerdhe majë lisi mbi çati. Vjersha të cilat në atë kohë do të shohin dritën edhe te „*Flaka për fëmijë*“. Vjersha tjetër, „*Bilbili shkruan*“ veç më paralajmëronte se në Letërsinë Shqipe vjen një poet me *Librin për Nesër*. Hapat e parë ishin ato, që unë dita-ditës me penë në dorë e libra në krah, ngjitesha maleve te Lugu i Ymerit. Përderisa, një ditë do ta braktis Lisin e mjedis livadhit dhe Katundin. Mësimet e shkollës së mesme do t'i vazhdoj në Shkup.

Ditët e para e pata vështirë të adaptohem me këtë mes të ri dhe qyetet, që pasi e kishte

rrafshuar tërmeti katastrofal me tokë, përsëri lëshonte shtat rrëzë Kalasë Dardane. Shkaku, se: vija nga Katundi rrëzë Çukës, Lisi i midis livadhit, Përroni i Thanës dhe Lumi i Zajazit. Verës, ku kërcenim për t'u freskuar nga vapa njëri pas tjetrit bythekrye në hurdhë. Megjithatë, koha e bënte të veten, dalngadalë unë padiktuar po ia ktheja shpinën vendlindjes. Vetëm gjatë stinës së verës kthehesha në Katund. Vjeshta, përsëri më hudhte nga qyteti në qytet.

Vitet e studimeve, më vonë thuaj se do të më largojnë plotësisht nga Katundi. Nuk e dija pse më dukej se bëja jetën e lejlekut, kthehesha me pranverën dhe ikja me vjeshtën. Dimrin e prisja larg vendlindjes, edhe atë në Prishtinë. Qytet me verë të thatë pa lumë e me dimër të ashpër me borë. Vapa kur të rrokte për fyti e bora t'i lidhte këmbët nye. Megjithatë, unë më isha mësuar me vapën dhe borën. Lisi midis livadhit më mungonte në këtë qytet. Patjetër, duhej gjetur një lis tjetër edhe në këtë qytet. Edhe, e gjeta: Përpara „Bozhurit“. Studentët edhe e pagëzuan: „Druri i Kaloshit“. Gjithë takimet e asaj kohe, i lenin te „Druri i Kaloshit“.

Dhjetë vjet me gjithë studime do të strehohem te „Druri i Kaloshit“, përpara „Bozhurit“. Vite këto, edhe kur do të afirmohem si shkrimtar. Papritmas, një ditë do të kthehem me punë të jetoj në Shkup. Malësia e Shkupit do të më bëj shkrimtar. Librat më të mirë për fëmijë i shkruajta mes këtyre maleve.

Vetëm, më mungonte Lisi midis livdhit, që kudo që shtegëtoja e bartja me vete qytet më qytet. E kisha një në Katund, një tjetër në

Prishtinë. Patjetër, duhet gjetur edhe një në Shkup. Edhe, e gjeta: Rrapin mes Çarshisë në Bit-Pazar. Vend, ku do ta lidhja gjokun pullali. Armën do ta varë në një degë. Nën hijen e të cilit do ta pi verën, shkruaj poezinë dhe pres Miken. Vit për vit me miqtë poetë me poezi do t'u biem përmes sokaqeve të Bit-Pazarit.

Vendlindje të dytë, pas vdekjes klinike në Voskopojë dhe ringjalljes po të njëjtën ditë në Korçë (2000), e kam Korçën. Për çdo vjet i trokas te porta si mik gjatë festivalit Netët Korçare të Poezisë. Qytet mikpritës, që ma hap derën krah më krah me poezi. Përveç Lisit midis livadhit, mua më ndjek edhe fati si poet. Në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, që nga ky vit unë do ta kem edhe Drurin tim të poezisë (Rrapin e Ri), në Korçë. Gjatë festivalit Netët Korçare të Poezisë më jepet edhe çmimi letrar: Kurora e Poezisë „Korça 2012".

Falemnderit, Korçë! Vendlindja ime e dytë e poezisë... Miq poetë...

## KOPILAT QË I POLLI XHADIA DHE NA I LA PAS PORTE

Moti merrem me studimin e veprimeve "patriotike" dhe karakterin e rrumaducëve shqiptar. Veçanrisht, me ata "patriotët kuqezi" dhe hoxhalarët që e fshehin veten nën petkun fetar. Njerëzit e sotshëm me tru të moçëm, siç ka thënë Filip Papajani. Ose, Teki Dërvishi: Xhamitë janë fabrika për prodhimin e turqve. Shkurt, me çallama turku në kokë ose lecka arabe e jo me kësula të bardha të Bajram Currit. Nesër, ndoshta edhe do ta mbroj temën e disertacionit me këtë punim-zbulim shkencor. Vetëmse, jo në univeristet tona, po në Oksford, Howard ose Serbonë. Përditë e pasuroj me risi dhe ide matanë malit te Përroni i Thanës. Çifligu i Xha Derallës. Gjurmët e tyre më shpiejnë pas Shtëpisë, në Hale. Vendi ku rritet me të madhe dhe lulëzon ky soj "luleje xheneti". Shtat lëshon mes krimbave në shoqërinë shqiptare.

Nateditë i shtrydh trutë me dorë. Përpiqem të them diçka të re për rrumaducët. Lëmsh shkoj në shtrat. Ëndrra shoh të tmerrshme. Jerm flas pasmesnate. Xhindet më rrahin gjithë natën, më hedhin dorë më dorë majë lisave. Çative të shtëpive. Pak para agimit më kthejnë si dikur kur isha fëmijë në shtrat, mes Nënës dhe Babait.

Asgjë nuk kam të them diçka të re për rrumaducët. Kopilave, që ua dimë Nënën, po jo edhe Babën. I kam thënë të gjitha nëpër librat e mi artistik dhe me publicistikë letrare kokë më kokë në bibliotekë. Problemi është se, rrumaducët

nuk lexojnë libra, po e kalojnë kohën nëpër çajtore dhe "bibliotekat" e partive politike. Rrezik i madh ky për popullin shqiptar në këtë shekull.

Edhe vazhdoj t'i shtrydh trutë nateditë. Kokës t'i bie me grushta. Rrumaducët, them me vete i di e gjithë bota si farë e keqe hithre që na mbiu edhe nëpër arat tona rrëzë maleve. Nuk ka nevojë dhe dobi të humbësh kohë me ta si fenomen i çuditshëm shqiptar. Kancerin e kanë në tru. Përmëtepër, janë pacientë me virus të pashërueshëm komunist. Mjek nuk gjendet në këtë botë që mund t'i shërojë këta eksponentë të "vëllazërim-bashkimit". Sëmundjen e tërbimit me vite e kanë në gjak, shpirt e tru. Sojin e këtillë të përflakur nga xhindet e shëron vetëm Zonja Vdekje.

Shkak ky, që publikisht heq dorë nga shërimi i rrumaducëve. Nuk ka ilaç, as hajmali që i sjellë në "din e iman", janë të pashërueshëm me diagnozë të pashpresë neokomuniste. Nuk i shëron dot mjek e as hoxhë me ndonjë hajmali përqafe. Plakat më kot mund t'ju fryjnë mbi ndonjë enë me ujë plot thëngjij të shuar e eshtra të vdekurish. Babashehu, moti ka hequr dorë nga soji i tyre dhe u arratis në Baba Tomor. Thotë: këtij soji të "gjetur" përpara Shtëpisë te pragu i derës me tokmak në kokë u ka rënë Dexhalli. Nuk e dinë ku e kanë kokën e ku bythën. Rrugës nuk ecin me kokë në qafë, po me bythë.

Përditë përjagen para dyerve të partive politike. I shkojnë pas Dashit me brirë mos i bien udhës. Ose, ndonjë partizani partiak me yll të kuq në ball mos rastësisht ua hedhë ndonjë ashtë pas

porte. Turren me të katra pas torbës me taxhi. Jo, se e kanë barkun e urët, po për atë se nuk u fryhet syri. Bërrylat i përdorin në ndarjen e taxhisë. Me këmbë e duar i sulen grazhdit të partisë politike. Brirët i vënë në përdorim për rrëmbimin e ndonjë kocke ose koshi me kashtë në Lëmë. Ndodhë, t'i nxjerrin edhe armët kur është në pyetje taxhia. Kohën e fundit siç duket kanë edhe simptome tërbimi. Komente sakate më shkruajnë në mjetet e informacionit: me dhunë duan të më bëjnë edhe hoxhë. Ku ta di unë, ndoshta edhe prift. Dosje policore më shkruajnë në Facebook duke pi çaj rusi me këmbët dhe trutë në legen. Ndihmë më dalin duke më dërguar përmes faqeve të internetit, merreni me mend edhe viagër. Falë Zotit dhe Natyrës ende nuk e përdor deri në këtë ditë. Ndoshta, më vonë do të më hynte në punë për ndojnë plakë, por jo edhe për cucat e reja azgane me dy shamia lidhur për brezi . Përçudi, kur nuk më dërgojnë edhe pak drogë, ndonjë vijë ose cigare. Ec, e mos i duaj të mjerët me këmbë e tru në legen. Nuk harrojnë të më përcjellin me thashetheme përmes internetit edhe ndonjë shishe raki rrushi se, "mu ka tharë fyti". Urime, dhe faleminderit. Tashti, paskeni rënë në "din e iman".

Mërziten për mua se kam "falimentuar", e kam shitur gjithë tokën e Babait dhe nuk kam më çka të shes, më ka mbetur edhe një mal me lisa. I lumi unë, që ma bajnë gajlen trusakatët e Allahut. Edhe kush, bërlloku shqiptar që për arsimin dhe kulturën shqiptare nuk e ka dhënë as edhe një kafe. Dudumët që janë nisur të shpërngulen si

"turçeli ehamdurila" në Turqi dhe, pasi Turqia e prishi marrëveshjen me Serbinë na mbetën nëpër këmbë si ferra halldupi në Shkup. Rrufjanë, që pas rënies së Rankoviqit ikën me gjithë dhenë nga Kosova. Erdhën ta ushtrojnë zanatin e vjetër të spiunimit, ta shesin veten një vend pune, një nënshtetësi. Vëllezërit e tyre kosovarë që nuk e pranuan këtë profesion edhe sot e kësaj dite janë pa nënshtetësi maqedonase. Në kulminacion të tërbimit më shkruajnë komente anonime, pavetëdije se e zbulojnë veten para meje dhe lexuesit me emër e mbiemër si rrufjanë shqiptar. Përpiqen të më rrëfejnë përralla arabe. Anekdota popullore. Përsëri, pa vetëdije se janë rritur e ushqyer me ilahi arabe:

*Me duket se kjo vlen per kete njeri qe vetem shane e nuk ka asgje artistike te mesojne te tjeret nga ky palaqo i vetshpallur shkrimtar me raki ne dore.*

*2*

*Me nje fshat, kishte pas qene njeri qe kishte bere shetitje gjithandej botes, ne nje ndeje te odave, i thoni bariut te "famshem" te fshatit, trego ti bari si roktar ka ke qene, bariu ja nis, po te guri bardh, te mexha avdise, te duqani shevalit, e ky i shetitur i botes i thote, une kurre s'kam qene ne keto vende, cilen planete kokan.*
*edhe puna e ketij shkrimtari qe si shitet asnje liber, qe ska asfare imagjinate dhe dije, paska qene Prishtine, Tirane dhe Shkup (hahaha)*
*Pse nuk e di Shkupin, ky i mjer, si kemi faj, nuk ta zene per te madhe shkupjanet, as me pak Karadaku i Shkupit, mos harro i thone Karadaku i Shkupit, jo i Kosoves dhe Turqise, mos harro poashtu Karshiaken, Dervendin, ndaj mire te kane thene se je kodosh,*

*spiune, kopil serbie, per moral as qe duhet te flitet, ngase mbi Kercoven tende kane kaluar krejt pushtuesit duke hyp e zdryp mbi erzin tend te namuzit, qe e bejne njejte edhe sot.*
*Ti nuk je shkupjan, as i karadakut, as i karshiakes, te je spiun dhe kopil serbi, qe nuk dallon me asgje, ndaj nuk e di fetvan e hoxhes se alllahut, Ataullah Hoxhes, zoti e past meshire, "mos shko Turqi se behesh shka"*
*ti je nje hordhuce qe vetem leh si qen, e per dite rri me shkije matan ures me msitni mos po te lshojm naj koce qeni per naj liber te sharjeve tua mbi xhamite e shkupit. Kjo eshte e verteta jote o kopil serbi.*

Përshesh me kos, si vetë autori i këtij komenti teknefes. I mjeri Hoxhë i Allahut, që në trup e shpirt nuk ka të veshur asgjë shqiptare. Lëmsh i bënë fjalitë, mendimet, shenjat e pikësimit. Nuk e di gjuhën shqipe. Përmëkeq, në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012), në shekullin XXI, përpiqet të na shesë dushkë për gogëla.

Serbia gjithmonë i ka dashur dhe i do hoxhallarët e sojit tënd dhe xhamitë turko-arabe. Serbia nuk e do xhaminë shqiptare dhe hoxhallarët shqiptar me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë dhe abetare në gji të Kostandin Kritoforidhit. Dudumëve, që në vend të hajmalive, sot erdhi koha t'ju varim nga një këmbonë të grisur deleje për qafe. Përmëkeq, si buba leshatuk lehin pas Ujkut, nuk e dinë gjithë pasurinë time të patundshme si trashëgim që ma la Babai. Përderisa, ata zvarriten me vite më këmbë e bark mes avlive, unë rrugët e Shkupit dhe Atdheut i shëtis me xhip. Edhe deri më tani i kam pasur makinat e rralla, që rrugëve të Shkupit janë numruar në gishta.

Jetën time të bujshme që e kam pasur unë gjatë këtyre viteve të jetës sime në Kërçovë, Prishtinë e Shkup, ata nuk e kanë parë e nuk do ta shohin kurrë as në ëndërr. Hoteleve dhe salloneve aristokrate, kur unë ju kam rënë si kaçak mali përmes Sarajeve të Pashës, ata gjatë asaj kohe nga gëzimi e kanë fërkuar barkun me dorë e lutje drejtuar Allahut (Zotit), para legenit me përshesh me kos. Dudumët e Allahut, që parashohin dhe kërkojnë publikisht që unë të bëj vetëvrasje. Ndonjëri shkon edhe më larg, pas teravisë para këmbëve të Hoxhës Allahut, dëshprohet me mua si shkrimtar duke kërkuar ndihmën e nobelistëve me prejardhje shqiptare. Askushi nuk tha se, nobelistët me parejardhje shqiptare nuk i kanë shërbyer mbarë njerëzimit. Gjest human ky, edhe shumë më i madh shqiptar, që rrallëkush e ka ndonjë popull tjetër në botë. Dhe, mirë që i kemi këta dy nobelistë si pasuri kombëtare. Dhashtë Zoti e kemi edhe një Ismail Kadare, ose ndonjë tjetër personalitet shqiptar. Populli shqiptar është i pasur, gjithmonë i ka dhënë botës dhe i jep ende personalitete më shumë se vetvetes nëpër shekuj. Fjalën e kam pasur dhe e kam në tjetër vend, se këta nobelistë me prejardhje shqiptare shumë pak kanë bërë për popullin shqiptar, Shqipërinë. Përjashtim këtu bën Ismail Kadare, nëse e merr një ditë çmimin Nobel. Edhe, do të di se ku do të investojë për çështjen e pazgjidhur shqiptare.

Lexuesin tjetër "besnik" e paskam "marrë" më qafë me shkrimet e mia publicistike e letrare: *"I nderuar po ju shkruaj ngase nuk shoh ne vargun tend ate qe mendoja se jeni.me vjen keq se paskam genjyer veten.*

*I nderuar separi fillon te qortosh dikend pore pa emer.Nese din diçka emro thuaju lexuesve kush esht.mandej ngushtoni vargun nga shumica e disave dhe treteni ne figure te dikushit.per mua esht vetem çeshtje personale i nderuar dhe çeshtjen personale nuk mund ta hudhish ne shumice ne problem kombetar apo kush e di se òka tjeter.*

*...*

*me vjen keq per kete shkrim qe shkruaj pore metevertete kam qen i genjyer per ate qe kam pas mendimin tim shum pozitiv shum kombetar dhe shum poet e kush e di se çka.. Me shprese ne mirekuptim vellazeror Mireqofshi".*

Përfundimi, edhe si përgjigje lexuesve të mi "besnik": Moti e kam lënë profesionin e mësuesit, që në kohën e sistemit komunist. Nuk mund t'i mësoj sot dudumët shkrim-lexim. Përmëtepër, me abetaren e Kostnadin Kristoforidhit. Edhe, po të dua është shumë vonë, t'i kthej në klasë të parë me nga një fletore, laps e abetare mbi bangë. Gomë nuk u duhet këtyre "gjenive" turko-arab. Shumica janë me diploma universitare e tituj shkencor të blerë në Bullgari e Qafë Thanë. Kohën e fundit edhe nëpër universitetet e "vëllazërim-bashkimit". E kam thënë disa herë nëpër shkrimet e mia se, unë nuk merrem me individë, po me fenomene shqiptare. Përinat timin, dudumët ngulin këmbë, kërkojnë t'i pagëzoj me emra shqiptar. Mirë them, po unë nuk jam prift e as hoxhë. '

Edhe pse, të gjithë ato personazhe të potretizuar artistikisht nëpër shkrimet e mia kanë emra e mbiemra. I dinë dudumët se kush janë këta melezë, u shkrua shqip në ballë. Qëllimi im nuk është nëpër shkrimet e mia ta gjej veten vetem një individ, po më shumë "burra" mejdani me "armët" në brez për Liri. Edhe, siç e shoh unë e gjejnë këmbekrye veten mes atyre rreshtave. Përgëzime! Atëherë, pse ngulni këmbë t'i emëroj heronjt e mi të dashur, mos vallë me përmendjen e personazheve të mi artistik mes faqeve në Librin për Nesër, ju mund ta shpëtoni veten nga Përmbytja e Madhe. Jo. Nuk ka njeri të gjallë që mund t'ju nxjerrë nga ky batak ku keni rënë këmbekokë. Gabim i madh, nëse nuk keni ditur të më lexoni mes rreshtave dhe dilni me përfundime 'patriotike-profetike" si Hoxha i Allahut. Personazhet e mi të arratisur, unë nuk i urrej, po i dua marrëzisht si trima pas lufte. Përsëri, nuk më dëgjoni me veshë, nuk më lexoni me sy nëpër shkrime publicistike e libra në Ditën e sotshme të Motit Madh?! Ose, më dëgjoni e lexoni, po fatkeqësisht me shqisa të tjera mos ua përmend këtu emrin, sidomos asaj që e keni zgjedhur në vend të kokës.

E keni gabim. Tekefundit, më vjen mirë që më shani, reagoni e ofendoni si pa kokë nën shkrimet e mia publicistike. Nuk dua të më lëvdoni për së gjalli, po të më shani e ofendoni sa të mundeni me gjithë fjalorin e juaj sakat që posedoni të rrugaçit. Shkaku, se: Rreziku më i madh për një shkrimtar është, lëvdatat për së gjalli. Vërtet po ma kënaqni lapsin, nuk keni ju faj si lexuesë të

dëshpruar, po unë që nuk kam më shumë kohë të merrem me dyluftimet dhe "flijimet e juaja artistike". Heqi maskat patriotike nga fytyra dhe t'ua hedhë si cungje shelgu para këmbëve në baltë. E di, dikushi do të kërkoj në vend të maskave patriotike, kokën t'ua hedhë para këmbëve, po jo: unë nuk jam kriminel e as xhelat shqiptar. Shpatën moti e kam zëvendsuar me penë. Luftën e urrej, po jo atë me penë. Vend nuk do t'ju lë rrumaducëve për së gjalli ta fshehin kokën garroçe si "patriotë kuqezi" as nëpër parti politike. Vendin e kanë në hale. Nesër, pas vdekjes do t'ju ngrihem Lugat nga varri me gjithë libra. Soj i keq që na e prishët edhe gjakun.

Publikisht heq dorë edhe nga disertacioni i doktoraturës. Rrumaducët nuk janë objket i denj studimi për penën time rebele. Shkaku, se: Nëna Parti ende vazhdon të ma nxjerrë para të më pri gomari me gjithë samar në shpinë. E, ku mund t'i pri gomari fisit të kaçakëve?! Fisit që brez pas brezi me mauzerr për qafe e kalë me shalë janë ngjitur maleve për Liri. Fat i rrumaducve, që sot ky fis nuk e kap për kërpeshi në mes të udhës këtë coftinë me samar e taxhi në grazhd dhe ta hudhë bythekrye në përrua. Gomari, që edhe pse me profesion është hoxhë, tollumbaxhi ose rrugaç kuqezi, merret edhe me vlerësimin e kulturës dhe letërsisë shqipe. Burri i grave vendos për vlerat artistike të letësisë shqipe në Minstrinë e Kulturës. Planprogramet shkollore. Tekstet shkollore. Lektyrat shkollore. Letërsinë maqedonase „Makedonska knizhevnost".

Enciklopedinë maqedonase. Partizançe me direktiva partiake vendos për blerjen e titujve të

librave me vetëfinansim të shtëpive botuese nga Ministria e Kulturës. Në mes të udhës, në pluhur shtrihet dhe pellet për liri kombëtare. Flamur kuqezi. Gjuhë shqipe. Shkolla shqipe. Letërsi shqipe. Histori shqiptare.

Edhe, rrumaducët shqiptar në konkursin e shpallur të Minsitrisë së Kulturës nuk e blejnë "Xhadinë" për nevoja të biliotekave, lexojnë dhe shohin veten se si mrizojnë kokë më kokë nëpër institucionet maqedonase (Dardhat gorrice). I blejnë titujt e librave të miqve, familjes dhe klaneve të tyre partiak, me vlera të skaduara arnë përmbi arnë ose të dyshimta artistike. Shpërblimi i fundit i pret pas dere. Zoti u ndihmoftë!...

## QYSH KA DITUR ME E BË ZOTI KAQ BUKUR SHQIPËRINË

*(Shtegëtime poetike nëpër Evropë).*

Motin e Madh (2012), Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, grupi i krijuesve shqiptar nga të gjitha viset shqiptare me ndihmën financiare nga Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës me në krye Ministrin z. Ibrahim Makolli e gëdhiu me poezi mes bashkatdhetarve në Evropë. Rrugës poetike i printe kryetari i Unionit të Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptar z. Reshat Sahitaj.

Ditën e hënë (01.11.2012), herët në mëngjes nëpër një mot me shi nga aeroporti i Prishtinës "Adem Jashari" fluturuam në qiell. Aeroplani dikur doli mbi mjegulla dhe e pa Diellin. Plot pas tre orëve fluturimi, aeroplani nëpër një mjegull të dendur mezi zbriti në Bruksel. Edhe këtu shi dhe erë hutaçe. Ose, siç këndoi dikur Dervish Shaqa me çifteli: "*Kur ta ktheva Kosovë shpinën, e lamë borë e gjetëm Dimën...*"

Në aeroprtin e Brukselit, kontrolluesi i pasaportave të disa shteteve pyet: Të gjithë jeni shqiptarë?! Po, i përgjigjet Reshati. Jemi nga Shqipëria e coptuar copë-copë: Kosova, Maqedonia, Mali Zi dhe Presheva. Hë për hë, na mungon Çamëria. Polici belg shkund kokën me çudi dhe rrudhë krahët.

Ne pasi i morëm valixhet, në aeroport na pret Gjergj (Qamil) Zekolli, një veprimtar i palodhur për çështjen patriotike shqiptare të Diasporës. I ngarkon valixhet dhe pasi ulemi nëpër karrige,

nisemi të vizitojmë simbolin Atomium, në Bruksel. Posa zbritëm nga minibusi, Reshatit iu kujtua se nuk e ka telefonin celular. Me siguri, thotë më ka rënë në aeroport duke marr valixhen. Gjergji (Qamili) me telefonin e tij celular e kërkon numrin e telefonit të Reshatit. Matanë, i përgjigjet zëri i policit të aeroportit: Telefoni është te ne në aeroport, mund të vini dhe ta merrni në çdo kohë. Gani Xhafolli, duke mos e përmbajtur veten ndërhyn në bisedë: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?! Gjergji (Qamili) niset pas telefonit celular, ndërsa ne nëpër shi vazhdojmë të kërkojmë ndonjë restorant për strehim. Jo larg, pas disa hapave e gjejmë një dhe hyjmë brenda.

Kamarieri, pasi e ka dëgjuar bisedën tonë në gjuhën shqipe na thotë: Mirëse erdhët! Ne, pasi e shikojmë njëri - tjetrin pyesim veten: Edhe ky qënka shqiptar?! Po, përgjigjet kamarieri. Pronari është nga Peja. Në ndërkohë vjen edhe pronari: Urdhëroni vëllezër dhe mirëse keni ardhë! Për çka jeni, porositni edhe drekë, i keni falas nga shtëpia. Jo, i përgjigjemi ne gati njëzëri. Jemi një grupë i krijuesve nga të gjitha viset shqiptare: Tirana, Prishtina, Shkupi, Ulqini dhe Presheva. Vetëm për pak kohë ikëm nga shiu dhe e presim një shok, jemi vetëm për kafe. Nuk shkon shumë kohë dhe kamarieri na i sjellë kafetë përpara mbi tavolinë. Në ndërkohë vjen edhe Gjergji (Qamili) me telefonin celular në dorë. Reshati do t'i paguaj kafetë. Jo, i përgjigjet pronari, i keni nga shtëpia.

Ne, pasi iu faleminderuam dhe u pershëndetëm dolëm jashtë në oborr.

Shiu, kishte pushuar pak, nuk biente si me shtamba. I bëmë disa fotografi para simbolit Atomium, në Bruksel dhe u nisëm rrugës. Gjergji (Qamili), thotë: Mirë është ta vizitojmë edhe përmendoren e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në Bruksel. Patjetër, i përgjigjemi ne, gati njëzëri. Dhe, pas disa minutave, gjëndemi përpara përmendores së Skënderbeut me gjithë shpatë në mes të Brukselit. Edhe këtu, i bëjmë disa fotografi. Dikushi shpreh dëshirën ta vizitojmë edhe Unionin Evropian. Nuk ka problem, përgjigjet Gjergji (Qamili). Nuk është larg nga këtu. Edhe atë, mund ta vizitojmë, bëjmë disa fotografi. Dhe, ende pa përfunduar bisedën, arritëm përpara Unionit Evropian. Vendit historik, ku shumë takime ishin zhvilluar e vendosur para dhe pas Luftës së Kosovës (1999) për çështjen ende të pazgjidhur shqiptare. Edhe këtu, i bëmë krah për krahu disa fotografi.

Reshati, pas gjithë kësaj ngjarje, propozoi që të kthejmë te vajza e tij në Bruksel për një kafe. Nuk ia prishëm dëshirën. Thamë, gati njëzëri: Mundet. Edhe, vazhduam rrugën poetike. Posa arritëm përpara shtëpisë, në derë na priste gati e gjithë familja: Mirëse erdhët! U përshëndetëm dhe hymë brënda në sallonin e pritjes të mysafirëve. Nuk shkoi shumë kohë, erdhi kafja, rakia e rrushit dhe uiski të shoqëruar me meze. Biseda miqësore e ngrohtë familjare u shtrua në sofër. Dikur, zonja e shtëpisë na thirri për drekë. Jo, e kundërshtuam ne gati njëzëri. Drekën e kemi paraparë ta hamë në tjetër vend. Kurrësesi, përsëri ndërhyri zonja e shtëpisë.

Tradita shqiptare është, mikun të mos e lëshojmë pa i shtruar bukë e kripë në sofër. Nuk ngulëm këmbë, shkaku se: të gjithë ishim shqiptarë, i dinim këto zakone brez pas brezi nëpër shekuj.

Pasdite, dolëm nga shtëpia mikpritëse dhe u nisëm drejtë hotelit ku duhej ta kalonim natën. Nesër, sipas programit na priste takimi i parë me bashkatdhetarët. Ashtu të lodhur nga rruga, pasi pushuam pak dolëm të shëtisim nëpër qytet.

Mbrëmjen e shfrytzuam duke vizituar qytetin. Sheshin e Brukselit plot me turistë. Kështjellat e vjetra të ndërtuara para pesë shekujve. Edhe vendbanimin e Viktor Hygos. Para pllakatës përkujtimore të tij, i bëmë edhe disa fotografi. Pak para se të bie mesnata, u nisëm drejtë hotelit. Unë dhe Haxhi Shabani duke kërkuar ndonjë birrë të marrim me vete udhës në dhomë, dalldisëm nëpër dyqane. Përinat tonin, në ballë të çdo dyqani në gjithë lagjen, shkruante “Hallall”. Hoqëm dorë, por tek tashti e pamë se e kishim humbur rrugën. Nuk mundëm kurrësesi ta gjejmë hotelin. Përmëtepër, nuk e dinim edhe si emërohej, në cilën rrugë. E marr Reshatin në telefonin celular, matanë më përgjigjet zëri: Tashti po ta dërgoj me mesazh emrin dhe rrugën e hotelit. Merrni një taksi! Nuk vonoi shumë, dhe erdhi mesazhi. Unë me frëngjishten time të çalë, e pyes kalimtarin e parë, një djalë të ri kalimtar rasti. Për fat tonin, ai e njihte gjuhën frënge. Ja, pas semaforëve, në anën e djathtë është hoteli.

Ecëm. Pas disa metrave, ne u gjëndëm para hotelit. Siç duket, ishim humbur në afërsi, na ishin ngatërruar rrugët.

Ditën e nesërme (02.11.2012), pas mëngjesit në hotel, në mbrëmje na priste aktiviteti latrar. Ora poetike me bashkatdhetarët. Pas shëtitjeve nëpër qytet dhe drekës, pushimit të domosdoshëm, u drejtuam në vendin e aktivitetit tonë latrar. Përçudi, aty i takuam edhe disa miq të vjetër: Agron Shele dhe Gani Azemin, mikun e studimeve në Prishtinë. Orën letrare me bashkatdhetarë e hapi kordinatorja e Shoqatës të Shkrimtarëve të Belgjikës, znj. Shqiponja Duro, e cila e çeli këtë sipar me vargjet e Ali Podrimjes: *Kosova është gjaku im që nuk falet… Më shumë se kushdo tjetër të njoh Kosovë… Unë, biri yt* etj. Më pas këtë takim poetik e përshëndeti edhe Ambasadori i Republikës së Kosovës Z. Ilir Dugolli. Sipas programit u bë edhe përurimimi i librit "*Dhimbë e bukur*" (homazh për poetin Ali Podrimja), përgaditur nga autorët Reshat Sahitaj dhe Bagzad Baliu. Në vijim, gjatë kësaj nate lexuan poezi: Bahri Myftari, Gani Xhafolli, Kalosh Çeliku, Haxhi Shabani, Arsim Halili dhe Gjergj (Qamil) Zekolli.

Herët në mëngjes (03.11.2012), përsëri u nisëm për rrugë. Dihet, tashti më të freskët se ditën e djeshme. Përsëri, Gani Xhafolli posa shihte ndonjë vreshtë me rrush, kopsht me pemë, ose ndërtesë, e prishte qetësinë e rrugëtimit: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?! Ose, kur duhej të hanim drekë: A, prapë me hëngër?! Dada Hajri, pas një rruge kaq të gjatë për në Paris, përsëri e prishi qetësinë: Arritët në vendin e kërkimit. Zbritëm. Përpara nesh qëndronte hoteli "Ibis". Nuk e di se kush nga ne e pagëzoi si Ibish. Hotel,

për të cilin do të na marr malli edhe në Cyrih të Zvicrës.

Erdhi koha e darkës, të cilën unë nuk e doja që nga koha e studimeve në Prishtinë. Gani Xhafolli, përsëri nuk duroi pa folur: A, prapë me hëngër?! Qeshëm. E gjetëm një restorant në afërsi të hotelit. Dhe, hëngrëm darkë. Pasmesnate, u kthyem në hotel.

Të nesërmen, dolëm nëpër Paris. Haxhi Shabani kishte dëshirë që ta vizitojmë Kullën e Ajfelit. Për mua nuk ishte kutadi çfarë "zbulimi" turistik, unë në Paris kisha qenë në vitet e shtatëdhjeta, falë tim vëllai që punonte dhe jetonte me vite në këtë qytet. Edhe atë, me të vetmin qëllim për të studjuar dhe punuar në Paris.

Përsëri, falë tim vëllai, që e kishte mik profesorin e Serbonës Abaz Ermeni, unë arrita të regjistrohem në atë Universitet. Im vëlla, pasi vetë nuk guxonte të vijë si "armik i shtetit" në Jugosllavi, përsëri vendosi për fatin tim të jetës: Nuk ka nevojë, më tha edhe ti të mbetesh në mërgim. Ne kemi pasuri në Katund. Ende i kemi gjallë Nënën dhe Babain. Patjetër, duhet të kthehesh prapë në vendlindje dhe të regjistrohesh në Universitetin e Prishtinës. Unë do të të mbajë dhe mbulojë shpenzimet e studimeve. Ashtu edhe ndodhi. Unë pas tre muajve, u ktheva në vendlindje dhe vazhdova studimet në Prishtinë. Ndoshta, edhe im vëlla pati të drejtë në atë kohë.

Ku ta di. E ka paraparë rrezikun, që unë si i ri mund të mbetem përgjithmonë në Paris. Megjithatë, tashti e shoh se mua nuk më doli keq të punoj, jetoj dhe korr suksese letrare edhe në vendlidje. Edhe pse, gjithë jetën e kalova në

rrezik, eca tehut të thikës me dy të preme para syve të Qoftëlargut.

Lexues i nderuar, kërkoj falje që të largova pak nga qëllimi i këtij reportazhi letrar. Vështirë e kam, të kaloj shkel e shko mbi ato ditë të vështira që nga truri im nuk fshihen kurrë, gjithë jetën deri në vdekje. Kohë qorre, kur nateditë më rrinte një tokmak mbi kokë. Prandaj, le të kthehemi te vizita e Kullës së Ajfelit. Pajtohemi me propozimin e Haxhi Shabanit. Edhe, hymë në rreshtin e gjatë që priste për buleta. Dikur, nga mesi i rreshtit gjatë, kur pamë se duhet përsëri të presim me orë të hipim në ashensor, pastaj përsëri të presim radhën për të zbritur poshtë, u nervozuam dhe dolëm nga rreshti. U pajtuam me fatin, i bëmë vetëm disa fotografi përpara Kullës së Ajfelit.

Në mbrëmje erdhëm në lokalet e redaksisë së revistës letrare "L'Eksprit", një ambient i bukur mes librash e revistash, në prani të filozofëve dhe poetëve francez ku marrin pjesë Olivier Mongin, drejtor i revistës, Antoin Garapon, Akademiku prof Dr Daniel Leuëers dhe shkrimtarë të tjerë francez e shqiptar, nën përkujdesjen e z. Musa Jupolli dhe përfaqësuesve të ambasadës së Kosovës në Francë, dhe konsullit Kadri Dadakaj. Edhe këtu bëhet përurimi i librit "*Dhimbë e bukur*", përgaditur nga Reshat Sahitaj dhe Begzad Baliu dhe librit me poezi të zgjedhura "*Jam Mbret i vogël*" nga poeti Gani Xhafolli i përkthyer në gjuhën frënge.

Orën letrare e hapi Gjergj (Qamil) Zekolli dhe ia dha fjalën z. Oliver Mongin. Që, përçudi gjatë gjithë kohës nuk e di pse, ai përpiqej që Ali

Podrimjen ta paraqes si poet nacionalist. E, në realitet ishte e kundërta. Ali Podrimja kulminacionin e tij artistik e arriti me librin e tij "*Lum Lumi*", që nuk kishte të bëjë fare me nacionalizmin shqiptar. Tekefundit, pa qenë nacionalist, nuk mund të jesh internacionalist. Reshat Sahitaj reagoi në këtë moskuptim për poetin Ali Podrimja.

Dita tjetër (05.11.12), na gjeti në rrugë për në Berlin. Qytetin e dikurshëm historik, të ndarë në dy pjesë nga Lufta e Dytë Botërore. Dada Hajri, siç i thoshte Gjergji (Qamili) rrëfyeses së rrugës në minibus për në Berlin, dalëngadalë na afronte drejtë këtij qyteti.

Dada Hajri, pas një heshtje të gjatë e prishi qetësinë në gjuhën frënge: Arritët në Berlin. Ndonjërit nga ne, edhe ia prishi gjumin. Majtas. Djathtas. Rrugës drejtë. Dikur, tashti keni arritur në vendin e kërkuar, në oborr të restorantit " La Gondola due" të djalit të Gani Xhafollit, Fatos Xhafolli

Zbresim, djali i Ganiut - Fatosi bashkë me të shoqen na dëshirojnë mirëseardhje. Ganimetja, na e tregon vendin e rezervuar apostafat për ne si mysafirë. Urdhëroni, uluni! Kamarieri, pa vonuar me një shqipe të pastër na pyet: Çka dëshironi për të pi? Dikushi i përgjigjet kafe.

Tjetri ujë të gazuar. i treti, raki rrushi. Unë, duke ia ditur vlerat e arrira birrës gjermane, një birrë. Gjergji (Qamili), porositi një shishe verë.

Dikur, na u shtrua edhe darka e pasur shqiptare. Unë, si joadhurues i darkës, kësaj radhe e prisha përbetimin. Lexuesi shqiptar, me siguri e di dhe ka lexuar ose dëgjuar se si, gjatë

Mbrëmjeve të Poezisë Strugane, unë e kam shitur darkën për një birrë. I thashë vetes: Gjatë këtyre ditëve duhet prishur rregullat e organizmit. Përpiqesha t'ju ikë darkave, por e kisha vështirë mes kësaj begatie: rakisë së rrushit, birrës dhe verës. Ose, siç thoshte shpesh Gani Xhafolli: Qysh ka ditur me i bë Zoti kaq bukur?!

Natën e kaluam në periferi të qytetit. Qetësi e tmerrshme, mes zogjëve dhe gjelbërimit. Vërtet, si poetë kishim pasur nevojë për një ikje të këtillë nga "Liria", larg nga zhurma e makinave. Ose, siç më ka mbetur ende në kokë një varg i Rilindasve: *Larg rrëmujës, larg rrëmetit*. Politika ditore. Ajëri i ndytë, që na ngulfatëte përditë mes mureve, na e zinte frymën. I hapa dritaret krah më krah. I bërtita qiellit dhe u ngopa me ajër, gjelbërim përpara syve. Fuqi të Zanave të maleve tona për këtë reportazh latrar.

Në mbrëmje, (06.11.2012) e gjetëm veten përpara bashkatdhetarve tanë në një ambient tipik shqiptar, "Oda shqiptare", ku në ballë të oxhakut rrinin krah për krahu Ibrahim Rugova dhe Adem Jashari. Mes tyre flamuri kuqezi kombëtar shqiptar. Rreth tyre Ismail Qemali me Rilindasit shqiptar. Vërtet, një ambient i bukur i odave tona shqiptare. Në këtë Orë letrare morën pjesë edhe Islam Spahiu, këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Gjermani dhe Kosovë Mula, i cili ishte vazhdimisht në bashkëshoqërimin tonë me përkrahjen e tij të parezervë. Edhe këtu, lexuam poezi për Atdheun. Njëqindvjetorin e Pavarësisë të Shqipërisë. Aktivitetit tonë kulturor i bashkangjitet edhe grupi i këngëtarve të "Odës Shqiptare" me çifteli.

Darkën, atë natë e hëngrëm te restoranti "Nouva Maria", në Berlin. Djalit tjetër të Gani Xhafollit, Labinot Xhafolli.

Ditën tjetër (07.11.2012) u ndalëm në Qendrën Kulturore Shqiptare të Shtutgardit. Takimin poetik e hapi moderatorja Gjyla Leci, sekretare e QKSH të Shtutgardit. Më vonë, ajo ftoi Vitor Spaqin, kryetar i Qendrës Kulturore Shqiptare të Shtutgardit për fjalën e rastit. Reshat Sahitaj përshëndeti të pranishmit e kësaj Ore letrare duke faleminderuar ish ambasadorin e Kosovës zotin Vitor Spaqin dhe Vilson Mirditën, që ishin si iniciatorë të organizimit të kësaj ore letrare. Poezi lexuan edhe krijuesit nga Shtutgardi: Miradije Gashi, Miriman Bajraktari, Asllan Dibrani, Asllan Koqinaj, Zef Preka, Zeqir Asllani, Ndue Lekaj dhe Sulejman Lulaj. Aktiviteti letrar i radhës (08.11.20120), na thërret në Gjenevë. Rruga e gjatë me qindra kilometra na lodhi shumë atë ditë. E sidomos shoferin tonë, Gjergj (Qamil) Zekollin. Më kot, Gani Xhafolli përpiqej të na e përzë lodhjen me atë fjalinë e tij të zakonshme: Qysh ka ditur me e bë Zoti këtë ndërtesë, këtë rrugë, këtë urë, këtë fushë, këtë mal, këtë dru, këtë përmendore kaq bukur.

Rrugës u detyruam të ndalemi disa herë për pushim, një kafe. Lodhja e kishte bërë moti të veten si rrugaçe. Përsëri rrugë e gjatë për në Gjenevë. Herë pas here Reshat Sahitaj dhe Gjergji (Qamili) kontaktonin me telefon. E kërkonin adresën e hotelit ku do ta kalonim natën. Sipas bisedës së tyre përmendej shpesh emri i Abdyl Gërvallës, të vëllait të Jusuf Gërvallës. Matanë u përgjigjej Abdyli se hotelin e vendosjes

e kemi matanë kufirit të Zvicrës, në territorin e Francës. Nuk prish punë, i përgjigjej Gjergji (Qamili), na e dërgo adresën e saktë të hotelit. E kemi afër Gjenevën.

Arritët në vendin e dëshiruar, na thotë Dada Hajri. Posa zbritëm, erdhi edhe Abdyli. Pasi u përshëndetëm, u vendosëm në hotel ta kalojmë natën. Gani Xhafolli, përsëri nuk duroi pa folur: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?! Ne, si zakonisht ashtu të lodhur e rraskapitur edhe kësaj radhe qeshëm.

Dita e nesërme (09.11.2012), si gjithë të tjerat erdhi te pragu i derës. Ne, pas mëngjesit, drekës dhe vizitës të Gjenevës nëpër shi na priste aktiviteti kulturor i radhës. Abdyli nga makina përpiqet të na tregoj përmendoren e Skënderbeut, karrigen me tre këmbë, institucione të rëndësishme në Gjenevë. Në fund, për t'i ikur shiut gjejmë një strehim në një restorant për kafe. Kamarierja zezake si flutur arrin para nesh me listën e pijeve dhe ushqimeve. Gani Xhafolli, kësaj radhe e ka vështirë të mos flasë para bukurisë së zezë: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?! Kamarierja, nuk e di a e kuptoi gjuhën e Gani Xhafollit, megjithatë buzëqeshi ëmbël dhe iku pas porosive. E Ganiu, vazhdoi me ato shprehjet e tia të zakonshme: A, prapë me hëngër?!

Në Gjenevë arritëm te vëndi i dëshiruar, kështu na tha Dada Hajri: Universiteti Popullor i Gjenevës. Në këtë takim kulturor morën pjesë edhe shkrimtarë, veprimtarë, studentë që jetojnë në Zvicër, si dhe kordinatorja e Universitetit Popullor të Gjenevës, Albana Krasniqi – Malaj.

Natën e radhës, u strehuam te "Ibishi", siç e kishim pagëzuar në Paris. Ora letrare (10.11.2012) u mbajtë në lokalet e Bibliotekës Pestaloci të Cyrihut, ku e drejtonte një shqiptare nga Shqipëria, Suela Jorganqi. Edhe këtu, plot të njohur e të panjohur shqiptar: Ajmane Veseli, zëvëndëskonsull në Konsullatën e Kosovës në Cyrih i përshëndeti të pranishmit dhe u dëshiroi mysafirve mirëseardhje. Poezi përveç mysafirve, lexuan: Shaip Beqiri, Bujar Salihu dhe një strugane nga Ladorishti që recitoi poezi patriotike. Edhe këtu lexuam poezi, dhe dhuruam libra për bibliotekën. Edhe u fotografuam së bashku mes librave. Në fund, u interesuam të kërkojmë ndonjë restorant për darkë. Vështirë e ke në orët e vona të gjesh restorant të hapur në këtë kohë. E sidomos për ne, që nuk e njihnim gjithaq mirë qytetin. Dikush propozoi të shkojmë për darkë te stacioni i trenit. Jo, ndërhyra unë, a ka ndonjë rstorant turku në këtë qytet? Po, sa të duash u përgjigjë njëri nga nikoqirët. Po, të duash ka edhe kinez. Mirë, ndërhyri Reshati, shkojmë te restoranti i turkut. U nisëm, ata para, ne përmbrapa tyre me minibus.

Arritëm, tha Gjergji (Qamili). Turku na priti te dera me një "bojrum". Unë posa hyra, i hodha sytë te banaku, vallë mos këtu ka ndryshime nuk është si në Gjermani. Sytë m'i zunë shishet e rakisë rrushit, verës, uiskit dhe të birrave. Urdhëroni, m'u drejtua mua turku sipas radhës? Një birrë "hallall", i përgjigjem unë. Ti, i drejtohet Gani Xhafollit: një ujë të gazuar! Ëhë, "haram", buzëqesh turku. Ti, një shishe verë i përgjigjet Gjergji (Qamili). "Hallall", e plotëson

turku. Ti, e pyet Arsimin? Një ujë bunari. “Haram”, i përgjigjet turku. Dhe, pas darke, u nisëm për në hotel te “Ibishi”. Meqenëse orari këtij hoteli m’i përkujtonte vitet e studimeve në Prishtinë, fjeta në shtratin e katit të dytë, ndërsa Gani Xhafolli poshtë, në të parin.

Ditën tjetër të nesërme (11.11.2012) përsëri na priste rrugë e gjatë për në Milano. Gjergji (Qamili) gjatë rrugës na e bënë me dije se e kemi arritur gjashtëmijë kilometrin nëpër Evropë. Duatrokasim. Përgëzime. Rrugës plot male. Ujëvare. Shtëpi malore. Erë dhe shi. Tunele të gjatë me kilometra, që na qesin matanë malit me borë. Gani Xhafolli, përsëri nuk mund ta përmbaj veten: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?!...

Dada Hajri na e bën me dije se arritëm në Milano. Reshati dhe Gjergji (Qamili) përsëri bisedojnë me telefona celular: Si, nuk mund të organizohet në Milano?! Mezi vjen zëri matanë deri tek ne, ka dështuar organizimi. Në rregull, përgjigjet Reshati. Ditën e mirë! Jepi minubusit i thotë Gjergjit (Qamilit) për në Bolonjë! Rrugës e merr në telefon edhe një mik të një shoqate atdhetare Zenel Bytyçi. Ai matanë valëve, i përgjigjet: Mirëse vini në Reggio Emilia! Ju presim, ne do ta organizojmë Orën letrare në hotelin “Evropa”. Edhe hotelin ku do të vendoseni ta kaloni natën do t’jua dërgojmë adresën me mesazh.

Gjergji (Qamili) pothuajse fluturon rrugës nga gëzimi me minibus që më në fund u zgjidhë problemi. Në ndërkohë arriti edhe mesazhi, adresa e hotelit. Gjergji (Qamili) ia bën me dije adresën Dadës Hajri. E pranova, i përgjigjet Dada

Hajri. Dalëngadalë i afrohemi dhe i largohemi detit. Shtëpi dhe kopshte me pemë. Ara të mbjellura me grurë. Gani Xhafolli i shikon nëpër dritare dhe pshertinë: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?! Papritmas, Dada Hajri me zërin e saj të ëmbël na nxjerrë nga kjo bukuri natyrore: Arritët në vendin e dëshiruar. Parajsë, bërtet nga gëzimi Gani Xhafolli.

Në mbrëmje, në hotel vjen një djal i ri me shokë. Përqafe e ka një shall të kuq - flamur me shqiponjën dykrenare kuqezi. Anësh shallit, shkruan ALBANIA. Edhe kapsen e rripit e ka kuqezi. Unazën në gisht. Gjergji (Qamili) na prezenton me djaloshin nga Shqipëria dhe shokët nga Kosova. Djaloshi mësojmë se e ka emrin Klodian Capa. E ka të kryer edhe një shkollë fetare. I përket fesë islame. Dikur, Klodiani na pyet se çka do të pimë? Një raki rrushi, i përgjigjem unë. Një ujë të gazuar, Ganiu. Një shishe verë, i përgjigjet Gjergji (Qamili).

Ti, i drejtohet Atdheut (Bahriut)? Edhe unë një shishe verë…

Ditën e radhës (12.11.2012), Gjergji (Qamili) e porositi Dadën Hajri për të na përcjellë deri te hoteli "Evropa". Dada Hajri e pranoi porosinë. Dhe, u nisëm rrugës. Majtas. Djathtas. Rrugës drejtë. Arritët përpara hotolit Evropa, tha Dada Hajri. Zbritëm dhe hymë brenda. Klodiani me shokë na priste në korridor. Pas pak kohe erdhën edhe bashkatdhetarët me gjithë familje. Përdallim, nga takimet tjera, kësaj radhe kishim edhe fëmijë. Përçudi, si i kishim harruar gjeneratën e ardhshme të Atdheut edhe në vendlindje, edhe në megrim. Salla u mbush plot e

përplot me dashamirë të fjalës poetike. Dikushi mbeti në korridor për ta përcjellur Orën letrare. Mbrëmjen e nderoi edhe prania e mikut të shqiptarve, poeti italian Michele San Pietro që e fliste bukur gjuhën shqipe. Një plak me kësulë të bardhë në kokë e shkopin me kërrabë ishte ulur në rendin e parë. Fëmijët e hapën Orën letrare me poezi përkushtuar Atdheut. Njëri pas tjetrit lexuan edhe poetët. Gani Xhafolli me poezinë e tij "Kush" duke shëtitur nëpër sallë herë pas here i drjetoheshte plakut, të cilit lotët i rridhnin rrëke faqeve nga përmallimi për Kosovën.

Përsëri, e nesërmja (13.11. 2012) na gjeti në rrugë. Përdallim, kësaj radhe për në Bari. Gani Xhafolli për çdo shtëpi, kopsht, arë… vazhdonte me atë të tijën: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq të bukur?! Edhe, më në fund arritëm në portin e Barit. Në çdo anë dëgjoje fjalë shqipe. Vetja të dukej se je në Shqipëri.

Anije dhe tragetë pranë portit. Gani Xhafolli, përsëri i mahnitur me madhështinë e tyre ngjalli bisedën: Qysh ka ditur me i bë Zoti kaq bukur?! E sidomos, kur filluan të hyjnë makinat dhe kamionët e ngarkuar me mallëra dhe makina në traget.

Valixhet i lamë nëpër dhoma dhe zbritëm në rastorant për të hëngër darkë. Secili mori sipas dëshirës së vet, unë edhe një birrë. Reshati si gjithmonë e kishte me vete shishen e "ujit". Atdheu (Bahriu) me Gjergjin (Qamilin) kishin marrë nga një shishe me verë. Edhe e shtruam darkën mbretërore si në katund. Dikur, pas nisjes së anijes vendosëm të shkojmë të flejmë pak, që të nesërmen ta shohim lindjen e diellit.

Herët në mëngjes (14.11.2012), Reshati na troki në derë: Zgjohuni "ushtri", lindi Dielli! Unë u ngrita përgjumshëm dhe mezi zbrita nga shtrati në dy kat. Gani Xhafolli, edhe ai u ngritë pas meje. Njëri pas tjetrit dolëm në verandën e anijes. Dielli kishte lindur mbi det. Bukuri e hatashme. I bëmë së bashku edhe disa fotografi. Gani Xhafolli bërtiti nga gëzimi: Qysh ka ditur me e bë Zoti kaq bukur?!

Zëdhënsja paralajmëroi se arritëm në Durrës. I morëm valixhet dhe zbritëm shkallëve për te minibusi në parking. Mezi dolëm jashtë në portin e Durrësit. Gjergji e hapi dritaren për t'i rrëfyer pasaportat duke mos prituar të flasë si zakonisht me policët: Jemi një grup poetësh, gjithësjetë shtatë veta nga të gjitha viset shqiptare. Vijmë nga Evropa me pesë-gjashtë pasaporta të ndryshëm në Shqipëri.

Polici, pasi i kontrollon pasaportat ia kthen duke i dëshiruar rrugë të mbarë. Rrugës nëpër Durrës, përshëndetemi dhe përqafohemi me Atdheun siç e thirrte Ganiu, Bahri Myftarin duke e lënë pranë stacionit të autobusëve për në Tiranë. Ne vazhdojmë rrugën për në Morinë drejtë Prishtinës me atë thënjen e zakonshme të Gani Xhafollit posa shihte ndonjë mal, fushë, shtëpi, kopshtë me pemë, lumë, ujëvarë mali ose liqe, po kësaj radhe pak më ndryshe: Qysh ka ditur Zoti me e bë kaq bukur Shqipërinë...

X TRI HERË MATE E NJËHERË PREJE

## ZONJA VDEKJE KJO GRUA ME TEKE DHE KURTIZANE

***Gani Azemi*** *(1951-2012), shkrimtar, gazetar, lindi në vitin 1951 në Kosovë. Avokat i zjarrtë dhe i palodhur i Kosovës, ai ka jetuar në mërgim për më shumë se njëzet vjet deri në vitin 1999. Azemi kreu funksione politike dhe diplomatike për vendin e tij, Kosovën. Ai është autor i librit:* ***Letër feqinjit tim serb*** *(2009), një thirrje e mprehtë për mbrojtjen pa kompromis të lirive dhe vlerave universale.*

Vëretet, vështirë e kam t'i besoj lajmit kobzi publikuar në mjetet e informacionit se, papritmas ike nga mesi ynë në përjetësi larg Kosovës, Atdheut. Nuk e prite me familje e shokë 28 Nëntorin e Motit Madh (2012), Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Përçudi, plot para

njëzetë ditëve u takuam në Bruksel, në një Orë letrare organizuar nga Unioni i Shkrimtarve dhe Kritikëve Shqiptar të Kosovës.

Shkaku i këtij takimi isha unë, i thashë Reshatit: E kam një shok të studimeve nga Prishtina në Bruksel. Mirë do të ishte ta shihja në këtë Orë letrare të Ditëve të Kulturës së Kosovës në Diasporë. Moti nuk e kam parë qe disa vite.

Reshati, buzëqeshi dhe m'u përgjigjë: Edhe, unë e kam mik Ganiun Patjetër, do ta lajmërojmë edhe ai të marrë pjesë në këtë Orë letrare.

Edhe pse, kohën e fundit ankohet se nuk është mirë me shëndet.

Dashamirët e fjalës poetike filluan të vijnë një nga një dhe në grupe. Unë isha dalldisur në bisedë e sipër me disa krijues në një tavolinë. Dikur, dikushi na ftoi që të dalim në tavolinën përballë sallës para të pranishmëve. Tek tashti, posa u ula përpara meje nga mesi i sallës mu duk një fytyrë e njohur me pak tipare nga koha e studimeve, të cilën aty për aty nuk munda ta përcktoj nga e njihja dhe në cilën kohë e vend.

Reshat Sahitaj i përshëndeti të pranishmit, në mesin e tyre edhe Gani Azemin me emër e mbiemër. Aty për aty më dolën para vitet e studimeve në Prishtinë. Koha, kur ne një grup studentësh nga të gjitha viset shqiptare jugosllave bëmë revolucionin kulturor, në Prishtinë. Nateditë i kalonim krah për krahu me flokë të gjata pas shpine e mjekra vështirësitë e asaj kohe kokë më kokë mes librave.

Disqeve të gramafonit të grupeve më të njohur botëror të asaj kohe: Beatles, Rolling Stones, Led Zeppelin, Johnny Hayday, TinaTainer, Charles

Aznavour, Jimi Hendrix, Mireille Mathieu, Bee Gees etj. Netëve të vona me këngën e asaj kohe të Hanifes: Elbasan i bukur, Elbasan, në "Bozhur" (Iliri). Pasmesnate duke dalur nga ai lokal nate me nga një bokall të vjedhur në xhepat e gunave të gjata gati deri në fund të këmbëve në rrugë. Dorën në zemër, me Ganiun e kishim edhe një simpati të përbashkët të studimeve. Që, në atë orë letrare, Reshati e përmandi kalimthi duke u arsyetuar se Ganiu është me të shoqen. Përmëtepër, mu kujtua edhe momenti kur në të njjtën ditë nga Shkupi u nisëm për në ushtri, ai në Prilep të Maqedonisë e unë në Knin, të Dalmacisë. Kohë qorre ajo, kur ishte në kulminacion përndjekja dhe dhuna ndaj shqiptarve. Plot pas tre muajve dëgjova se ke ikur nga ushtria jugosllave (1978), je arratisur në Belgjikë dhe je vendosur si refugjat politik në Bruksel.

Dekada të tëra ishe aktivist i palodhshëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Angazhimi i yt ishte i pareshtur e i shumanshëm, si gazetar, publicist, aktivist e diplomat. Puna dhe veprimtaria e pakursyer dhe kontributi i jashtëzakonshëm i Azemit, është shoqëruar përherë nga synimi i paepur për sensibilizim të vendimmarrësve në Bruksel me kauzën e Kosovës. Gani Azemi ishte në ballë të një numri nismash atdhetare, përfshirë edhe si bashkëthemelues i Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ndërsa gjatë tri viteve të fundit shërbeu si këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel.

Vite më vonë, herë pas here edhe dëgjoja ndonjë lajm nga miku i përbashkët, Azizi. Ende nuk i kishe ndërprerë kontaktet dhe korrespodencën me të si kolegë i studimeve.

Gjatë ndryshimeve demokratike ishe edhe veprimtar i flaktë i LDK -së për çështjen shqiptare. Në mjetet e informacionit lexoja ndonjë shkrim ose poezi. Vetëm kaq. Në Panirin e librit në Prishtinë (2009), rastësisht u takuam për herë të parë. Mezi e njohëm njëri – tjetrin nga vitet që na kishin ndarë si me sëpatë.

E pimë se bashku edhe nga një kafe. I ndërruam adresat dhe numrat e telefonit. Ora letrare përfunmdoi, unë tek tashti u ktheva në sallë nga ato kujtime të bujshme stundentore në Prishtinë. I sigurt u nista drejtë tavolinës tënde duke ta zgjatur dorën dhe të prëërqavofa me mall. Ishe bashkë me një krijues nga Shqipëria, Gjovalin Kola. Emër të cilin e njihja nga publikimet e tia nëpër gazeta, po jo edhe personalisht. Gjatë bisedës jua dhurova edhe librin tim më të ri: *Plaga e dhjetë e Babait*. Në, fund e lamë që të shihemi për darkë, vzhdojmë aty ku e lamë bisedën .Gjatë kohës së darkës, më kot të kërkova me sy, mos je ulur diku në ndonjë tavolinë. Nuk të pashë. E pyeta Reshatin, që e kisha afër: Pse, nuk erdhi Ganiu në darkë?! Reshati m'u përgjigjë me sy gati të përlotur: Me siguri nuk është mirë me shëndet. Edhe, unë e arsyetova mosardhjen tënde për darkë. Por, kurrë nuk më shkoi mendja se ti do të ikësh aq shpejtë nga mesi ynë edhe pa një fjalë përshëndetjeje. Edhe atë, vetëm me të falat miqësore për shokun e studimeve, Azizin. Amanet, i cili plot dy javë

pas kthimit t'im nga Evropa  erdhi pas ikjes tënde të papritur nga jeta.

O burrë, të qoftë i lehtë dheu i vendlindjes të Kosovës! Nuk kemi ku ikim më larg se varri. Kudo që shtegtove e kishe në zemër Kosovën. Gjurmë të thella le në Prishtinë e Bruksel. Kosova ishte djepi yt i fëmijërisë, përsëri mbetet djepi yt i amshueshëm me shqiponjën dykrenare mbi kokë duke të përkundur në histori…

## DELEDASHI

Matanë xhamave errët. Imzot, lehin qentë! Vetëm përtej çative shoh një dritë. E hap dritaren, është dhoma e Vjollca Rrapit. Me siguri e ka harruar dritën ndezur apo e ka marrë gjumi mbi libër! Po, dritaren? Dritaren a e ka lënë sonte hapur pas mesnate? Nuk e di. E shuaj dritën dhe shtrihem në shtrat. Rrokullisem lëmsh nëpër errësirë. Dikur, zgjohem i larë në djersë, e hap përsëri dritaren dhe fluturoj mbi çatia…

Mëngjesi më gjen në shtrat. Rrotullohem herë në njërin krah, herë në tjetrin. Nata ka qenë e gjatë dhe e mundishme. Dita më e shkurtër për një sy gjumë. Mundohem t'i heq perdet, por nuk më dëgjojnë duart. E kam vështirë pas gjithë asaj beteje në shtrat ta marr veten dhe përsëri të ngrihem më këmbë. Megjithatë, lufta është luftë, nuk dorëzohen armët para se mejdanin pa e shkrepur tekefundit edhe një fishek…

Vjollca Rrapi më puthi në faqe. Papritmas, kërceva nga shtrati dhe i hapa sytë. Dritë… Dritë… Dhe, dritë… E shikova orën, tre pasmesnate. O Imzot, ç'po ndodh me mua të pagjumin! Kush na rri me tokmak vathe mbi kokë natë e ditë? Kush më mban në gjumë kaq gjatë me dhunë? Me cilën do ta përcjellë Natën e do ta pres Ditën? Heshtje.

- Zgjohu, o i pagjumë! Ende mendon ta vazhdosh ëndrrën?

- Jo. Jo, - iu përgjigja duke u dridhur dhe duke i hapur sytë. O Imzot, ç'më panë sytë! Deledashin me një dajre nën sjetull. Për dore e mbante Tatën

e Madhe. E në shpinë Xhadinë, që i biente bythëve me një thupër, e shalonte me të katra nëpër Bit-Pazar. E dija se kishin ardhur para syve të më heqin një "valle patriotike kuqezi". Vetëm edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë se cilën valle e luajtën atë pasdite para syve të popullit. Vjollca Rrapi, që më do mua dhe poezinë, tha se e kanë hequr Vallen e Vdekjes. Unë nuk i besova, i thashë se atë ditë e kanë hequr Vallen e Kaçakëve të Zajazit…

- Hi-hii-hiii… -qeshi Vjollca Rrapi. -E di, se edhe ty të kanë dhënë pak ujë Xhehneti, prandaj edhe flet jerm pasmesnate…

- Jo, e dashur. Më detyrojnë të heq një valle "patriotike". E unë nuk di të luaj sipas ritmeve të tyre muzikore me lodra. Kam frikë t'i luaj këmbët, se mund t'u dukem si arusha e xhypit në Katund duke hequr vallen me dajre para fëmijëve…

- Nxirre shaminë! Nxirre, mos ki frikë!

- Shaminë ma mori Pasardhësi i Zef Serembes…

- Hi-hiii-hiii… Edhe, ti do të më dush mua me zjarr, do t'ia kalosh Zef Serembes?!…

- Jo, e dashur. Zef Serembes deri më sot nuk ia kaloi asnjë shqiptar, pa edhe as unë me verë të kuqe nëpër tavernat e Qytetit të qyqeve.

Vjollca Rrapi qeshi. E dinte se nuk isha në gjendje t'i kaloj shtatë dete. E dinte se nuk isha në gjendje t'i humb të gjitha dorëshkrimet. E dinte se nuk jam në gjendje të mbytem për të as në Vardar, e ku më t'ia kaloja Zef Serembes. Vetëm një gjë e dinte.

E them pa fije turpi se, unë isha ai që tri ditë e tri net e dërgova në botën e çudirave. Unë isha ai që e laj me verë gjithë natën. Unë isha ai që pas gjithë këtyre ceremonive mistike në Tyrbe e mbuloja me poezi. Unë isha ai që e bëra të pavdekshme edhe përtej varrit nëpër libra. E pranoj, edhe ajo qe Zana me dy shtamba verë që më dha gji, nuk më la të plakem nën Rrap, m'i dha armët e luftës ta vras vetëm me një varg Deledashin…

Juve më kot ju shkruaj në këtë shkrim se kush ishte Deledashi. Më kot mundohem t'ju trimëroj me fjalë nëse frika ju ka hyrë në bark. Ja, edhe arsyja pse me ju më nuk do të humb kohë. Jeta është luftë. E luftën e duan trimat. Frikacakët e duan robërinë.

Vallë, Deledashi është trim? Ku ta di unë. Ndodhë. Deledashi bën luftë për poste politike. Vende pune. Pasuri. Deledashi është komandant i ushtrisë së frikacakëve… Deledashi është armiku i Lirisë… E, shërbetorët e tij me dy e katër këmbë? Shërbetorët e tij, janë pisa. Këlyshë me zgjebe të Zotit, të cilëve duhet prerë sipas Nolit të Madh jo vetëm duart, po edhe kokën e këmbët…

Përsëri, pas gjithë kësaj, dua t'ju them edhe diçka në vesh! Po, si t'ju them, kur nuk keni shpirt! Veshë e sy. Apo, keni, por jua ka lidhur me shami Deledashi…

Lufta vazhdon me penë…E thirr Miken në Parajsë. Ajo, për çudi, do ta shpie në Xhehnem… E do zjarrin… Urën e Xhehnemit… Deledashin "kuqezi"… Ja, arsyeja pse në këtë shkrim do ta lidhë me një fjalë kaçaku.

Letërsia shqipe e ka Zef Seremben mashkull, por ende nuk e ka Zef Seremben femër. Ti, më thotë Vjollca Rrapi, nuk je në gjendje të ecësh këmbë as një mëhallë katundi. Ti nuk je në gjendje të humbësh për mua as edhe një poezi. E ku më t'i biesh pash më pash me gjithë dorëshkrime Xhehnemit. Ja, edhe pse do ta krijoj Zef Seremben femër, në mos në jetë, së paku në këtë shkrim, në këtë libër…

E di se e dini, Vjollca Rrapi është një Zef Serembe femër, por këtë nuk do ta pranojë para meje, jush, po as edhe në këtë shkrim. Edhe unë nuk ngul këmbë. E dua Vjollca Rrapin, po e do edhe Deledashi "kuqezi". E di se, edhe Deledashi i ka dërguar shkuesit dhe këto ditë pritet ta shpie nuse me koçi në Xhehnem. Zoti i ndihmoftë!...

"Zekthi" në një faqe e ka bërë nuse me ferexhe! E ka veshur sipas zakoneve dhe traditave të Xhehnemit. I duken vetëm sytë. Lexuesit, besimtarët e vërtetë të Zotit, nëse nuk e kanë frikë Deledashin, le ta shohin në këtë shkrim!...

E di, ju dhimbset edhe në këtë shkrim. Edhe mua më dhimbset, po ç'e do, deshi të bëhet Nusja e Deledashit. Edhe një herë e them me plot gojë: Zoti i ndihmoftë!...

Tri ditë e tri net nuk e pashë Vjollca Rrapin nëpër Qytet. Një natë vonë cingërroi telefoni. E ngrita kufjen dhe ia dëgjova zërin matanë telit.

- Hë, ende s'po të merr gjumi? – Qeshi nëpër natë.

- Jo, nuk më lënë personazhet e librave. Kohën e fundit kanë filluar edhe të zihen njëri me tjetrin, të rrihen me grushta…

- E di, fajet i ka shkrimtari. Nuk mund t'i pajtojë  të gjithë në një libër. E aq më keq vetëm me një Mike…

- Po, hallin?

- Hallës duhet gjetur një burrë!...

- E nëse halla deri më tash i ka ndërruar shtatë burra?...

- Hi-hii-hiii… E ke për detyrë t'i gjesh edhe një burrë me tirqi e xhamadan!... Kësulën e bardhë në kokë… Sahat me qostek për qafe… Nagantin në brez…

Qesha pas mesnate me Vjollca Rrapin, që nuk kishte gjumë e kërkonte që unë ta rrëzoj në shtrat. Vetëm, ku t'i lija personazhet e mia, që disa më tërhiqnin për dore, disa për setre… Megjithatë nata është e gjatë, iu përgjigja nëpër tel…

- E dashur, lëre dritaren hapur! Ku ta di unë pas mesnate vij e të futem në shtrat…

- Hi-hii-hiii… -Qeshi. Edhe oxhakun…

Zëri matanë telit u ndërpre, e unë për inat e hapa dritaren... E thirra Hënën… I thirra yjet… E nxora lapsin nga brezi…

- Hë, ende s'po të merr gjumi? – E hapi derën im Atë.

- Jo. Tashti më rreh Nusja me pashterkë të kuqe…

- E ç'të thotë, kaq vonë pas mesnate?

- Më detyron të bëj me të dashuri…

- Imzot! Biri im të marrë për grua një kurvë?!...

- Oh, jo! Baba, nuk e dua për grua…

- Ti nuk e do, por ajo të do ty, or bir për burrë!

- E si t'u shpëtoj epsheve të saj, baba?...

- E ke lehtë, o bir! Këmbët pas ndonjë mullari me bar ngreja përpjetë në hava…

E tha këtë fjali dhe e mbylli derën. U turra pas tij, por e pashë që ngutej nga livadhi. E kishte edhe mauzerrin me vete krahut. E di, ju do të thoni ty ta la penën. E vërtetë, po Nusja me pashterkë të kuqe ndonjëherë do edhe pushkë…

Edhe këtë e di. Vetëmse, unë nuk trembem nga Deledashi që i ka dhënë gji dhe e ka përkundur në djep me ninulla meleze Njerka komuniste, as sot e as nesër. Kokën, që e ka futur në disa grazhde: Fondacione e shoqata "joqeveritare". Edhe, Doktorziu natë e ditë i jep tambël me kusi nën dardhat gorrice. Sorrat dhe çafkat e zeza fluturojnë në grupe. Laraskat nëpër lisa. Dhentë në kope, ecin pas bariut. Ujku, tigri dhe luani jetojnë dhe ecin verë e dimër vetë maleve. E doni edhe këtë t'ua them me plot gojën në këtë shkrim? Po, ë? Thashë: Unë jam Ujk në letërsi… Edhe, mjaftë më m'i ndërsyet këlyshët me zgjebe pas shpine me bishtin ndër këmbë. Koha është, ta nxirrni në fushën e mejdanit Qenin me zgjebe me gjuhën e nxjerrur jashtë dypëllëmbë nga vapa.

- Hi-hii-hiii… Qeshi Vjollca Rrapi. Përderisa është gjallë Njerka dhe Doktorziu, Deledashi ende do të pi tambël me kusi... E ty, kush të jep gji?

- Hi-hii-hiii… Tri Zana të maleve… Fuqi për luftë… Njëra më pri para, e dy të tjerat më mbajnë për krahu. Dallim i madh ky mes meje si Ujk në letërsi dhe Deledashit si soj i deleve "kuqezi" në mesin e Kopesë me zgjebe…

Natë. Dritat u ndezën në dhomë. U shuan. Muzika e fortë përplasej mureve. Rolling Stones i

thyenin kitarat. Djersë. E mora pak veten dhe e tërhoqa nëpër errësirë. Duart e një femre filluan të më përkëdhelin, të m'i shpërthekojnë pantollonat… Më kot e kundërshtova, më mbuloi me puthje. Dritat u ndezën. Ngadalë i hapa sytë, e pashë se ishte Xhadia e Deledashit.

- Dorëzoi armët! E ke kot t'i shpëtosh këtij shtetrrethimi, kësaj pusie!…

- E di, vetëm kush ta hapi derën?

- Hi-hii-hiii… - Qeshi Xhadia e Deledashit. Ende nuk e di?! Derën ma hapi krah më krah Deledashi. – Mjaftë më shkruajte poezi për Miken. E bëre të pavdekshme nëpër libra. E di se unë jam njëqind herë më e mirë se ajo në shtrat… Kur bëj unë dashuri në mes të dhomës, dridhet i gjithë pallati… Lagjeja… Qyteti… Unë po të dua edhe të çmend nga goditjet me bark në shtrat deri në vdekje…

- O Imzot! Më shpëto nga Xhadia e Deledashit, se duhet të kthehem në shtëpi!

- Ti nuk ke shtëpi… E ke humbur rrugën në mes të ditës… Përderisa Deledashi me një këmbonë për qafe i pri Kopesë me zgjebe për Liri…

- E si t'i ik Deledashit "kuqezi"?!... Njerka atij i jep tambël me kusi… Doktorziu e ushqen në grazhd me taxhi, e mba për soj të Kopesë me zgjebe…

- Ec pas meje!...

Xhadia e Deledashit më mori për dore dhe më futi në një dhomë të errët.

Papritmas, u ndezën dritat. Asgjë nuk pashë përveç librave dhe fotografive. Në mes të dhomës e pashë shtratin, por vetëm atëherë kur më rrëzoi

në kokërr të shpinës Xhadia e Deledashit. Egërsisht ma hudhi jelekun e lëkurës, këmishën dhe pantollonat për dritare. Brekët as vetë nuk e di se si m'i hoqi me këmbë. Tërmet! Librat filluan të më rrëzohen mbi kokë… Fotografitë… Pikturat… Pllakat e gramafonit… Llamba elektike në mes të tavanit luhatej andej-këndej dhe prisja në çdo çast të më bie mbi kokë. Megjithatë, nuk u dorëzova, u kapa për dy gjinjtë e hazdisur gur të Xhadisë së Deledashit dhe i dhashë lopatës sa më thellë nëpër detin e tërbuar plot dallgë. Një dallgë e fuqishme përpak desh më hodhi nga barka, por më shpëtoi Xhadia e Deledashit. Edhe një herë i dhash forcë lopatës duke hyrë sa më thellë  në det si një peshkaqen i përgjakur, të cilin e ndjekin me vite qindra gjuetarë. Dhe, në atë çast, kur u çmenda, e përmbysa barkën, i thyeva lopatat, dëgjova vetëm piskamën e pakontrolluar të Xhadisë së Deledashit. Edhe një herë u dridh fuqishëm pallati. Shtrati u bë copë-copë dhe ra në tokë. Qyteti mbeti pa dritë…

Pak para mëngjesit, kur u zgjova, e pashë Xhadinë e Deledashit sesi ishte paluar mbi mua si bollë shullani sa gjerë-gjatë në gjumë. Nuk e zgjova, me siguri shihte ndonjë ëndërr. Apo ku ta di unë, m'i mblidhte eshtrat nëpër dhomë...

## BURRAT NUK I DORËZOJNË ARMËT PARA SE MEJDANIN

*(Përkujtim: Perikli Jorgoni (1936 - 2012)*

Moti e kam thënë publikisht në mjetet e informacionit: Përpara fushën e mejdanit, sesa armët (penën). Miqtë e mi të penës, falë Zotit Madh deri më sot nuk e kanë dorëzuar penën, para se mejdanin: Frederik Rreshpja, Hida Halimi, Pano Taçi, Teki Dërvishi, Zyhdi Morava, Qerim Arifi, Fadil Bekteshi, Mirko Gashi, Shaqir Sadiku, Gani Azemi…

Dhe ja, këto ditë edhe një penë e mirënjohur luftarake nuk e dorëzoi armën, përpara se mejdanin: Perikli Jorgoni. Lajmi zi: Është ndarë nga jeta në mënyrë aksidentale përkthyesi, poeti dhe gazetari Perikli Jorgoni. Përkthyesi i emrave më të njohur të letërsisë botërore në gjuhën shqipe: I Safo, Kavatis, Gijom Apoliner, Friedrich Hordelin etj. Vite me radhë ka punuar si mësues dhe gazetar, si dhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", në Tiranë.

O burrë, armën e vetme gjithë jetën ti e kishe penën. Anembanë Atdheut ti e nxore nga brezi në dyluftime me trusakatët. Mik të penës dhe jetës e pate Pano Taçin. Shkaktari kryesor, që u njohëm unë e ti rastësisht në një manifestim kulturor në Tiranë, që vinim nga të dy anët e Atdheut. Dihet, edhe sot e kësaj dite ia di për nderë Pano Taçit, që gjithë jetën sa qe gjallë më njohu vetëm me burra të penës e jo me kulturofagë.

Vërtetë, ishe i madh për të të njohur sot ne kaçakët e kësaj ane të Atdheut. Herë pas here

jemi takuar në Netët e Poezisë Korçare, në Korçë. Vite me radhë edhe në Prishtinë. Patjetër, ne do të takohemi shpesh edhe në Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombtar: TAKIME NËN RRAP, në Shkup. Dorën në zemër, ishe krahu ynë i djathtë gjatë rrugës për në Baba Tomor.

Përçudi, sonte dëgjojmë përmes mjeteve të informacionit se ti ke rënë dëshmorë në fushën e betejës të letrave shqipe. Papritmas, të kemi humbur rrugës për në BabaTomor. Nuk të kemi me vete krah për krahu për në Atdheun e Perëndive: Baba Tomor. Tyrben, ku shkruhet poezia, pihet vera… Dhe, bëhet dashuri…

Megjithatë, ishe burrë dhe ike nga mesi ynë si burrë, nuk e dorëzove penën para se mejdanin.

Burrat e vërtetë vdesin në luftë. Lufta yte ishte e vështirë, luftë fyt për fyti me armik. Ike ti, po nuk iku pena yte, vepra historike për të hipur në Baba Tomor.

Edhe, padashtas m'i kujton Netët e Poezisë Korçare, në Korçë që me shumë vështirësi ekonomike i organizonte poeti i mirënjohur lirik Skender Rusi. Manifestim Kulturor Tradiconal Ballkanik, ku njiheshim me njëri – tjterin si vëllezër të shpërndarë nëpër botë si Kashta e Kumbarës. Moment histrorik, kur gjatë një manifestimi rastësisht në rrugë na takon poeti lirik i dashurisë Klito Fundo dhe do të na qërasë me një pije. Ne ishim vetë i treti me një poete rebele matanë Atdheut. Klito Fundo atë natë kishte vendosur të na "vrasë" me nga një raki rrushi. Edhe, u pajtuam si poetë.

Vetëmse, pijet me Klito Fundo, ne nuk e dinim se nuk kanë fund. Hymë për një pije, po i pimë

shtatë… Vetë Klito Fundo na thoshte plot gojën: Letrësia popullore shqiptare gjithmonë i ka numrat historik: shtatë dhe nëntë. Kohën e fundit, edhe dhjetë. E ne, si pasardhës të atyre kreshnikëve të Jutbinës që në atë kohë u jepnin gji për luftë Tri Zana të maleve, nuk guxojmë t'i reduktojmë numrat, në tre, katër e pesë në Ditën e sotshme të Njëqindvejtorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Kohën e fundit sipas disa shkrimtarëve duke aluduar në plagën e nëntë të Gjergj Elez Alisë që u ngritë nga shtrati me nëntë plagë, ne si shqiptarë sot e kemi arritur edhe Plagën e dhjetë.

E shtruam sofrën si burrat. Pijet të shoqëruara me meze vinin njëra pas tjetrës. Përpak, ta humbnim programin e manifestimit kulturor. Perikliu ndërhyri, është koha të nisemi për te Kodra e Poezisë mbi Korçë. Mirë, mezi pajtohet Klito dhe përshëndetemi. Nisemi, secili rrugës së vet përmes Korçës të serenatave.

Matanë rrugës, na ka zënë pritë Klito Fundo. Edhe, përshëndet plot gëzim: Ju pashë, nuk keni ku të ikni. Edhe, një pije do ta pimë sonte për fund dhe më hiç! Nuk ka shpëtim, më thotë Perikliu. Vetëmse, kësaj radhe i drejtohet Klitos, kjo është e fundit. Nuk ka problem, përgjigjet Klito: Kjo është e fundit sonte gjatë kësaj Nate të madhe.

Përsëri kthehemi në tavernë. Fjalën nuk e mbajmë si poetë, i pijmë jo një, po edhe tri shtamba me raki rrushi. Klito thotë: Pini se, këto janë lotët e Shën Mërisë Virgjër! Nuk kemi rrugë tjetër, i ngrejmë dolli me fund. Dikur, përsëri ndërhy Perikliu, është koha të nisemi për në

Kodrën e poezive. Mirë, pajtohet Klito, dhe përshëndetemi.

Ne, tashti duam ta ndërrojmë rrugën, t'ia hedhim Klitos. I dalim pas shpine. Njëri pas tjetrit dalim një qorrsokaku. Përçudi, matanë rrugës Klito Fundo bërtet plot gëzim: Ju pashë, nuk keni ku më ikni sonte si kaçakë mali! Edhe nga një pije e keni sonte për natën e mirë nga Shtëpia e këtij Zotëriu, bën me gisht nga vetvetja.

Pajtohemi, nuk kemi rrugë tjetër, përveçse përsëri të kthehemi në Tavernë.

Për herë të parë në jetën time mësoj dhe shoh me sy të ikë pijetari nga pijetari, në Korçë.

Dikur, para se të fillojë programi i manifestimit kulturor Klito më në fund na lë të lirë si shqiptarë me "din e iman". Nuk na ka vënë më pusi rrugëve të Korçës. Ne të lumtur, që shpëtuam nga pusitë e Klito Fundo ngjitemi përpjetë Kodrës të poezive. Arritëm me kohë. Programi posa kishte filluar në sallën e mateforave.

Ora letrare e hapi programin. U përpoqa diku ta zë me sy Perikli Jorgonin. Fatkeqësisht, më kot nuk ma zuri syri. Perikliu siç duket ia kishte futur gjumë në dhomë. Poezinë e tij atë natë e lexoi Mikja e tij, Elida Jorgoni. Nata mori zjarr. Poezi, këngë dhe valle deri në agim. Përpiqem t'i fshij sytë me dorë, matanë tavolinave e shoh Klito Fundo me Miken e tij se si luan tango në mes të sallës.

O Imzot, nuk e kam të qartë si mundet një njeri që pak para disa orëve ka përmbysur bythekrye shtamba me raki rrushi, tashti luan esull tango me Miken. Aty, për aty m'u kujtua se,

ne: Gjatë gjithë asaj kohe nuk kishim qenë pijanecë rruge, po pijetarë poetë…

Faleminderit, o burrë për ndihmën tënde në luftë me trusakatët. Ende kemi rrugë. Tyrbja e Baba Shehut është larg. Baba Tomori edhe më larg. Miqtë e tu të penës që e vazhdojnë rrugën, patjetër një ditë do të hipin në majë, Baba Tomor. Vendin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia… Dhe, bëhet dashuri…



***Perikli Jorgoni dhe Kalosh Çeliku te "Parku i grave" në Shkup (2011).***

## ZHURMË E DALLDISUR "KULTURORE"

Historikisht, populli shqiptar kurrë nuk ka vajtuar si sot sokaqeve të Bit-Pazarit, në Shkup me kaq shumë lot derdhur rrëke për Shqipëri Etnike. Duartrokitë Robërisë nëpër përvjetore e "manifestime kulturore". Ose, i është turrur me të katra kulaçit në sofër. Tortës së Pavarësisë nëpër sheshe. Gjithë jetën nëpër shekuj ka bërë luftë me armë e penë në dorë, herë me Krajl e herë me Mbret. Fajin, kurrë nuk ua ka hedhur armiqëve shekullor, po vetes se si e duron Robërinë me shekuj mbi shpinë. Çajupi në një vjershë te libri i tij me famë botërore ***Baba Tomorri*** e ngre zërin: *Mjaft punove për të tjerë, o fatkeq*!... *Si s'të lodhi robëria, Shqiptar*! Tytën e pushkës verë e dimër ia ka kthyer armikut e jo mikut të Shtëpisë. Shkurt, siç thotë këngëtari popullor me çifteli: *Për çdo vjet e kemi nisë nga një luftë, herë me Krajl e herë me Mbret*. Përmëtepër, nuk ka qenë popull euforik i dasmave pa Nuse, me zhurmë politike - "kulturore" parazgjedhore nëpër sheshe e stadiume sportive në dyluftime demagogjike fyt për fyti me armikun, po kaçak që me pushkën krahut ka dalë maleve për Liri.

E, sot?! Sot, është mu si te ajo vjersha e Vaso Pashë Shkodranit: ***Moj Shqypni e mjera Shqypni***. Populli shqiptar, sot më shumë se kurdoherë është i përçarë nëpër parti politike, që turren i madh e i vogël pas pushtetit. "Burrat dhe gratë e Kombit" të Nënës Parti të veshur kuqezi bëjnë fytas luftë për pushtet me këngë e valle. Poste politike. Pasuri. Përdhosin flamurin kombëtar, fytyrat tona

më të ndritura historike. Vend e pa vend i varrosin e rivarrosin personalitetet historike (mu si te ajo poezia e Fan Nolit: *Dhe Feridi faqe ndrrron/ Dje shante sot lëvdon),* ngrejnë përmendore të fytyrave historike shqiptare. Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë e festuan sipas bindjeve të tyre politike partiake në Tetovë, Shkup, Prishtinë, Tiranë e Vlorë. Secila Parti politike i shpalli si personalitete historike dhe i nderoi me çmime vjetore partizanët e vet partiak. Nëpër sheshe shtruan torta gjigante duke iu sulur me legenë, karroca dore e çizme dhe shkelur me këmbë para syve të botës. Fat, ndoshta patën një mijë deshët kurbanë të "Bajramit Vogël", nëse kësaj radhe falë Zotit shpëtuan nga kasapët politik me thika në dorë para kamerave televizive. Vetëmse, asgjë nuk besoj në Ditën e sotshme historike pa i parë vetë me sy e dëgjuar me veshë. Vështirë e kanë pasur t'u ikin këtyre ujqërve të rrezikshëm me dy këmbë pa i gjykuar nateditë në pusi te Lumi. Në çdo qytet para popullit nxjerrin nga një flamur kuqezi të cilin e kanë ngritur të parët e tyre patritotë. Tjetër punë është ajo se, ne vite me radhë e kemi mësuar në shkollë, përgaditur shfaqje teatrore, se: Flamurin kombëtar e ngriti Ismail Qemali me shokë në Vlorë.

Vërtet, sot e ndjej veten krenar që edhe Katundi im nuk e nxori në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë atë flamurin historik kuqezi me të cilin mësuesi i popullit nga Shqipëria, Llaqi Prenqi bashkë me nxënësit e sulmoi stacioninin e karabinierve në fshatin

Premkë të Kërçovës. Flamur, të cilin një familje e fshatit Cërvicë e ruajti me xhelozi pesëdhjetë vjet me radhë të feshehur në kohën e komunizmit. Interesant, si nuk e nxori edhe kjo familje të lëvdohet pak para kamerave televizive me familjarët e tyre për veprat patriotike. Kohë kjo, kur qyqet politike me të madhe propagandojnë patriotizëm "institucional", arsim, shkencë e kulturë partiake në emër të popullit shqiptar. Përditë, kujt si t'i teket organizon festivale mbarëkombëtare, koncerte e sofra njëpartiake lokaliste rreth sofrave e oxhakut në vend të atyre mbarëshqiptare. Festivale teatri kombëtar të improvizuar në çdo qytet, pa Teatër Shqiptar. Nderon me çmime republikane rrumaducë që nuk kanë "haber" nga arti hyjnor i Perëndive. E aspak, ose së paku të jenë afër vlerave të arrira artistike të nivelit mesatar botëror.

Popullin shqiptar, partitë politike sot e kanë përçarë edhe nëpër katunde. Brenda një nate dudumët shpallin patriotë dhe tradhtarë me thasë e qerre. Shkurt, presim të vdekurit të na e sjellin me koçi Lirinë. Krushqit t'u prinë mes maleve për Liri në ballë me flamurin kuqezi. Këngën popullore: ***Hajdeni bini djemtë e Shalës, permes Sarajeve të Pashës***! Paralajmërojnë njëzet vjet me radhë Bashkimin Kombëtar me fjalime patetike në foltore. Shqipëri Etnike. Ose, ndryshe me sopatën e madhe: Fytyrat politike shqiptare siç duket ende e mbajnë veten gjallë në pushtet me punën dhe famën e atyre personaliteteve historik, që sot nuk i lënë rehat as edhe nëpër varre. Në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012)

u janë ngjitur për herdhesh me të dyja duart për pushtet si rriqëra me parulla demagogjike nën hijen e Dardhave gorrice.

Fatkeqësisht, fajin edhe sot ua hudhin të tjerve, armiqve shekullor: Na e kanë marrë Lirinë përpara Shtëpisë. Shqipërinë Etnike. Përditë na vrasin, dhunojnë para fëmijëve e duan të na përzënë me dhunë nga Atdheu. Gjakun nëpër oda të burrave, sofra qytetare, xhami e oxhaqe televizive e derdhin me çifteli deri në gju për Liri. Edhe, nëpër "gazetat e pavarura". Vatëm hapni kanalet televizive shtetëror e nacional (privat e të "pavarur"): Valle dhe këngë gjithë ditën e natën kuqezi. Shqiponja e qyqe bashkë krah për krahu. Matanë Lëmës hedhin valle e këndojnë këngë edhe laraskat brez për brezi me sorrat e zeza. Pushkë e shpata nxjerrin nga brezi për Liri. Shqipëri Etnike. Flamurin kombëtar kuqezi e zvarrisin rrugëve, nëpër skenë e nëpër festivale. Gjoksin para vdesin e ringjallen në "fushën e mejdanit" me shpata e kobure në brez. Herë hidhen më një anë, herë në tjetrën anë duke u rënë duarve shuplakë. Përdredhin bythët para kamerave televizive e nxjerrin sisat për mejdani me këngën e Adem Jasharit. E hipin mbi tank heroin legjendar në Katund sikur të ishte partizan komunist i shokut Tito. I shpallin qytetarë nderi personalitetet me famë botërore nëpër lagje e katunde në vend të qyteteve. Emrin e Shkollës fillore "7 Marsi", Ditën e arsimit të shkollës në gjuhën shqipe e zëvendsojnë me atë të Adem Jasharit. Emër ky, që do t'i kishte hije një kazerme ushtarake. Shkolle ushtarake.

Akademie ushtarake. Gazetat e "pavarura" në gjuhën shqipe që dalin në IRJ të Maqedonisë plot reklama partiake kuqezi: Urimet e kryetarëve të partive politike, ministrave, kryetarëve të komunave shqiptare me fotografi të partizanëve teknefesë të Nënës Parti me poste politike, që të strukur nëpër istuticione shtetëror, kurrë nuk e kanë futur dorën në xhep për arsimin dhe kulturën shqiptare. Askund një varg për mall, një poezi shqipe, shkrim për arsimin dhe kulturën shqiptare. Interesant, ku e kemi kokën e ku bythën?! E të mos flasim për manifestimet tradiconale ndërkombëtare poetike që mezi e mbajnë veten gjallë në këtë zhurmë të dalldisur "kulturore" të partive politike shqiptare. "Burrat dhe gratë e kombit" me të dyja këmbët haptas para syve të botës përparimtare e shkelin pamëshirë trurin e popullit shqiptar.

Imzot, i hidhni një sy arsimit dhe kulturës shqiptare! Partizanët e Nënës Parti, nuk i shihni se bëjnë zhurmë teknefese politike "arsimore - kulturore" deri në qiell me ngjyra partiake. I kanë zënë rendet e para trusakatët partiak dhe fotografohen pa fije turpi para kamerave televizive nëpër përvjetore historike, pothuajse arsimi e kultura shqiptare i takojnë vetëm një partie politike e jo mbarë popullit shqiptar i shpërndarë si Kashta e kumbarës nëpër botë. Përditë, hapin ekzpozita figurative e përurime të librave të autorëve me vlera partiake duke i futur krijuesit shqiptar si kunguj Stambolli në një thes me arna. Partizanë të djeshëm komunistë, sot të shndërruar brenda një nate në "patriotë kuqezi"

nderohen pa fije turpi me çmime të nivelit republikan. Këlyshët e djeshëm me zgjebe të rritur dje nëpër redaksi komuniste me një asht në gojë ose një torbë taxhi, sot dërdëllisin jerm para kamerave televizive për "vlera të arrira artistike". Jargët u rrjedhin për goje e për bythe që i përdredhin nëpër "manifestime kulturore" si kurvat para syve të Nënës Parti. Turren me të katra të gjithë brenda një nate të bëhen artistë, shkenctarë, kritikë letrar e profesorë universitar. Vend nuk të lënë para Vitit Ri nëpër lokalet e Shkupit dhe Tetovës heroike të pish rehat me Miken edhe një kafe. Njëri pas tjetrit e në kope si të tërbuar garojnë dhe shtyhen me bërryla para Vitit Ri me "projektet e tyre kombëtare" për një torbë taxhi në prehërin e Qeverisë. Dudumët, që pesëdhejtë vjet me radhë i ngatërrohen nëpër këmbë popullit shqiptar me hapa "madhor arsimor e kulturor" nëpër programe partiake "institucionale" të "vëllazërim-bashkimit". I mbushën thasët e grisur arnë përmbi arnë me para "hallall" në emër të popullit shqiptar e asgjë deri më sot nuk nxorën me vlerë në dritë për Ditën e Nesërme.

Momentalisht, jemi populli më i "lumtur" në botë plot "patriotë kuqezi" e pa Shqipëri Etnike. Nuk e duam Serbinë, shkaku se e kemi brez pas brezi armik shekullor, po jemi bërë edhe më zi se "vëllezërit serb", i këndojmë Robërisë dhe humbjeve historike me vite nëpër dasma, festa e përvjetore. E shpallim Shqipërinë Etnike nëpër stadiume sportive, sikur ato të ishin Akademi të Shkencave dhe Arteve.

Vetëm se, kësaj radhe në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë na mungoi Kali i bardhë me një këmbë të thyer me "Heroin legjendar" mbi shalë me shpatën e Skënderbeut  në dorë, në mes të Tetovës heroike (Arusha e Malit). Hava e Bit-Pazarit, sesi e përcjellë në luftë me dajre e këngë patriotike. Përditë përurojmë varre, pllaka përkujtimore dhe përmendore. Gjithë kohën e kalojmë mes varreve me fjalime patetike e zbuluar përmendore nëpër sheshe e katunde duke u fotografuar para kamerave televizive krah për krahu si "patriotë kuqezi". E pak kohë na mbetet për punë, Liri. Politikë "madhore" bëjmë nëpër çajtore e xhami me çaj rusi kokë më kokë duke u përpjekur t'i imitojmë burrat e asaj kohe.

Popujt tjerë moti i kanë përveshur mëngët, i janë futur punës Zotit. Nuk e fajsojnë asnjë popull për dështimet e tyre historike. Nuk manifestojnë si ne "fitore" nëpër varre. Nuk ngrejnë përmendore për të vdekurit, kur të gjallët vdesin edhe për bukën e gojës. Fëmijët (ardhmërinë e Nesërme) edhe në ditën e sotshme i kemi pa plan-programe shkollore. Tekste e lektyra shkollore. Libra të këndimit. Revista letrare. Emisione radiotelevizive. I kemi, po hapsirat e tyre i kanë uzurpuar partizanët partiak duke ligjëruar "tema politike evropiane" partiake para fëmijëve në vend të shkrimtarëve. E thirrin "Lirinë" nga minaret e xhamive me trutë dhe këmbët në legen mes flamujve turko-arab me gjysmë hënë. Trusakatët e soçëm, që harrojnë se ne si popull flamurin shqiptar kuqezi e kemi hipur në minare të xhamisë edhe në kohën e komunizmit.

Dorën në zemër, përjashtim bëri në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë – Shqipëria Nënë, që i stolisi me flamurin kombëtar kuqezi dhe shqiponjën dykrenare përveç shesheve, institucioneve shtetërore edhe minaret e xhamive shqiptare. Nuk vajtuan si qyqe politike lis më lis duke i lënë vezët nëpër çerdhet e huaja nëpër botë. Përpak, e harrova ta përmend edhe një fshat shqiptar të Kërçovës (Llagje), në minaren e të cilit në këtë Njëqindvjetor të Pavarasisë së Shqipërisë valoi krenar edhe flamuri kombëtar kuqezi.

Koha është sot, populli shqiptar ta fajsojë veten si armikun kryesor historik për dështime politike. Përveshi mëngët dhe pantollonat deri në gju, në vend të tirqve falso me gajtana nëpër manifestime e përvjetore, t'i futet punës historike si dikur Rilindasit. Në vend që të derdhi gjakun deri në gju nëpër manifestime të improvizuara kulturore, përvjetore historike, varre e ekrane televizive, derdhi djersë pune në arenën e politikës botërore. Shpatën e Skënderbeut dhe dy koburet e Isë Boletinit në Ditën e sotshme t'i zëvendsojë me penën me dy tyta nëpër libra. Studime shkencore nëpër institucione. Akademi të shkencave. Përfundimisht, hedhë euforinë patriotike që i ka hipur në shpinë mbi samarë duke pasur parasysh ta mashtrojë për pushtet popullin shqiptar, e në realitet me vite e mashtrojnë vetveten si parti politike. Çiftelinë me dy tela, vallen dhe këngët e sotshme patetike "rreth oxhakut" e sofrave të katundit, që nuk hiqen si dikur dorë për dore, krah për krahu e brez

për brezi. Edhe, këngët patriotike - patetike "tallava kuqezi" duke derdhur vetëm me fjalë gjakun për liri deri në gju nëpër "manifestime kulturore" e përvjetore partiake para kamerave televizive. Politikokuajt (kërkoj falje nga kuajt se janë kafshë besnike të njeriut) të pushojnë së lehuri për Shqipëri Etnike pas porte para zgjedhjeve lokale dhe parlamntare duke kërkuar ndihmë nga intelektualët t'i shpëtojnë nga mbytja ku kanë rënë bythekrye në hurdhë. Edhe pse, shumica e "intelektualëve" dhe mjeteve të informacionit janë shitur shumë lirë te partitë politike duke manipuluar me popullin shqiptar. Trusakatët harrojnë se, Truri i popullit shqiptar, falë punës së tyre "patriotike kombëtare" nëpër institucione të shtetit kanë mbetur edhe pa bukën e gojës. Dhe, nuk ka pasur njeri t'i shti edhe në varr. Vite e vite, trusakatët i presin të vdekurit te pragu i derës të ngriten nga varret bashkë me ndërkombëtarët të na e sjellin lirinë në lëmë me koçi, që të na shpëtojnë nga robëria shekullore.

Mjaftë më vajtuat si qyqet lis më lis pa fole! Qyqja e di, kërkon të Vëllain. Hall, kam me ju "patriotët kuqezi", nuk e di cilin "vëlla" ose "motër" e kërkoni nëpër shekuj në Ditën e sotshme?! Dhashtë Zoti, nuk e kërkoni Babadovletin. Përditë e përnatë gjatë gjithë Motit Madh (2012) na mbytët me zhurma të dalldisura "kulturore - patriotike" e përurime të librave me autorë neokomunistë . Partizanët partiak, që e kënaqën "politikën madhore", tashti i janë sulur me "lapsa" në dorë edhe kulturës dhe letërsisë shqipe. Lëmsh i keni bërë profesionet.

Politikani merret me kulturë e artisti me politikë. Partitë politike dhe Komunat shqiptare gjatë gjithë vitit u morën me përurimin e librave, në vend të institucioneve kulturore. Koha është, t'i përveshni mëngët dhe t'i futeni punës historike! Hidhni inatet personale për pushtet, Shqipëri Etnike në emër të popullit shqiptar duke na i shpallur familajrët e juaj si heronj kombëtar e na i mbushët arat e bukës me varre e përmendore. Pangopsinë e pasurisë në emër të popullit shqiptar duke e rrjepur si qengjin të gjallë mes livadheve. Ujku nuk e hëngri kaq egërsisht si ju, kur e gjykoi fatkeqin te lumi. Edhe pse, ia turbulloi ujin Babai i tij vite më parë, ai bridredhur disa herë rreth veshëve. Nevojë kemi për Shtet Shqiptar, bukë dhe çati mbi kokë. Muhamedi a. s. e ka thënë moti: Pa Vatan, s'ka iman. Vetëmse, nuk e ka pasur mendjen te shtëpia. Pejgamberi ynë i fundit, sipas Kur'anit, gra dhe shtëpi ka pasur sa t'ia dojë qejfi. Vatan për të ka qenë Atdheu.

Nateditë i nderoni paraardhësit tanë trima për interesa të ngushta personale e partiake për ta mbajtur veten gjallë edhe ndonjë ditë në politikën "madhore" si burra të pushkës e penës. Flamurin kombëtar kuqezi në Vlorë, Tiranë, Prishtinë e Shkup, po e përdhosni duke e harruar rrugëve me vite nëpër shtylla elektrike e varre. Përditë e mashtroni popullin shqiptar se, të vdekurit do të na e sjellin një ditë Lirinë… Shqipërinë Etnike… Përmëkeq, simbolin tonë kombëtar të Shtetit Shqiptar, kujt t'i teket e hedhë krahëve si ferexhe dhe ngjeshë si poshterkë te bytha.

Përçudi, ju edhe në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012) kënduat këngë festive, copë-copë e

bëtë çiftelinë me dy tela dhe i ratë fyellit të bariut nëpër oda për "fitore"... Nateditë i luteni Allahut me trutë dhe këmbët në legen në xhami duke e thirrur për ndihmë nga minaret me flemuj turko-arab t'ju shpëtojë nga Dexhalli. Amani, po më villet në Ditën e sotshme të Motit Madh. Zorrët do t'i nxjerr jashtë para këmbëve. O popull, m'i hiqni nga qafa qyqet politike e fetare me votën e juaj të lirë demokratike në zgjedhjet e ardhshme lokale e parlamentare! Mjaftë më dolën në rrugë me protesta partiake-fetare për Liri! Emisione televizive përpara Qeverisë duke na i fotografuar para kamerave televizive fytyrat e djeshme të dështuara komuniste. "Padëgjushmëri qytetare" nëpër institucione të shtetit. Kuvend të improvizuar në rrugë. Koha është të votoni për individë të shekullit, që e kanë dëshmuar veten në arenën politike me punë dhe vlera patriotike për çështjen ende të pazgjidhur shqiptare, e jo për parti politike.

Përfundimi. Pak më ndryshe në Ditën e sotshme historike, jo si te ajo poezia e famshme e Asdrenit për Kosovën: *O shqiptar, rrokni huj e shpatë,/ ta shptojmë Kosovën e ngratë!* Kosova sot është shtet i lirë demokratik dhe i pavavarur, e njohur nga disa shtete të botës përparimtare. Nesër, e pret edhe një rrugë historike: Rruga e Bashkimit Kombëtar. Vargu im luftarak në këtë shkrim për Nesër, ndryshe e jep kushtrimin nga Dita e djeshme mes mjegullave mbi Shqipëri që na e fshehin me shoshë Diellin: Ooo, shqiptarë! Koha është t'i bashkoni forcat intelektuale përparimtare dhe përvishni mëngët deri në bërryla për ***Ditën e Nesërme Shqiptare*** me punë

produktive e jo me fjalë e premtime patetike mes varreve! Përralla arabe duke rrëfyer nëpër sheshe para kamerave televizive. Rrokni penë e libër, ta shpëtojmë Shqipërinë e ngratë!…

Edhe, në këtë fushatë parazgjedhore lokale e parlamentare (2013), e di se nëpër sheshe e stadiume sportive do të çirreni në kupë të qiellit dhe "kërkoni luftë heroike" për Shqipëri Etnike. O, bini burrat e mejdanit – bini Tortës së Pavarësisë!... Dihet, si gjithmonë edhe kësaj radhe fyt për fyti me "armikun për fitore historike" nëpër përvjetore duke iu sulur me legenë e karroca dore Tortës së Pavarësisë (popullit shqiptar)…

## PARKU I "ÇAIRIT" MES SËPATAVE POLITIKE DHE FETARE

Parkun e bukur të dikurshëm të "Çairit" e mbaj mend si sot, kur isha nxënës i shkollës së mesme normale "Zef Lush Marku", në Shkup. Përmëtepër, ato vite shkollimi isha vendosur me banesë edhe në këtë lagje të Shkupit. Vendbanim përrallor, që pas tërmetit katastrofal (1963) u ndërtua me ndihmat solidare nga e mbarë Bota. Dihet, politika e atëhershme shtetërore jugosllave e "lulëzoi" për vete si një ndër lagjet më të bukura maqedonase (kombeve dhe kombësive) mes gjelbërimit. Edhe, në atë kohë ua shpërndau banesat falas partizanëve të Partisë Komuniste.

Natyrën qiellore kësaj lagjeje të Shkupit ia kishte falë vetë Zoti. Jo, rastësisht edhe sipas pozitës gjeografike e kishin pagëzuar me një fjalë turke "Çair" (livadhe). Plot me drunj e gjelbërim që e ruante nëpër vite me xhelozi para syrit keq të Dexhallit. Vend, ku ne nxënësit e asaj kohe me kitara përqafe e mandolina të mësuesit të muzikës, Syreja Imami e kalonim kohën e lirë nën hije me cucat azgane qafë për qafe para syve të Hënës deri në agim. Edhe sot, më rri parasysh si në fotografi: gjelbërimi i madh dhe drunjtë kokë më kokë verë e dimër. Lagje e re moderne, që i gjithë Shkupi ia kishte lakmi. Degëve të tyre, ku nateditë fluturonin plot pëllumba. Zogjë, që gjatë stinës së verës këndonin këngë e gjatë dimrit truma-truma na trokisnin për thërmia buke në dritare. Vetja të dukej se jeton në katund, e jo në mes të Shkupit. Dihet, majë tyre herë pas here

kakariste edhe ndonjë laraskë, ose sorrë e zezë. Pasmesnate, edhe Zogu i keq me atë këngën e tij të kobshme shkatrraçe mbi çati, që mezi na vënte në gjumin e thellë të gërhasim për Liri duke sharruar shelgje mes livadheve.

Vite më vonë, pas studimeve në Prishtinë, kur do të kthehem përsëri me punë në Shkup, rreth viteve ’80 –ta, vërtetë do të dëshprohem keq me pamjen e Parkut të “Çairit”. Sipërfaqen e madhe me gjelbërim dhe drunj e kish uzurpuar një stadium sportiv betoni. Thuaj ti se, nuk ka pasur për të ndonjë vend tjetër strehimi në periferi të “Çairit”. Sipërfaqe shtetërore të lënura shkret me vite edhe sot e kësaj dite, të mbjellura me misër dhe lakëra nga pensionistët e afërt me shtëpi.

Gjatë ndryshimeve demokratike, Parkut të “Çairit” do t’i sulet edhe një Parti politike shqiptare (PDSH). Lokalin e vogël turistik “Merkez”, do t’ia dhurojë një partizani të saj partiak, të cilin ai brenda pak viteve pas disa “flijimeve patriotike” partiake do ta uzurpojë gati gjysmën e sipërfaqes së Parkut të “Çairit” dhe do të ndërtojë një godinë të madhe disakatëshe biznesi mbi pronën shoqërore.

Lufta e vitit 2001, Parkut të “Çairit” plotësisht do t’ia ndërrojë pamjen e bukur nusërore të përrallave fantastike. Maqedonasit dhe serbët do t’i shesin me të madhe banesat e tyre për pak e për shumë para, vetëm e vetëm që të mos jetojnë më bashkë me shqiptarët. Lufta e 2001 -shit, menduan se i dha fund “vëllazërim-bashkimit”. Prognozë vizionare kjo e gabuar e “vëllezërve”.

Rast i volitshëm ky, që katundarët e fshatrave përreth Shkupit me pak para i blenë banesat e tyre

dhe zbritën në qytet. Një rrezik tjetër ky për Shkupin shqiptar. E sidomos "Çairin", të cilit po ia shohim sherrin si shqiptar sot gjatë "ndryshimeve demokratike". Shkaku se, i lëshonin fshatrat dhe vinin pa vende pune në qytet. Përgaditje të lartë shkollore. Asnjë shpresë ekzistimi për jetë. E, qyteti si qytet, nuk është si katundi ku e ke plot me pula e gjela oborrin. Lopë e dele livadhin. Dru për dimër në të katër anët e shtëpisë. Qyteti të detyron nëse nuk ke ekzistencë buke, të merresh me të gjitha punët tjera joligjore për ta mbajtur veten gjallë dhe familjen.

Tashti, sipërfaqet e gjelbëruara para ndërtesave dhe Parkun e "Çairit" filloi ta mbulojë me të madhe edhe bërlloku. Ferrat që i sillnin fshatarët nga katundi me të cilat rrethonin oborrin e tyre para ndërtesave. Edhe telat e djersitur gjembor, një rrezik tjetër për fëmijët  që loznin top mes hapsirave të mëdha të gjelbërimit para ndërtesave të banimit në mungesë të fushave sportive. Secila ndërtesë banimi ishte mjaftë larg njëra tjetrës, thuajse projektuesit kishin menduar që fëmijët ta kenë edhe parkun e tyre të lojërave para dere. Populli thotë: ***Uji fle, po hasmi nuk flen***. Drunjt filluan t'i presin për dimër, ndezin zjarrin me flakë si në katund rreth oxhakut. Vetëmse, jo këtij "Rreth oxhaku", që e shohim ne për çdo javë në ekranet tona televizive me këngë dhe valle popullore. Shpeshëherë, ku fotografohen para kamerave televizive edhe politikanët tanë dhe artistët e partive politike.

Po, rreth oxhakut ku drunjt e Parkut të "Çairit" digjen flakë. E për mua si shkrimtar, një dru i Parkut të "Çairit" është i barabartë me një njeri. E

pret një dru, e ke vrarë një njeri pas shpine. Tjetër punë është ajo se, te ne në këtë "shtet demokratik" edhe policinë e ka zënë gjumi i thellë dimëror. Nateditë gërhet në gjumë, sharron shelgje mes livadheve.

Përinat të shqiptarëve, përditë e më shumë Parku i "Çairit" zhvishet lakuriq nga bukuria natyrore. Asnjë petk gjelbërimi nuk i mbeti më në trup. Qoftë ai edhe gjethi i Adamit. Rrezik ka, kështu si e kanë nisur partizanët e partive politike shqiptare me politikën e tyre "madhore", një ditë ta lënë edhe pa brekë në mes të Dimrit.

Kryetari i komunës, më në fund falë luftës së 2001 –shit për herë të parë erdhi shqiptar. Shpresa e vetme kjo, për Parkun me gjysëm shpirti të "Çairit" që Ditën e nesërme të ngrihet nga shtrati. Duartrokitje, Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Vetëmse, nuk ndodhi mrekullia e premtimeve të përrallave parazgjedhore. Secili, kujt t'i teket i rrethonte hapsirat para ndërtesave dhe shtronte përmes gjelbërimit rrugica me asfalt për kalimtarët e rastit para zgjedhjeve lokale e parlamentare. Ndërtonte në mes parkut shtëpi pa leje ndërtimi si në kohën e Turqisë. Garazhë për makinën e tij shkatrraçe. Ose, lokal biznesi të çajit rusit. Tjetri kotec të pëllumbave. Partizanët e partisë në pushtet, edhe ndërtesa disa katëshe biznesi të egëra vend e pa vend pa plan urbanizimi, që brenda një nate mbinin si këpurdhat pas shiut.

Hapësirat e të cilave, të nesërmen i shitnin me para të majme në Bit-Pazar. Pasurinë e shoqërisë nisën ta përvetsojnë për vete, bëjnë rrush e

kumbulla para syve të popullit dhe "Shtetit juridik".

Njëzet vjet më vonë, në Ditën e sotshme "demokratike", përveç partive politike kësaj lagjeje të "pastërt" shqiptare me sëpata në krah e duar do t'i sulen edhe "vëllezërit" besimtarë ortodoks të Zotit. Drunjtë e rritur me vite, edhe ato sot pak në numër, brenda një nate do t'i presin persona të papërgjegjshëm fetar në emër të Krishtit dhe me to do t'i ndezin zjarret e krishtëlindjeve ortodokse. Edhe atë, Natën e Madhe, kur besimtarët mysliman të Pejgamberit fundit Muhamedit a. s. e falin "teravinë" në xhami.

Përçudi, me gjithë këta politikanë dhe besimtarë të Zotit dhe Allahut, Parku i "Çairit" në Ditën e sotshme mezi e mbanë veten gjallë mes sëpatave politike dhe fetare para syve të shqiptarëve. Kryetarit të Komunës së "Çairit", që me siguri kësaj radhe duke u marrë gjatë gjithë vitit me "aktivitete kulturore" partiake në Njëqindvjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, e ka zënë pa dru Dimri…

## TRI HERË MATE E NJËHERË PREJE

Moti e kam ditur, por sot jam bindur se politikanët shqiptar nuk punojnë me tru, po me bythë. E tregon këtë historia me fakte, që nuk e luan as gjylja e topit të cilën e rroku për fyti Mic Sokoli. Sharra, siç thotë populli kur has në gozhdë. Tjetër punë është ajo se, ne nëpër këngët popullore me çifteli gjakun e kemi derdhur deri në gju sa që është mbytur edhe kali. Nuk është ky edhe kutadish sa ndonjë problem i madh shqiptar. Qëllimin e kam në tjetër vend, kodër pas bregu: Feja, Besa dhe Trimëria. Tri dukuri në të cilat thirret dhe krenohet më të madhe edhe sot e kësaj dite populli shqiptar. E, në realitet, moti e kam thënë te monodrama: *Një vit frikë* (1994) se, ne nuk kemi as fe, as besë e as trimëri. Shkaku se, një popull që gjatë gjithë jetës së vetë i manifeston dhe krenohet me këto tri vlera historike, ai nuk i ka në vepër. Koha sot vetë e dëshmoi se, a i kemi ne këto tri dukuri si popull të dalim matanë lumit në breg?!

Realiteti e dëshmon të kundërtën me shekuj. Mirë, por deri kur ky popull historik do të provokohet me metoda kaq të ulta provokative?! Shqiptarët në ditën e sotshme nuk kanë nevojë për përmendore e as për varre politike. Trusakatët t'u japin shkak armiqëve tanë historik të na provokojnë e veprojnë në vepër. Nëqind herë me radhë po e përsëris nëpër shkrimet e mia publicistike. Edhe kësaj radhe nuk mund ta përmbaj veten: Pejgamberi ynë i fundit, Muhamedi a. s. ka thënë: Pa Vatan, nuk ka iman.

Gra dhe shtëpi ka pasur sa t'ia dojë qejfi e shpirti i profetit. Nuk e ka pasur fjalën te shtëpia, po te shteti (Atdheu). Shqiptarët, nuk e kanë këtë problem, kanë fat në jetë: E kanë edhe Atdheun, edhe Mëmëdheun.

Politikanët shqiptar, sot është koha dhe duhet t'i ndryshojnë metodat demagogjike të veprimit për të arrirë deri te Liria, Shqipëria Etnike. Punë dhe djersë duhet të derdhin ende nateditë. O, vëllezër futjuni punës! Luftë bëni për Shtet shqiptar e jo për pushtet! E pastaj, kur do ta bëjmë Shtetin shqiptar - Shqipërinë Etnike, anembanë Atdheut do t'i hapim shkollat, fakulttetet, Universitet sipas dëshirës dhe arshinit tonë shqiptar. Dihet, kohë tek atëherë do të kemi edhe për përmendore edhe ndonj varr heroi në Katund.

Demagogët, që gjithë jetën ishin dhe janë në pushtet, sot plot gojën japin deklarata: "Hoqën një copë gur, por ngritën historinë". Sali Berisha nga foltorja e Parlametit të Shqipërisë duke i fajësuar dhe shpallur "serbët si fashistë". Thaçi nga Parlamenti i Kosovës duke e hedhur topin në Luginën e Preshevës. Ose, siç thotë një urtësi popullore: Për pleshtin e djeg jorganin. Realitet shqiptar ky, që Lapidari me gjithë këta "trima mejdani", zihet rob dhe dërgohet në Minstrinë e Drejtësisë së Serbisë, në Beograd. Gjoja për të krijuar procedura penale kundër atyre që lejuan vendosjen e këtij monumenti përpara Komunës, në Preshevë.

Mediat serbe, jozyrtarisht raportojnë se, Lapidari është dërguar në Nish dhe se po mbrohet

në kushte sigurie për mosdëmtimin e tij, deri në veprimin zyrtar të Qeverisë Serbe, dhe për fatin e këtij monumenti historik përkushtuar dëshmorëve të UÇPMB – së do të vendosë gjyqi.

Qëllimi arrirë i politikës shoveniste serbe ishte që t'ju tregojë forcë të shtetit ligjor rebelëve shqiptar, që edhe sot veprojnë "krye më vete" si në kohën e Tirqisë: "Askush nuk është më i fortë se ligji", përgjigjet Daçiqi. Ose, përgjigja e liderve shqiptar të Luginës së Preshevës para heqjes së Lapidarit të UÇPBM -së me deklarata dhe mesazhe kërcnuese në adresë të Beogradit në mbrojtje të Lapidarit të UÇPMB - së. Deklarata teknefese kërcnuese nuk munguan edhe nga Shteti amë, Shqipëria, Republika e Kosovës dhe IRJ e Maqedonisë.

Kryetari i Komunës së Preshevës, Ragmi Mustafa ka deklaruar: " Nëse hiqet me forcë përmendorja nga qendra e Preshevës, atëherë do të shkaktohet krizë institucionale në Komunën e Preshevës dhe Bujanocit si dhe do të ndërpritet bashkëpunimi me Qeverinë e Beogradit. Jonuz Musliu, kryetar i Lëvizjes së Proqesit Demokratik ka deklaruar: " Lapidari i dëshmorëve është ngritur për ta përkujtuar veprën heroike të ish luftëtarëve për lirinë e vendit. Nuk do të lejojmë, që dikush të na rrënojë vlerat tona kulturore, identitetin dhe dinjitetin tonë". Ish komandanti i Brigadës së UÇPBM –së që ka vepruar në rajonin e Preshevës, Lulzim Ibishi, druan se do të ketë arrestime dhe viktima, në rast të intervenimit të dhunshëm të autoriteteve serbe të sigurisë për të

hequr lapidarin e Dëshmorëve të UÇPBM –së, në Preshevë. E plot deklarata të tjera të këtij soji nga politikanë e trima pas lufte.

Fatkeqësia: Persona të papërgjegjshëm politik në Beograd dhe Preshevë luajnë lojëra të rrezikshme në kurriz të popullit shqiptar për ta mbajtur veten gjallë në pushtet. Përmëtepër, kur krekosen e fryhen si gjela deti para një situate të rrezikshme me deklaratën teknefese: "Në rast të intervenimit të dhunshëm, sigurisht se do të ketë kundërpërgjigje të fortë nga shqiptarët".

Partitë politike shqiptare: PD, PS, FRD, LSI dhe Aleanca Kuqezi turren me deklarata pompoze boshe dhe protesta në rrugë kundër Beogradit. Edhe atë, në kohën kur Shtëpia e tyre digjet flakë, përpiqen ta shuajnë Shtëpinë e kojshiut, Beogradit. Shaqiri bën hop, para se ta kërcej përronin: "Luginën e tradhtuan Presheva dhe Tirana". Përmëtepër, merret edhe me deklarëtën e AKSH –së, e cila hë për hë është vetëm një "Organizatë" interneti. Pavetëdije se, pas deklarateve të këtilla mund të qendrojë edhe organizatë policore sekrete serbe. Haptas bën thirrje për një luftë të re: "E patëm mundësinë të bëjmë bam, por jo. Të presim se ndoshta Gafurr Adili, do ta sulmojë Beogradin, siç e deklaroi para disa ditësh. Kur unë para disa viteve u mbështeta në mur dhe nuk kisha përkrahje dhe nuk pata zgjidhje përveç me vetëmbrojtje dhe me ndihmën e Allahut dhe disa shokëve në Tanushë, Gafurri më quante njeri i Serbisë edhe pse luftoja me serbin".

Edhe, plot deklarata të tjera mbareprapë për të shitur mend, pasi qerrja na është thyer në mes të rrugës.

Organizata "Dinjiteti", që është pjesë e opozitës maqedonase dhe që tubon veteranë maqedonas të Luftës së vitit 2001 ka bërë thirrje që, kryeministri Nikolla Gruevski të mësojë nga qeverisja e kryeminstrit serb Ivica Daçiq, lidhur me heqjen e lapidarëve që janë vendosur nga shqiptarët anembanë Maqedonisë. Që. sipas Angellovskit, gjatë qeverisjes së Gruevskit, shumë shkolla, rrugë dhe bulevarde mbajnë emrat e ballistëve dhe veteranëve të UÇK –së.

Thirrje e re për luftë mes shqiptarëve dhe maqedonasve e këtij rrugaçi politik në emër të maqedonasve. Pavetëdije acaron "bashkëjetesën" e dy komuniteteve më të mëdha në IRJ të Maqedonisë: Shqiptarëve dhe maqedonasve. Vorba po vlon mbi zjarr. Kapaku në mes të Dimrit kërcen valle. Grosha derdhet në shpuzë. Shqiptarët ose duhet ta heqin vorbën nga zjarri, ose në vend të cungjeve të shelgut duhet t'i fusin dru lisi, të ndizet flakë e bëhet shkrum e hi në oxhak. Urtësinë popullore ta vënë në praktikë: Ai që luan me zjarr, vetë le të digjet si kërcu shelgu.

Vështirë e ka sot populli shqiptar t'u bëjë ballë Donkishotëve me nga një Sanço Panço pas hipur mbi gomar, që bëjnë luftë nëpër Evropë e Shqipëri për Dylqinenë e Tobozës. Përditë duke e provokuar me njëqind metoda policore të ziera nëpër kuzhina të Beogradit edhe një herë ta fusin në luftë popullin shqiptar. Lufta e shqiptarëve mori fund në vitin 2001, në IRJ të Maqedonisë.

Edhe, e fituam Kosovën republikë. Populli shqiptar në IRJ të Maqedonisë si shtetformues i barabartë me popullin maqedonas. Luftën e djeshme me armë në dorë, sot e zëvendsuam me paqe në politikë. Tashti punët e pazgjidhura i kemi mbi tavolinë. Koha është t'i përveshim duart deri në bërryla, dhe pantollonat deri në gju, t'i futemi punës politike. Rrugës së vetme për të arritur deri te Liria. Shqipëria Etnike.

O popull shqiptar, po deri kur ne do të mrizim si dhentë nën hijen e Dardhave gorrice me kësi deklaratash teknefese deri te Dita e Nesërme?! Sot na e hoqën me dhunë përmendoren e dëshmorëve të UÇKB –së, në Preshevë. Nesër, do të na e heqin edhe Skënderbeun, në Bit – Pazar të Shkupit. Disa metra më larg edhe Hasan Prishtinën, para gjyqit. Adem Jasharin mbi tank, në Katund. Po, deri kur ky popull me këta politikanë do të bëjë "politikë madhore" për Ditën e Nesërme Shqiptare?!

Politikanët tanë kudoqofshin anë e mbanë Atdheut copë-copë, mjaftë më e futën këtë popull në qorrsokaqe politike. Koha është, ky popull këtë "tru" ta përzë me shqelma nga politika strategjike shqiptare. Përveshë mëngët dhe pantollonat deri në gju, këtij populli t'i pri tjetër tru për në Baba Tomor.

Fatkeqësisht, e gjithë kjo shamatë kombëtare bëhet vetëm për jorganin e Nstradin Hoxhës. Nuk e besoj se, nuk e dini edhe këtë anekdotë. Shekuj me radhë gojë më gojë jeton në popull. Vetëmse, përçudi ne shqiptarët nuk marrim mësim. Prandaj, edhe kësaj radhe nuk do t'ju marr kohë në këtë

shkrim parashikues për Nesër. E gjithë puna është për jorganin e Nastradin Hoxhës. Politikën demagogjike me të cilën liderët tanë duan ta mbajnë gjallë veten gjithë jetën në pushtet.

Populli është ai që ka dhënë dhe jep viktima historike. Ende i mbanë gjallë në politikë. Koha është me shqelma t'i përzëmë nga politika teknefese shqiptare. Nëse, duam ta gëzojmë Ditën e Nesërme Shqiptare. Përndryshe, edhe gjatë kohë këta politikanë trusakatë do të na përkundin në djep me ninulla të përrallave shqiptare.

"Vëllezërit" serb, u treguan të "kujdesshëm me përmendoren" që të mos i mungojë as edhe "një copë guri". Përmëtepër, edhe e mbështollën me plastmasë dhe na propozuan që ta vëndosim përpara Pallatit të Kulturës, ose në xhami. Intersant, shekuj me radhë duan të na shohin bythekrye në xhami. Padashtas, na e bëjnë me dije, se: Me këta politikanë të sotshëm e me tru të moçëm ku e kemi vendin, në xhami. Ju lumtë! Vetëmse, kjo vetëdije e shqiptarëve nuk do të zgjasë edhe për shumë kohë. Shqiptarët, që sot nuk do ta ushqejnë më bythën, po trurin.

Serbia të gjithë e dimë se është si gomari para cofjes, përpiqet t'i japë edhe shqelmat e fundit vdekjeprurës ndaj shqiptarëve. Jo, nuk do të ndodhë kjo kurrë. Shqiptarët, besoj se kanë mësuar shumë nga historia deri më tani nëpër shekuj, nuk do të lejojnë që t'i provokojë armiku shekullor edhe për një luftë.

Luftë shqiptarët, patjetër do të bëjnë një ditë (me pushkë apo me penë), por jo kur të dojë Serbia, por kur do të duam ne, vetë shqiptarët.

Edhe ajo ditë nuk është larg. E kemi te pragu i derës. Zoti i ndihmoftë Shqiptarët! E mbi të gjitha, ata vetë Vetëveten si popull historik në mes të Ballkanit.

Vallë, politikanët tanë ende nuk e dinë atë urtësinë antologjike popullore: Tri herë mate, e njëherë pre…

## KOHA ËSHTË PAK "SEHIR" TË SHOHIN SHQIPTARËT

O Imzot, sa i lumtur do të isha t'i shoh Këlyshin me zgjebe dhe Hojdodolen me nga një asht në gojë, kuqezi në tru e jo në palare! Pse jo, edhe Hoxhën e Allahut. Vetëmse jo, nuk e do Zoti. Dhe, nuk e do këtë mrekulli magjike të shekullit. Fatkeqësisht, miqtë e mi dudumë mbi pleh, siç duket e kanë ngatërruar bythën me trurin. Përditë i shoh kuqezi në rrugë, në politikë, instuticione, vende pune, redaksi, manifestime kulturore. Edhe, lehin me shoqe e shokë nën shkrimet e mia publicistike të më "përshëndesin" me komente teknefese anonime: Patrioti i Vonuar, Dum Dumi, Rrumaduci, Hoxha i Allahut, Hojdodlja, Kritik Tullaci me një asht në gojë duke u turrur me të katra për një çmim letrar pas DoktorZiut…

Kuqezi kurdisen gjithë ditën me këmbën përmbi këmbë nëpër vendet e punës. "Postet politike", që për "flijime artistike" presin t'ua dhurojë Nëna Parti si trusakatë. Kuqezi dalin në rrugë. Kuqezi janë nëpër shkolla. Kuqezi nëpër universitete. Kuqezi bëjnë kulturë dhe shkencë. Kuqezi i hapin gazetat dhe ekranet televizive. Gjithë jetën duke u marrë me shpifje, etiketime dhe ofendime.

Kuqezi miqtë e mi të luftës me penë, i përcollën edhe dy ngjarje të rëndësishme historike: Njëqindvjetroin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Pesëvjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha viset shqiptare u nisën këmbë, me kuaj e karroca si dikur Ismail Qemali për në Vlorë. Dikushi si Skenderbe, tjetri si Ismail Qemali e i treti si Adem Jashari. Sa mëshel e qelë sytë e bënë Shqipëri Etnike. Lodrat e çiftelitë i bënë copë – copë në valle para kamerave televizive dhe syve të popullit. I madh e i vogël Mic Sokola, që e rrokin topin për fyti si qymkë koftorri. Vallen krah për krahu: ***Të vranë o Ali Pasha, të vranë***. ***Kokën në Stamboll e trupin në Janinë***.

Tortës së Pavarësisë në Tiranë edhe këto "patriotë kuqezi" të parët iu sulën me legenë e karroca duke e shkelur me këmbë para kamerave televizive. Edhe një herë i treguan botës se jemi popull i lashtë me "kulturë" ballkanike. Punemadhe, që Brukseli nuk na i hapë dyert krah më krah për të hyrë në Evropë. Ne jemi një popull me traditë, që Evropa duhet të hyjë te ne me luftë si "çlirimtare", siç ka hyrë historikisht, e jo ne ta braktisim Atdheun me gjithë familje në mënyrë "vullnetare" si dikur në kohën e Turqisë. Përndryshe, ne dimë të rebelohemi, t'i mbyllim të gjitha portat e Atdheut si në kohën e xhaxhit Enver. Edhe me " vëllezërit", sipas Këlyshit me zgjebe dhe Hojdodoles sot për sot i kemi punët mirë den baba den me të cilët jetojmë si një familje në një Shtëpi të përbashkët. Rrenë është ajo, që thonë se ne me "vëllezërit" jemi në luftë. Cili është ai që do të na përçajë me "vëllezërit"?! Miqtë tanë historik, që edhe të mirën edhe të keqen e kemi ndarë si "vëllezër". Motrën time partizane, që para kohe ma rrëmbeu Zoti.

Tjetër punë është ajo se, vëllai i madh ndonjherë ka të drejtë vëllait të vogël t'ia fusë shuplakë. Traditë shekullore kjo ballkanase. Fëmijët e vegjël duhet t'i edukojmë në shkollë me "vëllazërim - bashkim", përgadisim me "dije" për në Evropë. Nuk i shihi "vëllezërit" e Njerkës se mbyten si qentë në Kuvend për të mirën tonë, popullit shqiptar?! Mikrofonët i shkulin me forcë nga foltorja. Deputetët "vëllezër" të LSDM –së, që Gruevski me polici t'i hedhë si bërdhoqe neokomunsite në rrugë. Edhe gazetarët e "vëllazërim – bashkimit" me kryetarin shqiptar, që "ngulin" këmbë të mos dalin nga Kuvendi.

Moti e kam pritur një veprim të këtillë historik. Shkaku se, njëzetë vjet me radhë partitë politike "maqedonase" bënin luftë për pushtet dhe hynin në Kuvend të përçara dhe dilnin nga Kuvendi të bashkuara si një kokë, kur ishte në pyetje populli shqiptar i "rrezikshëm" për shtetin. E dini, pse?! Jo, nuk e dini. Shkaku se, Partitë "demokratike" Shqiptare hynin të përçara dhe dilnin të përçara në politikë. Falë Zotit, për herë të parë erdhi koha, që dy partitë politike më të mëdha "maqedonase" të hyjnë në politikë të përçara dhe të dalin nga Shtëpia ligjvënëse të përçara me Kuvend të improvizuar në rrugë për rrëzimin e pushtetit të Gruevskit. Gropën që ua bënë dikur partive politike shqiptare duke i fshirë gjurmët me bisht, ranë vetë bythekrye si dhelpërat dinake. Gjatë shëtitjeve me makina luksoze nëpër Qytet, në një makinë e valvitën si grep me një krimb të hedhur për shqiptarët edhe flamurin kombëtar kuqezi.

Edhe, shqiptarët t'i nxjerrin si "vëllezër" në rrugë për të drejta kombëtare. Veten duke e fshehur prapa xhamave të errët, qafë për qafe me "vëllezërit" si në Shtëpi publike . Edhe atë, kush?! Këlyshi me zgjebe dhe Hojdodolja krah për krahu me Patriotin e Vonuar. Flamurin, që dje në Gosivar e zbritën me forcë policore nga komuna dhe e shkelën me këmbë. Pehlivani maqedonas neokomunist para kamerave dhe syve të popullit bëri teposhtë edhe me gishtin e madh të dorës për "fitore". O Imzot, a kaq shpejtë i harruat ato storie televizive?! Kryetarët e komunave të Gostivarit dhe Tetovës kur i rrasën edhe në burg si "nacionalistë shqiptar". Vite me radhë sa ishin ata në pushtet e luftuan Universitetin e Tetovës. Përfundimisht, sot vendosën t'i bojkotojnë zgjedhjet lokale. Shkaku se, Gruevski "shumë" u ka dhënë shqiptarëve: Universiet Shtetëror në Tetovë, Flamur kombëtar kuqezi që ta zvarrisin kur t'u teket "patriotëve kuqezi" edhe rrugëve të Shkupit. E, në kohën e LSDM – së kur ishte në pushtet mezi e nxirrnin dy sahat në Tetatrin e Kombësive, në Bit - Pazar. Gjuhë zyrtare shqipe, Ministër të drejtsisë. Fatkeqësia më e madhe edhe ministër të Ushtrisë maqedonase, ish komandantin e UÇK –ës, Talat Xhaferin. Qeshararke ë, me Organizatën politike maqedonase "Dinjiteti"?! Grafitet e tyre nëpër mure: "ARM + VMRO=UÇK". Talat Xhaferi ka qenë epror ushtarak i Ushtrisë Jugosllave, e nuk mundeshka të jetë ministër i Ushtirsë maqedonase?! Përmëtepër, Ali Ahmeti po e "harxhon" Gruevskin (VMRO – DPMNE -në).

Duartrokitje, nga ana ime si shkrimtar. Edhe, sipas analistëve shovenistë maqedonas, shqiptarët shohin "sehir", nuk dalin me ne krah për krahu të protestojmë në rrugë, rrëzojmë nga pushteti Gruevskin (Millosheviqin). Hi-hii-hiii… Qeshë, unë autori i këtij shkrimi mes rreshtave: Epo, mjaftë më maqedonasit njëzetë vjet me radhë panë "sehir" me shqiptarët duke u rrokur fytas të mbyten në foltore si qentë për një asht. Ose, për të qenë gjithë jetën argatë në Qveri. Koha është, pak "sehir" le të shohin edhe shqiptarët me "maqedonasit" para Ditës Madhe Shqiptare.

Dorën në zemër, për herë të parë partitë politike shqiptare bëjnë politikë madhore para syve të popullit dhe botës. Shyqyr Zotit, më në fund edhe këto burra të grave me brekët mbi pantollona filluan të punojnë me tru e jo me bythë. Nuk e hanë grepin me një krimb, që gjatë gjithë kësaj kohe ua hudhnin në lumë "vëllezërit". E dinë më në fund se, kur duhet të dilet nga Kuvendi për të bërë politikë në rrugë. Tirqit me gajtana t'i zëvëndsojnë me kismetet e pehlivanëve të Shkupit. Edhe, dalin në "protesta demokratike" përpara Qeverisë. Shkurt, falë Zotit madh bëjnë politikë madhore nëpër institucionet e shtetit. Hiç, hiç të mos kenë bërë punë gjatë këtyre "viteve demokratike", një gjë e kanë bërë me kokë. Arritën partitë politike "maqedonase", që gjatë gjithë kohës kanë qenë antishqiptare, tashti t'i bëjnë të merren me vetveten në politikë. U lumtë, burrave të mejdanit me Pehlivanin e Kërçovës në krye me tirqi e xhamadan në vend të kismeteve që zbritën nga mali!

Nuk i kam dashur si politikanë, por tashti kam filluar t'i dua marrëzisht. Papritimas, ma kujtojnë edhe Esat Ymerin, profesorin tim të gjuhës shqipe në gjimnazin e parë të Kërçovës (1964/65). Përmëtepër, në atë kohë edhe me poste të larta politike. I cili shpeshherë na thoshte nëpër biseda të "aktiviteteve të lira": e vëretetë është se, ata me një të rrokme më shtinë përfundi (fjalën e kishte për politikanët maqedonas komunistë), ama unë me "marifete" të këmbës, "sarmës" u çohem dhe i rrëzoj në kokërr të shpinës. E dini "marifetin"?! Jo, nuk e dini as "sarmën" e profesorit. Atëherë, po jua rrëfej: unë isha i veshur me kismete dhe lyer ma vaj si pahlivan i vëretëtë Shkupi. Hë, të mos harroj t'ua them edhe këtë: po të mos jeni ju këtu në Kërçovë, unë nuk mund të rri as edhe një ditë si politikan në Shkup. Meritat politike për ta mbajtur unë veten gjallë si politikan, i keni ju në Kërçovë.

Kohë ajo, e "vëllazërim – bashkimit", kur për herë të parë në Kërçovë mezi u hapën pas shumë përpjekveve të veteranëve të atëhershëm të arsimit shqiptar edhe dy paralele në gjuhën shqipe. Edhe atë, të gjitha lëndët mësimore i kishim në gjuhën maqedonase, me përjashtim të gjuhës shqipe të cilën na e ligjëronte prof. Esat Ymeri me post politik në Komitetin e Partisë Komuniste Jugosllve. Njësoj si sot me politkanët tanë shqiptar me tri-katë vende pune: në Qeveri, Universitet e biznes privat. Dhe, përsëri garojnë në këto zgjedhje lokale (2013) për një vend të katërt pune: kryetar komune. Publikisht, para kamerave televizive nga një post politik japin

dorëheqje, e në anën tjetër që të nesërmen turren me të katra ta riaktivizojnë vendin e punës në Universitet, që u ruhet gjatë gjithë karrierës së tyre politike. Vërtetë, "vëllazërim-bashkim" unikat i nivelit botëror?! Momente të paharruara ato, kur ne viktimat e asaj kohe në fund të vitit shkollor, të gjitha lëndët mësimore i kishim njësha me përjashtim të Gjuhës shqipe.

Problemi ishte me profesorin tim të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në atë kohë se, kundërshtarët e tij politik maqedonas posedonin një fotografi të tij si nxënës, kur ai e kishte recituar një vjershë në shkollën fillore "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në fshatin Kastriot të Kërçovës, në kohën e "Shqipërisë Madhe". Edhe, ato, sa herë që ky e ngrente zërin në Komitetin e Maqedonisë komuniste për të drejta kombëtare të shqiptarëve, e tërhiqnin anësh dhe ia tregonin "tinëz" atë fotografinë artistike.

E kaluar qoftë, edhe e harruar ajo kohë për shqiptarët! Vetëmse, çuditem me popullin tim heroik se, si gjithë jetën mbeti krah për krahu me "vëllezërit" edhe sot e kësaj dite duke i ndarë lugët dhe enët, e jo arat dhe Shtëpinë. Luftë bëri me shekuj për gjuhë shqipe. Shkolla shqipe. Flamur kuqezi kombëtar. E kurrë nuk mori guxim të bëjë luftë për ndarjen e pasurisë së patundshme që e trashëgoi brez pas brezi nga të parët nëpër shekuj, Shtëpinë. Vatanin, që sipas Muhamedit a. s. pa të cilin nuk ka "Din e Iman". Ose, pse i lindi dhe i cofi si trusakatë Këlyshin me zgjebe e Hojdodolen, "kuqezi" krah për krahu me Patriotin e Vonuar në palare e jo në tru.

Koha është, sot shqiptarët një gjë duhet ta kenë të qartë në mes të Ditës Madhe: veshin kismetet e lëkurës dhe të lyhen mirë e mirë me vaj luledielli para se të dalin në fushën e mejdinit si pehlivanë Shkupi. Trurit t'i bien me grushta: me fundërrina të harxhuara neokomunsite përgjatë rreth njëzetë vjetëve të luftës "demokratike" në fushën politike për pushtet e Shtet, nuk mund të themelohet lëvizje e re joqeveritare, e as parti politike e fuqishme shqiptare për ndryshime demokratike të shekullit.

Populli i urtë shqiptar moti e ka thënë: Kalaja merret nga brenda… E, shqiptarët ende janë brenda Kalasë Dardane me shekuj, nuk kanë nevojë të dalin në livadhe…



## SHTËPIA E BABAIT RRËZË ÇUKËS

Përditë bërllokun edhe sot e kësaj dite vazhdoni të ma hidhni para dere. Dhunë të paparë me vite ushtroni të ik nga Shtëpia e Babait. Imzot, po na përsëritet historia. Edhe t'im Atë me njëqind metoda policore donin ta përzënë në Turqi. Jo, nuk iku nga vendlindja, rrëzë Çukës. Përmëtepër, im Atë si trim me "nagantin" në brez një xhandar e zdepi çotek në mes të Pazarit të Kërçovës. Edhe i biri i tij, përfundimisht në Ditën e sotshme për herë të parë e bën publike: Nuk ik në Turqi. Në vend të "nagantit" të Babait e kam nxjerr penën nga brezi. Edhe atë, në këtë kohë qorre kur të gjithë ata shqiptarë brenda një nate të shndërruar në "turq ehamdurila", që dikur ikën në Turqi, sot kthehen me gjithë familje në Shkup.

Vërtet, i biri tij e ndërroi vendbanimin, po nuk e shiti Shtëpinë. Përkohësisht, u strehua në tjetër Shtëpi. Edhe këtu, ia hedhin bërllokun para dere. Megjithatë, nuk shpërngulet në Turqi. E dini pse?! Jo, nuk e dini. Shkaku se, ju pavetëdije ia keni siguruar dhe ia keni blerë disa shtëpi. Falë juve, ai në këtë Kryeqytet i ka disa shtëpi.

Përfundimi: Dudumët nuk e dinë metodën e përsosur policore se si të më përzënë nga Shtëpia ime e Babait. Edhe pse, i kanë disa argatë pa pare. Patjetër, duhet t'i ndryshojnë metodat e veprimit dhe presionit policor. Oborrin e tyre ku jetojnë me frikë dhe timin në mesin e ferexheve. Koha është, sot të filloni ta pastroni nga bërlloku pragun e Shtëpisë.

Atëherë, Unë Kalosh Çeliku me siguri një ditë me gjithë plaçkat në shpinë do të ik me të katra nga Shtëpia e Babait…

## MIKJA NËN RRAP DHE POETËT QË NUK IKIN NGA ATDHEU

Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar në kuadër të Njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë festoi njëzetvjetorin e themelimit si institucion i pavarur kulturor. Takimet nën Rrap shënuan pesëmbëdhjetë vjetorin e themelimit si manifestim poetik i veçantë i poezisë erotike, në Shkup. Poashtu, edhe revista e pavarur letrare STILI 97 (nr. 55 dhe 56), organ i Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar, që në këtë anë të Atdheut erdhi si një zë i ri kryengritës në letërsinë shqipe. Hapi dyert krah më krah edhe të krijuesëve të rinj, sidomos të femrës krijuese rebele shqiptare. Sot një numër i tyre që kanë kaluar nëpër gjirin dhe djepin e Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar në Shkup, janë emra të mirënjohur në Letërsinë Shqiptare mbarëkombëtare, po edhe atë botërore. Njëqind vjet shtet shqiptar nuk janë pak në këtë Ditë të Madhe. Poashtu, nuk janë pak edhe njëzet vjet veprimi të Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup. Nën Rrap, rrëzë Kalasë Dardane për çdo vit ka jehuar vargu lirik i poetëve shqiptar më të njohur anembanë Atdheut dhe botëror edhe para tytave të tanksave (2001). Nata e Madhe Poetike është përcjellur me poezi, këngë e valle deri në agim. Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, u themelua para pasëmbëdhjetë vjetëve për të freskuar varfërinë e madhe kulturore që mbretëronte asaj kohe në Shkup gjatë muajve të verës me vapë.

Edhe atë, me një karakter krejtë tjetër nga manifestimet e tjera kulturore që mbaheshin në IRJ të Maqedonisë, të politizuara deri në palcë. Jo rastësisht, e pagëzuam edhe TAKIME NËN RRAP, manifestim i veçantë dhe specifik i poezisë erotike, që do të mbahej për çdo verë nga fundi i gushtit në organizim të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë. Dhe, i zhveshur krejtësisht lakuriq, ashtu siç e ka lindur Nëna Natyrë nga politika ditore e partive politike, por i veshur me art e vlera të arrira letrare - artistike.

Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, qe manifestimi i parë poetik, që në vitin 1997 në Shkup e zgjoi nga gjumi shekullor Çarshinë e Vjetër, rrëzë Kalasë dhe i tuboi penat më të njohura nga të gjitha trojet etnike shqiptare, Diaspora dhe bota.

Menjëherë, pas luftës së 2001 - shit qe i vetmi manifestim kulturor që solli në Shkup aq shumë poetë nga Shqipëria (një autobus me targa TR), që kurrë nuk ka pasur në gjirin e vet ndonjëherë tjetër ky kryeqytet i vjetër i Dardanisë, ku u lexuan poezi erotike dhe patriotike në mesin e tanksave. Megjithatë, edhe pse manifestimi është i veçantë dhe i vetëm, vite me radhë përballet me vështirësi të mëdha materiale e politike. Shkaku se, individët që merren me politikë “madhore” dhe vendosin për kulturën shqiptare te ne në IRJ të Maqedonisë, nuk kanë haber nga arti, e ku më ta duan poezinë. Mos të them, edhe se e luftojnë me të gjitha forcat dhe armët politike. Partive politike në pushtet, u duhen manifestime të

politizuara, ku ata të munden të trumbetojnë lirishtë të arriturat e tyre demagogjike në politikë, arsim e kulturë. Fotografohen para kamerave dhe në mjetet e shkruara të informacionit gjatë hapjeve të këtyre manifestimeve kulturore si politikanë të "suksesshëm" e dashamirë të arsimit dhe kulturës. Fatkeqësisht, Manifestmi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP, nuk ua ka mundsuar këtë reklamë politikanëve, po poetëve dhe njerëzve të kulturës.

Ja, edhe arsyeja e vetme, që ky manifestim kulturor tradicional ndërkombëtar, edhe pse sivjet u mbajtë për të pesëmbëdhjetën (XV) herë me radhë, ende përballet me vështirësi të mëdha materiale e politike që i ngatërrohen me vite nëpër këmbë. Edhe, e dini nga kush, pjella e tij: "patriotët" e soçëm që e kanë shitur veten një torbë taxhi, vajtojnë e derdhin lotë krokodili në mjetet e informacionit dhe Facebook për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, Isë Boletinin, Pjetër Bogdanin se, "kanë mbetur pa varr", i ka "mallkuar" shkau. E. në realitet këta individë anonimë, pjellë e keqe e mallkuar shqiptare komuniste, asgjë s'kanë bërë për arsimin dhe kulturën shqiptare deri në Ditën e sotshme. Përmëtepër, vazhdojnë t'i dalldisin shqiptarët me parolla të thata neokomuniste.

Vështirësitë, problemet dhe presionet e ndryshme ndaj këtij Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar, në vend që të zbuten pas Luftës së 2001 - shit, ato falë këtyre "patriotëve" thellohen edhe më tepër, përpiqen ta ngulfasin këtë manifestim kulturor në zemër të Çarshisë së Vjetër, në Shkup. Edhe atë, me

veprime trumbetuese për rrethin e vet të trusakatëve partiak, familjar, miqësor e klanor duke trumbetuar manifestime të improvizuara të "vëllazërim - bashkimit" në Çarshinë e Vjetër, në Shkup më shumë si zhurma të politizuara partiake se sa si manifestime kulturore me vlera të arrira artistike.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre vështirësive e presioneve u mbajtën dhe po vazhdojnë të mbahen këto takime poetike për të pesëmbëdhjetën (XV) herë me radhë. Edhe atë, mu në zemër të Shkupit, Çarshinë e Vjetër, në të cilin edhe kësaj radhe morrën pjesë poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare dhe bota. Tjetër punë, është ajo se sa arritën t'i përcjellin këto manifestime kulturore mjetet e informacionit.

Personalitetet e kulturës shqiptare dhe asaj botërore t'i kenë prezentë nëpër emisionet e tyre kulturore. Dorën në zemër, këtu nuk e kam fjalën për përcjelljen e personailteve politike.

Ne qemë ata të parët që e futëm për oxhaku vargun shqip në Bit - Pazar të Shkupit, që në vitin 1997 nëpër Qafë Thanë e Bllacë, nga të gjitha anët shqiptare. Poetët qenë ata që me libra kokë më kokë u strehuan nën Rrap me vargje përqafe në pusi në vend të kollanëve me fishekë. Vargu i tyre nuk ishte vdekjeprues, po jetëdhënës e paqedashës. Dihet, me moton: nëse nuk e do veten, nuk mund ta duash tjetrin. Varg i dashurisë. Varg që i afronte popujt, e jo të vazhdojë t'i ndajë ende me kufinj politik shqiptarët. Prandaj, këta "plumba" dum-dumë të poetëve i ulën edhe tytat e tankeve të tërbuar gjatë luftës së 2001 - shit, që na kishin rrethuar

natën gjatë një manifestimi kulturor: TAKIME NËN RRAP, në Shkup nga të katër anët e Atdheut. Rastin më mirë e di dhe ende e ka të freskët edhe në varr poeti ynë rebel Pano Taçi me poetët e tjerë pjesmarrës në manifestim, kur dy policë si të tërbuar hynë në autobusin me targa TR dhe ia rrëmbyn kamerën nga duart me të cilën e kishte regjistruar mbarëvajtjen e Manifestimit Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP. Në atë kohë lufte, poeti ynë i mirënjohur Visar Zhiti, pjesmarrës në ngjarje do të shkruaj dhe botojë në gazetën "Dita" të Shqipërisë edhe reportazhin emocional nga Shkupi: ***Të lexosh pozi pranë tanksave***.

Edhe, plot pusi e atentate i kaloi ky manifestim kulturor nga mashat shqiptare për të arritur deri te Dita e sotme, nën hije të Rrapit ta lidhë Gjokun krah për krahu me Skënderbeun, në Shkup. Në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë erdhi në Shkup edhe Hasan Prishtina. Nesër, vjen me shokë edhe Pjetër Pogdani. Mikja me dy shtamba verë, t'u japë gji poetëve që nuk ikin nga Atdheu, fuqi për luftë me penë…

Nën Rrap, gjatë këtyre viteve kaluan emrat më të njohur të letërsisë shqipe dhe asaj botërore, mbi njëqind poetë. Mikja u dha gji me dy shtamba verë nën Rrap poetëve rebel që nuk ikin nga Atdheu: Frederik Rreshpja, Teki Dërvishi, Musa Ramadani, Xhevahir Spahiu, Mirko Gashi, Pano Taçi, Zyhdi Morava, Visar Zhiti, Gani Xhafolli, Skënder Rusi, Fadil Bekteshi, Vahit Nasufi...

Ditën e sotme të Motit Madh, në Njëqindvjetorin e Pavarësisë të Shqipërisë, poetët përsëri u ulën këmbëkryq rreth sofrës poetike.

Sipas programit të paraparë nga organizatori, i përkujtuan me portrete letrare, miqtë e Rrapit: Hida Halimi dhe Pano Taçi. Reshat Sahitaj për disa çaste në mesin tonë me një poezi e ringjalli Hida Halimin***: Dhe nisem***, e hap krah më krah portën letrare. Rreth veprimtarisë letrare të Hida Halimit folën miqtë e saj të penës: Gani Xhafolli, Reshat Sahitaj, Beatriçe Balliçi e Kalosh Çeliku. Mikun tjetër të Rrapit, Pano Taçi e përkujtoi Pandeli Koçi. Remzi Salihu me një studim artistik: ***Dy net burg me Pano Taçin***. Përjashtim radhe, bënë miqtë tanë nga Greqia: Kostas Valetas dhe Iliaz Bobaj. Natën e Madhe ata nuk e pritën me ne nën Rrap. Shkaku se, duhej të udhëtonin për në Greqi. Nesër janë në punë. Librat e tyre më rrinin kokë më kokë mbi tavolinë "për t'ua prerë kërthizën". Përurimin e tyre e hapi poeti Iliaz Bobaj me librin e Kosta Valetas: ***Drita e Lesbos***. Paskal Gilevski edhe ai doli me një diskutim për librin me tregime të mikut vëlla grek. Tashti, sipas zakonit fjala iu dha edhe Kosta Valetas. Reshat Sahitaj i përktheu fjalët e tia nga gjuha frënge. Shkrimtari i madh grek gjatë diskutimit i lëvdoi shqiptarët duke thënë se janë vëllezër me grekët. Thotë: Unë i dua patriotët dhe nacionalistët, po jo edhe shovenistët e pushtuesit. Radha i mbeti poetit Iliaz Bobaj me librin e tij satirik: ***Kali i pushtetit***, që posa ka dalë në dritë nga Shtëpia Gazetare Botuese "ASDRENI", në Shkup. Rreth librit diskutuan Pandeli Koçi dhe Prend Buzhala. Në fund fjalën e mori edhe vetë autori i librit. Përgëzime. Urime.

Gjatë asaj nate u bë edhe përurimi i dy numrave më të ri të revistës letrare: ***STILI 97***,

përkushtuar njëri Mikes të Rrapit - Hida Halimi dhe tjetri Mikut të Rrapit - Pano Taçi. Fjalë miradie foli kryeredaktori i revistës letrare, Kalosh Çeliku.

Pasmesnate, juria profesionale e përbërë nga Reshat Sahitaj (kryetar), Remzi Salihu (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndanë edhe çmimet letrare: Për vepër jetësore e rrëmbeu shkrimtari Kosta Valetas. Tjetrin, për vepër erotike e fitoi poetja nga Elbasani Beatriçe Balliçi. Një çmim Mikja e Rrapit iu nda edhe poetes bullgare Dima Çomova. Çmimin e poezisë erotike kësaj radhe e mori poeti Fatmir Musai.

Agimi, të nesërmen me të dy këmbët zbriti në Shkup. Poetët i priste rrugë e gjatë për në vendlindje. Satiristët i shaluan kuajt e shalës për në Kërçovë, në Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA. Plaku mjekërbardhë si dikur me shkopin me kërrabë përpara këmbëve u doli para t'i presë te porta me anekdota.

Pasdarke, nga malli për humanistin e madh shqiptar, poetët përsëri e shaluan vargun, kësaj radhe atë humoristik dhe satirik. Për disa çaste e sollën Xha Derallën në mesin tonë me humor dhe satirë. Orën simbolike satirike e hapi Ibrahim Koça me poezinë e Ali Asllanit: *Hani, pini dhe rrëmbeni*. Vëllezërit Dervishi i përshëndetën të pranishmit me këngën kërçovare: *Në bahçe na ka ra bryma*. Lumturi Axhami i dha zjarr e flakë me një këngë dasme kërçovare. Poetët, pas këngëtares e morën Natën e Madhe në dorë me humor dhe poezi satirike. Njëri pas tjetrit lexuan poezi, rrëfyen barcoleta, edhe anekdota. Dikur, çetës së tyre i erdhi në ndihmë edhe Xha Deralla

me anekdotat e tij të "egra": *Hoxha i katundit*, *Pajtimi me Kolibaret* dhe *Xhandarët e serbit*.

Ditën e nesërme, u bë edhe përurimi i dy librave të satiristit kërçovar Begzat Rrahmani: *Gjarpërinjtë e fushës sterile* dhe *Eunukët e Haremit*. Rreth krijimtarisë letrare të autorit dhe librave diskutoi Bekim Adili. Poashtu, u bë edhe përurimi i numrit më të ri të revistës për humor dhe satirë, që del kur t'i teket ZEKTHI.

Tryeza satirike kërçovare u shtrua në mesin e poetëve: ***Humori dhe satira brez pas brezi e mbajtën gjallë popullin heroik shqiptar në mes të Ballkanit.*** Atmosferën e ngrohtë satirike e ndezën me diskutimet e tyre rreth humorit dhe satirës nëpër shekuj. Në fund, Tryezën satirike e përmbylli artisti i madh strugan Pajazit Murtishi, që kishte ardhë nga Amerika me një fragment të poemës Naim Frashërit *Bagëti e Bujqësi*.

Nata e Madhe kërçovare i hapi dyert krah më krah me humor, satirë dhe këngë deri në agim. Poezitë e tyre i lexuan poetët: Gani Xhafolli, Pandeli Koçi, Nikolla Spathari, Begzat Rrahmani, Xhevdet Ukalli, Bujar Plloshtani, Fatmir Musai, Remzi Salihu, Xhelal Ademi, Ilmi Veliu, Ibrahim Koça dhe Kalosh Çeliku.

Pasmesnate, juria profesionale e përbërë nga Reshat Sahitaj (kryetar), Remzi Salihu (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndau edhe çmimet letrare: për vepër jetësore satirike Nikolla Spatharit, për vepër satirike Iliaz Bobaj dhe për poezi të "egër" satirike gazetarit dhe humoristit Ibrahim Koça (Date Koçi).

## GOZHDA E NASTRADIN HOXHËS

Eh, lexuesi im i nderuar, sikur këto politikanë shqiptar, këto akademikë, këto intelektualë, këto shkrimtarë, këto gazetarë, këto patriotë me kësula të bardha në kokë, shalla kuqezi përqafe e pa to, të punonin e reagonin me kohë për arsimin në gjuhën shqipe, kulturën shqiptare! Vërtetë, do të hapte një faqe të re historia. Nuk do ta lodhnim sot shumë kokën me "Makedonska enciklopedija", Letërsi maqedonase e marrëzira të tjera se, a jemi kaçakë dhe a kemi zbritur nga mali. Gazetat t'i mbushim kotnasikoti plot reagime e vajtime të grave. Edhe, kush?! Trusakatët, që më së shumti sot kanë faj për këtë gjendje momentale shqiptare si "akademikë", "analistë" politik të vendit e importuar me shumicë e pakicë nga Kosova e Shqipëria.

Partizanë "besnik" të partive politike shqiptare, anëtarë jurie të çmimeve letrare republikane e përpiluesë të "makedonska eciklopedija" e Letërsisë maqedonase. Popullin shqiptar, me "organizatorë të fshehtë" sot ta thirrin me protesta në rrugë: "Pranverë shqiptare". E në të vërtetë, ai është në rrugë me vite, i papunë falë partive tona politike shqiptare. Po, ja që nuk reagojnë burrat e botës në mjetet e informacionit, nuk protestojnë në rrugë me parulla e pankarta në duar për arsimin e politizuar deri në palcë, nuk e ngrejnë zërin për liri. Dorën në zemër, me të gjitha forcat reaguan për "Makedonska enciklopedija". Punë e madhe. Pamfleti politik, që na e dhuruan "vëllezërit", duam - s'duam ne,

do të përfundojë në Bibliotekën Popullore Universitare të Shkupit: "Shën Kliment Ohridski", ose nëpër shtëpitë e lexuesve të "vëllezërve" të Njerkës e shqiptarë. Nuk më pengon kjo, dhe as që kam kohë e ndërmend të merrem në Ditën e sotshme historike me një pamflet të këtillë teknefes që e polli mushka me fletët e së cilës nesër torbeshët do të fshijnë bythën e shesin fara kungulli nëpër qytet.

E rëndësishme është se, më pengon Vetëvetja. Politizimi katastrofal i arsimit shqiptar dhe kulturës shqiptare. Fatkeqësisht, e kemi nën nivelin e pas kohës së Luftës së Dytë Botërore. Ne nuk kemi ende në nivel arsim shqiptar evropian, ne nuk kemi ende kulturë të arrirë shqiptare botërore. E në anën tjetër, kemi kohë për të harxhuar energji për një pamflet politik mushke. Kohën e fundit, edhe për zgjedhje lokale. Shqiptarët nuk duhet të tremben se, mezi më në fund u bashkuan partitë politike maqedonase (VMRO-DPMNE dhe LSDM) për "rrëmbimin" e komunave shqiptare: Kërçovën dhe Strugën. Shyqyr Zotit, erdhi dita që edhe këto "parti politike rivale maqedonase" u bënë si gjithmonë bashkë, dalin krah për krahu në zgjedhje lokale kundër shqiptarëve. Gjithë jetën mbetën të ndarë në serb e bugllarë: edhe në kohën e Serbisë, edhe në kohën e Turqisë, edhe në kohën e Gjermanisë, edhe në kohën e Jugosllavisë së shokut Tito, edhe në kohën e IRJ të Maqedonisë. Vetëmse, kur janë në pyetje shqiptarët që kanë zbritur nga mali, ato bëhen bashkë këmbekokë si një parti politike.

Historikisht, kjo do të thotë: shqiptarët vazhdojnë të jenë Buba pas dere për partitë politike "maqedonase", që edhe në ditën e sotshme nuk e dinë se ku e kanë kokën e ku bythën.

"Analistët" e Oborrit shesin plot "mend", përpiqen t'i hapin rrugë për në Evropë këtij shteti artificial të Shokut Tito në mes të Ballkanit. Që, është bërë si gozhda e Nastradin Hoxhës ngulur në mur, kur e ka shitur Shtëpinë. Anekdotën e Nastradin Hoxhës besoj se e dini, nuk ka nevojë në këtë shkrim profetik të ju marrë kohë. I madhë e i vogël thonë: Partitë politike shqiptare duhet të bashkohen në këto zgjedhje lokale, shkaku, se: i humbëm Strugën dhe Kërçovën. Gabim i madh. Partitë politike shqiptare nuk duhet të bashkohen në këto zgjedhje lokale, le t'i masin kush si di dhe si mundet forcat politike duke u përçarë copë-copë deri në varr. Përmëtepër, nuk e di pse çojnë kaq shumë inatë, pluhur e tym politik, kur në Kërçovë edhe kandidati tjetër "maqedonas" është me prejardhje shqiptare nga një fshat i malësisë. Faleminderit, duhet thënë partive politike të "bashkuara maqedonase". Njohuri të sakta nuk kam me kandidatin për kryetar komune nga Struga. Me siguri, edhe ai është me prejardhje shqiptare. Vështirë është në këtë Maqedoni të Shokut Tito, sot të gjejsh ndonjë maqedonas të pastër për farë nga gjaku. Shumica janë me prejardhje bullgare, serbe, vllehe, turke e ndonjëri edhe shqiptare. Burra e gra, mos u zini kot për zgjedhjet lokale, turruni e ua jepni me të dyja duart votat e lira demokratike edhe kandidatëve të

tjerë të partive politike kundërshtare “armike”, edhe ato janë shqiptarë. Energjinë politike mos e harxhoni kot, kur pas dere i kemi zgjedhjet parlamentare. Koha është, këtu t’i masim forcat me palën tjetër kundërshtare politike “maqedonase”. Tjetër punë është ajo se, kandidatët e partive politike “maqedonase”, nuk janë të fesë myslimane, po të asaj ortodokse. E gjithë kjo, shumë pak rëndësi ka në këto zgjedhje lokale. Kryetari i komunës së Kërçovës, patjetër në mos sot, nesër do të jetë shqiptar. E, tashti i cilës partie politike: BDI, apo i kualicionit VMRO-DPMNE - LSDM, shumë pak ka rëndësi në Ditën e sotshme historike.

O shqiptarë, mjaftë më pavetëdije punuat e luftuat për armiqtë historik! Shtetin e shokut Tito, që pas Luftës së Dytë Botërore e polli pas mullarit me barë Jugosllavija e sot e përkundin serbët e bullgarët në djep me ninulla shoveniste - nacionaliste. Popullin artificial pakicë të prodhuar nga shqiptarët, bullgarët, serbët, vllehët, turqit e romët. E ktheni kokën pas një herë edhe për shqiptarët, popullin shumicë në këtë vënd, që me plot arsye u takon të udhëheqin me Qeverinë e Shtetit. Pse jo, le t’u kërkojnë shqiptarëve një herë edhe “vëllezërit” e Njerkës gjuhë amtare, shkolla, flamur, Universitet, Akademi të shkencave e të drejta kombëtare. Veten le ta provojë edhe ky popull artificial në rolin e lypsit te Ura e Gurit. I bindur jam se, shqiptarët do t’ua jepnin me të dyja duart të gjitha këto të drejta kombëtare.

E nesër?! Nesër, shohim e bisedojmë në Kuvendin shqiptar të Maqedonisë se, sa banorë të

"vëllezërve" të Njerkës do të ketë ky shtet multietnik, që me këmbëngulje duam ta ndërtojmë ne shqiptarët. Edhe njëherë them: ktheni kokën, shikoni prapa në lëmë! Arsimin e keni në gjendje katastrofale, me pak shpirt nëpër shkolla. Ende nuk keni shkolla fillore. Planprograme. Tekste shkollore. Lektyra shkollore. Abetare.

E këndej, ia futni pordhë politike në mes të ditës në qiellin e kaltërt me diell mbi kokë kundër enciklopedisë të "vëllezërve" të Njerkës. Përgëzime, në një "Mbrëmje Gala": "Milingona e artë" (ku ka milingonë të artë?!...), Puntormadhja bashkë me "Nova Godinën" në një juri "profesionale", mes çmimeve politike parazgjedhore lokale, Çmimin e artë të karrierës ia japin edhe DoktorZiut. Urime! Gojën plot e them: ju jeni edhe kundër fëmijëve të juaj në bangat shkollore. Vite me radhë i keni lënë pa lokale shkollore. I keni lënë edhe pa mësuesë. E them këtë se, më ka ardhë më deri në fyt. E kam vjellë ushqimin (bukën). E kam vjellë "politikën madhore". I kam vjellë edhe zorrët. Dhe, nuk kam më çka të vjellë, nxjerr jashtë nga barku për në hale pas Shtëpie.

Poezinë, jo nuk e vjellë. Edhe librat e Rilindasëve. Pamarrë parasysh se, çka do të bëni ju si politikanë "evropian" me historinë shqiptare. Kërkesës së Qeverisë turke për ta ndryshuar, "pastruar nga ofendimet historike shkencore".

E di, politkanët duan t'i vjellë edhe këto pasuri e dhunti të Zotit, po ja që unë nuk dua t'i vjellë. Unë e vjellë politikën e tyre teknefese "madhore". Unë i vjellë argatët e tyre trusakatë brez pas berzi.

Dhe, unë i vjell me gjithë zorrë spiunët e tyre shekullorë. Pse, do të thoni ju si lexues?!

Nuk ka problem, edhe këtë fshehtësi do t'ua rrëfej si shkrimtar. Vetëmse, nesër nuk dua të më ankoheni te partitë politike "shqiptare". Nëna e juaj Njerkë. Shkaku, ngase: Nëna juaj Njerkë, nuk u jep tambël si Nëna e juaj e vërtetë. Djepin nuk di ta përkund me ninulla shqiptare deri në mëngjes. Nuk ju merr në gji si Nënë shqiptare.

Punemadhe, do të thoni ju burrat e mejdanit me brekët nëpër këmbë. Nuk është ashtu, lexues i nderuar. Nuk është njësoj të pish tëmbël te Njerka dhe të thithish gji nga Nëna shqiptare. E them këtë se, thirrem dhe u besoj ligjeve të Natyrës. Vërtetë, është e përkryer kjo filosofi natyrore. Kot mundohemi ne artistët me këmbëngulje t'i bëjmë konkurencë filosofike. Natyra është ajo, që momentalisht është e pakalueshme me kryevepra. Nesër nuk dihet, del ndonjë burrë nëne dhe e kalon edhe Nënën Natyrë.

Fatkeqësi, kombëtare, ë?! Partitë politike, nesër kush do t'i marrë në gji?! Kush do t'i përkund në djep?! Kush do t'u jap tagji?! Kush do t'i nxjerrë në rrugë çdo katër vjet në zgjedhjet komunale e Parlamentare?! Tymeflakë, në emër të popullit do të nxjerrin nga goja për "fitore" e pushtet. Zërin do ta ngrejnë lartë nëpër fushata zgjedhore për Gjuhë shqipe. Universitet shqiptar.

Akademi shqiptare. Shqipëri Etnike. Punemadhe. Edhe kësaj radhe le t'u jap Njerka gji me shtamba. Vetëmse, një gjë duhet ta pranojnë: janë kopila. Kopila edhe do të vdesin brez pas brezi, hyjnë në varre si kopila. Profetike, ë?!

Kopilat, dihet e kanë Njerkën. Dhe, Babën e rrejshëm. Vetëm, nuk e kanë tambëlin e Nanës. Gjirin, që edhe të vdekurin e çon nga varri. Tambëli i Nanës është jeta. Shpirti. Gjaku që ecën nëpër damarë. Lufta që e bëjmë ne shqiptarët nëpër shekuj brez pas baezi për liri. Edhe, në doni të ju flas, shkruaj marrëzira: Mjerimi. Po, kur do të ju dalë gjumi shekullor, ngrisni zërin si kaçakë mali për Shtet shqiptar?!

Nesër. Ose, pasnesër?! Vonë. E them këtë se, nesër më do të keni vdekur, gërhisni në varr. Ndodhë, të sharroni shelgje nëpër livadhe. Ndonjëri, ndoshta do të bëjë edhe çerepë. Saç me shpuzë nuk do të keni ta piqni bukën në mes të odës. Saç me shpuzë.

O Imzot, edhe kësaj radhe mos ua merr për të madhe! Nuk shohin me sy. Nuk dëgjojnë me veshë. Nuk dinë me tru. Ua ke dhënë sytë, po nuk i shohin shenjat e Dritës. Ua ke dhënë veshët, po nuk e dëgjojnë lodrën matanë Kodrës. Ua ke dhënë kokën, po nuk e kanë në qafë në këto vrapime maratonike.

Halli?! Edhe një lutje: ua kthe në kokë! Në mes të Shkupit nuk kam vend si shkrimtar rehat ku të pi as edhe një kafe. Rrugët e Bit- Pazarit janë të bllokuara me “besimtarë mysliman” me gjithë këto xhami në Çarshi të Shkupit e nëpër katunde me dy e katër minare që i luten Allahut në mes të sokakut me këmbët dhe trutë në legen e bythët në hava. Në shërbim të kujt është ky bërllok mysliman “shqiptar”, që vendin e ka në xhami e jo në rrugë t’i lutet Allahut?! Amani, mos më thuani se është në shërbim të Xhamisë Shqiptare! O Imzot, sa i lumtur do të isha që ky

"xhematë" mes sokaqeve të Bit-Pazarit të faleshte e luteshte për shkolla shqiptare. Matanë, te këmbët e Urës Gurit më presin misionarët grek (Metropolitë të Beogradit). Përkarshi, Olimbia Ilire me gratë e bukura e fëmijët në gji duke u dhënë tambël. Filipi i Maqedonisë u bënë roje duke i përshëndetur me grusht si xhaxhi Enver me shpatën në brez. Aleksandri i Madh me shpatën në dorë e ka shaluar kalin për luftë matanë Vardarit. Mëshirë, o Zot! Nuk e bëjnë këtë se duan, po nuk dinë. Patjetër, duhet dikushi t'u pri në ballë. Rrok për dore. Tjetër është ajo se, këtij populli i prinë në ballë gjysmanalfabetët e partive politike e fetare. Edhe një herë ju lutem në emër të Krishtit e Muhamedit, mos e merrni më qafë dhe fajësoni popullin shqiptar në këtë jetë e në atë jetë, rrëzë Kalasë Dardane!...

Dënimi duhet vuajtur gjithësesi, dëgjova një zë nga qielli. Edhe një rrufe në qiell të hapur mbi lisa. Rrufeja, kurrë nuk ka shti në ferra. Pajtohem. Vetëmse, nuk i dorëzoj armët e mejdanit. Atëherë, së paku le të jetë sa më i lehtë dënimi historik, pa dhimbje. Nëse është nevoja le të digjemi në zjarr të Xhehnemit! Njëherë e përgjithmonë t'i lajmë mëkatet si popull i zgjedhur nga Zoti, që me siguri edhe ai ka prejardhje shqiptare.

Jo, përsëri bërtiti zëri nga qielli. Juve si popull shqiptar, u ka nemur Turku. E nama, përderisa të zë vend fluturon në qiell e tokë. Fatkeqësisht, kësaj radhe zbriti në tokë, në mesin e shqiptarëve. Këmbëkryq u ulë edhe në xhami. Hoxha thirri në minare.

Ndihmë! Ndihmë, o Zoti Madh! Na shpëto edhe kësaj radhe nga robëria pesqindvjeçare anadollake! Asimilimi. Ti e di se ne më nuk kemi të lindim edhe një Skënderbe, që të na çlirojë nga halldupët, heqi prangat e robërisë. E patëm një, po edhe këtë duan të na e marrin "vëllezërit" e Njerkës. U kemi dhënë mjaftë. Po, këto siç duket e kanë barkun e madh tinar. Thesit nuk janë duke ia lidhur grykën. Përmëkeq, e kanë një thes të grisur me arna. Specat u bien udhës. Patlixhanat. Edhe, patatet e kalbura…

Mëshirë, o Zot! Ecin rrugës e flasin jerm. Ndonjëri ka përmirë edhe në sofër të xhindeve. Sokaqeve të Bit-Pazarit flet vetmevete marrëzira. Babashehu i fry në Tyrbe. Hoxha kot përpiqet t'ia këthejë në kokë me një hajmali për qafe. Përsëri, ai pas "namazit" nga xhamia delë në protesta politike me "organizatorë të fshehtë" në rrugë. Nuk e zënë magjitë, xhindet e kanë në dorë. Natë për natë e hudhin dorë më dorë mbi çatia. Majë lisave. Nuk e dinë ku e kanë bythën e ku kokën. Përmëtepër, Hoxha i Allahut kur më sheh mua i pari që zbres nga autobusi dhe dua ta kalojë rrugën në vizat e bardha, më ikë dhe futet te dyqani i një vëllai të një partie politike me kokën e bythën në grazhd. E sa di unë, bota përparimtare do kokë e jo bythë të ngritura në hava nëpër Bit-Pazar.

Zoti Madh, siç duket është me ne shqiptarët, po shqiptarët nuk janë me Zotin. Rrufeja nuk shti në ferra. Shqiptarët kanë shumë ferra nëpër oborr, përpara Shtëpisë. Fat, që ferra kanë edhe "vëllezërit" e Njerkës me qerre. E pak lisa rreth Lëmës e Livadhit. Fitorja është e atij që e ka

Rrapin në mes të Livadhit me lisat kokë më kokë. Armën e luftës që e ka varë në një degë lisi. Dhe, e ka lidhur gjokun pullali nën hije.

Bashkimin e partive politike shqiptare, mund ta bëjë vetëm populli shqiptar. Kryetarët e komunave shqiptare t'i zgjedhë me votën e lirë demokratike. Edhe atë, pa bashkimin e partive politike shqiptare në këto zgjedhje vendimtare lokale. Tekefundit, kushdoqoftë kryetar i Kërçovës dhe Strugës, ato kanë qenë dhe janë komuna shqiptare.

Histori më vete është ajo, se: Maqedonia është një gozhdë e ndryshkur të cilën e ka ngulur në mur Nastradin Hoxha për ta varë setren kur e ka shitur Shtëpinë...

## PESË ASKUSHËT E NJERKËS NDJEKIN ARTISTIN

Ferra bën ferra. Kurrë nuk bën mollë. Ose, kumbulla. Përmëtepër, rrush. Nuk e kam thënë unë autori i këtij shkrimi. E ka thënë, popullli. Unë, vetëm e përsërita në këtë shkrim, për aq sa t'ua përkujtoj këtë kryevepër të poppullit.

***Adem Kastrati***

Populli është ai edhe, që më së shumti ia sheh sherrin kësaj pjelle të rrufjanëve komunistë, kopila që pasmesnate na i lanë pas porte. Një Zot e di se, me cilët u hipën në kohën e komunizmit. Që, edhe në Ditën e sotshme të na trokasin pas porte në barkun e Kalit Trojës. Turren me të katra pas shpine për një torbë cc c v 0taxhi. Nateditë t'i ndërsehen nga pusia Trurit shqiptar.

Dëshmitar i gjallë jam për jetën dhe veprën e një piktori të madh shqiptar, Adem Kastrati.

Ferrin komunist nëpër të cilin ai kaloi si artist shqiptar. Përfitimi, kam qenë nxënës i tij në Shkollën Normale në Shkup. Edhe, e përkujtoj një shkrim kritik timin në atë kohë në gazetë: *Flejnë profesorët, flejnë nxënësit, flejnë aktivitetet e lira*. Profesori shkrimin nuk e priti me duartrokitje. Megjithatë, nuk mu hakmorr si nxënës me "ndëshkime pedagogjike". Momente, kur e pashë në vepër artistin se, vërtetë ishte i Madh. Malli më ka marrë sot për kalibrin e nivelit të tij pedagogjik në arsim. Dihet, nuk ka qenë i vetëmi veteran i arsimit. Trimi i mirë me shumë shokë. Thotë, populli. Pemë që sot, dhanë fruta. Rrënjë të thella kanë shti në çdo qytet shqiptar.

Profesorin dhe piktorin e madh shqiptar Adem Kastratin do ta njoh më së miri pas studimeve. Edhe atë, në vitet e tetëdhjeta, pas kthimit tim nga Prishtina, kur gjithë kohën e lirë do ta kaloj me të dhe disa miq të penës kokë më kokë në Teatrin e "pakicave kombëtare", në Shkup. Tek tashti e shoh se, edhe pse unë katër vjet me radhë e kisha pasur profesor të artit figurativ, nuk kisha ditur asgjë rreth problemeve të tij jetësore dhe artistike si veteran i arsimit dhe patriot shqiptar. Kurrë, gjatë orëve të mësimit problemet e tij, nuk i kishte shprehur para nesh, në mesin e shkollës. Gjithmonë, i buzëqeshur plot vullnet për punë me atë thënien e Naim Frashërit: *Natën ta bëjmë ditë.*

Tashti, pas kaq viteve e shoh Natën dhe Ditën e piktorit të madh shqiptar. Artistit, që me brushë në dorë i kishte vënë gjoksin para kohës qorre.

Njerkës me pashterkë të kuqe, që në mesin tonë shqiptar gjuante me qerre "nacionalistë dhe

irredentistë". Burri, që kurrë nuk u ankua për gjendjen e tij materiale e artistike si i pabarabartë me "vëllezërit" maqedonas me honorare e atele shtetërore, kur ky nuk kishte as çati mbi kokë duke krijuar e jetuar në një podrum, herë pas here duke e vërshuar uji i shiut rrebesh. Dhe, në stinën e vjeshtës nga podrumi ia nxirrte pikturat si anije pa vela rrugëve të Shkupit për në Ekspozitën figurative të Vjeshtës nën "përkujdesjen" e fenomeneve natyrore. E them këtë se, kohën e fundit nga "dekoratat e luftës" më ka ardhë deri në fyt: rrufjanët nderohen dhe shpërblehen me çmime të majme letrare e pensione - shpërblime republikane për "merita artistike", gjoja për vlera të arrira kulturore.

Edhe sot, më kujtohet kur në Lidhjen e Shkrimtarëve Shqiptar e solli pikturën e Pjetër Pogdanit (1999), të një formati të madh sa që na e zuri plotësisht një anë të murit. Gjendjen tonë materiale në të cilën na gjeti papritmas si shkrimtarë. Momente ato, kur kultura shqiptare ndiqej si shtrigë dhe mezi prisnin ta dënonin në turrën e druve. Dorën në zemër, ishte bashkëluftëtari ynë në çdo pusi krah për krahu në luftë. Bashkëpuntor i rrgulltë i *Zekthit*, kopertinës dhe karikaturave të librit me satira: *Kali i Trojës nëpër Bit – Pazar* (1994) me pseudonimin e tij letrar, Cun Geli. Përmëtepër, dora e tij e piktorit i gëlqerosi pa asnjfarë shpërblimi material edhe zyrat e Lidhjes së Shkrimtraëve Shqiptar.

Adem Kastrati nuk ishte vetëm piktor, por edhe publicist dhe dramaturg. Tjetër punë është ajo se, dramat e tija nuk arritën gjatë asaj kohe të

vihen në skenë, shkaku se: të punësuarit në atë Teatër ishin edhe aktorë, edhe drejtorë, edhe regjisorë, edhe shkrimtarë. Pazarin kulturor e bënin në mesin familjar, miqësor, klanor e partiak. Kastrati, ishte njohës i mirë i folklorit shqiptar. Fshikullues i rrept i anëve negative përmes shkrimeve dhe karikaturave, që herë pas here publikoheshin te *Zekthi*, revistë për humor dhe satirë që, ***del kur t'i teket***, në Shkup. Halë në sy e bërllokut komunist e fetar fundamentalist dhe policisë letrare nateditë në pritë pas porte.

Piktori i madh shqiptar, profesori dhe miku im besnik i Luftës me penë, një ditë iku papritmas nga mesi ynë para syve të pikturave, fluturoi në qiell mes yjeve. Përsëgjalli, përveç pikturave, disa dramave dhe karikaturave, ai na e la amenet për botim edhe një ditar (Fadil Currit). Ditar të cilin shkrimtari Fadil Curri do të marrë guximin edhe ta botojë si libër. Amaneti, është amenet. Pa sikur, edhe ai të kushtoj me kokë.

Vite më vonë, pas arratisjes të piktorit të madh dhe mikut tonë në amshim, Fadil Curri do të ma dorëzojë për botim Ditarin e profesorit. E pranova, pa hamendje. Nuk prish punë, i thashë Fadil Currit, ende pa e lexuar Ditarin, e di hiç pa e lexuar se çka përmbanë mes atyre dy kapakëve. Nuk ka rëndësi, e pranoj rrezikun se me të cilët kemi punë policore letrare. Kopilat, që përpiqen me denoncime gjygjsore të na e mbyllin gojën. Përveç shpërblimeve policore të asaj kohe, me këmbëngulje kërkojnë edhe dëmshprëblime materiale. Lotët u shkojnë rrëke për një krah kashtë në grazhd.

Edhe atë, nuk janë pak, pesë askushë me emra e mbiemra. Pjellë komuniste e shëtitur me vende pune e poste politike. Fatkeqësisht, edhe pas arratisjes në amshim e ndejkin Piktorin. E akuzojnë në gjygj si delezeza të nënkryera mes Kopesë me zgjebe, gjoja për "shpifje dhe ofendime" publike për ditarin e tij autobiografik. Ditë kjo, kur Piktori jeton në mesin e luleve, vazhdon luftën me kulturofagët.

Libri *Ashtu mendonte, fliste dhe shkruante Adem Kastarti* (Asdreni, Shkup - 2009) më në fund doli në dritë. Vërtetë, një dëshmi interesante policore e Piktorit. Cili më mirë se ai e njihte frymëmarrjen e popullit shqiptar?! Pak veta mund t'i vuanin, luftonin dhe përballonin gjithë ato përndjekje të papara policore deri më sot, përveç Adem Kastratit?! Profesori, nuk i kishte përqafuar shpërblimet e atëhershme komuniste: honoraret e majme, çmimet shtetërore dhe rahatinë artistike, po luftën me brushë në dorë.

Luftë, të cilën do ta vazhdojë me miqtë e tij besnik edhe përtej varrit. Pamarrë parasush pasojat, sulmet dhe kërcnimet edhe me gjygj. Pjella komuniste, edhe sot mbi si gëlbaza në çdo vend moçalik, pranë kënetave. Rrënjët përpiqet t'i lëshojë edhe në lëmë, përpara Shtëpisë. Përderisa, dikur kërcnoheshte me UDBA jugosllave, sot kërcnohet me gjygjin. Dëmshpërblim kërkon për plehërat e familjeve të tyre rrufjane, që në atë kohë shumë vetë i kanë marrë më qafë. Edhe pse, e di se kjo farë hithe vendin e ka pas Shtëpisë, në hale. Nuk prish punë, jemi mësuar me ferrat dhe haletë shqiptare. Portën edhe këtyre fundrrinave

rrufjane ua kemi hapur krah më krah, i presim në çdo kohë.

Shqiptarët, gjithmonë përveç sëpatës pas dere e kanë varë edhe një kizë për pastrimin e oborrit nga ferrat përpara Shtëpisë…

## VETËVRASJA "ARTISTIKE" E ABDULHAKIMIT

Moti e kam ditur, po nuk e ka ditur "ABAZI" i Malit, "Patriotin" e vonuar në barkun e Kalit të Trojës pas porte. E mori nga shkolla politike e "Koperativës bujqësore" në Saraj të Shkupit dhe i dha post politik të zv/drejtorit në TVM. E, ai gjithë ditën e natën fotografoheshte para kamerave televizive me emrin e tij në gojë: Ali Ahmetin e kam mik. Nesër, po të thotë "ABAZI", unë bëhem edhe shërbetor. E pyesja veten në atë kohë pas Lufte (2001), çfarë shkrimtari është ky që bëhet shërbetor për një pdost politik, një torbë taxhi për qafe?!

Kohë tjera ishin pas lufte. "ABAZI", ende nuk i njihte mirë njerëzit e fushës. E pas lufte, dalin shumë "trima". Nuk e ka thënë kotë populli: Trima pas lufte. Edhe "komandantë" kishim, u mbushën malet e fushat. Qeveria më vonë, pas zgjedhjeve parlamentare. Ministritë. Kabinetet. Mjerisht, vetëm një "Asker", që pas lufte nuk kërkoi dekorata e as poste partiake, u kthye në Katund. Prandaj, edhe "komandantët" tanë pas lufte si ministra, deputetë e politikanë, i ndërronin partitë brenda një nate si kurva burrat. Edhe "Patrioti" i vonuar si gjithmonë, që nga koha e komunizmit, shkonte nga fryente era. I ka ndërruar deri më sot disa burra e parti politike "demokratike" derë më derë.

E sot, era nuk fryen nga shkon "Patrioti" i Vonuar me shokë. Shkak ky, që edhe e ka humbur rrugën në mes të ditës  në  oborr,  përpara

Shtëpisë. E ka ngatërruar "ABAZIN" me Ali Ahmetin. Shqipërinë me Turqinë (fenë islame). E ka dashur dikur shumë "ABAZIN", edhe më tepër se babain, po ja kohën e fundit, shkaku i Ali Ahmetit, edhe "ABAZI" i delë nga zemra. E pabesueshme!? E di, ju do të pyesni: PSE???!!!

Deri dje, kudo i shihje krah për krahu me DoktorZiun dhe Nusen kuqezi në rendin e parë nëpër manifestime të Akademive përkujtimore të dëshmorëve të kombit. Festave shtetërore. Zbulimin e përmendoreve. Shënimin e përvjetorit të Skënderbeut... Ditën e flamurit… Natën qafë për qafe me Dhëndrrin, matanë Vardarit që tha për Universitetin e Tetovës se, është foshnje e vdekur. E shi sot, i paska "tradhtuar" Ali Ahmeti?! Nuk i dëgjon më këta "patriotë kuqezi" të vonuar, siç i dëgjonte dje "ABAZI". Dorën në zemër, kanë deri diku edhe të drejtë. Vërtetë, kohën e fundit nuk i dëgjon "këshillat" e tyre Ali Ahmeti, siç i dëgjonte dikur "ABAZI". E këta "burra fisi", që nga koha e komunizmit, veten e kanë hequr si këshilltarë dhe baballarë për të ardhmen e kombit shqiptar. Edhe të mençur. E si është e mundur, sot të mos i dëgjoj Ali Ahmeti këta "profetë" në të gjitha sistemet politike antishqiptare?! E kërkojnë "ABAZIN", që pas lufte me shokë zbriti nga malet. Vitet pas lufte, kur këta të parët me shokë si kuadër "deficitar" iu turrën me të katra për poste politike në Parti e Qeveri. E përgëzuan për guximin si komnadant lufte. E përqafuan me të dyja duart si shpëtimtar i kombit shqiptar. Ia rrahën krahët dhe ia uruan "fitoren" e luftës çlirimtare. U ngutën të parët ta

këshillojnë që të formojë parti politike. Edhe e dalldisën, i thanë: ti duhet të jesh kryetari i partisë demokratike politike shqiptare në IRJ të Maqedonisë, që zbriti nga mali.I afruan listat e an ëtarëve që duhet t'i ketë kjo parti politike.

E pagëzuan edhe me emër evropian BDI. Fundrrinat e të gjitha partive politike shqiptare të mëhershme i mbëlodhi në një thes me arna Partia e Ali Ahmetit. Dhe, dolën në zgjedhjet parlamentare krah për krahu me premtime, parulla demagogjike, me flamuj partiak e kombëtar kuqezi.

Populli shqiptar i etshëm për liri ua dha votën. Edhe fitoi krahu i luftës (UÇK) në zgjedhjet e para parlamentare. Rast i rrallë ky në histori, e dha provimin politik populli shqiptar dhe doli mbi nivelin e politikanëve. Dihet, hynë në Qeveri plot gëzim dhe i ndanë postet e fituara me gjak. Shembull ky, që nuk ndodhi me popullin shqiptar të Kosovës, që pas lufte në zgjedhjet e para parlamentare, fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, e humbi Krahu i Luftës (UÇK). Që, do të thotë: Përderisa, në Kosovë populli shqiptar hyri në politikë pa bagazhin e luftës, në IRJ të Maqedonisë hyri edhe shumë më i fuqishëm me gjithë bagazh lufte. Ja shkaku, pse veprimi i shqiptarëve në këtë "Shqipërizë të Maqedonisë" ka pasur një përparësi më të madhe për të bërë politikë madhore dhe korrë fitore historike. Vetëmse, me komunistë të djeshën e "demokratë" të sotshëm teknefesë, fundrrina të mbetura nga ish Partia Komuniste e Jugosllavisë me Kalin e Trojës pas porte, nuk bëhet politikë.

"ABAZI" me shokë, që zbriti pas lufte nga malet, këtë jo vetëm që nuk e dinte, po as edhe e parashikoi, kur themeloi parti politike dhe hyri në Qeveri. Edhe, filloi të merret me politikë. Ali Ahmeti gjatë këtyre viteve e mësoi politikën, po vonë pasi iu thye rrota e qerres në mes të rrugës. Ose, siç thotë populli: erdhën mendtë, po ikën dhentë. E pasi të thyhet rrota e qerres, gjenden plotë rrugë për në shtëpi.

E tashti, ku është problemi që "Patrioti" i vonuar me shokë e kërkon "ABAZIN", e nuk e do Ali Ahmetin?! E qartë: Katundi që shihet nuk do kallauz. E kam ditur dhe e kam pritur një veprim të këtillë të AbdulhaKim Memetit se, një ditë do të dalë me këtë "tezë të mirënjohur shkencore" teknefese. Shkaku se, AbdulhaKim Memeti shkollimin fillor dhe të mesëm të ndërtimtarisë (gjeodezi) i ka kryer në gjuhën maqedonase. Një kohë para se të merret me letërsi ka punuar në një Organizatë Ndërtimtarie "Granit", në Kërçovë. E më vonë nëpër disa qytete të Jugosllavisë komunsite dhe Shtetet Arabe. Gjatë kohës komuniste, pa konkurs pranues në Flakën e Vëllazërimit me dy tri vende pune, ku e "mësoi" edhe gjuhën shqipe. Që, do të thotë se: AbdulhaKim Memeti nuk është rritur me vjeshat dhe librat e Rilindasëve shqiptar. Porosinë e Madhe të Naim Frashërit. Fatkeqësisht, edhe sot mendon dhe flet sllavisht dhe përpiqet të shkruaj shqip.

Ali Ahmeti këtë vit i mbush mbi dhjetë vjet që merret me politikë. Mezi e fitoi Kërçovën si komunë. Rrezik ka me Tetovën dhe Gostivarin.

I pa njerëzit e fushës të këtij soji "patriotik". Edhe, më në fund u mësua të bëjë politikë. Kohën e fundit ka filluar edhe të mos i dëgjoj "trimat pas lufte" dhe t'i pastrojë radhët nga bërlloku i skaduar politik, fundrrinat komuniste. Edhe bënë mirë dhe punë me mend. Përndryshe, nëse vazhdon kështu me këtë politikë ditore dhe bagazh "intelektual" në radhët partiake, duhet sa ma parë ta pastroj veten, laj duart nga "politika medhore". Rrugën, veç më ia kanë treguar kundërshatarët e tij të përjetshëm politik: të kthehet në vendlindje, Zajaz. Ose, të ikë nga ka ardhë, në kurbet (Zvicër).

E, "Patrioti" i Vonuar me shokë, që edhe në Shkup me përurime të librave e protesta politike - fetare me "organizarorë të fshehtë" e thirr "Pranverën arabe"? Mos Zot më keq! Librat e tij teknefesë, që me shumë vështirësi janë përkthyer nga gjuha maqedonase e kanë lënë në mes të rrugës, sokaqeve të Bit – Pazarit, në Shkup. Asaj kohe si luftëtar i flaktë i Maqedonisë multietnike, jepte edhe intervista në mjetet e informacionit si shkrimtar maqedonas. Kutadi unë, nesër kështu siç e ka nisur rrugën e haxhillëkut për në Mekë, i teket dhe e shpallë veten edhe si shkrimtar turk ose arab. Nuk ka kjo gjithaq rëndësi, është dëshirë dhe punë e tij private, po nuk duhet t'i fus hundët aty ku nuk e ka vendin, në Historinë Kombëtare Shqiptare. Vërtetë, më vjen keq për "Patriotin" e vonuar! Edhe po të dua, nuk kam si e shpëtoj përpara stuhisë së pamëshirshme për themelimin e një partie politike - fetare. I ndërroi që nga koha e "artë" komuniste duke dhënë shpirt

e deri më tani në këtë kohë "demokratike" disa vende pune. Redaktor me dy-tri poste partiake në redaksinë e një gazete komuniste të "vëllazërim-bashkimit". Fat i tij, këtu e "mësoi" për sherr edhe gjuhën shqipe. Në prag të ndryshimeve "demokratike" e provoi edhe "ABAZIN". E, merreni me mend ky "ptriot", po ta ngrente zërin për ndryshime demeokratike që në atë kohë! Heshti, në kohën komuniste. Heshti, në kohën e ndryshimeve "demokratike". Heshti, edhe në kohën e "ABAZIT". Tashti, i doli gjumi pasmesnate si "analist politik": "Shqiptarinë e ka shpëtuar Islamizmi"?! I dështoi edhe përpjekja e themelimit të një Organiazate "joqeveritare" PYKA, që më vonë mendonte ta avansojë në Parti Politike Fetare Myslimane. Nëpër gazeta e para kamerave televizive shkruan e fol jerm vetmevete me hajmali turku përqafe. Merreni me mend: Pavetëdije, me dërdëllisjet e tij teknefese, mohon personalitetet më të njohur shqiptar, që Turqinë e bënë Shtet duke shpresuar në "vëllezërit mysliman" se do ta ndihmojnë Shqipërinë. Numri i tyre nuk ishte i paktë: Skënderbeu (ushtri turke) Ismail Qemali, Sami Frashëri (gjuhë letrare shqipe), Naim Frashëri, Vaso Pashë Shkodrani e Filip Shiroka në Egjipt… Ataturku, që Turqinë e bëri shtet modern. Haptas pa fije turpi i mohon Rilindasit shqiptar: Jeronim De Radën, Asdrenin, Zef Seremben, Çajupin, Gjergj Fishtën, Mihal Gramenon, Luigj Gurakuqin, Ndre Mjedjen, Ali Asllanin, Fan Nolin, Hil Mosin me shokë, që gjithë jetën e luftuan Turqinë si pushtuese duke asimiluar popullin shqiptar.

Kryengritjen e Dervish Carës. Burra, që me penë e pushkë deri në vdekje e luftuan robërinë pushtuese shekullore të Perandorisë Osmane.

Shpërblimi dihet: shqiptarëve, Turqia "Nënë" ua ndaloi gjuhën amëtare dhe shkollat shqipe, përmes fesë islame duke i asimiluar në turq "ehamdurila" dhe në bashkëpunim me Serbinë me marrëveshje politike i ka shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre me gjithë familje në Turqi. Dhe, përçudi, sot rrugën e tyre të "shenjtë" e vazhdon pasardhësi i tyre me shokët "myslimanë", AbdulhaKim Memeti. Shkrimtari, që e vetmja rrugë e shptëtimit nga Përmbytja e madhe politike (Kiameti) i ka mbetur dhe është: "ABAZI". Tekefundit, ai edhe i donte shërbetorët besnik dhe servilët e përjetshëm në politikë. Ali Ahmeti, kohën e fundit i do ujqërit dhe luanët.

I zemruar me Ali Ahmetin, në rrjetin e tij në Facebook AbdulhaKim Memeti ka shkruar se: shumë nga ata të UÇK –së, përfshirë edhe Ali Ahmetin do të përfundojnë si heronj mbi gomarë. Kulminacionin e zemërimit do ta arrijë, kur e shpalli veten kandidat i përbashkët i opozitës për kryetar të qytetit të Shkupit në zgjedhjet lokale (2013), e nuk e kandidoi asnjë parti politike shqiptare e as maqedonase (LSDM), që e dalldisi para kohe me protesta maratonike të fotografohet edhe përpara Qeverisë.

Gazeta "LAJM", që del në gjuhën shqipe në Shkup, dhe me këmbëngulje e reklamon AbdulhaKim Memetin si lider të ardhshëm në themelimin e ndonjë Partie Politike Fetare Islame, boton edhe një shkrim të çuditshëm: se, "e kanë

vrarë Kim Mehmetin”?! Dalldisësit e tij se, ai mund të bëhet një lider politik në IRJ të Maqedonisë, trumbetojnë se, edhe pas këtij “lajmi” kontaktuan me Kim Mehmetin, i cili u është përgjigjur: “Jo, ende nuk më kanë vrarë…”

Qesharake, ë?! Publikisht them: AbdulhaKim Memetin nuk e vret njeri. Asnjëri nuk do t’i përlyej duart me këtë kalorës të arratisur në Bit - Pazar. Nuk e duan maqedonasit, nuk e duan shqiptarët. Falë u qoftë turqve dhe arabëve! Moti me “veprimet e tia patriotike”, vetë e ka vrarë vetveten. Tashti, me tezën e tij të mirënjohur “shkencore” për shqiptarët, në Prishtinë: “Shqiptarinë e ka shpëtuar Islamizmi”, e vrau vetëveten me një “plumb” në kokë për vdekje duke e varrosur në varrin historik të rrufjanëve.

“ABAZI”, ishte i malit… E ky Ali Ahmeti, të cilin nuk e do sot AbdulhaKim Memeti me shokët “mysliman”, është i fushës…



## XHINDIHALLI *

E kthej shiritin e "Westerni film" artistik të trurit me njëzet vjet mbrapa në politikën shqiptare. Kohë e publikimit të librit: *Trumbetat e tellallit* (1992). Vitet e Pavarësisë së IRJ të Maqedonisë. Dyluftimet heroike të "24 pashallarëve" shqiptar në Kuvend për ndarjen e lugëve dhe enëve. Betejën historike, kur "vëllezërit" e Njerkës merreshin nëpër institucionet e Shtetit me ndarjen e pasurisë: arave dhe Shtëpisë. Ose, shqiptarët me protesta të kota demokratike në rrugë: gjuhë shqipe, shkolla shqipe, flamur kuqezi e të drejta kombëtare. Dyluftime politike, kur "vëllezërit" bënin luftë për pushtet e shtet. Vite, kur Haxhi Deputeti me xhaxhin Kiro (Tatkoto) u arratisën në Amerikë për shpëtimin e Maqedonisë pa asnjë kusht politik, "marrëveshje historike" nga ana e partive politike shqiptare. Edhe, tmerrohem kur para sysh më del Xhindihalli shqiptar, rrufjan i djeshëm që vinte nga një Çerdhe spiunazhi e "vëllazërim – bashkimit", që me shumicë e pakicë në atë kohë na pillte viça të palëpi. Dudum i veshur me rroba të bardha fetare arabe e nalle me disa "politikanë" të tjerë partiak, i përcjellur haxhi në Mekë hipur mbi gomarin e Haxhi Rrencit. Që, ende pa mbërri në Kaçanik i cofi gomari. Fotografinë artistike, të cilën në atë kohë e botoi edhe gazeta fetare që dilte në gjuhën shqipe "*Hëna e re*", në Shkup.

Xhindihalli gjatë gjithë kohës e kishte ndjekur hap pas hapi veprimtarinë tonë arsimore, kulturore, fetare e politike. Nateditë me pare e pa pare, kishte informuar me besnikëri për çdo hap tonin "nacionalist e irredentist", lexim mes rreshtave (Shqipëri të Madhe). Rrëfimin dhe "aminin" e kishte bërë para këmbëve të hoxhës në "xhaminë shqiptare". Punemadhe, që ndonjëri besimtar, e kishte shitur veten për një post politik, vend pune, diplomë universiteti. Tjetri për titull shkencor, ambasador e anëtar akedemie te "vëllezërit" e Njerkës. Delezezat me "nishane" nga Zoti, kryesorja ishin në numër në vathën e Qeverisë së atëhershme "demokratike".

Inspektori "vëlla", që më mori në "bisedë informative" si "armik i rrezikshëm i shtetit", pas gjithë atyre pyetjeve provokative, se unë gjoja isha i dërguar nga Kosova në Shkup për të vepruar në Maqedoni: takimet e fshehta në Bullgari, dërgimin e dhjetra mijëra markave Partisë Socialiste në Shqipëri… Përçudi, sipas tyre në shkrimet e mia publicistike - letrare e kisha sharë edhe Kur'anin?! Veprim "shejtani" sipas disa hoxhallarëve, për të cilin Kryetari atëhershëm i Bashkësisë Fetare Islame në Shkup e kishte angazhuar gjithë stafin e kuadrit arsimor fetar për leximin e shkrimeve dhe librave të mi satirik: ma gjeni ku e ka sharë Kur'anin, qoftë edhe mes rreshtave! Lajmin, ma përcolli rastësisht nën Rrap një profesor i Fakultetit të

Shkencave Islame, në Shkup. Informata, më tha le të mbesë mes nesh si miq besnik shqiptarë të Baba Tomorit. I kemi lexuar të gjithë librat e tu me qëllim që të gjejmë ku e ke sharë Kur'anin. E, a gjetët, e pyeta unë me ironi?! Jo. Atëherë, paskan qenë shpifje dhe etiketime të kota për mua si shkrimtar. I kam sharë dje, i shaj sot dhe do t'i shajë edhe nesër interpretuesit e rrejshëm të Kur'anit. Përmëtepër, sipas akuzave: unë isha edhe ai kryesori (komandanti). Dhe, çështjen shqiptare doja ta zgjidhë me luftë.

Qesha. Aty për aty edhe iu përgjigja Inspektorit policor "vëlla": unë dua të jem ai që e paskeni "zënë" si lepurin me qerre në mes të fushës. Artistikisht, siç thotë populli: me pelë për dore. Tekefundit, më vjen mirë si kalorës i penës, por e keni gabuar adresën. Fatkeqësisht, nuk jam aq trim i madh sa më paraqesin bashkëpuntorët e juaj në këtë "zbulim policor" si "armik i Shtetit të përbashkët". Porosia ime si shkrimtar: mos më thirrni më për kësi budallakish "informative" policore. Jo, vazhdoi bisedën informative Inspektori. Njëzet nëshshkrime i ke në aktakuzë: shkrimtarë, gazetarë, mësuesë, hoxhallarë… A, do t'i shohësh me emër e mbiemër? Jo, iu përgjigja. E marr me mend dhe i di rrufjanët e Dexhallit me vulë në ballë. Edhe Xhindihallin që flet rrugëve vetmevete nëpër Bit - Pazar. Këngën e tij të përditshme në minare që ia ka lënë turku amanet. Përpiqet të imitojë Muhamedin a. s. duke

shitur zarzavate në Pazarin e grave. Natën, pas teravisë të hedhë edhe ndonjë "filosofi fetare" të arnuar nga Kur'ani në mjetet e informcionit. Pejgamberi fundit i Fesë Islame, vërtet ishte "shërbetor" i Hatixhes, po nuk ka qenë me profesion tregtar. Hatixheja të cilën e martoi para shpalljes, kur ai ishte njëzet e pesë vjet e ajo dyzet vjet, ishte tregtare. Aisha ishte gruaja e preferuar e Muhamedit a. s. që u martua me profetin kur i kishte gjashtë vjet, dhe konsumoi martesën (kontratën e martesës) kur ajo ishte nëntë vjet, e cila qëndroi me të nëntë vjet deri në vdekje. Përfundimisht, për "myslimanët" e sotshëm me këmbët dhe trutë në legen, hazreti Muhamedi a. s. ka qenë burrë i shumë grave (shumica vejushka) të ligjshme e të paligjshme dhe filozof i madh i asaj kohe.

Viti 1993 ishte atëherë, kur "demokracia" na e hapi krah më krah derën e vathës mes egërsirave. Hoxha e thirri ezanin pa flamurin kombëtar kuqezi në minare. I madh e i vogël u turrëm livadheve. Shpatën e Skënderbeut e nxorrëm nga brezi. Flamurin kuqezi nga arka e gjyshes. Vjershën e xha Naimit me shokë nga podrumet shkollore. Kalin e bardhë me një këmbë të thyer në stadiumin e Tetovës. Arushën e Malit duke u rrok fytas me Skënderbeun në skenë tek drama tragji-komike e porositur nga Nëna Parti. Torbën e Hoxhës plot "mallëra sokaku" lidhur me grykë para syve të zonjave të rënda në skenë.

Duartrokitjet frenetike të politikanëve me brekët nëpër këmbë. Vetëm se, edhe sot e kësaj dite nuk e di i sigurt kush ishin informatorët e Vetëshërbimit?! Komisioni Lustrues, përpiqet me çdo kusht t'i fsheh kodoshët në brekët e grisura neokomunsite. Përsëri siç duket, me shumicë e pakicë janë shqiptarët. Edhe atë, "patriotë kuqezi" të djeshëm, "demokratë" të sotshëm me një torbë taxhi për qafe me kokën nateditë në xhami e bythën përpjetë si palare në polici.

Inspektori policor edhe pse nuk ishte shqiptar, pas gjithë atyre "informatave" antishtetërore dhe pyetjeve, ma mundësoi edhe një dëshirë të fundit para gjykimit. I ke, më tha me emra e mbiemra në numër njëzetë denoncues si "armik i shtetit". I do t'i shohësh emrat e atyre "burrave"? Jo, i thashë. Edhe pa i parë, i di se kush janë këta "patriotë kuqezi" shqiptar. Falë iu qofshin si argatë pa pare! Gjithë jetën ua kemi shitur dhe do t'ua shesim edhe në të ardhmen me pare e pa pare, në Bit - Pazar. Edhe Xhindihallin, u zgërdhi Inspekori na e shitni pa pare?! Po, edhe Xhindihallin e keni pa pare me gjithë "zarzavate" të kalbura nëpër tezgat e Bit- Pazarit, në Shkup.

Problemi i sotshëm?! Po ai, i djeshmi. Xhindihalli me shokë, për inatë edhe sot ndërsehet pas Trurit shqiptar me shpifje e etiketime në polici dhe mjetet e informacionit. Përgjumshëm flet e shkruan jerm duke gjetur strehim të përkohshëm në xhami, institucione të

Shtetit "përbashkët" dhe parti politike. Kohën e lirë, pas faljes së "xhumasë", e shfrytëzon duke shitur pemë e perime kopshti me afate të skaduara nga firma e mirënjohur "Tun – Batuni", në Pazarin e zarzavateve. Nateditë, pesë vakte i falë në xhami (Shtëpinë e Zotit) në mes të udhëkryqeve nëpër Bit - Pazar. Edhe atë, merreni me mend: Shkupi kur i ka disa xhami e pak myslimanë të vërtetë me "Din e Iman" dhe ndërton të tjera shtëpi të Zotit me uzurpimin e pasurisë shoqërore mes Parkut të Çairit, në Shkup duke i sakatuar lulet, drunjt dhe gjelbërimin që na e fali Nëna Natyrë. Ose, siç dëshironi të thoni shpesh ju besimtarët, me "Din e Iman", Zoti. Dorën në zemër, këtu, nuk do t'i përmendim xhamitë nëpër katunde me dy e katër minare, në numër më të madh se të shkollave fillore. E di, ju do të thoni: Po, "vëllezërit" e Njerkës ndërtojnë kisha. Kryqa edhe nëpër male. Ani. Përgjigjuni ju, për inatë me ndërtimin e shkollave dhe çerdheve të fëmijëve.

Përçudi, edhe sot investohet me të madhe për të Djeshmen e errët me një këmbë në varr, e jo për të Nesërmen te pragu i derës, ardhmërinë e popullit shqiptar. Përditë kokën e qitni në sexhade persie e bythën tek Partitë politike. Herë pas here tinëz, pasmesnate i luteni Zotit mbarë-prapë me bythët në hava e kokën në polici.

Xhindihalli nga minarja e xhamisë, përderisa katundarët janë duke punuar e derdhin djersën

arave në fushë për Dimër, na e bën me dije përmes altoparlantëve nga qielli mes reve ne shqiptarëve: përderisa dje kemi pasur një Teutë, sot i kemi dy Teuta, voton për gratë e Muhamedit a. s. pa hamendje me të dyja duart. Demagogji e paparë publicistike. Përsëri, përpiqet të na pri si dje me shkarravina teknefese neokomuniste e hajmali të skaduara afatesh nëpër tezgat e Bit - pazarit nga hoxhallarë serbi, përzë edhe në Ditën e sotshme si "turq ehamdurila" në Turqi me tespihe kuqezi në dorë e bythët në hava për liri dhe Shqipëri Etnike nëpër stadiume e salla sportive.

O Imzot! Athua, edhe në Ditën e sotshme shqiptarët nuk kanë djem Nëne si Sulë Jetimi që dje i ndihmoi Zotit: Hoxhës në mes të ditës ia ngriti këmbët  në hava nga minarja e xhamisë duke e hudhur bythekrye në tokë?! Nuk e besoj. Shqiptarët kanë pasur, kanë dhe do të kenë djem, që gjithmonë Nënës do t'i dalin zot sa herë që të jetë në rrezik…

1/. *Burrë me xhinde (të meta psikike), që flet vetmevete rrugës marrëzira*.

## SHPALLJA E "REPUBLIKAVE" NËPËR KATUNDE

Vite më parë, në prag të demokracisë, partitë politike shqiptare PPD dhe PDSH u përpoqën me të gjitha forcat politike e intelektuale, që Tetovën ta bëjnë kryeqendër kulturore e politike. Kohën e fundit rrugën e tyre e ndjek edhe BDI. Nuk e kam fjalën që këto parti politike, selitë e veta i kanë në Tetovë, por për veprimet e tyre "strategjike" - politike kur dalin në foltore me fjalime "luftarake" përpara popullit. Gabim historik. Publikisht, heqin dorë nga Shkupi, kryeqendra politike shqiptare e kulturore e rritur nëpër shekuj me ato vargjet e këngës antologjike popullore shqiptare: "*… për çdo vjet e kemi nisur nga një luftë. / Herë me Krajl e herë me Mbret*".

Fatkeqësisht, përballë një historie të këtillë legjendare, edhe në Ditën e sotshme shqiptarët vazhdojnë të shpallin " kryeqytete e republika" nëpër katunde. "Vëllezërit" nga një hap i këtillë pakrye i politikanëve tanë "çlirimtarë" për një të Nesërme, u ranë duarve shuplakë. U lumtë "truri" shqiptarëve! Vërtetë i kemi "vëllezër" besnik që nga koha e Baba Dovletit duke bërë "politikë madhore" nëpër katunde. Nëna në këtë kohë moderne, nuk ka gjithaq rëndësi historike.

Shkenca e ka arritur kulminacionin: mund të na pjellë edhe një Nënë. Babën, kryesorja e kemi përballë oxhakut, në Shtëpi. Pushtuesit shekullor na kanë përçarë dhe na e kanë prishur Shtëpinë me "vëllavrasje" për pushtet. Armiqtë e Shtetit të "përbashkët", le të plasin nga inati! Dorën në zemër, shqiptarët Maqedoninë e duan më shumë se ne "maqedonasit" si komb pa identitet (Babë e pa Nënë). Dhashtë Zoti, mbeten gjithë jetën me këto mend në kokë! Ose, siç thotë populli: Përderisa ka budallenj, do të jetojnë të mençurit. Ditën, kur budallenjt do të bëhen të mençur, o burra: mblidhni plaçkat dhe ikni nga "politika madhore". Vërtetë, jemi popull i ri në Ballkan, të cilin e shpiku ose e shpalli pas lufte (1945) dhe na e dhuroi si shtet pa merita lufte Shoku Tito, po shqiptarët na dolën bese. E përkrahën Gruevskin, në vend të përmendores të Shokut Tito në sheshin "Makedonija", në Shkup e ngritën Aleksandrin e Madh. Përmëkeq, vazhduan t'i përkrahin edhe përmendoret e Filipit të Maqedonisë dhe Olimbisë me gra të tjera antike plot fëmijë në gji, krah për krahu me Skënderbeun dhe Hasan Prishtinën, në Bit - Pazar.

Problemi madh historik në këtë Shtet, nuk janë shqiptarët, po ne "maqedonasit". Historikisht, ne jemi pjellë artificiale e ulur këmbëkryq në mes të Ballkanit, që edhe sot e kësaj dite u ngatërrohemi nëpër këmbë shqiptarëve dhe i morëm më qafë

me shekuj. Ama, të rrimë shtrembër në histori, po ta themi të vërtetën siç e thonë troç shqiptarët e Rekës të Josif Bagerit: pa shqiptarët, ne "maqedonasit"nuk mund ta mbajmë veten gjallë as edhe një ditë në këtë shtet të ri "demokratik" në mes të Ballkanit.

Publikisht, politikanët shqiptar hoqën dorë nga Shkupi, kryeqendra e Shqiptarisë nëpër shekuj. Qytet, të cilin Perandoria Osmane gjatë gjithë jetës e mbajti pranë zemrës si kryeqytet i Rumelisë. Jetë politike, kulturore e ekonimike bëri gjatë luftërave të përgjakshme ballkanike në një sofër me pushtuesit në Ballkan. Rasti ma kujtoi edhe këngën e vjetër popullore që na e këndonte shpeshë Xha Deralla ne fëmijëve para porte, kur na vënte pusi në rrugë: "*Turku na e shiti këtë Rumeli/ e ka ble çaj Moskovi Zi, shtatë xhemi me alltan*." Këngë historike, të cilën shqiptarët, sot gati e kanë harruar dhe nuk e këndojnë më si dikur me krenari nëpër dasma në odën e burrave. Përkundër politikanëve tanë, që gjithë forcën politike dhe intelektuale e përqëndruan dhe e "harxhuan" në Tetovë. Tjetër punë është ajo se, edhe "vëllezërve" u pëlqente ta propogandonin Tetovën si kryeqendër politike e kulturore të shqiptarëve. Qëllim i tyre tendecioz edhe sot e kësaj dite dihet, të cilin një ditë e vëretoi edhe koha në "Shtetin e përbashkët".

Historikisht, kurrë Tetova s'ka qenë, as është dhe as nuk do të bëhet kryeqendër politike,

kulturore e Shqiptarisë. E dini pse?! Jo, nuk e dini. Shkaku se, vite me radhë e mbytë bërlloku i vet politik para dere, që nga koha e Turqisë. Vërtetë, Fadil Sulejmani me shokë këtij qyteti i dhuroi Universitetin e parë shqiptar mes gërshërve politike shoveniste sllave, po nuk ia vodhën "zanatin" e të bërit Shtet. Luftën për pushtet e rrëmbyen vetë si politikanë me diploma të shkollave komuniste. "Vëllezërit" me ndërkombëtarët na e dhanë edhe një tjetër universitet (UEJL), për ta ngulfatur këtë vatër të dijes në emër të "bashkëjetesës" (foshnjë që lindi e vdekur, sipas Fërçkovskit), siç u përpoqë më herët me Fkultetin Pedagogjik në Shkup PPD -ja ta shuajë zjarrin, po xixa që hidhet në kashtë: një ditë ndizet edhe pa dëshirën e "vëllezërve" përkarshi Diellit me rreze.

Përsëri, fituan shqiptarët, shkaku fajit të politikës teknefese ditore, u bëmë me tre universitete shqiptare. Inatin mund t'ia kesh dikujt, por kurrë nuk mund t'ia hash rriskun e fatin të cilin ia ka shkruar vetë me dorë Zoti. Punë tjetër është ajo se, "patriotët kuqezi" shqiptar kur dalin në foltore para popullit në Tetovë, dehen me çaj rusi dhe flasin jerm me orë të tëra para të pranishmëve: " Nëse Tirana dhe Prishtina nuk kanë forca politike të bëhen kryeqendra të Shqiptarisë, ne do ta bëjmë Tetovën kryeqytet të Shqiptarisë"?! Demagogji e pashoqe politike me tru shtatë pash thellë strukur në palarenë politike,

rrëzë Sharrit Plak. Shqiptaria nuk mbrohet vetëm në Tetovë. Hurdhë e cektë patriotike, në të cilën pas darke këndojnë në kor bretkosat dhe e mbysin veten politikanët e sotshëm të "vëllazërim-bashkimit". Dorën në zemër, pas shumë vështirësive politike me ndihmën e "vëllezërve" e fituam një "Teutë ilire", si kryetare të komunës shqiptare, por kjo sot është shumë pak për ta shpallur Tetovën heroike si kryeqendër të Shqipërisë Etnike.

Shkurt dhe shqip: Tetova me këtë kapacitet politik, kulturor e ekonomik, kurrë nuk mund të bëhet kryeqytet i Shqiptarisë, përpara Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit! Përmëtepër, pas Luftës së 2001 - shit, siç nuk u bë "Tanusha - republikë", sipas aventurave të disa kalorësve të arratisur "analistë" në mjetet e informacionit me në krye një komandant lufte. Amani, nëse nuk keni të thoni e shkruani diçka të mençur në këtë kohë rreziku, atëherë së paku heshtni para ngjarjeve historike, mos bluani krunde te Mulliri i Arapit! Punë tjetër është ajo se, disa partizanë të dalldisur dhe "vetëbegenisur" nëpër çajtore  të partive politike "gju më gju me popullin", flasin nateditë jerm kur dalin symëshelë në foltore.

Orë të tëra harrohen nëpër përvjetore politike e kulturore, mezi i lexojnë fletoret e hallvaxhinjve duke vazhduar të flasin përmendësh marrëzira politike. Gjumin e rëndë dimëror, përpiqen t'ia vazhdojnë këtij populli heroik e të përvuajtur

nëpër shekuj me përralla të “pranverave arabe” në mes të Shkupit. Mjaftë. më me veprime të nënkryeme teknefese nëpër livadhe e Bit - Pazar, rrëzë Kalasë Dardane! Vorba me shekuj vlon në zjarr pranë dromaxhakut me kokë gjarpëri në oxhak që nga koha Ilire. Tymin mbi çati e përcjellë në qiell mes mjegullave. Edhe, kohën e fundit ka filluar të derdhet grosha mbi shpuzë. Mirë do të ishte në këtë kohë të rrezikshme (rrëshqitshme politike në akull), politikanët e harxhuar shqiptar, thirrin forcat e shëndosha patriotike dhe të kthehen krah për krahu në Katund, t’i kalojnë të lumtur ditët e fundit të pleqërisë në gjirin familjar.

Populli shqiptar, sot nuk ka nevojë për demagogji të shekullit. Marrëzira politike dhe fetare. Shpallje të “kryeqyteteve” të Shqiptarisë. Dhe, “republikave” nëpër katunde…

## POPULLI SHQIPTAR E SHKRUAN VETË HISTORINË

Historiani më i madh i të gjitha kohërave është, vetë populli shqiptar. Autor legjitim i Histrorisë Shqiptare. Historianët, janë vetëm zëdhënës dhe përshkrues të veprave madhore të këtij populli historik nëpër shekuj. Popull. që për çdo vjet e ka nisur nga një luftë për liri, herë me Krajl e herë me Mbret. Tjetër punë është ajo se, sa këta historianë i kanë mbetur besnik veprës së tij madhore brez pas brezi për Shqipëri Etnike. Nateditë me penë e armë në dorë.

Pajtohem, që nga Historia Shqiptare të mënjanohet "gjuha e urrejtjes" ndaj pushtuesve barbar në emër të popujve të pafajshëm, por jo edhe faktet historike aq të thella deri në fyt nëpër shekuj. Shkaku se, Historinë Shqiptare e kanë përshkruar nëpër libra aq bukur dhe me besnikëri, përveç historianëve edhe shkrimtarët shqiptar: Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Bogdani, Jeronim De Rada, Sami Frashëri, Vaso Pashë Shkodrani, Naim Frashëri, Gjergj Fishta e Çajupi me shokë.

Rrezik është në kohën e sotshme të marrësh guximin të rishkruash Historinë Shqiptare. Hap të cilin mendoj se nuk e bënë asnjë popull në botë me mend në kokë. Përmëtepër, me propozimin e një shteti "mik" që me shekuj ka qenë pushtues i popullit shqiptar në trojet e veta etnike. Realitet historik, që përmes fesë islame ka pretenduar ta asimilojë, zhduk nga faqja e dheut si popull në Ballkan. Nuk e them unë, hidhnju një sy fakteve

historike! Librave të Rilindasëve shqiptar! Burrave të pushkës e penës. Falë vetë popullit shqiptar dhe Zotit, nuk ia arritën qëllimit antishqiptar historik. Prandaj, jam i mendimit që Historinë e Popullit Shqiptar ta shkruajnë vetë historianët.

Propozimi i Qeverisë turke, që të rishkruhet Historia shqiptare është tendecioze dhe me prapavijë politike. E dini pse, nuk e kemi ndër mend, përsëri ta veshim ferexhenë e zezë të robërisë qindravjeçare. Shqiptarët nuk mund ta ndryshojnë historinë e tyre sipas mendimit dhe bindjeve të të tjerve, sa herë që t'u teket Qeverive politike "mike" në pushtet. E di, do të pyesni pse e them këtë në Ditën e sotshme, kur ne i kemi punët mirë me Turqinë mike. Maqedoninë përpiqemi ta bëjmë shtetin më të ri demokratik në Evropë. Vitet e fundit, pas Lufte (1999) t'ia zgjasim dorën e pajtimit edhe Serbisë. Ligje të Natyrës. Pse, të mos them edhe të Zotit?! Gjithë jetën jam thirrë në këto ligje dhe besimin e të parëve të mi bektashinj gjatë rrugës për në Baba Tomor. Veprime profetike me të cilat kam rënë në gjumë, i kam parë ëndrrat nën Rrap për Ditën e Nesërme dhe jam zgjuar nga gjumi shekullor. "Vëllezërit", nëse duan pajtim historik me popullin shqiptar, nuk duhet të përzihen dhe fusin hundët e duart në Historinë e popullit shqiptar! Ose, përsëri t'i nxjerrin gërshërët e përgjakshme mbi tavolinë. Përzierje politike në realitetin historik të popullit shqiptar, që e ka shkruar vetë nëpër shekuj me gjak historinë. Nesër, një kërkesë të këtillë mund ta parashtrojë edhe Serbia

"mike". Edhe, çka?! Shqiptarët, historinë e tyre do ta shkrujanë sipas dëshirave dhe porosive politike të pushtuesve dhe "armiqve historik". Skënderbeun, do ta heqim nga Sheshi i Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit?! Arsye, shkaku se:"miqtë" tanë të djeshëm dhe të sotshëm gjithë jetën i ka luftuar me shpatë?! Përmëtepër, sipas historisë së tyre ai është edhe "tradhtar". Jo. Shqiptarët do ta shkruajnë historinë siç e kanë shkruar deri më sot, me fakte historike dhe shkencore. Ashtu siç kanë nd odhur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike nëpër shekuj flakë më flakë me armikun shekullor. Pushtuesit, janë ata që duhet ta rishkruajnë historinë e tyre të mbushur plot luftëra të përgjkshme e pushtime shekullore të një populli liridashës duke propoganduar plot të pavërteta e falsikime historike për shqiptarët. Njerëz të cilët i kanë quajtur para syve të Botës edhe me bishta.

Populli shqiptar, historikisht kurrë nuk ka qenë popull pushtues, por popull i shkelur me këmbë, i robëruar dhe ndarë nga fqinjtë copë-copë nëpër shekuj. Armiqtë historik, kanë dashur ta fshijnë nga harta dhe zhdukin nga faqja e Dheut. Përçudi, dhe inat të tyre, ai ende është gjallë, e vazhdon luftën për liri e Shqipëri Etnike. Koha është, sot populli shqiptar t'ua thotë haptas fqinjëve dhe Botës në sy: Mjaftë më me robëri shekullore! Mjaftë më na e sakatuat trupin nëpër shekuj duke na i prerë duart dhe këmbët!. Tashti, kohën e fundit doni t'ia fusni gërshërët edhe Historisë Shqiptare.

Fatin tonë historik, do ta marrim vetë në duar. Edhe, Historinë shqiptare do ta shkruajmë vetë si

popull më i vjetër i Ballkanit pa porosi politike në dëm të Shqipërisë.

Përndryshe, kurrë nuk do të ketë paqe dhe rehati mes popujve të Ballkanit…

## FITORJA HISTORIKE

Duartrokitje! Dhe, e dini, çka?! Jo, nuk e dini. Madhështore është Dreka festive e Fitores historike pas zgjedhjeve lokale (2013) me një maçorr trim siç është Dr. Gaçi. Krah për krahu me një mace nën Rrap, Zonjën Di. Asnjëri nuk kemi libreza partiake, nuk i takojmë ndonjë partie politike. Megjithatë, edhe ne i takojmë një partie politike demokratike: Partisë të Shqiptarëve. Përmëtepër, maçorri dhe macja janë patriotë të dëshmuar në Bit - Pazar me mustaqet vesh më vesh në gjuajtjen e minjve. E duan Rrapin, komandantët e vet heroik të luftës. Shkaku se, vetëm nën Rrap mes Bit - Pazarit kanë liri, ushqim ndonjë asht kur politikanët ua hedhin si shpërblim nën tavolinë.

Armiqtë më të mëdhenj të kësaj shoqërie, shtetit – kishin qenë politikanët teknefesë me një torbë taxhi për qafe. Pas tyre vijnë, "patriotët analistë kuqezi", që nuk kishin ditur vite me radhë në "demokraci" se, cila Nënë i kishte pjellë pas porte në mes të Dimrit Madh. Nuk prituan edhe kësaj radhe të shkruajnë kollumna (arsyetojnë veten si vizionarë), hedhin fajin popullit shqiptar në mjetet e tyre të "pavarura" të informacionit: *Humbën shqiptarët – fituan partitë politike*. Edhe atë, nga autori papagall: Patrioti i vonuar. Autori i kollumnave, që gjithë kohën i thirrte shqiptarët në protesta përpara Qeverisë për bojkotim të zgjedhjeve lokale. Bërlloku shqiptar, që merr guximin ende të shes mend se kush ka fituar e kush ka humbur në këto zgjedhje lokale.

Edhe, thotë: votuesit u ndjenë të kënaqur, ngaqë jo vetëm që shëtisnin falas me makina luksoze rrugëve të Shkupit nga një qytet në tjetrin, por shumica e tyre morën nga 50 euro nga më shumë parti politike, e që pastaj të mos votonin për asnjërën. Madje, edhe pse më të dobëta se kudo qoftë, partitë shqiptare kanë një përparësi: të kushtëzojnë VMRO-DPMNE si kurrë më parë, ngaqë numri i përbashkët i votave shqiptare mjafton që partia opozitare maqedonase, ***LSDM-ja të vijë në pushtet***. Andaj, liderët shqiptarë partiakë, sikur të ishin të mençur, tani do duhej t'i kishin mbyllur telefonat celularë, me çka do e çonin Gruevskin t'i kërkonte nëpër fshatrat e Maqedonisë perëndimore e t'u premtonte se nuk është duke kërkuar vasalë të nënshtruar, siç i kishte gjer më tani BDI -në e PDSH -në, por bashkësundues të shtetit që do jenë të barabartë me palën maqedonase. Por sidoqoftë, t'i parashikosh gjërat në Maqedoni, është si të merresh me paragjykimin se kur një vullkan do mund të shpërthejë. Nëse ka diçka që gjer më tani është e qartë, ka të bëjë me zgjedhjet mirë të organizuara dhe me përfitimet e vogla që nxorën votuesit shqiptarë, duke marrë ndonjë lekë nga partitë konkurruese. Nxënësit dhe studentët, ndonjë notë kaluese në shkollë dhe fakultet. Dhe, shikuar nga ky këndvështrim, mund të thuhet se: ***humbën partitë politike, por fitoi Kërçova historike***. Edhe, atë: falë mërgimtarëve që kur e panë në rrezik Atdheun, i erdhën nga të katër anët e botës nga toka e qielli ta shpëtojnë vendlindjen.

Dhe, ma kujtuan poezinë e Nolit të Madh të asaj kohe revolucionare për Shqipërinë, ***Jepni për***

***Nënën***: … ***Mbahu, Nëno, mos kij frikë/ Se ke djemtë n' Amerikë***!...

Tjetri: *Analizë politike bën pas zgjedhjeve: çka ndodhi me shqiptarët*? Dum Dumi shqiptar, që thirret në emër të shkencës dhe të "vërtetës shkencore" me çdo kusht do t'ju pri shqiptarëve për Liri. Edhe atë, shet mend në çdo derë të hapur nga ndonjë parti politike: Disa ditë pas zgjedhjeve, disa mediume bëjnë analiza, me të drejtë se, pse rezultatet e anketave të instituteve dhe agjencive për matjen e pulsit të popullit gabuan në prognozimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale të 24 marsit (2013).

Edhe ne vetë si Institut publik, organizatë që merremi mes tjerash edhe me hulumtimin e opinionit publik e kemi për detyrë të analizojmë dhe të shohim se çka ndodhi, jo për hirë të asaj që të arsyetohemi e mbrohemi, nuk e kam ndërmend të bejë një gjë të tillë, por për hirë të shkencës, dhe hulumtimit të opinonit publik si një formë dhe proces i matjes së disponimit të qytetarve, dhe për hirë të së vertetës shkencore e jo të manipulimit publik dhe jepjes kahje të gabushme publikut se gjoja janë manipuluar dhe abuzu anketat. Gjthësesi se, unë këtu mundem të flas vetëm në emër të Institutit që udhëheq, dhe të argumentoj dhe analizoj atë që ne e prognozuam.

Si do që të jetë, parashtrohet pyetja se në të vërtet çka ndodhi?

Ndodhën tre gjëra kyçe që ndryshuan gjthçka, e që me hulumtim nuk mundeshte të parashikohet, me që efekti ishte psikologjik, e jo logjik. Populli shqiptar edhe kësaj radhe në këto

zgjedhje lokale u pa se, nuk votoi për individë, po për lider dhe parti politike. Në Kërçovë votoi për Ali Ahmetin, në Çair të Shkupit për Izet Mexhitin, në Tetovë për Sadi Bexhetin dhe BDI – në dhe në Gostivar për Rufi Osmanin dhe BDI - në. Dukuri negative politike kjo te shqiptarët, që në këto zgjedhje lokale (2013) do ta detyroj Izet Zeqirin pasi nuk e fitoi besimin e popullit, të tërhiqet nga pozita e deputetit të popullit. I cili do të deklarojë: "Edhe pas korrjes së keqe, përsëri duhet me mbjellë" duke thënë se, do të jetë në pozitën e sekretarit të Rilindjes Demokratike Kombëtare.

Interesant, populli shqiptar kur është bashkë në veprime politike, nuk i mungon edhe fitorja historike. E "shpëtoi" Ali Ahmetin në larjen e duarve nga "politika madhore". Kërçova ishte provimi politik i shkollimit të lidershipit. E pati vështirë gjatë studimeve në Prishtinë, pastaj në Luftën e fundit të 2001 -shit si komandant i UÇK -ës në IRJ të Maqedonisë, po më vështirë e ka pasur në këto zgjedhje lokale vendimtare si politikan me përgjegjësi, në vendlindje (Kërçovë). Mezi e dha me shumë vështirësi provimin historik duke mos i larë duart nga "politika madhore". Tashti, duhet t'i përveshi mëngët dhe tirqit deri në gju, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, shkaku se mund të na gëdhijnë papritur si të parakohshme pas porte.

Tjetër punë është ajo se, Hojdodolja u kthye me "fitore" nga Velesi (Tito), kur shqiptarëve u digjej zjarr mbi kokë në Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë e Strugë. VMRO – DPMNE në rrethin e parë fitoi 40 komuna, BDI 8, LSDM 2 dhe PDSH

dhe RDK, asnjë komunë. Rezultat, që Cërvenkoski i dëshrpauar në këto zgjedhje lokale, në raundin e dytë paralajmëron bojkotimin – përsëri daljen në rrugë, në vend që t'i lajë duart nga skena politike.

Në raundin e dytë, fitorja nuk mvaret nga partitë politike nacionale, po kush me cilin do të bëjë marrveshje politike mes partive shqiptare dhe maqedonase. Ali Ahmeti e mbajti fjalën. Edhe pse, në politikë nuk ka sinqeritet dhe besë. Gjatë shpalljes së fitores në blokun shqiptar tha, se: në Strugë do të mbështesë kandidatin e PDSH –ës, një marrëveshje që është arritur edhe më herët mes kandidatëve. Pyetje tjetër është ajo se, pse partitë politike shqiptare këtë veprim politik nuk e bënë më herët që në rrethin e parë në Tetovë, Gostivar dhe Strugë, që të fitonte kandidati shqiptar. Punë që nuk është e imja dhe do një analizë të thellë më vete, po e Kryesive të partive politike shqiptare që në të ardhmen të merren pak më shumë me këtë fenomen të çuditshëm shqipar, i cili vite me radhë na ngatërrohet nëpër këmbë dhe jemi duke ia parë sherrin.

Instituti… edhe njëherë thekson se kjo analizë nuk ka për qëllim të arsyetojë apo mbrohemi, por t'i shiqojmë faktet, dhe elemetet që ndikuan në një rezultat që askush nuk e parashikoi në këto zgjedhje euforike lokale.

Deledashi shqiptar, që bashkë me partizanët politik neokomunistë fotografoheshin para kamerave televizive të "pavaruara" anembanë Atdheut: Edhe ne i paraprijmë fushatës parazgjedhore me "aktivitete kulturore" konfuze.

E, unë them: ***Humbën partitë politike – fitoi Kërçova historike***. Vetëm populli shqiptar nuk hanë më bar. Vdiq ajo kohë qorre. Mjaftë më e përçatë nëpër fe e parti politike popullin shqiptar si "shpëtimtarë" duke e shitur shumë lirë te "vëllezërit"! Vërtet, i humbi në raundin e parë disa qytete shqiptare, ndoshta edhe ndonjë tjetër në raundin e dytë, por ka filluar të punojë dhe veprojë me kokë. E di se, kujt duhet t'ia japë votën, besimin për Ditën e Nesërme. Nuk është ai populli i sistemit komunist për të cilin ju derdhni lot nëpër debate televizive edhe sot e kësaj dite, të shkojë pas hoxhës dhe gomarit me samar në shpinë. Fatin e vet e ka në duart e veta, dhe një ditë do t'ia arrijë qëllimit historik. Patjetër, nuk ka tjetër rrugë!

Amani! Mjaftë më me themelimin e partive politike shqiptare! Këshillave kombëtar. Shoqatave "joqeveritare". Edhe ashtu i kemi me bollëk sa që kanë të hanë edhe qentë. Nuk kemi politikanë të aftë, nuk kemi intelektualë guximtar, nuk kemi vizionarë për një të Nesërme. Ose, i kemi, po nuk mund të vijnë në shprehje, ngrejnë krye nëpër parti politike e institucione të shtetit nga dudumët shqiptar që shtyhen me bërryla nëpër parti politike për poste dhe vite me radhë na ngatërrohen nëpër këmbë.

Vazhdojnë parashikimet teknefese të "analistëve" deledash: Si konkluzione, pa mos hyrë në debate, se ku gabuam e ku jo, dhe si të dilet në rrugë për në Baba Tomorr. Mundemi të themi se këto zgjedhje lokale, ishin më specifike që deri tani nuk i kemi pasur, dhe që do të rezulutojnë me fshirjen e partive të vogla, që në

fakt vetëm dëmtuan votën opozitare, dhe krijimin e qartë të dy blloqeve politike të ndarë në të dy kampet politike nacionale për pushtet.

Në rregull, të themi, o burra pushteti! Por, mos është për ju pak si vonë për zgjim politik e kombëtar. E, themelimin e partive të reja politike shqiptare?! Pasi u thye qerrja, gjetëm plot rrugë. Po, pse nuk kërkuam rrugë para se të thyhet qerrja me gjithë këto parti politike, "patriotë kuqezi", analistë politik e shoqata "joqeveritare"?

Realiteti: Prognozimet e Partive politike dhe analistëve me shumicë e pakicë që na i ka dhënë Zoti, fatkeqësisht këtë popull e fusin edhe më thellë në huti, qorrsokak politik. Analistët e këtij soji neokomunist që me vështirësi japin shpirt, nuk dinë ku e kanë kokën e ku bythën. E lëre më në Ditën e sotshme historike, kur zjarr na digjet mbi krye, t'i prinë në ballë popullit shqiptar për Ditën e Nesërme. Dhe, vazhdimi: E njejta gjë ndodh edhe me Tetovën dhe Gostivarin, ku Dy partitë plitike shqiptare (BDI dhe RDK) do të bëjnë luftë të ashpër edhe në raundin e dytë për postin e kryetarit të Komunsës, shtëpi për shtëpi, sokak më sokak, katund më katund.

Demagogji fantastike, gjoja në emër të shqiptarëve. E përsëris: ***Humbën partitë politike – fitoi Kërçova historike***. Kulminacioni: tashti, përsëri do t'i shohim pas raundit të dytë të zgjedhjeve lokale, në Kuvend me diskutime të zjarrta patriotike, replika dhe bojkotim të Kuvendit. Edhe kësaj radhe, të marrin rroga deputeti pa punë fare në Shtëpinë ligjore në emër të popullit. Shqiptarët, e kanë edhe atë rrugën tjetër pas Çuke, le t'i përgadisin çiftelitë me dy

tela, kavallët, fyellin e Bariut të staneve të Sharrit, dajret dhe lodrat. Edhe, le të heqin valle, le t'i këndojnë "fitores" nëpër dasmat politike me atë këngën e njohur popullore: "***Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola***."

Edhe, burrat e botës rrahin kot ditë e natë ujë në tavan. Njëri thumbit, tjetri patkonit. Dudumët, që shqiptarët në Maqedoni gjithë jetën i trajtuan si pakicë shqiptare, me 25 përqind e popullatës. Gjuhën shqipe si gjuhë të dytë zyrtare. E kurrë nuk e ngritën zërin se, populli shqiptar në Maqedoni është popull shumicë. E them këtë, se: ende është populli i vetëm në botë që lind dhe vdes në këtë shtet "demokratik" pa nështetësi. E ka lehtë populli "vëlla maqedonas" që e bëjnë popull shumicë dhe shtet: bullgarët, shqiptarët, vllehët, serbët, turqit, boshnjakët, romët, torbeshët…

Analistë të vonuar janë njëzet vjet me radhë që i përsërisin fjalët si papaglli në kafaz. E ka thënë këtë dikushi para njëzet vjetëve, në kohën e PPD –së (K. Ç.), edhe atë, me një stil artistik në libra: Gabimi më i madh i yni, shqiptarëve është që ne me "vëllezërit" maqedonas i ndajmë lugët dhe enët. E jo, pasurinë e patundshme: arat dhe Shtëpinë. Vetëm se, fatkeqësia ishte se ju në atë kohë gërhisnit gjumë të thellë me nga dy-tre vende pune nëpër redaksi komuniste dhe institucione të shtetit. E dyta: pushteti dhe ekonomia merren me politikë dhe luftë. Shqiptarët e kanë provuar edhe politikën, edhe luftën. Përfundimi, shkaku paaftësisë politike, përsëri shqiptarët edhe sot vazhdojnë të merren

me ndarjen e lugëve dhe enëve, mbesin me gishta në gojë.

Rrugë?! Ende kemi rrugë. Edhe atë, vetëm me një kusht që në të ardhmen mos i prinë në ballë politikanët humbës këtij populli! Shqiptarët për një kohë duhet ta flugin euforinë dhe "fitoret" e përkohshme politike: çiftelitë, dajret dhe lodrat duke i vajtuar familjarët dhe farefisin për së gjalli me këngë epike nëpër dasma e përvjetore. Koha është, i madh e i vogël t'i përveshin mëngët e këmishave deri në bërryla, pantollonat deri në gjunj. Hedhin në përrua interesat e ngushta personale, familjare e partiake. Trurin e këtij populli që e kanë përzënë nga partitë politike ta vënë në përdorim në vend të rrufjanëve. Edhe, do të shihni se si fitohet Liria. Shteti Shqiptar.

Shqipëri Etnike nuk fitohet me këngë tallava. Patriotizëm të rrejshëm. Parti Politike Neokomuniste. Poezi patetike. Po, me punë. Djersë. Dhe, tru…

Fundi i këtyre zgjedhjeve lokale sipas meje për parashikimet e Ditës së Nesërme: ***Humbën partitë politike – fitoi Kërçova historike***. Duarve binu shuplakë!

Dhe, Dita e Nesërme sipas meje, autorit të këtij shkrimi: ***Patjetër, do të fitojnë shqiptarët – do të humbin partitë politike***…

## PAPAGAJ POLITIK KAFAZI ME DYER TË HAPURA

Namën e turkut gati të gjithë e dimë, që nga koha e Baba Dovletit. Shqiptarët, kur ia kthyen pushkën dhe shpinën Turqisë, i nemi turku: kurrë, mos t'u heqtë nga shpina robëria. Njëri - tjetrin e hënkshi me gjithë lecka për karrike e pushtet! Mallkimin e asaj Perandorie osmane, herë pas here na e kanë bërë me dije edhe të parët tanë kaçakë, që gjithë jetënë me pushkë në dorë e luftuan "lirinë e dhuruar të vëllezërve" nga Anadolli. Rilindasët tanë, (jo këta politikanët e sotshëm) e futën edhe nëpër libra ose këngë popullore. Edhe, përçudi "vëllezërit" këtij populli liridashës ende nuk i zbresin nga shpina krah për krahu me kalorësit e arratisur. Punemadhe, që gomari asht e lëkurë me të katra këmbët me gjithë Nastradinicën në shpinë është rrasur deri në bark mes batakut. I zbresin "vëllezërit" sllav, i hipin "vëllezërit" turq. I zbresin "vëllezërit" turq, i hipin përsëri "vëllezërit" sllav.

Interesant, pas Luftës së parë botërore si "çlirimtarë" i hipën edhe italjanët bashkë me gjermanët. Në fund të Luftës "nacional-çlirimtare" si "shpëtimtarë" edhe partizanët e xhaxhit Enver e shokut Tito. Kohën e sotshme me ndihmën e argatëve shqiptar, përsëri e vallojnë livadheve me "politikë madhore vëllezërit" sllav. Tymemjegull me të katra e shalojnë nëpër histori. Dhashtë Zoti, këtij populli historik, nuk i hip mbi samar përsëri turku. Amani, le t'i hipi kush të dojë nesër, vetëm jo edhe turku se, nuk mund ta

bartim edhe pesqind vjet të tjera samarin e tyre historik mbi shpinë me gjithë barrë.

Përjashtim, deri diku sot bëjnë Shqipëria dhe Kosova. Sllavi vështirë më i shalon me të katra nëpër stadiume sportive e sheshe të qyteteve. Ndoshta, i shalojnë miqt e tyre "strategjik": Bashkimi Evropjan dhe Amerika. Dihet, me vullnetin dhe dëshirën e tyre mikpritëse njëzetëvjeçare në një sofër: me bukë, kripë e zemër. Shkak ky, që bëjmë "sefa" nën hije si në kohën e Turqisë me këngë e valle duke e vrarë armikun shekulllor nëpër dasma e "konaqe" televizive. Copë-copë i bëmë daullet. Çiftelitë me dy tela. Duart duke u rënë shuplakë e përdredhur bythët në valle me kënëgën e Adem Jasharit. Vetë u hipim kuajve të arratisur për pushtet, vetë u zbresim pas fushatës së zgjedhjeve lokale e parlamentare nëpër kabinete të Qeverisë. Betejave të "përgjakshme" na prinë në ballë "bajraktarët" me Skënderbeun e postere të Rilindasëve shqiptar nëpër foltore. Herë pas here, në çdo tubim madhështor - parazgjedhor para popullit, rrugën na e shtrojnë me lule, e bëjnë sa çelë e mëshelë sytë Shqipëri Etnike.

Rrugë shtrojnë me qindra kilometra, hapin vende pune, ujësjellësa nëpër qytete, shkolla moderne e universitete nëpër katunde. Edhe pse, nëpër ato vendbanime nuk na ka mbetur asnjë fëmijë për shkollë. Fshatarëve Nëna parti u bënë edhe fëmijë. Vetëm e vetëm, që t'ua vjedhin në mes të ditës "votën e lirë demokratike".

Nesër, pas zgjedhjeve lokale e parlamentare, që zakonisht ndodhin në pranverë, verë ose vjeshtë, vjen "*Dimri i vetmisë madhe*",

siç shkruan në romanin e tij Kadare. Gurë e dru mbi politikanë shqiptar: tradhtarë, hajdutë, spiunë… Na mashtruan për një thes miell, vende pune në administratën shtetërore e pak para.

Mirë, them unë mes këtyre rreshtave të këtij shkrimi. Njëzet vjet me radhë ta mashtrosh popullin shqiptar, e ky përsëri të të besoj për liri?! Nuk e mba këtë rrenë politike asnjë kandar në botë. Njëzet vjet, të njëjtët individë me "votën tonë të lirë" rrotullohen me ushtrime akrobatike nëpër parti politike, kabinete e qeveri me të njëjtat parulla patetike "për ndryshime"?! Premtime boshe nëpër sheshe e stadiume sportive. Herë me ngjyrë qielli, herë me ngjyrë bordeli e herë kuqezi… Shpenzime marramendëse bëjnë nëpër fushata zgjedhore anë e mbanë Shqipërisë. Fishekzjarre me qindra mijëra mbi qytete duke e ndezur flakë edhe qiellin. E merreni me mend, sikur gjithë ato para t'i derdhnin për arsimin dhe kulturën shqiptare?! Qindpërqind, nuk do të ishim në këtë gjendje të mjerueshme kombëtare siç i kemi sot punët, po krah për krahu me të arriturat shkencore para dyerve të botës përparimtare.

Gojën plot them: Jo, kjo aspak nuk është e besueshme në Ditën e sotshme. Problem siç duket, ne nuk kemi me armikun shekullor, po me vetëdijen e popullit shqiptar?! Vetveten, që na ngatërrohet me vite nëpër këmbë. Shqiptarët nga dy më të këqijat politike, duhet të zgjedhin atë më të mirën për Shqipërinë. Nuk e marr guximin t'ua them në sy se cilën rrugë demokratike. Shkaku se, populli shqiptar është vetë i mençur. Përmëtepër, vetë i zgjedhë rrugët historike dhe prijësit e tij

politik për Nesër. Patjetër, në këtë shkrim duhet ta përsëris edhe se, një popull për të ardhë deri te qëllimi historik i duhen t'i pri tre faktorë kryesor: në ballë - njerëzit e ditur, pastaj vijnë të pasurit dhe në fund populli. E, a i ka sot populli shqiptar këto tre faktorë për të arritur deri te qëllimi historik?! Fatkeqësisht, ende jo.

Përpjekjet e disa fundrrinave politike me inetresa personale për ndryshime në politikën shqiptare, përfunduan siç thotë populli: "*si qeni në rrush*". Mësim të cilin duhet ta marrin parasysh politikanët e ardhshëm shqiptar, nëse duan të themelojnë lëvizje politike për ndryshime, që me verprimet e tyre politike të mos u shërbejnë më këmbekrye partive politike në pushtet. Parti politike mund të themelojnë individë që nuk i ka shtrydhur dhe harxhuar deri më sot asnjë parti politike, pjellë pas porte si Kuaj Troje. Shembull më i freskët është ai i papagajve politik të kafazit me dyer të hapura. Partizanë, që u kanë shërbyer padronëve partiak deri në themelimin e lëvizjeve të tyre politike, që me veprimet "nacionaliste" ende i mbajnë gjallë në pushtet.

Shqiptarëve u duhet tjetër kalibër i politikanit: Burrë mejdani, që tjetër flet e deklaron në mjetet e "pavarura" të informacionit. Tjetër mendon dhe tjetër punon për Atdheun. Dhe, krejtë tjetër vepron në politikë.

Koha është pra, ta ndryshojmë veten ne shqiptarët në veprime dhe politikë, e jo partitë politike që njëzetë vjet me radhë bëjnë luftë demagogjike për pushtet si ato Dhitë kryeneqe mbi vigun e lumit te Abetarja! Votën e lirë kësaj radhe në këto zgjedhje parlamentare t'ua japim

individëve që e kanë dëshmuar veten për zgjidhjen e çështjes shqiptare e jo partive politike që bëjnë luftë për pushtet.

Papagajve politik të kafazit me dyert e hapura krah më krah, që para zgjedhjeve lokale e parlamentare rrinë "gju më gju" me popullin, e pas "fitoreve historike" i zë gjumi me sy të hapur në Qeveri, erdhi dita t'ua mbyllim dyert politike me çelës, t'i lëmë të çirren pas porte për pushtet .

Dhe, me shqelma (votën e lirë demokratike) t'i përzëmë nga politika shqiptare…

## ENESËRMJA ËSHTË NË DUART E SHQIPTARËVE

Në disa shkrime të publikuara në mjetet e informacionit kam thënë: Dielli që më rrinte mbi kokë si një saç i skuqur, përderisa unë kisha bërë një sy gjumë pas dere, ishte ngritur lart mbi male. Ku ta dish, ndoshta edhe sa herë e kishte zgjatur dorën të më zgjojë nga gjumi. Po ç'e do, kur unë shihja ëndërr në mes të ditës. I kisha hipur Gjokut pullali dhe fluturoja mes reve nëpër qiell. E shaloja atin, po ende nuk e kisha flug gurin pas shtatë maleve. E ç'është më me rëndësi, e dija se nuk jam Gjergj Elez Ali, që në trup t'i marrë nëntë plagë, e të dhjetën ta kërkoj nëpër Qytetin e qyqeve. Edhe pse, gji nën Rrap më jepnin për luftë Tri Zana. Njëra më printe përpara e Dy të tjerat më mbanin për krahu. Ja, mu pse isha shtrirë pas dere, nuk kisha mundur të zgjohem nga gjumi.

Dhe, kur i sheh sot patriotët e vonuar kaq të flaktë për Shqipëri Etnike, të vjen të pëlcasësh jo nga barku, po nga kurrizi. Komunistët e djeshëm të Partisë Komuniste, "demokratë" të sotshëm me fjalime të zjarrta patetike e shkrime "bombastike" nëpër istikame kulturore e politike. Njëri me kravatë të kuqe mbi shkrimin patriotik, i ndezur zjarr e flakë. Tjetri, me shqiponjën e pergjysmuar dykrenare kuqezi mes flamurit me një gotë çaj rusi përpara mbi tavolinë. "Disidenti" i Doktorziut në mjetet e informacionit po si Mic Sokoli duke e rrokur topin për fyti: "Shqiptarët do t'i zhgarravisin fletëvotimet, Marrëveshja e Ohrit

ka vdekur, pres që të ketë incidente të përgjakshme, analisti i kërkon falje popullit shqiptar, a duhet të bashkohet Kosova dhe Shqipëria (edhe IRJ e Maqedonisë, Mali Zi dhe Lugina e Preshevës v. j.)”… Përditë, shesin mend me qerre: “ideologji e deledashëve”, presione, shantazhe dhe kërcnime të partive politike. Trusakatët që deri dje u bënin “temena” liderve partiak: Ali Ahmetit dhe Menduh Thaçit. Edhe, ua fërkonin natë e ditë me dorë për poste politike, tituj shkencor në Universitet. Përçudi, shih sot kur këta i përzunë nga Partia si material shpenzues (vetëm për një përdorim) dhe i flugën në hedhurinat e kontejnerëve të berllokut, gurë e dru hedhin mbi këta “burra mejdani”. Krah për krahu fotografohen me shqiponjën e zezë dykrenare me Skënderbeun e Adem Jasharin e improvizuar para kamerave televizive edhe në këtë Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipëririsë, qafë përqafe dalin në syrret me kësula të bardha, përkrenare e shpata në brez. E ti, kur i sheh kaq të “përmalluar”, kaq të mjerë, kaq të varfër në tru, aty për aty të hidhet t’i duash këta liderë partiak.

E merr guximin të thuash në këtë shkrim: Po, mirë ua bëjnë Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi. E sidomos ky i fundit, Menduh Thaçi që është i pamëshirshëm për sojin e këtyre “patriotëve kuqezi”, që janë shërbetorë të dëgjueshëm dhe i ndrrojnë partitë politike si kurva brenda një nate burrat. Vetëm edhe Menduh Thaçi nuk rri duarkryq, i “dogj” gjatë këtyre viteve patriotët e rrejshëm me kësula të bardha në kokë. Meritë e vetme kjo patriotike e këtij lideri politik shqiptar,

që i zhveshi burrat e grave para syve të popullit lakuriq e pisa ashtu siç i ka lindur nëna pas dere një natë dimri në Katund. “Kryengritësit” e këtij soji të zemëruar me liderët e tyre partiak, të nesërmen turr me shkrime e sharje duke hedhur gurë e dru mbi liderët e tyre partiak të themelojnë parti të reja politike edhe nëpër katunde. Dudumët, që pantollonat mezi i mbajnë me duar duke u rënë rrugës.

Përmëkeq, shqiptarët edhe sot e kësaj dite janë të përçarë nëpër parti politike. Një Parti Neokomuniste gjatë njëzet vjetëve i polli pas porte me dhjetra parti të tjera kopilesha “demokratike”. Fatkeqësisht, të njëtit individë njëzet vjet me radhë bëjnë akrobacione politike duke shëtitur parti më parti si kurva burrë më burrë. Dorën në zemër, kurvës edhe i ka hije. Po, jo edhe këtyre rrospive meshkuj me pashterka të kuqe, që gjatë natës na i flukin kopilat pas dere. Ose, nga pangopësia për pasuri e pushtet, përditë themelojnë parti të reja politike duke vazhduar ta përçajnë këtë popull edhe nëpër katunde. Fatkeqësia më e madhe: Gjithë këtë e bëjnë në emër të popullit dhe për popullin shqiptar. Edhe, qeshë me energjinë pozitive të popullit shqiptar. Vite me radhë e harxhon për zgjedhjen e kryetarëve të partive politike. Deputetëve të popullit. Kryetarëve të komunave. E, në anën tjetër pavetëdije e sakatoi arsimin dhe kulturën shqiptare, themelet e një shoqërie dhe Shteti demokratik. Populli i shkretë, sot e ka humbur rrugën në mes të oborrit përpara Shtëpisë. Nuk di pas kujt të eci, cilit t’i besojë ose t’ia japë votën.

Kohë shterpë kjo, kur Gomari Babatasit i pri para këtij populli historik nëpër fushëbeteja për Liri. Rrugëdalja: Pajtohet me fatin, ende t'i prinë këta hajdutë politikë duke e vjedhur me duar e këmbë popullin dhe pasuruar veten brenda një nate, një rreth të ngushtë familjar, miqsor e klanor, grupe interesi partiak nëpër kabinete qeveritare.

Qesha përsëri në Ditën e sotshme të Motit Madh (2012). Dhe, them me vete: Po, në fillim të viteve '90 –ta, në prag të ndryshimeve demokratike, këta "burra mejdani" ishin bashkë si një trup e kokë në themelimin e PPD -së, në Tetovë. Përjashtim këtu bënte vetëm Ali Ahmeti me shokë. Në atë kohë erdhën gra e burra nga të katër anët e botës nga toka e qielli me aeroplanë special në votime. Kurrë populli shqiptar nuk ka qenë më i bashkuar se atë ditë në atë kohë historike. Edhe Sheshin e Shkupit e mbushën me kësula të bardha e flamuj kombëtar kuqezi. Vetëm, tjetër është ajo se, ky "bashkim kombëtar" nuk zgjati shumë kohë. Plasi sherri për interesa të ngushta personale, ose hyri Dreqi me brirë në mes të "patriotëve kuqezi" me poste të djeshme komuniste. Nëna Parti çdo katër vjet, gjatë zgjedhjeve të reja pillte kopila e kopilesha pas porte. E përçanë popullin shqiptar, mos Zot më keq! Njëzet vjet me radhë të njëtit "patriotë kuqezi" i ngatrrohen popullit shqiptar nëpër këmbë. I hipin për çdo katër vjet mbi shpinë gomarit të Nastradinit nëpër beteja politike: Herë i hip Nastradini e herë Nastradinica. E kanë rrëzuar me të katër këmbët të shkretin asht e

lëkurë në mes të udhës. E ky popull i dalldisur me turbofolklorizëm edhe sot e kësaj dite, përçudi nuk e hedhë samarin, barrën nga shpina në mes të batakut. Bythekrye t'i hudhë trusakatët në baltë.

Edhe sot si dje, zërin e ngrejnë për Liri trusakatët, hipin në foltore, nëpër karrige na rrëfejnë grushta patriotik e "luftëra heroike" në demokraci. Herë pas here në gazetë përmes partizanëve të tyre besnik na shkruajnë "letra dashurie", se: Si e kanë kaluar natën matanë Vardarit me rrospitë meshkuj qafë për qafe. Na shesin mend nëpër emisionet debative televizive: "*Një temë një bisedë*". Vëllazërim-bashkimin e ri që do ta ndërtojnë në Qytetin e qyqeve. Himnet e para partiake që do t'i shkruaj poeti Honxhobonxho. Kolumnat "profetike" Patrioti i Vonuar, "miku" i Abazit dhe armiku i Ali Ahmetit. Librin për të cilin në "Librarinë e Çarshisë" do të çohet aq pluhur nga Kritiku Teknefes (Sanço Panço i Doktorziut), që nuk ka haber nga letërsia. Bibanin Qafërjepur se, si fryhet para kamerave televizive me një torbë taxhi për qafe si pjellë komuniste dhe "flijimet e tij artistike" se, si e ka shpëtuar "Mëmëdheun" nga Përmbytja e Madhe…

E për sa u përket liderve të rinj partiak që gjatë këtyre ndryshimeve demokratike mezi i pollën me shterëzime partitë politike shqiptare: PPD, PDSH dhe BDI, nuk dua të flas mes këtyre rreshtave, kanë qenë vite me radhë shërbetorë të tyre "besnik" për një torbë tagji nëpër institucionet e shtetit.

Edhe pse më shtini ta them haptas: Ata "patriotë kuqezi" të cilët i ka djeg Menduh Thaçi,

kurrën e kurrës nuk mund të bëhen liderë të sukseshëm politik shqiptar. Realiteti, me këtë dua të them, edhe këtu në këtë shkrim: Menduh Thaçit duhet t'i takojnë meritat si politikan shqiptar në pastrimin e haleve të partive politike shqiptare, e jo në avansimin dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare. Nuk do t'i përmendi emrat e "dëshmorëve të luftës" në këtë shkrim, i di populli shqiptar. Fatkeqësisht, ndonjëri nga pakujdesia ka shkuar edhe si qeni në rrush.

Njëzet vjet na kanë hipur e zbritur nga shpina si gomarit të Nastradin Hoxhës. Herë Nstradini e herë Nastradinica. Njëzet vjet na i kanë shitur lirë të gjitha të drejtat kombëtare te "vëllezërit"matanë Vardarit. Njëzet vjet na i mohojnë të gjitha librat. Njëzet vjet na i helmojnë fëmijët nëpër shkolla me tekste shkollore e planprograme sakate. Njëzet vjet me radhë na e shtinë në dhomën e librave Zonjën Vdekje… Njëzet vjet… O Imzot, njëzet vjet na kanë ndjekur maleve, vetëm e vetëm t'ju bindemi urdhërave të tyre, të udhëtonim nëpër gjiriz mes hithërave pas Shtëpie. Kujt i hynte në kokë, ose së paku të na dëgjonin se, ne i kishim frikë krimbat të na ecin nëpër trup. Atyre me rëndësi ishte t'u ndizet zjarri në oxhak. Tymi politik t'ju shkojë drejtë qiellit mbi çati. E për ne, kush e çante kokën se një ditë do të na e burgosnin edhe Lirinë brenda katër mureve. Fajin e patën vetë, do të thoshin nëpër emisione debative, ne u dolëm borxhit. E nisëm nga të katër anët e "Mëmëdheut" me karrocë e kuaj Ismail Qemalin për në Vlorë krah për krahu me Skënderbeun e Adem Jasharin. Lodrat i bëmë copë-copë duke hequr valle në këtë

Njëqindvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë veshur kuqezi anembanë Atdheut. Ekranet televizive me shpata në dorë e "nagantë" në brez nga secili katund e qytet, më këmbë e kuaj me mjekra e mustaqet vesh më vesh me nga një Isamil Qemal në karrocë arritëm në Vlorë. Dhe, vërtet duhet pranuar nëse ka Zot, se na "dolën" borxhit…

Dritat u shuan në tribinë. Në sallë shpërtheu një duartrokitje frenetike. Nëpër errësirë dëgjova edhe një zë femre. Thashë, me vete: Me siguri është Hojdodolja. O Imzot, ama ia kishte marrë një kënge partizane! Flamurin kuqezi e kishte hedhur krahëve. E përdridhte zërin, më thirrte me emër e mbiemër nëpër errësirë… Skënderbeu me Adem Jasharin krah për krahu në mesin e popullit. Grupi i burrave me çifteli: Ne gjatë këtyre njëzet vjetëve kemi gabuar në politikë, por nëse tani na e jepni votën "demokratike" – shpërblimin e popullit, kurrë më nuk do ta gabojmë rrugën politike. Tjetri duke mbajtur ison me alltinë në brez: Kryetarin e Parlamentit, nëse fiton Partia jonë demokratike do ta kemi shqiptar! I treti me një parullë partizane të Partisë Komuniste: Liri ose vdekje…

Punemadhe. Them unë në këtë shkrim artistik - profetik. Shqiptar e kemi pasur një kohë në komunizëm edhe kryetarin e Shtetit të Jugosllavisë (Sinan Hasani). Edhe atë, shkrimtar të stolisur me disa çmime republikane. Poashtu, në Kosovë e Maqedoni, gjatë sistemit komunist kemi pasur poste të larta në nivele shtetërore: Kryetar Kuvendi, Kryeministër Kuvendi, Kryetar të Lidhjes socialiste, Kryetar të sindikatës, ambasadorë e akademikë vite me radhë në disa

shtete, ministra të shkencës, arsimit e kulturës, deputetë të popullit. Edhe dy shtete sovrane shqiptare i kemi sot në demokraci me plot parti politike: Shqipërinë dhe Kosovën. I treti shtet shqiptar e pret radhën pas porte. Që, nëpër dyluftime heroike për poste politike duam t'i ndajmë me litar jug-veri, siç e ndante gjatë një fushate parazgjedhore Xhaxhi Kuqezi Kërçovën. Dhashtë Zoti në këto zgjedhje lokale (2013) e ka humbur litarin, përndryshe na mori më qafë. Edhe gjatë ndryshimeve "demokratike", poste politike kemi pasur e kemi me qerre për burrat e mejdanit, po nuk kemi pasur e kemi Shtet demokratik shqiptar: Shqipëri Etnike. Ekonomi të zhvilluar shqiptare. Barabarësi të plotë kombëtare me "vëllezërit" e Njerkës në këtë shtet të "përbashkët" në mes të Ballkanit. Shkaku, se: Ende shqiptarëve nëpër damarë u qarkullon gjaku komunist i vëllavrasjes për pushtet. Vështirë e kanë në kohën e sotshme të gdhihen qafë për qafe si demokratë, këta burra mejdani me brekët mbi pantollona.

E thashë këtë mendim dhe u ula këmbëkryq mbi një varr, rrëzë Çukës. Vetëm se tani kukullat filluan të sillen në rreth, t'i rrahin duart herë pas here shuplakë. Kjo do të thoshte se, u pëlqente muzika e rokënrolit në këtë festival ballkanik. Ja, edhe pse e këpusnin mjedisin, i rrotullonin sytë, përdridheshin para kamerave televizive.

I venin në përdorim të gjitha shkathtësitë politike, që para kukullave të ishin sa më bindës, sa më të zjarrtë. Vetëm pak veta i besonin lojës së tyre patriotike, kishin frikë mos thyejnë ndonjë këmbë në valle… Kokën... Nuk i kuptonin

përdridhjet e tyre "artistike", nuk e dinin ku i shpienin këta flamurtarë, në Liri ose Robëri. Një kukulle edhe i ra të fikët kur Vajza e Dr. Madhit një lojtari iu hodh në qafë. E mori për dore pas mullarit me bar dhe e rrëzoi në kokërr të shpinës nën qiellin e hapur me yje.

Edhe, them: BDI – në, nuk mund ta rrëzojë nga pushteti ky kapacitet politik që e kanë shqiptarët në Maqedoni. Problem kemi me "vëllezërit". Përderisa, shqiptarët vazhdojnë të votojnë edhe në të ardhmen për parti politike, e jo për individë (personalitete) të dëshmuar me punë në shoqërinë shqiptare. Shembull: Shpallja e Ramush Haredinajt qytetar nderi i Tetovës. Deklarata e Rufi Osmanit se, vjen në skenën politike për ta rrëzuar nga pushteti Ali Ahmetin. RDK –ja në këto zgjedhje të parakohshme do të fitojë 17 deputetë. Mandatin e kryetarit të Komunës së Gostivarit do ta fitoj që në rrethin e parë në këto zgjedhje lokale. Ose: Paszgjedhjet e kaluara të parakohëshme parlamentere, ku Menduh Thaçi: Sinqerisht e uroi Ali Ahmetin për "fitoren". Njëkohësisht, duke i porositur kopilat e PDSH -së që humbën në këto zgjedhje, t'i thonë lamtumirë "politikës madhore" shqiptare. Poashtu, edhe se do të jetë në të ardhmen një opozitë e fuqishme.

Porosi kjo për BDI – në, që nëse nuk bënë reforma brenda partiake, pastrojë radhët e veta nga bërlloku i mbledhur me vite para dere, as le të mos marrë guximin t'i masi forcat në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Enesërmja është në duart e shqiptarëve…

# Dhe, në fund
## KOHA ËSHTË T'I LANI DUART NGA "POLITIKA MADHORE"

Edhe, më merr malli për personazhet e mi nëpër libra që turren me të katra përmbrapa partive politike pas një ashti shpërblim. Herët, dal t'i shoh te "Tivoli" burrat e mejdanit, para këmbëve të Skënderbeut në Shkup, sesi bëjnë luftë kokë më kokë për Atdheun. Përçudi, edhe sot si dje asnjëri nuk mungon, vijnë njëri pas tjetrit dhe harrohen me orë të tëra duke bërë "politikë madhore": Doktorziu krah për krahu me Baxhanakun, Rrumaduci, Hojdodolja, Këlyshi me zgjebe, Dum Dumi, "Nova Godina"...

Gjithë ditën e gjatë, përderisa unë i marr "ilaçet e mia" të zakonshme sipas nipit tim Joni, ato gjithë ditën e gjatë merren me thashetheme politike, marrin gra e burra nëpër gojë. Edhe, me kolumna politike si "analistë" teknefes politik në mjetet e informacionit. Dihet, me parashikime mbarë e prapë për një të Nesërme shqiptare, fundekrye në shërbim të Partisë Neokomuniste, që me protesta "demokratike" në rrugë do të kthehet në pushtet. Përçudi, janë të njëjtit tursakatë si prodhim serik i një kallëpi - shkolle gazetareske partizane të "vëllazërim – bashkimit". E, në anët tjetër harrojnë se janë bërë vetë mu si Cuca e Sulçes, që ia hapi derën pasmesnate Xhangos me shokë se, ia kishin zbuluar "llozinkën": Shefqeti me çizme.

Përditë e shoh Rrumaducin me një "bagazh të madh patriotik" nga Partia Komuniste se, si shkon tavolinë më tavolinë ta pranojnë në shoqëri të bëjë edhe ai pak "politikë madhore" para zgjedhjeve lokale. Burri i botës, tashti në "demokraci" e ka vështirë të nuhas diç të re për Vetëshërbimin e Kukullave, në Bit - Pazar. Arsye, i doli bytha "patriotike" si palare në diell për mejdani. DoktorZiu e shpërbleu me një asht për "flijime artisike" duke e përcjellur në pension të merituar shtetëror mes varreve partizane të "vëllazërim – bashkimit". Viktimat shqiptare nuk duan të rrinë më me të në një tavolinë. Dikur, më në fund mezi ulet fillkat vetëm në një tavolinë, në verandë. E ngre telefonin celular, gjoja se e kërkon dikushi matanë gardhit, thirrë për shoqëri pune parazgjedhore. Jo, Rrumaducit më nuk i ulet askush në tavolinë. E kanë përzënë të vdekurit, e kanë përzënë të gjallët. Përveç, DoktorZiut me Baxhanakun, që ende nuk i kanë dorëzuar armët e luftës, i dalin zot Partisë Neokomuniste të "vëllezërve" të Njerkës. Edhe, pas pak kohe vijnë Kalorësit e arratisur të harruar nga partitë politike shqiptare nëpër institucionet e "Shtetit të përbashkët", i ulen Rrumaducit në tavolinë, aq sa për një kafe dhe t'i japin detyra "patriotike" në zbulimin e "armiqve të Shtetit". Rrumaduci nuk ka njeri më as për farë të pi si shok lufte edhe një kafe. Rastësisht, më pyet ndonjë kalimtar i rastit: ku i ke sot dudumët? I përgjigjem: posa dolën nga xhamia.

Këtu pari janë nëpër tavolina me mikrofona në brez e xhepa, i presin në pusi partizanët partiak

për sulme strategjike para fushatës zgjedhore. Fytas të rroken me gotat e çajit të rusit mbi tavolinë me këmbët dhe trutë në legen. Përsëri duan ta nisin luftën për liri. E thirrin "pranverën arabe" edhe në Shkup. Moti e kanë filluar me protesta në rrugë, që nesër të dalin me kërkesa partiake para Qeverisë. Në ndërkohë, kur Rrumaduci më ka mbetur fillkat vetëm në tavolinë, vjen edhe Cuca e Sulçes me një shoqe për ngushllime dhe ulet në një tjetër tavolinë me shpinë të kthyer nga Rrumaduci. Nuk do ta shoh as me sy dudumin. Jo, Rrumaduci më në këtë jetë nuk ka njeri të gjallë e as xhenaze për ta ngushëlluar si rrufjan shqiptar. I ka mbetur vetëm edhe një tavolinë – "tabut" i zbrazët në atë jetë, para këmbëve të Xhebrahilit. Interesant, nuk e di pse ma kujton në Ditën e sotshme Bubën e fëmijërisë me shkop në Katund.

Bubën, që më kujtohet nga ditët e "lumtura" djaloshare, në errësirë matanë dritareve. Nëna ime ndjesë pastë, sa herë që bënim ndonjë bela, ose e kishte vështirë të na vë në gjumë si hutaçë të asaj kohe, na thoshte: Heshtni, se vjen Buba me shkop!

Edhe dihet se, nuk bënim bela ia futnim gjumit duke u strukur, mbuluar kokën me jorgan nga frika. Natën, edhe gërhisnim në gjumë, sharronim shelgje nëpër livadh, rrëzë Çukës. Pasmesnate, shihja ëndrra të tmerrshme: Xhindet duke më hedhur majë lisave mbi çatia dorë më dorë dhe pak para agimit më kthenin në mes Nënës dhe Babait. Tmerr, edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë sesi, ato nuk zgjoheshin nga gjumi.

Buba me shkop më ndoqi si hije pas shpine gjithë jetën: në Kërçovë, Shkup e Prishtinë. Ndoshta, ky qe shkaku kryesor që unë edhe ia pashë hajrin në letërsi. Përndryshe, një Zot e di se ku do të përfundoja si shkrimtar. Përgjigjeja juaj dihet: në Universitetin e shqiptarëve (Idrizovë). Faleminderit, ende deri më sot nuk kam bërë asnjë "vepër patriotike". E di, ju do të thoni: edhe sot mu si dje e kemi Bubën me shkop pas dere. Këmbën e lyer me miell duke na e treguar përmes hekurave të dritareve. Përmëtepër, ende na merr si edha të vegjël katundi mes livadheve t'ia hapim derën.

Gruaja ime besnike e ka fajin për këtë shkrim kaq të vonuar me vite, në fund të Dimrit. Bora kur na mbuloi fundekrye kopshtin dhe çatitë e shtëpive. Ftonit, pranë bunarit ia hudhi krahëve gunën e bardhë deri në fund të këmbëve. Kumbullat na i rrëzoi përtokë. Mollët i tërhoqi për setre. Edhe çatinë bashkë me pragun e Shtëpisë. Kohë qorre, kur Ushtria e maceve në kor me këngë patriotike protestojnë për ushqim pas dere. Minjtë na ecin nëpër Shtëpi si mbretër. Dr. Gaçi kërcnohet me veprime demokratike se, do të hidhet në grevë urie para Qeverisë. Mjetet e informacionit do t'i bombardojë me deklarata politike partiake. Dhe, ende pa i marrë "ilaçet" e mia të përditshme, pasi e kisha harruar kafen e mëngjesit mbi tavolinë, Gruaja ime besnike me dy shami lidhur për brezi e poshterkë të kuqe deri në fund të këmbëve, më tha: Vërtetë, sot jam bindur se e kam lehtë unë në punë e jetë, kur e kam Bubën me shkop pas dere.

E kuptova aty për aty se ku e kishte fjalën, kodër pas bregut i themi ne në Katund. Moti kohë për shumë njerëz në bazë të shkrimeve të mia satirike, Buba me shkop isha Unë, Kalosh Çeliku. Përmëtepër, e arsyetova veten si shkrimtar: Ndonjëherë, në jetë njeriu duhet të jetë edhe Bubë me shkop. Përndryshe, të marrin nëpër këmbë dudumët. Populli thotë: Nuk ngacmohet te bytha arusha me krënde. Kujt t'i teket i turret pas me brekët nëpër këmbë. Pastaj, oleleee kuku: më hëngri arusha! Rasti ma kujtoi ngjarjen e disa viteve më parë të djalit tim Asdrenit. Nëna e tij kur deshi ta vë në gjumë duke i rënë me dorë dërrasës të shtratit: Bam,baam, baaam... Bir, flej se vjen Buba me shkop.

Deni i vogël pas një heshtje në errësirë, i përgjgijet duke i rënë vetë dërrasës të shtratit: Mami, flej se vjen Buba me shkop! Frika, paprtimas atëherë qeshi nën shtrat, në dhomë. Matanë dritareve ëndrrat e hoqën një valle. Yjet i hapën sytë mbi çati. Lakuriqi u turr mes errësirës degë më degë. Huti me veshë i trembi zogjtë majë kumbullës në fund të oborrit. Zogu i Keq e thirri mëngjesin. Dita e nesërme zbriti më këmbë maleve nga qielli.

Vite e vite kanë kaluar që nga ajo kohë qorre. Fëmijët e sotshëm nuk i trembim më me Bubën me shkop pas porte, po me personazhet e përditshme politike të televizorit. Kompjuterit. Buba moderne këto shtëpiake, që i vënë në gjumë me sy të hapur edhe në mes të Ditës Madhe. Sonambël i nxjerrin në protesta "demokratike" edhe në rrugë.

Pasmesnate, edhe në vend të nënave i mbulojnë me jorganin e ëndrrave fantastike të livadheve. Dorë më dorë duke i hedhur në botën e fantazisë politike.

Vetëm unë siç duket gjithë jetën mbeta i papërmisueshëm, Bubë me shkop për dudumët që më lexojnë mbrapsht edhe sot e kësaj dite mes rreshtave. Fjalën nuk e kam për politikanët, që nuk dinë të më lexojnë fare. Burrat dhe gratë e mejdanit, që ende "vëllezërit" vazhdojnë t'i trembin me Bubën me shkop në Qeveri. Heshtni, mos e hapni gojën për të drejta të barabarta kombëtare të shqiptarëve! Buba me shkop, troket pas dere. Ose, kërkojnë me këmbëngulje të hanë kashtë nëpër shkrimet e mia publicistike.

Asgjë nuk kam kundër këtij soji të politikanëve, "analistëve" e lexuesve të trembur si lepujt nën ferra. Frika, që u ka hyrë në bark nga koha e komunizmit. I ka djegur tambëli, tashti i fryjnë edhe kosit. Përditë trumbetojnë suksese e premtime dhe nxjerrin në skenën politike fytyra të harxhuara që nga koha e komuizmit. Politikanë teknefes që me vite politikës shqiptare i ngatrrohen nëpër këmbë me luftën për pushtet. Fushatat zgjedhore të të cilëve më shumë përngjajnë në arena gladiatorësh, se sa në fushëbeteja politike. Gurë e dru hedhin mbi njëri tjerin me shpifje e etiketime. Përbaltin popullin shqiptar me përçarje politike duke na i përdhosur para syve simbolet kombëtare. Në vend që t'ia zgjasin dorën e pajtimit njëri – tjetrit, bashkojnë forcat politike për fitore para syve të popullit.

Dyert t'ia hapin krah më krah një gjaku të ri shqiptar. Fatkeqsisht, një gjaku të ri politik, që

nuk e kemi ende as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoni. Gjak të cilin partitë politike e kanë ngulfatur me vite, e kanë rrokë për fyti me të dyja duart. Vështirë qarkullon nëpër damarët e këtij populli, ngrejë krye në politikën shqiptare. Shkaku, se: kashtë kërkojnë "patriotët kuqezi" në grazhd. Kashtë u japin politikanët e sotshëm me kosh në mes të Lëmës. Metodë e re kjo politike - shkencore për ta ushqyer sot trurin e tyre sakat të arratisur nëpër institucionet e shtetit. Nuk i urrej e as ua kam inatin e lakminë me kokën në grazhdin e partive politike shqiptare e bythën te "vëllezërit" e Njerkës. U bëftë mirë, taxhia!...

Vetëmse, taxhinë e partive politike shqiptare nuk duhet ta shkelin me këmbë, tinëz fusin kokën në grazhdin e "vëllezërve" të Njerkës. Sofrën e shtruar shqiptare në mes të dhomës, së paku mos harroni ta ngreni pas buke! Traditë shqiptare brez pas brezi tradicionale: Bukë e kripë për mikun. Mundësisht, edhe një lutje: të përpiqeni gjatë zgjedhjeve lokale e parlamentare t'ua jepni votën e lirë demokratike individëve që e kanë dëshmuar veten për zgjidhjen e çështjes shqiptare, e jo partive politike që vite me radhë bëjnë luftën e argatit për pushtet.

Koha është, sot t'i lani duart nga "politika madhore" se, na morët më qafë...

*Shkup, 13 shkurt 2013*

# Shënime për autorin

Kalosh Çeliku lindi më 13 shkurt l951 në fshatin Cërvicë të Kërçovës (IRJ e Maqedonisë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme normale në Shkup, ndërsa studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Çeliku shkruan poezi e prozë për fëmijë e të rritur dhe gjer më sot ka botuar rreth dyzetë libra: ***Zogu erdhi me një këngë*** - vjersha (l982), ***Lepuri me pushkë*** - tregime (l983), ***Shtëpiza e xixëllonjave*** - tregime (1984), ***Ferexhja e zezë*** - dramë (1985), ***Arusha pa bisht*** - tregime (l986), ***Dielli zbret maleve*** - novelë (l986), ***Varrimi i sorrave*** - roman (1988), ***Vite me borë*** - roman (l990), ***Trumbetat e Tellallit*** - satira (l992), ***Imzot, lehin qentë*** - drama (1993), ***Trimi shihet në vepër*** - poemë (l994), ***Çohuni trima shaloni lapsin*** - rrëfenja (1994), ***Sorraku i Qytetit*** - pjesë teatrore (1994), ***Kali i Trojës nëpër Bit - Pazar*** - satira (1994), ***Loja e syve*** - poezi (1995), ***Babi ka dy nuse*** - roman, (1995), ***Vjellja e zorrëve*** - poezi (1996), ***Qyteti i qyqeve*** - roman (1997), ***E përcolla Natën*** - poezi (1998), ***Mbrëmë fjeta me Vjeshtën*** - poezi (1999), ***Kopeja me zgjebe ndjek Autorin*** - drama (2000), ***Shtëpia publike*** - roman (2000), ***Si u ndava me Gruan time***“ - satira (2001), ***Gratë e mia besnike*** - roman (2001), ***Lamtumirë bërllok*** - nëntë drama (2002, 2007), ***Me tre varre*** - roman (2002), ***Vdekja më deshi më pak se Ti*** - poezi (2003), ***Edhe Ajo nuk ishte xheloze*** - poezi (2004), ***Repriza e vëllazërim - bashkimit*** - dramë

(2005), ***Atdheu ky burrë pa Grua*** - poezi (2006), ***Kulturofagu*** - antiroman (2006), ***Burrat i përzë me burra e Mua me gra*** - poezi (2007), ***Engjëlli im është Grua*** - poezi (2007), ***Dimri, s'vjen me lule*** - 5 poema (2007), ***Ujku e di një lojë*** - poezi (2007), ***Kur bërtet "vojvoda" e pjell Kurvë Partia*** - satira (2008), ***Dac Poeti i shkruan poezi Mamit*** - poemë humoristike (2008), ***Ehu*** - poezi (2008), ***Gruaja besnike*** - roman (2009), ***Djemnusha*** - roman (2010), **Atdheu burrë pa Grua** - poezi (përzgjedhje, 2010), ***Xhadia*** - piblicistikë letrare (2011), ***Cuca Boheme u jep gji poezive të mia*** – poezi, përzgjedhje në gjuhën gjermane (2012), ***Plaga e dhjetë e Babait*** - roman (2012) etj.

Që nga viti 1992 ai drejton Shtëpinë Gazetare - Botuese ASDRENI, në Shkup dhe është kryeredaktor i të vetmes revistë për humor dhe satirë **ZEKTHI**, që **del kur t'i teket** në IRJ të Maqedonisë. Dhe, që nga ky vit (2009) mbarëkombëtarë, është fitues i disa çmimeve të konkurseve letrare në poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Njëherit, edhe i çmimeve letrare: PERENDESHË E BUKURISË, në Netët e Poezisë Korçare (2003), në Korçë, Çmimin AS për letërsi (2007), në Kërçovë, "SYRI I KALTËR" (2007), në Sarandë, "SEREMBE" (2008), në Laç, "FLAKADANI I KARADAKUT" (2009), në Viti, Çmim special për vëllimin poetik: EHU nga Simpoziumi Ndërkombtar " MUZA POETIKE ", " PEGASI " (2009), në Gjirokastër, "JEHONA E KARADAKUT" (2010), në Kumanovë,

"SKAMPINI" në Festivalin Ballkanik të pozisë (2010), në Elabasan, Kurora e poezisë "KORÇA 2012", në Korçë etj.

Drama ***Ferexhja e zezë*** është vënë në skenë nga disa teatro në Kosovë e IRJ të Maqedonisë dhe është mirëpritur nga publiku e kritika letrare. Edhe satira ***Ndihma e shpejtë*** u përgatit për t'u vënë në skenë me mjaft sukses nga Trupa teatrore " Aleksandër Moisiu " në Kumanovë dhe çoi pluhur nëpër kuluaret e oborrtarëve. Drama tjetër ***Zorra qorre*** dy herë me radhë u përgatitë për skenë, një herë në Kumanovë dhe herën tjetër në Strugë, po i ranë në gjurmë kulturofagët dhe nuk u shfaq para publikut. Një fat të këtillë kanë pasur edhe pjesët teatrore për fëmijë të shpërblyera me çmime letrare duke u luajtur në skenë dhe duke u emetuar përmes valëve të radiotelevizionit të Prishtinës (Kosovë) dhe Tiranës (Shqipëri).

Krijimtaria e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë: maqedone, gjermane, turke, bullgare, rumune, greke etj. Që nga viti 1992 – 1997, ishte nënkryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar dhe kryetar 1997 – 2001. Momentalisht është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në IRJ të Maqedonisë. Dhe, themelues i disa manifestimeve kulturore tradicionale ndërkombëtarë: Ditët e Naimit, në Tetovë, Takime nën Rrap, në Shkup (poezi erotike) dhe i Ditëve të humorit dhe satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Poashtu është edhe themelues dhe kryeredaktor i revistës letrare **STILI 97**, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë.

Çeliku gjer më vitin 1995 punoi si mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenicë të Kosovës dhe Malësinë e Shkupit. Vitet e fundit punon dhe jeton në Shkup, tashmë në profesionin e lirë të shkrimtarit.

**Lufta vazhdon me penë...**

# Përmbajtja

**Në vend të parathënies**
ÇELIKU ZË VEND TË VEÇANTË
NË LETRAT SHQIPE / 7
**I PROFETI**
Kryevepra / 19
Faqezinjtë erdhën edhe në Shkup / 25
Arratisja e Profetit në Baba Tomor / 30
Shtrigani i Allahut / 34
Edhe Filipi i Maqedonisë vjen në Shkup / 43
Rrufjani/ 46
Shkupi një ditë do ta gëdhij mëngjesin
si kryeqytet i Shqipërisë Etnike / 55
Rrugaçja / 60
Darkën e shita për një birrë / 66
**II RRUGA QORRE**
Mëzi im i bukur ende i palëpi / 73
Gjaku dhe fisi flasin shumë për pasardhësit
e familjes / 76
Nata e Madhe dhe Dita e Nesërme
nën Rrap, në Shkup / 81
Regjistrimi i popullatës sa për sy e faqe / 85
Honxhobonxho / 88
Rruga qorre / 93
Bërlloku kur i sulmon institucionet shqiptare /98
**III KOHA ËSHTË SOT SHQIPËRIA**
**TA HUDHË GUNËN KRAHËVE**
Lëngu i turshisë / 102
Sheikut në Shkup i pëlqyen qoftet
e “Destanit” / 106
Mëzati i tredhur kuqezi / 109
Dashuri me tullumbat / 113

Koha është sot Shqipëria
ta hudhë gunën krahëve / 118
Pazari i librit / 123
Delezezat e nënkryeme kakademike / 129
**IV ASKUSHËT SI ARGATË BESNIK TË PARTIVE POLITKE**
Datja* hyri në konak pa asnjë kobure / 132
Arusha me dajre heq valle / 138
Askushët si argatë besnik të partive politke / 143
Dlladia politike e butakëve para Motit Madh/ 149
Rrumaduci / 158
Demi / 170
"Vëllazërim-bashkimi" i neokomunsitëve / 174
**V LUFTA PËR PUSHTET E VESHUR "KUQEZI"**
Këlyshët me zgjebe ndjekin Autorin / 181
Partizani i vogël zbuloi shokët / 186
Babadimri pushtoi Kumanovën
para Vitit Ri 2012 / 191
Lufta për pushtet e veshur kuqezi / 197
Namqorri nuk e sheh rrugën
e Mesditës Madhe / 203
Rebelja / 209
Rrena / 212
**VI TRËNDAFILJA DHE FACEBOOK**
"Çertifikata e shkrimtarit"
merret në Shkodër / 220
Dudumët nën sjetullat e partive politke / 227
Diagnoza teknefese e Policisë letrare / 233
O burrë, kot i bie samarit
nuk i teket gomarit / 244
Kryengritësi / 247
Trëndafilja dhe Facebook / 253
Punëmadhja / 257

Qoftëlargu / 264
Përpak desh i përzimë kësulat / 269
**VII RRUGA E MISTIKËVE PËR NË BABA TOMOR**
Liqeni ky burrë – Muzë i poetes rebele / 276
Rruga e mistikëve për në Baba Tomor / 280
Sanço Pançot hipur mbi gomarë / 286
Pjeshka e Katundit / 295
Kakademiku / 299
Protesta politike me petk fetar / 309
"Përralla e përgjakshme" maqedonase / 315
Hoxha i Allahut / 320
Thirrja në "Din e Iman" për hakmarrje / 328
**VIII MOTI MADH**
Unaza magjike / 337
Filipi Dytë i Maqedonisë si xhaxhi Enver/ 343
Ashiku i Rrapit vdes i ri / 352
"Xhami" pa minare / 357
Qorrfishekë kërçove dhe groshë tetove / 366
Enesërmja vjen Nuse me koçi / 373
PYKË shelgu / 385
Rruga e vetme deri te Liria / 385
Moti Madh / 395
**IX KOPILAT QË I POLLI XHADIA DHE NA I LA PAS PORTE**
Kalorësit e arratisur me një këmbë në varr / 400
Poeti rebel i pozive të egëra / 406
Sahat me një akrep / 411
Hojdodolja / 419
Miqtë e Rrapit me poezi erdhën në Shkup / 430
Xha Deralla na e hodhi edhe kësaj radhe / 435
Rrapi më ndejk si hije anembanë Atdheut / 440
Kopilat që i polli Xhadia
dhe na i la pas porte / 445

Qysh ka ditur me e bë Zoti
kaq bukur Shqipërinë / 455
**X TRI HERË MATE E NJËHERË PREJE**
Zonja Vdekje kjo grua me teke
dhe kurtizane / 471
Deledashi / 476
Burrat nuk i dorëzojnë armët
para se mejdanin / 484
Zhurmë e dalldisur "kulturore" / 489
Parku i "Çairit" mes sëpatave
politike dhe fetare / 501
Tri herë mate e njëherë preje / 506
Koha është pak "sehir" të shohin shqiptarët / 514
Shtëpia e Babait rrëzë Çukës / 522
Mikja nën Rrap dhe poetët
që nuk ikin nga Atdheu / 524
Gozhda e Nastradin Hoxhës / 532
Pesë askushët e Njerkës ndjekin Artisitin / 542
Vetëvrasja "artistike" e Abdulhakimit / 548
Xhindihalli / 556
Shpallja e "republikave" nëpër katunde / 563
Populli shqiptar e shkruan vetë historinë / 569
Fitorja historike / 573
Papagaj politik kafazi
me dyer të hapura/ 582
Enesërmja është në duart
e shqiptarëve / 587
**Dhe në fund**
Koha është t'i lani duart
nga "politika madhore" / 596
shënime për autorin / 603

Cip katoligizimi në publikim Biblioteka popullore dhe universitare « Sv. Kliment Ohridski « , Shkup

821.18 (497.7) - 92

ÇELIKU, Kalosh

Rrufjani: (Publicistikë letrare) / Kalosh Çeliku. - Shkup: Asdreni. 2013. - 612 f.; 23 cm. - (Biblioteka: Xha Deralla)

ISBN 978-9989-174-66-7
COBISS.MK-ID 91309066

KALOSH ÇELIKU
RRUFJANI

Botues
ASDRENI

Korrektore
Fitore DERALLA

Formulimi kompjuterik
Ilir EMINI

Tirazhi: 1.000 kopje

U shtyp në shtypshkronjën:
**Tringa Design**
Tetovë, 2013